

PËRRALLAT E TRANZICIONIT SHQIPTAR

SHINASI A. RAMA

I lindur në Shkodër më 1959, ka magjistruar në South Carolina University (1992-1996), mban gradën Doktor i Shkencave Politike nga Columbia University (1996-2004) dhe është Profesor Klinik në Departamentin e Politikës në New York University në SHBA. Është Drejtor i Programeve të Masters në Departamentin e Politikës të NYU dhe Zv. Drejtor i Qendrës Alexander Hamilton për Ekonominë Politike. Jep mësim në nivelin mbasuniversitar në NYU dhe në Columbia University.

Ai ka qenë edhe Organizues dhe Drejtues i Lëvizjes Studentore të viteve 1990-1991, bashkëthemelues i Partisë Demokratike, Anëtar i Komisionit Nismëtar të PD-së. Gjatë Luftës së Kosovës ka qenë Zëdhënës i UÇK-së në SHBA, Këshilltar Politik i Delegacionit Shqiptar në Rambuje dhe Këshilltar i Lartë Politik i Kryeministrit të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës.

Libri i tij “Probleme Politike Shqiptare” është botuar në vitin 2006.

SHINASI A. RAMA

Përrallat e tranzicionit
shqiptar

BOTIMET PRINCI
TIRANË • SHKURT 2012

Botues: Myftar Gjana

Autor: **SHINASI A. RAMA**

Titulli: Përrallat e tranzicionit shqiptar

Redaktor letrar: Vaid Hyzoti

Botimi i parë: Princi, Shkurt 2012

© Copyright Shinasi A. Rama

Të gjitha të drejtat janë të mbrojtura me ligj dhe të rezervuara prej autorit.

Riprodhimi i librit, qoftë edhe në formë të pjesshme, është i ndaluar. Nuk mund të kopjohet asnjë pjesë teksti pa lejen dhe miratimin paraprak të autorit, i cili është mbajtës i vetëm i së drejtës së botimit, përveç rasteve kur kjo e drejtë lejohet qartazi nga ligji.

Dizajni: Irena Buzi

ISBN

Shtypja u krye në **shtypshkronjën....**
Tiranë, Shqipëri, Shkurt 2012

Në kujtim të prindërve të mi

SAMIJE RAMA (GUSHTA) dhe **ALI RAMA,**

që vuajtën kaq shumë por ditën me e mbajtë dhimbjen e vuajtjen
e tyre për vete dhe me na ruajtë prej së keqes që gjindej gjithkah
rrotull nesh e që nuk ka shkue askund.

Përmbajtja

PARATHËNIE (15)

I. STUDIMI I TRANZICIONIT: KËNDVËSHTRIME TEORIKE DHE RASTI SHQIPTAR (23)

Një rast i veçantë? Rasti shqiptar dhe paradigmat e.....	
shkencave shoqërore.....	27
Tranzitologjia.....	34
Projektet modernizuese dhe specifika e problemit shqiptar.....	42
Paria: faktori qëndror për dështimin e tranzicionit.....	47
Machiavelli: Princi dhe Madërgonat.....	49
Gaetano Mosca: oligarkia, klasa politike, dhe formula politike.....	52
Vilfredo Pareto.....	55
Teoritë e parive dhe rasti paradoksal shqiptar.....	57
Dy fjalë mbi influencat teorike.....	73

II. MBI DËSHTIMIN E TRANZICIONIT DHE PËRGJEGJËSINË HISTORIKE TË PARISË: NJË VËSHTRIM I SHPEJTË (75)

III. NJË PROCES QË NUK KA PËRFUNDUAR ENDE: SHPËRBËRJA E ISH-JUGOSLLAVISË SI PROBLEM QËNDROR I POLITIKËS SHQIPTARE (94)

IV. MBI FUSHATËN PËR ZGJEDHJET KUVENDORE TË 28 QERSHORIT 2009 (99)

Përse shherri mediatik është në nivelin e rrugës?.....	99
Përçaj e sundo: një teknikë që funksionon.....	102
Mbi disa aspekte themelore të demokracisë.....	
që mungojnë në sistemin shqiptar.....	106
Në vend të mbylljes: një reflektim.....	108

V. PARIJA E TIRANËS: PROBLEMI THEMELOR I DËSHTIMIT TË TRANZICIONIT (110)

Kush është paria e Tiranës?.....	110
Problemi që paraqet shtresa sunduese e parisë së Tiranës.....	118
Si duhet trajtuar kjo pari e çfarë duhet bërë me të?.....	121

VI. PSE NUK KA PARTI NACIONALISTE EFEKTIVE
NË SHTETIN SHQIPTAR? (123)

VII. "DJALLI DHE SHISHJA":
PROBLEMATIZIMI I MENDËSISË SË PARISË SË TIRANËS (127)

Problemi i djallit dhe i shishes:	
sjellja e parisë në kontekste të ndryshme.	127
Nga vjen ky dualizëm në vlera e në sjellje?.....	130
Si u soll paria gjatë tranzicionit?.....	131
Cilat janë rrënjët dhe pasojat e kësaj sjelljeje?.....	133
A mund të ndahet paria e Tiranës nga mendësia e saj kriminale?....	135
Mbyllja e tranzicionit.....	140
Përfundim.....	143

VIII. PROBLEMATIZIMI I PAVARËSISË SË KOSOVËS DHE RIKTHIMI
I ÇËSHTJES KOMBËTARE SHQIPTARE (144)

IX. ROBERT MICHELS, LIGJI I HEKURT I OLIGARKISE
DHE POLITIKA E TIRANES (155)

X. DËSHTIMI I NDËRTIMIT TË SHTETIT TË DUHUR
GJATË TRANZICIONIT (163)

Dy fjalë mbi shtetin.....	164
Problematizimi i gjendjes së shtetit ndër shqiptarët.....	166
Ndërtimi i shtetit si objektiv qëndror i tranzicionit.....	168
Pse jemi në këtë gjendje?.....	171
Justifikimet ideologjike të parisë.....	173
Cilat janë pasojat e dështimit të shtetit.....	175
Nga vjen zgjidhja.....	177

XI. PARIA E TIRANËS DHE SHTERPËSIA
E FUSHATËS SË SAJ ELEKTORALE (180)

Programet Elektorale.....	182
Fenomeni Lufter Xhuveli.....	183
Prijatarët në qendër të vëmendjes.....	185
Paria e Tiranës si dhëmbë të një goje që bluajnë për vete.....	186
Si grindet, pse grindet dhe si do ta zgjidhë problemin e vet paria....	187

Përse i duhet personalizimi i debatit parisë së Tiranës.....	187
Përse parisë së Tiranës i intereson mungesa e debatit ideologjik. ...	189
Mbyllje.....	191

XII. PROBLEMI I LEGJITIMIT TË SISTEMIT
DHE BOJKOTI SI ARMË E DOMOSDOSHME POLITIKE (193)

Si e siguron legjitimitetin paria e Tiranës?.....	194
Legjitimimi i sistemit dhe palët e interesuara.....	198
Si shprehet besnikëria ndaj sistemit e ndaj parisë?.....	199
Cilat janë rrugët që mund të ndiqen?.....	203
Bojkoti si rruga e vetme për të luftuar sistemin.....	205
Përfundimi.....	207

XIII. MITI QENDROR I TRANZICIONIT:
LËVIZJA STUDENTORE E VITEVE 1990-1991,
PËRLESHJA E RRADHËS DHE PARIA E TIRANËS (208)

XIV. PERËNDIA DYFYTYRËSHE, NDRYSHIMI DHE VAZHDIMI
NË ZGJEDHJET E 28 QERSHORIT 2009 (213)

Bojkotimi i procesionit.....	216
------------------------------	-----

XV. OBJEKTIVI I TRANZICIONIT, LUMTURIA KOMBËTARE,
DHE QEVERIA E INTEGRIMIT (218)

XVI. MAKINA OLIGARKIKE E PARISË SË TIRANËS
DHE DËSHTIMI I DEMOKRACISË SHQIPTARE (227)

XVII. MËRGIMTARËT DHE SHKËPUTJA E MADHE (233)

XVIII. MORALI DHE POLITIKA: RASTI SHQIPTAR (243)

XIX. MBRRITJE DHE DËSHTIME: PËRSIATJE
MBI GJENDJEN DHE JUSTIFIKIMET E PARISË (252)

Ana tjetër e tranzicionit.....	254
Si duhet të vlerësohen arritjet e prekshme në jetën e njerëzve?.....	255
Pasurimi përmes politikës.....	261

Problemet me mendimin se “kështu si ne, e kanë filluar që të gjithë.”	263
Mungesa e ideologjive	266
Shqiptarët kanë një qeveri që nuk e meritojnë.....	269
E ardhmja vendoset nga veprimet e përditshme	271

XX. POLITIKA E PAZËVENDËSUESHMERISË: SISTEMI OLIGARKIK
DHE MUNGESA E ALTERNATIVAVE POLITIKE (274)

XXI. 20 VJET MBAS RËNIES SË MURIT TË BERLINIT:
TRADHËTIA E MADHE (282)

XXII. MANIPULIMI I DASIVE POLITIKE:
OBJEKTIV PARËSOR I PARISË SË TIRANËS (292)

XXIII. ELIMINIMI I KUNDËRSHTARËVE POLITIKË:
DISA METODA KONTROLLIMI TË SISTEMIT NGA PARIA (304)

XXIV. SHTETI MAFIOZ DHE NEVOJA PËR NDRYSHIM (316)	
Problemi: modeli i Haitit në Europë	317

XXV. PO SHKOJMË KU ISHIM – PËRSIATJE MBI GJENDJEN,
20 VJET MBAS RËNIES SË MURIT TË BERLINIT (320)

XXVI. DON KISHOTIZMI I RREMË
SI ZGJIDHJE POLITIKE E PARISË SË TIRANËS (326)

XXVII. SUKSESI I DYSHIMTË I PARISË SË TIRANËS:
KRIJIMI I NJERIUT TË RI TË TRANZICIONIT (334)

XXIX. RRETHIMI DHE INTEGRIMI –
MBI KONCEPTIN STRATEGJIK TË PARISË SË TIRANËS (348)

XXX. PROBLEMI I KRIMINALIZIMIT TË PARISË:
SHKAKU KRYESOR I DËSHTIMIT TË SHTETIT SHQIPTAR (356)

Shteti dhe krimi i organizuar.....	357
Origjinat e kriminalizimit të shtetit dhe të parisë së Tiranës	359
A mundet para e Tiranës të ndërrojë rrugë?	364

XXXI. PËRSËRITJA E HISTORISË: MBI SKANDERBEGUN E TRANZICIONIT (366)

XXXII. INTELEKTUALËT DHE
PSEUDO-INTELEKTUALËT E TRANZICIONIT (373)

Intelektuali dhe vendi i tij në shoqëri	373
Intelektuali dhe Politikani	375
Një shembull zgjidhjeje politike:	
kërkesa për transparencën e zgjedhjeve.....	376
Një interpretim ndryshe i kërkesës për transparencën e zgjedhjeve ..	378

XXXIII. DISA MENDIME MBI SHKRIMIN E SHABAN MURATIT:
"DIPLOMACIA PUBLIKE DHE GLOBALIZIMI RAJONAL" (383)

XXXIV. KATUNDARIZIMI: PROBLEMI I MENDËSISË KATUNDARE
SI SËMUNDJA E POLITIKËS BASHKËKOHORE SHQIPTARE (394)

Ibn Khalduni, katundaria dhe teoria e qarkullimit të parive	395
Ibn Khalduni dhe rasti shqiptar	397
Katundi si forma më e përhapur e organizimit të shoqërisë shqiptare	399
Paradoksi i sundimit të mendësisë katundare në politikën shqiptare..	404
Përkufizimi i katundarit dhe i mendësisë katundare.....	407
Dy shembuj që ilustrojnë paradoksin e lidhjes së parisë me popullin..	412
Pse paria e Tiranës është fajtores për gjendjen?	414
Përfundim.....	420

XXXV. SHTETI I GANGSTERËVE, DËSHTIMI I TRANZICIONIT,
DHE NEVOJA E NJË FILLIMI TË RI (422)

Dilema e parisë së Tiranës	423
Objektivat dhe niveli i realizimit të planeve të parisë	426
Dilema e qytetarëve	427
Cila është rruga ndryshe?	429
Kush do ta bëjë ndryshimin?	430
Çfarë duhet të bëhet?	431
Përmbledhja e argumentit	432

XXXVI. RRETHI VICIOZ I TRANZICIONIT DHE BOJKOTIMI I SISTEMIT
SI DOMOSDOSHMËRI SJELLJEJE POLITIKE (434)

XXXVII. KAOSI TOTALITAR (442)

Ku po shkojmë?	448
----------------------	-----

XXXVIII. PASHMANGSHMËRIA E GJENDJES
DHE ZGJEDHJA E VULLNETSHME (450)

XXXIX. ZGJEDHJET LOKALE DHE SJELLJA E FAKTORËVE QENDRORE
NË POLITIKËN SHQIPTARE (459)

Zgjedhjet e vitit 2011 si pikë kthese në tranzicion	459
Faktori ndërkombëtar	460
Votuesit	461
Paria dytësore	462
Struktura zgjedhore	463
Paria e Tiranës	463
Përfundim	465

XXXX. MANIPULIMI I REALITETIT:
PARADOKSET E ZGJEDHJEVE LOKALE TË 8 MAJIT 2011 (466)

Gjendje kritike dhe premtime idilike	469
Flamuri i unitetit dhe thellimi i prekshëm i dasive politike e shoqërore	476
Fushata është thellësisht “ideologjike”,	
por zgjidhjet që ofrohen janë pragmatike	478
Zgjedhje demokratike dhe politikanë të kriminalizuar	480
Zgjedhje demokratike, por vendimet merren nga të huajt	482
Pragmatizmi katundar dhe çështja kombëtare shqiptare	483
Përfundim	484

XXXXI. PARIA E TIRANËS DHE KATËR PROBLEMET POLITIKE
TË PAZGJIDHSHME TË TRANZICIONIT (485)

Rrethi vicioz i mendësisë katundare dhe të kriminalizuar të shoqërisë	485
Sistemi demokratik: problemi i zgjidhjeve të përkohëshme	489
Ideologjia shtetformuese dhe kombëtariste	491
Roli qëndror i shtetit në shoqëri	492
Kriza shqiptare dhe rruga e daljes nga tranzicioni	497

PARATHËNIE

Kjo përmbledhje është një përpyetje për të reflektuar mbi shkaqet e dështimit të proceseve historike të transformimit të gjithanshëm të shoqërisë shqiptare, e të kalimit nga një sistem shoqëror në një tjetër, pra të kësaj periudhe mbi-20 vjeçare të përcaktuar si tranzicion. Analizat janë përgatitur si pjesë të një mozaiku refleksionesh, të shkruara për t'u botuar në shtypin e përditshëm, të quajtur 1001 Përrallat e Tranzicionit. Shtysa për analizat është marrë nga ngjarje reale që kanë ndodhur gjatë këtyre dy viteve të fundit, si zgjedhje, përkujtimore, mitingje, formime koalicionesh, takime ndërkombëtare, fjalime politikanësh, apo reflektime lidhur me analiza e komente të botuara në shtypin e përditshëm.

Por, analizat nuk janë thjesht një përmbledhje mekanike dhe gazetareske e shkrimeve, të botuara për probleme të ditës, në shtypin e ditës gjatë këtyre dy viteve të fundit. Edhe pse një pjesë e tyre janë botuar në shtypin e përditshëm, si tek *Libertas*, *Gazeta Shqiptare*, *Sot*, *Shekulli*, *TemA*, *Panorama*, shkrimet iu kanë shkuar me postë elektronike të gjithë organeve të shtypit. Kush e ka parë të arsyeshme i ka botuar. Këtu, analizat janë paraqitur të ripunuara dhe për një audiencë tjetër. Në procesin e ripunimit të librit, mbasi e pashë të nevojshme që t'i bëj mendimet më të qarta dhe të kuptueshme për lexuesin, analizat i kam prekur në disa pika, veçanërisht në anën argumentative e teorike. Nevoja për të qartësuar e fthillar më mirë aspektet teorike e praktike të problemeve që trajtohen këtu, si dhe për të zhvilluar argumentin e paraqitur në një kohë tjetër, natyrisht, pa prekur ndonjë parashikim që është bërë në lidhje me fenomene të caktuara,

ishite e pashmangshme. Mendimet, që ishin shprehur me shpejtësi e lehtësi, shpesh ishin të hedhura shkujdesshëm, dhe kishin nevojë për sistemim e sqarime, që do t'i bënë të kuptueshme për gjithkënd.

Pavarësisht nga ka ardhur shtysa e momentit, në këtë përmbledhje, jam munduar që t'iu ofroj përgjigje, kryesisht e sistematikisht, tre pyetjeve kryesore. Së pari, a ka arritur paria sunduese që të ndërtojë shoqërinë që iu garanton shqiptarëve sigurinë e jetës, të nderit, të pronës, begatinë e ardhmërinë që meritojnë ata, ashtu siç bënë paritë respektive për popujt e tjerë të Europës Lindore? Ky do të ishte fundi i tranzicionit të suksesshëm për shoqërinë shqiptare. Së dyti, në se nuk është arritur që të ndërtohet një shoqëri me struktura, me institucione, me vlera, me kulturë, me identitet, e me objektiva që e bëjnë të mundshme zhvillimin progresiv, në vazhdimësi dhe me qëndrueshmërinë që nevojitet, ku duhet kërkuar përgjegjësia historike? Së treti, çfarë duhet bërë me ndryshue, me vendosë, e me konsolidue një sistem të ri, i cili do të garantojë të ardhmen më të mirë të mundshme për shqiptarët?

Përgjigja e këtyre tre pyetjeve vjen përmes analizimit të aspekteve të ndryshme të tranzicionit, të para nga kënde të ndryshme. I përsëritur rregullisht, në fund të çdo shkrimi, e për tema të ndryshme, argumenti im është se tranzicioni ka dështuar në arritjen e objektivit të përbashkët të shqiptarëve. Eksperimenti shoqëror, që u ideua dhe u drejtua nga paria, ka dështuar për të ndërtuar një shoqëri normale dhe demokratike, e cila mund të ofrojë siguri njerëzore, mbrojtje shoqërore, mundësi zhvillimi, përparim ekonomik e begati për të gjithë shqiptarët. Duke vlerësuar ndryshimet pozitive që janë arritur në drejtime të caktuara, ky gjykim ofrohet duke mbajtur në mend gjithnjë çmimin e pakrahasueshëm që është paguar për ato mbrojtje. Po ashtu, gjykimi im mbështetet në shkallën e mundësive që u krijuan, si dhe në sasinë e në cilësinë e burimeve njerëzore e ekonomike të jashtëzakonshme që paria, dhe e gjithë shoqëria shqiptare, pati në dispozicion mbas vitit 1990. Është gjithnjë më e vështirë me gjykye sjelljen njerëzore nga këndvështrimi i synimeve dhe i

qëllimeve se sa i të dhënave faktike. Por, pa një gjykim të tillë, nuk mundet me u vlerësue si duhet përvoja historike. Shkurt, mendimi im është që ishte dashtë që të përfitohej shumë më shumë nga mendësia historike që u krijua.

Ka edhe faktorë të tjerë, si *Zeitgeist*, mendësia popullore, dhe influencat e huaja, që luajnë një rol të madh në këtë proces të dështimit të tranzicionit. Mirëpo, duke mos e nënvlerësuar rëndësinë e këtyre faktorëve, mendimi im është se nuk ka fare dyshim që shkaktarja kryesore, për këtë dështim të tranzicionit, është paria e Tiranës. Kjo shtresë numerikisht e ngushtë, që kontrollon me dorë të hekurt pushtetin politik, sistemin ekonomik, dhe vlerat kulturore në shtetin shqiptar, në dukje, është amorfe, e fragmentarizuar, dhe e përçarë. Por, në realitet, “e kapur si lëmashku në ujë,” kjo rrjetë e ndërlidhur e parisë është e lidhur me një mijë fije tejet të qëndrueshme përmes interesave, vlerave, edukimit, lidhjeve farefisnore, origjinave, mendësisë e qëllimeve të përbashkëta brenda një brezi e midis brezave të njëpasnjëshëm. E lidhur mbas individëve të veçantë e klaneve respektive, paria ka punuar vetëm e vetëm për të ruajtur interesat e saj.

Krizat që ka kaluar shoqëria shqiptare janë të njëpasnjëshme e shumë tranduese. Por, në mos tjetër, *Fortuna*, e papritura, e paparashikueshmja dhe rastësorja në histori, siç thotë edhe Machiavelli, nuk i ndërron njerëzit aq sa i kultivon karakteristikat e tyre të vërteta. *Fortuna* i bën që të tregojnë karakterin e tyre të vërtetë. Paria kishte dijen, zotësinë, aftësitë, stërvitjen dhe edukimin për të bërë zgjedhjen e duhur. Prandaj, përgjegjësia historike për dështimin e tranzicionit nuk duhet t’i mbesë karakterit dhe kulturës së popullit shqiptar, një popull që është mbajtur qëllimisht në errësirë për kohë të pafund. Nuk mundet me iu lënë përgjegjësia as të huajve që, në fund të fundit, nuk janë përgjegjës, e nuk kanë ndonjë interes jetik për zhvillimin e shtetit shqiptar. Nuk mund t’i mbetet përgjegjësia as rrethanave historike, apo edhe vetë *Fortunës*.

Kur një shtresë e caktuar, shumë e organizuar, me ide të qarta, dhe e përgatitur mirë, lufton me të gjitha mënyrat e me vetëdije të plotë, vetëm e vetëm për të ruajtur sundimin e vet, i arrin

objektivat e saj. Paria, edhe kur është numerikisht e papërfillshme, e përcakton fatin historik të një populli dhe është në gjendje t'i shmangë efektet e rastësive historike nga vetvetja, dhe, po të jetë e përgjegjshme, edhe të ruajë popullin e vet. Në shtetin shqiptar, me vetëdije, paria mendoi vetëm për veten e vet dhe nuk u kujdes aspak për popullin shqiptar. Sistemi që është ndërtuar është sistemi që ajo ka punuar që të ndërtojë. Prandaj, përgjegjësia e dështimit të tranzicionit është e shtresës sunduese.

Karakteristikat e përbashkëta, që ka pasur e që e dallojnë edhe tani, e që paria i shfaq hapur gjatë tranzicionit, ishin shumë të frikshme. Përtej kësaj, paria ka arritur që t'i imponohet të gjithë shoqërisë shqiptare. Kjo ka ndodhur jo vetëm në marrjen e vendimeve të rëndësishme strategjike, por edhe në çdo aspekt të jetës së përditshme. Si pasojë, paria e ka deformuar dhe kriminalizuar shoqërinë deri në një pikë të rrezikshme, aq sa kthimi në normalitet duket thuajse i pamundur. Në këtë drejtim, paria ka qënë tejet e suksesëshme. Por, arritja e saj, si pari, si shtresë shoqërore, është fatkeqësia e të gjithë shqiptarëve si komb. Tash, paria mundohet që ta paraqesë atë që ka ndodhur si *Fortuna*. Por, në fakt, *Fortuna* kanë qënë një numër i pafund dhe i njëpasnjëshëm vendimesh të marra nga paria dhe nga prijatarët e saj.

Dy fjalë në lidhje me qasjen e përmbledhjes. Së pari, *caveat emptor*, njerëzit që e jetojnë përditësinë në realitetin shqiptar kanë zhvilluar mekanizma jetese, argumente mbrojtëse, si dhe justifikime të shumëfishta kulturore për sjelljet e tyre. Këto argumente kulturore apo të rrjedhura nga praktika e përditshme, janë përforcuese të interesave, të lidhura fort me dhe që mbështesin njëri-tjetrin. Veprimet e tyre të përditshme, në kushte të tjera, do të konsideroheshin si pastërtisht kriminale ose jonormale. Megjithatë, në shtetin shqiptar sjelljet kriminale janë bërë shoqërisht të justifikueshme. Për shumë prej njerëzve, ai realitet është normaliteti, dhe jeta, për ta, nuk imagjinohet ndryshe. Edhe kur e dinë se i kanë "shkepë me rrena" e me mashtrime, njerëzit durojnë thjesht sepse kanë një jetë më të mirë në disa drejtime, d.m.th. materialisht, standardi i tyre i jetesës është më i mirë se sa standardi i jetesës që kishin në vitin 1990. Ata shohin përmirësim

relative të gjendjes ekonomike e materiale, dhe ndalen në atë pikë. Mosngopja e barkut me bukë në sistemin e dikurshëm, dhuna dhe kontrolli totalitar i shtetit, që janë të pashlyeshme në mendjen e brezave mbi një moshë të caktuar, përcakton edhe shkallën e gjykimit të tyre lidhur me tranzicionin. Problemi është se në sistemin enverist gjendja materiale ka qënë aq e keqe, dhe shtypja ka qënë aq ndrydhëse, sa çdo gjë që mund të ndodhte mbas vitit 1990, do të ishte një përmirësim i pakrahasueshëm.

Por, edhe për këta njerëz që ende gjykojnë me urinë e me varfërinë e dikurshme, nuk mjafton vetëm ana materiale. Njerëzit gjithmonë duan që të besojnë në diçka që e justifikon sjelljen e tyre si të moralshme, dhe që i konsideron praktikat që janë në të mirë të interesit të tyre të ngushtë, si rrugën e drejtë të sjelljes në shoqëri. Për të funksionuar shoqëria, duhet arritur kodifikimi i këtyre sjelljeve, që duhet të konsiderohen si sjellje të moralshme, të pranueshme, e praktikisht të pazëvendësueshme nga të gjithë.

Prandaj, edhe kur nuk ka një ideologji të gatshme, njerëzit shpikin argumente e vlerësojnë sjellje që bëhen koherente, konsistente dhe që, me kohë, marrin dukjen e një botëkuptimi, pavarësisht se sa irracionale që mund të duket ajo sjellje nga jashtë atij realiteti. Në realitetin shqiptar, për shumë vjet, objektivi i njerëzve ka qënë mbijetesa. Kjo është arritur nga shumica e njerëzve duke punuar kundër ligjit e shtetit, si dhe kundër shumë formave të tjera të moralshme të organizimit shoqëror. Për ata që ikën, mbijetesa është siguruar, në rastin më të mirë, duke mbetur në pjesën e padukshme të shoqërive e të shteteve perëndimore si mërgimtarë. Nga ana e saj, paria e Tiranës përdori shtetin dhe dijet që kishte për të forcuar oligarkinë e vet. Shoqëria përdori klanin katundar, forcën, dhe hapësirën e ligjshme e të paligjshme që iu krijua me rrënimin e shtetit. Tashmë, të dy palët po ecin në rrugë të ndryshme. Edhe pse pajtohen se forcimi i shtetit është një problem për të dy palët, zgjidhja e krizës kalon përmes forcimit të shtetit.

Duhet kuptuar qartë se njerëzit e racionalizojnë gjendjen e tanishme, si dhe sjelljen e tyre në luftën për mbijetesë gjatë tranzicionit, duke e krahasuar me mjerimin e fundit të viteve

1980-të. Nuk ka dyshim që shumicës së shqiptarëve, jeta e tyre personale, *relativisht*, nga ana materiale, iu duket shumë më e mirë gjatë tranzicionit se sa ka qënë më parë. Në jetën e njerëzve, shteti, që tashmë është një instrument i pakushte, korruptiv, e zvetënues nën kontrollin e padiskutueshëm të parisë, është kthyer në armikun kryesor të shumë njerëzve. Problemi është se rruga e pasurimit, por edhe e mbijetesës, kalon përmes krimit, si dhe në kundërvënien të hapur ndaj shtetit e ndaj moralit të një shoqërie normale. Duke qënë se paria ndan të njëjtën mendësi, se pse kjo gjendje i shërben më së miri, situata është me të vërtetë kritike.

Prandaj, edhe realiteti shqiptar, që për mua është një realitet krejtësisht anormal dhe i shfjytyruar, është edhe lehtësisht i kuptueshëm dhe e ka shpjegimin e vet, logjik, dhe të mbështetur me një masë të pakundërshtueshme provash, tek sjellja e parisë. Edhe kundërshtimi për rrugën e zgjedhur vjen pikërisht prej kuptimit të ndryshëm të asaj se çka ka qënë dhe është normale, njerëzore, e nevojshme, e dobishme, si dhe, mbi të gjitha, racionale dhe *e mundshme* për shoqërinë bashkëkohore shqiptare.

Po ashtu, në disa pika, gjatë paraqitjes së këtyre argumenteve ia kam lejuar vetes lirshmërinë e të shprehurit që, vende-vende, duket sikur është edhe emocionale. Këtu nuk ka fare elemente subjektiviteti, përkundrazi. Por, e vërteta të dhemb. Është krejt ndryshe me t'ia shpjeguar dikujt të keqen që i ka rënë, prej identifikimit të së keqes në shoqërinë tënde. Aq më shumë që kjo që po ndodh sot ka provuar katërcipërisht atë që unë e kam thënë dhe e kam parashikuar qartë, qysh në fillimet e tranzicionit, *cicatrix manet*, një bindje që veç më është forcuar me kohën. Por, sot mundem me e arsyetue atë që dikur e kam marrë me mend dhe që e kam pasë frikë, edhe pse nuk kam mundur t'i imagjinoj përmasat e së keqes që do të ndodhte.

Në përmbledhje thuhet haptazi, si në përrallën e Andersen, se "mbreti është lakuriq." Ky nuk është një përfundim i këndshëm për ata që presin të dëgjojnë se punët në shtetin shqiptar janë mirë. Por, detyra e ime është me dhënë mendimet e mia. Në se mendimet dhe analiza ime janë të pranueshme apo jo për dikënd tjetër, ky nuk është më problemi i im por i lexuesit. Me dalë mbreti i zhveshur

lakuriq mundet me kenë edhe moda e fundit, dhe, njëkohësisht, shprehja më e gjallë e bashkëkohores në jetën shoqërore të një populli, po kjo nuk don të thotë se ai popull është në rrugë të drejtë. Asgjë më shumë se organizimi serioz e impresionues i karnevaleve, vetëm pak kohë mbasi një qytet i madh përmytet për javë të tëra, e m'u për këtë tragjedi konsiderohet se ka qënë gjithnjë si *Venecia e Ballkanit*, nuk e ilustron këtë mendësi paradoksale, anormale e tragjikomike, të shoqërisë shqiptare në tranzicion.

Shpresoj që mërgimi i gjatë, edhe pse i padëshëruar dhe i imponuar, si dhe studimet e mia, të më kenë ndihmuar që t'i shoh, si individët që janë lojtarë kryesorë të parisë, ashtu edhe proceset e ndryshme, më qartë e më qetësisht se atyre që iu duhet të jetojnë përditësinë në shtetin shqiptar. E vërteta është se i kam njohur mjaft mirë disa nga këta individë shumë kohë më parë. Natyrisht, ato ishin kohë kritike, kur s'mund të dilje lehtë nga lëkura e vërtetë. Duke i vëzhguar nga afër, mendoj se e kam parë fytyrën e tyre të vërtetë, dhe ajo nuk ka kenë e këndshme. Po ashtu, edhe pse nga larg, i kam ndjekur me vëmendje të madhe gjatë evolucionit të tyre edhe gjatë kësaj metamorfoze të tranzicionit. Ata që kanë kenë, ata edhe kanë mbetë.

Miqësitë personale janë të çmueshme. Gjithsesi, të vërtetën duhet me e thanë ashtu si e kupton, edhe kur mundesh me i humbë miqtë që presin me i dashtë, pa i gjykuar për sjelljet e tyre. Por, e vërteta nuk ndrron prej kushteve ku jemi, ajo që ndrron është aftësia e jonë me e thënë atë në kushte e në realitete të caktuara. Për këtë arsye, sidomos në kohë të këqia, si këto që po kalojnë shqiptarët, duhet me ditë me dalë mbi vetveten, mbi të metat, mbi lidhjet personale e, mbi të gjitha, me i tejkalue edhe mangësitë tona personale si njerëz. Në këtë pikë, ndërgegja e ime është miku që më duhet më shumë. Si për çdo njeri tjetër, që është tërësisht i shkëputur, me vetëdije, nga proceset politike e nga marrëdhëniet shoqërore në një shtet të caktuar, edhe për mua, fjala që kam me thënë, është gjithçka që mundem me dhënë.

Më në fund, si të gjithë përmbledhjet me shkrime, edhe kjo iu detyrohet shumë vetëve. Edhe pse e shkruar për një botë që ata nuk e njohin, ky libër është shkruar me Ashtinin dhe Aidanin në

mendje. Kjo përmbledhje nuk do të ishte e mundur pa mbështetjen e vëllezërve dhe motrave të mia. Kolegët si Prof. Eda Dërhemu më kanë dhënë një ndihmë të çmuar, si me komentet ashtu edhe me anën gjuhësore. Poeti dhe kritiku Vaid Hyzoti, që me përkushtim mori përsipër redaktimin letrar, më ka ndihmuar shumë në ruajtjen e normës letrare. Komentet e studentëve të mi, Najada Tafili Phoenix dhe Grid Rroji, kanë qënë një ndihmesë e paçmuar gjatë procesit të përgatitjes së librit. Si gjithnjë kritikët më të ashpër dhe lexuesit më të vëmendshëm kanë qënë Nereida Rama dhe Sokol Muja. Përmbledhja ka përfituar shumë prej leximit të vëmendshëm dhe komenteve të shumë miqve të tjerë që nuk po i përmend këtu, por ata e dinë kush janë dhe unë iu jam shumë mirënjohës për leximin e vëmendshëm dhe komentet e tyre.

STUDIMI I TRANZICIONIT: KËNDVËSHTRIME TEORIKE DHE RASTI SHQIPTAR

Shteti shqiptar është në një gjendje krejtësisht të ndryshme nga shtetet që hynë në procesin e tranzicionit mbas vitit 1990. Gjithkund tjetër ndryshimet kanë qënë të prekshme dhe në shumë drejtime pozitive. Por, në rastin shqiptar ka ndodhur e kundërta. Mbas ndryshimit të sistemit në vitin 1990, shteti shqiptar ka qënë përherë i mbërthyer në një krizë të thellë të vazhdueshme dhe të gjithanshme që është duke u përkeqësuar me shpejtësi. Edhe me një shikim të shpejtë vërehet se paradokset shqiptare janë me të vërtetë të paimagjinueshme në kontekste të tjera.

Në shtetin shqiptar flitet për demokraci por sistemi politik është oligarki e padyshimtë. Në shtetin shqiptar flitet për tregun e lirë dhe *ndërtimin* e lulëzimin e kapitalizmit, por ekonomia është informale dhe e mbajtur me shërbimet. Në shtetin shqiptar flitet për vlera moderne dhe tradicionale por shoqëria është thellësisht e kriminalizuar dhe e karakterizuar nga një sistem sundues vlerash që nuk është moralisht i shëndoshë. Të gjithë politikanët deklarohen të pafajshëm por standardi i jetesës tregon qartë se paria sunduese është e korruptuar, plutokratike dhe kleptokratike. Në shtetin shqiptar flitet për shërbim publik por shteti është i kapur nga krimi. Shoqëria civile numëron me mijra organizata por është krejtësisht e paralizuar. Sistemi sundues i vlerave është imoral dhe materialist në ekstrem. Partitë politike janë banda në shërbim të klaneve të caktuara. Në një formë perverse, sistemi politik shqiptar është një *Fuhrerdemokratie* në të cilin drejtues të shtetit zgjidhen pikërisht ata që kanë bërë më shumë krime, vjedhje, vrasje dhe që kanë përgjegjësi të padiskutueshme

historike për dështimin e tranzicionit.

Mund të thuhet hapur se tranzicioni ka krijuar një shoqëri në të cilën paria tallet ditën për diell me popullin e vet. Kështu, shteti shqiptar nuk ka mbajtur ndonjëherë zgjedhje të pakontestuara demokratike. Shteti shqiptar e ka humbur sovranitetin me kohë dhe ligjin e bëjnë të huajt. Shoqëria shqiptare ka përjetuar dy shkrirje të strukturës shtetërore, një luftë civile, dy tentativa për grushte shteti, mërgimin e 1/3 të popullsisë së regjistruar, shkatërrimin dhe uzurpimin e pashembullt të pronës, rrënimin e vlerave kulturore e të trashëgimisë. Nga shteti shqiptar janë trafikuar me qindramijra femra dhe fëmijë. Ekonomia ka qënë dhe është një seri piramidash financiare. Me paralizën e sektorit të ndërimit, ekonomia është mejhanet, hotelet dhe lokalet e kumarit. Në vend prodhohet shumë pak dhe prodhimi i përgjithshëm industrial përbën vetëm 8 përqind të ekonomisë. Bilanci tregëtar është përherë negativ, me të paktën 3 miliardë dollarë në vit më shumë importe se eksporte.

E vetmja industri që njeh rritje janë lojrat e kumarit aq sa brenda një viti taksat e mbledhura nga kumari janë rritur me 25 përqind më shumë. Krimi është në nivele të jashtëzakonshme. Të gjitha krimet merren vesh brenda ditës, por pak krime raportohen ose ndiqen. Policia nuk lejohet të hyjë në shumë fshatra e zona që prodhojnë dhe eksportojnë drogë ditën për diell siç është, bie fjala, Lazarati. Jashtë Unazës së Tiranës, varfëria është në nivele të papara. Mbi 46% e popullsisë së Kukësit jetojnë me ndihma nga shteti. Gjendja është e frikshme edhe në aspekte të tjera. Një ndër katër shqiptarë ka probleme mendore. Shkalla e shkatërrimit të familjes shihet në numrin në rritje të divorceve që janë disfashuar. Numri i dështimeve e ka ulur ndjeshëm shkallën e rritjes së popullsisë. Gjendja e shërbimeve shoqërore, mjekësore, dhe të arsimit është katastrofike.

Megjithatë, nga ana e vet, paria sunduese jeton një jetë të pa-parë, e zhytur në luks e në qejf. Tashmë, ata kanë zonat e tyre ekskluzive të punës, të jetesës dhe të argëtimit. Standardet e jetesës së parisë janë të krahasueshme me ato të oligarkëve rusë. Mund të thuhet se rreth 10 përqind e popullsisë ka një jetë nor-

male edhe për vendet perëndimore. Shumë njerëz kanë makina të reja, apartamente dhe shtëpi pushimi, pajisje dhe orendi të modës së fundit. Por këta jetojnë në disa oaze që përditë e më shumë po ndjehen të rrezikuara nga krimi dhe nga gjendja e rënduar e shtresave të tjera të popullsisë. Vetë paria është hap-tazi jashtë ligjit, mbi ligjin, dhe e paprekshme. Ligji bëhet simbas nevojës së kryeministrit të radhës. Mbështetja popullore për parinë sunduese është në nivele interesante. Individët që janë në krye të shtetit janë ata që kanë bërë e bëjnë krime të përbindshme pa u shqetësuar shumë. Megjithëse krimet e tyre shihen në video, njihen publikisht dhe nxijnë faqet e gazetave, ata marrin edhe më shumë vota në zgjedhjet e mëpastajme. Disa prej tyre rizgjidhen me aklamacion dhe trajtohen si heronj kombëtarë nga mbështetësit e shumtë të tyre.

Ky është vendi i vetëm në brinjë të Europës ku demagogjia politike është e pabesueshme, e shfrenuar dhe përtej çdo imagjinate. Këtu flitet pa reshtur për *ndërtimin* e kapitalizmit. Këtu flitet për shtetin shqiptar si shembull të demokracisë liberale. Këtu flitet për zbatimin e metodave më efikase të funksionimit të tregut të lirë. Këtu luftohet më shumë se gjithkund tjetër në media për mbrojtjen e të drejtave njerëzore. Diskursi politik është i mbushur me numërimin e arritjeve të papara në procesin e integritit të shtetit në BE.

Megjithatë, ky është një vend që importon 113 ton flori dhe xhevahire në vit, dhe prej të cilit eksportohen femra, drogë, fëmijë, krim dhe armë kontrabandë. Përrjashta rrethit të Unazës së Vogël të Tiranës, gjendja ekonomike, morale dhe kulturore e shoqërisë së gjerë është e mjerë. Ky është një vend prej të cilit edhe ata që e sundojnë dhe e shfrytëzojnë duan të ikin sa më shpejt që të mundën. Ky është një vend që sundohet me SMS dhe me emisione televizive. Ky është një vend ku të gjithë politikanët kërkojnë dikë nga të huajt që t'i sundojë dhe ta mbajë përgjegjësinë për punët e shtetit.

Por, paradoksi kryesor, dhe ajo që të bie më shumë në sy, është përbërja e parisë sunduese. Të njëjtët individë që ishin të piketuar për të qënë në krye të proceseve gjatë kohës së sistemit

të mëparshëm janë sërish në krye të proceseve dhe të partive politike. Të njëjtët individë, të njëjtat familje, dhe të njëjtat klane që kanë qënë në krye të sistemit enverist, po ata e kanë drejtuar edhe tranzicionin. Ka pasur ndryshime, ka pasur ngritje-ulje, por sundimtarët janë po ata. Në krye të shtetit, kësaj here si pari plutokratike dhe oligarkike, është paria e vjetër enveriste por e zgjeruar me intelektualët enveristë, me profesoratin universitar enverist, dhe me zyrtarët enveristë. Ajo që të bie më shumë në sy është që, edhe pse sistemi që është vendosur është qartësisht plutokratik, kleptokratik dhe oligarkik, nuk ka kundërshtime të ndjeshme dhe efektive nga shoqëria. Pra, kanë ndryshuar format dhe metodat e sundimit, por nuk kanë ndrruar sundimtarët. Tashmë ata e kanë vënë shtetin, shoqërinë, dhe ekonominë në shërbim të interesave të tyre të ngushta. Shkurt, shoqëria shqiptare ka pësuar një metamorfozë të frikshme. Sot shoqëria shqiptare është në një gjendje të pashpresë, krejt ndryshe nga shoqëritë e tjera të ish-kampit socialist. Shoqëria shqiptare është e sunduar me dorë të hekurt nga të njëjtët sundimtarë që kishte në sistemin e mëparshëm, që tashmë janë pasuruar në nivele marramendëse. Më pak se pesë përqind e popullsisë zotëron më shumë se gjysmën e pasurisë kombëtare. Politikanët që deklarojnë 3000 euro pasuri gjithsejt, i kalojnë pushimet familjarisht në Sharm Al-Shaykh. Shumica dërmuese e kanë vënë pasurinë duke qënë ose në politikë, ose duke qënë të lidhur me politikën, ose duke qënë pjesë e klaneve të parisë sunduese.

Nuk ka dyshim se tranzicioni, që duhej të ofronte një jetë më të mirë për të gjithë shqiptarët, ka rezultuar në ndërtimin e një sistemi politik oligarkik, të një sistemi ekonomik monopolist dhe shitblerës, në polarizimin ekstrem të shoqërisë në plutokratë dhe në të varfër, si dhe në shkrirjen e plotë të shtetit dhe kapjen e tij dhe të shoqërisë nga krimi i organizuar. Kjo është metamorfoza që kemi pësuar si popull e si shoqëri. Kjo është gjendja në të cilën ndodhemi. Asnjë nga vendet e tjera të Europës Lindore dhe Qëndrore nuk ka kaluar në një metamorfozë të tillë me kaq shumë pasoja për popullin e vet.

Një rast i veçantë? Rasti shqiptar dhe paradigmat e shkencave shoqërore

Si edhe u shpjegua më lart, rasti shqiptar është një rast problematik jo vetëm nga dështimi i mbylljes së tranzicionit. Paradokset që identifikohen në rastin shqiptar janë të paimagjinueshme në kontekste të tjera. Atëherë, pyetja shtrohet, si duhet ta trajtojmë metamorfozën e mbrapshtë të shoqërisë shqiptare gjatë tranzicionit? A duhet të analizohet si një rast *sui generis*? Apo duhet ta trajtojmë si një rast tjetër ndryshimesh në kategorinë e ndryshimeve nga sistemi parti-shtet në një sistem tjetër? Dallimi midis këtyre dy qasjeve është thelbësor dhe zgjedhja që bëhet në nivel të premisave përcakton shumëçka.

Në se supozohet se rasti shqiptar është i veçantë, atëherë premisa është se veçantësitë përcaktojnë rrugën që është ndjekur. Mësimet që mund të nxirren nuk mund të jenë të vyeshme në raste të tjera, ku kushtet nuk janë e nuk mund të jenë të njëjta me rastin shqiptar. Edhe zgjidhjet që duhen kërkuar duhet të jenë të mbështetura në specifikën shqiptare. Nga ana tjetër, në se premisa e gjykimit është që ky rast është vetëm një rast tjetër në morinë e rasteve të tranzicionit nga sistemi parti-shtet drejt kapitalizmit ose drejt demokracisë liberale, atëherë, këndvështrimi ndryshon. Duke qënë se supozohet se përvojat e rasteve të tjera pritet që të përsëriten në rastin shqiptar, edhe rezultatet duhet të jenë pak a shumë të ngjashme dhe të shpjegueshme.

Ky debat lidhur me rëndësinë përcaktuese të karakteristikave të veçanta të shoqërive është karakteristik edhe për rastet e tjera të kalimit nga një sistem shoqëror tek një tjetër, si në hapësirën ish-sovjetike, ashtu edhe në Europën Qëndrore e Juglindore. Në një nivel, ky tranzicion është një nga anomalitë e jashtëzakonshme historike. Secila prej paradigmave kryesore të shkencave shoqërore ka shpjegimin e vet. Megjithatë, edhe pse ka shpjegime për tranzicionin në përgjithësi, të gjithë paradigmat kryesore kanë vështirësi të madhe që të shpjegojnë rastin shqiptar.

Një mënyrë do të ishte që të argumentohej me Durkheim dhe me funksionalistët se kjo që po ndodh në shtetin shqiptar është

procesi i shembjes së një sistemi shoqëror despotik totalitar që karakterizohej nga një *anomie* e theksuar. Kështu, mbas shembjes së sistemit të vjetër dhe të shtetit, duhet të pritet edhe formësimi i një ndërgjegjeje të re shoqërore që, edhe pse e mbështetur në individin prapë duhet që të ketë në thelb të vet shtetin. Kjo arrihet ose përmes kthimit në traditën shtetërore të mëparshme ose përmes krijimit të një ndërgjegje kombëtare në nivel të shoqërisë, d.m.th., vetëdijësimit si një komb që në qendër të identitetit ka shtetin e vet, shtet-kombin. Mënyra se si këto struktura rikrijohen apo rivendosen përmes një kontrate të re shoqërore dhe luajnë rolin e tyre në shoqëri mund të ndryshojë. Por, në fund të fundit, këto struktura duhet të krijohen dhe të përmbushin rolin e tyre.

Mirëpo, funksionalizmi, d.m.th., qasja që mëton të shpjegojë paevitueshmërinë e strukturave të cilat vijnë domosdoshmërisht për shkak të funksionit që kryejnë, nuk shpjegon shumë procese që janë evidente në rastin e tranzicionit shqiptar. Ndër të tjera, shteti është tejet i dobët, i kapur dhe i paralizuar. Shteti shqiptar ekziston thjesht sepse është një shtet i njohur nga shtete të tjera dhe pjesë e sistemit ndërkombëtar. Por, shteti shqiptar është më shumë një bashkëngjitje artificiale katundesh të ndryshme, me tradita të ndryshme, që bashkëjetojnë secili në mënyrën e vet, se sa është një shtet modern.

Po ashtu, kthimi në traditë është më shumë një rishpikje e traditës lokale, kësaj here të theksuar edhe me dallueshmërinë e formave të ndëshkimit, të krimit dhe të marrëdhënieve kulturore. Ndërgjegjja kombëtare e shtetërore janë në nivele shumë të ulta. Ndërgjegjja kombëtare është duke u bjerrur gjithnjë e më shumë. Në rastin shqiptar, kthimi në traditë është, në fakt, kthimi i mendësisë katundare e klanore. Kjo mendësi, që mbizotëron në të gjithë shtresat e popullsisë është krejt e kundërta e mendësisë shtetërore. E gjithë shoqëria është e kriminalizuar, e sunduar nga mendësia katundare. E gjithë shoqëria lufton kundër vendosjes së një shteti të fortë në katundin e vet dhe për pronën e vet. Si pasojë, rregulli dhe rendi shoqëror burojnë dhe ruhen nga mendësia katundare respektive.

Sundimi i mendësisë katundare është një problem i pazgjidh-

shëm për funksionalistët. Arsyeja është se një mendësi e tillë nuk është e pajtueshme me shtetin e fortë dhe modern. Të paktën paria duhej të përpiqej që të ndërtonte shtetin aq sa të mund ta mbante shoqërinë nën kontroll. Mirëpo vetë paria sunduese është pjesë integrale, krijuese dhe drejtuese e mafias shoqërore që lufton kundër vendosjes së një shteti funksional, edhe kur është në krye të shtetit. Për më tepër, përpjekja për ta paraqitur këtë periudhë transformative si të kufizuar në kohë, dhe për ta analizuar nga një perspektivë *longue durée*, është po ashtu problematike. Në rastin shqiptar nuk ka vullnet politik për të ndrruar sistemin. Nuk shihen zgjidhje të qarta dhe të zbatueshme. Nuk ka njerëz që dinë e që po punojnë për gjetjen e zbatimin e një rrugë-zgjidhjeje të tillë nga përbrenda sistemit.

Nga ana tjetër, strukturalistët do ta konsideronin këtë transformim si kalimin nga një sistem parti-shtet në një sistem ku kapitalizmi nuk është domosdoshmërisht zgjidhja. Për strukturalistët zgjidhja është në thelb politike dhe institucionale. Për strukturalistët, që ndjekin Kant, zgjidhja është ndërtimi i shtetit dhe vendosja e rendit ligjor. Vendosja e një strukture institucionale është e paevitueshme për shkak të nevojave të organizimit politik të shoqërisë. Do të shtoja se ndërtimi i shtetit është e paevitueshme edhe për shkak të ekzgjencave të sistemit ndërkombëtar. Për shumë nga strukturalistët, formësimi i një shteti të fortë burokratik me struktura të forta ligjore-rationale është etapa e fundit dhe më e lartë e zhvillimit të një shoqërie. Kjo është edhe karakteristika themelore e modernizimit, krijimi i një strukture institucionale që është racionale dhe ligjore dhe që është e mbivendosur mbi shoqërinë. Struktura dhe institucionet e mbajnë shoqërinë nën kontroll dhe i detyrojnë individët që të sillen brenda normave morale që vendosin institucionet. Kant thonte se njerëzit mund të jenë mashtrues e keqdashës por ligji i detyron që të sillen në një mënyrë të caktuar dhe të moralshme.

Mirëpo, ajo që ka dështuar në shtetin shqiptar është pikërisht ndërtimi i strukturave të qëndrueshme që janë autonome dhe të shkëputura nga shoqëria. Shteti është një shtet pastërtisht mafioz, i kapur nga struktura që nuk janë tërësisht feudale. Strukturat

sunduese shoqërore janë me bazë katundare. Në këto struktura bashkësie, ligjin e bëjnë përfaqësuesit e klaneve të parisë dhe strukturat kriminale. Shteti, institucionet dhe ligjet ekzistojnë vetëm në letër. Edhe më keq se aq, shteti shqiptar është bërë si karroca e Nastradinit. Sunduesit e radhës dhe përfaqësuesit e vendeve të huaja i sjellin lojën politike dhe institucionet nga duan ata. Shteti nuk ka autonomi, as nga strukturat e sistemit ndërkombëtar. Shteti nuk ka autonomi nga shoqëria. Në rastin shqiptar, strukturat e kriminalizuara që kontrollojnë shoqërinë i kanë kthyer shtetin dhe shoqërinë në një fushë beteje të interesave të tyre.

Një paradigëm tjetër zakonisht paraqitet si liberale por, në rastin e tranzicionit, argumentet e saj janë të pranueshëm edhe për marksistët. Argumenti kryesor i kësaj paradigme është se vendosja e sistemit ekonomik kapitalist do të kishte si pasojë përfshirjen e shoqërisë shqiptare në rrjedhat e globalizimit dhe të ekonomisë botërore që imagjinohet se është e mbështetur në marrëdhënie të kulluara shoqërore kapitaliste. Sipas kësaj paradigme, shoqëria shqiptare, edhe për arsye se gjendet në anë të Europës, gradualisht do të bëhej pjesë e sistemit ekonomik botëror kapitalist. Shteti do të kishte strukturat përkatëse dhe shoqëria do të evoluonte në drejtime të njohura në të cilat kanë kaluar edhe vendet e tjera në Europën Lindore por edhe në Azi e në Amerikën Jugore. Në rastin më të keq, ekonomia shqiptare do të ishte një ekonomi në periferi të vendeve më të zhvilluara kapitaliste, d.m.th., një ekonomi në një gjendje varësie të përhershme prej tyre. Në rastin më të mirë, ekonomia do të ishte pjesë integrale e sistemit të ekonomisë kapitaliste europiano-perëndimore.

Në të dy rrugët që do të merreshin, tregu do të përcaktonte vetë strukturën e shoqërisë. Tregu do të përcaktonte marrëdhëniet shoqërore me të gjithë të mirat e të këqijat e sistemit kapitalist. Shoqëria do të ndahej në klasa. Disa do të kishin monopolet dhe pasurinë. Të tjerët do të ishin krah pune dhe proletariati apo një proletariati agrar. Do të kishte një shtresë të mesme dhe një borgjezi të vogël që mezi do të ngrihej mbi shkallën e varfërisë.

Megjithatë, ajo që ka ndodhur është se shoqëria shqiptare nuk

është e integruar, ashtu siç pritej dhe ashtu siç duhet, në nivelin e pranueshëm në sistemin formal ekonomik botëror. Lidhjet e saj me ekonominë europiane dhe atë botërore janë shumë të brishta, të paqëndrueshme, të kontrollueshme nga politika dhe që mund të këputen shpejt e pa shumë dhimbje nga partnerët ekonomikë. Problemet me fasonët, emigrantët, investimet e huaja dhe koncesionet janë të shumëfishta. Marrëdhëniet janë të mbajtura në nivele shfrytëzimi të hapur e të kushtëzuara nga përfitimi maksimal që duan të nxjerrin të huajt dhe paria sunduese. Prodhimi kombëtar nuk ka asnjë mbrojtje sistematike nga shteti. Kapitali njerëzor dhe material, që e vendoste shtetin shqiptar në një pozicion të volitshëm për një tranzicion të suksesshëm është shpërdoruar në mënyrën më të papërgjegjshme që mund të bëhet. Paria nuk investon në nivelin e burimeve që ka në dispozicion. Pasuritë janë transferuar jashtë dhe paria është kthyer në pari rentiere.

Pra, integrimi në ekonominë rajonale ka ndodhur deri në një shkallë por ky nuk është integrimi që duhej të ndodhte dhe integrimi që pritej nga shqiptarët. Deri në një pikë, mund të thuhet se rrjeta e pazgjidhur e problemeve politike në Ballkan, dhe, në veçanti, problemet e çështjeve kombëtare, e kanë mbajtur peng edhe procesin e transformimit të shoqërisë shqiptare simbas parimeve ekonomike. Pa stabilitet politik nuk ka marrëdhënie ekonomike, dhe shteti shqiptar nuk ka qënë një shtet i konsoliduar. Mirëpo, zgjidhjet që janë bërë për të ecur në këtë rrugë, janë bërë me vetëdije të plotë prej parisë sunduese. Rruga e integritit të shqiptarëve si një popull që mund të shfrytëzohej lehtë, kthimi i tyre në krah të lirë pune brenda e jashtë vendit, koncesionet e pajustificuara të pasurive kombëtare, shpërdorimi i burimeve cilësore njerëzore dhe i kapitalit kombëtar janë përcaktuar nga paria. Edhe më keq, integrimi në sistemin ekonomik ndërkombëtar, po me pjesëmarrjen aktive të parisë, ka ndodhur në nivelin e shoqërisë së nëndheshme, të jashtëligjshme e kriminale.

Mund të thuhet se edhe pse disa kompani të huaja kanë bërë investime minimale apo se disa të tjera kanë marrë koncesione të rëndësishme, këto investime nuk janë në nivelet e mundshme

dhe se ato nuk kanë sjellë zhvillim për shqiptarët. Shteti shqiptar është anashkalar në mënyrë sistematike nga shtetet që mund të bënin investime afatgjata dhe të ndiqnin projekte zhvillimore. Faktorët më të rëndësishëm për të shpjeguar këtë anashkallim të shtetit shqiptar nga strukturat ekonomike ndërkombëtare, dhe reduktimin e shtetit shqiptar në një burim krahu pune të lirë, të pasiguruar, të pambrojtur, të papensionuar dhe të shpërdoruar, janë tre. Së pari, është mungesa e stabilitetit politik për të cilën është përgjegjëse para sunduese. Së dyti, është vendosja e një sistemi efektiv kontrolli mafioz të parisë mbi ekonominë në shtetin shqiptar. Së treti, është vendi që zë populli dhe shteti shqiptar në projektet afatgjata të vendeve fqinje dhe më gjerë.

Problemi me përdorimin e paradigmave të ndryshme është se e bëjnë rastin shqiptar, që është në një gjendje kaosi të vazhdueshëm, të duket një rast paradoksal dhe anormal. Por rregulli duhet kërkuar tek përjashtimet. Në sipërfaqe, gjendja në rastin shqiptar duket kaotike. Problemi është se ky është një kaos i organizuar dhe i administruar me kujdes nga para sunduese. Shteti dhe shoqëria shqiptare janë në kaos sepse kështu iu intereson drejtuesve të parisë.

Një mundësi do të ishte që në qendër të shpjegimit të vihej influenca ndërkombëtare. Shteti shqiptar është në anë të BE-së. Përfshirja në strukturat politike ndërkombëtare bëhet me vendimin e të huajve, por kjo nuk është e lidhur drejtpërdrejt me proceset e zhvillimit të shoqërisë dhe të vendit. Përfshirja në strukturat ekonomike ndërkombëtare është bërë deri diku, por jo në nivelin e duhur. Por, ajo është arritur në rrjetën e veprimtarisë kriminale me tolerimin e disa shteteve të tjera që edhe kanë marrë pjesën e luanit nga ekonomia shqiptare. Kur i intereson parisë, influenca ndërkombëtare është vendimtare në proceset politike. Por, edhe influenca politike ndërkombëtare, që do të ishte një faktor përcaktues i jashtëm, ekzogjen, nuk shpjegon shumë raste kur të huajt janë injoruar, nënvlerësuar, denigruar dhe sulmuar hapur nga para. Pra, mund të thuhet lirshëm se kur janë ndeshur me interesat e parisë, edhe ndërkombëtarët kanë dështuar. Para zgjedh kur vendos që të humbë e kur të fitojë.

Nuk ka dyshim që kur konsiderohen shumë nga paradokset e evidentueshme, rasti shqiptar paraqet një paradoks shqetësues për teorinë e ndryshme.

Megjithatë, duke lënë mënjanë paradigmat kryesore, ka mjaft qasje teorike të nivelit të *mid-range theory* që mund të përdoren. Paradigmat kryesore janë të mbështetura në qasje që shohin si parësore njëri nga tre strukturat themelore organizuese të shoqërisë: shtetin, tregun ose shoqërinë. Nga moria e qasjeve të *mid-range theories*, edhe për shkak të natyrës së proceseve historike ku u përfshinë shqiptarët, qasjet teorike më të përshtatshme që mund të përdoren për të shpjeguar rastin shqiptar janë teoria e modernizimit në disa nga variantet e saj, teoria e udhëheqësve, dhe teoria e parive sunduese apo siç njihet në një variant tjetër, teoria e elitave.

Siç do të argumentoj më poshtë, teoria e modernizimit (duke përfshirë këtu tranzitologjinë dhe konsolidologjinë) nuk mund të shpjegojë një numër paradoksesh shqiptare. Duke qënë se është e rrënjësor në një përzierje të strukturalizmit dhe të funksionalizmit, teoria e modernizimit, shfaq shumë nga mangësitë e të dy qasjeve. Në një nivel, marksizmi klasik dhe modernizmi ndajnë të njëjtin vizion për ndërtimin e shoqërisë, të paktën në domosdoshmërinë e ndërtimit të kapitalizmit. Në mos tjetër, të dy qasjet theksojnë rolin pozitiv të kapitalizmit në përparimin e një shoqërie. Vetë Marksi e shihte këtë fazë të vendosjes së kapitalizmit si një fazë të domosdoshme zhvillimi edhe për vendet e kolonizuara dhe joeuropiane të kohës së tij. Megjithatë, është shumë e vështje që aplikimi i tranzitologjisë në rastin shqiptar të bëhet me kujdesin e duhur.

Por, qasja e cila argumenton se paria sunduese është faktori kryesor për gjendjen, shpjegon shumë më shumë aspekte dhe paradokse të këtij tranzicioni se sa teorinë e tjera. Përmes këndvështrimit që ofron kjo qasje, ky rast nuk ngjan më si një rast i veçantë. Paradokset e shumta të identifikuara në rastet e përpjekjes për verifikimin e teorive të ndryshme marrin një shpjegim të pranueshëm dhe të mbështetur me faktet që ofrohen me shumicë nga rasti shqiptar. Duke përdorur një kombinim të teorisë së

parive me qasjen e zgjidhjes së arsyeshme, *rational choice*, d.m.th. duke vënë në qendër të analizës prijatarët e parisë dhe llogaritjen e fitimit dhe të humbjes në bazë të interesave të ngushta vetjake, rasti shqiptar merr një shpjegim shumë më të gjerë dhe më bindës. Atëherë, edhe kaosi dallohet që është i mirëorganizuar, por edhe patologjitet e sistemit bëhen të kuptueshme dhe të analizueshme.

Tranzitologjia

Në studimet lidhur me tranzicionin, rasti shqiptar shpesh anashkalohet. Arsyeja është se ky rast është një rast shumë problematik për teoritë të cilat synojnë që të shpjegojnë ndryshimet që ndodhën në vendet e ish-kampit socialist. Literatura e gjerë mbi këto procese, sidomos në fillim të viteve 1990-të kishte një karakter përshtues se cilat duhej të ishin proceset kalimtare. Literatura tranzitologjike kishte një karakter parashikues, në lidhje me atë që pritej të ndodhte në përfundim të proceseve si dhe në lidhje me atë që duhej të ndodhte si rezultat i proceseve që po zhvilloheshin gjatë kalimit nga një sistem shoqëror tek një tjetër. Prandaj, në literaturën shumë të gjerë janë trajtuar gjerësisht temat se si duhej ecur, çfarë rrugësh duheshin ndjekur, dhe se cilat politika do të ishin të suksesshme. Mbi të gjitha, diskutimet kanë qënë shumë intensive përreth argumentit se cilat struktura institucionale do të ishin efektive dhe në shërbim të arritjes së këtyre objektivave politikë që parasheh tranzitologjia.

Shumë aspekte të tranzicionit shqiptar janë analizuar në kuadër të tranzitologjisë nga sistemi socialist që lulëzoi gjatë viteve 1990-të, sidomos në lidhje me anën përshtuese. Mirëpo, tranzitologjia nuk jep shpjegime për shumë prej këtyre dukurive paradoksale që vihen re në rastin shqiptar. Edhe kur pajtohen që tranzicioni ka dështuar, studjuesit nuk përqëndrohen në shkakun e vërtetë të dështimit të tranzicionit. Duke folur për proceset, harrohet roli kryesor i parisë. Vetë këndvështrimi që është përdorur ka qënë i kushtëzuar nga analizat e mëparshme apo në kontekste të ngjashme nga këndvështrimi tranzitologjik. Por, veçantësitë rrafshoheshin dhe kishte një tendencë të dallueshme

për të theksuar të përbashkëtat e rastit shqiptar me rastet e tjera. Shpesh mungonin të dhënat e duhura për të bërë krahasimet e duhura dhe për të ndërtuar pamjen e plotë të gjendjes së shoqërisë shqiptare.

Ka disa probleme me tranzitologjinë dhe zbatimin e saj në rastin shqiptar që duhen theksuar këtu. Një nga problemet kryesore me këtë qasje është se tranzitologjia mbështetet në zbatimin e teorive, të zhvilluara në kohë e në lidhje me vende të tjera, si bie fjala, Amerika Latine, Europa Jugore e Mesdhetare, në fundin e viteve 1970-të, në kontekstin e ndryshimit të sistemeve në ish-kampin socialist. Siç shihet nga debatet e pambyllura lidhur me tranzicionin në vende të ndryshme, shumë studjues këmbëngulin se tranzitologjia nuk është një qasje e dobishme. Arsyet janë të thjeshta. Nga një anë, tranzitologjia sjell përdorimin e një aparati konceptual e shpjegues që është qartësisht ideologjik. Duke vepruar kështu nënvlerësohet dukshëm roli i historisë, specifikat e zhvillimit të shteteve të ndryshme, kultura dhe mendësia sunduese e parisë por edhe e shoqërisë. Po ashtu, nënvlerësohet edhe problematika e veçantë në marrëdhëniet ndërkombëtare me të cilën janë përballur këto shtete.

Një problem tjetër është se tranzitologjia është e orientuar nga arritja e dy objektivave qëndrore, vendosja e kapitalizmit dhe vendosja e demokracisë liberale. Mirëpo këto objektiva përcaktues janë efemeralë dhe proteanë dhe, në rastin më të mirë, teleologjikë. Në veçanti, besimi se sistemi politik demokratik dhe sistemi ekonomik kapitalist janë të përputhshëm dhe që natyrshëm mbështesin njëri-tjetrin, është i gabuar. Ky besim nuk mbështetet nga përvoja e vetë vendeve të zhvilluara kapitaliste europianoperëndimore. Vendosja e demokracisë liberale shihet si një proces i paevitueshëm dhe si fundi i historisë. Pra, modeli i ndërtimit të shoqërisë që ofron tranzitologjia është një model që e detyron shoqërinë, cilëndo shoqëri, që t'iu përshtatet strukturave që janë ideologjikisht të paracaktuara. Shoqëria duhet t'iu përshtatet me dashje apo pa dashje, dhe pavarësisht identitetit, kulturës dhe trashëgimisë historike, modelit të demokracisë liberale që ofrohet nga tranzitologjia.

Në studime të shumta, tashmë, është argumentuar se ky model nuk është lehtësisht i zbatueshëm, i transplantueshëm dhe i përdorueshëm në shumë raste të tjera të tranzicionit. Në të vërtetë, nuk ka pasur një tranzicion, nuk ka pasur as dy tranzicione. Siç edhe provohet lehtë nga rasti shqiptar, në fakt, ka shumë tranzicione që janë të njëkohëshme, që zhvillohen në rrugë paralele dhe që i japin procesit karakterin e një metamorfoze të mirëfilltë. Me kohë, në shtete të ndryshme është parë se proceset janë shumë të ndërvarura. Mundësitë e zbatimit të projektit tranzitologjik nuk ekzistojnë. Projekti mund të ofrojë udhëzime të përgjithshme, por jo një rrugë të paracaktuar. Gjithkund ku ka ndodhur tranzicioni janë ndjekur e po ndiqen rrugë që janë të ndryshme dhe të dallueshme nga njëra-tjera.

Por, askund nuk kanë shkuar proceset siç kanë shkuar në rastin shqiptar. Në këtë rast ka ndodhur e po ndodh krejt e kundërta e asaj që parasheh tranzitologjia. Sistemi politik është oligarkik, kapitalizmi është shitblerje, shoqëria është e kriminalizuar, shteti nuk ka sovranitet, dhe institucionet janë të kapura nga krimi. Për shkak të krizës së gjithanshme në të cilën gjendet, shteti shqiptar është një shtet i paralizuar nga një problematikë krejt tjetër prej asaj të tranzitologjisë. Shteti shqiptar është një shtet tejet i dobët, pa parakushtin themelor që është uniteti kombëtar, d.m.th. një shtet efektiv me një identitet të qartë dhe që shihet si legjitim prej qytetarëve të vet. Parë nga ky këndvështrim, problem qëndror politik ka qënë dhe mbetet zgjidhja e çështjes kombëtare shqiptare. Kjo çështje kombëtare është pjesë e pashkëputëshme e problematikës së tranzicionit në shtetin shqiptar. Pa arritjen e një niveli ndërgjegjësimi kombëtar, të çfarëdo ndërgjegjësimi kombëtar, nuk mund të ketë stabilitet në shtetin shqiptar. Ky është parakushti i suksesit të projektit. Përtej këtij problemi themelor të pazgjidhur, qëndron edhe moria e problemeve të tjera dhe e paradokseve të shumta të numëruara më lart që e bëjnë rastin shqiptar të duket si një rebus teorik i pashpjegueshëm.

Për ta përsëritur, paradigma ku mbështetet tranzitologjia, teoria e modernizimit, është shumë e kritikuar dhe e problematizuar deri në atë pikë sa nuk e ka më besueshmërinë dhe koherencën

e duhur si teori shpjeguese. Por tranzitologjia fitoi shumë mbështetje dhe u pranua si një qasje më vete. Mirëpo, njëlloj si në teorinë e modernizimit edhe në analizat tranzitologjike vihen re shkapërcime shqetësuese. Për shembull, në analizat tranzitologjike paria sunduese luan një rol kryesor në procesin e shembjes së regjimit. Mbas përmendjes se paria luan një rol qëndror në ndërrimin e sistemit, roli i saj në etapat e mëpastajme të zhvillimeve politike e shoqërore zvogëlohet ndjeshëm. Shumica e analizave ngushtohen në analizën e aspekteve procesuale të sistemeve shoqërore, politike, ekonomike, dhe kulturore të tranzicionit duke u përqëndruar kryesisht në proceset transformative shoqërore.

Ky shkapërcim bëhet për arsye të kuptueshme. Prania e një partie që jo vetëm nuk është zhdukur, por që luan një rol të rëndësishëm në proceset politike, nuk është e pajtueshme me konceptimin e demokracisë si një sistem politik në të cilin vendimet merren nga populli. Në fakt, në të gjithë sistemet efektive demokratike paria është e pranishme. Por roli i saj si shtresë është formalisht i delegjitimuar dhe hapësira e saj për veprim është e ngushtuar. Paria është e përmbajtur nën fre nga sistemi politik, nga ideologjia sunduese dhe nga shoqëria civile. Megjithatë, brenda rregullave e ligjeve, paria vazhdon që të luajë një rol kryesor e shpesh përcaktues në proceset politike. Por ajo vepron kështu duke mos e cënuar hapur vullnetin e popullit dhe duke i zgjedhur me kujdes betejat që kërkon të luftojë.

Roli i parisë është i ndjeshëm në të gjithë sistemet demokratike. Megjithatë, roli i parisë është më vendimtar, dhe shumë më i dukshëm në rastet e demokracive që nuk janë stabilizuar si duhet, ashtu si po ndodh në rastin shqiptar. Në këto raste, paria që ndjehet gjithnjë e rrezikuar pajtohet me proceset demokratike vetëm kur ato janë në interes të saj. Nëse sistemi demokratik iu bie ndesh interesave të parisë, paria vepron gjithnjë në të kundërt të interesave të popullit. Nëse nuk mund të veprojë legalisht, atëherë paria vepron kundër ligjit. Zgjdhja që gjen paria është duke i deformuar thelbësisht rregullat e lojës. Në se kjo rrugë dështon, paria mund të përdorë edhe forcën e dhunën.

Pra, problemi i pazgjdhshëm që ndeshin tranzitologët është se

demokracia e mirëfilltë liberale mund të vendoset vetëm e vetëm kur paria beson se është në interesin e saj jetik që të mbrojë e të respektojë rregullat e sjelljes në demokraci. Demokracia funksionale përqëndrohet kryesisht në përzgjedhjen e drejtuesve të zëvendësueshëm të shtetit për një periudhë të caktuar kohe. Demokracia funksionale i zgjidh vetëm përkohësisht konfliktet në shoqëri. Por për të vendosur një demokraci funksionale duhet një shtet autonom nga shoqëria, me një strukturë të fortë institucionale, dhe me ligje që mbrojnë strukturën institucionale dhe ligjore nga influencat imediate politike. Shteti efektiv është parakushti i demokracisë, edhe pse demokracia që vendoset mund të jetë më pak se ideale. Por, për të pranuar shtetin efektiv, paria duhet të përballet me struktura të forta ideologjike në nivel të shoqërisë si dhe me shtetarë që përdorin ligjin në të mirën e përgjithshme. Ideologjia e përbashkët e mbështetur në këtë interes të shtet-kombit forcon lidhjet midis individëve të parisë, lidhjet midis parisë dhe popullit, si dhe i orienton vendimet që duhet të merren në një kah të caktuar.

Nga një anë, ideologjia e përbashkët lejon prijatarët që të mbrojnë deri-diku interesat e tyre dhe interesat e parisë si shtresë, pa u dukur se po iu bien ndesh interesave të popullit. Nga ana tjetër, ideologjia është edhe një shtërngesë e madhe sepse hapësira e parisë për veprim është e ravijëzuar qartë dhe e ngushtuar. Si pasojë, nuk mund të bëhen kompromise gjithfarëlloj e thjesht në bazë të interesave të momentit, as nga paria, as nga grupe e fraksione të caktuara brenda parisë. Prandaj, duke qënë se demokracia dhe prania e një partie që kontrollon proceset janë të papajtueshme, atëherë zgjidhja teorike që është gjetur, është që të venitet roli parësor i parisë dhe i ideologjisë së bashkësisë së shtet-kombit nga analizat tranzitologjike.

Këto probleme me tranzitologjinë shihen qartë në rastin shqiptar. Në shtetin shqiptar, për shembull, demokracia liberale nuk është e vendosur. Nuk ka as edhe një përpjekje serioze për ta vendosur një sistem të tillë sepse, pikë së pari, në shtetin shqiptar nuk bëhen përpjekje serioze për të ndërtuar shtetin dhe bashkësinë ligjore-politike që duhet për të mundësuar

demokracinë liberale. Procesi i ndërtimit të institucioneve është futur, qysh në fillim të tranzicionit, në një rrugë pa krye. Gjendja është e tillë që shteti është i kapur, demokracia është zëvendësuar me oligarkinë plutokratike dhe kleptokratike, sistemi ekonomik nuk është një ekonomi tregu e institucionalizuar, administrata është e korruptuar, dhe shoqëria është e kriminalizuar. Mbi të gjitha, mungon një ideologji dhe një sistem vlerash morale që janë të përbashkëta për parinë dhe për popullin.

Vendosja e një demokracie liberale, si objektiv dhe si proces, duket një objektiv më i largët sot se sa ka qënë në vitin 1990. Sistemi shqiptar është një sistem oligarkik në shërbim të parisë dhe që funksionon në bazë të përqindjeve të kontrollit mbi strukturën shtetërore nga ana e palëve të parisë. Mirëpo ky sistem oligarkik është ndryshe nga sistemi *verzuiling* që funksionoi në Hollandë mbas Luftës së Dytë Botërore, apo në raste të ngjashme si Austria, në të cilin paritë e grupeve të caktuara punuan për ndërtimin e konsolidimin e shtetit dhe thyerjen e barrierave midis grupeve të ndryshme.

Në rastin shqiptar, askush nuk ka arritur që të shkëpusë parinë nga kontrolli i plotë mbi proceset. Nga ana e vet, paria punon për të thelluar dallimet midis grupeve të ndryshme. Paria funksionon duke e thërmuar e atomizuar edhe më tej shoqërinë dhe duke minuar, me çdo veprim të saj, funksionimin e sistemit demokratik. Edhe kur të huajt kanë synuar vendosjen e një sistemi demokratik, ata janë penguar nga paria dhe kanë dështuar. Kur populli ka kërkuar një sistem demokratik, apo është sjellur në mënyrën më demokratike, paria sunduese ia ka arritur që ta përmbysë popullin. Edhe kur populli ka kërkuar ndryshimin e regjimit oligarkik të parisë me një sistem tjetër oligarkik, siç ndodhi me referendumin për monarkinë që u zhvillua në vitin 1997, paria ia ka arritur që t'i drejtojë proceset në rrugën që kanë synuar prijatarët e saj dhe ta përmbysë vullnetin e popullit. Çdo shpjegim i këtyre dështimeve të sistemit nuk është i lidhur me kulturën e shqiptarëve. Çdo dështim i sistemit është i lidhur pazgjidhshmërisht me parinë dhe me rolin e saj. Shpjegimi që mund të japë tranzitologjia është i mangët dhe nuk e vë në pah shkakun kryesor për këtë numër anomalish të

pranishme në sistemin politik shqiptar.

Në lidhje me parakushtet për vendosjen e demokracisë, shoqëria shqiptare kishte një specifikë e dallueshmëri të madhe me shtetet e tjera të ish-kampit socialist dhe shumë mangësi në nivelin e përgatitjes së shoqërisë. Këto mangësi ndikuan objektivisht në ecurinë e procesit të tranzicionit. Për shumë dhjetrvjeçarë, shoqëria shqiptare nuk ka pasur ndonjë lidhje të qëndrueshme, përveçse me Francën, me ndonjë shtet tjetër perëndimor dhe me demokraci funksionale. Përvojat e vetë shqiptarëve me shtetin demokratik kanë qënë të papërfillshme. Institucionet e shoqërisë civile nuk kanë ekzistuar. Mungonin udhëheqësit karizmatikë që mund të drejtonin tranzicionin. Njerëzit ishin të arsimuar, por jo të edukuar si duhet. Nuk kishte një sens të fortë të identitetit kombëtar. Paria ishte shtresa e vetme që ishte e mirëorganizuar, me ide të qarta, me objektiva të qarta dhe me prijtarë që ishin të stërvitur në proceset e kontrollimit të shtetit, të manipulimit të mendësisë së popullit e të mbrojtjes së interesave të shtresës.

Prandaj, edhe pse dukej se kishte shumë mbështetje ndërkombëtare për vendosjen e sistemit demokratik, edhe pse kishte mbështetje relative popullore për vendosjen e një sistemi demokratik, rezultati në drejtim të vendosjes së demokracisë ishte, gjithsesi, *un bel niente*. Paria nuk ka pasur e nuk ka në mend që të vendosë sistemin e mirëfilltë demokratik. Paria ka synuar që të vendosë sistemin që i shërben më mirë ruajtjes së interesave të saj. Prandaj edhe demokracia shqiptare lindi e dështuar. Sot e ardhmja e saj është, në dukje, si e shkuara, krejt e pashpresë.

Mirëpo edhe kur u krijuan kushtet për vendosjen e një demokracie funksionale në vitin 2005, mbas përvojave traumatike të përjetuara gjatë 20 viteve të kaluara, e në veçanti mbas ngjarjeve tragjike të vitit 1997, proceset po vazhdojnë që të ecin në të njëjtën hulli. Në rastin shqiptar, të gjitha rregullat e strukturat janë formalisht demokratike. Megjithatë, nuk ka ndryshim kahu lëvizjeje drejt demokracisë funksionale apo liberale. E kundërta ka ndodhur. Në shtetin shqiptar ka ruajtje e kultivim të një ekuilibri politik e shoqëror të dominuar nga paria, d.m.th. vendosje të një sistemi oligarkik në të cilin paria është plotësisht në kontroll

të gjendjes. Në shtetin shqiptar u vendos një sistem që është pastërtisht oligarkik, plutokratik e kleptokratik. Shteti është i kapur nga një grup i vogël klanesh të parisë që kanë mbledhur e përvetësuar pasurinë kombëtare, dhe që vjedhin sistematikisht nga thesari i shtetit. Paria ndjek synimet e veta duke iu kundërvënë, në çdo hap, forcimit të shtetit, të sistemit demokratik, dhe është në luftë të hapur me popullin e vet. Jo vetëm që shteti nuk ka sovranitet, por institucionet shtetërore janë të kapura nga krimi, të vëna haptazi në shërbim të strukturave kriminale, dhe paria sunduese është bashkëpunëtore e strukturave kriminale dhe në krye të tyre. Makina oligarkike e parisë është tejet efektive dhe bllokon çdo iniciativë për ndryshim. Kontrolli mbi shtetin ushtrohet nga strukturat politike të parisë që e kanë feudalizuar shtetin dhe punojnë në bazë të përqindjeve.

Gjithkund paritë mundohen të punojnë prapa skenës. Prandaj paritë akuzohen si shtresa konspirative. Në rastin shqiptar, paria i bën të gjitha hapur dhe sheshit. Si grindjet, ashtu edhe marrëveshjet midis palëve të parisë janë lehtësisht të lexueshme nga çdokush. Zhveshja e parisë shqiptare nga vlerat morale ka arritur në ekstrem. Tashmë, me thellimin e krizës, paria është në një luftë të hapur me popullin e vet. Nuk ka asnjë shtet që është në një gjendje të krahasueshme me shtetin shqiptar, thjesht sepse paria është e vendosur që të ruajë sistemin oligarkik dhe kleptokratik, me çdo çmim e me çdo kusht. Prandaj, ndryshe nga të gjithë shtetet e tjera që dolën nga sistemi sovjetik, në shtetin shqiptar nuk u vendos një sistem demokratik si në Hungari apo në Poloni. Nuk u vendos as një sistem autoritar i pastër si në Azerbajxhan apo një sistem despotik si në Turkmenistan. Nuk u vendos as edhe një sistem që dominohej nga individë me bindje nacionaliste si në Serbi, Kroaci apo në Maqedoni. Prandaj, edhe tranzitologjia, që i sheh proceset në mënyrë sterile nuk na ndihmon ta kuptojmë si duhet këtë gjendje krize të përhershme të shtetit e të shoqërisë shqiptare. Megjithatë, një rishikim i shkurtër dhe i shpejtë i projekteve modernizuese gjatë historisë së vonshme shqiptare, dhe konsiderimi i tranzicionit si një fazë tjetër dhe në vazhdim të këtyre projekteve modernizuese, na ndihmon që

të identifikojmë më qartë rolin e parisë si faktorin kryesor dhe përgjegjës për gjendjen kritike.

Projektet modernizuese dhe specifika e problemit shqiptar

Teoria që synon të shpjegojë rastin shqiptar duhet të jetë e mbështetur në një njohje të thellë të problematikës specifike, të kushteve historike, të mendësive sunduese, të trashëgimisë institucionale, të strukturës specifike shoqërore, si dhe të individëve e të grupeve që kanë luajtur e luajnë një rol kryesor në procesin e tranzicionit. Përvojat historike të shoqërisë shqiptare janë tejet komplekse. Për shkak të pushtimeve, të ndrrimeve të sistemeve dhe të ideologjive sunduese, projektet modernizuese kanë lënë më shumë rrënoja dhe e kanë fragmentarizuar e thërmuar shoqërinë se sa kanë krijuar struktura të qëndrueshme dhe që i rezistojnë kohës. Përthyerjet kanë qënë të një niveli të tillë që në kontekste të tjera do të konsideroheshin si shumë anormale, shqetësuese për argumentin teorik dhe, në një nivel, edhe të pashpjegueshme.

Teoritë e ndryshme të aplikuara në kontekstet e shoqërive në tranzicion në Europën Lindore e Qëndrore theksojnë influencën e shumë faktorëve. Shumë argumente theksojnë influencën e huaj apo të diasporës si në rastin e kroatëve. Në raste të tjera studjuesit theksojnë përvojën demokratike të vendeve të caktuara në periudhën midis dy luftërave botërore si në rastin e Çekosllovakisë. Të tjerë theksojnë rolin e shoqërisë civile dhe të strukturave fetare si në Poloni. Të tjerë përmendin përgjegjësinë qytetare të udhëheqësve karizmatikë si në vendet baltike. Edhe në rastin e Bullgarisë apo të Hungarisë, autorët përmendin identitetin e fortë shoqëror apo ruajtjen dhe krijimin e ekulibreve shoqërore si faktorë përcaktues të ecurive të tranzicionit.

Por, përqëndrimi në këto faktorë të veçantë s'na lejon që të analizojmë si duhet ecurinë e embrapshtë të proceseve të tranzicionit shqiptar. Influenca e huaj përgjithësisht ka qënë negative. Shoqëria civile e Tiranës ka qënë një maskë e parisë, një skemë për të vjelur financimet e huaja kur pjestarët e parisë nuk ishin në

pushtet. Në Tiranë nuk ka pasur udhëheqës karizmatikë e tribunë popullorë. Paria e ka luftuar çdo përpjekje për t'u organizuar në bazë të identitetit e të vetëdijes kombëtare. Hegjemonia e parisë është e mbështetur qartësisht mbi mendësinë katundare dhe në kultivimin e kujdesshëm të saj.

Më në fund, duhet thënë se ekuilibret shoqërore janë krejtësisht fluide dhe të paqëndrueshme. Thënë përmbledhtas, gjendja është e tillë që në shtetin shqiptar flitet për një sistem demokratik pa demokratë. Në shtetin shqiptar flitet për kapitalizëm pa kapitalistë. Në shtetin shqiptar flitet për një shoqëri qytetare me katundarë. Në shtetin shqiptar flitet për një shtet modern me një pari të kriminalizuar. Në shtetin shqiptar flitet për një shtet sovran kur ligjin e bëjnë të huajt. Për të kuptuar se si kemi arritur deri në këtë pikë, duhet që të paktën, të ofrohet një ravijëzim i shpejtë i proceseve historike modernizuese ndër shqiptarët. Historia nuk përsëritet. Por, kjo që po ndodh nuk mund të kuptohet mirë pa një kuptim të drejtë të përvojave historike.

Si një nga periudhat më të rëndësishme në historinë shqiptare, periudha e sundimit osman ka lënë gjurmë të thella në mendësinë dhe në sjelljen politike të shqiptarëve. Këto influenca manifestohen përditë në sjelljen e parisë dhe të shoqërisë. Strukturat që u konsoliduan gjatë asaj kohe, mendësitë popullore, dhe marrëdhëniet shoqërore kanë pasur një influencë të madhe ndër shqiptarët. Kështu, gjatë proceseve modernizuese në shtetin osman, gjatë shekullit të 19-të, shqiptarët u anashkaluan si komb. Shumica e tyre iu kundërvunë projektit modernizues osman, po për arsye të ndryshme. Kjo e përkeqësoi gjendjen e shumë shtresave dhe mileteve me pasoja të ndjeshme në periudhat e mëpastajme.

Gjatë periudhës së ekzistencës së një shteti formalisht të pavarur gjatë shekullit të 20-të, projektet modernizuese erdhën nga jashtë dhe u zbatuan në rrugë anormale dhe të njëanshme. Si pasojë, edhe kur patën anë pozitive, ato projekte e dëmtuan rëndë strukturën, edhe ashtu të brishtë shoqërore të shoqërisë së fragmentarizuar shqiptare që, mbas 1878, ishte në kërkim të identitetit të përbashkët që mungonte. Për më tepër, projektet

modernizuese kanë ardhur nga qeveritarë të huaj. Ka pasur projekte modernizuese osmane që synonin një herë ndërtimin e një shteti dinastik, e mandej ndërtimin e një shteti kombëtar turk. Ka pasur projekte modernizuese nga sundues bejlerë katundarë. Disa prej tyre, të stërvitur si administratorë të një perandorie lindore, e gjetën zgjidhjen tek oligarkia dhe vazhdimi i politikave perandorake osmane në një shtet me katundarë dhe të sunduar nga mendësia katundare.

Po ashtu, projektet modernizuese gjatë luftërave u zbatuan nga pushtues të ndryshëm, që vetë ishin të sunduar nga diktatorë që ndiqnin projekte totalitariste antihegeliane apo korporativiste. Projekte modernizuese ishin edhe adaptimi i një sistemi të deformuar shoqërie të centralizuar sipas modelit etatist despotik rus mbas Luftës së Dytë Botërore. Projekt modernizues ishte edhe përqafimi pa kushte i një projekti eksperimental, por edhe thellësisht ideologjik, të bazuar në parimin që tregu duhet të formësojë shoqërinë, në fillim të vitit 1991 dhe gjatë gjithë tranzicionit.

E deformuar, e thërmuar (anomike), dhe e fragmentarizuar edhe më shumë gjatë këtyre përvojave historike, shoqëria shqiptare nuk ka kaluar në proceset e zhvillimit normal, as gjatë këtij tranzicioni. Shoqëria shqiptare i ka *brûler les étapes* (shkapërcyer fazat) të zhvillimit normal shoqëror dhe është transformuar në mënyrë tepër të sforcuar. Shqiptarët, si komb, kanë kryer shkapërcime shoqërore e kanë kaluar në metamorfoza sistemesh që kanë shkuar në skajet e mundshme ideologjike dhe eksperimentale. Shqiptarët nuk e kanë ndjekur rrugën e sprovuar të ndryshimit gradual të përjetuar nga popujt e tjerë. Por, në të gjitha këto periudha kritike, paria ka luajtur një rol përcaktues e vendimtar. Edhe pse gjatë këtyre përvojave ajo është *trashëguar, rikrijuar, zëvendësuar* apo *zgjerruar*, thelbi i organizimit, mendësia, dhe objektivat që paria ka synuar që të arrijë nuk kanë ndryshuar.

Këtu ia vlen të bëhet një digresion i shkurtër. Metamorfozat sistemike ndër shqiptarët kanë qënë metamorfoza të sistemeve shoqërore e politike por edhe metamorfoza të parisë sunduese. Vetë paria ka përjetuar disa metamorfoza ideologjike, por edhe

zëvendësime radikale, disa edhe të paimagjinueshme në kontekstet e tjera. Për shembull, gjatë shekullit të 19-të, paritë shqiptare të tre mileteve osmane u specializuan dhe u transformuan në rrugë shumë interesante. Jeniçerët u bënë administratorë perandorakë, por shumica e tyre përfunduan si katundarë që jetonin në zona të humbura të Toskërisë. Gjithsesi, këta ruanin mendësinë e ortës dhe kishin në qendër të jetës shoqërore teqenë dhe shtetin. Nga ana e tyre, reshperët katolikë dhe paria e bashkësisë ortodokse fituan dimensionin e munguar politik në lidhje me shtetin, si dhe përfaqësimin si pari politike lokale. Në të njëjtën kohë, lidhja e tyre me strukturat fetare ishte shumë komplekse dhe e ndërlikuar. Më vonë, sidomos mbas pavarësimit e krijimit të shtetit, këto dy pari u integruan edhe në nivel shtetëror e kombëtar duke marrë rol qëndror në periudha të caktuara. Gjatë shekullit të 20-të, transformimet shoqërore ishin, po ashtu, edhe metamorfoza të mirëfillta të parisë që ishte vazhdimisht në një evolucion shumë të shpejtë. Kjo ndodhi me zgjerim të parisë sunduese gjatë periudhës ndërmjet dy luftërave botërore, kur paritë e segmenteve të ndryshme filluan të ndeshen dhe të bashkëpunojnë në ndërtimin dhe kontrollimin e shtetit. Metamorfoza e parisë ndodhi me zëvendësim thuajse radikal në vitin 1944. Paria e re ishte, në rastin më të mirë, një pari dytësore dhe që vinte nga shtresa të mesme katundare dhe urbane. Por, si shpeshësia e zëvendësimit të parive, që e merrnin legjitimitetin kryesisht nga lidhja me të huajt, ashtu edhe shpejtësia e ndrrimit të parive sunduese nuk lanë kohë për stabilizimin e vetë parisë si shtresë e mbyllur me pushtet tradicional dhe të rrënjosur në shoqëri. Përjashta zonave të trajtuara si jashtë ligjit shtetëror, d.m.th., si zona tribale, legjitimiteti i parive vinte nga kontrolli i tyre mbi shtetin.

Mirëpo, metamorfoza e sistemit, që ndodhi në vitin 1990 e mbas, ishte thelbësisht e ndryshme nga këto metamorfozat e mëparshme. Sistemi që duhej të vendosej në vitin 1990 e mbas, duhej që të ishte një sistem demokratik. Tranzicioni do të ishte i karakterizuar nga procese diferencuese të thella shoqërore dhe ekonomike. Shoqëria do të kalonte në një metamorfozë të plotë e të gjithanshme. Vendosja e një sistemi demokratik, që do të ishte

formalisht një demokraci liberale, mbi një shoqëri katundare, të sunduar nga një mendësi katundare, me një shtet pa legjitimitetin e duhur, ishte një ndërmarrje e vështirë. Vetëm paria sunduese mund të zgjidhte problemin duke iu paraprirë proceseve dhe duke e drejtuar popullin në rrugën e duhur. Paria zgjodhi që të mbronte interesin e vet si shtresë dhe kështu e futi vendin në një krizë të thellë e të vazhdueshme. Paria ishte efektive deri në atë pikë sa që i detyroi edhe të huajt që të bashkëpunonin me të. Paria enveriste fitoi një rol qëndror në drejtimin e proceseve. Edhe kur nuk ishte në pushtet, ajo e ruajti këtë rol gjatë gjithë tranzicionit duke u transferuar nga pushteti tek kontrollimi i ekonomisë dhe i strukturave të shoqërisë civile.

Projekti modernizues që do të zbatohet, në parim, duhej që të sillte një jetë më të mirë për të gjithë shqiptarët. Jo vetëm që paria i përcaktoi objektivat, por ajo nuk i lejoi këto procese që të ecnin në rrugën e duhur dhe i futi në hullinë ku gjenden tani. Jo vetëm që paria u bë zbatuese e projektit, ajo zgjodhi, me vetëdije, rrugën e deformimit e të shtrembërimit të projektit modernizues të së ardhmes, vetëm e vetëm për të ruajtur interesat e veta të ngushta si shtresë. Dhe, më e keqja, në këtë rrugë ajo kishte edhe mbështetjen e një mase të madhe të popullit, që shihte nga e shkuara. Zbatimi i projektit modernizues krijoi mundësinë, në interes të parisë, për të thelluar dasitë shoqërore e politike midis shqiptarëve. Ajo veproi kështu pa hezitim, dhe gjithnjë për të ruajtur sundimin e vet. Projekti që duhej të ishte modernizues, në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, krijoi vetëm një shtet ku paria është e përbërë nga plutokratë e kleptokratë. Kjo ishte pikërisht ajo rrugë që duhej shmangur.

Edhe ky projekt modernizues u sprovua që të ishte shumë traumatik dhe me pasoja të rënda e që do të kenë efekte të zgjatura në kohë. Gjithsesi, *nolens-volens*, ky projekt duhej të ishte i drejtuar dhe i zbatuar nga paria sunduese enveriste. Kjo pari, që e kishte sunduar shtetin me dorë të hekurt për dy breza, kishte monopolin e dijeve, profesionalizmin dhe kohezionin e nevojshëm për t'iu imponuar shoqërisë edhe në tranzicion. Prandaj, edhe projekti transformativ që është zbatuar gjatë tranzicionit nuk ishte, por

u bë projekti i parisë. Për këto arsye duhet të përqëndrohemi në analizimin e kësaj shtrese të ngushtë shoqërore, e cila lufton që të kontrollojë, me dorë të hekurt, me dinakëri politike, por edhe me sfastikim të madh, fatin e shqiptarëve.

Dështimi i vendosjes së demokracisë liberale në një shtet të vogël si shteti shqiptar, një republikë bananesh që është krejtësisht e varur nga influencat e huaja, pa sovranitet, edhe 20 vjet mbas rënies së sistemit parti-shtet është një rast tejet problematik për tranzitologjinë. Ky rast, siç do të thoshte Popper, është *Mjellma e Zezë* për teoritë e ndryshme të demokratizimit.

Megjithatë, vlerësimet që mund të jepen në lidhje me rastin shqiptar kanë anë të mira dhe të këqia. Në një nivel, rasti shqiptar provon tezën se demokracia liberale, si projekt modernizues, nuk mund të funksionojë në se paria politike zgjedh rrugën e kundërvënies ndaj këtij projekti. Në një nivel tjetër, rasti shqiptar provon argumentin se faktori ndërkombëtar nuk mund të imponojë sistemin politik që dëshëron në se ndeshet me një pari sunduese që nuk e pranon atë projekt. Ky rast provon se, pavarësisht rregullave formale e strukturës ligjore, si dhe pavarësisht mbështetjes formale popullore për sistemin demokratik, paria është në gjendje që ta minojë sistemin demokratik të imponuar nga jashtë. Edhe më keq se atë. Rasti shqiptar provon se, nëse është në interes të parisë, atëherë paria mund të arrijë që të kriminalizojë një shoqëri të tërë. Argumenti im është se në se duam të kuptojmë dështimin e sistemit demokratik dhe kriminalizimin e pandërprerë të shoqërisë në shtetin shqiptar, kyçi i shpjegimit është paria.

Paria: faktori qendror për dështimin e tranzicionit

Edhe një analizë e cila synon që të përdorë rastin shqiptar si një ilustrim për teori të caktuara të parive, apo që mëton të përdorë vetëm një teori të parive për të shpjeguar rastin shqiptar të tranzicionit, do të ndeshet me një numër paradoksesh shqetësuese në kontekstin e këtyre teorive. Këto paradokse duken atipike në kontekstin e përdorimit të një teorie që mëton të identifikojë

rregullsitë e pritshme në një numër të madh rastesh të caktuara, si në rastin e Gaetano Mosca apo të Vilfredo Pareto. Prandaj edhe zbatimi dhe përdorimi i teorive të parive duhet bërë me shumë kujdes dhe duke mbajtur parasysh specifikën shqiptare.

Në fillim duhen theksuar të përbashkëtat e teorive të parive. Argumenti se paria, pakica numërikisht e papërfillshme por e mirëorganizuar, punon që të kontrollojë çdo sistem politik, përfshirë këtu edhe demokracinë, është një premisë më të cilën pajtohen të gjithë studjuesit e parive. Po ashtu, edhe argumenti më i gjerë, që thotë se paria lufton me të gjithë mënyrat e mjetet kundër çdo sistemi që nuk i shkon për shtat interesave të saj, nuk është një argument i ri apo i panjohur. Premisa për të gjithë studjuesit e parive është pak a shumë e njëjtë: *“në çdo shoqëri, ekziston një pakicë që ka epërsinë në drejtime të caktuara dhe prandaj e sundon/udhëheq shumicën.”* Studjuesit e parive argumentojnë se çdo sistem ndërtohet dhe evoluon duke mbrojtur pikë së pari e në vazhdimësi, interesat e parisë sunduese. Pavarësisht dukjeve, e gjithë lufta politike bëhet për vendosjen e kontrollit mbi shtetin. Edhe përplasja ideologjike është e përqëndruar në minimizimin apo në forcimin e rolit të shtetit.

Por, dallimet midis argumenteve të ndryshme janë domethënëse. Dallimet midis teorive të ndryshme të parive nuk duhen nënvlerësuar sepse nuk janë thjesht nuanca të parëndësishme. Dallimet kanë të bëjnë me të gjithë aspektet e formësimit, të funksionimit, të mendësisë, të legjitimitetit, dhe të transformimit të parive. Cila është kjo pakicë? A është paria vetëm politike apo edhe shtresa në kontroll të ekonomisë? A janë edhe hajnat më të zotë dhe kodoshët më të suksesshëm pari? Cila është baza e legjitimitetit të parisë? Si kontrollohet shoqëria? A qarkullojnë paritë? Cili është roli i parisë në revolucionet dhe roli i revolucioneve mbi paritë? Cila është lidhja e parisë me sistemin demokratik? A mund të kontrollohen paritë? Cili është lidhja e parisë me strukturat moderne si kombi dhe shtet-kombi? Secila teori iu përgjigjet këtyre pyetjeve në mënyrë të ndryshme. Për të qëmtuar disa nga këto dallime, si dhe mundësinë e zbatimit të këtyre teorive në rastin shqiptar,

mbas Machiavelli, ia vlen të paraqes shkurtimisht argumentet e dy prej studjuesve të parisë, Gaetano Mosca dhe Vilfredo Pareto. Paraqitja e shkurtër këtu cek në të njëjtën kohë edhe dallimet midis këtyre dy qasjeve kryesore.

Machiavelli: Princi dhe Madërgonat

Niccolo Machiavelli është padyshim mendimtari që u përqëndrua në analizën e parive që janë vetëm një njeri, d.m.th. të Princit. Si mund të fitohet dhe të ruhet kontrolli mbi shtetin? Reduktimi i mendimit të Machiavelli në frazën kaq shumë të përdorur në kontekstin shqiptar, kryesisht për të justifikuar sjelljen e individëve të parisë, se “qëllimi justifikon mjetet” është i gabuar. Problemi është se, për Machiavelli, një sundues që bën atë që i vjen ndërmend është i marrë dhe i çmendur. Për Machiavelli, qëllimi kryesor i princit është ruajtja e shtetit. Atëherë e vetëm atëherë qëllimi justifikon mjetet.

Princi është një udhëzues për dikënd që kërkon që të ndërtojë një shtet të vetin në Italinë e shekullit të 16-të, një *staterello*, siç do të thoshte një studjues. Princi duhet të bëjë gjithçka që i shërben këtij qëllimi. Mbi të gjitha, ai duhet të jetë shembull i virtytit, dhe të udhëhiqet nga *exempla virtutis* i prijësve të shquar të të gjithë kohëve. Por, në se mizoria ndihmon në vendosjen e rendit, ai duhet të jetë mizor pa mëdyshjen më të vogël. Është më mirë me u pasë frikë se sa me u dashtë nga populli thotë Macchiavelli. Princi duhet të ngatërrojë gjithnjë njerëzit dhe të mos i lejojë që të marrin vesh se çka don të bëjë, apo se cilat janë objektivat e tij. Princi nuk duhet të ketë asnjë respekt për ndershmërinë, për marrëveshjet, besën, apo të ketë besnikëri ndaj kujt. Atje ku i vyen ai duhet të përdorë forcën e dhunën. Atje ku vyen ligji, ai duhet të përdorë ligjin. Pra, Princi duhet të imitojë skilen dhe luanin. Princi duhet të jetë i virtytshëm, fetar, njerëzor, i mëshirshëm, me vlera, besnik dhe i sinqertë. Por, për të ruajtur shtetin e vet, Princi duhet të jetë edhe i pamëshirshëm, çnjerëzor, i pabesë, dhe mashtrues. Princi duhet të vejë mbi gjithçka ruajtjen e shtetit të vet. Kjo është

e rëndësishme sepse ky *staterello* dhe Princi janë të pandashëm. Shteti është Princi. Interesi i shtetit, *ragion di stato*, është vetvetiu interesi i princit. Mirëpo, ndërsa princi sillet kështu, ai duhet të imponojë standardet më të virtytshme të sjelljes mbi popullin e vet. Virtyti i princit janë kompetencat, d.m.th. aftësitë e tij për të qeverisur. Virtyti i popullit është bindja ndaj ligjeve. Hobbes e ka vënë këtë konceptim të shtetit në themel të *Leviathan*.

Në një anë tjetër, mbasi Machiavelli u përzue nga politika, ai filloi të mendonte se si do të ishte shoqëria në se të gjithë mendonin e silleshin si Princi. Ky argument, shpesh tejet i nënvlerësuar në argumentet politike, trajtohet tek komedia e tij *La Mandragola*. Mësimi më i rëndësishëm i kësaj komedie është i thjeshtë. Në se të gjithë sillen si Princi, atëherë shoqëria do të jetë tërësisht e korruptuar, e zvetënuar dhe e degjeneruar.

Mandragola, që në shqip e njohim si madërgonë, është një bimë që ka një vend të veçantë në mendësitë sunduese të kohës. Madërgona është një bimë helmuese me lule të verdha në të gjelbër që ka erë të rëndë. Ajo zakonisht rritet me ferrat dhe njihet edhe si afrodisiak. Por, në mitologjinë okultiste dhe praktikën e shtrigave, *Mandragola* është një lloj dreqi i vogël qeros, i cili të jepet nga Dreqi për ta konsultuar dhe për të marrë vesh të ardhmen. Rrënjët e madërgonës ngajnë me formën e shtatit të njeriut. Në shumë shoqëri, edhe në Firencen e kohës, kishte legjenda që e lidhnin lindjen e madërgonës me vdekjen e dikujt, të një njeriu të mirë apo të keq. E përbashkëta e tyre është të gjithë mendonin se Madërgona bëhet vetvetja e dikujt, anipse në përmasa më të vogla. Mirëpo kjo kopje e klonuar e njeriut (që gjithnjë vjen si burrec qeros) të shërben ty për të parë të ardhmen por i shërben edhe vetë dreqit sepse vjen prej tij e përmes tij. Prandaj edhe në okultizëm njihet si *Molla e Dreqit*. Në mesjetë gjermanët e njihnin madërgonën si *Burreci i Trekëmbëshit*. Gjermanët besonin se madërgonat lindnin nga pikat e gjakut të hajdutëve që vareshin në trekëmbësh. Rrënjët e tyre merrnin formën e njeriut nga shtati i të cilit binin.

Pra, Mandragola është përgjigja që Macchiavelli i jep artistikisht pyetjes së çfarë ndodh në një shoqëri nëse të gjithë sillen si Princi. Italia e kohës, me korrupsionin, zvetënimin, dhe imoralitetin

e theksuar ofronte material të bollshëm për argumentin e tij. Paraqitja e problemit në formë komedie ka të bëjë edhe me gjendjen delikate të Machivelli. Por, si duhet interpretuar teoria e Machiavelli në rastin shqiptar?

Në mënyrë figurative dhe përmbledhtas, argumenti mund të paraqitet kështu. Në se Princi shihet si Enver Hoxha, ajo që po ndodh sot është sundimi i madërgonave të sistemit të tij. Prandaj edhe çelësi i analizimit të gjendjes ndër shqiptarët duhet kërkuar më shumë tek sjelljet metaforike të njerëzve në *Mandragola* se sa tek udhëzimet për sundim që ofron *Princi*.

Mirëpo, Machiavelli nuk ofron shumëçka përtej këtij krahasimi. Gjendja në të cilën janë shqiptarët është thelbësisht e ndryshme. Gjendja që po përjetojnë shqiptarët është pikërisht e kundërta e gjithçkaje që imagjinonte Machiavelli. Princi nuk ekziston, mandragolat janë çmendur, dhe populli është lënë të bëjë atë që i thotë mendja. Për ta përmbledhur edhe një herë gjendjen duhet thënë se shteti nuk ka sovranitet, paria ndjek interesat e veta, populli mendon simbas mendësisë katundare, shoqëria është e kriminalizuar, sistemi ekonomik nuk është i shëndoshë, dhe sistemi politik është oligarki e pastër. Kaosi i organizuar dhe prurjet e shumta nga mërgimtarët e lejuan si parinë e kriminalizuar, ashtu edhe shoqërinë e katundarizuar që të arrijnë objektivat e tyre pa ndërhyrë në punët e secilës palë. Si shoqëria, ashtu edhe vetë paria është peng i së shkuarës së vet.

Në një nivel metaforik, Machiavelli e bën gjendjen e shqiptarëve shumë të qartë. Prapë se prapë, krahasimi është i mangët. "Njëshat" e sotëm në politikën shqiptarë janë mercenarë të krimit të organizuar, të mbajtur peng nga shoqëria e kriminalizuar. Ata nuk janë elitë, por një pari që duhet të luftojë gjithë kohën për të mbijetuar, si individë, si klane dhe si shtresë, në gropën thithëse, në kënetën politike të Tiranës. Çelësi i shpjegimit të gjendjes duhet kërkuar më mirë tek teoritë dhe argumentet e studjuesve të parisë si Mosca dhe Pareto.

Gaetano Mosca: oligarkia, klasa politike, dhe formula politike

Argumenti i Gaetano Mosca është se demokracia është e pamundshme sepse çdo sistem përfundon në oligarki. Për Mosca, në çdo shoqëri, një pakicë e organizuar mirë, klasa politike, ia arrin që të sundojë shumicën sepse në një mënyrë a në një tjetër, ekonomikisht, politikisht apo moralisht është superiore ndaj pjesës tjetër të shoqërisë. Kjo pakicë ia arrin që të ruajë sundimin dhe të ruajë kontrollin mbi shtetin duke gjetur një formulë politike abstrakte e cila mbahet si e shenjtë gjatë një periudhe kohe. Kjo formulë, vjen prej autoritetit hyjnor, *Dei Gratia* d.m.th. me hirin e Zotit. Formula vjen edhe prej vullnetit të popullit, *La Volontà della Nazione* apo në gjuhën e enverizmit, *Në Emër Të Popullit*. Vetëm një formulë e tillë politike, e tipit *vox Populi, vox Dei*, (Bobbio numëron gjashtë tipe formulash të tilla, pra, formula politike nuk ka pse të kufizohet vetëm tek këto të dyja), ia siguron legjitimitetin shtresës sunduese.

Për Mosca, formula politike duket se është e rrënjësor në kulturën e popullit. Formula politike është në thelb të strukturave dhe të moralit shoqëror. Kjo ia lehtëson parisë marrjen e legjitimitetit që i duhet në momente kritike dhe për politika të caktuara. Në të njëjtën kohë, kjo formulë politike e rrudh hapësirën e saj për veprime që iu shërbejnë ekskluzivisht interesave të saj të ngushta si shtresë. Ky *trade off* nuk duhet mbivlerësuar sipas Mosca, sepse “*nuk është formula politike që përcakton mënyrën se si strukturohet shtresa politike, është shtresa politike që gjithnjë adapton formulën politike që i përshtatet më së miri interesave të saj.*”

Mirëpo, ky është një vështrim dhe trajtim i ngushtë i rolit të ideologjisë në shoqëri. Lidhja e parisë me formulën politike është shumë më komplekse dhe nuk është vetëm njëdrejtimëshe. Nga një anë, revolucionet që përfundojnë në despotizëm, paritë që ndërrojnë fe, e ndryshime të tilla radikale (ashtu si ndodhi në vitin 1991 ndër vetë shqiptarët kur paria sunduese enveriste u shkërbye, d.m.th., u metamorfizua, brenda një periudhe të shkurtër nga enveriste në liberaldemokrate e socialdemokrate) janë prova

se paria zgjedh formulën politike që i intereson për mbrojtjen e interesave të ngushta të saj. Nga ana tjetër, mendimi im, dhe rasti shqiptar e provon këtë, është se formula të tilla marrin një jetë më vete, me kohë ato bëhen hegjemonike në sensin që e përdor Gramsci konceptin e hegjemonisë. Kështu, formula politike përdoret lehtësisht edhe nga kundërshtarët e parisë sunduese. Ashtu si shihet nga evolucioni i qytetërimeve të ndryshme, formulat politike nuk janë më thjesht mjeti për të arritur qëllimin, shpesh ato bëhen qëllim në vetvete. Po ashtu, formulat politike e shtërngojnë parinë në veprimet e saj, apo edhe ia mundësojnë jetëgjatësinë, edhe kur nuk e ka kontrollin mbi pushtetin. Kjo don të thotë se jo gjithçka është e lidhur me kontrollin e shtetit dhe jo çdo herë mbisundon cinizmi i paskrupullt apo materializmi. Paritë mundet që të mbesin të ngrira në të shkuarën e vet, dhe shpesh përfundojnë duke e lidhur fatin e tyre me formulën e kohës së artë të sundimit të tyre.

Për t'u kthyer tek Mosca, klasa sunduese mund të jetë 'e mirë' apo e 'keqe' në lidhje me popullin. Kjo është në varësi të llojit të njerëzve që e përbëjnë atë shtresë dhe të veprimeve që ata kryejnë. Kur pjestarët e shtresës sunduese janë racionalë, të ndershëm, të kulturuar e të moralshëm, e që, të paktën në dukje, punojnë për të mirën shoqërore, atëherë klasa politike sunduese konsiderohet se është e mirë. Në këtë sens, Mosca e përcakton shtresën sunduese si një shtresë thelbësisht politike dhe administrative, të karakterizuar e të kufizuar në veprimet e saj nga kornizat ligjore e nga vlerat morale, por jo si elitë. Mosca nuk e përdor konceptin *elitë* sepse nënkuptimi do të ishte se shtresa sunduese vjen nga pjesa më e mirë e shoqërisë, çka nuk është e vërtetë. Prandaj, Mosca përdor konceptin e *la classe politica*.

Ashtu si vëren Bobbio, në teorinë e Mosca, dallohen dy tendenca. Nga një anë, "të gjitha paritë kanë tendencën që të bëhen *de facto*, në mos *de jure* të trashëgueshme" dhe, nga ana tjetër, "ka gjithnjë forca të reja që mëtojnë të zëvendësojnë parinë e vjetër." Për më tepër, edhe pse cilësitë mund të trashëgohen, paria duhet të rigjenerohet dhe ajo e rigjeneron veten duke kooptuar elementë të rinj që i japin vitalitetin e duhur. Në fillim

Mosca thonte se paria janë disa 'dyzina njerëzish.' Më vonë, ai e zgjeroi këtë koncept duke përfshirë në strukturën e parisë edhe parinë dytësore. Prandaj njëri ndër konceptet që ai i kushtoi më së shumti vëmendje ishte organizimi i parisë. Me organizim të parisë, Mosca nënkuptonte të gjitha aranzhimet që kishte bërë paria për të ruajtur kohezionin e saj, për të ushtruar e për të ruajtur kontrollin mbi pushtetin. Autoriteti transmetohet nga lart-poshtë, d.m.th., me metodën *autokratike* por edhe nga poshtë-lart, një metodë që ai e përkufizon si *liberale*.

Një koncept shumë i rëndësishëm në argumentin e tij është *mbrojtja juridike*, të cilën Mosca e përcakton si kompleksin "e mekanizmave shoqërorë që rregullojnë disiplinën në një sens moral." Kjo do të thotë se sistemi krijon mekanizma autonomë kulturorë dhe standarte sjelljeje morale, *etikën publike*, e cila nuk i lejon individët e ndryshëm që të rrezikojnë parimet bazë dhe funksionimin e sistemit. Por, për Mosca, shtylla e vërtetë e sistemit politik është shteti. Shteti dhe administrata e shtetit konsiderohen prej tij si *architrave* të sistemit. Lufta politike bëhet për kontrollin e shtetit.

Duhet thënë se Mosca e kishte shumë frikë votimin e përgjithshëm. Frika e tij ishte se italianët ishin një popull katundar dhe i prapambetur. Për këtë arsye, ata do të sundoheshin lehtë nga paria e tyre. Padija e tyre do të rrëronte çdo mundësi për një demokraci liberale. Po ashtu, ai ka thënë pak ose aspak në lidhje me partitë politike të kohës që, gjithsesi, ishin tarafe të parisë sunduese. Mosca shihte tek partitë politike instrumentin e ngjashëm me atë të tarafeve mesjetare, *guelfi* e *ghibellini*, që përdorëshin nga paritë e kohës për të luftuar me njëri-tjetrin për kontrollin e shtetit dhe mbrojtjen e interesave të palës së tyre nën veshjen e mbrojtjes së interesave universaliste. Duhej të vinte Michels që ta mbushte këtë boshllëk në argumentin e Mosca me argumentet e tij se partitë janë struktura moderne dhe se çdo organizatë përfundon duke u sunduar nga një grup i vogël, që njihet si ligji i hekurt i oligarkisë.

Vilfredo Pareto

Në studimin e tij të shpërndarjes së pasurisë e të pushtetit në shoqëritë e ndryshme, Pareto argumenton se, në të gjitha shoqëritë njerëzore, vërehet një fenomen shoqëror domethënës. Në çdo shoqëri që ai studjoi, apo që e përdori si rast ilustrimi, Pareto identifikoi një grup shumë, shumë të vogël njerëzish punojnë që të gjenden gjithnjë në majë të piramidës shoqërore. Kjo shtresë shoqërore, tejet e vogël numerikisht, simbas Pareto, është e përbërë nga më të aftët e më të zotët në fushën e tyre. Këtu hyjnë të pasurit, më të fuqishmit, dhe më të kulturuarit. Por, këtu hyjnë edhe hajnat më të zotë, d.m.th, ata që vjedhin miliona por nuk kapen. Ky grup i ngushtë, paria, (që Pareto e quan *elite*) arrin që të kontrollojë pasurinë dhe pushtetin politik, derisa të përmbysset nga revolucionet apo të zëvendësohet nga një shtresë e re sunduese. Në fund të piramidës shoqërore mbesin shumica dërmuese e popullsisë. Këta janë masat e gjëra që mbijetojnë ashtu si munden. Në mes të piramidës shoqërore janë shtresat e mesme që jetojnë disi më mirë se masat e kohës, por që nuk kanë asgjë të sigurtë në jetën e vet, sepse edhe këta janë në mëshirën e parisë.

Historia njerëzore, për Pareto, ofron ilustrimin më të mirë për këtë evolucion në një rreth të mbyllur të marrëdhënieve shoqërore, thjesht sepse njeriu nuk shkëputet dot nga ana e vet primitive, *natura vim suam exercente proficiunt*. Ai argumenton që ky konflikt mbi pushtetin është i përjetshëm e i gjithkundgjindshëm. Pareto ishte një markez që dështoi në politikë e që nuk besonte as në demokraci dhe as në nacionalizëm. Për të, historia është mbushur me regjime të formësuara nga paritë sunduese për interesat e tyre e që vihen tërësisht në shërbim të tyre.

Duke ndjekur Machiavelli, Pareto argumenton se çdo pari përbëhet nga njerëz me karakteristika të aktuara që mbizotërojnë në atë periudhë kohe. Në njërin grup janë *luanët*, njerëz që kanë ndjenja të forta besnikërie për grupin të cilit i përkasin, si kombi, shteti, feja, ideologjia, apo qytetërimi dhe që e sigurojnë stabilitetin e shoqërisë duke u mbështetur në virtytin publik. Në grupin tjetër janë *skilet*, individët që janë të aftë të manipulojnë

ligjin dhe mendjen e njerëzve dhe që lidhin bashkë përvoja dhe përshtypje të ndryshme. Këta nuk kanë asnjë parim, virtyt apo vlerë dhe janë në politikë vetëm për interesin e tyre. Koha kur *luanët* sundojnë është koha e stabilitetit shoqëror. Koha kur sundojnë *skilet* është koha e mashtrimit dhe e luhatjeve të mëdha. Në krye të shoqërisë një herë dalin *luanët* e mandej *skilet* që janë shumë të aftë të penetrojnë e të minojnë sistemin, të ndërtojnë aleanca e të përdredhin ligjin në shërbim të interesave të tyre. Kjo gjendje luhatje pendulumi nga *luanët* tek *skilet* çon në një sistem qarkullimi në rreth të mbyllur të parisë që në një kohë ndan të njëjtat karakteristika, d.m.th. shumica janë ose *skile* ose *luanë*. Kur ndodhin revolucionet, paritë e vjetra eliminohen dhe paritë e reja i zëvendësojnë ata duke e marrë kontrollin e shtetit.

Gjithashtu, asnjë nga këto periudha sundimi të një partie të caktuar nuk zgjat përgjithmonë, e prandaj, historia është varreza e parive. Për të arritur objektivat e tyre të pasurimit e të kontrollit maksimal mbi shoqërinë, paritë e reja synojnë që të minojnë çdo sistem të vendosur nga paria e mëparshme e ta zëvendësojnë me një sistem të ri shoqëror që avancojnë objektivat e tyre. Ndërsa parimi i legjitimitetit në rastin e parive të reja është i ndryshëm, thelbi funksional i regjimit të ri është i njëjtë. Ai sistem duhet që t'ia garantojë parisë pushtetin politik dhe privilegjet që kërkon.

Ndërsa rruga që Pareto ndoqi për të arritur në këtë përfundim ishte padyshim joshkencore, përfundimi ishte tejet intuitiv, lehtësisht i vërtetueshëm dhe i pranueshëm. Argumenti i tij kryesor, çka edhe më intereson më së shumti këtu, lidhet me paritë dhe me qarkullimin e tyre. Kur zhvishet nga argumentet e cekta psikologjike dhe kur pajiset me një bazë të re argumentative, dm.th. kur si shkak parësor konsiderohet sjellja racionale e parive që mendojnë për interesin e tyre, një argument i tillë bëhet i dobishëm. Pareto ofron mundësinë për të kuptuar e për të vlerësuar rolin e sunduesve e drejtuesve të një shteti, për të reflektuar mbi rolin që luan paria sunduese në shoqëri si identifikon edhe mekanizmin e ndryshimit të parive sunduese.

Teoritë e parive dhe rasti paradoksal shqiptar

Në vija të trasha, teoritë e parive duken se janë shumë të dobishme për të kuptuar proceset politike që kanë ndodhur e që po ndodhin në shtetin shqiptar gjatë kësaj periudhe kalimtare. Në mos tjetër, paria ka luajtur rolin kryesor dhe të padiskutueshëm në proceset e dhënies drejtim të proceseve politike dhe të vendimmarrjes në lidhje me të gjithë politikat e zbatuara.

Në se teoria e tyre zbatohet në rastin shqiptar, secili në mënyrën e vet, Machiavelli, dhe në traditën e Machiavelli, si Mosca ashtu edhe Pareto, ndihmojnë për të shpjeguar deri-diku mirë këtë metamorfozë e dështim historik të radhës të parisë sunduese të shqiptarëve. Por, teoritë e tyre nuk janë formuluar për raste kaq komplekse dhe anormale sa problemi shqiptar. Teoritë e tilla nuk mbajnë parasysh kushtet e ndryshme në të cilat vepron paria sunduese. Po ashtu, kështu si janë të paraqitura, dhe për sisteme të tejkaluara, teoritë e tilla nuk e parashtrajnë as rrugëzgjdhjen e mundshme dhe të dobishme. Për këto teori, e ardhmja është njëloj si e shkuara.

Dallimet midis këtyre dy teorive tradicionale që parashtrohen këtu janë të spikatura. Dallimet kanë të bëjnë me përbërjen e grupit që është në qendër të vëmendjes (shtresa sunduese politike, paria apo elita), me sferën e veprimtarisë së grupit (politika apo më të suksesshmit në fushën e tyre), çfarë bëjnë apo se si dalin në krye të lojës politike, rëndësinë e kulturës e të moralit (konteksti historik-juridik apo zotësia individuale). Një problem tjetër lidhur me aplikimin e teorive të parive është se në të dy këto variante, paria shihet si një shtresë aristokratike. Megjithatë, Mosca dhe Pareto plotësojnë njëri-tjetrin dhe ofrojnë mundësi premtuese për të analizuar si duhet tranzicionin dhe parinë e Tiranës. Mirëpo, duhen bërë disa rektifikime të nevojshme.

Qasjet e Mosca dhe të Pareto duhet që të përplotësohen edhe me disa elementë që mungojnë. Së pari, ato duhet të plotësohen me analizimin e kujdesshëm të rolit qendror të shtet-kombit në organizimin shoqëror bashkëkohor. Së dyti, të dy analizat duhet të plotësohen edhe me vlerësimin e duhur të rolit të strukturave

të tjera të organizuara, nga kombi tek strukturat kriminale, që potencialisht e realisht janë jashtë kontrollit të parisë politike. Së treti, të dy teoritë duhet të plotësohen edhe me një vlerësim të thuktë të rolit që luan sistemi ndërkombëtar në politikën e shteteve të caktuara. Së katërti, edhe pse ka përmendje të veçantësive kulturore të popujve të ndryshëm, këto veçantësi konsiderohen si të pandashme nga karakteri dhe përvojat e tyre unike historike. Megjithatë, në kohët moderne është krijuar një gjendje e re, në të cilën këto veçantësi unike të popujve ndikohen nga ideologjitë universaliste, si dhe nga mënyrat e metodat bashkëkohore të organizimit. Ka pasur një proces mësimi të teknikave dhe të metodave të ndryshme që tashmë janë përvetësuar nga grupe të caktuara. Më në fund, organizimi shoqëror dhe sistemi politik demokratik kanë krijuar dinamika shumë komplekse që nuk lejojnë për një shqyrtim bardh e zi të gjendjes. Prandaj, pavarësisht se vijnë nga paradigma të ndryshme, studimet që analizojnë rolin e parive në sistemin demokratik, apo studimet e tjera që përqëndrohen në rolin e kulturës dhe të shtetit në kontekste demokratike, janë gjithashtu të vyeshme. Analizat e tyre na lejojnë që të shohim më mirë e të kuptojmë më qartë realitetin shqiptar se sa teoritë aristokratike të zbatuara rigorozisht.

Përtej këtyre vëzhgimeve dhe plotësimeve të rëndësishme, duhet thënë se në shtetin shqiptar, shumica dërmuese e popullsisë si dhe vetë paraia janë katundarë të mirëfilltë. Edhe pse ata kanë qënë në krye të shtetit dhe kanë marrë përvoja të sofistikuar të drejtimit të shtetit, prapë se prapë në strukturën familjare dhe të rrethit shoqëror kanë mbetur katundarë dhe sillen sipas mendësisë katundare. Edhe sot shumë prej tyre nuk mund të shkëputen nga rrjeta e dendur e lidhjeve, e mendësisë dhe e origjinave shoqërore të përbashkëta.

Besimi i Pareto dhe Mosca se dallimet psikologjike themelore e veçojnë parinë nga shtresat e tjera, d.m.th., se paraia është më të zgjuar e më dinake, në shtetin shqiptar nuk ka kuptim. Në shtetin shqiptar të gjithë katundarët, qytetarët dhe paraia besojnë se mund të jenë mbretër dhe presidentë. Atë që njerëzit nuk e kanë në terma të cilësive intelektuale e të trashëgimisë e kompensojnë

me numrat e klanit, me armët e fisit dhe me etjen për të mos u ndalur deri sa të mbrrijnë të pambrritshmen që kanë ata në mend. Vetëm në shtetin shqiptar ndodh që një katundar e mban peng të gjithë shtetin me një SMS dhe askush nuk guxon të thotë gjë. Në shtetin shqiptar, katundarët janë të organizuar në struktura mafioze klanore. Mafia është forma ideale e një korporate apo firme biznesi dhe mafia shqiptare është kaq e organizuar sa është në krye të shtetit. Më në fund, paria duhet të ketë superioritetin moral që çmohet në shoqëri. Mirëpo në shoqërinë shqiptare sot po çmohet pikërisht ajo që nuk është e moralshme dhe e ndershme.

Prandaj, në rastin shqiptar, si Mosca, ashtu edhe Pareto, por edhe të gjithë studjuesit e tjerë duhen përdorur me masë e me kujdes të madh. Në rastin e Mosca, paritë në argumentin e tij janë të lidhura ngushtë me prioritetet që shoqëritë e caktuara i vënë vetes, ose më mirë me thënë, që paria ia vë shoqërisë. Nga ana e tij, Pareto thekson se paritë manifestohen në mënyra të ndryshme e në varësi të kushteve ekonomike e shoqërore. Ndër popujt që i janë përkushtuar industrisë e tregëtisë paritë synojnë fitimin e pasurisë, ndër popujt që çmojnë suksesin ushtarak ata shfaqen si gjeneralë, ndër kinezët ata shfaqen si të shkolluar, ndër popujt fetarë si kasta e priftërinjve, e me rradhë.

Po ndër shqiptarët? Ndër shqiptarët, paritë janë metamorfizuar me një lehtësi marramendëse, njëlloj si uji që merr trajtën e shishes ku e derdhin. Gjatë 150 viteve të shkuara, veçanërisht mbas lejimit të krijimit të strukturave kombëtare në perandorinë osmane, paritë shqiptare nuk kanë demonstruar asnjë lloj stabiliteti ideologjik. Një kohë, bejlerët kanë qënë më patriotët, e paritë janë bërë çaushë, arhondë, jeniçerë, bashibozukë, hoxhallarë, shehlerë, dhespotë, fretën apo reshperë. Stërnipat e këtyre janë bërë komunistë, disa edhe më të flaktë se vetë Marksit.

Mandej, mbas vitit 1990, të gjithë janë bërë çka ta merr mendja, e çka nuk mund të imagjinohet. Lufta e këtyre trashëgimtarëve të të gjithë parive që kanë shkuar të paktën një herë në varrezën e historisë, apo janë përdorur pa mëshirë nga kundërshtarët, është një luftë interesante. Ata duan me ndenjë në majë të piramidës shoqërore, me çdo kusht, e pavarësisht nga çka do që e përbën

strukturën ideologjike të asaj piramide shoqërore. Lehtësia me të cilën hiqet lëkura ideologjike e rradhës, shpesh edhe dy lëkura ideologjike brenda një brezi të vetëm, ia kalon edhe *gjarpërit*. Oportunizmi i sjelljes ia kalon edhe *hienës* e cila ushqehet me gjithçka që ka kenë e gjallë para se me ngordhë apo që ende frymon. Kjo sjellje është e veçantë për parinë e Tiranës sepse, në këtë rast, paria e ka kthyer popullin e vet në pre të padyshimtë.

Nga ky këndvështrim, problemet që shfaq përdorimi i teorive të parive aristokratike në shpjegimin e rastit shqiptar janë të jashtëzakonshme e unike. Aty ku duhet të ketë *luanë*, d.m.th. individë që janë këmbëngulës në bindjet e tyre në shërbim të kombit e të shtetit, ka gangsterë oportunistë që manifestojnë një sjellje tipike për *hiena*. Aty ku duhet të ketë *skile*, d.m.th., individë që janë në gjendje të ndryshojnë bindjet simbas interesave, ka *gjarpërinj* që nuk ndryshojnë asgjë, as veten e as ambjentin ku ekzistojnë. Çka është edhe e çuditshme, hienat po lindin gjarpërinj e gjarpërinjtë po lindin hiena. Procesi i kriminalizmit shoqëror është një shenjë e qartë e përkeqësimit të gjendjes. Loja i ka dalë parisë nga duart.

Pra, edhe aty ku duhet të ketë dashuri fiktive për kombin e shtetin, ka besnikëri të shpallur e të pakufizuar për tarafin, bandën, katundin e klanin. Aty ku duhet të gjenden e të dallohen manipulorët e sofistikuar të ligjeve që janë formuluar për të gjithë e në interes të të gjithëve, brohoriten ata që e bëjnë ligjin aty për aty, veç për interesat e tyre, dhe e ndërrojnë ligjin sa të kryejnë punën e vet që mund të jetë, as më shumë e as më pak, nevoja e ndërtimit të një pallati në tokën e vjehrrës. Aty ku duhet të ketë shtet, të paktën aq sa për të mbrojtur interesat e parisë, ka një strukturë të pastër mafioze që e mban parinë si peng të saj. Aty ku duhet të ketë sofististikim intelektual e argumentim ligjor, luhet fall për natë në emisionet televizive. Aty politikanët të thonë sot, atë që nuk do ta thonë nesër, e që është e kundërta e asaj që kanë thënë dje e që nuk ka asgjë të përbashkët me atë që ia thonë vetes së tyre. Ai që duhej të ishte pari dikund tjetër, në Tiranë shet drogë në qoshe të rrugës, e ai që din se si mund të rrihet në qoshe të rrugës bëhet deputet, ministër, kryetar, prijatar i parisë dhe

konsiderohet si e ardhmja e kombit.

Po ashtu, rasti shqiptar është një rast shumë i veçantë sepse, për të aplikuar si duhet teorinë e parisë, duhet që, si parakusht, shteti të jetë i mbyllur nga influencat e tjera, d.m.th. të jetë nën kontrollin e parisë. Në rastin shqiptar, shtetin e kontrollojnë të huajt, paria kontrollon katundarët respektivë. Për më tepër, si një parakusht tjetër, për të vërtetuar teorinë e parive, shoqëria duhet që të jetë, hipotetikusht, e varur nga paria. *Por, shteti shqiptar është një shtet pa sovranitet, në të cilin një pari mafioze por që është e kapur dhe e kontrolluar nga interesa të krimit, formalisht mban pushtetin mbi një shoqëri të kriminalizuar dhe ku përgjegjësinë reale të qeverisjes e kanë të huajt.*

Për këto arsye, teoria e klasës politike e Mosca, teoria e elitave e Pareto, ashtu edhe teorinë e tjera, edhe në rastin më të mirë, në analizimin e këtij tranzicioni duhen përdorur me shumë kujdes. Prandaj është e nevojshme edhe formulimi i një teorie të parisë që merr parasysh specifikën shqiptare por edhe specifikën e tranzicionit të kushtëzuar nga sistemi ndërkombëtar, nga pashmangshmëria e sistemit demokratik, si dhe nga nevoja e organizimit shoqëror të mbështetur në një ideologji të caktuar. Mësimet që mund të nxirren nga ky rast, megjithatë, janë të aplikueshme edhe në raste të tjera.

Në traditën moderne të studimeve për demokratizimin dhe konsolidimin e demokracisë, formalisht, paria nuk duhet të ketë një rol të tillë qëndror. Rolin kryesor duhet ta luajnë strukturat. Në qendër të gjithçkaje është vullneti i popullit i shprehur me zgjedhje periodike, të drejtpërdrejta, të fshehta, dhe të përgjithshme. Por, edhe në një sistem pluralist, siç argumenton Dahl, ka grupe që luajnë një rol shumë më të madh se të tjerët.

Megjithatë, rasti shqiptar provon katërcipërisht të kundërtën. Shteti shqiptar është në gjendjen ku është për shkak të parisë që e sundon. Përvoja shqiptare tregon se paria është në gjendje që të minojë vendosjen e demokracisë, si dhe të gjitha proceset demokratike nëse ky sistem iu bie ndesh interesave të saj. Paria është në gjendje që t'iu kundërvihet me sukses edhe të huajve. Edhe më keq se aq, paria është në gjendje që t'iu kundërvihet shoqërisë

duke e shtyrë atë që të ecë në rrugë jo të pranueshme e deri kriminale. Paria mundet që t'i kundërvihet interesave të shteteve të interesuara duke e zhvlerësuar çdo influencë të huaj dhe duke i detyruar të huajt që ta pranojnë atë si shtresë sunduese. Për të arritur qëllimet e veta, paria mund të shkojë deri në kriminalizimin e plotë të shoqërisë. Kjo ka ndodhur në rastin shqiptar.

Paradoksalisht, teoritë që shpjegojnë më së miri aspekte të rëndësishme të rastit shqiptar, janë teoritë e parive. Analizat dhe qasjet e mendimtarëve si Platoni, Aristoteli, Xun-zi, Ibn Khaldun, Niccolo Machiavelli, Saint-Simon, kanë ndikuar në shumë prej autorëve modernë që kanë studjuar paritë. Autorë e studjues që janë marrë me problemin e parive në traditën e Machiavelli si Gaetano Mosca, Vilfredo Pareto, Robert Michels, kanë ofruar shumë mendime të vyeshme në lidhje me analizimin e parive dhe rolin e tyre në një sistem demokratik. Analiza e parive është qëndrore edhe në traditën marksiste, në të cilën spikasin Marks, Lenini, si dhe mendimtari më i shquar shqiptar, Antonio Gramshi. Trajtimi i parive ka qënë e mbetet një argument i rëndësishëm edhe në literaturën bashkëkohore në të cilën spikasin autorë si Mills, Domhoff, Bottomore, Higley, Burch, e të tjerë. Por, edhe këto teori e qasje duhen marrë me kualifikimet e nevojshme. Kur analizohen proceset demokratike në SHBA e në vendet e zhvilluara kapitaliste, dinamikat që ndeshen janë të ndryshme nga të rasteve të shteteve të vogla, të kapura në rretjen e proceseve kombformuese dhe që janë në periferinë e sistemit kapitalist si rasti shqiptar.

Shpjegimi i dështimit të tranzicionit shqiptar është i lidhur me parinë. Duke reflektuar pikërisht atë sistem vlerash me të cilat ishte mbrujtur gjatë sistemit enverist, paria sunduese shqiptare, kësaj here e zgjeruar dhe e transformuar, u soll si një shtresë që iu imponua me të gjithë metodat e mundshme shoqërisë shqiptare të cilën synonte që ta sundonte dhe ta skllavëronte. Në çdo hap që ndërmoi, paria sunduese punoi për të paralizuar shtetin e për ta kontrolluar atë, për të minuar procesin demokratik, për të vendosur një sistem ekonomik monopolist, dhe për të fragmentarizuar, kriminalizuar, e për të zvetënuar shoqërinë që sundon, thjesht sepse kështu dukej se iu shërbente më mirë

objektivave të saj. Aleanca e parisë është njëlloj si aleanca e madërgonave: të gjithë janë të ndryshëm, por gjithsecili ndjek të njëjtin interes të përbashkët, me të njëjtat metoda, dhe me të njëjtat objektiva.

Siç shihet nga gjendja ku jemi, rasti shqiptar provon se kur paria është e vendosur që të ecë në këtë rrugë, paria si shtresë do të gjejë rrugën e metodat për të minuar demokracinë dhe për të vendosur një sistem oligarkik që iu përshtatet interesave të saj. Shteti mund të gjendet në anë të Europës, mund të mos ketë ekonomi të mirëfilltë, mund të ketë humbur sovranitetin, dhe mund të ketë edhe një popull që është i gatshëm të sillet në mënyrë demokratike. Prapë se prapë, paria mund t'ia dalë që të arrijë objektivat e saj.

Po kush është paria? *Paria janë ata individë, që të organizuar në grupe me interesa e me vlera ideologjike të përbashkëta, luajnë një rol parësor, vendimtar, dhe sistematik në marrjen e vendimeve lidhur me organizimin shoqëror, si dhe në përcaktimin e politikave dhe vlerave të shoqërisë në një shtet të caktuar.* Paria janë pakica e organizuar dhe sunduese. Por, ka një dallim të madh cilësor midis parisë, klasës politike, shtresës sunduese dhe elitës. Këto janë kategori të ndryshme pakicash të organizuara të dallueshme nga njëra-tjera.

Kur pakica sundon sepse është në kontroll të shtetit dhe është administrata publike, atëherë mund dhe duhet të flitet për *la classe politica* të Mosca. Formula politike dhe legjitimiteti i saj vjen nga pozicioni politik që zë në shoqëri dhe justifikohet me interesin e shtetit. *La classe politica* nuk është tërësisht e shkëputur nga shoqëria. Kur pakica sundon sepse përbëhet nga njerëzit që kanë demonstruar më shumë zotësi në fushën e tyre, atëherë është shtresë sunduese, edhe pse Pareto preferonte termin *elite*. Në fund të fundit, dalja e tyre në krye të lojës është meritë e aftësive të tyre personale e jo e përzgjedhjes së tyre nga ana e popullit. Termi elitë, të përzgjedhurit, duhet rezervuar për një pakicë që punon për të mbrojtur e avancuar interesin e të gjithë shoqërisë e jo vetëm për ta përdorur.

Problemi, pra, është i thjeshtë: kur paria sundon në bazë të

interesave të veta të ngushta si shtresë, kur i imponohet shoqërisë, atëherë është pari. Sundimi i saj mund të zgjasë për shumë kohë, si *luanë* apo si *skile*, si *gjarpërinj* apo si *hiena*. Por, në se sundon në bazë të një sistemi vlerash materialist, edhe kur mënyra e vjeljes të të mirave material është përmes luftës, është gjithnjë në rrezik të shembjes së kontrollit e të zëvendësimit me humbjen më të parë. Por kur paria sundon në bazë të një ideologjie, e cila e shtërngon edhe atë në sjelljet e saj, atëherë transformohet në diçka tjetër, në elitë. Në këtë rast, ideologjia që e legjitimon, bëhet edhe pengesë e shtërngesë në sjelljen e parisë. Ideologjia bëhet edhe mekanizmi përmes të cilit shoqëria e kontrollon parinë dhe që ofron rrugët për zgjidhjen e problemeve e të fërkimeve shoqërore. Ky dallim është thelbësor por nuk është i zhvilluar në literaturë. Duke e përdorur konceptin 'elitë' në mënyrë të padallueshme e pa diferencimin e bërë më lart, shumë studjues ndeshin vështirësi në analizimin e rolit e të vendit të parive në demokraci. Dallimi është i qartë. Edhe kur një grup mundet që të uzurpojë pushtetin politik apo ekonomik, kjo nuk e bën elitë, thjesht sepse nuk e ka legjitimitetin e duhur ideologjik që e lidh me shoqërinë që drejton.

Paria është një grup shumë i vogël numerikisht. Egjithas shtresë, edhe në SHBA, paria asnjëherë nuk i kalon disa mijra vetët. Në majë të kupolës janë prijatarët, ata që edhe pse gjenden në hije e nuk janë formalisht të veshur me pushtet, vendosin dhe influencojnë politikën që ndiqen. Prijatarët nuk janë asnjëherë më shumë se një dyzinë. Në rastin tonë, në periudhën e mbas pavarësisë kjo shtresë është lehtësisht e identifikueshme në familjet e bejlerëve jeniçerë, të rytbes, dhe të pronës (Bushati, Kryeziu, Toptani, Vrioni, Vlora, Zogolli, Biçaku, Asllanpasha, Delvina, Këlcyra, Konica, Çoku, Dibra, Vërlaci, etj.), në përfaqësuesit e bashkësive katolike (Bibë Doda, Coku, Gurakuqi, Kaçorri, Bumçi), bashkësisë ortodokse shqiptare (Peci, Misha, Harito, Evangjeli, Gërmenji, Kotta) dhe në prijatarët e strukturave tradicionale (Boletini, Curri, Shehu, Mjeda, Dodani, etj). Po ashtu, kjo shtresë është lehtësisht e identifikueshme edhe gjatë periudhës së Zogut dhe të sundimit enverist.

E ndërtuar në bazë të klaneve familjare e të besnikërive personale, paria ka gjithnjë në qendër, një grupim shumë të vogël

e përfaqësues të interesave të saj, eksponentët e vërtetë të parisë. Këta individë, që në çdo sistem kanë pushtetin në një moment të caktuar, janë ata që marrin vendime në emër të të gjithë parisë. Një krahasim mundet të jetë më i dobishëm këtu. Në një turmë zogjsh në qiell, apo peshqish në det, të cilët duket se sillen rrotull pa rregullin e duhur, ka disa individë që ia japin drejtimin luzmës. Ashtu edhe në strukturën e parisë ka disa individë të spikatur që ia japin drejtimin të gjithë strukturës së saj.

Këtu ka vend që të parashtrohen një numër hipotezash. Sa më të vështira bëhen vendimet politike, aq më i ngushtë është ky grup vendimmarrës. Sa më kritike janë zgjidhjet që duhet të bëhen, aq më i polarizuar është ky grup. Sa më të mëdha janë interesat që luhen, aq më intensive është përplasja e klaneve. Por, mendësia e grupit është e njëjtë dhe intersubjektive. Edhe pse individët që janë pjesë e parisë mund të mos ndajnë të njëjtat pozicione, mendësia e tyre, e farkëtuat përmes eksperiencave, stërvitjeve, origjinave, lidhjeve, edukimit dhe interesave është e njëjtë. Prandaj edhe përplasjet midis fraksioneve të parisë sunduese sjellin një ridimensionim të saj, por jo zhdukje të plotë. Rrjeti i lidhjeve është i tillë që gjithnjë do të mbesin struktura që e lidhin parinë shumë fort dhe e mbajnë bashkë. Me fjalë të tjera, dy duart mund të përplasen, por nuk e thyejnë njëra-tjetrën.

Ndryshimi vjen kur paria përplasat më një grup tjetër të organizuar që ka vlera e ideologji tjetër prej saj dhe që ka një pari me të cilën ajo ka lidhje të dobëta dhe të paqëndrueshme. Përplasja atëherë është për jetë a vdekje. Në këto grupe, nëse nuk ka zgjerim apo kooptim, paria edhe mund të zhduket fizikisht. Një ndër shembujt në historinë tonë është vrasja e 500 derebejve jeniçerë në Manastir nga Mehmet Reshid Pasha në vitin 1830. Duke i vrarë të gjithë përnjëherësh, derebejtë dhe krerët e ortave, Sulltani ia këputi kokën rebelimit jeniçer në Toskëri dhe i detyroi ata që mbetën, nga Vlorajt e poshtë që të kthehen nga bektashinj në sunitë. Një shembull tjetër është zhdukja fizike e parisë së vjetër në vitin 1944-1948.

Mirëpo, ajo që i dallon individët që ia japin drejtimin shoqërive prej pjestarëve të tjerë të parisë, d.m.th. eksponentët e saj, është

aftësia e tyre për të përgatitur e ndërlidhur argumentet në nivelin ideologjik. Prijatarët janë formuesit e opinioneve, ofruesit e zgjidhjeve, justifikuesit e sjelljeve. Jo gjithnjë ata që kanë fuqinë, kanë edhe mendjen. Prandaj kur flasim për Enver Hoxhën mbrapa tij shohim hijen e Ramiz Alisë. Edhe pse historia është e mbushur me katundarë që njihen si “të mëdhenj”, prapë, mbrapa secilit prej tyre ka qënë një mendje e zgjuar. Në rastin tonë të tranzicionit, mendja e zgjuar ishte Enver Hoxha. Këta që sundojnë janë madërgonat e tij.

Prandaj, në çdo kohë, ata që ua japin drejtimin shoqërive janë intelektualët. Në mënyrë të drejtpërdrejtë, si formulues e zbatues të zgjidhjeve, gjithnjë ideologjike, ose në mënyrë të tërthortë, si ndikues mbi eksponentët e parisë, intelektualët luajnë një rol parësor e vendimtar në kthesat e tilla historike. Fillimisht, duhet thënë nuk ka rëndësi në se këto intelektualë janë të shkolluar, të arsimuar apo thjesht karizmatikë. Ajo që ka rëndësi është se ata janë në gjendje të paraqesin, me koherencë dhe me konsistencë, një sistem vlerash që hidhet poshtë ose pranohet nga shoqëria dhe nga vetë krahu i parisë që e mbështet zgjidhjen. Mund të jesh pa një ditë shkollë, e të mos dish shkrim e këndim, por të konsiderohesh si profet nga një e katërta e njerëzimit.

Marrëdhënia e intelektualëve me prijatarët është shumë komplekse. Të dy palët duhet ta shohin këtë sistem vlerash morale si të vetmin sistem që iu garanton mbrojtjen e interesave, ruajtjen e rregullit të duhur shoqëror, dhe kultivimin e vlerave që mundësojnë ndërtimin e një shoqërie të moralshme nga këndvështrimi e nga botëkuptimi i tyre. Mirëpo, pala e tretë është shoqëria. Dallimi midis parisë dhe shoqërisë është dallimi midis shoferit dhe këmbësorit. Mendësia e tyre është e ndryshme dhe me kohë, shoqëria zhvillon praktika e teknika sjelljeje që e mbrojnë në udhëkryqet e ndryshme. Shoqëria zhvillon kundërkulturën e vet që shfaqet në formën e herezive, të kulteve, të strukturave kriminale dhe që çimentohet me rituale, praktika e metoda rekrutimi dhe interpretimi të papranueshme prej parisë. Paria bëhet elitë, kur figurativisht, në një udhëkryq pa drita e semaforë, si shoferi ashtu edhe këmbësori respektojnë njëri-tjetrin. Pra, kur paria është

në drejtim të shtetit, ajo mendon e punon për popullin e vet dhe populli e konsideron sjelljen e saj si të vetën. Ashtu siç thoshte Lao Ce, *“Për një udhëheqës të mirë, që flet pak, kur të kryhet puna e tij, kur të përmbushet qëllimi i tij, atëherë populli do të thotë ‘Këtë shoqëri e kemi ndërtuar vetë ne.’”*

Sa më e vështirë është gjendja e parisë, aq më i rëndësishëm bëhet roli i intelektualëve që janë besnikë të saj. Këta duhet të dinë që të gjejnë zgjidhjet e duhura e të mendojnë përjashta kornizës së lejuar deri atëherë. Mirëpo, paria ka nevojë për intelektualët edhe pse këta janë mekanizmi që i lidh me shoqërinë. Por, intelektualët janë gjithnjë të konsideruar me dyshim. Zgjidhjet më të pranueshme për parinë janë gjithnjë ato zgjidhje që janë përdorur në të shkuarën. Prandaj, mendësitë ndryshe, argumentet ndryshe, dhe intelektualët që i bartin këto janë gjithnjë në kundërshtim me parinë, që është thelbesisht konservatore dhe e ngurtë. Rebelimet nuk fillojnë nga vuajtjet që përjetojnë njerëzit, rebelimet fillojnë nga idetë dhe vizionet për një të ardhme ndryshe. Intelektualët janë bartësit e kësaj mendësie.

Po për këtë arsye, roli i intelektualëve kundërshtarë të parisë është shumë delikat. Ata duhet të dinë që të shohin me largpamësi se cili është sistemi më i dobishëm për grupin e vet. Ata duhet të punojnë që të formulojnë sistemin e vlerave dhe të gjejnë rrugëzgjidhjen që krijon, më së pari, një shoqëri të moralshme, e së dyti, një shoqëri të begatshme dhe që ofron siguri materiale. Ndryshe, si Luteri dhe anabaptistët, ata mund të fillojnë një revolucion dhe përfundimi është krejtësisht i ndryshëm nga ajo që të dy palët shpresonin të arrinin.

Në pika kritike të krizës, roli i intelektualëve të vërtetë dhe të sofistikuar bëhet parësor. Arsyeja është se intelektualët duhet të gjejnë zgjidhje që janë koherente me formulën politike të parisë sunduese. Kjo e ruan stabilitetin dhe vendin e parisë në sistem. Si thotë edhe Mosca, në bërthamë të strukturës shoqërore dhe të justifikimit të sundimit të një partie qëndron gjithnjë një formulë politike. Formula politike e justifikon pushtetin e saj sepse është ideologjikisht koherente, konsistente dhe, në dukje, është në interes të parisë e të shoqërisë që ajo sundon. Në se paria e arrin

gjetjen e kësaj formule politike ideologjike dhe pranon shtërngesat që rrjedhin prej saj, atëherë para transformohet në elitë. Përndryshe para duhet ta mbajë pushtetin me forcë. Legjitimiteti humbet kur para nuk është në gjendje që të justifikojë veprimet dhe vendimet që merr.

Ata që mund t'ia japin parisë një zgjidhje të tillë ideologjike janë intelektualët me vizion e me një kuptim të thellë të shoqërisë së tyre e të proceseve e të hullive në të cilat do të ecë shteti dhe shoqëria. Shpesh intelektualët, në atë nivel që janë, mundet që t'i dalin kundër parisë politike dhe të punojnë që ta zëvendësojnë parinë sunduese. Kjo ndodhi në shekullin e 19-të në disa vende të Europës. Politicizimi i intelektualëve e fragmentarizon parinë dhe konflikti bëhet endemik. Rastet ekstreme janë revolucionet, kur intelektualët që shohin një mundësi të marrjes së pushtetit i kundërvihen parisë politike. Po ashtu, një rast tjetër interesant janë edhe kundërrëvolucionet, kur para politike iu kundërvihet intelektualëve dhe mundohet që t'i vërë në shërbim të saj.

Në një sistem oligarkik, është e qartë se kush ka kontrollin mbi politikën dhe ekonominë. Për një studjues që përqëndrohet mbi parinë dhe shtetin, në një mënyrë apo në një tjetër, të gjithë sistemet janë oligarkike. Këtu roli i intelektualëve është parësor. Sistemi oligarkik nuk i lejon intelektualët që të kenë mendime të ndryshme nga të parisë. Në fakt, mënyra në të cilën oligarkia e toleron aktivitetin intelektual është duke i detyruar që t'i shërbejnë asaj. Edhe kur intelektualët janë të mbyllur në kulla të fildishta, para oligarkike nuk mund të pranojë ekzistencën e tyre autonome. Njerëzit dhe strukturat kanë autonomi, idetë automatikisht kanë pavarësi të plotë.

Prandaj sistemi demokratik është një sistem shumë problematik për të gjithë paritë. Demokracia nuk është forma më tradicionale dhe e sprovuar e regjimit. Por demokracia është forma më e përshtatshme për shoqëri me nivel të lartë edukimi, me zhvillim shoqëror, me një shoqëri civile të fortë, dhe me identitet. Megjithatë, demokracia bëhet e mundur vetëm kur para e pranon strukturën e përzgjedhjes së udhëheqjes dhe të organizimit demokratik, pse ndan një sistem vlerash që është liberal, nacionalist, ose teokratik

por i njëjtë me shoqërinë e vet. Në konjunktura të caktuara politike, demokracia bëhet e pranueshme për parinë, si një mënyrë për të zgjidhur problemet e veta, duke pasur legjitimitetin e duhur që e merr nga vota popullore. Nëse zgjidhja që paria iu jep problemeve të shoqërisë është edhe sipërfaqësisht e pajtueshme me interesat dhe preferencat e popullit, atëherë, paria ka gjetur një rrugë të sigurtë për të shtyrë përpara interesat e saj. Por, nga ana tjetër, për të kultivuar një gjendje të tillë shoqërore, paria duhet të ketë ose të kultivojë rrënjë të thella në shoqëri, me të cilën, me kohë, e lidhin si vlerat ideologjike, ashtu edhe struktura e marrëdhënieve të komplikuar njerëzore e shoqërore, si dhe rrjeta e përhershme e interesave. Pa këto mekanizma, sistemi degjeneron shumë shpejt nga demokracia në oligarki.

Është e rëndësishme të vihet re se, në çdo kohë, paria sunduese, edhe kur është e transformuar në elitë, do të jetë në pozicion të kundërt me masat që i sundon apo drejton. Arsyeya është sepse paria duhet të vendosë, sa më shumë që mundet, nga të gjithë burimet e shoqërisë dhe të vetë parisë, në shërbim të përmbushjes së qëllimeve ideologjike që ia ka vënë vetes. Kjo arrihet vetëm përmes një shteti të fortë. Prandaj, një pari mund të jetë ose e interesuar për kontrollin mbi strukturën e shoqërisë ose për forcimin e shtetit si një tërësi instrumentesh politike që e shtërngojnë sjelljen e saj dhe të shoqërisë. Por, në të dy rastet, rruga kalon përmes kontrollit mbi shtetin. Rruga kalon përmes krijimit e forcimit të autonomisë shtetërore, duke e ndarë shtetin nga pjesa tjetër e masës së sunduar dhe duke e kaluar konfliktin politik brenda vetë parisë. Ka edhe një rrugë tjetër, kur paria, e vendos haptazi shtetin në shërbim të vet si shtresë oligarkike dhe e përdor kundër popullit që sundon.

Kjo dinamikë garanton që konflikti midis popullit e parisë, por edhe midis palëve të parisë që synojnë kontrollin e shtetit, do të jetë i përhershëm dhe i pazgjidhshëm. Arsyeya është se paritë do t'i përkasin shtresës/palës që kontrollon shtetin, ose edhe shtresës/palës që synon kontrollin e shtetit. Prandaj edhe paritë, që kështu do të jenë të ndara e në një gjendje papajtueshmërie të pazgjidhshme, do të përplasen, shpesh deri edhe në përprjekje për

zhdukje të njëres palë. Në mënyrë të pandryshueshme, përplasja do të jetë lidhur me kontrollin e shtetit dhe të burimeve të pamata në dispozicion të tij. Pra, pavarësisht se cili është shkaku formal, paritë do të luftojnë që të kontrollojnë shtetin.

Gjithmonë, një ose më shumë palë të parisë do të besojnë në argumentet se shteti dhe burimet e tij nuk përdoren si duhet, edhe kur kjo është thjesht mospërdorim në interes të ngushtë të tyre, dhe kështu do të mundohen që të mobilizojnë masat për t'iu kundërvënë palës tjetër. Në qendër të të gjithë problemeve është kontrolli mbi shtetin, apo mënyra e marrjes së kontrollit mbi shtetin.

Përplasjet e parive kurrë nuk përfundojnë me zëvendësim të përplotë. Paria e ka monopolin e dijeve, të profesionalizimit, të pasurisë, apo legjitimitetin në një kohë të caktuar. Por, kushdo që merr kontrollin e shtetit është i detyruar që të mbrijë një marrëveshje me një pjesë të parisë që ka sunduar deri atëherë sepse përndryshe nuk din e nuk ka se si të qeverisë. Pra, paria ose zëvendësohet duke integruar elemente të parisë së mëparshme, ose zgjerohet duke thithur e integruar elemente të parisë kundërshtarë, ose trashëgohet në familje.

Për shkak të rrjeteve të fuqishme të detyrimeve shoqërore, si dhe të prestigjit, të rrjeteve, të pasurisë, të specializimit, e me rradhë, paria është gjithnjë e aftë të trashëgojë një status më të ndryshëm se të tjerët në familjen e vet dhe një vetëdije krejt tjetër në lidhje me rolin e shtetit e të pushtetit politik nga të tjerët. Si normë, paria nuk motivohet nga vlera, nga ideologjia apo nga ndjenja e shërbimit publik sikundër bën elita. Paria ka vetëm interesa dhe gjithçka është në shërbim të atyre interesave. Familja dhe struktura e klanit bëhen mekanizmi në të cilin formësohen brezat e mëpastajshëm të parisë. Një familje e caktuar e parisë mund të jetë disa breza larg shtetit, por mendësia shtetare trashëgohet edhe në detajet e sjelljes së pjestarëve të vet. Si normë rekrutimi i pjestarëve të parisë ndodh brenda rradhëve të saj. Kjo krijon gjithnjë mundësinë e degjenerimit dhe të bjerrjes së aftësive, si dhe pakënaqësinë e vazhdueshme në rradhët e intelektualëve dhe të individëve që

kanë treguar aftësi superiore në fusha të tjera. Konflikti është gjithnjë latent dhe mund të shpërthejë shumë lehtë.

Po ashtu, për shkak se burimet e shtetit vijnë duke u shterrur, paria nuk të blejë legjitimitetin e vet gjithë kohën. Gjithnjë, një pjesë e parisë do të jetë e pakënaqur. Por edhe një pjesë e madhe e shoqërisë do të jetë gjithnjë e pakënaqur. Në një sistem të kontrolluar nga paria, krizat janë të paevitueshme. Paria mund të zgjidhë shumë prej tyre, por në fund do të thyhet nga fitimtarët e rradhës. Kjo është edhe tragjedia e parive që përfundojnë në varrezat e historisë.

Shpjegimi që u parashtrua këtu, është i aplikueshëm edhe në raste të tjera të ndryshme. Por, para së gjithash, ai ofron mundësinë për të vlerësuar si duhet rastin shqiptar të dështimit të tranzicionit. Në këtë rast, paria sunduese enveriste përdori intelektualët dhe strukturat për të ndërtuar një shoqëri që iu përshtatej plotësisht arritjeve të qëllimeve të saj të transformimit në shtresë të ngushtë sunduese, borgjezi e madhe, që ka monopolin mbi shtetin, mbi ekonominë dhe mbi vlerat e shoqërisë.

Nga ana e tyre, intelektualët iu kundërvunë parisë vetëm mbasi morën pushtetin. Mbasi krijuan klanet e tyre gjatë kohës që ishin në pushtet, ish-intelektualët punuan që të spostojnë parinë e vjetër sunduese dhe të marrin rolin qëndror në proceset politike. Konflikti midis dy palëve ishte i acaruar deri në ekstrem. Asnjëra palë nuk mundi që të kontrollojë sistemin, efektivisht dhe deri në shkallën që i jepte sigurinë e nevojshme. Për shkak se demokracia e mirëfilltë nuk e mundëson arritjen e një qëllimi të tillë, edhe kur e gjen mirëkuptimin me palën tjetër, të dy palët e minuan sistematikisht demokracinë. Për shkak se rruga më e shpejtë e pasurimit kalonte nga krimi, ata u kriminalizuan dhe vetë u shndërruan në instrumente të krimit të organizuar. Për shkak se mbështetja e vetme që mund të marrin vjen nga strukturat klanore katundare, nga edhe vijnë që të dy palët, këta kanë punuar e punojnë për forcimin e këtyre lidhjeve e të kësaj mendësie. Tashti, të dy palët e parisë së Tiranës kanë rënë dakord për sundimin e shtetit në bazë të përqindjeve. Kjo mund të realizohet me qeveri teknike ose me marrëveshje të heshtura, por është fakt shoqëror

në politikën shqiptare.

Në drejtime të tjera, paria ndoqi të njëjtën metodë. Për shkak se vendosja e një ekonomie tregu të institucionalizuar do të përkthehej në kontrolle të forta mbi interesat e tyre, ata promovuan ndërtimin e një xhungle ekonomike. Për shkak se pasurimi i tyre në kurriz të shtetit e të shoqërisë nuk mund të ishte moralisht i pranueshëm, ata punuan që ta kriminalizojnë shoqërinë. Në fund, për shkak se shteti autonom dhe në shërbim të shoqërisë e të arritjeve të ekuilibre shoqërore ishte një shtërgesë e padëshërueshme për ta, paria ia ka arritur që ta dobësojë shtetin deri në atë pikë sa të kontrollohet nga interesat kriminale e mafioze. Për shkak se interesi i saj është ruajtja e kontrollit mbi monopolet e pushtetin, paria e ka shitur sovranitetin e shtetit. Tashmë, paria është e zgjeruar edhe me klanet e drejtuara nga “intelektualët e shquar” të deridjeshëm dhe ka marrë formën e vet si paria e Tiranës. Paria e Tiranës është në kërkim të një zgjidhjeje politike që garanton strukturën e kontrollit mbi shoqërinë e mbi burimet materiale e njerëzore në bazë përqindjesh.

Duke qënë se gjatë tranzicionit, paria ka kaluar në proceset e zgjerimit e të transformimit, jo gjithnjë të kontrollueshme prej eksponentëve të saj të mëparshëm, ajo është fragmentarizuar, lidhjet intersubjektive janë dobësuar, por mendësia ka mbetur e njëjtë si dhe lidhjet klanore janë forcuar në mënyrë të ndjeshme. Në procesin e përplasjes midis palëve të parisë, një sherr i menaxhuar me shumë kujdes, paria nuk shkon asnjëherë deri në fund. Burimi i fuqisë së saj politike është formula politike që e lë fatin e shtetit në duart e një sistemi zgjedhor të kontrolluar nga makina oligarkike e saj. Dhe për të ruajtur sundimin mbi popullin ata kanë kultivuar një sistem kontrolli mbi aparatit shtetëror, si dhe mjete propagande mediatike që e mbajnë shoqërinë peng. Po ashtu, paria kultivon sisteme të vlerave e të identitetit që e mbajnë popullin peng të një mendësia katundare. Kështu paria e ka futur shtetin në një hulli të pashpresë. Megjithatë, kjo është zgjidhja që asaj ia garanton pushtetin.

Në rastin tonë si kuptimi i drejtë i gjendjes, ashtu edhe zgjidhja e problemit vjen nga një interpretim i qartë ideologjik. Bashkë

me qartësimin e strukturës së pushtetit në një shoqëri, bëhet jashtëzakonisht i rëndësishëm edhe kuptimi i kontekstit shoqëror dhe i ideologjisë sunduese të kohës. Argumentet që individët e veçantë përdorin për të analizuar gjendjen e tyre, vlerat përcaktuese të kohës, sjellja e njerëzve në atë kontekst shoqëror, përparësitë që ata vendosin për veten e tyre, marrëdhëniet që ata ndërtojnë me njëri-tjetrin, janë të gjitha të përcaktuara nga mendësia sunduese e kohës. Pra, kush përfiton çka, kur e përfiton e si e përfiton është e përcaktuar dhe e legjitimuar, më së pari, në nivel të mendësisë së shoqërisë, të asaj se çka është e drejtë, e pranueshme, normale, dhe legjitime në bazë të parametrave të ideologjisë sunduese. Forca, që në përkufizimin leninist të marrëdhënieve klasore, “*kto kogo?*,” del si thelbësore, në fakt, në çdo marrëdhënie, si të katundarit me parinë, ashtu edhe në atë të skllavopronarit me skllavin e vet, është e mbuluar me këtë zhguall ideologjik, një element që, në dukje, e lidh ngushtë e pazgjidhshmërisht parinë sunduese me masën e të sunduarve. Shpesh, struktura e ideologjisë sunduese as nuk mund të shihet, e të kuptohet si duhet, pa një qartësim të proceseve se si këto vlera sunduese janë bërë sunduese deri në atë pikë sa përkufizojnë realitetin edhe për të sunduarit e të shfrytëzuarit. Realiteti shqiptar duhet që të analizohet me kujdes e vëmendje sepse pa kuptimin e këtyre aspekteve të organizimit shoqëror specifik shqiptar, nuk mund të kuptohet as tranzicioni shqiptar as krizat që kemi kaluar, as krizat me të cilat do të përballemi së shpejti si komb e si shtet shqiptar.

Dy fjalë mbi influencat teorike

Edhe pse në shkrimet që vijojnë, lexuesi mund të ndeshë gjurmat që të çojnë tek një teori apo tek një tjetër, synimi im ka qënë që t’iu rri sa më larg debateve teorike lidhur me vlerën e argumenteve të ndryshme në nivel teorik. Mua më intereson problemi shqiptar, teoritë më ndihmojnë që ta kuptoj atë problem, dhe këtu nuk kam ndërmend që ta përdor rastin shqiptar si ilustrim për teori të caktuara. Teoritë, në një farë mënyre, janë si

çelësi që të lejon që të hapësh një derë. Në analizën e problemit politik, e rëndësishme është të hapet dera, e jo se duhet të ketë një çelës që i hapë të gjitha dyert, d.m.th., një teori që i shpjegon të gjitha, e që unë mund ta verifikoj apo ta falsifikoj duke e përdorur për të analizuar rastin shqiptar.

Ndër autorët që e kanë influencuar mendimin tim për parinë dhe rolin qendror të tyre në sistemin politik do të përmendja, në veçanti, Machiavelli dhe Hobbes si dhe argumentet që kanë të bëjnë me paritë dhe që janë zhvilluar tek autorë të shumtë. Platoni, Xunzi, Ibn Khaldun, Machiavelli, Saint-Simon, Mosca, Pareto, Michels, Gramshi, Schmitt, Mannheim, Riker, Bueno de Mesquita, Lassëell, Burnham dhe disa të tjerë. Argumentet e Mosca për klasën politike, të Ibn Khaldun e të Pareto për qarkullimin e parisë, të Michels për paevitueshmërinë e oligarkisë, e kanë informuar shumë mendimin tim për proceset e tranzicionit dhe shkaqet e dështimit të tij.

Nga ana tjetër, argumentet e Gramshit për “princin modern,” d.m.th., për partinë politike, si dhe për intelektualët janë pjesë e rëndësishme e diskutimit të këtyre dy aspekteve në këtë përmbledhje. Ndikim të veçantë në gjykimin tim ka pasur edhe analiza e Mills dhe Dye e parisë sunduese në sistemin demokratik në SHBA. Po ashtu, studimet e Robert Putnam në lidhje me analizimin e strukturës së parive, të Higley në lidhje me kotshmërinë e demokracisë apo me rolin e parive në sistemin demokratik kanë ndikuar në mënyrën se si unë iu jam qasur problemeve. Një mësim i madh ka qënë argumenti i Schmitt lidhur me rolin qendror të shtetit në ndërtimin e një shoqërie moderne. Në masa të ndryshme, studimet e këtyre autorëve kanë qënë shumë të vyeshme për të kuptuar si duhet realitetin shqiptar të tranzicionit.

MBI DËSHTIMIN E TRANZICIONIT DHE PËRGJEGJËSINË HISTORIKE TË PARISË: NJË VËSHTRIM I SHPEJTË

Në fund të vitit 1990-të, shteti shqiptar hyri në procesin e një metamorfoze të gjithanshme. Shembja e sistemit socialist në BRSS dhe në Evropën Qendrore e Lindore e bëri të pamundur edhe vazhdimin e sistemit enverist në shtetin shqiptar. Ndryshimi i sistemit enverist dukej se ishte i pashmangshëm edhe sepse presioni i jashtëm për të ndryshuar sistemin politik e ekonomik ishte tejet i fortë e i papërballueshëm. Nga një anë, kriza e thellë kishte krijuar pakënaqësi të madhe, jo vetëm tek shtresat e përndjekura në dy-tre breza, por edhe në masën e madhe të shtresave qytetase, tashmë thellësisht të proletarizuara në nivelin e gjendjes ekonomike, por edhe në nivelin e vlerave morale.

Nga ana tjetër, sistemi i sundimit të parisë sunduese ishte shumë efektiv dhe mbështetja e legjitimiteti që sistemi i partisë-shtet gëzonte në masa të gjera të popullit, veçanërisht në fshatra e në zonat malore, kryesisht në Jug, ishin ende tepër të fuqishme. Shkalla e indoktrinimit ideologjik ishte në një nivel të jashtëzakonshëm, deri në atë pikë sa qytetarët duhej të besonin se jetonin në vendin më të lumtur në botë dhe kishte shumë syresh që e besonin këtë dogmë. Më e rëndësishmja është se qytetarët e thjeshtë nuk ia kishin fare idenë se si mund të funksiononin sistemet e tjera shoqërore dhe se si do të gjallonin ata vetë në ato sisteme. Shumë individë kishin arsye që të druheshin se ndrrimi i sistemeve nuk do të ishte në të mirën e tyre. Po ashtu, strukturat e shtetit, që nga Sigurimi i Shtetit, ushtria, policia, partia, burokracia shtetërore e deri tek organizatat e masave, ishin plotësisht funksionale dhe efektive.

Megjithatë, në fillimet e tranzicionit kishte shumë shpresë që ndryshimi i sistemeve do të përmirësonte edhe gjendjen e atyre shtresave që ishin të lidhura ngushtë me sistemin e që ishin burimi formal i legjitimitetit të tij, si dhe i fuqisë së tij reale. Në veçanti, në atë kapërcyell kthese historike, shtresa e inteligjencies kryeqytetase, por edhe ajo e disa qyteteve të tjera të mëdha, si Korça, Shkodra, Vlora, Durrësi dhe Elbasani ishin një grupim shoqëror me influencë të gjerë. Ky grupim gëzonte besim, si në popull, ashtu edhe tek paria sunduese. Duke qenë se populli nuk kishte fare dijeni se ku po shkohej me ndrrimin e sistemit, e duke qenë se paria sunduese kishte interesa të veta të ngushta, që do t'i mbronte me çdo kusht e me çdo mjet edhe përkundër interesit kombëtar, inteligjencia ishte shtresa shoqërore, e cila do të mbante barrën e ndryshimit si shtresë udhëheqëse dhe që, natyrshëm, do të merrte përgjegjësitë historike për rrugën që do të ndiqej më pas.

Paria sunduese, me qendër në Blllokun e Tiranës ishte e ndërtuar si një sistem klanesh, që vareshin nga figurat me peshë në atë sistem. Ky grup i ngushtë vendim-marrës nuk hoqi dorë deri në çastet e fundit nga besnikëria e pamëdyshur e sistemit enverist dhe bindja e mbajtjes së pushtetit me forcë apo me hile e dredhi. Kështu u përjashtua mundësia e transformimit gradual. Mirëpo kishte edhe një shpresë të fundit. Duke qenë se në krye të të gjithë formacioneve politike edhe të atyre që u formuan mbas Dhjetorit 1990, dolën përfaqësues të spikatur të inteligjencias së kryeqytetit, d.m.th., "intelektualët e shquar, shpresa ishte se ndryshimi do të mund të shkonte në një kahje tjetër, që do të ishte më pozitive, se sa po të kishte përmbysje radikale të parisë.

Këta individë, "intelektualët tanë të shquar", siç filloi t'i quante edhe Ramiz Alia, ishin të lidhur me njëmijë fije e pazgjdhshëmrisht, me sistemin e atëhershëm e me parinë sunduese. Nga një anë, ata ishin të përdorur nga paria, por edhe të përndjekur, sepse sistemi i shihte gjithnjë me dyshim. Shumica ishin edhe me hije, sepse ishin të vetëdijshëm për përpjekjen e sistemit për t'i deformuar me metodën kineze, por edhe të frikësuar prej poshtërsive të panumërta që kishin kryer për të

arritur aty ku ishin e për të mbijetuar. Por, nga ana tjetër, ata ishin edhe më afër popullit; shumica jetonin si populli, kishin edhe mbështetjen e shumë teknokratëve, që iu ishin bashkëngjitur dhe gëzonin legjitimitet të mjaftueshëm për të marrë përsipër rolin udhëheqës. Kështu pra, kishte mjaft shpresë se alternativat që do të zgjidheshin nga “intelektualët e shquar” do të ishin në shërbim të një të ardhmeje, që do të ishte e menduar mirë, më e baraspeshuar dhe në të mirën e të gjithëve.

Edhe në periudhën kritike të përplasjeve e të paralizës institucionale, që zgjati deri në zgjedhjet e 22 Marsit 1992, ishte e mundur që të zgjidheshin alternativa mbarëshqiptare, që do të krijonin mundësitë për ndërtimin e një shoqërie bashkëkohore, në të mirë të të gjithë shqiptarëve. Mirëpo, nuk ndodhi kështu. Paria e deridjeshme ka përgjegjësitë e saj të padiskutueshme, por përgjegjësia kryesore i mbeti inteligjencies së kryeqytetit dhe prijatarëve të saj, “intelektualëve të shquar,” atyre që morën përsipër barrën e ndryshimit të sistemit.

Inteligjencia, si shtresë e dallueshme shoqërore në sistemin parti-shtet, nuk u paraqit në nivelin e duhur. Zgjidhjet e saj ishin thellësisht të gabuara. Inteligjencia e kryeqytetit, profesorati universitar, por edhe intelektualët si shtresë shoqërore, e tradhëtuan popullin me një shpirtngushtësi e mendjengushtësi të frikshme. Ata u sprovuan të ishin krejtësisht të paaftë të ngrihen në nivelin e duhur. Këta “intelektualë të shquar” e braktisën misionin e tyre historik të shpëtimit të kombit. Ata u turrën që të bëheshin si paria e deriatëhershme sunduese. Me kohë u pa se ata nuk synonin shpëtimin e popullit por synonin ta zëvendësonin parinë sunduese me klanet e tyre.

Pse e them këtë? Ka shumë argumente por më kryesorja, është zgjidhja e gabuar ideologjike. Zgjidhja që duhej të bëhej në atë pikë kthese historike, duhej të ishte, pikë së pari, ideologjike. Cila ideologji do të udhëhiqte rrugën e ndryshimit? Mbi çfarë baze ideologjike, do të bëhej ndryshim? Cilat do të ishin përparësitë? Si duhej të përdroreshin burimet njerëzore dhe materiale? Si duhej të ndërtoheshin strukturat që duhej të mbronin interesat e shqiptarëve. Paria dhe intelektualët zgjidhën vendosjen e një

sistemi ekonomik që do të ishte jashtë kontrollit të shtetit. Pika e fillimit do të ishte nga zero, d.m.th. do të hidhej mënjanë gjithçka që ekzistonte. Parulla e ditës ishte se Gramoz Pashko kishte marrë çekun e bardhë. Teoria më e përhapur ishte *shock therapy*.

Mirëpo, zgjidhja që bëri paraia dhe inteligjencia ishte e qëllimshme, e vetëdijshme, dhe në të njëjtën kohë, shumë e gabuar. Zgjidhja u bë duke e konsideruar gjendjen, si dhe rrugë-zgjidhjen, nga këndvështrimi i interesit të saj të ngushtë. Ajo nuk u bë duke u nisur nga interesi kombëtar.

Më së pari duhen konsideruar alternativat ideologjike që kishim. Alternativa dhe rruga në të cilën duhej që të ecte shoqëria shqiptare do të ishte e përcaktuar, detyrimisht e kushtimisht, nga njëra prej tri ideologjive sunduese të kohës sonë, d.m.th., nga marksizmi, liberalizmi dhe nacionalizmi. Për shkak të përvojës me sistemin totalitar parti-shtet e thellësisht despotik enverist, prej edhe nga vinim, marksizmi, në çdo variant, edhe në atë variantin e zbutur social-demokratik europiano-perëndimor, dukej se, në atë pikë kthese historike, ishte i papranueshëm për shumicën e shqiptarëve. Për shkak të përbërjes komplekse shoqërore e të vlerave sunduese, si dhe të mangësisë së rrënjëve të qëndrueshme të çdo sistemi fetar ndër shqiptarët, çdo ideologji e mbështetur në qytetërimet e veçanta ishte, po ashtu, e papranueshme dhe, në fakt, shumë e rrezikshme.

Pika e vetme ku mund të fillohej ishte se shqiptarët mbahen bashkë me vetëdijen se janë një grup etnik. Shqiptarët janë i vetmi komb në Ballkan që mbahet me vetëdijen e lidhjes së gjakut e të gjuhës e jo të fesë e të elementëve të tjera të identitetit. Vetëdija e lidhjes së gjakut i zbut të gjitha pasojat e dasive të tjera. Vetëm ajo vetëdije i shmang përplasjet e grupimeve që mbështeten në ideologjitë fetare e përkatësitë në qytetërimet e ndryshme.

Në realitet, ndërtimi i së ardhmes duhej që të mbështetej e të formulohej në bazë të njëres nga dy ideologjitë e tjera, dm.th., çdo projekt transformativ duhej ndërtuar, duke u mbështetur ose në nacionalizmin, ose në liberalizmin. Gjithsesi, sistemi shoqëror që do të ndërtohej, duhej të ishte i mbështetur parimisht në shtetin demokratik kombëtar e në tregun e lirë. Por, me një

identitet të fortë shoqëror, teprimet e pritshme dhe dhimbja e padiskutueshme shoqërore që do të shkaktonte ndërrimi i sistemeve, do të balancoheshin e do të korrigjoheshin brenda një kohe të arsyeshme. Ecuria e mëpastajme e tranzicionit do të përcaktohej nga balancimi i vazhdueshëm midis këtyre dy strukturave jo harmonike ndërmjet tyre të organizimit shoqëror – tregut dhe demokracisë – pikërisht sepse bashkësia ligjore-politike, shtrati ku do të vendoseshin këto struktura modernizuese e transformuese, do të ishte relativisht më e fortë, dhe në gjendje me përballue krizat e mundshme e të pritshme që do të vinin nga zigzaget e ekonomisë. Identiteti kombëtar do të ndihmonte shumë në ruajtjen e fabrikës shoqërore e në shmangjen e efekteve tejet negative të këtyre krizave. Duke qenë një shoqëri e orientuar nga një identitet i qartë kombëtar, ekstremet, që janë kaq të pranishme në shoqëritë me zhvillim të njëanshëm, ose të përkushtëzuara nga besnikëria e ngurtë ndaj një ideologjie politike, do të shmangeshin. Me shmangjen pragmatike e metodike të ekstremeve ideologjike, shoqëria e re do të mbrrinte, vazhdimisht e periodikisht, në një ekuilibër të ri të qëndrueshëm, që do të ishte në shërbim të qytetarëve e të shoqërisë shqiptare në përgjithësi. Për fat të mirë, në një numër regjistrimesh, është ruajtur kjo pikëpamje e imja, qysh atëherë shumë koherente, në lidhje me rrugën që duhej të ndiqej në atë pikë.

Mirëpo, përgjegjësia ishte e dikujt tjetër. Zgjidhja e vërtetë kërkonte shumë përgatitje, largpamësi, vëmendje profesionale, vetëdije ideologjike e përkushtim qytetar. Mbi të gjitha, kjo kërkonte marrjen e përgjegjësive historike nga ana e parisë dhe e inteligjencias së kryeqytetit. Në veçanti, brenda kësaj shtrese, kjo kërkonte marrjen e përgjegjësive prej grupit të dallueshëm të “intelektualëve të shquar,” të profesoriatit universitar, e të profesionistëve teknokratë. Këta grupime kishin mbështetjen e jashtëzakonshme të masave të gjëra popullore dhe gëzonin respekt të madh.

Këtu më duhet që ta sqaroj pak më shumë nevojën e vendosjes së balancës midis parimeve bazë të ndërtimit të shoqërisë e të zgjidhjeve afatshkurtra e pragmatike që duhej të bëheshin, që nga

ajo pikë e në vazhdimësi, në të ardhmen. Nga një anë, për të qënë i suksesshëm, sistemi që do të vendosej duhej të ishte i ndërtuar mbi një ideologji të qartë kombëtare. Kësisoj, duhej që strukturat ekonomike e politike që do të ngriheshin të ishin konsistente në lidhje me parimet ideologjike në bazë të të cilave do të ndërtohej shoqëria e së ardhmes. Nga ana tjetër, me që shoqëria s'mund të ishte thjeshtë e njëanshme, sistemi që do të ndërtohej duhej që të përmbushte shumë kritere të tjera, të lidhura me organizimin kompleks të shoqërisë e me vlerat e saj të veçanta. Prandaj, në atë pikë historike, përtej domosdoshmërisë së ndjenjës kombëtare e të shërbimit publik, nga ana e parisë dhe e intelektualëve tanë, duhej edhe një dozë e madhe pragmatizmi e idiosinkracie politike. Përvoja ka treguar se çdo sistem që ndërtohet vetëm e vetëm në bazë të një parimi, dhe që e vë të gjithë shoqërinë në shërbim të strukturës së ndërtuar mbi atë parim, sidomos kur parimi është i ndjekur e i zbatuar në mënyrë ekstreme e dogmatike, është i destinuar të dështojë, qoftë ky nacionalizmi ekstremist i Koresë së Veriut, oligarkia e një familjeje si në Arabinë Saudite, teokracia në Iran e kështu me rradhë.

E keqja është se, si mbas vitit 1944, ashtu edhe mbas vitit 1990, paria sunduese e Tiranës zgjodhi rrugën më të lehtë për atë vetë; atë të ruajtjes së sundimit të saj e jo rrugën e shërbimit të interesit kombëtar. Rruga e ruajtjes së pushtetit përcaktohej përmes vendosjes së një sistemi të ngrirë, eksperimental dhe ekstremist ideologjik të njëanshëm, të zbatuar në mënyrë dogmatike. Ky sistem, një model ekonomik i ndërtuar mbi parimin *laissez faire, laissez passer*, ishte plotësisht i përshtatshëm për parinë. Ajo kishte dijet, profesionalizmin, lidhjet e aftësitë për t'u pasuruar shpejt e në mënyrë marramendëse. Por, ky model ishte qartësisht në kundërshtim me interesat e të gjithë shqiptarëve, si individë e si komb, edhe pse njerëzit e thjeshtë nuk e kuptonin gjendjen kështu. Përfundimi që i trishtë: në shtetin shqiptar u ndërtua "kapitalizmi" me karakteristika tipike katundare, një rast i veçantë në historinë bashkëkohore të ndërrimeve të sistemeve shoqërore.

Nga ana e vet, paria kishte ndërmend të ndërtonte një sistem tjetër, jo sistemin e kapitalizmit katundar. Duhet të kujtojmë se në

vitin 1944, u kopjuan një herë jugosllavët e, më pas, sovjetikët. Në vitin 1991 e mbas, paria sunduese nuk e modeloi sistemin politik-ekonomik sipas përvojave të njohura evropiano-perëndimore. Paria sunduese, që doli në krye të shtetit, tashmë ishte një përzierje e rrezikshme e profesoratit, teknokratëve dhe elementëve të parisë sunduese. “Intelektualët e shquar” dhe paria sunduese ishin ata që i dhanë drejtimin ndryshimit, duke zgjedhur rrugën më të keqe të mundshme për shqiptarët.

Paria përqafoi variantin ekstremist të ndërtimit të një kapitalizmi kleptokratik, sundimin prej hajnave që vjedhin shtetin që, deri atëherë, praktikisht, ishte pronari i vetëm, e kështu ata bëhen borgjezia e re. Ky ishte një model që ata e kishin njohur vetëm nëpër librat që kishin lexuar në shkolla e që ata e kishin parë vetëm në sipërfaqe, përmes lenteve ideologjike enveriste e, disa prej tyre, përmes eksperiencave që kishin pasur në vizitat e tyre në Perëndim.

Në formën e tij ideale, mbas shkatërrimit të shtetit, kapitalizmi që do të ndërtohej në shtetin shqiptar, simbas konceptimit të parisë, kushtimisht duhej që të ishte një kapitalizëm ekstremist, që “do të ndante shapin nga sheqeri” e do të ndërtonte një shoqëri klasore. Ideja e kapitalizmit shqiptar duhej të ishte e modeluar simbas modeleve të analizave të kapitalizmit të shekullit të 19-të, të interpretimeve të propagandës enveriste, të interesave vetjake të parisë, të sugjerimeve eksperimentale të këshilltarëve gjysmakë dhe të mendësisë katundare të shumicës dërmuese të popullsisë. Dikush do të bëhej borgjezia e dikush do të bëhej proletariati. Fajin do ta mbante logjika e sistemit të ri që do të vendosej, jo vetë paria, që kështu i lante duart me popullin. Simbas logjikës së parisë, në se dikush nuk arrin që të bëhet borgjezia, atëherë faji është i tiji dhe jo i sistemit. Sistemi, sipas parisë, po i krijonte mundësinë e pasurimit gjithkujt. Por, shtresa që i kishte të gjithë avantazhet ishte vetë paria.

Mirëpo, ky variant i kapitalizmit ekstrem, që do të ndërtohej në shtetin shqiptar, do të ishte një xhungël shoqërore dhe jodemokratike. Marrëdhëniet shoqërore do të ishin të bazuara në paranë, në interesin material, në përfitimin e paskrupullt, si dhe

në kundërvlera e në sjelljen morale. Si një masë njerëzish që nuk ndajnë asgjë të përbashkët ndërmjet tyre, përveç interesit vetjak material, kjo nuk mund të quhet shoqëri. Nuk ka shoqëri njerëzore të bazuar vetëm në interesa. Individët ndjekin objektivat e tyre në mënyrë racionale por shoqëritë nuk mund të ekzistojnë nëse nuk ka një sistem vlerash që qëndron jashtë kontrollit të një individi dhe që buron nga një identitet i përbashkët. Shoqëritë janë të bazuara, para së gjithash e pa mëdyshe, në vlera morale, në besim të ndërsjelltë e në identitet të fortë. Prandaj edhe përkufizohen si shoqëri. Kjo strukturë e re shoqërore që do të ndërtohej, nuk mund të ishte një shoqëri normale tregu të institucionalizuar, e bazuar në parësinë e marrëdhënieve ekonomike, por edhe e lidhur simbiotikisht me një shtet të konsoliduar, efektiv dhe me vlera të spikatura shoqërore. Kjo nuk ishte e nuk është një shoqëri kombëtare që mbështetet në një kapital të jashtëzakonshëm shoqëror që e mban shoqërinë të lidhur bashkë edhe në periudha krize të gjithfarlojshme. Kjo nuk ishte e nuk është një shoqëri moderne demokratike, me vlera, me identitet e që synon përmbytjen e ruajtjen e dinjitetit njerëzor. Kjo do të ishte një xhungël kapitaliste.

Duhet theksuar se zgjidhja që duhej bërë, në fund të vitit 1990, por edhe mbas asaj pike kthese historike, nuk ishte e lehtë sepse kishte presione të fuqishme nga të gjitha anët. Por, gjithsesi, zgjidhja ishte në një masë të madhe, në duart e parisë sunduese e të inteligjencës. Zgjidhja ishte, posaçërisht në duart e “intelektualëve të shquar,” dhe e profesoratit universitar. Këtyre individëve, iu dha hapësirë në shtypin partiak, apo u konsideruan si lojtarë të mundshëm. Ndër ta ishin, bie fjala, Ismail Kadare, Sali Berisha, Fatos Nano, Ylli Popa, Gramoz Pashko, Skënder Gjinushi, Sabri Godo, Rexhep Mejdani, Kastriot Islami, Neritan Ceka, Genc Ruli, Lufter Xhuveli e mjaft të tjerë. Disa nga këta “intelektualë të shquar,” të promovuar edhe nga paria, dolën në krye të formacioneve politike që u formuan në atë kapërcyell historik.

Nga ana e vet, populli shqiptar ishte tejet i papërgatitur, intelektualisht, shpirtërisht, por edhe moralisht, për të bërë zgjidhjen e duhur. Deformimi mendor dhe shpirtëror i popullit shqiptar gjatë sistemit enverist kishte arritur nivele të frikshme. Në

atë pikë kritike, shumica e shoqërisë shihte ëndrra me sy hapur dhe besonte në mundësinë e ndërtimit të një shoqërie të sheqerosur, d.m.th., të një shoqërie që reflektonte limonatat që shihte përnatë në televizionin italian. Urrejtja për shtetin shtypës, urrejtja për çfarëdo projekti modernizues (në shumë sfera të jetës, sistemi enverist ishte një sistem teknokratik, modernizues e shkencor), si dhe idealizimi absurd i të shkuarës familjare e historike ishin sentimente të ndjeshme në masa të gjera të popullsisë.

Mbi të gjitha, duhet theksuar se niveli i varfërisë materiale e morale, ishin të skajshme e lehtësisht mund të thuhet, në nivele tronditëse. Pa frikë mund të thuhet edhe se masat e gjëra shoqërore, veçanërisht fshatarët që tashmë jetonin në ferma, katundarët, por edhe shtresat e proletarizuara qytetase, nuk ia kishin idenë, as shoqërisë së re që duhej të ndërtohej, as mënyrës se si do të funksionohej në atë shoqëri. Masat e gjëra të popullit nuk e dinin se si do të shkohej në atë rrugë. Pakkush nga këto shtresa dhe nga paria dytësore e asaj kohe, e dinte se çfarë e ardhmeje do t'i priste shqiptarët. Masat e njerëzve donin thjesht që të ndryshonin sistemin ekzistues me shpresë se e ardhmja do të ishte më e mirë. Por, edhe në rastin më të mirë, e ardhmja që imagjinonin shumica dukej si përshkrimet e jetës së idealizuar të stërgjyshërve të tyre.

Shpresa, apo më mirë bindja kolektive, ishte se, tashti që do të ndryshohej sistemi, bota e huaj do të bëhej njerka që do të kujdesej përjetë për shqiptarët, sepse këta "përmbysën" komunizmin. Këta njerëz, nga ana e tyre, dukej se nuk e mendonin asnjëherë se të nesërmen e përmbysjes së sistemit, ata duhej të shkonin në punë e se jeta e përditshme do të vazhdonte, pak a shumë, në hulli të njohura për ta. Karrocieri nuk mund të bëhej bankier brenda natës e kooperativisti nuk bëhej dot fermer.

Njëri nga mësimet që nxirret nga revolucionet e ndryshme është se ritmi i jetës njerëzore e struktura shoqërore nuk ndrron në sinkroni me ndrrimin e sistemit politik. Në fakt, revolucionet përfundojnë duke i ndërtuar strukturat shoqërore, për një kohë, në mbështetje të interesave të shtresave të gjëra që mbështesin parinë e re sunduese në projektin e saj. Ashtu si kishin ecur proceset në sistemin e përcudnuar të partisë-shtet, njerëzit, thjesht, nuk donin

të punonin as për shtetin e as për kënd tjetër. Mirëpo, realiteti ishte krejt ndryshe nga ëndrrat e tyre. Ishte detyra e parisë që punonte me të gjithë mjetet për t'ua bërë të qartë njerëzve këtë gjë.

Ashtu siç thotë Karl Polanyi në *Transformimin e Madh*, koha kishte ardhë që lavjerrësi të shkonte nga ana tjetër. Në rastet e tjera të tranzicionit, në Europën Qëndrore e Lindore, lavjerrësi po shkonte nga shteti tek tregu, por shteti po ruhej. Në shumë vende ish-socialiste, shtetet dhe strukturat qeverisëse ofronin parimin bazë të ndërtimit të shoqërisë që ishte, me pak variacione, nacionalizmi. Shoqëritë e vendeve evropiano-lindore e kishin ruajtur në formë rudimentale ose e zhvilluan shpejt mekanizmin mbrojtës ndaj tregut ekstrem. Paritë e tyre sunduese, në rastet e çekëve, sllovakëve, polakëve, hungarezëve e deri tek rumunët e bullgarët, e ruajtën dhe e kultivuan atë mekanizëm shoqëror, identitetin kombëtar, duke mos e lënë tregun që të formëonte shoqërinë e kombin e tyre. Në këtë mënyrë ata ruajtën, së pari, shtetin e tyre. Siç argumentonte edhe Polanyi, shteti është struktura që e bën të mundur kapitalizmin, tregun, por dhe vetë iluzionin e tregut të lirë. Në rastin shqiptar, lavjerrësi po shkonte nga një absurd ideologjik në një absurd tjetër ideologjik, nga enverizmi despotik tek kapitalizmi mançesterian i shekullit të 19-të. Në këtë rast, absurdi ideologjik do të ishte “ndërtimi i kapitalizmit”, por me karakteristika të theksuara katundare shqiptare.

Përfundimisht, zgjidhja iu la në duar parisë sunduese dhe shtresës së inteligjencies të maskuar nga “intelektualët e shquar”, të lidhur pazgjidhshmërisht me parinë e që ishte pjesë e saj. Pse ndodhi kështu? Në një farë mënyre, kjo ndodhi për shkak të padijes së gjerë popullore, të kontrollit të rreptë dhe efektiv mbi proceset nga paria e nga strukturat e saj, si dhe të nevojës imperative të ndërkombëtarëve për stabilitet rajonal. Arsyeja kryesore është e lidhur me aftësinë e eksponentëve të parisë, për të drejtuar kahun e diskursit politik dhe procesin e vendimmarrjes, ashtu siç donin ata vetë. Deri dje, ata kishin qenë të vetmit që kishin dije për botën e huaj. Kështu ata ishin bërë të domosdoshëm edhe për sistemin e ri. Pa pikë dyshimi, ata e shfrytëzuan këtë monopol që kishin deri në maksimumin e mundshëm. Jo vetëm që eksponentët e parisë

së deridjeshme ishin në politikë duke mbrojtur interesat e tyre; ata ishin edhe në kontroll të strukturave politike e të informimit. Mundësia e tyre për të ndikuar ishte, paradoksalisht, shumë më e ndjeshme se kishte qenë deri në atë pikë, kur ata, dhe sistemi që kishin kontrolluar deri atëherë, ishin tejet të diskredituar si shtresë. Tashmë, si individë, ata mundën të rikrijonin vetveten e reputacionin e tyre.

Edhe mbas zgjedhjeve të 22 Marsit 1992, u pa se njerëzit ishin të gatshëm që të ndiqnin në një strukturë binare, të dy palët, parinë sunduese dhe inteligjencian, që tashmë ishte duke u bërë pjesë integrale e saj, por që po shihte mundësinë e zëvendësimit të parisë sunduese. Me abdikimin e pushtetit nga ana e parisë sunduese, dhe me përqëndrimin e brezit të dytë të parisë në ekonomi, inteligjencia e deridjeshme e kryeqytetit, tashmë ishte në metamorfozë. Nga një shtresë e ndrojtur dhe e ndrydhur, ajo po bëhej pari e mirëfilltë politike duke spostuar pjesë të parisë së mëparshme. Ajo ishte e veshur me pushtet politik, kishte legjitimitet e mbështetje të gjerë, dhe gradualisht filloi të fitonte terren edhe në kontrollin e ekonomisë. Deri në atë pikë, inteligjencia kishte qenë në shërbim të pakushte të parisë së Tiranës.

Tashti, inteligjencia ishte kthyer e po luante si *sparring partner* serioz politik po i parisë sunduese që, nga ana e vet, mudohej ta mbante peng me një mijë fije të ndryshme. Por, duke e parë fuqinë e ndikimit që kishte e që mund ta shumëfishonte me një populizëm ordiner, profesorati universitar dhe inteligjencia e kryeqytetit, po fillonin, pak me ngathtësi, që t'i kundërviheshin parisë, së cilës i kishin shërbyer deri atëherë edhe me frikë, edhe me besnikëri. Tashmë, inteligjencia, që në një farë mënyre kishte qenë pjesë e parisë dytësore, politikisht e shtypur dhe e kontrolluar në mënyrë të shumëfishtë, e ndjente qartë fuqinë e ndikimit e saj në rritje dhe po aspironte që të bëhej pjesë integrale e parisë, në mos që ta zëvendësonte atë.

Mirëpo, edhe duke vepruar kështu, ajo po bënte lojën e vetë parisë sunduese e të gardës së saj pretoriane. Arsyerja është e thjeshtë. Duke i lënë mënjanë përplasjet e sipërfaqëshme, sherrin mediatik, burgosjet sa për sy e faqe e sharjet gazetareske, para

e deridjeshme, “intelektualët e shquar” dhe inteligjencia, në përgjithësi, pajtoheshin në pashmangshmërinë e vendosjes së një sistemi kapitalist ekstrem, me kushtin e vetëm që të ishte në shërbim të tyre.

Të gjithë palët pajtoheshin në vlerat ideologjike, në synimet e objektivat që i kishin vënë vetes, si dhe në metodat që do të ndiqnin për të arritur objektivin e transformimit të tyre nga pari sunduese enveriste, dhe nga inteligjencia enveriste, në pari dhe borgjezi e re sunduese në shtetin shqiptar. Mirëpo, në majë të piramidës nuk ka vend për shumë njerëz. Beteja e klaneve të parisë ishte se kush do të dilte më i fuqishëm brenda shtresës së parisë sunduese që po ristrukturohej e po riformësohej me shpejtësi. Ashtu si ndodhte në Anglinë e shekullit të 19-të, segmentet e parisë, të organizuar në partitë politike hidhnin baltën e pamasë mbi njëri-tjetrin. Megjithatë, të dyja palët kishin rënë dakord, ose haptazi, ose me mirëkuptim të heshtur, që, më së pari, të zhysnin në baltë popullin shqiptar.

Nga ana e vet, paria sunduese e shihte metamorfozën e përgjithshme që po ndodhte si një përmbysje të sistemit enverist dhe si një fitore të kundërshtarëve të deridjeshëm ideologjikë, të cilëve shpejtoi që t’iu bashkëngjitej me një arrvizëm shembullor. E ardhmja, në sytë e të gjithë pjestarëve më të rëndësishëm të saj, do të ishte ndërtimi i pashmangshëm i kapitalizmit. Meqë duhej ndërtuar kapitalizmi, atëherë, paria enveriste ia vuri vetes objektivin e luajtjes së rolit qëndror në këtë proces. Mirëpo, kapitalizmi që kishte ndërmend të ndërtonte paria nuk ishte një kapitalizëm i mbajtur nën fre nga strukturat shtetërore, nga strukturat shoqërore dhe nga një sistem i qëndrueshëm kulturor. Paria ndjehej shumë e shtypur nën sistemin enverist, pikërisht nga këto shtërngesa, që formalisht nuk e lejonin që të sillej ashtu si donte. Prandaj, ky sistem ekonomik që do të ndërtohej nuk duhej të ishte i rrethakuar nga vlera të qëndrueshme morale, fetare, tradicionale apo nga një identitet i fortë. Në shumë vende të tjera, kishin qënë pikërisht këto aspekte të shoqërisë që e kishin lejuar kapitalizmin të lulëzonte por, gjithnjë, duke qënë nën një kontroll të rreptë të strukturave të shtetit.

Kapitalizmi që ata kishin ndër mend të ndërtonin, siç edhe e përmenda më parë, ishte pak a shumë kapitalizmi ekstrem i përshkruar nga Engelsi në studimin *Gjendja e Klasës Punëtore në Angli*. Për të ndërtuar atë strukturë të përcudnuar ekonomike në shtetin shqiptar, paria e Tiranës e zgjidhi zinxhirin e kontrollimit të tregut nga sistemi mbikqyrës i shtetit e nga vlerat e vërteta shoqërore. Jo vetëm aq, ajo e çliroi vetveten, më mirë me thanë e zhveshi vetveten, nga mburoja e parzmores së vlerave shoqërore që e kishte mbajtur të lidhur e nën shtërngesë deri atëherë, anipse nën një sistem të përcudnuar, si sistemi enverist. Vlerat që paria dhe inteligjencia i kishin paraqitur publikisht deri atëherë, dhe që ishin një nga burimet kryesore të mirëbesimit të shoqërisë tek kjo shtresë, kishin maskuar shpirtrat e tyre të zhveshur nga çdo ndjenjë njerëzore, meskinë e të untuar deri në ekstrem. Ata që e kishin zhvilluar e përsosur çdo teknikë për minimin e efektivitetit të shtetit, u zbuluan jo si *skile*, një term makiavelian që përdorej shpesh në rrethet burokratike e partiake të asaj kohe, por si hiena.

Pengesa më e madhe në përmbushjen e planeve të tyre ishte shteti, d.m.th., shteti ligjor, i cili të imponon një sjellje të caktuar dhe funksionon në një mënyrë të tillë që e depersonalizon autoritetin. Njeriu më të cilin jep e merr në zyrë, nuk është më kushëriri që të kryen punë, por zyrtari, shërbëtori i shtetit që zbaton ligjin me drejtësi. Paria kërkonte jo që të manipulonte ligjin duke mbetur brenda ligjit, çka do t'i kualifikonte si *skile*, por që ta hiqte krejt qafe.

Arsyeja është se çdo lloj shtërngese e tillë, morale apo ligjore, nuk do ta lejonte parinë e vjetër e të re që të përmbushnin planet e tyre identike. Po për këtë arsye, paria e ka kundërshtuar sistematikisht, dhe vazhdon ta kundërshtojë edhe sot e kësaj dite ndërtimin e çdo strukture shtetërore autonome, që nuk i shërben ekskluzivisht asaj. Paria nuk pranon vendosjen e një shteti ligjor. Ajo e ka pranuar dhe nuk pranon ndërtimin e institucioneve që nuk janë të vëna pa kushte në shërbim të saj.

Kështu, përkundër deklarimeve të tyre për demokraci, për mbrojtjen e të drejtave të njeriut e të slliganeve të tjera, që

përdoren pa kursim në propagandën e saj, paria, dhe inteligjencia e vënë në shërbim të programit të parisë, me vetëdije të plotë, u turrën për të ndërtuar sistemin që iu shërbente atyre. Vetëm e vetëm pse idetë e tjera nuk iu shkonin sipas interesave, ata i konsideruan të gjithë këto sisteme shoqërore, politike, morale e kulturore, e që ishin faktikisht jetike për shqiptarët, si dytësore e të parëndësishme. Mbasi ua shitën shqiptarëve *shock therapy* si çlirim ekonomik dhe konceptin e lirisë, si shkatërrim të shtetit, ata u turrën për “të ndërtuar kapitalizmin”. Natyrisht, qëllimi i tyre ishte që vetë të bëheshin borgjezia e shtresa sunduese në këtë sistem të ri. Fundi i procesit kalimtar të metamorfozës së tranzicionit do të ishte ndërtimi i një sistemi kapitalist në të cilin paria do të kontrollonte gjithçka dhe në të cilin të gjithë shqiptarët do të shisnin krahun e punës dhe do të shndroheshin në proletariatin modern. Paria e Tiranës, tashmë e transformuar dhe e zgjeruar, do t’i bashkohej borgjezisë. Ky do të ishte fundi i të gjitha proceseve modernizuese si dhe fundi i historisë ndër shqiptarët. Sipas propagandës së parisë, fundi i modernizimit dhe i historisë ishte se shqiptarët, “populli më i vjetër i Evropës,” po ktheheshin në gjirin e qytetërimit mëmë. Ky ishte një argument që theksonte vlera dhe identitetet. Në të njëjtën kohë, për parinë enveriste, fundi i rrugëtimit të saj do të integrimi i saj në borgjezinë ndërkombëtare, mundësisht në borgjezinë e lartë.

Duhet theksuar se paria, dhe në veçanti, eksponentët kryesorë të saj, e kishin një ide shumë të qartë se cilat ishin rrugët që duheshin ndjekur. Ata kishin qenë në Perëndim, e kishin parë botën e huaj, kishin jetuar me vite atje, kishin studiuar edhe modelet perëndimore, e kishin kritikuar apo analizuar si kapitalizmin ashtu edhe liberalizmin dhe ia njihnin shumë mirë të gjitha anët e sistemit që do të ndërtohej në shtetin shqiptar. Aq më tepër, që shumë nga ekspertët e sistemit të mëparshëm, kishin bërë studime, disa edhe shumë të detajuara, lidhur me shoqëritë e tjera në tranzicion. Prandaj, përpjekjet e tyre të mëvonshme e sistematike, për t’i paraqitur zgjidhjet e bëra si të kushtëzuara nga të huajt, nga gjendja e vendit, nga padija e popullit e të tjera argumente të tilla, janë thjesht justifikime të papranueshme propagandistike.

Zgjidhja që ata bënë, e për të cilën do të mbajnë përgjegjësi historike, ishte ndërtimi i kapitalizmit katundar shqiptar ku parimi i vetëm i aplikueshëm do të ishte “o Mete, për vete.” Një shoqëri që ndërtohet në bazë të një parimi të tillë, është e destinuar që të dështojë, pa arritur që të bëhet funksionale, sepse nuk mund të bëhet asnjëherë funksionale. Një mendësi e tillë nuk do të lejonte ndërtimin e një shoqërie të shëndoshë, të një shteti funksional, të një kulture politike e të një sistemi të konsoliduar vlerash, të gjitha këto elemente që mbajnë bashkë shoqëritë e tjera. Mirëpo, një “shoqëri” materialiste dhe e zhveshur nga këto vlera jetike, i shërbente për bukuri arritjes së objektivave të tyre.

Shkurt, vendosja e një sistemi materialist që funksionon simbas parimit *homo hominis lupus est*, d.m.th., një sistem ku “njeriu për njeriun është ujë”, në të cilin do të merrej e jepej në bazë të interesave e të fuqisë, ishte një zgjidhje e qëllim të ana e parisë së Tiranës. Kjo ishte një zgjidhje në shërbim të interesave të saj të ngushta. Kjo zgjidhje nuk ishte në shërbim të interesave të të gjithë shqiptarëve, të cilëve, edhe pse nuk e dinin se sa jetike ishin për ta, i duheshin të gjithë ato struktura e vlera që përmenda më lart. Duke vepruar ashtu, paria dhe inteligjencia shkaktuan një dëm të jashtëzakonshëm por, njëkohësisht, ata edhe morën mbi vete një përgjegjësi historike të pajustificueshme.

Ndërtimi i sistemit kapitalist, simbas modelit të imagjinuar marksist, u bë objektivi i gjithanshëm i tranzicionit në shtetin shqiptar. Çdo reformë ishte e lidhur apo në funksion të arritjes së këtij objektivi. Një pjestar i rrethit më të ngushtë të parisë, dhe “intelektual i shquar,” Gramoz Pashko, nxori teorinë e “çekut të bardhë”, që do vinte nga Amerika. Të tjerë, si Ylli Bufi, i nxorën njerëzit në rrugë me thirrjet se kemi bukë edhe për tre javë. Të tjerë, si Azem Hajdari dhe Sali Berisha iu premtuan minatorëve nga dy-tre makina dhe minatorët i besuan. Paketa e premtimeve të parealizueshme dhe përpjekjet e stërholluara për të terrorizuar mendjen e njerëzve krijuan një gjendje anormale, të papërsëritur kund tjetër në Evropën Lindore e Qendrore. Fabrikat dhe uzinat u mbyllën. Tokat nuk u punuan më. Pemët u prenë në rrënjë. Makineritë e shtrenjta u shitën për skrap. Minierat u mbyllën.

Objektet e pafund, e gjithë pasuria kombëtare, u nxorën në ankand për një copë bukë, apo u shpërndanë me letra me vlerë. Ato objekte e industri që mbetën funksionale iu dhanë koncesion të huajve, si dhe mbështetësve e militantëve respektivë. Ky ishte edhe niveli “zero.”

Pa bazën e duhur industriale dhe ekonominë bujqësore, shoqëria që do të ndërtohej në shtetin shqiptar do të ishte shoqëria e rrugës, e ndërtuar mbi parimet e materializmit ekstrem, d.m.th., ‘shoqëria’ e hajnave, banditëve, matrapazëve, drogaxhinjve dhe trafikantëve. Kjo do të ishte një shoqëri ku njeriu për njeriun do të ishte ujk, ku nuk do të kishte nder, identitet, vlera e dinjitet, përveç parave e vendit që paraja të jep në një shoqëri të tillë. Eksperimente të gjithfarlojshme në të gjitha fushat, disa të mbështetura në agjendën e në vlerat ideologjike të të huajve, që s’dihej prej nga vinin e ku shkonin, u vunë në jetë me rezultate shkatërrimtare. Projektet politike dhe reformat, disa të ushqyera nga interesat e ngushta të eksponentëve të spikatur të parisë sunduese e të “intelektualëve të shquar”, si Nexhmije Hoxha, Ramiz Alia, Sofokli Lazri, Sali Berisha, Fatos Nano, Xhelil Gjoni, Gramoz Pashko, Skënder Gjinushi, Sabri Godo, Aleksandër Meksi, Neritan Ceka, Gramoz Ruçi, Anastas Angjeli, Servet Pëllumbi e me radhë, çuan në deformime të jashtëzakonshme e me shumë pasoja për shoqërinë shqiptare edhe në të ardhmen.

Përpyekjen e tyre për të ndërtuar kapitalizmin mançesterian, që përfundoi si kapitalizëm katundar, paria e Tiranës e përcaktoi si “tranzicion”. Si çdo proces kalimtar edhe ky duhej ta kishte një fund. Duke qenë se shumë prej objektivave të tyre ekonomikë e politikë janë arritur, duke qenë se strukturat ekonomike duket se po funksionojnë, duke qenë se superstruktura është relativisht e legjitimuar, si dhe, mbi të gjitha, duke qenë se shoqëria është e lidhur me një mijë fije interesash, kredish, detyrimesh, edhe individuale, bindja e parisë është se tranzicioni ka përfunduar. Tashmë, nuk është për t’u habitur që pjestarët e parisë këmbëngulin se tranzicioni është mbyllur përfundimisht.

Ky sistem ka dështuar por askush nuk po e merr përgjegjësinë për ndërtimin e këtij sistemi që thuhet se është i konsoliduar, edhe

pse çmimi që është paguar e që po paguhet nga shqiptarët është i paimagjinueshëm. Është e vërtetë se sistemi që duhej të ndërtohej simbas mendësisë e aspiratave të parisë është ndërtuar si ngrehinë. Nuk ka dyshim se ky sistem është i përbindshëm dhe se, në planin afatgjatë, nuk iu shërben fare interesave të shqiptarëve. Ky është një sistem katundaresk, i bazuar në mashtrimin e paskrupullt, fragmentarizimin, fanatizmin, injorancën, shkatërrimin e familjes, zvetënimin, kriminalitetin, degjenerimin, zhveshjen nga vlerat morale e njerëzore, legjitimitimin e hajnisë, korrupsionit të pashembullt dhe shpërdorimit të besimit të qytetarëve. Si çdo shoqëri e ndërtuar mbi parime ekstremiste, edhe kjo është e dënuar të shembet nën peshën e zullumeve e teprimeve të veta.

Koha ka ardhur që lavjerrësi të kthehet në kahjen e normalitetit e të njerëzisë edhe për shqiptarët. Ndoshta para ligjit nuk ka fajtorë, *damnum absque injuria*, por përpara ndërgjegjes kombëtare e historisë së një populli, nuk mund të kalohen gjërat kaq lehtë. Dënimi të paktën duhet të jetë dënim moral.

Nga ana e saj, paria e Tiranës ia ka arritur që të ndërtojë sistemin ekonomik oligarkik e monopolist, që ajo ka ëndërruar e që e ka dëshëruar. Mirëpo, siç shihet, nga evidenca e përditshme, ky sistem është një përçudnim i çdo shoqërie normale njerëzore. E prandaj, pavarësisht se sa pasuri kanë vënë eksponentët e parisë së transformuar, shembja e këtij sistemi është vetëm çështje kohe. Herët, ose pak më vonë, shoqëria do të kërkojë mekanizmat për t'iu kundërvënë zbrastësisë morale, zvetënimin, varfërimin, dhe mungesës së vlerave. Ata që shkatërrojnë gjithçka për të fituar vetë e për të përvetësuar gjithçka për vete, nuk kanë e nuk do të kenë kurrë siguri për të ardhmen e tyre. Ata, dhe të gjithë shqiptarët, po shohin përditë se në shtetin shqiptar nuk ka as shoqëri me vlere, as demokraci të mirëfilltë, as shoqëri civile, as ekonomi tregu që zhvillon, as moral, as dinjitet, as stabilitet, e as siguri. Kjo gjendje nuk është normale apo e dëshërueshme për një popull.

Tranzicioni u sprovua të ishte një seri tragjedish njerëzore e mbarëshoqërore, të papërjetuara në ndonjë shoqëri tjetër, që ka sprovuar të kalojë një metamorfozë të ngjashme. Territ duhet me i thanë terr edhe pse dikujt nata i duket dita e vërtetë, sepse veç

atëherë nuk mundet me i fshehë pandershmëritë e veta. Çmimi që është paguar e që po paguhet nga të gjithë shqiptarët, pavarësisht se a janë ata të vetëdijshëm apo jo, nuk mund të matet në vlerë materiale. Sistemi që paria e inteligjencia, tashmë e lidhur në kërbthizë me të, luftuan që të ndërtonin është ndërtuar. Por, ky sistem ka qenë i destinuar që në lindje të jetë i dëshmtuar. Alternativa e parisë ka dështuar për t'i dhanë shqiptarëve jetën e të ardhmen që ata meritojnë. Në mënyrë sistematike, shoqëria shqiptare po rrëshqet në drejtimin e një shoqërie të kriminalizuar si Haiti. Kështu si janë ndërtuar strukturat politike, ekonomike e shoqërore, si dhe sistemet e vlerave e ato kulturore, ka shumë pak shpresë për të ardhmen.

Koha ka ardhur për një fillim të ri. Çdo ditë e më tepër kjo bëhet e qartë si drita e diellit. Nevoja për ndryshim është e pashmangshme. Ndryshimi duhet mbështetur në vlerat e vërteta të një populli si shqiptarët dhe në një projekt të ri modernizues, të balancuar dhe të mbështetur në themelet e forta të elementëve të mëposhtëm. Së pari, në identitetin e padiskutueshëm të shtetit-komb. Së dyti, në një sistem politik demokratik. Së treti, në një administratë shtetërore të pakorrruptueshme e të mbështetur në ligj. Së katërti, në një ekonomi tregu të institucionalizuar ku i jepet përparësi prodhimit kombëtar. Së pesti, në një politikë të jashtme të bazuar në interesin kombëtar. Së gjashti, në luftën e pakompromis kundër krimit e kundër të keqes, në çdo formë që të materializohet e keqja shoqërore. Së shtati, në krijimin e në kultivimin e vlerave të vërteta të një shoqërie që krijon mundësi për të gjithë. Së teti, në kultivimin e vlerave të një shoqërie civile efektive. Së nënti, në ndërtimin dhe konsolidimin e strukturave të shërbimeve shoqërore si edukimi, shëndetësia, e mbrojtja e fëmijëve dhe e pensionistëve. Më në fund, por jo më e fundit, ndërtimi i strukturave funksionale të një sistemi të partive politike i cili të avancojë e të mbrojë interesat e bashkësisë ligjore-politike me mjete legjitime demokratike.

Çdo përpjekje për ndryshim, qoftë në formën e një programi politik, qoftë në formën e një pakete ndryshimesh ligjore, që

nuk mban parasysh këto parime themelore, është e destinuar që të dështojë. Këto elemente janë pjesë e pandashme e çdo projekti për shërimin e përmirësimin e gjendjes. Por, ata që marrin përsipër këtë detyrë, duhet të jenë të përgatitur që të përplasen me një pari që do të përdorë çdo mjet në dispozicionin e saj, edhe në format ekstreme të dhunës e të terrorizmit shtetëror e mafioz, për të ruajtur pushtetin politik, dhe kontrollin mbi ekonominë e mendësinë e popullit që sot e sundon.

NJË PROCES QË NUK KA PËRFUNDUAR ENDE: SHPËRBËRJA E ISH-JUGOSLLAVISË SI PROBLEM QËNDROR I POLITIKËS SHQIPTARE

Problemi themelor politik, zgjidhja e të cilit do të përcaktojë fatin e Kosovës, por edhe atë të të gjithë shqiptarëve në të ardhmen, vazhdon të mbetet ecuria e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë. Pavarësisht mendimeve të kundërta, të cilat kërkojnë që ta paraqesin shpërbërjen e ish-Jugosllavisë si një proces politik tashmë të mbyllur, në fakt, ky proces nuk ka përfunduar dhe mendoj se është shumë larg përfundimit. Përkundër mendimeve të ndryshme lidhur me rrugën që duhet të ndiqet në të ardhmen, e ardhmja e shqiptarëve si komb është e lidhur pazgjidhshmërisht me drejtimin që do të marrë ky proces politik.

Procesi i shpërbërjes së ish-Jugosllavisë është shumë larg përfundimit. Në thelb, edhe përkundër luhatjeve të fuqishme, në një drejtim apo në një tjetër, zgjidhjet e mundshme të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë thuhet nuk kanë ndryshuar fare prej fillimit të krizës së shpërbërjes së saj në vitin 1990. Njëra zgjidhje është e mbështetur në parimin politik, sipas të cilit ish-republikat e krahinat autonome në nivel të federatës bëhen shtete të pavarura. Zgjidhja tjetër është e mbështetur në parimin etnik, d.m.th. që, kombet e ish-Jugosllavisë i krijojnë shtetet e tyre etnike duke i shpërbërë ish-republikat e ish-krahinat autonome. Kështu, zgjidhja etnike vjen duke i riorganizuar njësitë politike e duke i ndryshuar kufinj të ekzistues.

Zgjidhja që synonin të arrinin udhëheqësitë politike në ish-Jugosllavi ka qënë shpërbërja e Jugosllavisë në bazë të kombësisë e të riorganizimit të njërive politike në bazë të parimit etnik.

Forca e shtetit ishte mjete i tyre i preferuar për realizimin e këtyre objektivave politikë dhe angazhimi i tyre në mbrritjen e këtyre objektivave ka qënë e vazhdon që të jetë pa luhatje të ndjeshme. Të huajt synonin, e mbrritën që, përkohësisht, të impononin një zgjidhje politike. Kjo u arrit në Bosnjë, në Kosovë e në Maqedoni.

Zgjidhjet politike të imponuara nga të huajt janë të paqëndrueshme dhe pa mbështetjen e duhur në popujt e ndryshëm. Nacionalizmi intens i popujve të Ballkanit e ka minuar efektivitetin e kësaj përpjekjeje të të huajve për të zhvilluar shumëkulturalizmin e për të ruajtur njësitë shtetërore shumëkombëshe. Flaka e nacionalizmit në Ballkan është më e ndezur se kurrë. Mirëpo, nëse të huajt e strukturat e tyre nuk e shuajnë dot flakën e nacionalizmit në Ballkan, këto zgjidhje politike të imponuara nga jashtë janë, e do të jenë, vetëm aranzhime të përkohshme. Herët a vonë, nacionalizmi i parive politike ka me nxjerrë krye. Nacionalizmi ka me dalë si forca kryesore mobilizuese e grupeve të ndryshme të pakënaqura me gjendjen ku janë. Atëherë, kombësia do të afirmohet si parimi i ndërtimit të shteteve kombëtare që, mandej, do të duket se janë të paevitueshme.

Si ilustrim, mund të themi se çdo ditë që kalon, patosi nationalist vazhdon me kenë shumë i fuqishëm ndër paritë sunduese serbe, boshnjake, dhe maqedone. Në veçanti, serbët dhe malazezët, por edhe maqedonët, janë shumë të vetëdijshëm për lojën ndërkombëtare e për vendin që ata zënë në skemat e mëdha e në lojën e madhe politike. Ata e kanë kuptuar se mund të përfitojnë diçka duke u mbështetur tek rusët, kinezët, apo tek disa fuqi europiane për të gjetur avokatë për variantin e tyre respektiv të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë e për të rritur pazarin e kërkesave të tyre në lidhje me BE e me strukturat e tjera.

Nga ana tjetër, ata po vazhdojnë që të mobilizojnë grupin e tyre etnik për t'u paraqitur si mbrojtës të ideve e të kauzës nacionaliste të kombit të tyre, duke e mbajtur gjallë konfliktin etnik në hapësirën e ish-Jugosllavisë. Kjo është më e dukshme se gjithkund tjetër në hapësirat e kontestueshme edhe brenda Kosovës, por edhe në Maqedoni e në trojet e tjera ku jetojnë shqiptarët, si në Serbi e në Mal të Zi. Përpjekja e pandërprerë dhe e përqëndruar e parive

sunduese serbe, malazeze e maqedone, për të thyer, asimiluar apo dobësuar vetëdijen politike të shqiptarëve në shtetet respektive, ka pasur sukses. Në arritjen e këtij objekti, ata kanë përdorur me shumë efikasitet institucionet shtetërore, që janë vënë në shërbim të ideologjive nacionaliste.

Me fjalë të tjera, edhe pse në dukje e kontrollueshme nga jashtë, përplasia etnike në hapësirën e ish-Jugosllavisë vazhdon të jetë shumë e fuqishme, por vendosmërisht e përcaktuar prej intensitetit të nacionalizmit etnik në paritë sunduese. Paria e Tiranës dhe paritë shqiptare në shtetet ku jetojnë shqiptarët, janë të vetmet që nuk e shohin mbrojtjen e interesit të grupit të tyre kombëtar si parësor. Të gjitha paritë e shohin ruajtjen e interesit kombëtar si rrezikun kryesor.

Kjo shihet qartë në rastin e Kosovës dhe politikat që ndiqen, të cilat janë në kundërshtim me mendësinë e popullit. Duke qenë se shteti shqiptar dhe paria e Tiranës janë të instrumentalizuara deri në palcë, Kosova konsiderohet si vatra e vërtetë e nacionalizmit etnik shqiptar. Vetëdija kombëtare, që në Kosovë është shumë më e ndjeshme, si dhe gjendja e paqartë politike e shtetit, i shtyn shumicën dërmuese të shqiptarëve që jetojnë në Kosovë që të vazhdojnë të identifikohen me nacionalizmin etnik shqiptar. Po ashtu, kujtimet e sundimit serb janë ende shumë të freskëta dhe kundërshtia është e fortë.

Po për këtë arsye, përpjekjet e të gjitha palëve, si të vendorëve ashtu edhe të ndërkombëtarëve, për të zgjidhur problemin e çështjes kombëtare shqiptare, problemin kyç e të pazgjidhur të Ballkanit, janë të përqëndruara tek Kosova. Sot Kosova konsiderohet si Piemonti i mundshëm shqiptar dhe si qendra e ndërgjegjes së vërtetë kombëtare shqiptare. Asnjë nga kombet fqinje e nga shtetet ballkanike nuk e dëshiron krijimin e një shteti kombëtar shqiptar. Të gjitha shtetet e Ballkanit kanë arsye që t'i druhen formimit të një shteti të tillë. Me Tiranën e neutralizuar dhe të instrumentalizuar, Kosova pra, është në qendër të kësaj përplasjeje të definuar nga përkatësia etnike. Fati i saj si shtet, por edhe roli që Kosova do të luajë në të ardhmen si Piemonti shqiptar, do të përcaktohet po prej kësaj përplasjeje të

pashmangshme të mbështetur në interesat nacionaliste të parive të shteteve ballkanike.

Në këtë drejtim, si shoqëria shqiptare në Kosovë, ashtu edhe shoqëritë etjeras shqiptare në ish-Jugosllavi, në veçanti në Maqedoni, në Preshevë por edhe në Mal të Zi, po përballen e do të vazhdojnë që të përballen me trysni shumë të fuqishme. Këto trysni mund të çojnë edhe në rivlerësimin e gjendjes aktuale dhe përfaqimin e zgjidhjeve të tjera. Këto zgjidhje shkojnë nga njëri ekstrem i zgjidhjes politike (rikrijimi në një formë tjetër i Jugosllavisë, si një seri protektoratesh politike europianoperëndimore, të cilat janë të dallueshme edhe tash) tek një seri përplasjesh të ardhshme që, me etapa, do të çojnë në krijimin e shteteve kombëtare.

Për shkak se do të mungojë përputhshmëria e grupit etnik ose kombit me kufinj të shteteve, apo edhe një përpjekje për të arritur një objektiv të tillë, faktori shqiptar do të jetë më i dobët se kurrë. Edhe më keq, faktori shqiptar do të vijë duke u dobësuar progresivisht e më tepër. Shoqëritë shqiptare në përgjithësi, e në veçanti paria politike e Kosovës, janë të papërgatitura për me u përballë me problemet e shumta që do të lindin nga secila rrugë që mund të merret. Kjo do të ndodhë pavarësisht besimit tejet të përhapur, por krejtësisht të pabazuar, se pavarësimi i Kosovës ka qënë zgjidhja përfundimtare e të gjitha problemeve të shqiptarëve.

Në përfundim, duhet thënë se pavarësimi formal i Kosovës ka zgjidhur shumë probleme shumë të mprehta. Po ashtu, pavarësimi ka krijuar probleme të tjera të cilat nuk po zgjidhen si duhet, e që në fakt, nuk mund të zgjidhen në këtë rrugë. Mbi të gjitha, as paria politike e Kosovës, amatore në politikë dhe tejet e korruptuar, dhe as shoqëria shqiptare atje, që e ka humbur përqëndrimin në objektivat politike themelore e afatgjata, nuk duken të përgatitura për të rivlerësuar krizën afatgjatë të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë dhe shpërbërjen e saj në linja etnike, një hulli që pavarësimi i Kosovës as nuk e mbylli e as nuk mundet që ta shmangë. Pavarësimi formal dhe presionet në rritje nga serbët e kanë vënë Kosovën në qendër të përplasjes etnike në Ballkan. Tensionet me të cilat do të përballen, si shoqëria shqiptare atje, ashtu edhe paria shqiptare e

Prishtinës, do të jenë vetëm në rritje.

Paaftësia e parisë shqiptare të Kosovës për të vlerësuar si duhet gjendjen politike në të cilën gjinden shqiptarët, si dhe për të peshuar rrugëzgjdhjet e mundshme, duke përfshirë këtu edhe rikonsiderimin e një shteti etnik shqiptar, do të ketë pasoja për të gjithë. Në një kohë jo të largët, dështimet e pritshme e të njëpasnjëshme të strukturave të shtetit të Kosovës, do të çojnë edhe në një rivlerësim të vetë pavarësisë së Kosovës.

Kjo mund të vijë nga përplasjet etnike, që do ta bëjnë ekzistencën e shtetit të Kosovës të pamundur. Kjo mund të vijë edhe nga ana e popullit shqiptar, që do të lodhet nga dështimet e nga fjalët boshe e do të kërkojë zgjidhjen etnike. Gjithsesi, populli shqiptar i Kosovës mundet që të zgjedhë që të mos ndjekë rrugën e parisë së Kosovës, e cila e ka shkëmbyer objektivin real të ndërtimit të shtetit funksional me nevojën e ruajtjes së pushtetit për vete e për klanet e taborret e tyre personale. Atëherë, e vetëm atëherë, kur do të ndodhë përballja iminente me nevojën e zgjidhjes së problemit kompleks të çështjes kombëtare shqiptare, do të shihet qartë se cilat kanë qenë pasojat e zgjidhjeve politike të bëra nga paritë sunduese shqiptare në të gjitha trojet shqiptare.

MBI FUSHATËN PËR ZGJEDHJET KUVENDORE TË 28 QERSHORIT 2009

Sa më shumë që po afrohet data e zgjedhjeve kuvendore në shtetin shqiptar, aq më shumë po ndizet debati tradicional për listat, për deputetët, për personalitetet, për koalicionet, për firmat konsultuese, për analizat e elektoratit, për parullat e rradhës, si dhe për meritat dhe sukseset e të gjithë parisë politike dhe të segmenteve të saj të rreshtuara në partitë politike të prijatarëve përkatës. Debati është i ethshëm. Shkalla e lartë e personalizimit të përplasjes midis të ashtuquajturve personalitete politike të parisë së Tiranës është e karakterizuar nga një egërsi e pashoqe dhe e frikshme.

Po ashtu, kjo përplasje është e karakterizuar nga një paturpësi dalluese për rrugaçët e dorës së fundit. Por, si duhet ta konsiderojmë këtë sjellje? Sa shqetësuese është? Me gjasë, nuk ka shumë arsye për t'u shqetësuar. Kur iu duhet, duket se të ashtuquajturit personalitete politike merren vesh shumë mirë me njeri-tjetrin. Kjo sjellje tipike e rrugës mbulon qëllime të tjera. Kjo është një mënyrë për t'i hedhur hi syve popullit dhe për të zhvendosur vëmendjen, njëlloj siç veprojnë prestigjiatorët në cirk. Njerëzit shohin kapelen, por lepuri është në mëngën e tyre.

Përse sherri mediatik është në nivelin e rrugës?

Sherri mediatik i parisë është në nivelin e rrugës dhe, në shumë raste, është më keq se aq. Por problemi kyç në politikën shqiptare është se paria e Tiranës e, në veçanti, prijatarët e saj, janë shumë më të lidhur me njëri-tjetrin se sa lënë për të kuptuar

kacafytjet e përnatshme televizive e kuvendore. Këta nuk grinden për ideologji, për programe, apo për vlera. Grindja e përplasja e tyre publike nuk ndodh vetëm e vetëm sepse këta e kanë kuptuar rëndësinë e medias. Grindja publike dhe sherri, në dukje vrashtar e pa rrugë kthimi, sepse në sulmet e ndryshme çenohet nderi e gjithçka që duhej të ishte e shenjtë për njeriun, nuk ndodh sepse këta janë përfaqësues të partive të tyre që përplasen për vlera e për ideologji. Grindja ndodh pikërisht për të kundërtën. Partitë janë biznesi i tyre dhe ata janë përfaqësues të interesave të klaneve respektive në politikë. Sherri nuk ndodh për diçka përmbajtësore e thelbësore, por për diçka që është e dënueshme në nivelin e rrugës e të mbështetësve respektivë. Aq më keq, sherri politik ndodh në nivelin e imazhit e të simbolikës. Nuk ka sherr mediatik në shtetin shqiptar për probleme thelbësore dhe jetike që i interesojnë parisë. Dhe, për sa kohë që çështjet themelore nuk preken, interesat e parisë si shtresë janë të mbrojtura.

Pse ndodh kështu? Nga një anë, politikanët ndjekin modele udhëheqësish që janë të respektuar në popull. Përdorimi i mjeteve të informimit nga ana e tyre është shumë i sofistikuar, dhe ambalazhimi i mesazhit që duan të përçojnë, është profesional. Mirëpo, mbi të gjitha, sjellja e tyre është e kushtëzuar nga votuesit, nga preferencat e votuesve të tyre, dhe kjo flet shumë për gjendjen. Votuesit e tyre merren me personalitetet e jo me idetë, me njerëzit, me veset e tyre e jo me vlerat apo kontributet reale. Në shtetin shqiptar, lufta politike bëhet për të kontrolluar siglën, vulën dhe emblemën e partisë. Votuesit nuk votojnë programe por individë e sigla partiake. Kjo nuk është një provë e qartë për të thënë se votuesit nuk kanë njohuritë e mjaftueshme për t'i gjykuar prijatarët. Por kjo është një provë e qartë për të thënë se personalizimi i politikës është i lidhur me mendësinë e votuesve të cilët e presin këtë lloj sjelljeje nga ana e tyre. Politikanët zihen me njëri-tjetrin për të bindur një elektorat të caktuar se ata janë përçuesit e vlerave që janë thelbësore për atë grup votuesish. Pra ata po iu flasin klientëve të tyre, jo qytetarëve të përgjegjshëm, apo të pavarur që duan të bëjnë një zgjidhje politike mbështetur në një program të caktuar politik.

Mirëpo, nga ana tjetër, kjo gjendje sherri, herë latente, herë e tensionuar, por asnjëherë e shuar, është thjesht shfaqje e përkohshme dhe për konsum elektoral. Sapo mbaron shfaqja e rradhës, në kulisat e Tiranës fillon politika e vërtetë. Dhe politikën e vërtetë këta e luajnë me njëri-tjetrin, me rregulla të tjera. Politika e vërtetë është e lidhur me shkallën e kontrollit mbi shtetin dhe ekonominë që do të ushtrojë klanet e caktuara të parisë.

Pse ndodh kështu? Në një shtet pa ekonomi, politika është ekonomi. Kontrolli mbi shtetin është kushti paraprak për mbrojtjen dhe lulëzimin e interesave të klaneve. Prandaj, politika është biznesi i klaneve respektive të të ashtuquajturve personalitete politike. Të gjithë prijatarët e klaneve, si ata që janë të përfshirë në politikë, si ata që tashmë rrinë në hije, kanë qënë të përfshirë në politikë që nga kohë të vjetra që s'mbahen mend. Në politikën aktive në shtetin shqiptar ka ish-partizanë të Luftës së Dytë Botërore, ish-sekretarë të PPSH-së, ish-Ministra të kohës së Enver Hoxhës e të Ramiz Alisë e me rradhë. Të gjithë janë në krye të partive kryesore. Edhe sot e kësaj dite, janë po ata njerëz të parisë që vendosin për politikat e ndryshme në krye të organeve drejtuese të shtetit. Po kështu, në hije, ka një strukturë tjetër, shumë të fuqishme. Por, kjo pjesë e nënujshme e akullnajës, pjesa që nuk shihet, është e përbërë me ish-anëtarë të Byrosë Politike, anëtarë të Pleniumit të Komitetit Qëndror, ministra e me figura të rëndësishme të sistemit të kaluar, kësaj here në role të tjera. Tashti janë në rolet shoqërore si vjehërr, prindër, apo edhe si patriarkë klanesh mafioze. Këta janë ata që luajnë me figurat politike të ditës, këta janë ata që bëjnë sherrin televiziv për konsum publik, që mësojnë brezin e ri dhe që vazhdojnë të punojnë me metodat e vjetra. Edhe pse mund të jetë zgjeruar e modifikuar, sepse tashmë, burimet materiale janë të paimagjinueshme me të shkuarën, dhe individë e klane të tëra janë fuqizuar ekonomisht e politikisht, kupola e parisë nuk ka ndryshuar thelbësisht, as në përbërje, as në vlera, por as në qëllimet që kanë e që ndjekin.

Njerëzit janë të çorientuar nga sherri intensiv mediatik. Normat e sjelljes shoqërore nuk e pranojnë këtë nivel sharjeje publike dhe përplasja mediatike është e pamëshirshme. Por, pyetja shtrohet se

pse, të dy palët e parisë e durojnë nivelin e sharjes publike deri në këtë shkallë, aq sa duket se janë armiq për vdekje? Duhet thënë se edhe pse paria e Tiranës është një përzierje shumë e komplikuar origjinash klasore, etnike e me rradhë, shumë prej tyre vijnë nga shkolla e vjetër e PPSH. Ata kanë qënë të edukuar me shumë kujdes për të funksionuar në atë sistem. Dhe kjo stërvitje ka ndodhur, të paktën, për dy-tre breza. Pra, ata e njohin shumë mirë njëri-tjetrin, e njohin me rrënjë, me degë e me gjethe. Ata e dinë mirë se ku preket pala tjetër, e dinë se sa larg duhet shkuar e se sa të trashë e kanë lëkurën secili. Atë që njerëzit e moralshëm nuk e durojnë dot, këta e përbijnë me lehtësi, sepse është pjesë e lojës politike. Prandaj, luajnë kaq hapur me mendësinë e njerëzve të thjeshtë. Ata bëjnë kryesisht sherr të shfrenuar mediatik, nuk ndalen para asgjëje e duket se në çdo rast do të nxjerrin koburet nga brezi, e do të vrasin njëri-tjetrin. Arsyeja është se, mbas sqarimit të nivelit të mbështetjes e të le-gjitimitetit që kanë klanet në popull, çka përcakton se kush merr pjesën më të madhe nga thesari i shtetit, ata e gjejnë gjuhën shumë lehtë me njëri-tjetrin. Sherri kontrollohet me shumë kujdes.

Ajo që i bashkon, diçka që ata nuk e thonë asnjëherë hapur, është qëllimi i përbashkët që ndajnë. Si atëherë edhe sot, objektivi i tyre mbetet i njëjtë. Ata duan për t'u bërë pari sunduese me zor, ani pse rruga e tyre ka qënë dhe është e shtruar me mjerimin e vuajtjen e të gjithë shqiptarëve. Në këtë aspekt, asgjë nuk ka ndryshuar. Ata e njohin mirë njëri-tjetrin, ndajnë të njëjtat interesa, vlera, e qëllime dhe pavarësisht partive politike, janë dy anët e të njëjtës medalje. Pavarësisht nga përkatësia partiake, paria është si dy duart e të njëjtit trup dhe, përplasja fiktive, për propagandë mediatike e mobilizuese, krijon imazhin e rremë të zhvillimit të politikës në shtetin shqiptar.

Përçaj e sundo: një teknikë që funksionon

Duke gjykuar nga sjellja e pandryshuar e parisë, si në sistemin e mëparshëm, si gjatë tranzicionit, duket sikur tranzicioni për ata do të mbarojë vetëm kur ata të kenë nën këmbët e tyre të gjithë

shqiptarët, siç i kishin për disa dhjetjavëçarë nën udhëheqjen e Enver Hoxhës. Por ky qëllim, edhe pse i dallueshëm në veprimet e tyre, nuk përmendet më hapur si dikur.

Arsyeja? Tashmë, ata e dinë që nuk mjafton të sundosh dikënd vetëm me forcë. Sundimi më i mirë është kur tjetri bindet se gjendja ku është shteti e shoqëria në të cilën jeton, nuk mund të ndryshohet. Prandaj, kësaj here, jo duke i mbyllur në një kamp përqëndrimi, por duke u dhënë zgjidhje individuale problemeve në dukje individuale, njerëzit ose ikin e lënë vendin ose i nënshtrohen parisë. Ata që mbesin në shtetin shqiptar janë ata që janë më të pazotët e më të nënshtruarit, më të manipulueshmit e disa edhe veglat e tyre. Ky është një proces seleksionimi, suksesin e të cilit nuk ka asnjë sistem terrorist që mund ta arrijë. Me këtë mënyrë, para ka përzënë mbi një milion e gjysëm shqiptarë. Me këtë mënyrë, para sundon mbi rreth tre milionë të tjerë që janë të kapur në kurthin e saj.

Askush nuk i nënshtrohet të keqes me vullnetin e vet. Paria e di këtë, por ajo nuk ndalet në përpjekjen për thyerjen e njerëzve. Forca më e madhe e pushtetit të tyre është rezinjata e njerëzve. Dhe rezinjata masive, dorëzimi para së keqes, arrihet me dështimin e njëpasnjëshëm të zgjidhjeve, të rrugëdaljeve e të të gjitha përpjekjeve për të ndryshuar drejtim. Prandaj, jemi e do të jemi në tranzicion të vazhdueshëm, derisa para e Tiranës të arrijë objektivat e saj. Paria do të minojë çdo përpjekje që i bie ndesh interesave të saj si shtresë e si klan. Ajo do të godasë pa pikë mëshire e pa asnjë hezitim çdo përpjekje për ndryshimin e gjendjes ku janë shqiptarët.

Mirëpo, nga ana tjetër, sistemi duhet të jetë formalisht demokratik. Parisë i duhet mbështetja e popullit, i duhet legjitimiteti, pikërisht prej atyre që jetojnë në atë shtet. Në shtetin shqiptar ka dy grupe njerëzish që iu shkojnë mbrapa liderëve të rradhës, militantët injorantë dhe klientët. Pavarësisht së shkuarës së tyre që dihet mirë, në shtetin shqiptar ka ende shumë njerëz që besojnë verbërisht në të ashtuquajturin udhëheqës të caktuar. Militantët nuk pyesin për programe politike, ide, vlera apo për zgjidhje problemesh. Ata janë tifoze

e fanatikë të prijatarit, si dhe, armiq për vdekje të kundërshtarit të tyre personal e familjar. Grupi i dytë përfshin klientët politikë. Këta janë në shumicë dërmuese rrogëtarë e biznesmenë. Klientët janë të rreshtuar mbas një formacioni të caktuar vetëm e vetëm për fitimin e radhës. Këta shiten e blihen për një kafshatë bukë, për një thes mielli, apo për një lopë. Por, një pakicë e tyre, synon fitime të majme nga thesari i shtetit. Këta, që i shkojnë mbrapa së keqes, besojnë vetëm në interesin e në kuletën e tyre. Për këtë arsye, të gjithë prijatarët partiakë po luftojnë që të mbajnë të lidhur mbas qerres së vet militantët e tyre, tifozët fanatikë të mitingjeve, si dhe të bindin klientët se ata do të fitojnë e prandaj duhet që të vazhdojnë t'i mbështesin.

Militantëve dhe arrivistëve u bëhen premtimet për policë e doganierë, për tendera e për korrupsion. Përndryshe, të ashtuquajturit personalitete politike, nuk i marrin dot votat e shumta, që i mbledhin dhe i hedhin në kuti, militantët dhe sekserët respektivë. Por, në shtetin shqiptar, militantët po pakësohen dhe interesaxhinjtë e makutëria po shtohen dhe politika është kthyer në një biznes, fitimprurës si asnjëherë tjetër, në historinë e shqiptarëve. Sistemi është kthyer në një sistem të pastër klientelist. Nga ana tjetër, edhe pse jo aq dukshëm, po shtohet edhe masa e njerëzve që nuk duan të luajnë më këtë lojë me viktima e fitimtarë. Më në fund, këta, që e kanë kuptuar se lojën e fiton gjithnjë paria, janë një shtresë shoqërore në rritje. Këta duan një politikë serioze e të mençur, një politikë që të mbrojë nderin e jetën e sigurinë e njerëzve. Por, kjo masë ende nuk sheh zgjidhje serioze e që ata mund ta mbështesin me bindje.

Shkurt, shqiptarët janë në qorrsoak, por ka zgjidhje për të dalë nga kjo gjendje. Ato janë të ditura. Edhe paria, edhe të shkolluarit, i dinë mirë zgjidhjet që iu shërbejnë të gjithëve. Mirëpo, rruga e zgjidhjes së ndershme të problemeve nuk i intereson parisë së Tiranës. Vendosja e një sistemi të ndershëm e të përgjegjshëm iu cënon interesat e shumta e të gjithanshme që ata kanë. Për parinë e Tiranës, nuk ka e nuk duhet të ketë një popull shqiptar që don të jetojë me qetësi, me siguri, edhe pse më i varfër se disa të tjerë, por me nder në vendin e vet, në shtëpinë e vet, në shtetin e vet.

Ky objektiv nuk arrihet ndryshe përveçse përmes një zbatimi metodik të një politike *divide et impera*, “përçaj e sundo”. Prandaj edhe shqiptarët duhet të copëzohen, të përçahen, të dezinformohen, të manipulohen e të kontrollohen, me të gjitha mënyrat e mundshme, të cilat paria i njuh mirë dhe nuk heziton që t’i përdorë. Ku nuk funksionon kërbaci, përdoret kulaçi. Ku nuk mund të premtohet e ardhmja, manipulohet e shkuara. Ku nuk mund të ofrohet bukë e siguri, ofrohen fjalë boshe për sedrën e sëmure dhe emrin e “familjes së madhe” edhe pse gjyshi ka qenë rrobaqepës, këpucar, teneqexhi, furrxhi apo bakall. Me këto histori tragjikomike janë mbushur faqet e gazetave të përditshme.

Ka edhe një masë njerëzish që nuk do të nënshtrohet e të shitet. Prandaj, atje ku nuk ofrohet punë e jetesë, ofrohet rruga e mërgimit dhe e përzënies së heshtur prej atdheut. Shpesh, paradoksalisht, kjo është edhe rruga më e arsyeshme edhe për vetë ata. Dhe, për më keq, e gjithë shoqëria shqiptare duhet të luajë këtë lojë hipokrite. Pa doreza e haptazi, paria po ia shet krimin e vet si zgjidhjen e vetme të së ardhmes, gjithë popullit shqiptar. Prandaj, për parinë e Tiranës, përçarja e shqiptarëve është norma e sjelljes dhe kjo sjellje e saj nuk do të ndryshojë. Në shtetin shqiptar, gjithkush është e duhet të ndjehet i persekutuar nga një sistem i caktuar. Gjithkush është e duhet të jetë pronar dhe, paradoksalisht, tashmë kemi edhe ish-pronarë. Pa folur këtu për forma të tjera të identitetit, që po promovohen me të gjithë format e metodat e ndryshme, rezultatet e këtyre politikave kanë qënë përçarja dhe fragmentarizimi i mëtejshëm i shoqërisë.

Këtu kemi edhe një përpjekje të pashembullt por edhe flagrante për të luftuar kundër së vërtetës. Arsenali argumentativ e sugjestionues i parisë mbështetet në teknika të sofistikuara të *marketing*, dhe përziën mite të ndryshme dhe fakte e argumente, që shpesh përjashtojnë njëri-tjetrin. Teknikat e ndjekura ushqejnë sedrën e kotë të një mase të njerëzve, apo iu fryjnë flakëve të armiqtësive midis grupeve. Kështu, të gjithë shqiptarët duket se kanë luftuar e do të luftojnë kundër Turqisë e imperializmit, me e kundër fashizmit e komunizmit e me radhë. Asnjë shqiptar nuk është derë e vogël dhe që vjen nga një prejardhje e varfër, asnjë

nuk i ka pasur paraardhësit shërbëtorë apo të shfrytëzuar nga të tjerët. Të gjithë njerëzit që sheh rrugëve janë intelektualë me shkollë të lartë edhe pse padija është në kulmin e mundshëm. Kjo është teknika që funksionon.

Legjitimiteti i sistemit duhet ruajtur e kultivuar përmes krehjes së sedrës e fryrjes me fjalë boshe, thirrjeve për mbrojtjen e interesave të grupeve imagjinare, në emër të interesave të imagjinuara, absurde apo ekstremiste. Por e gjithë kjo lojë luhet në bazë të identiteteve të shpikura, të mbrojtjes së parimeve imagjinare e sloganeve ideologjike që nuk iu shërbejnë aspak njerëzve por vetëm e vetëm parisë.

Mbi disa aspekte themelore të demokracisë që mungojnë në sistemin shqiptar

Gjithsesi, ka shumë elemente të demokracisë që mungojnë, dhe që identifikohen lehtësisht. Fushata intensive, zallamahia elektorale, si dhe zhurma e mjeteve të informimit të transformuara në pushkaliqet e shashkat mediatike, nuk mund të fshijnë disa mungesa të ndjeshme që e bëjnë këtë fushatë të radhës, si dhe rezultatin që mund të vijë prej saj, të duket, qysh tani, i pashpresë. Është e dobishme që të vihet në dukje, anipse shkurtimisht e thjesht si ilustrim, mungesa e disa prej këtyre elementëve, të pranishme në fushata të këtij niveli, në çdo vend tjetër që është edhe minimalisht demokratik.

Së pari, është mungesa e realizmit në premtime e në vendosjen e prioriteteve në politikën e shtetit. Edhe po të mos jenë të pranishme në vende të kategorisë së shtetit shqiptar, kudo që janë ato vende, në Afrikë apo në botën e tretë, kjo nuk është justifikim. Shteti shqiptar gjendet m'u në anë të Europës, anipse do të mbesë në anë të strukturës politike të BE-së për shumë e shumë kohë. Por, natyrisht, nuk ka rëndësi se si të konsideron bota e jashtme. Në Tiranë, ka më rëndësi ka se si e sheh ti veten. Prandaj, flitet për struktura euroatlantike, objektiva të larta ideologjike, për kozmopolitanizëm, për liberalizëm e me rradhë. Në diskursin

politik të parisë përdoren gjithfarë konceptesh që nuk kanë asnjë lidhje me interesat jetike të shqiptarëve. Të gjitha janë shprehje të pastra demagogjike.

Kjo më sjell tek problemi i dytë. Kjo sjellje është metodike, e vetëdijshme, dhe e qëllimtë. Në Tiranë mund të flitet për gjithçka tjetër, e të mbrohet çdo pikëpamje, sado absurd të jetë argumenti, por nuk mund të flitet për problemin kombëtar shqiptar. Për parinë, askush nuk duhet të ndjehet shqiptar. Arsyeja është se, po menduan njerëzit se janë pjesë e një bashkësie kombëtare, atëherë, edhe të mirën e të keqen, ata do ta shohin me atë sy. E kështu, bëhet shumë e lehtë për dikënd që të drejtojë gishtin drejt tyre e të flasë për krimet e parisë. Paria, deri dje jeniçerët e përjetshëm, *denbabaden*, të të gjitha sistemeve që kanë ekzistuar e sunduar në atë vend, ka marrë vendim që ne shqiptarët të jemi evropianë dhe, *hocus-pocus, abra-cadabra*, me varjen e flamurëve të BE-së në rrugët e Tiranës na thuhet se jemi bërë të tillë. Një demagogji e tillë e paskrupullt i bën të qeshin të gjithë ata që e njohin sado pak Evropën. Në BE, shqiptarët kanë një reputacion shumë të dyshimtë. Shumë pak i konsiderojnë ata evropianë, por paria nuk ndalet. Kjo është pjesë e përpjekjes së tyre për çoroditjen sistematike të shqiptarëve.

Ndër patologjitë e shumta të tjera që vihen re ashiqare dhe që do të duken edhe më mirë në ditët e javët e ardhshme, janë mungesa e debatit të mirëfilltë ideologjik, mungesa e vizionit për të ardhmen, shterpësia e vlerave morale, përçarja e qëllimtë e popullit, mungesa e vetëdijes për përgjegjësitë politike të partive dhe feudalizimi i tyre, afrimi i kolapsit ekonomik, kriza e thellë dhe efektet e saj mbi mërgimtarët, manipulimi me ligjin dhe elektoratin, shkatërrimi i sistemeve të shërbimeve publike, legjitimimi i politikanëve të korrumpuar e të kriminalizuar, si dhe shtrembërimi i qëllimtë i vendit që zë shteti në marrëdhëniet ndërkombëtare. Mbi të gjitha, ajo që do të dallohet shumë qartë, do të jetë dështimi i pakontestueshëm dhe i qëllimtë i prijatarëve politikë për me ndërtue një shtet modern të shqiptarëve, e në shërbim të tyre.

Në vend të mbylljes: një reflektim

Duket se qëllimi i pandryshuar i parisë së Tiranës dhe i të ashtuquajturve personalitete politike vazhdon që të jetë i pandryshuar. Objektivi i tyre është që ta transformojnë shoqërinë shqiptare në një top gëlbaze morale, ku askush të mos ketë forcë të thotë të vërtetën e të mos ketë respekt e dinjitet për veten e vet, por edhe për familjen e shoqërinë. Për arritjen e këtij objektivi të zvetënimit moral të shoqërisë, po përdoret çdo instrument influencimi që ata kanë në arsenalin e tyre. Po ashtu, duket se objektivi i tyre i pandryshuar është që të trullojnë sa më shumë që të mundën segmentet e caktuara të shoqërisë dhe t'i bëjnë të votojnë për palën e tyre. Në mos tjetër, ata duan që njerëzit t'i zgjedhin e t'i mbështesin ata si të keqen më e vogël. Nga ana tjetër, ata duan të bindin të huajt se ata janë kandidatët më të meritueshëm me u zgjedhë për të drejtuar shtetin dhe institucionet e tij.

Duhet thënë se kjo mënyrë që ka gjetur paria me i zgjidhë problemet e veta të legjitimitetit, si me të huajt, ashtu edhe me elektoratin shqiptar, është shumë efektive. Kjo metodë, diversive dhe hutuese, ka funksionuar shumë mirë në të shkuarën, të paktën gjatë tranzicionit të deritashëm që, as nuk ka mbaruar, e as nuk duket se do të mbarojë së shpejti.

Por, edhe pse prijatarët e parisë grinden në media gjithë ditën, paria e ka ruajtur me intransigjencë kohezionin e vet si shtresë e mbyllur shoqërore. Duke gjykuar nga ligjet e vendimet që aprovojnë, nga bizneset që mbrojnë, nga interesat që ndajnë, me e thanë disi metaforikisht, ata flejnë bashkë gjithë natën. Së bashku, atje ku duhet ata ruajnë e mbrojnë interesat e tyre identike. Për të arritur këtë objektiv, ata kanë përdorur e do të përdorin mjete të shumta propagandistike që veç do të vazhdojnë që të ç'orientojnë njerëzit.

Nuk ka arsye për të besuar që një taktikë e tillë nuk do të funksionojë edhe në të ardhmen, përfshirë këtu edhe zgjedhjet e pritshme të 28 Qershorit. Prandaj është e nevojshme që ata individë, të cilët kanë kurajon e guximin qytetar, t'i kundërvihen së keqes. Qëllimi i parisë është që të duket se rruga, ku ata duan

që ne të ecim, është e pashmangshme. Qëllimi i atyre që duan të jetojnë me nder duhet të jetë që të vënë në dukje të keqen, t'ia vënë emrin që ka, të ndahen prej saj dhe të luftojnë për ta ndryshuar rrjedhën e jetës e për t'i ikur zgjedhës ku do ta mbajë popullin shqiptar paria e Tiranës.

PARIA E TIRANËS: PROBLEMI THEMELOR I DËSHTIMIT TË TRANZICIONIT

Në shkrimin e mëparshëm, u mundova të argumentoj se paria e Tiranës është problemi më i madh dhe më i rrezikshëm me të cilin përballen e do të përballen shqiptarët në rrugën e tyre në gjetjen e një jetë më të mirë në të ardhmen. Mirëpo, me e ditë se me kë duhet të merremi e si duhet të merremi në këto analiza, duhen sqaruar pak më mirë tre gjëra. E para, kush është paria? E dyta përse kjo shtresë është problem kaq i rëndësishëm dhe i frikshëm për shqiptarët? Dhe e treta, çfarë duhet bërë me problemin e me shtresën vetë? Në këtë shkrim, do të mundohem që të sqaroj pak këtë problem, që do të trajtohet më shumë e më në thellësi në shkrimet e tjera.

Kush është paria e Tiranës?

Paria e Tiranës përbëhet nga të gjithë ata individë që, për shkak të influencës së tyre mbi politikën, ekonominë, kulturën e vlerat e popullit në shtetin shqiptar, luajnë një rol kryesor në drejtimin që merr shoqëria shqiptare dhe pakicat që jetojnë me ta në shtetin shqiptar. Pjesë integrale e parisë së Tiranës janë tre grupime individësh. Së pari, janë prijatarët e partive politike, që mbrojnë interesat e shtresës së tyre nga shteti e nga shoqëria përmes kontrollit e influencës së tyre mbi vetë shtetin e strukturat institucionale. Këtu hyjnë edhe strukturat e konsoliduara të parisë si klani i Enver Hoxhës, por dhe klanet e vjetra të dala nga sistemi i mëparshëm, duke mos përjashtuar këtu klanet Kapo, Shehu, apo të tjerë të identifikuar në bazë të krahinës apo besimit. Por

gjithnjë, prijatarët janë maja e ajsberg-ut të parisë në çdo kohë. Prandaj, duhen veçuar individë të spikatur, që dalin në krye të tyre, ose që formojnë struktura të reja brenda parisë si Ramiz Alia, Xhelil Gjoni, Sali Berisha, Sabri Godo, Fatos Nano, Genc Ruli, Rexhep Mejdani, Paskal Milo, Arben Imami, Servet Pëllumbi, Jozefina Topalli, Bamir Topi, Fatmir Mediu, Genc Pollo, Kurt Kola, Edi Rama, Neritan Ceka, Aleksandër Meksi, Skënder Gjinushi, Ilir Meta, Gramoz Ruçi, Pandeli Majko, Ridvan Bode, Besnik Mustafaj, Lufter Xhuveli, Erion Braçe, Ilir Rusmajli, Dashamir Shehu, Arta Dade, Kastriot Islami, Ben Blushi, apo Paskal Milo. Këta e shumë të tjerë që kanë qënë figura me rëndësi politike, sot mund të jenë në hije, apo në dritë-hije, por ata vazhdojnë që të luajnë një rol në politikën e Tiranës.

Së dyti, janë pronarët e monopoleve dhe të ndërmarrjeve ekonomike që e mbajnë gjallë dhe spikasin ekonomikisht në të gjithë shtresën e parisë si Bashkim Ulaj, Rezart Taçi, Koço Kokëdhima, Anastas Angjeli, Dritan Hoxha, Artan Dulaku, Stefan Pinguli, Lefter Koka, Tom Doshi, Sadri Abazi, Fidel Ylli, Sami Gjergji, Arben Duka, Shyqyri Duraku, Ramë Geci, Zamir Mane, e të tjerë afaristë, tregtarë e investitorë me peshë të madhe në ekonomi. Edhe këta e kanë vënë pasurinë duke qënë të lidhur politikisht me strukturat e parisë. Kurdo që qëmtohet mënyra e vënies së pasurisë së këtyre individëve do të shihet se rrënja e saj ka qënë një lidhje politike.

Së treti, janë krijuesit e vlerave apo të antivlerave e të mendësive që i interesojnë parisë e të cilët, përmes lumit të botimeve, propagandës e të emisioneve televizive, ia paketojnë e ia shesin interesat e kësaj shtrese si vlera të mirëfillta letrare, kulturore, apo ideologjike popullit shqiptar. Këtu hyjnë shkrimtarët, artistët, opinionistët, analistët, komentatorët e prodhuesit e argumenteve që formësojnë debatin në Tiranë. Ndër figurat e spikatura të këtij krahu të parisë janë Dritëro Agolli, Ismail Kadare, Visar Zhiti, Nikollë Lesi, Blendi Fevziu, Agron Tufa, Arjan Çani, Filip Çakuli, Ylli Pango, Rudina Xhunga, Fatmir Toçi, Kiço Blushi, Skënder Minxhozi, Fatos Lubonja, Ilva Tare, Aleksandër Frangaj, Anila Basha, Mero Baze, Mustafa Nano, Sokol Balla, Andrea Stefani, Artan Lame,

Mark Marku, Armand Shkullaku, e të tjerë. Këtu hyjnë edhe shumë të tjerë, që nuk dinë se çfarë flasin si Ndriçim Kulla, Hamit Take, Miranda Haxhia, apo, edhe i ndjeri, mjeku i paharrueshëm popullor, Arqile Boti, individë të superkulturuar që shkruajnë por që në shkrimet e tyre dallohet se kanë obsesione profesionale si Edmond Tupja me personazhet e tij Françesk Armadhi dhe Vangjel Lezeti, mitomanë dhe prototipë të dikujt që vuan kompleksin e madhësisë si Edison Ypi, apo pisqolla mediatike të dala nga romanet e Balzakut si Fahri Balliu apo Frrok Çupi. Rëndësia e këtij grupi për parinë shihet qartë në vëmendjen që marrin individët brenda këtij grupi nga paria. Paria ka mbetur e ngrirë në mendësinë e vitit 1990. Pika kulmore kulturore e shoqërisë shqiptare kanë qënë e mbeten Ismail Kadare dhe Dritëro Agolli, poeti më i shquar katundar kombëtar.

Më në fund, si askund tjetër, pari legjitime në shtetin shqiptar janë edhe figurat e botës së nëndheshme, si Miri i Xhikes, Rrahmoni, Lul Berisha, Aldo Bare, Zan Çausi, Kakami, Gjenerali i Babrrusë, Gzimi i Kashtës, Qorri, e shumë të tjerë, që nga paria njihen me emra të tillë përkëdhelës, si Tan Lepri. Shumë më të rëndësishëm janë ata që nuk iu përmendet emri, as në shtyp dhe as në media, por që arrijnë të kërcënojnë edhe kryeministrin me një SMS. Këta janë ish-truproja dhe ish-shoferë, ish-oficerë apo zyrtarë, që punojnë në strukturat dritë-hije të parisë dhe që janë pasuruar në mënyrë marramendëse. Disa kanë qënë pjesë e rëndësishme e parisë sunduese, si bie fjala, “nipi i kryeministrit”, trafikanti i drogës, kolonel i antidrogës, avokat Sokol Koçiu. Por roli qëndror i këtyre dregzave të shoqërisë shihet si në periudha krize ashtu edhe në allishverishet e dyshimta të parisë.

Si edhe shihet lehtë, ky përkufizim i parisë, është i ndryshëm nga përcaktimet tradicionale të elitave tek Pareto sepse është shumë më i ngushtuar dhe selektiv, por më i zgjeruar se sa tek Mosca, sepse paria nuk është thjesht klasa sunduese politike. Arsyeja është se gjithkund tjetër, paria, elitat apo klasa sunduese kanë një bazë shumë më të gjërë tradicionale legjitimiteti, fetare, ushtarake, kulturore apo historike. Këta që sundojnë në shtetin shqiptar nuk kanë pasur asnjë mundësi që të krijojnë legjitimitetin

e duhur apo të imponohen në disa breza. Prandaj, ndër shqiptarët, paria janë ata që sundojnë e që duan të sundojnë me forcë politike, dhe duke kontrolluar politikën e krimin për t'u pasuruar ata vetë dhe klanet e tyre. Politika është në plan të parë. Krimi është rruga për të ruajtur interesat kur nuk mbetet zgjidhje tjetër. Pasurimi është objektivi i pandryshuar i parisë. Edhe për disa kohë të mira, shteti ligjor dhe instrumentet e dhunës do të jenë armiku i parisë.

Po ashtu, nga përkufizimi shihet se kam përjashtuar figurat kulturore dhe fetare bashkëkohore. Strukturat fetare janë ende të brishta e don kohë që të fuqizohen, megjithëse Anastas Janullatos, Rrok Mirdita, Selim Stafa, e një kohë, Reshat Bardhi, Hafiz Sabri Koçi, apo janë bërë pjesë integrale e parisë së Tiranës. Figurat e sekteve që po fuqizohen dita më ditë, përfshirë këtu edhe kultin e 'Shenjtores Eleonorë,' që ndërroi jetë në rrethana të dyshimta dhe pa mundur të parashikojë fundin e vet, me kohë do të fillojnë të kenë më shumë peshë. Po ashtu, paria i kontrollon me shumë rreptësi zhvillimet në struktura të tilla. Gjithsesi, strukturat e mirëfillta kulturore e fetare janë tejet të dobta e pa influencë të mjaftueshme në shoqërinë shqiptare.

Më në fund, nga paria e Tiranës janë të përjashtuara edhe figurat ushtarake. Shteti shqiptar nuk ka më as ushtri, as oficerë shërbimesh që të imponohen si figura me ndikim kombëtar. Një gjeneral ushtrie shqiptar apo një gjeneral i policisë, për nga influenca, është i barabartë me drejtorin e postës në një shtet tjetër. Paria e re sunduese shqiptare, edhe kur vjen nga profesorati apo nga shtresa intelektuale është pastërtisht politike, kriminale dhe ekonomike. Ajo ka edhe një frikë të justifikuar nga instrumentet e dhunës së shtetit si ushtria, policia, dhe shërbimet e ndryshme. Edhe ky përqëndrim kaq i ngushtë interesash e vëmendjeje tradhëton interesat dhe identitetin e vërtetë të shtresës.

Po të shikohet e të qëmtohet me qetësi, kjo shtresë e ngushtë bëhen a nuk bëhen më shumë se tre mijë vetë. Të gjithë janë të vendosur në Tiranë ose në rrethinat e saj ku i kanë vilat dhe apartamentet luksoze. Të gjithë kanë lidhje me parinë sunduese të mëparshme. Paria e mëparshme ishte thelbësisht politike, dhe këta nuk janë thjesht një rikrijim i zgjeruar i parisë së mëparshme. Kësaj

rradhe, zgjerimi ndodhi me intelektualët që u bënë politikanë, dhe me pasanikët e rinj që po seleksionohen me shumë shpejtësi. Ata që po mbesin të fortë ekonomikisht janë pjesë integrale e shtresës, të tjerët po zhyten e do të zhyten në fund, me ngadalë, e me kohë, por nuk mund të jenë pari. Në thelb, ajo që të bën pari, është lidhja me pushtetin politik, mendësia e shtresës, dhe përkatësia e pranimi në shtresën vetë. Dhe shtresa përzgjedh vetveten, pikë së pari, përmes besnikërisë së individëve ndaj interesave të saj si shtresë dhe identifikimit të tyre me vlerat e shtresës.

Kur janë në rrethet e tjera, edhe elementët e parisë dytësore, janë tejet të lidhur me Tiranën me një mijë fije. Thuajse të gjithë vijnë nga shtresa e zyrtarëve dhe e inteligjencës së lidhur me sistemin e mëparshëm. Edhe këta janë të lidhur me njëri-tjetrin, e me parinë, me interesa, me martesë, me akraballëk, me klane, me miqësira e me armiqësira të vjetra e të reja, vijnë nga të njëjtat zona e katunde, kanë kaluar në të njëjtat përvoja edukative dhe të gjithë e shohin aktivitetin e tyre si aktivitet të familjes përkatëse e të klanit respektiv. Çuditërisht, edhe si pasojë e feudalizmit në rritje të strukturave të parisë, paria dytësore po zhvillon një autonomi të theksuar nga qendra dhe po ndërton bazën e saj në nivel lokal.

Në këtë shtresë të parisë së Tiranës ka edhe familje e individë që janë në politikë, por nuk kanë as fuqi ekonomike e as influencë në botën e ideve. Po ashtu ka edhe familje e individë që kanë influencë relative në botën e ideve e të mendësisë por nuk kanë as fuqi ekonomike e as politike. Pavarësisht pozave impresionuese që marrin, këta individë të margjinalizuar, për shkak të varësisë ekonomike, janë kthyer e po kthehen në mercenarët e klaneve të parisë së Tiranës. Paria ka ndërtuar struktura politike, ekonomike, dhe ideologjike që dukshëm përcaktojnë perceptimet për gjendjen ekonomike, objektivat e shoqërisë, dhe mendësinë e pjestarëve të vet, por edhe të gjithë të tjerëve. Përmes këtyre mekanizmave e strukturave kontrolluese, ata e kanë kushtëzuar ndjeshëm të ardhmen e të gjithë shqiptarëve.

Në zemër të parisë janë disa klane të tilla familjare që spikasin mbi të tjerët. Këto dallohen jo vetëm sepse kanë qënë në lojë për

një kohë të gjatë, por edhe sepse janë të stërvitur si hiena politike, d.m.th., e njohin mirë politikën dhe e konsiderojnë popullin si pre të tyre. Por, thuajse të gjitha klanet e parisë, si të rinjtë ashtu edhe të vjetrit, në masë dërmuese, vijnë nga hiçi. Shumica mezi shkojnë dy breza e menjëherë dalin origjinat e tyre katundare, të përmirësuar me një bursë studimi në Moskë dhe me titujt si zyrtarë të kohës së Enver Hoxhës. Thuajse të gjithë, stërgjyshët më të largët që njohin, i kanë pasur çobanë e jeniçerë ose, edhe kur rrjedhin nga shtresa qytetare, vijnë nga familje “të rëna me kohë nga dynjallëku”. Prandaj, ose nga origjinat, ose prej imitimit të formës më të suksesshme të organizimit klanor, klanet e parisë kanë evoluar si struktura të bazuara në mendësinë katundare.

Më e keqja është se këta klane dhe prijatarët e tyre, edhe kur në krye të tyre ishin Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu, kanë sjellë mendësinë e katundit edhe në drejtimin e shtetit. Nga kjo shtresa e re e forcuar gjatë tranzicionit, modele të familjes së parisë së Tiranës me një fuqi të tillë të madhe janë, bie fjala, klanet e drejtuara nga Sali Berisha e Gramoz Ruçi. Të ngritur vonë nga hiçi, po tamam nga hiçi, njëri nga Salaria e Tepelenës dhe tjetri nga Viçidoli i Tropojës, këta të dy janë përfaqësues tipikë të kësaj shtrese. Të dy janë ish-konviktorë, shërbyes të bindur të sistemit të mëparshëm e të partisë në pushtet, njëri sekretar partie rrethi e ministër i brendshëm i sistemit, dhe tjetri, sekretar partie i spitalit e kandidat për kandidat i KQ të PPSH-së, por i pa emëruar në KQ, për shkak se gruaja kishte pjesë të familjes jashtë vendit. Sot, që të dy janë në krye të klaneve të fuqishme politike, ekonomike e mediatike të familjeve respektive dhe figura kryesore të parisë. Si ilustrim, po përmend Sali Berishën, thjesht sepse Mero Baze, me gazetën *TemA*, ka bërë një shërbim të madh publik, duke nxjerrë në dritë mjaft fakte të dhimbshme për këtë klan kriminal. Këto të vërteta nuk janë kundërshtuar nga Sali Berisha vetë. Edhe për këtë arsye, derisa të dëgjojmë të kundërtën, e derisa Sali Berisha ta hedhë Mero Bazen në gjyq, argumentet e Mero Bazes duhet të merren si të vërteta.

Simbas Mero Bazes, që për shumë kohë ka qënë instrument politik, mediatik e propagandistik i Sali Berishës, në rastin e

Sali Berishës, ai vetë mbron interesat e familjes në politikë dhe është në politikë vetëm e vetëm me atë synim. Duke mos pasur ideologji e vlera konsistente, Sali Berisha po përdor Partinë Demokratike, militantët e PD-së, partitë e koalicionit qeveritar, si dhe të ashtuquajturit liderë të këtyre partive, por edhe shtetin, ashtu si intereson atij. Nga ana e tyre, po simbas Mero Bazes, i biri i Sali Berishës, e bija, dhëndri, kunati, kunata, nipat, si dhe aleatët afatgjatë, si Lulzim Basha, punojnë *in tandem* dhe për fuqizimin e klanit të tyre. Po kështu edhe mercenarët e tyre të tjerë të të gjithë markave e të gjitha kombësive, jo vetëm ballkanike, si Damir Fazliç, pronarë lokalesh të Blllokut të Tiranës, por edhe më gjerë, afaristë si Bashkim Ulaj apo Zamir Mane, i mbrojnë dhe i zgjerojnë interesat e klanit Berisha në ekonomi në kurriz të interesave të të gjithë shqiptarëve. Ky klan i shtrirë nga Tropoja në Kamëz, në Durrës, e në rrethe të tjera ka të gjitha karakteristikat e një trusti kriminal të dalë nga drama e Brecht.

Kjo strukturë klanore-mafioze e këtij Trusti të Gështenjave shtresëzohet në formën e rrathëve të influencës nga Sali Berisha që është në qendër të klanit, tek figurat politike që pa mbështetjen e tij nuk kanë asnjë vlerë në politikë, për të mos thënë se janë zero politike si bie fjala, Astrit Patozi, Bujar Nishani, apo Myqerem Tafaj, për t'u ulur tek deputetët, zyrtarët e emëruar, që nga prefektët si Keltis Kruja tek ministrat si Aldo Bumçi, deri tek ata që kanë punuar për të gjithë, si Arben Imami, apo Neritan Ceka dhe që sot janë në shërbim të Sali Berishës. Në këtë mënyrë, Sali Berisha ka krijuar një shtet paralel që i shërben klanit të tij. Këta pjestarë e shërbyes të klanit, pjestarë të parisë, kalojnë ligje, japin tendera, ndajnë fitime, bëjnë buxhete shtetërore, lëshojnë koncesione e me rradhë, duke mbajtur parasysh, gjithnjë e mbi gjithçka tjetër, interesat e klanit Berisha.

Në rastin e influencës së ideve, simbas Mero Bazes, që e njuh mirë, Sali Berisha ka marrë me qera një pisqollë mediatike të stërpërdorur të tipit Fahri Balliu dhe disa të tjerë të të njëjtit nivel. Këta vegla të të gjithë regjimeve, Sali Berisha i përdor në televizionet që kontrollojnë si në *Tv Klan*, në *RD* dhe në gazetat e tjera që i shërbejnë me zell, e që pavarësisht nga emri që kanë,

në një moment të caktuar, si *Tv Shijaku*, *Radio Kontakt*, *Gazeta 55*, *Koha Jonë*, apo *Bulevard* kryejnë të njëjtin funksion. Përmes tyre sulmohen individët kundërshtarë të Sali Berishës dhe mbrohen pikëpamjet që i shërbejnë klanit.

E gjithë përpjekja titanike e Sali Berishës për të influencuar politikën shqiptare e për të mbetur në qendër të saj bëhet me synimin e mbrojtjes së interesave ekonomike e të sigurisë personale të klanit të tij e ne veçanti, të familjes së ngushtë. Politika e Sali Berishës, që mobilizon të ashtuquajturit militantë, simbas Mero Bazes, mbron sjelljen kriminale të të birit, të bijës e të familjes. Familja e Sali Berishës ka interesa që nga Jala, te Gjiri i Lalzit, tek Gërdec, por edhe shumë më tepër se aty. Por të gjitha këto janë bërë të mundura përmes kontrollit të shtetit nga ana e tij. Pra, interesat ekonomike të familjes mbrohen përmes kontrollit të shtetit e përfitimet vijnë prej kontrollit mbi shtetin. Fahri Balliu e shërbëtorët e tjerë si Aleksandër Frangaj, dhe gazetaret *RD*, *55*, apo *Koha Jonë* e mbrojnë në nivelin mediatik. Partia Demokratike i jep Sali Berishës mburojë politike që i duhet Trustit të Gështenjave.

Ky trust është prototipi i klanit sundues të parisë së Tiranës, një trust kriminal i organizuar në bazë të lidhjeve familjare e lokale, kryesisht të katundit. Tek të gjithë klanet e tjera ndërrojnë emrat që lakohen në shtyp, por jo struktura dhe përmbajtja, që janë të njëjta, edhe sepse të gjithë imitojnë suksesin e palës më të suksesshme. Në Tiranë njihen e dihen klanet dhe interesat që kanë. Askush nuk mund të mos kujtojë mbledhjen e famshme të Këshillit të Përgjithshëm Drejtues të Partisë Socialiste gjatë zhvillimit të së cilës Fatos Nano ua kujtoi figurave të PS-së, të gjithëve pa përjashtim, se kë përfaqësonin në politikë, cilave interesa iu shërbenin, e cilat monopole kontrollonin. Asnjë prej atyre 'figurave' nuk e hodhi Fatos Nanon në gjyq. Po ashtu edhe sulmet e njëkohëshme të Sali Berishës kundër parisë së Tiranës, "klanit të Zemunit" kur ishte krejtësisht i vetmuar e në opozitë, kanë nxjerrë në dritë shumë të vërteta jo të këndshme, që nuk duhen harruar kaq lehtë.

Problemi që paraqet shtresa sunduese e parisë së Tiranës

Me e thënë përmbledhtas, paria e Tiranës, dhe klanet sunduese në gjë të saj, janë kanceri vdekjeprurës i shoqërisë shqiptare. Ata kurrë nuk duan e nuk mund të lejojnë që shqiptarët të kenë një të ardhme normale si popull. Një e ardhme e mirë për të gjithë shqiptarët do të thotë që monopolet e tyre politike, ekonomike e kulturore duhet të thyhen e të shprishen. Për këtë arsye, ata do të luftojnë që, me çdo kusht e me çdo mënyrë që kanë në dispozicion, të mund ta mbajnë shtetin shqiptar peng të tyre. Shteti duhet të jetë i dobët e i pafuqishëm. Shteti shqiptar duhet të funksionojë vetëm e vetëm si instrument për të zhdukur hajdutët e xhepave, dhe konkurrentët e tyre që shpesh vijnë nga radhët e parisë, por që nuk i respektojnë rregullat e lojës së saj kriminale.

Prandaj e gjithë shoqëria duhet të jetë e kalbur moralisht fund e krye. Partitë politike duhet të jenë kartelet kriminale mafioze e të feudalizuara, struktura, në të cilat, numri i votave që siguron dikush, i jep të drejtën atij që të shklyejë një thellë nga taksat e nga thesari i shtetit. Ekonomia duhet të jetë një strukturë mafioze informale pa rregulla, ku ata janë e do të jenë në krye të monopoleve. Shteti duhet të jetë i paralizuar, dhe një strukturë e përdorueshme deri në atë nivel sa që, shoferët e bodigardët e tyre, të mund të thyejnë e të sakatojnë bizneset e ndershme fill sa mbarojnë zgjedhjet e pak përpara tyre pa iu hyrë gjemb në këmbë.

Shteti i kontrolluar prej tyre është shpata që iu mbahet varur mbi kokë reshperëve e ndërmarrësve të ndershëm që mandej bien në gjunjë para tyre e shtypen sistematikisht. Çdo njeri që punon me nder duhet të zvetënohet. Çdo zyrtar që ka ndjenjën e shërbimit publik ose duhet të përjashtohet nga puna, ose duhet të korruptohet e të degjenerohet. Në fushën e vlerave e të ideve, paria kërkon t'i bindë njerëzit që kështu, në këtë gjendje që është shteti shqiptar, është e gjithë bota. Gjithkund, simbas argumentit të saj, sundon mafia dhe krimi, ndërron vetëm niveli i kamuflimit. Motivimi i tyre për këtë sjellje është se atyre iu intereson që t'i bindin njerëzit që të mos kërkojnë rrugë tjetër. Argumenti i tyre, refreni i tyre i preferuar është: "kështu si ne janë të gjithë."

Për të arritur këtë objektiv të bindjes së njerëzve, ata nuk lënë gazetë pa shtypur e botim pa nxjerrë, natyrisht, duke i paguar mirë të gjithë sharlatanët e mundshëm që gjinden me shumicë. Mediat vazhdojnë që të organizojnë rubrika e emisione televizive nga më të ndyrat, të krijojnë antivlera e mendësi të njerëzve pa dinjitet e pa rrënjë, vetëm për të degjeneruar shqiptarët. Synimi i tyre? Synimi është për t'i bindur se kjo shoqëri është më e mira ku ata mund të jetojnë. Objektivi është i qartë: shqiptarët duhet t'ua dinë atyre për nder që ata e klanet e tyre ua mundësojnë jetesën në shtetin shqiptar. Modeli që iu shitet shqiptarëve, është modeli i degjenerimit e zvetënimit moral që i ka rrënjët tek etja e untia e jashtëzakonshme e parisë për gjëra materiale.

Rrënjët e kësaj sjelljeje duhen kërkuar në sistemin e mëparshëm. Kanë ndrruar format, por përmbajtja është e njëjtë. Sistemi i mëparshëm luftonte me thye gjithkënd, me e zhveshë gjithkënd që do të bëhej pjesë e strukturës së shtetit nga çdo gjë njerëzore. Përndryshe, sistemi i mëparshëm nuk mund t'i përdorte njerëzit edhe kundër familjeve të veta, nuk mund të përçudnonte shoqërinë deri në ekstremin e mundshëm pa pasë pasur shërbëtorë të tillë. E të gjithë këta që janë në krye të klaneve sunduese të parisë kanë kaluar në rrugën e në kalvarin e deformimit të sistemit të mëparshëm.

Këta janë, në thelb, konviktorë të untë, të rritur me një gotë çaji pa sheqer e me shtatë lekë marmalatë molle apo fiku, konvikteve, aksioneve e zboreve të Enver Hoxhës. Këta nuk kanë pasur në sistemin e mëparshëm e nuk kanë as në këtë sistem mëshirë për askënd e për asgjë. Gjithçka bëhet nuk i ngop dot shpirtinat e tyre të uritur e të ndrydhur qysh në moshë të re. Këta nuk kanë as ndjenja kombëtare, as besnikëri, as luajalitet, e as vlera njerëzore. Këta vijnë nga soji më i keq i jeniçerëve të përgatitur me i shërbye një krimineli si Enver Hoxha e një shteti të fortë por krejtësisht të shkëputur nga populli prej nga vinin. Tashti, të përgatitur si vegla të kimit, ata po sillen si krimineli vetë. E vetmja besnikëri që kanë është ndaj kohortës me të cilën janë rritur e me të cilën kanë ndarë mjerimet e rinisë.

Çka është me keq, kjo sindromë e pashëruar e jeniçerëve dhe

e konviktorëve të shkëputur nga populli i tyre, që janë vetëm në shërbim të untisë së tyre, tashmë është përhapur edhe në vetë familjet e parisë. Jetët e tyre private janë të shkatërruara. Shumë nga fëmijët po iu vdesin nga drogat, sëmundjet, e nga përvojat jo të këndshme që kanë pasur në botën e huaj. Fëmijët e tyre po dalin në jetë të thyer dhe po bëhen vegla të krimit të familjeve të veta kriminale. Por, as paratë, as pozitat zyrtare të prindërve, as rojet personale e as llogaritë rrjedhëse në bankat e botës nuk e mbulojnë dot llumin moral prej kah po vijnë. Megjithatë, ka shumë prej tyre që po mundohen të shkëputen nga trashëgimia kriminale dhe po kërkojnë rrugë të tjera që ta ndiejnë veten njerëz me dinjitet, çka edhe, gradualisht, po i shtyn që të pozicionohen edhe kundër prindërve e familjes së tyre.

Mbi të gjitha, problemi më i madh është se paria është ngjitur si ushujza në trurin e popullit. Ata po e shfrytëzojnë deri në maksimumin e mundshëm frikën e lindur dhe eksperiencën negative të frikshme që shqiptarët, dhe pakicat, patën me shtetin terrorist gjatë kohës së diktaturës së parisë. Duke pasë qënë vegla të rëndësishme të saj, duke qënë të rrahur me vaj e me uthull në mbledhjet e burokratëve, të zyrtarëve si dhe të organizatës bazë të partisë, këta janë të gjithë mjeshtër të manipulimit. Këta e kanë perfeksionuar artin e sundimit dhe sillen si dhelpra e hiena të vjetra që e dinë se si mund të manipulohen, si të blihen, e si të shiten njerëzit. Këta e dinë mirë se si të hedhin gurin e të fshehin dorën. Këta e njohin strukturën e shtetit me rrënjë. Prandaj, kur iu krijohet mundësia, luftojnë që ta manipulojnë atë si duan vetë.

Një shtet i fortë, me zyrtarë të ndershëm, me struktura të shëndosha e në shërbim të popullit është armiku i tyre për vdekje dhe ata nuk mund të lejojnë këtë. Mirëpo, shteti është aq i fortë sa është besnikëria e njerëzve karshi tij. Prandaj, lufta e tyre është drejtuar kah shkatërrimi i shtetit dhe i shoqërisë mbi të cilën mbahet shteti dhe që e mbështet atë shtet. Armiku më i madh për ta është një shoqëri normale e ndershme e cila e quan dhe e trajton sjelljen e tyre si kriminale, dhe që i identifikon individë të tillë e klanet e lumpenit shoqëror, që u shkojnë mbrapa, si zgjebe kombëtare. Jo më kot, lufta e tyre drejtohet pa ndërprerje

nga armiku i tyre më i madh: mendësia e një populli që don e lufton që të jetojë me nder, në vendin e vet, dhe që nuk i toleron poshtërsitë e krimit të klaneve që duan të bëhen pashallarët e vezirët e kohës moderne.

Gjithkush që flet kundër tyre e i quan ata me emrin e vërtetë nuk ka e nuk mund të ketë vend në shtetin shqiptar. Siç shihet edhe nga transkriptet e zbardhjet e bisedave të ndryshme, që nga Rogneri tek Foltorja Kombëtare, shoqëria duhet të jetë një top gëlbbaze morale ku askush të mos mundë t'iu kundërvihet atyre. Por, gjithkush, gjithnjë, duhet që të druhet e të ketë frikë për jetën e vet e të familjes së vet. Atëherë, kur të vendoset një gjendje e tillë, paria mendon se do të triumfojë dhe shteti shqiptar do të bëhet një sistem modern skllavopronar ku ata do të jenë bejlerët e të tjerët do të jenë rajatë e tyre. Ose për ta thënë më qartë, ata duan të ndërtojnë një sistem, ku ata të jenë si Byroja Politike, me mendime të ndryshme por, gjithsesi, të gjithë bashkë. Kështu ata do të jenë me prona e me parti të vetat dhe, të gjithë shqiptarët e tjerë, të jetojnë si bujkrobër në pronat e tyre, me lejen e tyre, nën hyqmin e tyre e nën frikën e pushtetit të tyre në një katund gjigand. Ky është sistemi ideal i parisë.

Si duhet trajtuar kjo pari e çfarë duhet bërë me të?

Paria e vërtetë e një populli është ajo pari që e shkrin jetën, pasurinë, dinen e vlerat për popullin e vet. Këta janë elita e vërtetë, të zgjedhurit, ata që e meritojnë, sepse punojnë për popullin e tyre, si për shembull, njerëz si Adem Demaçi në Kosovë. Kombi shqiptar ka pasur shumë heroj të tillë. Ka shumë e shumë familje e individë që e kanë shkruar pasurinë, jetën, familjen, e dhanë gjithçka që kishin për kombin e tyre. Shumë prej njerëzve ju mjafton të kthehen e të shohin rrugën e prindërve e të parëve të tyre, për të kuptuar se këtë herë diçka nuk funksionon si duhet. Rruga ku po ecet sot është një rrugë që të çon në skllavërim dhe sundim të parisë.

Ka shumë mënyra për të rezistuar, por ka vetëm një rrugë që, po u ndoq me konsistencë, e thyen këtë pari dhe sistemin e

ndërtuar prej saj. Ajo rrugë kërkon që shoqëria të shkëputet nga 'helmi që paria kërkon t'ia hedhë në bukën e përditshme,' në nderin e familjes e në respektin për vete. Ka një hap të parë që edhe pse shumë i mundimshëm duhet hedhur se s'bën. Lufta e rezistenca kundër kësaj partie fillon si rezistencë morale. Ajo fillon e vazhdohet duke iu shmangur pa mëdyshje sjelljeve degjeneruese e çnjerëzore të cilat i promovon paria. Ajo luftë e rezistencë ndaj së keqes, vazhdon e intensifikohet duke luftuar për t'u lidhur me njeri-tjetrin si njerëz e si shqiptarë, duke iu shmangur strukturave të krimit e mendësisë kriminale, duke respektuar e njohur njerëz e bij e bija të popullit që mund e duan të bëjnë mirë për kombin. Atëherë e vetëm atëherë parisë do t'i dridhet toka nën këmbë dhe krimi i saj do të dalë sheshit sepse do të kuptohet qartë që paria e Tiranës nuk i ka rrënjët aq të thella sa duket në sipërfaqe. Figurativisht, dheu i mban rrënjët bashkë, por janë edhe rrënjët që e mbajnë dheun bashkë gjithashtu.

Çka e mban gjallë e të fortë parinë, nuk janë paratë e pronat që ka, fuqia politike apo mjetet propagandistike që ajo ka në dispozicion. Në shtetin shqiptar askush nuk e ka pasur as pronën as kokën të sigurtë ndonjëherë. Ajo që e mban gjallë parinë është mendësia e gabuar e popullit. Po filloi populli shqiptar që të ndrrojë mendje e t'i shohë partitë politike ekzistuese si kartelet kriminale të parisë, do të jetë hedhur një hap shumë i rëndësishëm përpara. Po t'i shohë populli politikanët si gjarpërinj që duan vetëm të hedhin helm në jetën e tyre, do të mundohet që të mbrohet prej tyre. Po t'i shohë bizneset e klaneve të Tiranës si rrjetën e merimangës monopoliste që po ia merr frymën të ardhmes së tyre ekonomike do të motivohet për të kërkuar zgjidhje të tjera. Po t'i konsiderojë populli komentatorët, fjalamanët e grafomanët e kënetës së Tiranës si gjuhë e zgjatur e klaneve të parisë kriminale, atëherë çdo gjë që thuhet prej tyre do të shihet me dyshim. Atëherë, me identifikimin e së keqes, do të bëhet një hap i madh përpara drejt shërimit të sëmundjes morale, materiale, politike, e të mungesës së vlerave që i ka kaplluar shqiptarët.

PSE NUK KA PARTI NACIONALISTE EFEKTIVE NË SHPETIN SHQIPTAR?

Në shtetin shqiptar të gjitha grupet e pakicat e njohura kanë partitë e tyre, ose parti të cilat kontrollohen prej tyre. Tashmë në shtetin shqiptar, paradoksalisht, ka parti politike efektive të të gjitha komuniteteve me përjashtim të vetë shqiptarëve. Nga një anë kemi partinë e grekëve. Nga një anë tjetër, tashmë kemi edhe partinë e komunitetit rom. Në mes të ekstremeve të tilla ka të paktën 30 parti që pretendojnë të mbrojnë interesat e shqiptarëve, ose si pjestarë të një bashkësie si bie fjala, partia e çamëve të përzënë me dhunë nga Çamëria. Këmi edhe parti që pretendojnë të mbrojnë interesat e shqiptarëve si komb. Edhe këto janë parti me emra pompozë, me kryetarë, me seli, me prezencë mediatike, dhe me vula, por pa anëtarë.

Mirëpo, paradoksi është ky: partitë e pakicave ia dalin të marrin thujse të gjithë votat e grupit të tyre etnik. Po ashtu, ato ia dalin që të kenë nga dy-tre vetë të tjerë nga grupi i tyre etnik në listat e partive kryesore, në mos në krye të tyre. Nga ana e tyre, partitë e ashtuquajtura etnike shqiptare, të gjitha bashkë, marrin më pak vota se partia e grekëve. Të gjitha partitë shqiptare bashkë kanë më pak anëtarë se Shoqata e Smokthinës në Tiranë.

Në të gjithë botën, partitë me program kombëtar marrin një numër të konsiderueshëm votash. Edhe partitë ekstremiste nacionaliste në vendet kryesore të Europës Perëndimore marrin rregullisht 10-15 përqind të votave. Në Ballkan, në të gjitha vendet partitë me program nacionalist janë ose në timon të shtetit (Greqi, Maqedoni, Mali i Zi, Bosnjë) ose janë partia më e madhe dhe më e fuqishme por në opozitë (Kroaci, Serbi). Pra, mungesa

e mbështetjes për partitë me program nacionalist në shtetin shqiptar duhet analizuar me shumë qetësi. Pse shqiptarët janë një shembull *sui generis*? Duke qënë se jemi në këtë gjendje, ne mund të japim një shembull që duhet ndjekur nga të tjerët se si ta shohin edhe ata veten si qytetarë euroatlantikë dhe të modernizuar. Shqiptarët duket se nuk kanë ndjenja kombëtare. Politikisht, ata nuk e shohin veten si pjesarë të një grupi të caktuar etnik.

Ka disa shpjegime pse ndodh kjo gjë por në fund të fundit të gjithë shpjegimet përqëndrohen ose tek populli ose tek paria. Kështu, nga njëra anë na thuhet se shqiptarët nuk janë nacionalistë. Paria don të na bindë se të gjithë shqiptarët janë euroatlantikë të thekur. Por kjo është pak problematike. Si provë do të përmendja se sa herë që luan Përfaqësuesja e Futbollit, që nuk humbet gjithë kohën, shqiptarët e shprehin vetëdijen etnike me një entuziazëm problematik. Kjo ndodh jo vetëm në Tiranë, por edhe në Itali, Greqi, Gjermani e kudo që ndodhen ata. Ka pasur shqiptarë që i kanë therur si berrat sepse, edhe në mes qyteteve të Greqisë, apo edhe në ishujt si Zakynthos, kanë shprehur krenarinë për kombin e tyre dhe e kanë quajtur veten shqiptarë.

Po ashtu, numri i shoqatave shqiptare jashtë shtetit ka ardhur duke u rritur me shpejtësi marramendëse. Klube, organizata dhe shoqata nacionaliste e patriotike, ka me shumicë gjithkund si në SHBA, por edhe në Angli, në Gjermani, Zvicër, Itali e Greqi. Të bëjnë përshtypje librat e gazetatat e shtypura nga mërgimtarët shqiptarë në Greqi, revistat, botimet, gazetatat e aktivitetet që zhvillohen, konferencat e takimet që organizohen gjithkund e me një intensitet të lartë. Të bëjnë përshtypje shkrimtarët shqiptarë, që mezi e fitojnë bukën e gojës, duke bërë punë të rëndomta. Megjithatë, ata duan të jenë pjesë e kulturës kombëtare shqiptare, duke bërë sakrificat të panumërta.

Nuk duhen harruar studimet e pafundme nga studentët shqiptarë, që duan të jenë e të ndihen shqiptarë dhe që në rrugën e karrierës së tyre zgjedhin të studiojnë kombin e tyre, duke ngushtuar mundësitë e tyre për avancim në karriera akademike. Ka shumë shqiptarë që janë kthyer për të punuar e jetuar në Atdheun e tyre, të motivuar nga dëshira për t'i shërbyer kombit të

vet. Ka të tjerë që kanë rënë heronj me armë në dorë si Indrit Cara. Ka të tjerë që nuk dinë se si ta shprehin vetëdijen kombëtare, por e vënë flamurin kombëtar në ditët e festave kombëtare në majë të pallateve, ku ndoshta punojnë e pastrojnë plehërat gjithë ditën, si mbikqyrës ndërtesash. Ata mundohen fort që të jenë shqiptarë, njerëz të mirë, me identitet, e me vlera kombëtare. Nëse të gjithë shqiptarët janë patriotë të fortë jashtë shtetit e aspak patriotë kur kthehen në vendin e tyre, kjo do të thotë se problemi nuk është me shqiptarët si grup etnik. Shkaku për këtë mungesë të nacionalizmit në politikën shqiptare duhet kërkuar diku tjetër.

A mos janë të ndryshëm shqiptarët janë shtetit me shqiptarët që jetojnë në shtetin shqiptar? Siç e thashë më lart, edhe brenda shtetit shqiptar ka shprehje të larta të patriotizmit. Për shembull, mbështetja për Kombëtarën është një shembull i qartë i nevojës që kanë njerëzit për t'u ndjerë shqiptarë e për ta shprehur identitetin e tyre. Krenaria që njerëzit duan të ndejnë për Tiranën e Durrësin si kryeqytet e si plazh, për aeroportin e Rinasit, apo për Rivierën Shqiptare janë po ashtu shprehje të ndjenjës kombëtare. Pra, problemi nuk është tek shqiptarët. Nga ana e tjetër, fajin nuk ia vëmë dot sistemit politik që mund t'i penalizojë shqiptarët dhe t'i pengojë që të organizohen si parti politike. Fakti që atje ka mbi tridhjetë parti etnike shqiptare, tregon se po u organizove, ligji të lejon të veprosh si strukturë politike. Mungesa e suksesit të partive kombëtariste shqiptare duhet kërkuar tjetërkund.

Pyetja, që duhet bërë, është se kujt ia japin votën shqiptarët e pse ia japin votën? Shumica e shqiptarëve në shtetin shqiptar ia japin votën partive politike të kryesuara nga njerëz me mangësi të theksuara, me mungesë besueshmërie e të vërtetuar si njerëz problematikë. PD e PS, dy partitë që marrin më shumë vota dhe që vijnë të dyja nga PPSH-ja, janë të drejtuara nga Edi Rama dhe Sali Berisha. Ky i fundit është me të vërtetë një rast emblemantik. Edhe pse këtij i janë faturuar e do t'i faturohen krime të përbindshme, e tash së fundi edhe Gërdeci, aleancat me Fazliçin, serbët, malazezët, grekët e, mbi të gjitha, kriza e vitit 1997, prapë se prapë, të paktën një e katërta e votuesve shqiptarë e mbështet Sali Berishën me një vendosmëri të madhe.

Duke qenë se programet politike të partive në shtetin shqiptar janë thjesht fjalë në erë e përralla të pazbatueshme, dhe duke ditur se liderët e tyre janë njerëz me probleme, shpjegimi është tek teknika e mobilizimit. Prandaj, kyçi i shpjegimit është paria. Shpjegimi është se, në shtetin shqiptar, paria politike e Tiranës lufton me të gjitha mënyrat që të shmangë mendësinë e vlerat kombëtare. Ajo i ka organizuar partitë politike të sillen e veprojnë si instrumente të interesave të saj. Partitë i mbrojnë interesat e klaneve të parisë, që nga ana e tyre, veprojnë si kartelet kriminale. Paria e ka mendjen vetëm tek pasurimi e fuqizimi i saj. Asaj nuk i intereson shërbimi kombëtar dhe e ka kuptuar se shqiptarët sundohen kur përçahen mirë e mirë. Duket se ky është çelësi i suksesit të parisë dhe i dështimit të të tjerëve dhe i nacionalizmit shqiptar.

Po shqiptarët, pse e ndjekin parinë? Paria i mban shqiptarët peng, duke i detyruar që të jetojnë në të shkuarën, e të shesin të ardhmen e tyre për të gjetur fajtorin, herë real e herë imagjinar, për mjerimin që kanë kaluar nën një diktaturë ose nën një tjetër. Aftësia e parisë ka qënë që të mos e lerë plagën të mbyllet, por ta cingrisë metodikisht sepse, “ku dhemb dhëmbi, shkon gjuha,” thotë populli. Dhe, nga ana e vet, paria e Tiranës e krijon dhe e mban gjallë realitetin absurd ku jetojnë shqiptarët duke i mëshuar të shkuarës rregullisht e sistematikisht. Paria vepron kështu, sepse e di që, për sa kohë që njerëzit janë peng i së shkuarës individuale, shqiptarët nuk do t'i shohin ata si shkaktarë të tragjedi kombëtare. Duke mos i identifikuar ata si problemin kryesor, njerëzit nuk do të mobilizohen, si njerëz e si shqiptarë, për të luftuar për të ardhmen e tyre, për një jetë më të mirë, më të sigurt e me dinjitet si gjithë kombet e tjerë.

“DJALLI DHE SHISHJA”: PROBLEMATIZIMI I MENDËSISË SË PARISË SË TIRANËS

Një nga paradokset e shtypit është se, edhe pse nuk ka problem më të madh për shqiptarët se ai i parisë, nuk ka problem që është trajtuar më me ngathtësi e aq përciptazi se sa ky në shtypin e përditshëm të Tiranës apo në studimet profesionale të tranzicionit. Këtu do të përqëndrohemi shkurtimisht vetëm në disa prej tyre. Kryesisht, do të fokusohemi në problemin që paraqet mendësia e parisë si shtresë kompakte dhe e dallueshme e shoqërisë shqiptare në këtë tranzicion.

Problemi i djallit dhe i shishes: sjellja e parisë në kontekste të ndryshme

Për ta zgjeruar pak, por edhe për ta qartësuar argumentin, në lidhje me parinë, duhet të bëjmë një dallim të madh. Përralla e xhindit në shishe (në rastin e parisë së Tiranës, djalli në shishe, është më i përshtatshëm) na ndihmon që të kuptojmë më mirë sjelljen e saj, komplekset me të cilat përballet dhe përse paraia është një problem kaq i madh për ne. Shkurt, sa është në shishe, xhindi lutet për lirinë e vet. Sa del nga shishja, na kërcënon me jetë. Ky është edhe problemi shumë interesant i dualitetit të sjelljes së parisë.

Kështu, për të kuptuar këtë sjellje, diferencimi duhet bërë midis personave, d.m.th., të individëve të veçantë nga një anë, dhe të grupit e të sistemit sundues të vlerave që e lidh e ngjiz atë grup bashkë dhe që i jep atij karakteristikat e një lukunie hienash e stërvinash politike nga ana tjetër. Ia vlen ta shtjelloj këtë idenë e

dyqenësisë dhe të sjelljes idiosinkratike brenda parisë, sepse kjo e ilustron qartë me kë kemi të bëjmë.

Paria sillen në dy mënyra të ndryshme. Kur janë në Tiranë, ata sillen si pashallarë orientalë, d.m.th. djalli ka dalë nga shishja dhe e ndjen veten se është tepër i fuqishëm. Kur janë jashtë shtetit sillen si intelektualë. Në shtete të tjera, djalli e di që s'ka asnjë pikë fuqie, përveç vendit që i krijon vetes në një shoqëri në të cilën, edhe pse e njeh pushtetin, ai nuk ka mundësi të ndikojë për gjë. Pra, dualizimi më i frikshëm, por edhe njëkohësisht edhe më i prekshëm i sjelljes së parisë është ai i sjelljes së tyre si individë të veçantë në kontekste private e jashtë vendit, e mandej si pjestarë të grupit të parisë në Tiranë, në politikë e në fusha të tjera të jetës.

Kur shihet si sillen, e kur takohen vetëm për vetëm ose kur janë të shkëputur nga konteksti i parisë së Tiranës, të gjithë pjestarët e parisë sillen si individë relativisht të edukuar mirë ose shfaqin në sipërfaqe, të paktën, vlera e mënyra sjelljeje të njerëzve të edukuar mirë, me kulturë e me maniera. Të gjithë kthehen në atë guackën ku ishin mbledhur në kohën e sistemit të mëparshëm kur vetëm duke qënë të sjellshëm, të edukuar dhe të bindur deri në ekstrem ndaj rregullave e normave të vendosura, ata mund të ecnin përpara. Nga ana tjetër, kur iu duhet të sillen në rrethet shoqërore e politike të Tiranës, po të njëjtët individë sillen si pjesëtarët e tjerë të parisë. Atëherë, shfaqen të gjitha simptomat e sjelljes së jeniçerëve. Secili prej tyre bëhet fodull e arrogant, ku egërsia, pabesia, pandershmëria, sjellja imorale dhe amorale janë normative e përcaktuese. Atëherë del gjarpëri nga lëkura.

Në se si individë ata dinë që të sillen e sillen mirë, por si grup sillen shumë negativisht, problemi është tek lënda që e ngjiz dhe e mban grupin bashkë. Ajo që e mban parinë të lidhur fort me njëri-tjetrin janë mendësia dhe vlerat e përbashkëta që ndajnë. Mandej vijnë interesat dhe aspekte të tjera komplekse të marrëdhënieve të tyre klanore e personale që shfaqen në të gjithë format e mënyrat e mundshme. Por, që të gjitha burojnë prej mendësisë së tyre.

Kur janë të vetëm si individë e jashtë kornizës së shoqërisë së Bllokut të Tiranës, sjellja e pjestarëve të parisë është normale. Në raste të caktuara, është tejet impulsive, fine, dhe me klas. Këtë

ndryshim e dyftyrësim, e kemi parë qartazi kur dalin jashtë shtetit, kur takohen me të huajt, ose kur janë në kushte inferiore. Ka qënë një kohë, sidomos në fillimet e tranzicionit, kur mjaft prej pjestarëve të parisë që fituan *Green Card*, iu është dashur që të bëjnë shumë punë të rëndomta, të fillojnë që të lajnë pjatat, të bëhen roje dere, ose të shesin gazetatat në vendet e huaja, sepse vetëm atëherë e kuptojnë se sa pak mund të funksionojnë në një shoqëri tjetër. Këta kthehen shumë shpejt tek guacka e sjelljes qytetare e normale. Kur janë në Tiranë, metamorfozën e sjelljes së tyre e shohim, në veçanti, kur ata takohen me diplomatë të huaj. Ka diçka që iu ngjall instinktin e shërbëtorit besnik, një ndjesi që ata nuk i rezistojnë dot, por që e shfaqin me shumë zell në përunjësinë ndaj të huajve, sikur janë duke kërkuar zot. Por, në momentin e parë që ata individë hypin në pushtet, në momentin kur iu duhet që të japin e marrin me shqiptarët, ose edhe me njëritjetrin, pjestarët e parisë shfityrohen dhe sillen sikur vijnë nga lloji më i keq i rrugaçëve e cubave të rrugës. Atëherë djalli del nga shishja. Të gjithë djajtë dalin nga shishja dhe prandaj vendi kthehet në një ferr të vërtetë.

Pra, problemi kryesor e thelbësor për parinë, si dhe për ne të tjerët, nuk është shuma e problemeve vetëm të individëve që janë pjestarë të saj. Problemi kryesor i tyre janë vlerat identike të shtresës, mendësia e përbashkët, thuajse uniforme që ndajnë, standardet e sjelljes që admirojnë, morali i kulisave që emulojnë dhe modelet e gangsterëve, që me aq zell i imitojnë, si në jetën publike, ashtu edhe në atë private e në marrëdhëniet me njëritjetrin. Në këtë kontekst, urrejtja e thellë që shumica e tyre shfaqin për të gjithë shqiptarët si popull, “këta pisa”, etja për gjëra materiale dhe sjellja e paskrupullt dhe tejet e pamoralshme edhe në lidhje me familjen e vet, karakteristike për shtresat e ulta të çdo shoqërie, janë shenjat më dalluese të saj. Nuk duhen futur të gjithë në një thes, sepse edhe në këtë shtresë ka individë me vlera e të spikatur, por ja që shumica sillen në këtë mënyrë e në këtë nivel.

Nga vjen ky dualizëm në vlera e në sjellje?

Nga vjen kjo sjellje e ky dualizëm i mendësisë së parisë? Nga një anë, janë origjinat katundare, një argument që e kam shtjelluar në një shkrim tjetër. Nga ana tjetër, duke pasë kaluar ata vetë në disa prej atyre përvojave, mendoj se dualizimi i këtyre individëve e ka origjinën në kohën kur, edhe pse në moshë të njomë, këta ishin duke u përpunuar e duke u deformuar për t'i shërbyer sistemit të Hoxhës; ca se nuk dinin rrugë tjetër, ca nga halli, ca të tjerë në miopine e gjetjes së një alternative e shumë të tjerë me bindje e me vetëdije të plotë.

Mbas vitit 1990, këta u liruan nga zinxhiri i një shteti të fortë e ndrydhës, siç ishte ai i diktaturës së kaluar. Kështu, në vend që të shërbenin me devotshmëri e të luftonin, që të bëheshin elitë e mirëfilltë, njerëz të respektuar e zotërinj të nderuar nga populli i tyre, duke e ndihmuar me dijen e përvojën që kishin e duke e drejtuar popullin shqiptar në atë rrugë ku duhej, këta u turrën që të imitonin rrugaçët, matrapazët e gangsterët e lagjes. Si fillim, e bënë shtetin copë-copë, e shkatërruan ekonominë, e shtynë shoqërinë të luftojë kundër vetes, filluan të përdorin etiketime e dasi vdekjeprurëse por gjithnjë në shërbim të interesit të tyre të ngushtë. Shumë shpejt u kuptua se ajo sjellje *pro forma*, që deri atëherë iu shërbente që të ngjisnin shkallët e karrierës, në shtetin e atëhershëm, fshihte njerëz të deformuar deri në nivele të pakorigjueshme.

Paraqitja e tyre me familje të qëndrueshme, të përmbajtur, me partishmëri, me kulturë të gjerë letrare e muzikore ishte domosdoshmëri për të qenë dikush në shoqëri. Kur u ndrrua sistemi, u pa se kjo kulturë ishte tejet e cekët, nuk kishte zënë rrënjë e nuk i kishte ndryshuar si persona. Paraqitja intelektuale ishte vetëm një lustër, që mbulonte përbindsha të untuar dhe të frikshëm. Përtej lustrës së hollë të intelektualit e të zyrtarit besnik të shtetit, fshihej një njeri i vogël pa vlera, pa ndjenja e pa kurrfarë morali. Shumica ishin arrivistë, intrigantë, mashtrues të niveleve më të ulta e njerëz pa pikën e ndjenjës së shërbimit publik. Përtej lustrës së intelektualit të shquar dhe

të përkushtuar në zbatimin e normave të sjelljes të vendosura nga paria enveriste fshihej katundari konviktore që nuk i ikte dot untisë, pasigurisë në lidhje me sjelljen e vet, dhe dëshirës me kenë i pari i katundit, me çdo kusht e me çdo mjet. Kjo u pa qartë gjatë sjelljes së tyre në tranzicion.

Si u soll paria gjatë tranzicionit?

Si u sollën paria e Tiranës, grupi i zgjedhur i profesorit, dhe “intelektualët e shquar” kur u ndrrua sistemi? Sapo iu dha mundësia më e vogël, ata u turrën, si jeniçerë të vërtetë, e nuk lanë gjë pa bërë, për t’u bërë, sa më shpejt, Enver Hoxhë e Ali Pasha të vegjël. Këta ishin madërgonat e sistemit që u shemb. Objektivi i kësaj çorbe parie me origjina shumë të dyshimta etnike, klasore, fetare, e krahinore, që mbahej në këmbë nga frika shpatës së Partisë, ndryshoi brenda natës. Nga shërbëtorë të bindur të një sistemi totalitar, ata u turrën për t’u bërë pjesë e borgjezisë së madhe ndërkombëtare. Në këtë rrugë ata nuk lanë krim pa bërë. Çka është më e keqja, të gjithë krimet i kanë bërë me vetëdije e me ndërgjegje të plotë.

Jeniçerët duan perandori me sundue. Dhe këta nuk mund të bënin përjashtim. Endrra e tyre e vjetër dhe e njëjtë ishte dhe mbetet t’ia kalonin edhe Bill Gates me pasuri e me prona, edhe pse të gjitha pronat e tyre janë të vëna me gjakun e shqiptarëve dhe janë, as më shumë e as më pak, përfituar si rezultat i sjelljes së tyre pastërtisht kriminale. Ata u nisën, të bindur, që duhej të vendosnin kapitalizmin. Ata e vetëm ata duhej të bëheshin borgjezia, ndërsa ne të tjerët do të ishim proletarët e skllëverit e tyre. Përbuzja e thellë që këto shërbëtorë të deridjeshëm ndjenin për të gjithë shqiptarët si komb u manifestua në sjelljet e tyre ordinere e kriminale gjatë e mbas përmbyesjes së sistemit.

Kështu, në vend që të dilnin e ta udhëhiqnin popullin në momentin më kritik të mundshëm të historisë, duke sakrifikuar gjithçka e mandej të njiheshin përjetë si bij të nderuar të një populli të vuajtur, pa zgjidhje e pa dije për zgjidhjen e vërtetë, këta individë të untuar për gjëra materiale, për sende e mallra

gabelësh, të deformuar në vlerat e tyre, tamam si jeniçerë e bashibozukë të vërtetë, adaptuan botëkuptimin dhe moralin e shtresave që jetojnë në skajet e shoqërisë normale. Kështu doli fytyra e tyre e vërtetë prej njerëzish me dije por pa jetë brenda vetes. Këto karakteristika mikroborgjeze e katundare janë manifestuar në një urrejtje të thellë për shtetin, për tjetrin, dhe në një dëshirë të çmendur për të mbledhur para, prona, dashnore e pushtet dhe për të shtypur të tjerët.

Po ashtu ata adaptuan e internalizuan edhe konceptet e normat e sjelljes së këtyre grupeve të skajshme në krye të të cilave edhe u vunë e në krye të të cilave janë ende, ndonëse edhe sot e emërtojnë megalomaninë e tyre si militantë, aktivistë, vullnetarë, qëndrestarë, etj. Është e habitshme se si e gjithë paria e Tiranës u drejtua tek rrugaçët e gangsterët, që ishin e u manifestuan të ishin lumpeni e llumi i shoqërisë shqiptare. Gjithsecili politikan e kishte një gangster të Tiranës mbas vetes. Për ta ishte krenari me u pa në shoqërinë e këtyre tipave. Edhe më e habitshme është se si ata vendosën të adaptonin mendësinë e rrugaçëve, duke u kthyer vetë më rrugaçë se rrugaçët. Prototipi i kësaj sjelljeje rrugaçërore ishte Azem Hajdari. Por të gjithë të tjerët kishin bandat e tyre. Sali Berisha kishte një numër të pakufizuar tipash të tillë në dispozicion. Fatos Nano kishte disa të tjerë, e kështu me rradhë.

Për të dhënë një shembull anekdotik, vetëm në shtetin shqiptar, paria dhe elementët përbërës të saj, në të gjitha nivelet, e quajnë njëri-tjetrin, e disa e kanë për nder t'i quash "99-sh", "dobiç" "bir k..." ose flasin me shprehje të tjera të rrugës si "zar", "njësh", e me radhë. Gjithkund tjetër, në çdo vend të botës, edhe kur janë të tillë, ose kur vijnë nga origjina të tilla të dyshimta, paritë sunduese luftojnë t'i ikin asaj stigme. Edhe mafiozët i thonë vetes dhe aspirojnë të jenë *uomo d'onore*, por në shtetin shqiptar duhet të ndjehesh shumë i nderuar po të jesh "dobiç i madh" ose "këlysh k...". Është mjerim i vërtetë për një popull që të sundohet e të përfaqësohet në botë nga njerëz të tillë.

Cilat janë rrënjët dhe pasojat e kësaj sjelljeje?

Kjo mendësi e dyfishtë, idiosinkratike, buron nga morali i trashëguar nga sistemet e mëparshme dhe mendësia sunduese e parisë. Mendësia sunduese e parisë ka qenë për shumë kohë, mendësia e skllëvërve, që nuk e dinë se çka do të thotë të jesh zotni, që nuk mund të bëhen zotërinj, e që, çka është më e keqja, pavarësisht se të veshur me pushtet e me pasuri, mbesin në shpirt ish-skllëvër, qole e jeniçerë, gjithnjë pa zotnillëk. Problemi është sepse mendësia e skllëvërve përcakton edhe idenë që ata kanë për shoqërinë. Ëndrra e përjetshme e skllavit është që të bëhet mbikqyrës i skllëvërve, apo si thuhet, “ëndrra e skllavit nuk është liria, por një skllav për veten e vet.” Kjo ishte dhe mbeti ëndrra tragjike e parisë edhe gjatë tranzicionit.

Ky nuk është standardi i sjelljes së elitës së vërtetë, me rrënjë në shoqërinë që drejton, me vlera të spikatura dhe me vetëdije shoqërore. Me metrin që elita e vërtetë e kombeve të tjera e mat veten, në të vërtetë, nuk ka rëndësi shuma e parave që ke, nuk ka rëndësi se çfarë posti të lartë mban, nuk ka rëndësi se si e sheh veten ti, por se kujt i bën mirë ose dëm sjellja e jote. Atyre që iu bën mirë, ata do të të nderojnë. Atyre që iu bën dëm, do të të mallkojnë. Çdo njeri që merr vendime politike duhet të jetojë me këtë zgjidhje që bën, *qui bono* e sjelljeve të mia? Gjithkund, paritë e ndjejnë shtërngesën e shtetit, por në shumë raste janë të vetëdijshëm se duhet të ruhet edhe shtërngesa. Shpesh, rregulli shoqëror i moralshëm është në dobi të vetë parisë.

Duhet thënë se paria e jonë sunduese ka vepruar në mënyrën më të keqe të mundshme. Për të arritur objektivat e saj, ajo nuk ka pranuar asnjë lloj shtërngese, që vjen në formën e rregullit shoqëror. Prandaj, në sytë e shumë shqiptarëve, paria, e organizuar sërish si orta e jeniçerëve dhe këshilli i të urtëve të bashkësive të mileteve dhe e përbërë nga legjioni i pretorianëve të Enver Hoxhës, i ka larë duart me gjak dhe ka përgjegjësi të mëdha historike për dështimin kombëtar. Për të arritur qëllimet e veta, paria e Tiranës ka dashur dhe kërkon të ecë me vetëdije të plotë mbi sakrificat e mjerimin e të gjithë shqiptarëve. Ata kanë shkelur pa mëdyshje

mbi gjakun e shqiptarëve por, mbi të gjitha, mbi nderin e vajzave shqiptare, që ata i kanë hedhur të shiten rrugëve të botës. Do të vijë koha kur edhe ata do të përballen me krimin e tyre. Asnjë komb me ndërgjegje nuk mund të ketë mëshirë për një pari të tillë e për pinjollët e tyre. Si mund të rrisësh fëmijë e të mbash një familje të shëndoshë me paratë e krimit, të drogës, të trafikut e të prostitucionit? Ashtu si thotë populli, “atë që hedh në det do ta gjesh në kripë” dhe “atë që mbjell në jetë do ta korrësh në jetën e fëmijëve”. Pra, sjellja e prindërve do të reflektohet edhe në sjelljen e fëmijëve të tyre. Mënyra se si paria po vepron me fëmijët e vet, sidomos në fushën e edukimit, të përvojave dhe të punësimit, është treguese për rrugën ku presin që ata të ecë brezi i ri i trashëgimtarëve të saj.

Po ashtu, në rastin e parisë, asaj i duhet bërë e qartë se nuk të bën elitë pasuria. Paratë, vetëm paratë nuk bëjnë zotëri askënd. Ato të blejnë shërbyes, por jo besnikëri të njerëzve. Shefqet Vërlaci kishte para, por ecte rrugëve të Evropës me një strajcë me florinj në kurriz, e hante me gishta në mes të Parisit dhe trajtohej si një dallkawk i vërtetë. Edhe shumë ministra e zyrtarë të shtetit shqiptar gjatë tranzicionit, me sjelljen e tyre, kanë lënë një emër jo të këndshëm nëpër botë. Andreë Carnegie mbahet mend se si i fitoi paratë duke shfrytëzuar deri në fund, e pa mëshirë, punëtorët e minoritet. Por Carnegie mbahet mend edhe më shumë, se si të gjithë pasurinë e tij e la për vepra bamirësie. Në Tiranën e sotme, Carnegie do të trajtohej si i marrë. Një shembull domethënës e sjell poeti i talentuar Agron Tufa në përshkrimin e një takimi për mbledhje fondesh për kulturën,

“Në vitin 2003 kam pasë botuar një shkrim me titullin ‘Revista letrare ‘Aleph’ dhe 60 biznesmenë në një’. Thelbi ishte ky: një ndër revistat më cilësore në Shqipëri lëshon thirrjen SOS dhe rrezikon të mbyllet për arsye financiare. Në këto kushte, kryeredaktori i saj, poeti Gentian Çoçoli, me ndihmën dhe mbështetjen e Ismail Kadaresë u bën një ftesë 60 biznesmenëve shqiptarë në një takim në hotel ‘Sheraton’. Përfundimi: prej të gjashtëdhjetëve u grumbulluan... 60 euro! Në thelb parallinjë tanë, që harxhojnë 2 milionë euro për të sjellë, fjala vjen ‘Realin’

apo 'Milanin' në Shqipëri, për një natë, nuk denjojnë të japin as 2000 për një numër reviste."- kujton Tufa."

Po ashtu, paria nuk arrin ta kuptojë se ajo që të bën elitë, e jo vetëm pari që sundon, është shërbimi publik. Nuk është vila në Tiranë e as dashnorja që e mban me rrogë, as Ferrari, as Benzi, as jahti, as hoteli me pesë yje ku shkon me pushime me miliarderët e botës. Ajo që të bën zotni e që të bën elitë të vërtetë (jo thjesht pari) është vetëdija se kur të vdesësh ke nevojë vetëm për dy metra dhe, për një varr ku do të varrosesh. Ajo që të bën elitë është nevoja për kujdesin e respektin e njerëzve, edhe të panjohur, të cilëve ti iu shërben me punën e me jetën tënde. Kur jeton e punon gjithë jetën me këtë shqetësim në mend, ti iu lë njerëzve tuaj një kapital moral që është i paçmueshëm. Kur sillesh kështu, atëherë je dikushi ose bëhesh dikushi për popullin tënd.

E sa për bindjen e tyre se koha i fshin e i mbulon të gjitha poshtërsitë, njerëzit nuk janë më aq të painformuar apo të paedukuar si dikur. Krimet lënë gjurmë. Sot, krimet e tyre janë në faqet e gazetave dhe kujtesa e njerëzve nuk fshihet lehtë. Atë që njerëzit nuk ta thonë në sy, njerëzit e fshehin në mendjen e tyre dhe, ashtu si parive të tjera që u zhdukën nga dheu në kohët e shkuara, edhe këtyre që sundojnë sot, ka me ardhë koha të ia kujtojnë se kush janë. Edhe pse këta mendojnë se ia kanë hedhur, dhe se askush nuk do të merret me ta, si të gjithë të tjerët përpara tyre, edhe këta do të përfundojnë një ditë në varrezën e historisë së shqiptarëve.

A mund të ndahet paria e Tiranës nga mendësia e saj kriminale?

Futja e djallit në shishe, d.m.th. ndarja e individëve të parisë nga mendësia e saj si shtresë kriminale dhe ristrukturimi i saj është edhe njëri ndër problemet kyçe të tranzicionit. Çështja themelore është si të gjendet mënyra që të ndahet paria nga kjo mendësi kriminale e gjithë shtresës? Si është e mundur që të futen në binarët e sjelljes normale këta njerëz që, po vazhduan në këtë

rrugë, do të përçudnohen edhe më shumë? Si mund të bëhen të dobishëm ata, për vete e për të gjithë shoqërinë? Nëse ata janë të aftë të funksionojnë në struktura e në vende të tjera, si mund të funksionojnë ata në shtetin shqiptar?

Nuk është se ata kanë nevojë për të dëgjuar mendime të ndryshme, e kështu, do të binden se mund të ndërrojnë rrugë. Ata e dinë mirë se çka po bëjnë. Ata janë të ndërgjegjshëm që po bëjnë krim të përbindshëm ndaj të gjithë shqiptarëve. Edhe pse e kanë vendosur një mur mendor që i shkëput nga realiteti, praktikisht duke e ndarë veten nga shqiptarët, është e pamundur që të mos jenë të vetëdijshëm për krimet e për poshtërsitë e veta. Por nuk janë ende të bindur se kjo rrugë ku janë duke ecur është një rrugë pa krye. Duke justifikuar sundimin e sjelljen e vet, ata i shohin shqiptarët si një popull që ka qeverinë që meriton, d.m.th., sundimin e tyre. Por, nga një anë tjetër, e vërteta është që shpesh shumë prej tyre as nuk e dinë e as nuk e marrin me mend se çfarë pasojash do të kenë sjelljet e tyre të tanishme për veten, për fëmijët e për familjet e tyre. Untia e tyre, ua ka errur sytë dhe këta motivohen nga tahmaja e fitimit.

Shkurt, pa e zgjidhur këtë problem të mendësisë së parisë që, kështu si është, kërkon që të thithë me çdo kusht edhe pikën e fundit të pasurisë kombëtare e të fshijë çdo shenjë të nderit të shqiptarëve, ne si shqiptarë nuk do të mund të ecim kurrë përpara. Lufta, pra duhet bërë me këtë mendësi të njerëzve të deformuar që janë në krye të shtetit, thjesht sepse ata nuk po e trajtojnë shtetin e popullin në mënyrën që duhet. Ata nuk po e drejtojnë popullin në rrugën ku duhet. Ata vetë janë problemi që ose duhet të zgjidhet, ose të eliminohet me metoda të njohura e forma demokratike. Djalli duhet futur në shishe dhe paria duhet të kufizohet në sjelljen e saj nga një rregull i fortë institucional e një shoqëri e moralshme. Kjo më sjell tek problemi i Edi Ramës dhe Sali Berishës, si dhe i të tjerëve, të atyre që janë në krye të ortave jeniçere të parisë së Tiranës, të këtyre tre mijë vetëve që përmbysin kazanin, sa herë që iu shkelen interesat e ngushta të klanit respektiv. Edhe këta janë të kapur në këtë lojë, e për sa kohë që janë në politikë, nuk kanë rrugë tjetër përveçse që të vazhdojnë të sillen kështu si po sillen.

Si e thashë edhe më lart, mendimi im është se lufta duhet të bëhet kundër vlerave e mendësisë së përbashkët të parisë së Tiranës e jo aq kundër individëve të veçantë. Lufta duhet të jetë me vlerat, me shtresën, e me mendësinë e saj. Kur sjellja e shtresës do të bëhet moralisht e shoqërisht e papranueshme, atëherë individët e veçantë do të shkoklohen e do të izolohen vetëvetiu. Kështu si janë strukturat, ata duan që të gjithë duhet që të sillen si rrugaçë e kundërshtia duhet të jetë pikërisht aty. Njerëzit nuk duhet të sillen si duan ata, sepse duke u sjellë ashtu, duke e pranuar atë kod sjelljeje bëhesh si ata.

Fatkeqësia është se nuk janë vetëm strukturat që janë pengesë. Në lidhje me politikanët e prijatarët e parisë, sjellja e tyre tregon se të gjithë janë figura shumë negative e pa vlera morale. Mirëpo, në politikë e në gjykimin politik, që duhet të jetë e është racional e objektiv, aq sa është e mundshme, nuk duhet të hyjnë ndjenjat personale për këto sjellje të tyre si individë. Individu duhet peshuar në lidhje me atë çka përfaqëson.

Këta individë sillen kështu, jo pse mungojnë strukturat por pse iu vjen e natyrshme. Për më tepër, ata mëtojnë që të ndërtojnë struktura të tilla, në të cilat ata mund të funksionojnë si peshku në ujë. Këta janë figura të lidhura pazgjdhshëmrisht me strukturën e krimit, që po ata vetë kanë ndërtuar. Prandaj, individë si Sali Berisha do të luftojnë të mbesin në politikën shqiptare, sa të kenë jetë. Ai dhe të tjerët janë të dënuar që të mbesin në politikë, jo pse nuk e kuptojnë të keqen e jashtëzakonshme që u kanë shkaktuar dhe po u shkaktojnë shqiptarëve. Ata janë të dënuar që të mbesin në politikë, sepse e dinë mirë dhe e besojnë pa mëdyshje, që po dolën nga politika, ata do të kryqëzohen nga armiqtë e tyre personale dhe nga populli. Ata punojnë që të mbajnë gjallë e funksionale një strukturë të tillë kriminale. Jo vetëm ata janë në krye të formacioneve politike e të klaneve të parisë, ata janë kyçet që e mbajnë parinë gjallë, si dhe ndërtuesit e ripërtëritësit e rrjetës së parisë. Ata janë pikat nevralgjike të sistemit, që iu shërben atyre. Për këto arsye, këta nuk do të ndalen para asgjëje. Ata kanë dhënë prova se ecin me parimin *après moi le deluge* d.m.th., mbas meje u bëftë qameti. Por, çmimin e së keqes që vjen prej sjelljes së tyre

gjatë tranzicionit do ta paguajnë të gjithë shqiptarët.

A duhet të merremi me këta individë gjithë kohën? Fatkeqësisht, në politikën që kemi, duhet të merremi me prijatarët partiakë e të parisë. Me ta duhet të merremi edhe si politikanë, edhe si njerëz që, për të mirë a për të keq, kanë mbështetje të madhe në popullin shqiptar. Me ta duhet të merremi edhe si pikat nevralgjike të parisë, me ata që i japin kohezionin e duhur si shtresë, që e rinovojnë dhe e mbajnë gjallë, që i japin mundësi pasurimi e që njohin rrugët e manipulimit të masave të gjëra të popullit që, si pasojë, bëhen pengje të injorancës e të mendjengushtësisë së vet.

Edhe në momentin më të keq politik për Sali Berishën, në vitin 1997, edhe pse ai ka bërë gjëra që një njeriu normal nuk ia rrok mendja, një e katërta e shqiptarëve e ka ndjekur me fanatizëm. Pra, duhet të merremi me Sali Berishën, sepse ai përfaqëson më shumë se vetveten, më shumë se parinë. Sali Berisha, dhe të gjithë prijatarët e tjerë të parisë, janë si rrënjët e pemëve në një pyll të dendur që e mban kënetën kënetë, e që nuk e lënë që të kthehet në një pellg me ujë të pastër. Jo më kot ai ka qënë prijatari kryesor i parisë, si president dhe si kryeministër për 13 vjet. Tashmë Sali Berisha dhe Trusti i Gështenjave që ai kryeson janë pjesë integrale e parisë së Tiranës.

Megjithatë, duhet kuptuar se si funksionon ky mekanizëm mobilizimi shoqëror e politik që nxjerr në krye të shtetit e të partive njerëz të tillë. Tashti, *uniquum sum*, gjithkujt hakun e vet. Ashtu si Sali Berisha, ashtu edhe si Edi Rama, janë të gjithë pjestarët kryesorë të parisë së Tiranës: Ramiz Alia, Jozefina Topalli, Fatos Nano, Sabri Godo, Ilir Meta, Gramoz Ruçi, Bamir Topi, Skënder Gjinushi e me rradhë. Nga një anë, të gjithë këta janë njerëz shumë të zotë, të aftë e me mend, sepse në një moment të caktuar, ata kanë mundur që t'i vënë njerëzit në rresht, "t'i fusin në brazdë" e t'i bëjnë të sillen si duan ata. Ata kanë arritur që të fitojnë respektin e njerëzve, nga paria e poshtë, deri në atë pikë sa pavarësisht çfarëdo gjëje që bëjnë këto individë, mbështetësit e tyre janë të gatshëm të japin edhe jetën, edhe nderin e familjes së tyre, për disa nga këto udhëheqës partish që i kanë duart e lara me gjakun e shqiptarëve. Me fjalë të tjera, këta janë faktorë me peshë

në politikën shqiptare, pjesë vendimmarrëse e parisë dhe duhet të merremi edhe me ta, sepse këta prijatarë i mbajnë peng dhe i kontrollojnë shqiptarët dhe të ardhmen e tyre.

Si rrjedhojë, zgjidhjet me të cilat përballemi ne shqiptarët në lidhje me parinë janë tre. Po vazhduan në këtë rrugë, dikur, dikush mund të dalë e të kërkojë që t'i zhdukë edhe fizikisht. Nuk është hera e parë që paria sunduese ndër shqiptarët është eliminuar me rrënjë. Nuk duket se është shumë e largët dita kur të rinjtë që nuk shohin shpresë tjetër, e që nuk mund të emigrojnë do të turren që të organizohen. Nuk dihet e nuk mund të parashikohet se çfarë rruge do të marrë ajo kundërvënie e tyre, siç ndodhi, bie fjala, me një manifest anarkist që u shpërnda para pak ditësh. Së dyti, po të lëmë mënjanë zgjidhjet e tilla ekstremiste si të pamundshme në periudhën afatshkurtër, zgjidhja tjetër është mundësia e fitimit të zgjedhjeve nga një forcë politike që nuk sot ekziston, por që mund të organizohet në të ardhmen. Së treti, duhet gjetur gjuha me këto individë të parisë, thjesht sepse nuk ka zgjidhje të problemit politik të krizës e mbyllje të tranzicionit po nuk u përfshinë edhe këto individë me peshë të parisë së Tiranës.

Prandaj, përpara se të vijë puna në pikën kritike, njerëzve, e në veçanti këtyre individëve, duhet t'iu jepet kohë të reflektojnë e të ndrojnë rrugë dhe këto zgjedhje kuvendore do të jenë guri i provës. Sado të pandreqshëm që mund të duken, sado keq që mund të jenë sjellur, të gjithë duhet ta kenë atë mundësi të ndërrojnë rrugë. Ne jemi një popull i vogël, nuk kemi kurrfarë përfitimi të humbim njerëzit rrugës. Gjithkush e ka dhe duhet ta ketë mundësinë të kontribuojë në politikë e në shoqëri, edhe me mënyra të tjera.

Gjithkujt i duhet dhënë mundësia për me reflektue e me ndryshue. Si thuhet në Shkodër, "as dreqi nuk asht njaq i zi sa duket." Por, nëse nuk ndryshojnë rrugë, gjasat janë që pasojat do të jenë shumë të rënda si për ata vetë, ashtu edhe për kombin shqiptar. Megjithatë, unë nuk kam fare besim se paria dhe prijatarët e saj që i përmenda më lart, do të ndrojnë rrugë. Prandaj tranzicioni, që është krijimi i tyre, do të vazhdojë në këtë hulli ku po ecet, deri sa të ndodhë diçka ndryshe. Çudirat që do të

përmenden e skandalet që do të zbulohen, janë tejet shqetësuese. Por sa më e ashpër duket përplasja, aq më thellë është kriza dhe, paradoksalisht, aq më intensive është përpjekja e parisë për ta gjetur gjuhën me njëri-tjetrin.

Mbyllja e tranzicionit

Interesat e parisë dhe të popullit janë të papajtueshme. Mendësia katundare e popullit që e lejoji parinë të ndërtonte sistemin që ka ndërtuar, nuk do ta lejojë që të ndërtojë shtetin që i duhet asaj për të ruajtur pronat e veta. Shoqëria është e kriminalizuar. Mundësitë e parisë për të vendosur kontrollin që synon janë ngushtuar me pakësimin e burimeve materiale në dispozicion të shtetit. Tranzicioni, pra, do të vazhdojë sepse askush nuk ka fuqi ta mbyllë lojën si duhet. Loja nuk mund të mbyllet ashtu siç i intereson parisë. Paria kërkon shtet të dobët dhe oligarkik, ekonomi monopoliste e një shoqëri skllevërisht, me katundarë të getoizuar në qytete të ngjashme me *Sadr City* në Bagdad. Shqiptarët e pranuan këtë pari sa kohë që dukej se edhe ata po fitonin diçka edhe vetë. Kjo lloj marrëdhënie nuk mund të vendoset edhe për shumë kohë ndër shqiptarët. Asaj vetë nuk i intereson mbyllja e tranzicionit me krijimin e institucioneve solide, të ndërtuara në bazë të një rregulli të moralshëm shoqëror dhe që vendosin ekulibre të pranueshme në shoqëri.

Kështu, *status quo* pritet të vazhdojë pa zgjidhje të dukshme. Zgjidhja e problemit të shqiptarëve vjen nga brenda vendit. Argumentet se integrimi në struktura të tjera do të sjellë ndryshimin janë të gabuara. Edhe mendimi se hyrja në NATO na i zgjidh punët përfundimisht është gabim. Në shtetin shqiptar ka aq probleme të shumta e të mëdha me të cilat nuk merret NATO, por që janë jetike për shqiptarët e për parinë e Tiranës, sa rrugëzgjidhja e tyre duket e pamundur. Hyrja në NATO nuk zgjidh asgjë. Problemet e shqiptarëve do të zgjidhen në Tiranë, jo në Bruksel.

Edhe në lidhje me çështjen e mbylljes së tranzicionit, roli i parisë është negativisht i pashpresë. Pavarësisht dukjeve, të gjithë këta individë të ortave jeniçere të parisë janë të paralizuar

politikisht dhe pa mundësi të mëdha veprimi thjesht sepse grupi i tyre i mbështetësve dhe i bashkëfajtorëve të tyre i mban peng dhe i ngrin politikisht. Ata i kanë shterrur dijet e tyre dhe po përsërisin të njëjtin cicmic që kanë luajtur gjithmonë duke e ndarë popullin në “popull i majtë” e në “popull i djathtë”. Makthi i madh i tyre është se qerthulli i tranzicionit është kthyer në një rreth vicioz, një gropë rëre nga e cila nuk ka dalje. Të gjithë e dinë se *status quo* do të vazhdojë derisa të ketë fuqi shteti dhe deri sa të mundet ekonomia e mjeruar shqiptare që të mbajë gjallë shpresën e njerëzve për pasurim të shpejtë e për poste shtetërore. Por, mandej, kur të shterrë ai burim e ai besim, askush nuk e di se çfarë mund të ndodhë.

Askush, më mirë se paria, nuk e di këtë gjë. Për këtë arsye, frika e tyre nga e ardhmja që i pret është reale dhe e prekshme. Nga një anë, këta njerëz që kanë vënë pasuri të pamatshme, duan të bëjnë shtetin e të ndërtojnë institucionet në mënyrë që t'i mbrojnë ata vetë, klanet e tyre dhe pasurinë e tyre sepse nuk kanë ku e çojnë e nuk kanë ku të ikin. Mirëpo, nuk ndërtohet shishja ku duhet futur djalli brenda me ujë. Të dënuar për të jetuar në shtetin shqiptar ata janë të pazotët që të dalin nga sistemi mafioz, që kanë krijuar po vetë dhe që i mban peng. E kështu, mutatis mutandis, loja ripërtërihet e përsërit veten simbas një logjike të *pandrrueshme*. Fëmijët e tyre duan të jenë si prindërit e tyre. Cubat e hajnat, që ata mbajnë pas vetes, duan të bëhen të gjithë të pasur si shefat e tyre. Ata që s'kanë gjë, duan të bëhen e të jenë si ata. Po e vunë re këta që i ndjekin se “shefi” don t'i heqë qafe, ata janë të gatshëm që ta heqin shefin qafe shpejt e shpejt me vrasësit që gjinden shumë lehtë. Të tjerët organizohen në banda që ndjekin pa mëshirë synimin e pasurimit të shpejtë. Sistemi korruptiv ka hyrë në palcë të shoqërisë, tashmë të kriminalizuar, shqiptare.

Pra, rrethi mafioz, dhe logjika e *praxis* mafioz, ku e kanë mbërthyer veten këta individë, nuk i lë të dalin nga loja. Ata duhet ta hedhin vallen si duhet, e si e kërkon logjika e sjelljes kamorriste, sepse është komplikuar çështja. Për parinë e Tiranës, duhet thënë se kënetat e politikës së Tiranës është si ato gropat thithëse që sa më shumë të kërkosh të dalësh prej saj, aq më shumë të thith brenda

vetes. Bashibozukët e tyre, ata që kanë vrrarë e prerë në emër të tyre, nuk e kanë harruar shembullin e bandave të eleminuara, liderët e të cilave sot japin intervista nga burgu i Peqinit. Asnjë nga këto *consigliere* të tyre, nuk don që të shkojë në burgun e Peqinit. Dhe, që të gjithë, i kanë mbushur kasafortat me regjistrimet e krimeve e të dosjeve të shefave të tyre. Shembulli më i mirë ishte marrëdhënia midis Ilir Metës dhe Dritan Priftit. Kështu e mbajnë peng njëri-tjetrin. Në shtetin shqiptar, edhe banditët janë me shkollë të lartë, por edhe profesionistë të zanateve delikate e të errëta. Kjo e ka ndërlikuar shumë punën e parisë, sepse, sipas praktikës së mafias, nuk del dot nga struktura e zëvendësimi, kur vjen, do të vijë nga brenda strukturës vetë.

Nga ana tjetër, një çështje kyçe ka të bëjë me fundin e me mbylljen e tranzicionit. Po të mos ketë ndryshime drastike nga ana e parisë, gjë që nuk do të ndodhë, edhe pse paria e Tiranës nuk mund ta fitojë luftën me të gjithë shqiptarët si komb, tranzicioni ka zgjatur e do të zgjasë edhe për shumë, shumë kohë. Ajo ka fituar shumë beteja, por nuk e ka fituar luftën me shqiptarët. Edhe përkundër dukjeve, paria nuk ka mundur që ta thyejë idenë e kombit, të nderit e të vlerave kombëtare, ndjesi që është e fjetur por shumë e fuqishme në shtresa të gjera të popullit shqiptar. Më e shumta që paria mund të arrijë është një armëpushim i përkohshëm me këto vlera e me këta njerëz. Ajo e blen atë armëpushim, duke zvetënuar një a dy liderë të rinj që dalin e mandej shiten lirë, por, me kohë, do të dalin të tjerë që nuk do të dorëzohen para saj.

Mandej, shqiptarët, *en masse*, as nuk i janë shtruar e as nuk do t'i shtrohen kësaj parie. Rezistenca e tyre është e dukshme. Për më shumë, shqiptarët kanë burime materiale që vijnë nga emigracioni. Por si me këto burime si pa to, shqiptarët nuk e kanë frikë as burgun e as vdekjen. Kur vjen puna me sigurue jetesën e familjes, shumë prej tyre nuk mendojnë dy herë që të merren me çfarëdo lloj aktiviteti kriminal ose të ndershëm vetëm e vetëm që të bëhen të pasur e të pavarur.

Paria shqiptare e të gjithë markave ka përgjegjësi të mëdha

historike, që do t'i përmenden kur të vijë koha. Por ka ende kohë për të ndryshuar dhe sa më shpejt që t'i thërrasë mendjes, aq më mirë do të jetë për të, por edhe për të gjithë ne. Le të kthehen e të shohin jetët e tyre familjare krejtësisht të shkatërruara, familjet që i kanë të rrënuara, fëmijët e tyre të droguar e të kriminalizuar dhe krejtësisht të deformuar nga përplasia me botën e huaj. Le të kujtojnë se mbi sa kufoma kanë shkelur e kanë kaluar për të ardhur deri aty ku janë. Le të mos harrojnë se mund të vijë dita kur as ata vetë nuk e dinë se çfarë fati mund të kenë. Kur erdhi koha që t'ia trazonin eshtrat në varr Enver Hoxhës, këta duhet të mendohen shumë më shumë se dy herë, thjesht sepse urrejtja e popullit nuk shuhet lehtë. Askush nuk ka kohë e para për të blerë të shkuarën e vet, por gjithkush mundet të ndërrojë rrugë. Zgjidhja pra, është e vetë atyre, por zgjidhja është edhe në duart e shqiptarëve.

Përfundim

Në përfundim, duhet thënë se sa më shumë që zgjat tranzicioni, aq më shumë do të kriminalizohen shqiptarët si komb. Paria nuk do të dijë se si ta fusë prapë xhindin në shishe. Çdo ditë që kalon e rrit rrezikun e transformimit të shtetit shqiptar nga një *quartiere napoletano* në një geto haitiane, ku e vetmja gjuhë që do të flitet, do të jetë gjuha e dhunës, e armëve, dhe e bandave të armatosura, që organizohen me lehtësi. Paria mund të ketë fituar shumë beteja me shqiptarët, mund të fitojë edhe shumë të tjera, por ajo betejë që do të humbë, mund të jetë beteja e fundit për të.

PROBLEMATIZIMI I PAVARËSISË SË KOSOVËS DHE RIKTHIMI I ÇËSHTJES KOMBËTARE SHQIPTARE

Pavarësimi i Kosovës konsiderohet si pika e madhe e kthesës historike në fatet e shqiptarëve në periudhën moderne. Si të huajt, ashtu edhe të gjitha paritë shqiptare, e trajtuan pavarësimin e Kosovës si pikën më të rëndësishme, “kthesën historike” në lidhje me trajtimin e problemit shqiptar nga të huajt. Po ashtu, shpallja e pavarësisë pati jehonë të gjerë dhe ngjalli interes të madh ndërkombëtar; u pasqyrua gjerësisht në shtypin e huaj. Megjithatë, pavarësimi i Kosovës u trajtua si precedent ndërkombëtar, kur në fakt nuk ishte ashtu për shumë arsye juridike, politike e historike, që nuk mund të trajtohen në këtë shkrim, por që unë i kam trajtuar rregullisht më parë.

Nga ana e tyre, të gjitha udhëheqësitë politike shqiptare dhe prijatarët e partive politike, e konsideruan pavarësimin e Kosovës si një pikë të madhe kthese në marrëdhëniet që shqiptarët, si komb, po ndërtojnë me vete e me të tjerët në këtë fillimshkulli. Na thuhet se tashmë kemi dy shtete. Në të njëjtën frymë, na thuhet se tashmë i kemi kryer të gjitha punët dhe e kemi zgjidhur problemin kombëtar. Theksi vendoset në argumentin se e vetmja gjë që na duhet para se të mbërrijmë lumturinë e vërtetë, do të jetë anëtarësimi në BE.

Pra, pavarësimi i Kosovës u konsiderua edhe si një pikë e rëndësishme kthese në marrëdhëniet ndërshtetërore. Me shpalljen e pavarësisë së shtetit të ri të Kosovës, të gjitha paritë politike shqiptare në Shkup, në Tiranë e në Prishtinë, u ngutën të deklarojnë se kjo ishte edhe zgjidhja *përfundimtare* e problemit të pazgjidhur të çështjes kombëtare shqiptare. Mendësia sunduese

është se “tash e mbrapa i kemi mirë punët”. Edhe pse nuk ka fare lidhje të forta shoqërore, marrëdhënie ekonomike dhe struktura për përhapjen e vetëdijes kombëtare, vlera të përbashkëta, politika të bashkërenduara e me radhë, por po vazhdojmë që të jetojmë të izoluar nga njëri-tjetri, na thuhet se ajo që na mungon është vetëm Rruga e Kombit, që po ndërtohet, e në të cilën ka shumë shumë pak trafik ekonomik. Mirëpo, një vit e ca më vonë, mund të thuhet, me mjaft siguri, se pavarësimi i Kosovës ishte një lëvizje politike shumë e rëndësishme për të gjithë palët e interesuara. Në të njëjtën kohë duhet thënë se pavarësimi ishte një lëvizje shumë e mangët, tejet problematike dhe e mbarsur me rreziqe të mëdha për të ardhmen e të gjithë shqiptarëve.

Problemi është se, më së pari, pavarësimi nuk e ka shmangur rrezikun e ndarjes së Kosovës. Së dyti, pavarësimi nuk e ka zgjidhur problemin shqiptar. Së treti, pavarësimi ka krijuar premisa shumë të rrezikshme për të ardhmen e shqiptarëve që jetojnë në shtetet fqinje dhe në shtetin amë. Thënë ndryshe, edhe pse duke e zgjidhur problemin e shkëputjes formale së Kosovës nga Serbia është arritur një fitore shumë e madhe, pavarësimi i Kosovës as nuk i ka zgjidhur problemet e vetë shqiptarëve, as të serbëve e as të kombeve të tjerëve, as në Ballkan e as brenda vetë Kosovës. Pavarësimi i Kosovës nuk i ka përforcuar bazat për një paqe të qëndrueshme në Ballkan. Përkundrazi, pavarësimi i Kosovës e ka kthyer Ballkanin në një gadishull ku përplasjet midis fuqive të mëdha dhe grupeve etnike do të intensifikohen edhe më shumë në të ardhmen e afërt e afatmesme. Si zakonisht, për shkak të parive politike që kanë, çmimin më të rëndë ndër të gjitha kombet ballkanike do ta paguajnë shqiptarët. Pse e them këtë?

Nga një anë, pavarësimi i Kosovës e afirmoi dhe e forcoi përshtypjen se parimi i ndërtimit të shteteve të dala nga ish-Jugosllavia, do të vazhdonte që të ishte i pandryshuar. Ai do të ishte parimi organizativ-politik e jo koncepti i shtetit-komb. Kjo don të thotë se nuk do të lejohej shpërbërja e njësive politike ekzistuese. Fuqitë e Mëdha nuk do të lejonin riorganizimin e tyre mbi baza kombëtare. Mirëpo, në realitet, nën strukturën formale të shtetit multietnik, të gjitha njësitë politike që dolën nga shpërbërja e ish-

Jugosllavisë, janë të organizuara fuqimisht në baza etnike. Bosnja, për shembull, është një krijim teologjik, tre shtete në një e secili në vete. Sa të tërhiqen ndërkombëtarët, Bosnja do të shpërbëhet. Fituesit e asaj shpërbërjeje, mbi të gjitha, do të jenë serbët, që janë të bindur se duhet të kenë vetëm durim, sepse koha punon për ta.

Maqedonia është, po ashtu, një shtet që po mbahet bashkë me presionin e madh të ndërkombëtarëve, si dhe me vullnetin e pakufizuar të parive shqiptare për ta mbështetur shtetin maqedonas. Pavarësisht shfaqjeve të bashkëpunimit në nivel të parisë politike, me dështimin e pandërprerë të shtetit maqedonas për t'u vënë në shërbim të të gjithë qytetarëve e shtetasve të vet dhe me kundërvënien e zgjuar nga ana e maqedonasve të çdo mase që përmirëson kushtet e gjendjen e shqiptarëve, dita më ditë tensionet etnike atje veçse po rriten e acarohen. Nga krahu tjetër, shumë maqedonas po kthehen në identitetin bullgar e po kërkojnë shtetësinë bullgare. Kështu, po vendosen bazat për ta rrëshqitur konfliktin shqiptaro-maqedon, në një konflikt bullgaro-shqiptar. Maqedonia vetë, në planin afatmesëm e afatgjatë do të bëhet një fushë beteje midis shqiptarëve e bullgarëve.

Nga anët e tjera, duhet thënë se me pavarësimin e Kosovës, të huajt e shuan pakënaqësinë e shqiptarëve të Kosovës ndaj tyre. Pakënaqësia ndaj të huajve (përjashto SHBA-të) po arrin në nivele kritike dhe po bëhet një problem tejet i vështirë të zgjidhet nga të prej të huajt. Pakënaqësia popullore për gjendjen e rënduar do të kalojë nga të huajt, që e kanë të gjithë përgjegjësinë formale, tek paria shqiptare, që në fakt ka e do të ketë, shumë pak fuqi vendimmarrëse. Me pavarësimin formal, ata e zgjidhën përkohësisht problemin kombëtar shqiptar në Kosovë, duke e ngrirë konfliktin serbo-shqiptar dhe duke e kthyer në problem të Kosovës vetë.

Duhet pranuar se pavarësia ishte një arritje e madhe për të huajt, sepse e ka kthyer dështimin e pritshëm e të garantuar të institucioneve të shtetit të sapodeklaruar të Kosovës, në një problem të pazgjidhshëm të parisë shqiptare të Kosovës. Si edhe gjatë kohës së UNMIK-ut, të huajt e ruajtën kontrollin e feudalizuar mbi pika kyçe të funksionimit të institucioneve shtetërore të

Kosovës. Sot shteti i ri është, as më shumë e as më pak, një protektorat ndërkombëtar, kësaj radhe përmes EULEX, KFOR, dhe strukturave të tjera mbikqyrëse, përfshirë këtu edhe UNMIK, që është ende i pranishëm në Kosovë.

Mirëpo, këto aspekte të funksionimit të shtetit që kontrollohen prej të huajve, nuk e prekin jetën e përditshme të qytetarëve. Problemet që prekin jetën e qytetarëve, më drejt për së drejti, tashmë duhet të zgjidhen nga paria politike shqiptare. Por paria shqiptare nuk ka as fuqi politike, as fuqi institucionale (kompetenca) të zgjidhë si duhet problemet jetike të qytetarëve. Kështu, duke e hedhur gjithë barrën e përgjegjësive politike për dështimin e pashmangshëm të institucioneve të pafuqishme shtetërore mbi parinë shqiptare të Prishtinës, dhe me sa duket nën presionin europian, u arrit dështimi i garantuar i shtetit të sapolindur të Kosovës.

Nga ana e vet, paria politike e Prishtinës, duket e kënaqur me titujt pompozë, me fotografitë e me intervistat e me pritje-përcjelljet protokollare. Mbi të gjitha, ata duken të lumtur se po hyjnë në histori. Me bindjen se të gjithë firmëtarët do të njiheshin përjetë si themeluesit e këtij shteti, paria e Prishtinës pranoi me e ruajtë pushtetin e vet në nivel të katundit e trevës, por faktikisht hoqi dorë nga kontrolli real mbi shtetin. Koha e rishikimit të këtij kompromisi të rrezikshëm po afrohet me shpejtësi dhe dështimi me i rivlerësue si duhet rrjedhojat e ecuritë, do të ketë pasoja të rënda.

Për parinë e Tiranës, pavarësia e Kosovës ishte një dhuratë e çmueshme politike, sepse e shmangu problemin e tyre më të madh, zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare. Paria e Tiranës kurrë nuk e ka dashur zgjidhjen e problemit kombëtar shqiptar. Krijimi i atij shteti kombëtar i vë klanet e parisë së Tiranës, që e kanë sunduar atë shtet tash disa dhjetërvjeçarë, në minoritetet të dukshëm para shqiptarëve të tjerë, që nuk vijnë nga klanet jeniçero-martalloze, por që kanë vetëdije të lartë kombëtare.

Pavarësimi i Kosovës jo vetëm e krijoi dhe e thelloi mundësinë për parinë e Tiranës që, në bashkëpunim me parinë e Prishtinës, të vazhdojnë të pasurohen e të fuqizohen edhe më shumë, por

edhe e shtyu shumë më larg momentin kur ata duhet të përballen me zgjidhjen e çështjes kombëtare. Pavarësimi i Kosovës ua krijoi mundësinë që të ruajnë e të fuqizojnë zotërimin e tyre jeniçero-martaloz në shtetin shqiptar, të patrazuar edhe për disa vite të mira. Edhe një herë, kështu si është, para e Tiranës nuk e ka dashtë, nuk e do dhe kurrë nuk do ta dojë zgjimin e vetëdijes kombëtare shqiptare.

Për ndërkombëtarët, pavarësimi i Kosovës ka qenë një kontribut i çmueshëm për të ruajtur paqen në Ballkan, kontribut që duhej përshëndetur e inkurajuar. Por, për të gjithë shqiptarët ka qenë një problem shumë i madh. Kjo zgjidhje gjysmake nuk ka lejuar që të gjithë ata, së bashku si komb, të përballen me problemin e vërtetë e më thelbësor ekzistencial të tyre, krijimin e shtetit kombëtar shqiptar.

Me e thënë përmbledhtas, para e Tiranës e ka shumë frikë rolin që mund të luajë një Kosovë e fuqishme e një pari patriotike e nacionaliste, që vjen prej një treve jashtë kontrollit të tyre. Frika është se një Kosovë e fuqishme mund të kërkojë bashkimin kombëtar shqiptar. Kështu do t'i trandë themelet e zotërimit në shtetin shqiptar, shtetin që ata e shohin si spahillëk të tyre. Sipas mendësisë së parisë së Tiranës, tash që Kosova u bë një shtet formal, para shqiptare e Kosovës do të mendojë për të ndërtuar atje sistemin e vet jeniçero-martaloz, sipas vetë modelit të parisë së Tiranës. Kështu që, shqiptarët e Kosovës nuk do të kenë kohë që të merren më me problemin kombëtar shqiptar. Mirëpo, para e Tiranës është shumë e paqetë me gjendjen e tashme të Kosovës. Ajo nuk mendon se rreziku që përfaqëson një pari kombëtariste shqiptare për pushtetin e saj është shmangur përfundimisht.

Për parinë e shqiptarëve në Iliridë, pavarësimi i Kosovës krijoi justifikimin se integrimi i shqiptarëve në strukturat e shtetit maqedonas është i pashmangshëm. Edhe pse përplasja midis shqiptarëve e maqedonasve nuk është evituar aspak e, bile, siç shihet nga përplasjet e fundit, është acaruar e komplikuar edhe më shumë, para shqiptare po i shtyn shqiptarët e Iliridës që të orientohen nga Shkupi. Me turrjen e maqedonasve për të marrë

pasaporta e nënshtetësi bullgare, si dhe me rritjen e identifikimit e të vetëdijes së tyre për me u ndërë bullgarë, përplasje etnike po zgjerohet dhe përditë e më tepër. Ecja në këtë hulli, po e bën konfliktin në Maqedoni një konflikt etnik shqiptaro-bullgar. Kjo po e tërheq edhe shtetin bullgar në atë përplasje përditë e më tepër. Si edhe e thashë, problemi është kthyer në një problem shqiptaro-bullgar. Kjo vjen me të gjitha pasojat e mundshme.

Po ashtu, pavarësimi i Kosovës e ridimensionoi gjendjen e enklavave shqiptare në Mal të Zi e në Serbi. Pavarësimi e ka komplikuar shumë pozicionin e tyre politik. Pavarësimi është duke i detyruar që të bëjnë zgjidhje pragmatike. Tashmë ata janë duke e parë veten si minoritete të papërfillshme etnike shqiptare, në shtetet etnike të serbëve e malazezëve. Duke qënë minoritete, këto nuk janë më pjesë integrale e çështjes kombëtare shqiptare.

Për serbët, pavarësimi i Kosovës ishte një humbje e madhe. Por nga ana tjetër, kushtëzimi i pavarësimit me pakon Ahtisaari, ishte një sukses i jashtëzakonshëm. Shqiptarëve iu dha një shtet formal, por që ishte një shtet jofunksional e fund e krye i paralizuar. Kjo ishte zgjidhja më e mirë e mundshme. Edhe pse serbët shfaqën e vazhdojnë të shfaqin shumë pakënaqësi e bërtasin fort kundër pavarësisë, e natyrshëm ata do të luftojnë për të drejtat e tyre si minoritete, pushteti i tyre është rritur ndjeshëm. Zgjidhja që parashihte dhënien e pavarësisë së Kosovës me pakon Ahtisaari, një seri masash që krijon një njësi politike as mish e as peshk, pse formalisht shtet e realisht një koleksion njësisish administrative etnike, punon në dobi të tyre.

Serbët janë arrogantë në politikën e jashtme, nacionalistë, me mendësinë e Beogradit të periudhës titiste, por ata janë edhe të durueshëm. Ata nuk kanë hequr fare dorë nga koncepti i *Serbisë Homogjene* dhe mendojnë me plane afatgjata. Problemi i Kosovës është vetëm njëri nga problemet me të cilin përballen ata. Ndarja e Bosnjës, kontrollimi i Malit të Zi, paralizimi i Maqedonisë dhe gjetja e pozicionit të duhur në marrëdhëniet ndërkombëtare, janë shqetësime të mëdha të parisë serbe. Nuk duket se serbët kanë

hequr dorë nga plani i tyre për të ndarë Ballkanin në linja etnike. Metodrat që ndjekin kanë ndërruar, por plani ka mbetur i njëjtë.

Nga ana e tyre, rusët dhe të tjerët po i shtynë serbët që të këmbëngulin në këtë projekt. Duket se serbët kanë besim se, me kohë, proceset do të ndërrojnë e do të ecin në të mirë të tyre. Dihet se pa bashkëpunimin e tyre, zgjidhjet politike në Ballkan nuk do të funksionojnë dhe prandaj rusët e grekët nuk po lënë gjë pa bërë që të fusin pyka midis serbëve e të tjerëve. Për ta, Ballkani duhet kthyer edhe njëherë në fuçi baruti dhe në fushë beteje midis Fuqive të Mëdha.

Në Kosovë, edhe përkundër tam-tamit të pavarësisë, ndërkombëtarët e shtynë procesin politik në dobi të serbëve. Tashmë, serbët, që komandohen si ushtarë të bindur nga Beogradi, kanë shumë më shumë fuqi se më parë. Pushteti i tyre ndjehet jo vetëm në veriun e Kosovës, por edhe mbi komuna kyçe të pjesës tjetër të Kosovës. Ata e kanë transformuar Kosovën në një lëkurë leopardi, dhe mbi të gjitha kanë paralizuar funksionimin e institucioneve të shtetit të ri, sepse ata kanë të drejtën e vetos në të gjitha nivelet.

Shqiptarët e Kosovës e shohin Kosovën si shtet të tyre. Mirëpo, kjo është një mendësi shumë e gabuar. Gjendja duhet sqaruar mirë e sa më shpejt që të bëhet kjo gjë, më mirë do të jetë. Mjafton një ripeshim e vlerësim i shkurtër i shkallës së sovranitetit të Kosovës për të krijuar një ide të qartë për gjendjen e krizës së thellë ku e gjejnë veten shqiptarët e Kosovës.

Disa shkrime të vyeshme të mëparshme të Esat Stavilecit, por veçanërisht debatet e brezit të ri të aktivistëve e studiuesve, si të Albin Kurtit, Bekim Baliqit, Besnik Pulës, Shkëlzen Gashit, Valon Muratit, e shumë të tjerëve, e kanë problematizuar mirë problemin e sovranitetit, si problemin themelor politik të Kosovës. Shumica e tyre e kanë bazuar gjykimin e tyre mbi formulimin e klasifikimin e sovranitetit nga Krasner, formulim gjerësisht i pranuar në teoritë e marrëdhënieve ndërkombëtare, që edhe unë po e përdor këtu.

Vëmendja e tyre është me të drejtë e përqëndruar tek sovraniteti, sepse ai është atributi themelor i shtetit. Një shtet sovran ka autoritetin absolut e të pakontestueshëm për të vendosur mbi

politikat që vendos se duhet që të ndjekë, si brenda vendit ashtu edhe në marrëdhëniet që ndërton me shtetet e tjera. Dështimi i shtetit lind nevojën për zgjidhje të tjera dhe të gjitha zgjidhjet kërkojnë një shtet të ri. Dështimi i shtetit të tashëm të Kosovës është me rrezikshmëri të lartë, sepse, mbas të gjitha përvojave të mëparshme, shqiptarëve u mbetet vetëm që të kërkojnë që, ose të hyjnë në BE, ose të kërkojnë shtetin e tyre kombëtar dhe bashkim me shtetin shqiptar. Dihet që Kosova, edhe pse një protektorat i deklaruar i BE-së, nuk ka asnjë shans që të hyjë në BE, as sot e as mot. Dështimi i shtetit të Kosovës, pra, është edhe dështimi i të gjithë përpjekjeve të ndërkombëtarëve dhe i planit të tyre për ta zgjidhur problemin e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë në baza politike e jo etnike. Por, në këtë pikë, shpallja e pavarësisë ishte e pashmangshme.

Për konvencencë, duhet thënë se ka shumë kategorizime e përkufizime të sovranitetit dhe shumë terma të përafrueshme, që ende janë në përdorim. Megjithatë, si rregull, pranohet se në kohën tonë se ka katër forma në të cilat manifestohet sovraniteti. Forma e parë është që shteti i pavarur gëzon një sovranitet formal dhe është i/e njohur nga dy ose më shumë shtete. Në këtë nivel, Kosova është shtet sovran. Dhjetra shtete, ndër to edhe disa edhe nga Fuqitë e Mëdha, e kanë njohur Kosovën si shtet të pavarur.

Forma e dytë e manifestimit të sovranitetit e të shtetësisë, është sovraniteti i mirëfilltë ligjor në nivelin ndërkombëtar, pranimi i shtetit si anëtar në institucionet ndërkombëtare dhe njohja e të drejtave e detyrave që shteti merr përsipër në ato struktura. Mirëpo edhe në lidhje me organizatat ndërkombëtare, anëtarësimi ka vlerë kur bëhet në organizatat ndërkombëtare politike. Në këtë drejtim, Kosova nuk ka fare sovranitet. Ajo nuk mund të bëjë pjesë as në OKB, as në OSBE, e as të bëhet palë në traktatet e në konventat e shumta ndërkombëtare.

Forma e tretë e sovranitetit është ajo që njihet si marrëdhënie e sovranitetit të ndërvarur. Shembulli më i mirë është ai i vendeve të BE, që kanë pranuar të heqin dorë nga disa të drejta, dhe kanë marrë përsipër detyra që e kushtëzojnë sjelljen e shtetit, por ata kanë bërë kështu vullnetarisht. Mirëpo, duke e lënë mënjandë fushën

e rëndësishme të sigurisë, Kosova nuk është shtet, por është një protektorat i mirëfilltë ligjor e administrativ evropiano-perëndimor. Politikanët e saj nuk kanë të drejtë vendimmarrjeje në forumet përkatëse. Populli i Kosovës nuk e ka përfaqësimin e duhur.

Megjithatë, forma më e rëndësishme e sovranitetit, sepse prej saj buron edhe autoriteti për të ndërtuar marrëdhënie specifike me shtetet e tjera, është sovraniteti i brendshëm. Shteti i Kosovës nuk gëzon fare sovranitet të brendshëm. Kjo ndodh sepse qeveria nuk ka autoritet të padiskutueshëm të vendosë mbi çdo gjë që i duhet. Dhe këtë mungesë të sovranitetit e shohim në ekzistencën e enklavave serbe. Jo vetëm aq, por qeveria nuk ka kompetencat e mirëfillta të qeverisë, të cilat i kanë ruajtur për vetë të gjithë organizmat ndërkombëtare, që ende sundojnë në Kosovë. Nga ana tjetër, Kosova nuk ka asnjë komb qytetar, por ajo ka gjashtë kombësi të njohura, të cilat kanë veton mbi veprimtarinë e institucioneve shtetërore. Kjo gjë e ka paralizuar shtetin. Për më tepër, Kosova nuk ka shtetas besnikë, përveç shqiptarëve. Serbët janë e sillen si vegla të Beogradit. Dhe Beogradi i përdor pa mëshirë si i intereson atij. Po ashtu, Kosova nuk ka ekonomi të mirëfilltë prodhuese. Shteti nuk ka kontroll të mjaftueshëm mbi ekonominë. Gjendja shoqërore është shumë e rënduar. Paria është e papërgatitur profesionalisht për të ndërhyrë në ekonomi. Mbi të gjitha, institucionet shtetërore janë të paralizuara. Pakënaqësia dhe rezistenca ndaj tyre po rritet përditë. Kosova është në krizë, dhe askush nuk duhet të jetë i lumtur për këtë gjë.

Me përjashtim të politikanëve të Kosovës, e disa prej tyre turren nga një shtet tek tjetri për të siguruar njohjen formale, të gjithë analistët bien dakord, dhe përvojat e deritashme provojnë katërcipërisht, se sovraniteti i shtetit të Kosovës është tejet i kufizuar, për mos me thënë eksperimental dhe i porealizueshëm. Mirëpo, pa sovranitet të mirëfilltë nuk mund të merren përgjegjësi të mirëfillta nga ana e shtetit. Kështu, nevoja për të zgjidhur problemet e shumta nuk është shmangur apo zgjidhur. Është e qartë se nuk mund të ecet përpara me një shtet të paralizuar.

Pasojat e pashmangshme të dështimit të pritshëm të shtetit të Kosovës do të jenë shumë të rënda për të gjithë. Jo vetëm se

mund të ketë rezistencë nga ana e shqiptarëve ndaj të huajve, ndaj serbëve e ndaj parisë së Prishtinës, por se mund të krijohet mundësia për futjen në lojë të një grupi të ri udhëheqësish, që do të jenë tejet dyshues karshi modeleve e zgjidhjeve të deritashme e që nuk dihet kah do të orientohen. Për më tepër, bindja që po krijohet ndër shqiptarët është problematike. Ata po binden se pavarësia e Kosovës nuk ka qenë zgjidhja përfundimtare e problemeve të shqiptarëve të atjeshëm. Dhe mbështetja për organizatat që kërkojnë vetëvendosje e deri zgjidhjen e problemit kombëtar shqiptar përmes rrugës së bashkimit në baza etnike, me pasoja për të gjithë, duket se është në rritje.

Problemi është se me dështimin e qeverisë, projekti i pavarësimit të Kosovës do të duket se ka qenë një zgjidhje gjysmake, objektivi i vërtetë i së cilës ishte për të shmangur zgjidhjen e problemit të vërtetë që i preokupon të gjithë në Ballkan, çështjes kombëtare shqiptare. Pranimi i paketës Ahtisaari ka krijuar kushtet e nevojshme për ndarjen faktike të Kosovës, paralizimin e institucioneve shtetërore dhe të ekonomisë, varësimin e mëtejshëm të serbëve nga Beogradi, vazhdimin e përplasjes etnike, dhe në mënyrë indirekte ka hedhur në tavolinë, pashmangshmërinë e ndarjes së Kosovës. Kjo e ka bërë zgjidhjen e problemit shqiptar në Maqedoni e në Preshevë në veçanti, dhe nevojën e bisedimeve me serbët, për të kthyer Kosovën në kufijtë e vitit 1956, të ndryshuar nga Tito, iminente.

Zgjidhja e problemeve kërkon që institucionet e huaja vendimmarrëse të rivlerësojnë sovranitetin e Kosovës. Të huajt duhet të bëjnë një zgjedhje të vështirë. Nga një anë, ata mund të pranojnë dështimin e paketës Ahtisaari. Kjo do të thotë që ata duhet të kalojnë kompetenca të vërteta në duart e parisë shqiptare të Prishtinës. Për më tepër ata duhet të rrisin presionin mbi serbët e të tjerët për ta parë Prishtinën si kryeqytetin e shtetit të tyre dhe veten si shtetas të Kosovës. Kështu, të huajt duhet të rrisin kontributet e tyre në ndërtimin e një ekonomie të mirëfilltë, të bazuar në burimet e shumta minerare e natyrore të Kosovës dhe të pranojnë një rol të kufizuar politik për përfaqësuesit e tyre. Në se ata nuk e bëjnë një gjë të tillë, por me praktikën e shtërngimit të

kompetencave gjendja do të përkeqësohet progresivisht. Nëse ata vazhdojnë që të luftojnë me presione të shumta mbi institucionet e pafuqishme në fushën e ekonomisë, të ligjit, të sigurisë, e të politikave administrative, ashtu siç shihet nga fushata e tyre për të bërë presion personal mbi figura kyçe të parisë së Prishtinës, si dhe nëse këmbëngulin që të vazhdojnë me u marrë me UÇK-në e me strukturat e saj, gjasat janë që Kosova do të shpërthejë shpejt, dhe atij shpërthimi nuk i dihet fundi.

Dështimi i pashmangshëm i strukturave të parisë e të shtetit të Kosovës, do të çojë në shtruarjen për zgjidhje të problemit shqiptar e të ndarjes së vetë Kosovës. E natyrisht, procesi do të jetë një proces domino, që do të shtrihet nga Bosnja në Maqedoni me të gjitha pasojat që të gjithë të huajt kanë dashur t'i evitojnë. Me kohë, etnia, e cila është paracaktuar që të paguajë çmimin e stabilitetit në Ballkan, shqiptarët, mund të mbështesin zgjidhje të tjera.

ROBERT MICHELS, LIGJI I HEKURT I OLIGARKISE DHE POLITIKA E TIRANES

Partitë politike janë mekanizmi kryesor përmes të cilit si paritë, ashtu edhe masat synojnë që të influencojnë sistemin politik dhe politikat e ndryshme shtetërore. Në një sistem demokratik, po edhe në një sistem oligarkik, partitë politike janë faktor përcaktues në përzgjedhjen e udhëheqjes së shtetit. Mirëpo, siç argumenton Robert Michels, edhe në organizata si bashkimet profesionale, struktura që zanafillën e kanë qartësisht tek një formë demokracie të pastër, struktura përfundon si një oligarki.

Me kohë, për shkak të pashmangshmërisë së dallueshmërisë së anëtarësisë në mbështetës e në udhëheqës, për shkak të domosdoshmërisë së daljes së prijatarëve që i japin drejtimin organizatës dhe marrin vendimet, për shkak të përplasjes midis grupeve të ndryshme dhe nevojës së daljes së strukturave të përfaqësimit, disa individë gradualisht marrin fuqi të jashtëzakonshme. Edhe në struktura që lindin si mirëfilli ideologjike, me kohë lind nevoja që të bëhen zgjidhje për të cilat nuk ka precedentë, apo receta ideologjike. Shpesh, duke përdorur me efikasitet mbështetjen që kanë në bazën e partisë, aftësinë e manipulimit të argumenteve ideologjike, vendin e veçantë që kanë në strukturë, si dhe duke pozicionuar në pika kyçe një pakicë besnike që i ndjek, këta individë i japin drejtimin që duan vullnetit të masës së mbështetësve. Kur prijatarët arrijnë ta bëjnë këtë, sistematikisht dhe në shërbim të interesave të tyre, atëherë, edhe pse partia mund të funksionojë në një sistem demokratik, ajo është një strukturë oligarkike. Michels argumenton që kjo gjë ndodh në të gjithë strukturat. Në këtë shkrim ia vlen që të diskutojmë

pak për argumentin e tij dhe për politikën e sotme shqiptare si evidencë në mbështetje të argumentit të tij.

Robert Michels studioi partinë socialdemokrate gjermane, një parti masash, dhe që ndiqte një ideologji universaliste. Studimi i tij e bindi Michels që nuk kishte zgjidhje tjetër, përveç sundimit të oligarkisë dhe të pranimit të sundimit të saj. Paradoksi që studioi Michels ishte ky: si shpjegohet që një parti e krijuar në bazë të një ideologjie universaliste si marksizmi dhe me bazë klasore proletariatin, përfshihet në proceset politike dhe, brenda saj, është vetëm një grup i ngushtë që merr vendime?

Shpjegimi që Michels i dha këtij paradoksi ishte “ligji i hekurt i oligarkisë.” Thënë shkurt, ligji i hekurt i oligarkisë përmblihet në këtë arsyetim. Pavarësisht origjinës së një partie politike, (dhe, në një sistem demokratik modern, të gjitha partitë fillojnë si parti të masave të gjera dhe me një bosht ideologjik), në fund të fundit, struktura e prijatarëve e shkëput partinë nga kontrolli i ideologjisë dhe e vë në shërbim të një grushti oligarkësh, që e përdorin partinë për interesat e tyre. Oligarkët partiakë e kontrollojnë partinë, sepse ata kontrollojnë strukturën. E vetmja gjë që e ndryshon këtë gjendje, është dalja e një partie të re, të bazuar në ideologji, dhe me udhëheqës të rinj. Mirëpo edhe kjo parti e re, me kohë, sipas Michels, do të bëhet si të tjerat përpara saj. Edhe ajo parti e re do të përfundojë si strukturë në shërbim të disa oligarkëve. Këta, më pas, do ta kontrollojnë partinë me dorë të hekurt. Dhe, kështu, për shkak të “ligjit të hekurt të oligarkisë”, rifillon cikli i minimumit të ideologjisë dhe i fillimit të oligarkisë partiake.

Partia të cilës Michels i përkiste deri në vitin 1907, dhe që ai e përdori si rast studimor, Partia Social-Demokrate Gjermane, përfundoi duke mbështetur kauzën nacionaliste dhe votoi në mbështetje të hyrjes së Perandorisë Gjermane në Luftën e Parë Botërore. Faktori vendimtar ishin udhëheqësit e saj, një grup i ngushtë që e kontrollonte të gjithë strukturën e partisë. Gjatë Luftës së Parë Botërore, Michels shkoi në Itali ku dha mësim për shumë vite. Duke ndjekur argumentin e vet dhe duke argumentuar se oligarkia ishte e pashmangshme, vetë Michels përfundoi si mbështetës i fashizmit dhe i Musolinit.

Mirëpo, përvojat demokratike, veçanërisht ato të mbas Luftës së Dytë Botërore, kanë treguar se jo gjithmonë ky ligj është i vërtetë. Përvojat demokratike kanë treguar se ky ligj nuk është as i hekurt e as përgjithësues. Por, oligarkizimi i politikës partiake është një përvojë rutinë që vihet re shumë shpesh në shumë sisteme demokratike. Veçanërisht e dallueshme është kjo rrugëzgjdhje e problemeve të organizimit partiak në demokraci të brishta e të pastabilizuara si duhet, në kohë të turbullta kur shoqëritë janë të paqarta për rrugën që duhet të marrin, në struktura ku mungojnë vlerat e mirëfillta ideologjike, si dhe në sisteme në të cilat pushteti i parive është më i rrezikuar. Oligarkizimi është i dukshëm kur sjellja e parive sunduese është sistematikisht paradoksale, d.m.th., kur ideologjia formale e parisë dhe sjellja e tyre në politikë janë të papajtueshme, dhe, prapë se prapë, ata janë të zotët që të kontrollojnë partinë e tyre. Në raste të caktuara, si në shtetet baltike, Çeki, Serbi, Kroaci, Maqedoni, Mal të Zi, Poloni dhe Sllovaki, fuqia e ideologjive ka qenë përcaktuese.

Ndër të tjera, nacionalizmi ka qenë një pengesë e fortë në rrugën e marrjes së vendimeve që mund të ishin në interes të parive apo të prijatarëve të tyre. Kështu, nuk ka rëndësi se cili është prijatari i rradhës në Serbi; ajo që dihet është se njohja formale e Kosovës si shtet nuk është një vendim që do të merret prej tyre. Nuk ka rëndësi se kush është kryeministri i Maqedonisë, por dihet se ata nuk do të heqin dorë nga emri. Pra, ideologjia është dhe vazhdon të mbetet një shtërngesë e pakapërcyeshme për këta politikanë.

Megjithatë, ndryshe nga disa raste të tjera në Europën Lindore e Qendrore, por edhe në Ballkan, në rastin e shtetit shqiptar gjatë këtyre njëzet vjetëve të fundit, ky ligj i hekurt i oligarkisë është vërtetuar plotësisht e katërcipërisht. Politika shqiptare është në ekstremin e mundshëm të oligarkizimit dhe të kontrollit të strukturave partiake. Partitë janë vënë pa kushte në shërbim të interesave të individëve si Sali Berisha, Edi Rama, Ilir Meta, dhe të klaneve të këtyre oligarkëve që i kontrollojnë këto parti me dorë të hekurt. Oligarkia shihet edhe tek lehtësia me të cilën figurat politike qendrore të partive braktisen dhe mënjanojnë nga loja, apo që kthehen në lojë me mbështetjen e kundërshtarëve të tyre.

Pjesë e parisë e të lidhur me njëmijë fije me ta, këto struktura oligarkike kontrollojnë partitë politike, shtetin, shoqërinë, vlerat, e militantët me dorë të hekurt dhe i kanë vënë në shërbim të tyre. Partitë nuk kanë ideologji. Partitë nuk kanë vlera universaliste apo kombëtare që i lidhin me militantët. Varfëria ideologjike shihet qartë në mungesën e programeve afatgjata që duhej të paraqiteshin edhe në këto zgjedhje. Kontrollimi i strukturës shihet qartë në turrjen e 'militantëve,' që në çdo sistem tjetër do të ishin hajna, lamashë e cuba, në mbështetje të marrëzive të radhës të prijatarëve partiakë. Çfarëdo që thuhet prej prijatarëve, thënie kontradiktore, pa vlerë, fyerje personale, shpifje e të tjera, thithet nga mbështetësit e tyre si sfungjer.

Megjithatë, oligarkia politike ndër shqiptarët është e ndryshme. PS është, në thelb, një parti kuadrosh që janë zhveshur nga vlerat ideologjike, por që kanë ruajtur strukturën e vjetër. Në PS, të gjithë janë mësuar të rrinë në rresht dhe dinë se si të gjejnë vendin e tyre në kolonën e përcaktuar. Nga ana e vet, PD është një masë njerëzish, që nuk kanë pasur vlera ideologjike, që nuk e kanë respektuar strukturën, dhe që kanë ndjekur personat e ndryshëm, duke përfunduar si parti e një individi. Këto dy parti janë ekstremet e politikës partiake shqiptare. Përtej këtij dallimi thelbësor, ndër elementët e dallueshëm të oligarkisë shqiptare janë edhe nëntë elementët e mëposhtëm.

Së pari, sistemi është qartësisht oligarkik, sepse ka një parti të konsoliduar që sundon, dhe një shoqëri të fragmentarizuar, që mobilizohet përmes mjeteve të propagandës, të kontrolluara nga vetë paria. Konsolidimi i parisë shihet qartë në lehtësinë me të cilën ndërrohen koalicionet, aleancat dhe qeveritë. Paria sundon me përqindje. Të gjithë palët kanë qeverisur me njeri-tjetrin. Aleancat janë të vendosur e të mbajtura nga individët prijatarë. Për shembull, Ilir Meta e arreston Sali Berishën, partia e tij e quan spiun serb dhe të keqen më të madhe të këtij kombi. Nga ana e tij, Sali Berisha nuk lë gjë pa thënë për Ilir Metën si të korruptuar dhe kriminel ordiner. Por, edhe pa mbaruar zgjedhjet, përkundër të gjithë asaj që kishin thënë, të dy pajtohen të qeverisin bashkë me kuota 80 dhe 20 përqind. Elektorati dhe militantët e të dy

palëve duhet të jetojnë me deklaratat shpjeguese të prijatarëve se “grindja ishte për fushatë”, ose se “kështu janë fushatat”.

Së dyti, partitë janë qartësisht të kontrolluara nga oligarkë, që bëjnë çfarë duan si me partinë ashtu edhe me mbështetësit e tyre. Tre paradokse vlen të vihen në dukje këtu. Për shembull Sali Berisha doli e deklaroi se ai është më socialist se prijatarët e PS-së. Reagimi nga ana e strukturave të PD-së ishte zero. Edi Rama i humbi zgjedhjet dhe prapë është në krye të PS-së. Ilir Meta është zënë me presh në dorë (gjykata e nxori të pafajshëm) dhe askush nga kryesia e LSI-nuk po e jep dorëheqjen.

Së treti, dasitë në shoqërinë shqiptare nuk janë ideologjike, por kundërvënie klanore midis dy strukturave të formësuara në bazë të parimit të sjelljes katundare të shitjes së mbështetjes politike për interesa të momentit. Morali i shoqërisë buron nga interesi material që kanë njerëzit. Kryetari i degës së një partie, të secilës parti, shitet në pazar për një shumë të caktuar parash. Klanet brenda partive janë shumë aktive dhe në kundërvënie të hapur me njëri-tjetrin. Edhe kur Erion Veliaj kishte mbështetjen e kryetarit të PS-së për kandidaturën e vet në Kuçovë, Erion Braçe iu kundërvue Veliajt, sepse kishte frikë humbjen e kontrollit mbi zonën e vet. Edhe nga ana e PD-së, shitja e votave dhe kundërvënia brenda partisë e klaneve të ndryshme, si për shembull, Jozefina Topalli kundër Lulzim Bashës, është një fenomen rutinë.

Së katërti, partitë politike janë burokratizuar. Pikat kyçe të strukturës janë mbushur me rrogëtarë, që marrin pagesë mujore nga arka e partisë. Mirëpo, si mbushet arka e partisë? Këtu del edhe lidhja e hapur e partisë me krimin. Financimet shtetërore janë një pikë uji në detin e nevojave financiare të strukturave partike. Rrogat e zyrtarëve dhe financat e partive sigurohen nga oligarkët që janë në krye të partive. Prandaj, njerëzit dhe militantët i qëndrojnë besnikë individëve dhe strukturës, por jo ideologjive.

Këtu duhet theksuar edhe karakteristika e pestë. Strukturat e partive janë të shkëputura, si nga ideologjia që duhej të kishin, ashtu dhe nga masat e popullit. Për shembull, PS është një parti që drejtohet nga oligarkët ekonomikë, plutokratë e kleptokratë, njerëz që nuk kanë asgjë të përbashkët me socializmin apo me

marksizmin. Nga ana e vet, PD, nuk ka asnjë vlerë ideologjike apo morale me të cilën mund të identifikohet sepse, në fakt, është një parti populiste dhe klienteliste, e kontrolluar nga një oligark dhe nga familja e tij. Ashtu si PPSH ishte Enver Hoxha, edhe PD është Sali Berisha. Mirëpo, Enver Hoxha i kishte disa caqe ideologjike që nuk i kalonte dot dhe që i duhej t'i respektonte. Enver Hoxha la një strukturë leniniste organizative shumë të fortë. Nga ana e vet Sali Berisha është PD. Çka thotë Sali Berisha bën PD. Si edhe shihet nga zhvillimet e fundit në PS, por edhe nga zhvillimet në LSI dhe në PD, oligarkët përdorin çdo mjet në dispozicion të tyre për të kontrolluar strukturën, për të eliminuar kundërshtarët, dhe për të mbajtur pushtetin në duart e veta. Si rezultat, me kohë, partitë politike bëhen dhe janë vetë prijatarët. Politika bëhet politika e prijatarëve dhe e parisë.

Së gjashti, një faktor me shumë rëndësi në këtë proces ka qënë edhe specializimi i prijatarëve në lojën e politikës, që tashmë është bërë profesioni i tyre i mirëfilltë. Tashmë ka një grup brenda parisë që jetojnë prej politikës, e jo për politikën. Si kryeministër, si president, si deputet, si prijatar partiak, si ministër apo si kryetar bashkie, secili nga oligarkët ka mësuar shumë në lidhje me mënyrën se si drejtohet shteti në mbrojtje të interesave të parisë, prijatar i së cilës është edhe oligarku. Të gjithë janë bërë mjeshtër në politikën e kulisave, d.m.th., të birucave, dhe duke pranuar e përzgjedhur një model sjelljeje që është përjashtues; e kanë kthyer vendimmarrjen politike në biznesin e ngushtë të një grushti individësh, që tashmë e paraqesin veten si të pazëvendësueshëm dhe të domosdoshëm për sistemin politik. Rasti më evident është përjashtimi i mundësisë së Bamir Topit për t'u rizgjedhur, me një intervistë të Sali Berishës, që u pasua nga pozicionimi i Edi Ramës dhe Ilir Metës.

Së shtati, shkëputja e prijatarëve nga kontrolli ideologjik, dhe zhvlerësimi që iu bëhet militantëve dhe mbështetësve është theksuar shumë nga mundësitë që ofron teknologjia si dhe nga natyra e komunikimit publik modern. Shtypi, media e re dhe televizioni e shkëput strukturën si ndërmjetës midis prijatarit e masës. Edi Rama shkon tek mbështetësit e tij përmes një

cicërimë. Mbasi vë një flamur kombëtar në një anë, dhe flamurin e NATO apo të BE në anën tjetër, Sali Berisha jep një intervistë tek Blendi Fevziu ose dërgon kasetën në TV me fjalimin e ditës në mbledhjen e qeverisë.

Së teti, një nga elementët kryesorë që e mbajnë oligarkinë gjallë është prestigji i prijatarëve, legjitimiteti i tyre si figura të pazëvendësueshme e historike dhe, si rrjedhojë, personalizimi i tejskajshëm i politikës. Sali Berisha ka kultivuar një imazh që e shet atë si lojtar kryesor në ndryshimet që ndodhën në vitet 1990-1991 kur, deri në dhjetor 1991 ai ishte thjesht një vegël e sistemit e përdorur pa shumë mëshirë nga shumë vetë. Sali Berishës i dhemb shumë kur i kujtohet ajo kohë poshtërimi. Mirëpo Sali Berisha, dikur një komunist i thekur, sot mundohet që të shitet si flamurtari i antikomunizmit. Propaganda intensive që zhvillohet përmes mediave e ka përforcuar këtë prestigj të tij. Gjithashtu ai po kapitalizon nga mundësitë e krijuara, për të luajtur me mendësinë e popullit. Mendësia katundare e sheh Berishën si njeri të zotin, sepse ai e ngriti edhe një herë veten dhe PD-në nga hiri i luftës civile të vitit 1997, një nga shkaktarët e së cilës ai ishte, për t'u kthyer edhe një herë në lojtarin kryesor të politikës shqiptare.

Së nënti, oligarkia mbështetet fort në mundësitë e shpërblimit apo të ndëshkimit, që janë në duart e prijatarit të radhës. Kur je Bamir Topi, Sali Berisha “të ngrin”, kur je Kastriot Islami, Edi Rama “të përjashton” dhe kur je Dritan Prifti, Ilir Meta “të djeg”. Por, kur je Arben Imami apo Genc Pollo, Sali Berisha të merr nga trotuari e të bën ministër, kur je Megi Ajtyresa, Edi Rama të bën kryetare të Rinisë, dhe kur je Lefter Koka, Ilir Meta të bën deputet. Oligarkia shqiptare nuk është partiake, por oligarki e klaneve të parisë. Fuqia reale është e përqëndruar në duart e pak individëve.

Mirëpo, në mos tjetër, tash jemi në fund të ciklit oligarkik. Mbështetja për këto parti e për prijatarët e tyre, të cilët kanë manifestuar e manifestojnë sjellje jonormale në politikë është në rënie të vazhdueshme. Niveli i votimit është në rënie. Klientelizimi i politikës është shenja më e qartë e humbjes së legjitimitetit. Mbështetja për parti e për forca të tjera që janë thelbësisht ideologjike është një shenjë tjetër se oligarkia është tejet e

paqëndrueshme. Natyrisht që oligarkia është shumë e fuqishme sepse humbjen e legjitimitetit ideologjik, prijatarët mundohen ta kompensojnë me mbështetjen materiale që ofrojnë për strukturat partiake, me punësimet në shtet, me mundësitë që krijojnë për individët që të pasurohen apo të punojnë në sektorë të tjerë të ekonomisë. Por këto burime po shterren. Thellimi i krizës së gjithanshme në shtetin shqiptar po i acaron shumë marrëdhëniet midis oligarkëve dhe shoqërisë dhe po i ngushton gjithnjë e më shumë hapësirat që kanë për manovrim. Dështimi i tyre është i prekshëm.

Nevoja për një zgjidhje të gjithanshme të problemeve të shumta është e dukshme. Thirrjet e tyre për ideologji e për justifikime ideologjike të reja janë qesharake, si thonë labët, “e lëshoi mjekrën dy pëllëmbë, por nuk e besoi njeri.” Mbas këtyre zgjedhjeve, e mbas dështimit të pritshëm, mund të ketë feudalizim e personalizim të mëtejshëm të politikës, por zhurma mediatike nuk e ka shmangur nevojën për një politikë realiste, dhe të mbështetur në një ideologji që iu shërben të gjithë shqiptarëve. Kësaj oligarkie po i vjen përditë fundi politik. Pra, dështimi i përplotë i demokracisë në këto njëzet vjet në shtetin shqiptar shihet qartë në dështimin e partive politike të parisë dhe të prijatarëve të tyre që janë në krye të klaneve oligarkike.

Në rastin e shtetit shqiptar, Michels mund të ketë pasur të drejtë për këto vite që kaluam, por nuk është e thënë që ai të ketë të drejtë në të ardhmen, edhe pse ne e dimë se çfarë duhet të bëjmë. Ne duhet të mësojmë nga rastet e tjera, pozitive dhe me sjellje më të mira, ku politika është vënë në shërbim të qytetarëve. Edhe pse kjo është e do të jetë një luftë e ashpër kundër parisë së Tiranës dhe veglave të saj, ia vlen që të bëhet, sepse kjo është zgjidhja e vetme politike që iu shërben shqiptarëve, por edhe të tjerëve që jetojnë me ta.

DËSHTIMI I NDËRTIMIT TË SHTETIT TË DUHUR GJATË TRANZICIONIT

Gjatë tranzicionit, shqiptarët, në të gjitha trojet shqiptare, kanë pasur një lidhje shumë të ndërlikuar me shtetin, thelbësisht të ndryshme nga lidhja që kanë kombet e tjera në Ballkan e më gjerë, me shtetin e tyre respektiv. Të gjithë popujt e tjerë dhe paritë e tyre respektive, edhe në momentet më të rënda të historisë së tyre, qoftë në luftë, qoftë në krizë ekonomike, iu drejtuan e u lidhën mbas shtetit kombëtar, e mbështetën atë dhe shfaqën një lidhje organike me të. Ndër të tjerët, grekët, bullgarët, malazezët, kroatët, e maqedonët e kanë përdorur strukturën e shtetit për të mbrojtur interesat e kombit të tyre, disa edhe kundër vetë interesave jetike të shqiptarëve dhe në kundërshtim krejt të hapur me vullnetin e Fuqive të Mëdha.

Me shqiptarët po ndodh ndryshe. Ndër shqiptarët, gjatë tranzicionit ndodhi e po vazhdon që të ndodhë e kundërta e asaj që ka ndodhur tjetërkund. Kudo, shqiptarët dhe paritë e tyre po shfaqin një kuptim të gabuar të rolit të shtetit, mendësi që shpesh arrin në interpretime absurde. Këto interpretime janë të motivuara nga interesa të tjera dhe, në rastin më të mirë, të mbështetura në përvoja eksperimentale apo në supozime thellësisht të gabuara apo të deformuara, lidhur me natyrën e sistemit ndërkombëtar dhe të strukturave të përshtatshme të një shoqërie moderne. Në veçanti, në shtetin shqiptar, paria dhe shtresa të caktuara po i kundërvihen stabilizimit real të shtetit sistematikisht dhe me konsequencë. Kundërvënia ka shkuar deri në atë pikë sa shteti konsiderohet, thujasë hapur, si një strukturë armiqësore dhe si një pengesë kryesore për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror.

Paria e Tiranës po punon intensivisht që shteti të jetë minimalist, tejet i dobësuar dhe i pafuqishëm. Paria nuk e ka problem që shteti shqiptar është i vënë nën kontrollin e grupimeve, që nuk ua duan të mirën vetë shqiptarëve. Paria nuk e ka problem që shteti është tejet i dobët, i kapur nga krimi, i personalizuar dhe pa rrënjë në një shoqëri që, tashmë, mundohet që t'i zgjidhë të gjitha problemet e veta në nivelin e bashkësisë lokale e të klanit katundar e të kriminalizuar. Ky është një proces që ka shumë kohë që është vënë në lëvizje, dhe, ç'është e vërteta, duhet shkuar mbrapa në kohën e sistemit të kaluar, dhe më larg në kohë, për t'ia gjetur rrënjët.

Mirëpo, gjatë tranzicionit, pikërisht kur duhej që, më shumë se çdo herë tjetër, të kishim një shtet relativisht të konsoliduar, efektet e shkatërrimit sistematik të shtetit, por edhe të mosndërtimit të tij kur u krijuan kushtet, kanë qënë e janë katastrofike në çdo nivel të imagjinueshëm. Dështimi i shtetit nuk është në qendër të vëmendjes, as të parisë, as të analistëve të shumtë të Tiranës, individë të arsimuar por të paedukuar, dhe as të grupimeve që po iu kundërvihen sjelljeve të parisë. Pse ndodh kjo?

Dy fjalë mbi shtetin

Shteti është forma më e lartë, më efektive dhe më moderne e organizimit shoqëror. Nga një anë, shteti është struktura autoritative dhe sovrane, njësia e pandashme dhe themelore e sistemit ndërkombëtar. Kur njihesh si shtet, në parim, ke sovranitet dhe autoritet të tillë që të lejon që të marrësh vendime në lidhje me çështje të politikës së brendshme e të jashtme, ashtu si e kërkon interesi jetik i shtetit. Edhe kur nuk ke qeveri si Somalia, ke shtet me kufinj të njohur dhe ndërhyrja e çdo shteti tjetër parimisht është e dënueshme.

Shteti është territori, por, mbi të gjitha, shteti janë njerëzit. Në çdo shtet, një grup i dallueshëm, paria politike dhe administrata, janë në kontroll të burimeve ekonomike, njerëzore, politike dhe ideologjike. Nëse paria i përdor burimet ekonomike, d.m.th., burimet njerëzore, natyrale, apo të mirat materiale që prodhon shoqëria, ashtu si duhet, ajo shoqëri do të jetë e begatë dhe me

një standard jete cilësor. Nëse paria e përdor fuqinë politike, d.m.th., institucionet e shtetit, që nga administrata tek ushtria, apo policia si duhet, atëherë rendi shoqëror do të jetë i përshtatshëm për zhvillimin e shëndetshëm të shoqërisë sepse ajo do të jetë e mbështetur mbi ligjin e mbi vlerat qytetare. Nëse paria i ndërton e përzgjedh strukturat ideologjike që të ndërtojë një sistem vlerash kulturore dhe ideologjike, që e mbajnë shoqërinë të lidhur si bashkësi dhe me sjellje të spikatura morale, atëherë qytetarët do ta mbështesin parinë dhe paria do të jetë e rrënjosur thellë në shoqërinë që drejton dhe do të ketë legjitimitetin për të drejtuar.

Rastet më të përshtatshme për ta ilustruar këtë argument janë gjermanët, sllovenët, apo izraelitët. Të gjithë këta shtete janë shtete-kombe demokratike, me vlera ideologjike të ndryshme, por të konsoliduara, me sisteme ekonomike të forta dhe me sisteme politike shembullore e legjitime. Pra, ndër format e shtetit modern, ka një formë që qëndron mbi të gjitha të tjerat, sepse është shprehja më e lartë e organizimit shoqëror, shteti-komb. Në formën e vet ideale, shteti-komb, që mund të jetë një komb qytetar apo etnik, e përcakton sjelljen e shtetit duke e konsideruar si parësor interesin shtetëror-kombëtar që, në këtë rast, shihet si i përputhshëm dhe i pandashëm.

Ky është edhe problemi themelor i ndërtimit të tranzicionit ndër shqiptarët. Interesi kombëtar dhe shtetëror, ai që duhej të ishte interes jetik për të gjithë, kërkon që shteti të vendosë shtërngesa të forta mbi sjelljen e parisë dhe të shtresave të tjera. Paria i ka refuzuar këto shtërngesa. Arsyeja është se konsolidimi i shtetit është në kundërshtim me interesat e saj si shtresë. Prandaj, nuk kemi as shtet të konsoliduar, as komb, as ekonomi efektive, as një sistem politik legjitim, as vlera të përbashkëta që e lidhin shoqërinë në nivelin moral. Prandaj, edhe tranzicioni ka dështuar.

Në nivelin ekonomik, në një shtet-komb normal, do të ketë pabarazi, por nuk do të ketë monopolizëm klanor dhe oligarki. Nuk do të ketë shfrytëzim irracional dhe të papërgjegjshëm të burimeve njerëzore, natyrale e të mirave materiale kombëtare. Sistemi ekonomik duhet të jetë një sistem tregu i institucionalizuar dhe i hapur por shteti do të mbrojë prodhuesit kombëtarë, sepse

kjo është në interes të të gjithë shoqërisë. Pa një shtet-komb të fortë e të lidhur pazgjidhshmërisht me qytetarët e tij, në nivelin ideologjik e të identitetit kolektiv, nuk mund të ketë as demokraci të fortë, as ekonomi tregu të institucionalizuar e të lulëzuar, as një shoqëri civile efektive, por as qytetarë të ndershëm e që i binden ligjit. Ndërtimi i shtetit modern me një regjim politik demokratik, ruajtja, kultivimi dhe konsolidimi i tij, si dhe përdorimi i të gjitha burimeve materiale e njerëzore që kishim për t'i vënë në shërbim të të gjithë qytetarëve duhej të ishte parësor. Ndër ne, ndodhi krejt e kundërta.

Problematizimi i gjendjes së shtetit ndër shqiptarët

Nuk është vendi këtu për të bërë apoteozën e shtetit e as për të analizuar të gjitha shkaqet që na kanë sjellë, ne shqiptarët, në këtë gjendje. Problemi bëhet i rëndë, kur kujtohet se kjo është gjendja edhe në shtetin shqiptar, që ka qenë një shtet shumë i konsoliduar, për disa dhjetra vjetra. Por, duke i mbajtur sytë nga e ardhmja, ia vlen të thuhet se pa një shtet-komb të konsoliduar nuk mund të ketë përparim, siguri, begati, e mirëqënie, për shqiptarët.

Shumë nga eksperimentet me shtetin, në Tiranë bëhen në emër të ligjit. Po të zbatoheshin si duhet ato që janë thënë në letër, në disa raste duhej të çonin në konsolidimin e shtetit dhe në një funksionim më të mirë të administratës shtetërore. Në fakt, rezultatet janë krejt e kundërta. Paradoksalisht, eksperimentet e ndryshme, që formalisht kanë si synim forcimin e shtetit, e kanë garantuar dobësimin e vetë shtetit dhe të strukturës së tij institucionale.

Shteti ka përfunduar duke humbur karakteristikat e veta thelbësore. Në lidhje me organizimin, shteti shqiptar është një strukturë e personalizuar, e sunduar nga klanet e parisë, që dalin në krye të shtetit me marrëveshje të hapur ose të fshehtë. Kontrolli mbi strukturat shtetërore është i feudalizuar dhe i përcaktuar me përqindje të sanksionuara me marrëveshje dhe pa legjitimitetin e duhur. Shteti nuk e ka ruajtur autonominë që duhet të ketë nga shoqëria që drejton dhe tashmë është një instrument i pakusht në

duart e parisë, që e përdor sipas nevojave të rastit, për të sunduar popullin. Shteti nuk ka sovranitet as të jashtëm, as të brendshëm. Në lidhje me territorin, kufinj të shtetit përcaktohen nga një marrëveshje private e sekrete e kryeministrit të rradhës. Strukturat e shtetit janë të dyfishuara, me një strukturë paralele që i është besnike kryeministrit të rradhës. Administrata është e përbërë nga individë që emërohen në baza politike e joprofesionale. Në këtë drejtim, shteti shqiptar është një shtet tipik i dështuar.

Shteti ka probleme të jashtëzakonshme, që nuk i përballon dot më si, bie fjala, presione të jashtëzakonshme demografike, zhvendosje të popullatës brenda vendit, probleme të pafundme me pronësinë, ikje e braktisje masive nga ana e popullsisë, zhvillim të pabarabartë ekonomik midis shtresave dhe rajoneve, kriminalizim të thellë dhe delegjitimim të shtetit, përkeqësim të shërbimeve publike, kriza politike të përhershme që shkaktohen, kontrollohen e drejtohen nga paria dhe mbi të gjitha, humbjen e aftësisë për të ruajtur sovranitetin e kufijtë e shtetit.

Shkurt, ndërtimi i shtetitkomb me një regjim demokratik, me ekonomi tregu të institucionalizuar e me një shoqëri të shëndoshë e me vlera të qëndrueshme morale, mbetet objektivi i papërmbyshur i këtij tranzicioni. Arsyeja nuk duhet kërkuar tek moskuptimi si duhet i rolit të shtetit. Arsyeja nuk duhet kërkuar tek mendësia e popullatës. Arsyeja duhet kërkuar tek mungesa e vullnetit politik nga ana e parisë së Tiranës, për të punuar në këtë drejtim. Mospërmbyshja e këtij objektivi ka qenë dhe mbetet shkaku kryesor i dështimit të tranzicionit, që nuk do të përfundojë derisa të ndërtohet shteti që duhet. Si pasojë, strukturat shoqërore, të konsoliduara në formën e klaneve oligarkike, kanë dalë sunduese. Shteti është i kapur e i kontrolluar prej oligarkëve, që janë në krye të segmenteve të parisë të organizuara në të ashtuquajturat partitë politike. Shteti shqiptar është tipik për këtë gjendje kur shteti është i personalizuar, i kriminalizuar, oligarkik dhe i kontrolluar nga paria.

Ndërtimi i shtetit si objektiv qëndror i tranzicionit

Ia vlen të bëj një digresion të shkurtër. Pavarësisht shumë gjërave që janë thënë e që thuhën për Lëvizjen Studentore të viteve 1990-1991, asnjëri nuk ka thënë e askush nuk dëshiron të pranojë, që ruajtja e shtetitkomb dhe vënia e tij në shërbim të të gjithë shqiptarëve, ka qenë objektiv kryesor dhe i pandryshuar i asaj Lëvizje Studentore. Ndoshta sepse nuk iu leverdis, por edhe ndoshta sepse e dinë që dikush mund t'i pyesë: "pse nuk e bëre ti atë gjë"? Paria refuzon të pranojë se ka pasur qëndrime të ndryshme prej atyre që ajo i përqafoi dhe promovoi publikisht dhe, me të gjitha mjetet e influencimit në dispozicion të saj. Si njëri nga ata që punoi për këtë qëllim, më duhet të them se pjesëmarrja ime në politikë ka qenë e motivuar pikërisht e vetëm nga ky qëllim, ruajtja e promovimi i interesave kombëtare në shtetin e shqiptarëve.

Pra, edhe kur ne, si studentë, e kemi kërkuar e marrë me forcë pluralizmin e vërtetë politik, ne e kemi kërkuar si një rrugë për të mbrojtur interesat e të gjithë shqiptarëve. Edhe kur i kemi mbledhur e i kemi bërë bashkë intelektualët që erdhën në Qytetin Studenti e që ende nuk e njihnin njëri-tjetrin, këtë e kemi bërë me bindjen se forca politike opozitare që do të lindte duhej të punonte që të mbronte shtetin-komb. Themelimi i PD-së, shembja e mitit të Enver Hoxhës e me rradhë kanë qenë të gjitha veprime politike të motivuara nga ky qëllim e objektiv qëndror. Duke qenë një grusht njerëzish, ne nuk arritëm që të bëjmë më shumë se sa të lëmë gjurmë, por që dëshmojnë për motivimin dhe bindjet tona. Por ato gjurmë, sado të parëndësishme të duken në kontekstin e tranzicionit, janë të mjaftueshme për të provuar se kishte edhe mendësi, individë e rrugë të tjera që nuk pajtoheshin me mendësinë dhe rrugën e zgjedhur nga paria e Tiranës.

Po cili ishte problemi kryesor? Ashtu si e shihnim ne, ndërtimi i shtetit demokratik ishte e duhet të jetë objektiv qendror i çdo force politike, që synon të punojë për shqiptarët. Shteti i kohës së Enver Hoxhës ka pasur shumë probleme dhe ia vlen të diskutojmë për to. Mirëpo, me përdorë një metaforë popullore, nuk e ka fajin makina, e ka shoferi. Problemi i madh i shqiptarëve ishte se si ta

shkëpusnim makinën e shtetit nga kontrolli i një grupi të caktuar e ta vinim në shërbim të mirëfilltë e pa kushte të popullit shqiptar.

Nga një anë, paria e kishte ndarë mendjen që kishte fituar kapitalizmi. Dhe në vendosjen e sistemit kapitalist ata donin që të ishin në kontroll të sistemit të ri. Ruajtja e shtetit ishte problematike. Shteti, për parinë, ishte një pengesë në vendosjen e sistemit kapitalist. Si paria mendonte edhe profesorati universitar, po edhe administrata. Në veçanti, këtu hynin edhe strukturat tejet të politizuara të sigurisë e të mbrojtjes. Nga ana e vet, paria luftonte që ata që do të merrnin pushtetin të mos gjenin asnjë institucion që të funksiononte si duhej. Inteligjencia dhe ata që po e merrnin pushtetin kishin një ide thujse artistike për shtetin modern dhe institucionet e tij e, njëkohësisht i druheshin një shteti të konsoliduar. Ajo që po ndodhte në mendjen e tyre, ishte përmbysja e sistemit dhe kthimi i armiqve personalë e klasorë në pushtet, qofshin të persekutuarit brenda vendit, të emigruarit apo edhe të përdorurit, që ishin të shumtë e me pakënaqësi të mëdha për sistemin. Nga ana tjetër, kishim një popull që, veçanërisht gjatë viteve 1980-të, kishte vuajtur shumë, edhe për bukën e gojës. Populli kërkonte rrafshimin e shtetit terrorist.

Kështu, me pak përjashtime, ndër të cilët fus veten dhe shokët e mi, në fillimet e tranzicionit askush nuk dukej se kishte pikë dëshire që të ndërtonte e të ruante bërthamën e institucioneve dhe të ndërtonte shtetin që duhej. Nuk ka kund shtet që funksionon pa polici, pa zbulim, pa ushtri, pa tatimorë, pa mësues, pa zyrtarë e me radhë. Të gjithë këto shërbyes të shtetit e pjesë integrale e tij, u luftuan pa mëshirë nga gjithkush që erdhi në pushtet. Synimi i përbashkët i tyre ishte që t'i përdorjnë e jo t'i mbikqyrin deri në atë pikë sa të mos cënohet funksionimi i tyre e të mos bëhet politicizimi i tyre. Të gjitha palët luftuan për instrumentalizimin e shtetit e të nëpunësve të shtetit, derisa erdhi puna që, mbas vitit 1992, nuk kishte më shtet të mirëfilltë dhe struktura autonome shtetërore në shtetin shqiptar. Ata që erdhën në pushtet nuk dinin si të drejtonin shtetin, ata që e lanë pushtetin, nuk donin të punonin për ata që nuk dinin. Të dy palët e konsideronin tjetrin si armik. Por secili grup po turrej për të marrë atë që nuk e

kishte. Inteligjencia po kërkonte kontrollin e shtetit. Paria e vjetër po kërkonte kontrollin e ekonomisë. Tashti që janë rivendosur ekuilibret po qeverisin me përqindje. Së shpejti do të kemi edhe një qeveri teknike.

Kështu, në vend të lidhjes profesionale e institucionale të mbrojtur nga ligji, shërbyesit e shtetit u lidhën me personat që ishin në krye të klaneve të parisë dhe shteti u kap nga segmentet e parisë së Tiranës, kësaj radhe të zgjeruar me “intelektualët e shquar” dhe profesoratin e universitar. E çliruar nga zgjedha ideologjike, nga kontrolli i rreptë partiak dhe nga rregulli formal institucional, paria e re e Tiranës shumë shpejt e ktheu shtetin dhe shërbyesit e shtetit në peng të vetin. Si pasojë, literalisht, nga viti 1992, në shtetin shqiptar, makina e shtetit është zbërthyer pjesë-pjesë dhe është hedhur në plehra. Gomat e motori i makinës së shtetit iu janë vënë qerreve partiake që, figurativisht, prapë po tërhiqen me krahë, si dikur në kohët e lashta apo mesjetare dhe që janë vënë në shërbim të segmenteve të parisë oligarkike të Tiranës.

Shkurtazi, kjo që ndodhi në shtetin shqiptar, po kopjohet e riprodhohet edhe në trojet e tjera shqiptare. Problemi është se, gjithkund ndër shqiptarët, shteti po përdoret si instrument kundër vetë interesave shqiptare. Strukturat shoqërore tradicionale e partiake kanë dalë fituese dhe, në dukje, kanë minuar mundësinë e funksionimit të shtetit që duhej modernizuar e reformuar, por jo shkatërruar me rrënjë siç ndodhi. Shtetet ku jetojnë shqiptarët, e në veçanti shteti shqiptar, janë vetëm *pro forma* shtete në shërbim të qytetarëve. Në realitet, strukturat shtetërore janë kthyer në struktura mafioze e në organizata kriminale, në duart e oligarkëve dhe të vëna pa kushte në shërbim të interesave të tyre private e të klaneve të parive respektive.

Ia vlen ta theksoj që kjo nuk është një dukuri e kufizuar vetëm në shtetin shqiptar, anipse këtu paria i trajton hapur shqiptarët si një popull që iu ka rënë për hise. Një nga paradokset mbarëshqiptare të tranzicionit është se të gjithë oligarkët e parive të Tiranës, të Prishtinës e të Shkupit e kuptojnë jashtëzakonisht mirë domosdoshmërinë e ndërtimit e të konsolidimit të shtetit për

të siguruar mbarëvajtjen e punëve të shqiptarëve por askush nuk po punon seriozisht për këtë gjë. Të gjithë palët punojnë pikërisht për të kundërtën.

E vërteta është që ka disa zëra në nivel partiak apo mediatik që flasin për ndërtimin e shtetit. Por, në të vërtetë asnjëri prej tyre nuk po punon si duhet për të ndërtuar shtetin e vërtetë, për ta bërë atë funksional e për ta vënë në shërbim të shqiptarëve. Problemi është se këta individë nuk dalin dot nga mendësia, kontrolli e strukturat e parisë, pjesë e të cilës edhe janë. Shpesh, politikanët shqiptarë as nuk lodhen për të folur për këtë temë. Kur flasin kanë ndërmend vetëm gjëra të përgjithshme e përqëndrohen në politikën e jashtme, sidomos në temën e preferuar të “integritimit europian”, apo “të integritimit euroatlantik”. Kjo është një fushë ku, natyrisht, ata dallohen, sepse po i japin mend e zgjidhje problemeve botërore, si luftës kundër terrorizmit, krizës ekonomike botërore, epidemisë së gripit të derrave e me radhë.

Paradoksi më i madh është se gjithkund paritë oligarkike, që sundojnë shqiptarët, bëjnë të kundërtën e asaj që duhet bërë dhe në këtë gjë ato duken se janë të mbështetura nga masat e gjera të popullit. Shembulli më i mirë është ajo që po ndodh në shtetin shqiptar. Duhet thënë se në gjendjen e tanishme, duket sikur është arritur pika më e ulët e mundshme dhe lidhja e shqiptarëve me shtetin është shumë e dobësuar dhe aspak efektive. Askush në Tiranë nuk e do një shtet relativisht të fortë kombëtar shqiptar dhe askush nuk punon si duhet për ndërtimin e shtetit shqiptar.

Pse jemi në këtë gjendje?

Pse ndodh kjo gjë? Nga një anë, problemi është i lidhur direkt me interesat e parisë. Paria e Tiranës nuk ka interesa për të pasur një shtet të fortë shqiptar, që është në shërbim të shqiptarëve, që i kontrollon ata dhe që i vë përpara përgjegjësisë. Interesat e saj janë të shumta dhe prekin të gjithë sferat e aktivitetit të shtetit. Në fushën ekonomike, një shtet normal do të taksojë, kontrollojë e t'i vërë kufi sjelljes banditeske të klaneve, që sundojnë në një periudhë të caktuar. Kështu monopolet dhe oligarkia e tyre do

të vihen në diskutim. Bashkë me rrezikun që përfaqëson një shtet i konsoliduar për interesat ekonomike të parisë, vjen edhe autonomia e shtetit nga paria. Një shtet autonom, nuk e lë parinë që të sillet me shtetin ashtu si i intereson asaj. Në mungesë të një ekonomie të qëndrueshme, pasurimi vjen nga thesari i shtetit. Paria nuk mund të lejojë që shteti të mos lejojë kleptokracinë e hajninë klanore, që e gërryen shtetin dhe e bën të pafuqishëm.

Në nivel të vlerave, paria nuk mund të lejojë që të formësohet e të stabilizohet një shoqëri, e cila ka vlera dhe që është e lidhur me shtetin, pse gjen mbrojtje, ruajtje të nderit e të dinjitetit, por edhe shërbime nga ana e shtetit komb. Paria ka nevojë që të ketë një shoqëri të kriminalizuar, që nuk i beson shtetit, që kontrollohet prej saj dhe që është moralisht e rënë dhe e fragmentarizuar. Ata mund të sundojnë vetëm e vetëm kur shteti nuk është në gjendje të mbrojë veten, por as edhe shoqërinë. Pra, çfarëdo fuqizimi i shtetit shqiptar do të ketë pasoja për zotërimet e tyre jeniçere e për monopolet që ata kanë krijuar. Këta që janë pasuruar me krim, nuk kanë interes që të bëhet një shtet i fortë, sepse e dinë mirë, e para gjë që një shtet i tillë do të bëjë, do të hetojë se si i kanë vënë ato miliardat e tyre.

Mirëpo, sjellja e parisë është pastërtisht kriminale. Ndaj edhe armiqësia e parisë karshi shtetit është e të njëjtës natyrë si armiqësia e cubit dhe e hajnit ndaj policit dhe kjo armiqësi do të përcillet edhe në brezat e parisë, që janë duke hyrë në jetën publike, apo që do vijjnë më vonë. Edhe ata që do të vijjnë pas tyre, në dy-tre breza, do të jenë tërësisht të kriminalizuar dhe pjesë e mafias klanore e familjare, sepse do të bartin vlerat, mendësinë dhe moralin e grupit nga vijnë. As etërit e as bijtë e bijat e tyre nuk e duan ligjin, thjesht sepse ata e kanë vënë pasurinë me rrugë të paligjshme, e ruajnë me rrugë të paligjshme dhe ligji iu cënon pasurinë që ruhet po me lidhjet e jashtëligjshme. Nuk ka ndonjë arsye pse paria e Tiranës e pinjollët e tyre do të vendosin që të prishin ekuilibrin kriminal të arritur midis oligarkisë sunduese e një shteti tejet të dobët, kur kjo gjendje iu shërben.

Gjendja duket edhe më kritike, kur duhet të llogariten edhe shtresat e tjera dhe individët që përfitojnë prej kësaj gjendje. Ata

që sot i shkojnë mbrapa klaneve të parisë, sejmenët, gangsterët dhe lamashët e tyre, nuk do ta tolerojnë një ndryshim të tillë. Banditët, që po përfitojnë nga ky sistem, por edhe që garantojnë sundimin e parisë, nuk dinë të sillen ndryshe. Ka ardhur puna që paria është e kapur deri në atë pikë sa këta individë e klane mafioze të nëndheshme nuk do ta lejojnë parinë që të ndrrojë rrugë.

Nga ana tjetër, rregullat e ligjet e pazbatuara dhe normat shoqërore sunduese kanë krijuar një sistem, që e mban shtetin peng të pazgjdhshëm të parisë, dhe që e bën atë tërësisht inefektiv dhe të paralizuar. Për më tepër, kjo gjendje nuk lejon as ndryshimin e as përmirësimin e shtetit nga brenda. Kush synon që të hyjë në lojën e tyre, duhet ta luajë lojën me rregullat e tyre, duhet të silllet si ata e të bëhet si ata. Viktimat më të fundit janë të rinjtë e të rejtat që kthehen me entuziazëm për të bërë diçka në shtetin shqiptar e që po thehen në mënyrë të pariparueshme. Kjo ndodh sepse kontrolli i parisë mbi shtetin është i hekurt. Si ata që hyjnë në politikë, ashtu edhe ata që punësohen në shtet, përfundojnë në vegla të hapura të sistemit oligarkik. Nuk mund të ndryshohen as partitë e parisë, dhe as struktura e shtetit ekzistues nga brenda, thjesht se nuk del dot kush mbi ujë, pa kaluar në njëmijë e një prova, që e zhveshin gjithkënd nga çdo vlerë njerëzore dhe që e bëjnë vegël të pakushte të parisë së Tiranës.

Justifikimet ideologjike të parisë

Në nivelin ideologjik, paria e Tiranës i ka gjetur dhe i ka përdorur të gjitha justifikimet e mundshme për të mbuluar dëmin që ka shkaktuar dhe për të hedhur përgjegjësinë mbi shkatërrimin e shtetit, të hallkave që e lidhin atë me masën e qytetarëve, si dhe të strukturave legjitimuese. Duke vepruar kështu, paria ia ka arritur që të shmangë përgjegjësinë nga shtesa, duke mos lënë që të ndërtohet shteti që u duhet shqiptarëve. Arsenali i argumenteve të përdorura nga paria është shumë i pasur, por të gjitha ato argumente janë totalisht të mangëta. Ndër argumentet që bien më shumë në sy janë mospajtueshmëria midis demokracisë dhe shtetit të fortë, mendësia e shqiptarëve, influenza e huaj dhe

nevoja imperative e integritimit europian.

Si justifikim për shtetin e dobët përmenden *Zeitgeist* i kohës dhe ideologjia liberale. E megjithatë, nuk na shpjegohet se pse demokracia dhe liberalizmi nuk po i pengon shtetet e Europës Perëndimore e kombet fqinje që të kenë shtete të konsoliduara e demokratike. Edhe Maqedonia, që është një shtet i pastabilizuar, ka një shtet në shërbim të një kombësie të caktuar.

Disa analistë duan t'ua lënë fajin shqiptarëve dhe mendësisë së tyre. Mirëpo shqiptarët iu kundërvunë idesë së një shteti të fortë në fillimet e tranzicionit, sepse dolën nga një periudhë tragjike. Shqiptarët po dilnin nga një sistem në të cilin, shteti ishte tërësisht i instrumentalizuar nga paria dhe në shërbim të saj. Sapo iu dha mundësia që të integrohen në shoqëri me shtete të konsoliduara, shumica dërmuese e shqiptarëve u sollën e sillen si qytetarë shembullorë. Vetë pjestarët e parisë kur dalin jashtë vendit sillen si njerëz normalë, që i njohin dhe i respektojnë rregullat. Nuk mund të identifikohet kombi shqiptar me një masë njerëzish, që u sollën si banditë në fillimet e tranzicionit, si brenda shtetit ashtu edhe jashtë tij.

Përmenden edhe të huajt, si shkaku kryesor i ndërtimit të një shteti të dobët. Mirëpo segmentet e parisë nuk i ka detyruar njeri që të sillen në këtë mënyrë. Ata e kishin një rrugë tjetër. Ata mund t'ia thonin të vërtetën popullit, mund të ndrronin rrugë, mund të dilnin edhe krejt nga politika, po të kishin parime. Mbi të gjitha, nuk na thuhet se pse segmentet e parisë u instrumentalizuan dhe u bënë vegla të pastra në shërbim të interesave joshqiptare. Nuk na thuhet se pse segmentet e parisë e përdorën shtetin si mëkëmbës të dikujt e jo si qeveritarë në shërbim të popullit të vet. Nuk na thuhet pse u nisën të shkatërrojnë çdo gjë, pse vendosën që "gjithçka do të fillohet nga zero", pse e bindën popullin se shteti ishte armiku dhe se shteti ishte struktura më negative që duhej shkatërruar me çdo kusht. Nuk na thuhet se pse paria dhe eksponentët e saj u vunë në shërbim e në krye të bandave mafioze e të klaneve kriminale. Nuk na thuhet pse edhe kur e kishin mundësinë me ndërrue rrugë, këta u sollën si banditët që i ndiqnin nga pas. Nuk na thuhet pse këta punuan me ndërgjegje kundër popullit të vet.

Megjithatë, kur vjen puna tek influenza e parisë, nuk na thuhet që fenomeni më shqetësues është ajo që po ndodh me shoqërinë shqiptare. Në shtetin shqiptar është arritur ekuilibri i krimit, diçka që mafia e bota e krimit të çdo vendi do ta kishte zili. Shteti normal duhet që të ofrojë mbrojtje të nderit, të jetës, të pasurisë e të sigurojë mirëqënien e ardhmërinë e qytetarëve të vet. Mirëpo në shtetin shqiptar, çdo problem që ka individit zgjidhet duke e anashkaluar shtetin dhe duke iu drejtuar strukturave private, që përmes partive të parisë, marrin kontrollin e shtetit dhe e vënë atë në shërbim të klientelës së tyre. Tashmë, shtetasit, e në veçanti shqiptarët, janë të bindur, se vetëm ashtu mund të mbrohen interesat e tyre. Tashmë, shumë njerëz janë të bindur që ky është modeli që duhet të ndiqet.

Të gjithë shtetasit i kanë forcuar lidhjet e tilla shoqërore, duke krijuar një shoqëri që e bën shtetin jo funksional. Kultivimi i lidhjeve të tilla, përmes të cilave mbrohet interesi i vetes dhe i familjes, është detyrë parësore e gjithkujt. Individët iu shërbejnë pikësëpari atyre lidhjeve, mosbesimi karshi shtetit është në rritje të madhe; nderi ruhet vetëm kur ke mbrojtje të tillë e pasuria po vihet e po mbrohet po përmes këtyre lidhjeve. Në vend që të jenë njerëz që jetojnë me nder në vendin e tyre, shqiptarët po manipulohen që të bëhen ushtarë (jeniçerë, bashibozukë, mamlukë e martallozë) të familjeve kriminale të parisë së Tiranës. Mbështetja më e mirë për këtë argument është korrupsioni i kudogjendshëm, kriminalizimi i përplotë, gangrena që i ka hyrë deri në palcë shoqërisë shqiptare.

Cilat janë pasojat e dështimit të shtetit

Pra, shteti është i dështuar. Cilat janë pasojat e këtij dështimi për të ndërtuar shtetin që duhet? Pasojat e këtij dështimi për të ndërtuar shtetin që duhet kanë qenë e janë tragjike. Nuk ka dyshim që në të ardhmen do të vazhdojmë që të paguajmë një çmim edhe shumë më të lartë se ky që po paguajmë sot. Pa shtet nuk ka as progres, as siguri, as identitet, as zhvillim ekonomik, as shoqëri të shëndoshë, as pasuri, as modernitet, as të drejta, as detyra, as respekt në botë e në shoqëri. Pa shtet të fortë e me autoritet, ashtu

si thotë Hobbes, shoqëria i kthehet gjendjes së natyrës dhe *status naturalis* është një gjendje lufte, ku njeriu për njeriun është ujk.

Në themel të këtij dështimi është bindja dhe besimi i parisë, se mbasi ata do të bëhen borgjezia, do të mund të krijojnë edhe shtetin që iu duhet. Kjo bindje është thellësisht e gabuar dhe tregon një kuptim të cekët të shtetit modern dhe të lidhjes që ai duhet të ketë me popullin e vet. Shteti nuk është vetëm qeveria dhe institucionet. Shteti janë qytetarët. Mbi të gjitha, shteti ekziston në vetëdijen e tyre si pjestarë të një bashkësie ligjore-politike, të cilët i shërbejnë shtetit ashtu si shteti i tyre iu shërben atyre. Por, kuptimi i cekët i shtetit që ata demonstrojnë me sjelljen e shprehjet e tyre, si dhe ngushtimi i rolit të tij në jetën shoqërore, nuk vjen sepse ata nuk e dinë se si duhet vepruar. Kjo ndodh sepse parisë nuk i intereson që të bëhet ndryshe e të veprohet ashtu si duhet.

Lufta e hapur e parisë për ta përdorur shtetin shqiptar si veglën në shërbim eksklusiv të tyre, si dhe refuzimi për të ndjekur rrugë të tjera janë fakte shoqërore lehtësisht të sprovueshme. Gatishmëria e tyre për të bërë gjithçka, por vetëm e vetëm për të mos u vënë në shërbim të shtetit, e për të mos lënë shtetin që t'i kontrollojë ata; kjo si është një shenjë e qartë e interesave që ata kanë, por edhe e shkallës së degjenerimit moral, si dhe e kriminalizimit të plotë të tyre. Problemi është komplikuar edhe për shkaqe të tjera, por që të gjitha të lidhura me sjelljen e parisë. Me largimin e me shuarjen e një shtrese të zyrtarëve që e kuptonin mirë disiplinën burokratike e kulturën institucionale, me rritjen e varësisë së individit nga strukturat shoqërore e klanore, me lokalizimin e problematikave të të zgjidhjeve, si dhe me humbjen e respektit të qytetarëve ndaj shtetit, po dobësojmë e dëmtojmë çdo mundësi për të rindërtuar shtetin që duhet. Si pasojë, po rrënohet edhe e ardhmja e brezave që vijnë. Edhe kësaj here, si në ndërrimet e tjera të pushteteve e të parive në historinë tonë, mund të thuhet se “kaq ditëm e kaq bëmë”. Por, të gjithë e dimë që e vërteta është ndryshe. Po ashtu, dimë edhe se kush është përgjegjës për ndërtimin e një shteti gangsterial, mafioz e kriminal si ky që kemi sot.

Nga vjen zgjidhja

Nga vjen zgjidhja? Problemet me këtë shtet gangsterial janë shumë, por ia vlen të thuhet se ndryshimi nuk vjen nga paria e Tiranës. Ndryshimi nuk mund të pritët të vijë prej saj e nuk do të vijë prej saj. Arsyeja është se paria e Tiranës nuk di se si të sillet ndryshe dhe, më keq se aq, paria nuk do që të sillet ndryshe. Familja kriminale i ka ngritur në këmbë, klani kriminal i mban në këmbë. Dhe për klanin ata do të bëjnë gjithçka. Ata do të luftojnë kundër shtetit. Ata do të punojnë që të kriminalizojnë shoqërinë. Mbi të gjitha, ata do luftojnë edhe që të kriminalizojnë vetë fëmijët, pjellën e tyre. Për më tepër, as ata që u shkojnë mbrapa nuk mund të pranojnë rrugë të tjera sjelljeje, rrugë të ndershme e normale, sepse kështu janë mësuar e stërvitur, nuk dinë ndryshe. Shefi shkon e vjen, metoda e kriminelit nuk ndryshon, sepse banda që e mban peng shefin e rradhës nuk e ka ndërruar mendësinë e saj.

Nga ana e vet, paria e ka shtyrë popullin që të përfitojë e të kriminalizohet po ashtu. Në shtetin shqiptar nuk e gjen një njeri që të arrijë të mbijetojë me nder e duke respektuar ligjin, sepse ashtu nuk fitohet as buka thatë e gojës. Dhe, pikërisht këtë ka dashur e do paria. Ajo ka punuar e luftuar që të gjithë shqiptarët të jenë pjesë e një strukture kriminale, me mendësi kriminale, njerëz pa nder e pa vlera e të vënë pa kushte në shërbim të parisë e të planit të saj. Objektivi i parisë për të ruajtur zotërimin e saj jeniçero-mamluk në shtetin shqiptar kërkon një shoqëri të katundarizuar, pa moral, pa vlera, që nuk ka siguri as për jetën, as për nderin e as për bukën e gojës.

Ngado që të shkojnë shqiptarët, ata duhet që të punojnë për ndërtimin e shtetit. Në mos sot, nesër ata do të detyrohen që të punojnë për shtetin dhe të ndërtojnë një shtet, që, në mos qoftë i tyre, do të jetë i tjetërkujt. Por pa ndërtuar një shtet normal, demokratik, legjitim, autonom, me identitet, që mbështet e që zhvillon një ekonomi tregu të institucionalizuar, në të cilin paria kontrollohet nga struktura ligjore të forta, nuk mund të ketë mbyllje të tranzicionit. Ekuilibri i kriminimit që sundon sot në shtetin shqiptar mund të zgjasë edhe disa kohë, por vetëm një shtet që

bart atributet e numëruara në fillim të shkrimit, d.m.th., një shtet-komb, me një ekonomi tregu të institucionalizuar, me një sistem politik demokratik, me kulturë politike, vlera dhe ideologji kombëtare, dhe që është i aftë të përdorë burimet njerëzore, materiale, politike dhe ideologjike me efektivitet dhe në shërbim të popullit, do të jetë i pranueshëm dhe legjitim.

Zgjidhja vjen nga një grup që mund të lidhet bashkë për një ideologji të caktuar. Ky grup duhet të luftojë që të mos jetë pjesë e krimit të parisë, por që ta shohë veten në shërbim të shtet-kombit. Ky grup duhet të jetë në gjendje të ndahet nga interesat e veta të ngushta personale, deri në atë pikë, sa ta identifikojë veten me shtet-kombin e vet. Dështimi i deritashëm i shumë individëve që kanë hyrë në politikë dhe që premtonin shumë, rrjedh prej faktit se ata nuk e kuptuan dhe nuk e parashtruan rrugën se si shteti duhet ndryshuar e se si duhej bërë pjesë kryesore e zgjidhjes së problemeve të qytetarëve e jo të ishte thjesht një strukturë që duhej kritikuar nga pozitat e interesave të tyre të ngushta si shtresë. Grupimi, që mund të sjellë ndryshimin, duhet të dalë me një platformë që të diskutohet seriozisht e që të ketë e të ofrojë mundësi, si për qytetarët ashtu edhe për parinë, që të dalin nga qerthulli ku janë të mbërthyer.

Të gjithë shqiptarët, edhe vetë paria kërkon zgjidhje. Askush më shumë se vetë paria nuk është e vetëdijshme se rruga që kanë ndjekur deri më tash është njëlloj si rruga e Ferrit. Ngado që të shkojnë do të përfundojnë të humbur. Ky është një dështim që e shohin dhe e jetojnë përditë në jetën e tyre. E tash që i kanë vënë pasuritë, ata po shfaqin një sjellje ambivalente. Ata edhe e duan, por edhe e kanë shumë frikë një shtet që mundet edhe t'i legjitimojë, por edhe t'i ndëshkojë. Kjo është arsyeja e paralizës së tyre.

Nga ana e vet, njerëzit e thjeshtë kanë filluar që t'i kuptojnë arsyet pse u duhet shtet-kombi normal. Vetëm me një shtet-komb normal, me shtërngesat që ai të imponon, por edhe me mundësitë që ai të krijon, vjen edhe begatia, liria, rregulli i duhur shoqëror, si dhe nderimi e dinjiteti që gjithkush e admiron në kombet e në shtetet e suksesshme. Shqiptarët që kanë bërë shtete për të tjerët,

duhet të kthehen nga vetvetja, të punojnë që të bëjnë shtetin e tyre, për veten e tyre, për të ardhmen e tyre.

PARIA E TIRANËS DHE SHTERPËSIA E FUSHATËS SË SAJ ELEKTORALE

Fushata zgjedhore është në kulmin e vet. Zallamahia dhe sensacionalizmi mediatik janë intensifikuar në një nivel marramendës. Programet politike janë pa brumë e merren thjesht me çështje teknike. Sloganet janë fare pa përmbajtje. Prijatarët partiakë janë të sharlatanizuar. Demagogjia e tyre nuk njeh kufi. Ja për shembull se si u shpreh Sali Berisha në Synej të Kavajës, një komunë me shtatë fshatra:

“Në tërësi ne po realizojmë këtu qytetarizimin e plotë të fshatit dhe komunës tuaj. Syneji është një nga komunat më të fuqishme të vendit, si në potencialin e saj turistik, ashtu dhe në atë bujqësor”, u shpreh kryeministri Berisha. Në këtë drejtim, ai ftoi kryetarin e komunës që të përgatisë çdo projekt për komunën e Synejt, pasi qeveria është e gatshme t’i financojë ato. “Jemi të gatshëm t’i rrisim edhe dhjetë herë të tjera investimet në këtë komunë, deri sa Synej të shndërrohet në një lagje të vërtetë të qytetit”, tha kryeministri. Sipas tij, ‘Synej ka një perspektivë të madhe turistike dhe kompani të mëdha botërore kanë treguar dhe tregojnë interes të madh për brigjet e kësaj komune.’”

Në fakt në emisionin e lajmeve ai dëgjohej e shihet duke thënë qartë, “Thoni kryetarit tuaj të më sjellë çdo projekt e unë do ta bëj. Rroftë Syneji!” Por edhe më interesante duken krahasimet dhe premtimet elektorale, që ai bën në Synej, një komunë me shtatë fshatra të vogla, ku nuk ka ujë të bollshëm e asnjë objekt kulturor me rëndësi lokale. Lexuesi duhet të mbajë mend se Syneji është në

rrethinat e Kavajës, një qytet me rreth 90,000 banorë, por që është lënë mbas dore nga të gjitha qeveritë. Vetë Kavaja, edhe bashkinë e ka të marrë me qera nga një person privat, nuk ka bibliotekë, ka një shesh qëndror; po aty mbaron gjelbërimi i qytetit, nuk ka një park lodrash për fëmijët, ka pasur një kinema, por që e bënë bingo, nuk ka as edhe një banjo publike. Natyrisht, nuk e ka më një fabrikë prodhimi. Ja si shprehet kryeministri Berisha:

“Po shkojmë drejt zgjedhjeve dhe ne kemi ndryshuar Shqipërinë, kemi ndryshuar Synejn, por Shqipëria dhe Synej kanë nevojë për ndryshime të tjera akoma edhe më të mëdha, të cilat ne do t'i bëjmë. Syneji, Kavaja dhe Shqipëria kanë nevojë që ju, të dashur qytetarë, të gëzoni ato standarde që gëzojnë edhe qytetarët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, në mënyrë që ju kudo që jeni të keni ujë 24 orë, të keni rrugë të asfaltuara, të keni shkolla moderne, të keni pensione të njëjta me disa nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Në rast se në katër vitet që kaluan, ne dhjetërafishuam mbështetjen për fshatin me rrugë, ujësjellës, kanalizime, shkolla, por edhe me financime për projekte bujqësore, në katër vitet që vijnë do të mbulojmë me subvencion të gjitha sipërfaqet tuaja të mbjella, do të subvencionojmë inputet tuaja, do të subvencionojmë edhe naftën. Kjo do të bëhet mbi bazën e sipërfaqeve të mbjella. Gjithashtu, ne do të financojmë çdo projekt tuajin. Ju hartoni projektet për feramat tuaja, ndërsa ne do t'i financojmë ato.”

Kjo është demagogji e pastër. Syneji është katund, banorët e Synejit janë katundarë, rruga përdoret për të kaluar bagëtitë e imta dhe nuk është bulevard, dhe ‘inputet e Synejit’ janë mjelja e deleve dhe e lopëve. Problemet me këtë nivel demagogjie politike, që është në kufirin e talljes së hapur me banorët e Synejit, janë të shumta. Problemet më këtë demagogji të gjithkundgjindshme janë të lidhura me prijatarët, me programet politike, me kandidatët, me ideologjitë, si dhe me personalizimin e debatit politik. Natyrisht, nga një këndvështrim tjetër, mendësia e njerëzve, apo pajtueshmëria e tyre me këtë sjellje, duhet vlerësuar me gjithë peshën që ka.

Programet Elektorale

Ndërmjet të tjerash, së pari, duhet vënë re që problemi më i madh është se programet elektorale të partive nuk gjinden kund. Për çfarë arsyeje do t'i zgjedhim partitë? Çfarë do të bëjnë këta në katër vitet e ardhshme? Programet e botuara (me gjashtë pika apo me 1000 faqe) janë për të të ardhur keq. Jo vetëm që programet nuk merren me problemet e vërteta të shoqërisë shqiptare, por ato përqëndrohen në diskutime dytësore për anë teknike. Shpesh, programet merren me çështje dytësore, fare të parëndësishme, dhe janë me mangësi të theksuara në drejtim të zgjidhjes së problemeve të mëdha.

Po ashtu, programet janë botuar në disa gazeta, që nuk i blen kush. Edhe më keq, askush nuk merret më me programet, as kandidatët as zgjedhësit, as prijatarët partiakë. Nuk ma merr mendja se ata që shkojnë nëpër mitingje i kanë lexuar programet. Shumica janë atje me detyrim, sepse përndryshe humbin punën ose shkollën etj. Nga ana tjetër, duke e parë cilësinë e fjalimeve e të diskutimeve të kandidatëve të ndryshëm për deputetë, me thënë të drejtën, kam frikë se as vetë kandidatët për deputetë nuk i kanë lexuar programet e partisë së tyre. E si t'i lexojnë? Kjo më sjell tek problemi i dytë. Shumica e kandidatëve janë "bisnesmenë" me interesa të gjera, që nga importi i qepës tek piramidat e universiteteve private. Kandidatët kanë halle të tjera që do t'i zgjidhin në politikë e përmes politikës. E sa për programet, ato dhe materialet e tjera partiake janë për prijatarët dhe për vëzhguesit e huaj, që me siguri, nuk i kanë lexuar me vëmendjen që meritojnë.

Së treti, partitë politike janë shkrirë në masën e mitingashëve. Mitingu është forumi qendror i organizimit politik, që tashmë e ka zëvendësuar strukturën e partisë. Katër mitingje në një katund me disa mijë vetë e pesë mijë vetë secila kanë nxjerrë katër partitë kryesore në mitingjet e tyre respektive në atë katund të zgjeruar në rrethin e Beratit. Kështu është vepruar e vazhdon të veprohet kudo. Por për të kuptuar kotësinë e programeve e të sjelljes së duhur, më parë duhet të konsiderohet xhuvelizmi dhe mandej të kalohet tek personalizimi i përplasjes politike.

Fenomeni Lufter Xhuveli

Nga të gjithë politikanët, vetëm Lufter Xhuveli, themeluesi dhe kryetari i partisë fantomatike, *Partia Agrare Ambjentaliste* u soll me ndershmëri, d.m.th. me një shprehje popullore, “e bëri si burrat”. Ata 27 vetë që e mbështesin në Vlorë, Xhuveli i mblodhi në një restaurant. Fjalimi i tij nuk u dha me zë në televizion por, manifesti i Xhuvelit ishte i qartë dhe i ndershëm: kaq kam mbështetje, kaq edhe do t’i mbështes kur të bëhem ministër prapë.

Mirëpo sjellja e tij tregon edhe një përpjekje thjesht për t’u dukur se po bën fushatë. Xhuveli është një politikan, i cili i ka dhënë emrin praktikës më të dallueshme e më të njohur të arrivizmit politik, *xhuvelizmit*, d.m.th., bërjes koalicion me fitimtarin e radhës, pavarësisht nga ideologjia, vlerat, morali apo nga pikëpamjet agraro-ambjentaliste të fitimtarit të zgjedhjeve. Xhuveli duhet të bëjë fushatë, edhe pse ai është i vetëdijshëm që vendin në koalicion nuk ia garantojnë votat që merr. Vendin në koalicionin e ardhshëm fitues ia garanton fakti se ai është pjestar i besuar i parisë. Xhuveli është një pjestar i besuar i parisë, që vjen nga profesorati universitar dhe paria dytësore politike. Duke qënë në krye të Partisë Agrare Ambjentaliste, ai ka krijuar monopolin në këtë drejtim, dhe nuk ka parti tjetër që mund të dalë që ta spostojë Xhuvelin në këtë ‘specializim’ të tij në spektrin e partive të Tiranës.

Nga një anë, ky eksponent i parisë sunduese që i ka mbaruar studimet universitare si agronom në vitin 1962, ka kredencialet politike dhe profesionale për të folur me përgjegjësi e kompetencë. Xhuveli ka tituj sa të duash: Anëtar i PPSH, Profesor, Doktor i Shkencave, Shef i Seksionit të Bujqësisë në Berat, Dekan, Rektor i Institutit Bujqësor të Kamzës, Ish-Nënkryetar i Komitetit për Marrëdhëniet me Popujt e Ballkanit, Anëtar i Këshillit Presidential të Shkurtit 1991, ish-Ministër i Ambjentit, Ujrave e Pyjeve, etj. Por, Xhuveli ka edhe garancitë që i nevojiten parisë për të qënë e sigurtë që ai nuk del nga shinat. Ky politikan “agraro-ambientalist”, sipas gazetave, dhe akuzave të njëkohëshme të “*Mjaft*” është edhe pronar i një fabrike për djegjen e gomave në Fier e të një tjetre në Fushë-

Krujë, si dhe pronar i pasurive të ndryshme të shpërndara në Fier, Tiranë, Qerret, Sarandë e me rradhë. Në këtë kohë, Xhuveli është Këshilltar i Kryeministrit Sali Berisha për Ambjentin. Kryeministri sapo ka vendosur që të lejojë Italinë që të eksportoje plehrat dhe mbeturinat e spitaleve në shtetin shqiptar, një veprim që është kundër të gjithë interesave jetike shqiptare. Me siguri edhe ky vendim e ka marrë miratimin e Këshilltarit për Ambjentin.

Xhuveli, njëri nga 60 doktor profesorët që kishte shteti shqiptar në vitin 1989, është pjestar emblemantik i inteligjencias shërbyese besnike të sistemit të mëparshëm, i “intelektualëve të shquar” dhe i profesoratit universitar. Si Xhuveli, janë shumica e “ish-intelektualëve të shquar” dhe e ish-profesorëve universitarë. Shembull, në fushën ekonomike është Anastas Angjeli, njeriu që përfillet si njëri nga njerëzit më të pasur në shtetin shqiptar. Sot, si Anastas Angjeli gjenden edhe individë si Tritan Shehu apo Adrian Civici, që janë në krye të strukturave universitare private. Ka të tjerë, si Servet Pëllumbi, që përmenden se janë të përfshirë indirekt në fushën e biznesit të birrës, për të mos folur për figura të tilla politike-letrare të sistemit të shkuar si Dritëro Agolli, që përfillet sikur, për hir të biznesit të dhëndrit, panairit në Pallatin e Kongreseve, e përdor influencën e tij tek të gjithë ata që duan të kenë një takim me të.

Dyftytyrësia e Xhuvelit shihet qartë në sjelljen e tij lidhur me politikën agrare-ambjentaliste dhe me llojin e biznesit, ku ai dhe familja e tij janë të përfshirë. Edhe pse Kryetar i Partisë Agrare, ky ka djegur gomat e pafund në pronën antiambjentaliste e thellësisht të dëmshme për shëndetin e fierakëve, por edhe të vetë familjes së tij. Megjithatë, kjo është një pronë e njohur me ligj nga qeveria. Aty mbaron ndërgjegja e përgjegjësia e Xhuvelit. Pra, kryetari i PAA e din se është i domosdoshëm si anëtar koalicioni qeverisës, kushdo që të fitojë. Aq i sigurtë është Xhuveli në vlerën e vet si faktor politik, sa ai nuk u kishte blerë as edhe një shishe birrë mbështetësve të vet, ndoshta sepse, si ministër me përvojë, ai e di se me çka bëhet edhe birra në shtetin shqiptar.

Prijatarët në qendër të vëmendjes

Megjithatë, fushata është e fokusuar në problemet që i interesojnë parisë. Fushata nuk është e përqendruar tek problemet me kartat, me komisionet, me vëzhguesit, me të drejtën e mërgimtarëve për të votuar, me dështimet e frikshme (të shkuarat, të tashmet e të ardhmet) me krizën ekonomike, me gjendjen e mjerë të shumë shqiptarëve. Fushata është e përqendruar tek prijatarët dhe tek këngët e tyre. Prijatarët partiakë janë gjithkund dhe në qendër të vëmendjes. Përplasja e tyre personale ka shmangur partitë, kandidatët, programet dhe ideologjitë si dhe debatet rreth problemeve reale e ideologjive që duhej të paraqisnin prijatarët. Fushata është përqendruar në përplasjen e vetë prijatarëve. Saliu i thotë Edi “dil të ndeshemi!” Edi i thotë Saliut, “Kënga “Çohu” nuk është për Berishën që rri në këmbë.”

Edhe më keq, sulmet personale janë të shfrenuara. Pra, përplasja e prijatarëve është intensive dhe pa asnjë rezervim. Por, prapa këtyre prijatarëve dhe sherrit të tyre, qëndron dora e fshehur dhe mekanizmi propagandistik i parisë. Si edhe e kam shpjeguar në një shkrim tjetër, parisë së Tiranës i duhet legjitimiteti, i duhet vota e lirë e popullit. Me këtë objektiv të pandryshuar në mendje, ajo ka hedhur në lojë të gjithë kartat që ka, e që i kanë mbetur. Karta më e fortë është përplasja e prijatarëve, që sillen si gladiatorët e paguar, që japin shfaqje për argëtimin e publikut. Personalizimi i konfliktit i bind njerëzit se ata e kanë mundësinë që të bëjnë një zgjidhje. Nga ana e tyre, militantët janë të bindur se këta që shahen pa mëshirë janë armiq për vdekje. Ata mendojnë me bindje se prijatarët e parisë së Tiranës kësaj rradhe e kanë sherrin me të vërtetë. Klientët, ata që shiten e blihen, i përdorin argumentet që dalin si një justifikim për sjelljen e tyre arriviste.

Mirëpo, përtej militantëve e klientëve, fushata ka edhe një dimension tjetër. Ndërsa fushata duket se është, thjesht e pastër, tifoza për persona të veçantë, shumë më keq se aq, mbi të gjitha, fushata është luftë e stërholluar për të intensifikuar antipatinë popullore për kundërshtarët personalë e për t'i ndarë njerëzit në kundërshtarë personalë të këtij e të atij pjestari të parisë. Thirrja

e parisë është që njerëzit të zgjedhin të keqen më të vogël dhe gjithkush thotë se vetë aiëajo është e keqja më e vogël. Në fund, në ditën e votimit, njerëzit do të zgjedhin ose atë që besojnë, ose atë që urrejnë. Pra, kushdo që të fitojë e të humbë, paria, si shtresë, është gjithnjë fituese e zgjedhjeve.

Paria e Tiranës si dhëmbë të një goje që bluajnë për vete

Çka nuk na thuhet është se të gjithë këta kundërshtarë, që s'kanë lënë gjë pa thënë për njëri-tjetrin, janë pjesë integrale e parisë, të shtresës oligarkike të lidhur me njëmijë e një fije, që e sundon atë vend me dorë të hekurt. Paria jeniçere e Tiranës është e keqja e vërtetë e shqiptarëve dhe këta prijatarë janë pjesë e saj, janë mbrojtësit e përfaqësuesit e saj. Prova e fundit që jepet për unitetin e parisë oligarkike është Gërdeci. Të gjithë segmentet e parisë e kishin ngjyer gishtin në hallvën e krimit. Asnjë nga lojtarët nuk doli i larë, e kush ishte i larë me Gërdecin, e mbylli gojën se kishte shumë petë lakrori dhe kishte gjëra të tjera në biznese të tjera që, pak a shumë, janë si Gërdeci.

Shkurt, paria është ndarë në dy kampe, si dhëmbë në një gojë, që mendojnë vetëm për veten e për ushqimin që duhet të përçapin. Fatkeqësia e madhe është se, duke mos e kuptuar se paria është shumë më kohezive se sa duket në pamje të parë, apo thjesht sepse ashtu shiten publikisht si besnikë të një prijatari të caktuar, njerëzit nuk merren me listën e krimeve të përbindshme të parisë apo me dështimin e thellë të ndërtimit të shtetit e të institucioneve politike e shtetërore e me shkatërrimin e vlerave e të shoqërisë, por kanë rënë në kurthin e saj.

Paria kërkon që qytetarët të merren me përfaqësuesit e saj që nuk ua ndjen se çfarë thotë populli për ta. Qëllimi i parisë është që populli të merret me të metat fizike e mendore të kandidatëve, në nivelin e thashethemeve të katundit. E kështu, prijatarët, gazetatat, komentatorët dhe kandidatët merren me shijet individuale apo me manierat e prijatarëve. Këto janë temë e ditës. Askush nuk po merret me vlerat e me ideologjinë që ata prijatarë duhej të përfaqësonin në politikë. Prandaj, debati është i mbushur me

shprehje katundareske. Disa nga shprehjet e mëposhtme i dëgjon në tavolina gjithë kohën. Këtë nuk e dua se e kam parë në plazh. Të dy palët njëllon janë, por ky i joni është pak, pak më i mirë. Ky ka dy dërrasa mangut. Ai deputeti han dy dopjo merluc. Ky që nuk është në lojë është qen e bir qeni. E di ç' i punon vjehrra këtij? Këtë e kam pasur në lagje. E kështu me rradhë.

Si grindet, pse grindet dhe si do ta zgjidhë problemin e vet para

Paria e din mirë se çka duhet të bëjë që të ruajë sundimin e vet. Sa të kalojnë zgjedhjet ata do të kthehen për të ngrënë në grazhdin e shtetit edhe për katër vjet të tjera. Prandaj asaj i duhet fort përplasia publike e prijatarëve, që i bëjnë thirrje njeri-tjetrit për sherr. Mirëpo, ajo që nuk thuhet e që nuk përmendet fare është që, ashtu siç e provoi edhe Gërdeci, këto prijatarë që shahen gjithë ditën, i zgjidhin punët bashkë gjithë natën.

Paria e Tiranës ka një parullë interesante: të gjithë bashkë për t'u pasuruar, secili më vete në zgjedhje, por punët tona e tuajat i zgjidhim vetë simbas interesave private që kemi. Si të mbarojnë zgjedhjet, paraia bën një "*gran coalizione*" deri në zgjedhjet e tjera dhe kështu e ruan sundimin e vet për një kohë të gjatë. Pra, do të ketë rrëmujë, por të gjitha do të jenë stuhi në një gotë uji, thjesht sepse paraia i zgjidh punët e veta me qetësi. Kjo lloj sjelleje e llogaritur është shenja më e qartë e pranisë së oligarkisë dhe e efikasitetit të metodës së saj për të ruajtur pushtetin. Cilado palë që fiton ia ruan shpinën palës tjetër. Parulla është që "le të grindemi për kockën, por qeni-qenin nuk e ha".

Përse i duhet personalizimi i debatit parisë së Tiranës

Duke e ditur mirë se të dy palët do ta gjejnë gjuhën bashkë, sa të vendoset ekuilibri i përkohshëm, të kuptohet raporti i forcave e që kështu të mund të përcaktohet se cila do të jetë pjesa e tortës që mund të marrë njëri e tjetri, fushata zgjedhore është e pamëshirshme në nivelin e përplases individuale. Në mënyrë tragjikomike, zgjedhjet po paraqiten si një përplasje titanësh, që

shahen e rrihen në media e i bëjnë ftesa njëri-tjetrit për të dalë në fushë të mejdanit.

Fatkeqësisht, prijatarët e partive në atë shtet nuk i kanë karakteristikat për të qenë udhëheqës, e jo më titanë. Edhe ata vetë e dinë se u mungojnë karakteristikat si udhëheqës, por kështu ua lyp puna, që të sillen sikur janë më të mëdhenj se tjetri dhe të përjetshëm. Ashtu si shamanët afrikanë, që me jermin e tyre besojnë se do të sjellin shiun mbas thatësisrës, ashtu edhe këta duan të shiten për tenecë e zgjidhës të problemeve në nivele globale. Por shiu bie kur ka re e problemet globale zgjidhen diku tjetër.

Përplasia e tyre për vdekje është, në fakt, si vdekja e gladiatorëve, d.m.th. përplasia është e ashpër, por një ndër dhjetë gladiatorë të mundur ishte për t'u vvarë. Por, edhe atëherë, kërkohet që të vriteshin të gjithë ata gladiatorë që nuk jepnin spektaklin e duhur. Ndër jeniçerët e Tiranës, metoda është si e gladiatorëve, por edhe shumë më interesante. Në këtë vend, hyn si i varfër por del prej lojës së vërtetë politike si miliarder e bëhesh deputet. Nuk të hyn ferrë në këmbë dhe, për më tepër, kështu bëhesh pjesë e parisë.

Prandaj, intensiteti i jashtëzakonshëm i përplasjes do të ishte një problem i madh për dikënd tjetër, por ja që nuk është aspak problem për parinë e Tiranës. Personalizimi i lojës politike është i pashmangshëm gjithkund dhe njihet e pranohet si një praktikë elektorale. Mirëpo, në shtetin shqiptar kjo sjellje ka shkuar në ekstremin e mundshëm. Kjo tepri në përplasje midis prijatarëve e ka një arsye që nuk është thjesht elektorale. Lepuri flen dikund tjetër. Personalizimi i lojës politike e ka zhveshur fushatën nga debati i nevojshëm politik mbi çështje kardinale dhe ekzistenciale lidhur me të ardhmen e shqiptarëve e të shtetit që duhej të ishte i tyri.

Kjo përplasje maskon një problem që nuk preket fare por pikërisht për këtë mospërmendje të bie më shumë në sy. Ajo që të vret sytë është varfëria e pamatë ideologjike e shoqërisë shqiptare dhe shterpësia e debatit ideologjik në fushata elektorale. Pavarësisht skajshmërisë ideologjike, gjithkund tjetër një politikan duhet të demonstrojë një sistem vlerash të caktuara ideologjike.

Në shtetin shqiptar ndodh e kundërta. Sa më koherent të jesh në pikëpamjet tuaja ideologjike, aq më i papranueshëm je për parinë dhe për elektoratin.

Përse parisë së Tiranës i intereson mungesa e debatit ideologjik

Në shtetin e shqiptarëve (ku shqiptarët nuk i pyet njeri) ideologjia dhe debati ideologjik nuk ka vend. Parisë i intereson që ideologjia, mendësitë koherente e mundësitë e vlerësimit të sjelljes së tyre në një nivel të tillë të mos kenë vend në fushata. Këto zgjedhje janë prova më e mirë e më e qartë e dështimit të ndërtimit të debatit mbi vlerat e mbi sistemet ideologjike. Këto zgjedhje janë ilustrimi i suksesit të futjes së përplasjes politike pikërisht në hullinë që i intereson parisë. Jo vetëm pse në Tiranë nuk flitet për ideologji, por platformat, programet, kandidatët dhe vetë paria dallohen për mungesën e ideologjisë, të koherencës ideologjike, të vlerave morale në paraqitjet e tyre dhe, për më tepër, ata vetë duken se janë e sillen sikur janë krenarë për këtë gjë.

Platformat politike dhe elektorale shquhen për një pragmatizëm, që shkon deri në cinizëm. Shumica përqëndrohen në çikërrima e probleme teknike. Paria e Tiranës, partitë e saj, mediat e saj, kandidatët e saj, analistët e komentatorët badihava e me rradhë, të gjithë dallohen për mungesën e impenjimit ideologjik, të trajtimit të problemeve në një nivel ideologjik, qoftë edhe të thjeshtë, por me koherencë e konsistencë, si dhe të ofrimit të zgjidhjeve të mbështetura në një ideologji të caktuar e duke ndjekur vlerat e saj.

Ideologjia është një botëkuptim koherent që shpjegon shkaqet e gjendjes së një grupi, kombi ose të një shoqërie, e përshkruan atë gjendje dhe problemet me të cilat përballet ajo shoqëri dhe që ofron një vizion se si do të jetë e ardhmja e grupit e kombit, grupit apo e gjithë shoqërisë nëse veprohet sipas zgjidhjeve të ofruara prej ideologjisë së caktuar. Në këtë kontekst, edhe fushata zgjedhore, kudo në botë, të paktën në nivelin e kandidatëve, të programeve, e të platformave elektorale është edhe një debat i

thellë ideologjik.

Edhe vetë përplasja politike është një përplasje interesash por e strukturuar si përplasje ideologjike. Partitë, udhëheqësitë, anëtarët e militantët partiakë duhet të jenë struktura të krijuara e të lidhura bashkë me një ideologji të caktuar. Veprimtaria e qeverisë respektive dhe politika gjykohet me metrin ideologjik. Fushatat bëhen për të zgjidhur problemet e së ardhmes dhe secila palë jep zgjidhjet simbas ideologjisë së vet, dhe, po ashtu, e mobilizon elektoratin në baza ideologjike e vlerash. Rruga që propozohet se duhet të marrë shoqëria është po ashtu e ravigjzuar nga vlerat, mendësia, e parametrat ideologjikë. Por këto vlera të njohura në vende të tjera shpërfillen nga paria e Tiranës dhe partitë e saj.

Ideologjia, pra, është një element shumë i rëndësishëm, pa të cilin nuk mund të ketë shoqëri e komb të lidhur bashkë. E po ashtu, nuk mund të ketë as proces politik demokratik e as demokraci të mirëfilltë. Kur vjen puna tek zgjedhjet, pra duhet që të diskutojmë se cilën rrugë duhet të ndjekim, se si të zgjedhim qeverinë, që do të na zgjidhë punët ashtu si i shohim ne, të mbështesim politika të ndryshme e politikanë të caktuar, por të peshuar me ideologjinë respektive. Figurativisht, ideologjia të tregon pse nuk duhet t'i sillësh rrotull mullarit të barit të dikujt, sepse ashtu ia lyp interesi atij. Ideologjia të orienton për drejtimin që duhet të marrësh, për rrugën ku do të ecësh për të arritur atje ku don ti, grupi të cilit ti i përket, shtetit në të cilin gjendesh.

Mirëpo, ideologjia e mban parinë sunduese peng, sepse ajo nuk mundet të thotë diçka një herë e mandej diçka tjetër, krejtësisht të kundërt. Prandaj, parisë së Tiranës i intereson që ta paraqesë gjendjen të zhveshur nga debatet ideologjike, debatet që janë thelbësore t'i paraqesë sikur janë të zgjidhura e të mbyllura një herë e mirë. Paria e Tiranës nuk do që njerëzit ta gjykojnë atë për çfarë bën, si sillet e si i mbron interesat e saj. E bash për shkak të mungesës së debatit ideologjik, shoqëria shqiptare po vazhdon që të sillet rrotull mullarit të barit, ashtu siç i intereson parisë së Tiranës.

Përveç vënies në dukje të shterpësisë ideologjike, personalizmi i debatit është shenja më e qartë e vendosjes dhe e konsolidimit të

sistemit oligarkik. Në një sistem oligarkik, njerëzit që prijnë kanë rëndësi reale e janë të zëvendësueshëm. Kanë rëndësi reale, sepse ata i marrin vendimet në emër të parisë. Janë të zëvendësueshëm sepse ata i mbajnë klanet e interesave bashkë dhe, kur nuk i përmbushin kërkesat e klaneve, zëvendësohen. Klanet janë të bazuara në lidhjet personale e prandaj ideologjia është problem.

Ideologjia i detyron oligarkët që të veprojnë ndryshe nga ajo që synojnë si dhe nga interesi imediat i klanit të cilit i përkasin. Ideologjia i mbyll shtigjet e arrvizimit e të manipulimit ekstrem. Me gjuhën popullore, ideologjia e vë "kufirin tek thana". Prandaj nacionalizmi, ideologjia, që iu shërben shqiptarëve si komb e shoqëri, është kaq i papranueshëm për ta, sepse është armiku për vdekje i interesave të parisë.

Mbyllje

Përplasja midis prijatarëve ndodh sepse parisë i intereson që njerëzit të mos merren me problemet e vërteta jetike. Edhe më shumë se atë, ata nuk duhet të merren me nevojën imperative të gjykimit të gjendjes në nivel ideologjik. Mbi të gjitha, përplasja e pandërprerë ndodh që të tërhiqet vëmendja e që njerëzit të mos merren me vetë parinë e Tiranës.

Prandaj, fushata e tanishme elektorale është për gjithçka tjetër përveçse për problemet reale e për zgjidhjet e nevojshme, të mundshme e të dëshërueshme për qytetarët. Në debate e në fjalime, nuk preket fare paraliza e përplotë e institucioneve shtetërore. Nuk preken as shpërdorimi i paskrupullt i burimeve materiale dhe njerëzore të shtetit e të pushtetit lokal në funksion të fushatave. Nuk preket as niveli mediokër i kandidatëve, që nuk dihet ku janë, kush janë e prej nga vijnë e ku shkojnë. Nuk preket as afrimi i shpejtë i krizës së thellë ekonomike që do ta godasë rëndshëm atë shtet. Nuk preket as kriza e thellë e emigrantëve, që nuk kanë se ku të shkojnë. Nuk preken as rritja e borxhit shtetëror, as topitja e trurit të njerëzve, as shkatërrimi sistematik i fabrikës së familjes shqiptare dhe as kriminalizimi i pandalshëm i shoqërisë. Paria e Tiranës po lufton për veten e vet, me njerëzit e vet, për

interesat e veta. Edhe këtë herë, shqiptarët që po mundohen për mbijetesë, do ta humbin betejën me parinë.

PROBLEMI I LEGJITIMIT TË SISTEMIT DHE BOJKOTI SI ARMË E DOMOSDOSHME POLITIKE

Zgjedhjet kuvendore janë një moment shumë i rëndësishëm politik për parinë e Tiranës. Për një ditë, fati i sundimit të tyre është në duart e popullit. Është në dorën e popullit të tregojë në se pajtohet apo nëse nuk pajtohet me sundimin e parisë, me rrugën që po ndiqet prej saj, si dhe me parinë vetë. Në këtë moment politik, qytetarët përzgjedhin, me vullnetin tyre, ata që do të drejtojnë shtetin deri në zgjedhjet e ardhshme. Sundimi i ligjit, depersonalizimi i pushtetit, efektiviteti i strukturave partiake, një shoqëri e gjallë qytetare janë elemente të rëndësishme të demokracisë. Por, një vend është demokratik vetëm e vetëm kur mbahen zgjedhje të ndershme, të lira, të fshehta e të drejtpërdrejta, duke ndjekur procedurat e një sistemi demokratik. Atëherë, sistemi është legjitim dhe paria ka mandatin e duhur për të drejtuar shtetin.

Mirëpo në një sistem demokratik nuk mjafton që paria politike e merr mandatin e drejtimit të shtetit në bazë të procedurave. Në një sistem demokratik duhet që populli të aprovojë sistemin politik. Këtë të transferimit të autoritetit populli duhet ta bëjë me vullnetin e tij të lirë. Kjo shkon shumë më larg se koncepti i aprovimit të *formula politica* të Mosca. Në një farë mënyre, zgjedhjet e përgjithshme janë thujtjse referendare. Shkaku është se një pari e re mund të marrë shumicën dhe mund të zgjidhet me vota të lira. Kësisoj, në parim, edhe me një zgjedhje e ndryshon edhe ligjin themeltar të shtetit, pra vetë formulën politike. Natyrisht sistemi nuk është më demokratik, por kjo është një mundësi. Veçimi i parimit bazë të sistemit, formulës politike, nga ajo çka qytetarët

mendojnë për atë parim themelor dhe për parinë është artificial dhe, në praktikë, i pamundshëm.

Pra, thelbi i legjitimitetit është aprovimi moral i qytetarëve për rendin shoqëror ku jetojnë si më i përshtatmi, më i drejti, dhe më i miri sistem i mundshëm. Mirëpo, rendi shoqëror në një sistem shoqëror ku ka kaq zhvatje flagrante dhe ku pushteti ekonomik, politik e i influencës është katërcipërisht në duart e parisë, si në shtetin shqiptar, me këtë nivel kriminalizimi, mungese vlerash morale e korrupsioni të gjithkundgjindshëm, nuk mund të shihet si rendi i duhur shoqëror. Prandaj edhe paraia u kushton rëndësi zgjedhjeve kuvendore, thjesht sepse u druhet fort. Edhe në këto zgjedhje, objektivi kryesor i parisë sunduese është i njëjti. Ajo synon që të bindë të huajt, veten, dhe popullin se ata e vetëm ata, duhet ta sundojnë shtetin shqiptar. Pa e krijuar këtë bindje në të tre grupimet e lartpërmendura (dhe më parë tek pjestarët e vet, natyrisht) paraia nuk mund të sundojë kurrë e qetë dhe e sigurtë në zotërimin e saj, në shtetin shqiptar. Nuk ka gjalle se rezultati që del prej këtyre zgjedhjeve është i manipuluar, i ndryshuar apo se vetë zgjedhjet janë një farsë politike, për sa kohë që ruhet fasada e legjitimitetit, d.m.th. që shumica e votojnë parinë. Për parinë zgjedhjet janë prova më e qartë që paraia mund të ofrojë si dëshmi të mbështetjes që, kinse ajo vetë, por edhe sistemi që ajo ka krijuar dhe që është totalisht në shërbim të saj, ka nga qytetarët e nga shqiptarët në veçanti. Kjo ditë është si një ditë referendumi, kur paraia e merr legjitimitetin që i duhet për të sunduar edhe për katër vitet e ardhshme.

Si e siguron legjitimitetin paraia e Tiranës?

Duke e ditur mirë rëndësinë e legjitimitetit të sistemit të saj, paraia ka përdorur sistematikisht e me shumë kujdes të gjithë arsenalin e armëve që ka. Natyrisht, instrumenti kryesor e parësor i saj është vendosja e ruajtja e kontrollit të hekurt mbi shtetin, institucionet qeverisëse, si dhe mbi strukturat e pushtetit lokal. Përdorimi i burimeve të shumta materiale dhe njerëzore të shtetit si dhe manipulimi i ligjit nga ana e saj kanë qenë e mbeten

instrumente të preferuara të parisë së Tiranës për fitimin e legjitimitetit e vijimisht, për arritjen dhe ruajtjen e kontrollit të tyre mbi fatin e të gjithë shqiptarëve.

Po ashtu, në veçanti, përpjekja e parisë për të fituar legjitimitet dallohet qartë në nivelin e shfrenuar të propagandës, manipulimit të shtypit e të informacionit. Paria ia njeht vlerën ideologjisë. Edhe përkundër përpjekjes së saj sistematike për ta shmangur debatin ideologjik në përplasjet midis segmenteve të saj, argumentet që ajo përdor për të bindur votuesit e në veçanti, militantët respektivë, janë qartësisht ideologjike.

Për shembull, parisë i intereson që shqiptarët të binden se nuk ka zgjidhje të tjera. Për të justifikuar këtë, paria përdor si mungesën e alternativave, dështimet e palës tjetër, dështimet e shteteve të ngjashme, dështimet e alternativave ideologjike e me radhë. Këtu duhet të përmenden, para së gjithash, argumentet e tyre ideologjike, që e paraqesin të gjithë botën e qytetëruar si një botë kriminale, ku paraja ble e shet gjithkënd. Ky është një argument që shitet lehtë në shtetin shqiptar. Shumica e atyre që kanë qenë jashtë, të punësuar ose kanë jetuar në perëndim, kanë qenë në fund ose afër fundit të strukturës shoqërore, pikërisht në ato nivele ku sjellja kriminale apo strukturat e bashkësisë janë kushti themeltar për të siguruar ekzistencën. Nga këndvështrimi i jetës së mërgimtarit të paligjshëm apo edhe i mërgimtarit që ecën përpara në nivelin lokal, në shoqëri thellësisht të korrumpuara dhe të politizuara si Greqia dhe Italia, bota nuk mundet që të funksionojë ndryshe.

Paria përdor çdo metodë tjetër, që ndihmon në konsolidimin e hegjemonisë së saj mbi shoqërinë. Në arsenalin e teknikave të saj dallohen manipulimi sistematik dhe organizimi korrriptiv i strukturave mbarëshoqërore dhe i aktiviteteve partiake në bazë klanesh e me karakter të dallueshëm mafioz. Në fushën e propagandës, dallohet përdorimi e glorifikimi i analistëve injorantë dhe manipulimi i opinionit publik, përmes komentatorëve me përgatitje profesionale shumë të dyshimtë. Po ashtu hapja e mbyllja e debateve mediatike, pa pikë vlere e mbi tema shterpë, që thjesht shërbejnë që të defendojnë mendjet e vlerat e njerëzve

me një ritëm marramendës, është një pjesë e rëndësishme e këtij arsenali metodash që përdoret për të për të çoroditur shqiptarët. Qëllimi i pandryshuar i parisë është stabilizimi i hegjemonisë ideologjike të saj. Krijimi i përshtypjes, se kjo rrugë ku po ecim është rruga e vetme ku duhet shkuar, e se nuk ka zgjidhje tjetër, është një hap i madh përpara në vendosjen e kësaj hegjemonie.

Qëllimit të vendosjes së hegjemonisë e të fitimit të legjitimitetit të sistemit i shërben, mbi të gjitha, zhveshja e përditshme dhe e pandalshme e shoqërisë nga vlerat e vërteta dhe nga morali njerëzor. Në Tiranë, çdo gjë e ka një çmim në vlerë monetare; edhe nderi, edhe fytyra, edhe vlerat, edhe historia. Paria jeton e vdes për pasurinë e vet. Prandaj, me këtë qëllim të qartë në mendje, paria po lufton ta shndërrojë shoqërinë shqiptare në shembëlltyrën e saj kriminale. Vetëm e vetëm ashtu i duket parisë që garantohet pasuria dhe sundimi i saj.

Nuk ka pikë dyshimi se mjete të preferuara të parisë së Tiranës janë edhe patologjitë e njohura të sistemeve politike, si korrupsioni, klientelizmi, shitja e shtetit dhe e interesave të qytetarëve të tjerë, si dhe blerja e njerëzve me çmimin që i kanë vënë vetes. Këtu hyn edhe paraliza e plotë e sistemit ligjor sepse, në fund të fundit, kë do të arrestojnë? Këtu hyn edhe mbyllja e gojës së gjithkujt tjetër që është kundërshtar. Cubat duan me dhënë e me marrë me cubat, hajnat japin e marrin me hajnat. Paria ndjek të njëjtën metodë, si cubat e hajnat. Shteti i duhet që të përdoret vetëm si instrument shpërblimi për mbështetësit, dhe si mjet ndëshkimi për kundërshtarët e saj.

Poashtu, kontrolli i saj duhet të jetë i hekurt dhe i padiskutueshëm edhe mbi ekonominë. Sipërmarrësve, reshperëve, tregtarëve e afaristëve, po nuk iu bindën, iu priten kontratat, iu anulohen licencat, iu hiqet buka e gojës. Kështu, edhe ata sipërmarrës apo prodhues që mendojnë se kjo sjellje nuk është e moralshme, bien në gjunjë para politikës dhe nuk guxojnë as të ngrejnë kokën. Ata që nuk binden hapur ose blihen me interesa, ose nxirren nga loja, falimentojnë, apo diskreditohen publikisht. Kjo vlen edhe për të gjithë kundërshtarët e tyre nga fusha të tjera të jetës.

Kur nuk ecën kjo taktikë e shklopit dhe kulaçit, përdoret

përzënia e denigrimi i hapur i kundërshtarëve. Një taktikë interesante është izolimi i atyre individëve e grupimeve, që mund të bëjnë diçka të mirë, por që e shohin veten si të pazotët që të luftojnë kundër tyre. Prandaj Tirana është kthyer në një tymbnajë e kënetë thashethemesh nga më të ndyrat që mund të bëhen në këtë botë, ku nuk ka aspak mbrojtje të jetës private dhe ku gjithçka bëhet sheshit.

Po ashtu, veset e njerëzve janë një çengel, ku ata mbahen peng e varur prej parisë. Pusi i llumit njerëzor nuk ka fund dhe, gjatë këtij tranzicioni, në shoqërinë shqiptare ka shpërthyer qelbi e njerëzit janë çliruar nga zinxhiri i vlerave morale. Shpërthimi nga zinxhirët, si dhe nevoja e ngopjes me para, me seks, me pushtet, me hakmarrje, i kanë kthyer njerëzit në përbindsha që e maskojnë keq e aspak anën e tyre të ndyrë njerëzore. Dhe, nga ana e vet, paria e di mirë që ajo mund t'i mbajë njerëzit peng për dobësitë e veta; çdo person, çdo familje e çdo grup e shtresë të shoqërisë, një e nga e një e të gjithë bashkë. Duke qenë një vend i vogël, askush nuk mundet të ruajë sekrete e të fshehta prej kujt tjetër. Askush nuk mundet me dalë kundër sistemit që e ka nxjerrë dikund dhe kundër strukturës familjare e shoqërore, që e lejon të mbijetojë. Përdorimi me efikasitet të jashtëzakonshëm i mendësisë katundare dhe i strukturave shoqërore nga ana e parisë e ka kthyer shtetin në një katund.

Për arritjen e këtij objektivi të rikthimit të shoqërisë në një kënetë morale, punohet sistematikisht e pa ndërprerje, aq sa sjellja kriminale ka hyrë në subkoshiençën e njerëzve dhe, tashmë, shihet si norma e sjelljes së pranuar në shoqëri. Në shtetin shqiptar, askush nuk duhet të jetë i pastër e i ndershëm, por të gjithë duhet të bëhen vegla të parisë. Gjithnjë e përgjithmonë ata duhet të kenë e do të kenë frikë prej vetes dhe hijes së vet. Si ka thënë edhe Montaigne, nuk ka një njeri që po të gjykohet për çka ka menduar e për çka ka bërë në jetë, nuk varet të paktën dhjetë herë. Paria lufton t'i përdorë këto pika të dobëta të njerëzve, vetëm e vetëm t'u mbyllë gojën dhe t'i kthejë në vegla të vetat. Suksesi i saj do të ishte i paimagjinueshëm diku tjetër. Mbi të gjitha, loja e qëllimtë e parisë shihet qartë tek përpjekja e tyre për

t'i shtyrë njerëzit që të zgjedhin, e që të mbështesin, ose njerën palë të parisë ose tjetrën. Lufta e parisë është të bindë njerëzit se ata duhet të zgjedhin medoemos njerën palë të parisë mbi palën tjetër. Ndarja duhet të shkojë deri në nivelin e armiqësisimit më të thellë të grupeve të ndryshme në shoqëri, e të prerjes së urave me palën tjetër të parisë.

Duke e ditur mirë se çka mendojnë njerëzit për ta, para i shtyn njerëzit që të mendojnë në një nivel tjetër. Njerëzit nuk duhet të zgjedhin palën më të mirë, ata duhet të zgjedhin të keqen më të vogël. Prandaj, nuk ka fare rëndësi se cila palë fiton zgjedhjet. Dy palë ka. Cilado palë që fiton, do të ruajë palën tjetër. E rëndësishme është se gjithnjë fiton sistemi i parisë dhe, përmes rikonfirmimit të sistemit e të kontrollit të saj mbi të, fiton para vetë.

Më në fund, por jo më e fundit, marka më e dallueshme e parisë së jeniçerëve është përdorimi i strukturave kriminale. Këta janë banda të frikshme mafioze e kamorriste, që nuk ndalen para asgjëje. Të kamufluara, herë si militantë, e herë si *clackers* mitingjesh politike, por lidhura në kërthizë me parinë, këta struktura mafioze janë duke u përdorur sistematikisht për të mbjellë frikë e terror në mendjen e njerëzve. Njëlloj si vampirët e lugetërit që e duan natën të jetë 24 orë, ashtu edhe para do që t'i bindë shqiptarët se jeta e tyre duhet të jetë skëterrë. Arsyetimi është se kështu është e gjithë bota, e se nuk mundet e nuk ka se si të jetë ndryshe. Ndryshe, ata janë të papranueshëm. Dhe, para e prijatarët e saj e dinë mirë se terri, por edhe nata e vërtetë, fillon e mbaron në mendjen e njerëzve. Aty është edhe burimi i legjitimitetit të saj.

Legjitimimi i sistemit dhe palët e interesuara

Megjithëse para e ka krijuar bindjen se gjendja në shtetin shqiptar është nën kontrollin e saj të hekurt dhe përshtypja e njerëzve është se para është e pakundërshtueshme; asaj i duhet shumë legjitimimi publik i sundimit të saj. Legjitimimi është i shprehur periodikisht nga pjestarët e saj, por edhe nga populli me vullnetin e tij të lirë në zgjedhje si dhe nga përfaqësuesit e vendeve të huaja me njohjen e sundimit të parisë. Në një mënyrë

ose në një tjetër, pjestarët e parisë, të huajt dhe populli i sunduar duhet ta shprehin besimin e tyre tek paria; çdo kundërshtim i këtij legjitimitimi të sistemit të saj është një goditje që paria nuk e harron e nuk e fal, nga do që vjen.

Por, më së shumti, e për arsye të kuptueshme, paria e dëshëron dhe e kërkon legjitimitimin nga populli. Për këtë arsye, demokracia e vërtetë, vota e fshehtë, është një problem i madh për parinë. Nuk është puna se paria nuk di se si ta minojë demokracinë e se paria nuk ia ka arritur që ta minojë demokracinë. Çdo model i imagjinueshëm zgjedhor që është përdorur ka dështuar. Mirëpo, për shkak se formalisht shteti shqiptar duhet të duket se është demokraci, paria nuk mund t'i vendosë njerëzit në rresht me hu e t'i nisë në rutinë e votimit, si dikur në kohën e “demokracisë popullore”. Ajo ka punuar dhe ka gjetur mënyra për t'i bërë njerëzit që ta shprehin besnikërinë e tyre publikisht ndaj parisë, ndaj sistemit të saj thelbësisht jodemokratik, edhe në dhomën e votimit, bash aty ku vota duhej të ishte e fshehtë dhe e drejtpërdrejtë. Kështu, duke e kontrolluar sistemin ekonomik, politik e shoqëror, por mbi të gjitha duke vendosur një hegjemoni të mbështetur me struktura impulsive të propagandës, paria duket sikur e ka arritur qëllimin e saj, që njerëzit t'i nënshtrohen me vullnetin e tyre të lirë.

Problemi kyç, megjithatë, janë zgjedhjet, ky moment kritik kur njeriu i thjeshtë e ka fatin e tij në dorë. Çdo votë pro partive të parisë ka peshë, sepse ndihmon në zgjidhjen e problemit të parisë. Çdo votë kundër është një problem i madh për parinë. Po ashtu, një problem i madh për parinë është edhe bojkotimi i zgjedhjeve dhe i sistemit zgjedhor, si një formë refuzimi publik për të qenë pjestar, mbështetës, tolerues i krimit të parisë apo një instrument i ndërgjegjshëm i sistemit që mbron interesat e parisë. Nga dy zgjidhjet që kanë qytetarët, për të mos votuar apo për të bojkotuar sistemin, bojkotimi është armiku i saj i vërtetë për vdekje.

Si shprehet besnikëria ndaj sistemit e ndaj parisë?

Më së pari duhet sqaruar se si e merr mbështetjen nga populli paria. Pjestarët e parisë dhe klientët e tyre, e shprehin mbështetjen

për këtë sistem kriminal duke u bërë pjesë e tij, duke u konformuar me jovlerat e këtij sistemi dhe duke u sjellë ekzaktësisht ashtu siç pritet prej tyre, d.m.th., si mafiozët, kamorristët dhe gangsterët e rrugës, anipse janë me poste e vishen me rroba firmato. Si shpërblim, ata marrin tendera, licenca e, kur është e mundshme, punësohen në shtet. Kur i duhen parisë, të gjithë këto individë e ulin qafën e i shërbejnë asaj me bindje qorre. Të gjithë e bëjnë këtë kompromis me vetëdije, sepse ndjekin e mbrojnë interesat e veta, ose pse e shohin veten si pjestarë të parisë, ose pse ndjekin logjikën e fitimit nga paria. Prandaj sjellja e tyre, e ndërgjegjshme, nuk është e falshme, por shoqërisht e dënueshme.

Të gjitha ato gjëra që këta individë, përndryshe të shkolluar, thonë në klube e në rrethe të ngushta kundër parisë, kundër njerit e kundër tjetrit pjestar të parisë, janë thjesht pallavra për të larë ndërgjegjen e tyre. Kur u kërkohet nga shefat, të gjithë këta pjestarë të parisë e shërbëtorët e zgjedhur të rangjeve të tjera, vihen në rresht si ushtarë të bindur. Kur refuzojnë ose kur hedhin vickla, shefat apo ata që kontrollojnë shefat e tyre, iu kujtojnë veset e shumta, dashnoret, bizneset, pislleqet, dosjet, poshtërsitë e "nderet" e pandershme të panumërta që iu kanë bërë. Kështu, paria e gjen mënyrën që, ose t'ua mbyllë gojën, ose t'i fusë edhe një herë në rresht.

Shumë nga këta tipa, VIP të tanishëm të parisë, kanë harruar se ka edhe një mënyrë të sjelluri me dinjitet. Sa për ilustrim të këtyre tipave të parisë, kam sjellë Lufter Xhuelin. Megjithatë, po sjell edhe rastin e Arben Imamit, sot Ministër i Mbrojtjes dhe, një kohë, edhe shef kabineti në zyrën e kryeministrit Sali Berisha, sepse ky është një rast shumë domethënës. Dikur Arben Imami ka qenë një ëndërrimtar e aktor i talentuar, pedagog në Institutin e Arteve por edhe një njeri me ambicje shumë më të madhe se sa mendja që kishte. Më vonë, u lidh me Azem Hajdarin dhe Sali Berishën në Partinë Demokratike. Një kohë u riciklua si parlamentar i dështuar me Aleancën Demokratike. Gjatë kundërvënies së tij ndaj Sali Berishës, ky i fundit përdori të gjithë informacionin që kishte ndaj Arben Imamit, i kujtoi të ëmën dhe aktivitetin e saj në shërbim të shtetit, përhapri thashëtheme që e ndanë nga gruaja

dhe i shkatërroi familjen. Mandej, Arben Imami u njoh si opozitar i rreptë, politikan me dhëmbë të thyer e me trup të copëtuar nga Saliu e nga veglat e tij në vitin 1996, që e rrahën barbarisht në sheshin kryesor të kryeqytetit. Në vitin 1997, Arben Imami u bë drejtues i vetëshpallur i një rebelimi enverist dhe krijoi një strukturë që synonte të vihej në krye të rebelimit enverist, por pa shumë sukses, sepse ata që e drejtonin kishin struktura të tjera. Megjithatë, në shpërblim të veprimtarisë antiberishiane, Imami u bë ministër, konstitucionalist pa një ditë shkollë për atë punë, drejtues i një OJQ-je liberale, pa ide për liberalizmin, dhe në media përfliet se është edhe pronar e aksionist në veprimtari të ndryshme ekonomike. Arben Imami është njeri pa bindje të qarta e koherente politike, pa sjellje konsistente e pa pikë morali politik. Tash gjendet i vënë pa kushte në shërbim të atij që, në kushte të tjera, po vetë ka thënë se i ka shkatërruar familjen, shëndetin e jetën. Berisha e ka shpërblyer, duke e bërë shef kabineti, ministër, deputet dhe anëtar të Këshillit Kombëtar të PD-së. Njeriu habitet se çka bën Imami në politikë dhe si e takon Sali Berishën. Mirëpo, ja që modeli i Arben Imamit i duhet parisë. Prandaj Imami mbrohet, promovohet e mbështetet nga oligarkia.

Si Imami ka shumë të tjerë që e kanë pasur karrierën tejet të ndërlikuar e me zigzage marramendëse, por Imami është prototipi ilustrativ i këtij grupi që njihen si *VIP* në Tiranë. Natyrisht, parë nga këndvështrimi i parisë, zgjidhjet e tij kanë qënë racionale. Kështu i del llogaria. Nga këndvështrimi i tij, Imami nuk e ka jetën e keqe. Ai jeton mirë, i dëgjohet fjala dhe takohet shpesh me kryeministrin e rradhës. Si Imami, ashtu edhe pjestarët e tjerë të parisë e ndjekin një vijë justifikimi të gjendjes së tyre e të rrëshqitjes në llumin moral. Por, në fund të fundit, çdo argument që përdoret s'është asgjë më shumë se sa justifikim i një sjelljeje amorale, të pandershme, e jonjerëzore, në emër të përfitimit për interesa të ngushta materiale në shërbim të parisë.

Nga ana e tyre, të huajt, përmes përfaqësuesve të tyre diplomatikë, janë të interesuar kryesisht për stabilitet. Për të huajt, shteti shqiptar është në një gjendje katastrofike. E megjithatë, të huajt mendojnë që duhet shmangur gjithnjë më e keqja që mund

të ndodhë në atë vend (viti 1997 ka qënë një mësim i madh për të huajt) dhe “më e keqja” shmanget duke e mbajtur kapakun të mbyllur mbi tenxheren që vlon. A fiton krahu i majtë i Gërdecit, apo krahu i djathtë i Gërdecit, për ata nuk ka shumë rëndësi. Shteti shqiptar ka qënë një problem i madh politik në të shkuarën dhe vazhdon që të jetë edhe më problem sot, tamam kur duket sikur në Tiranë nuk lëviz asgjë. Të huajt e dinë mirë se me kë kanë të bëjnë. Të gjithë këta pjestarë të parisë i kanë dosjet e mbushura me gjithfarë xhevahiresh. Të gjithë kanë dhënë prova që janë përjashta normës së sjelljes së duhur. Por paria është problem për shqiptarët. Të huajt duket sikur mendojnë që këta duhen duruar për hir të stabilitetit.

Mandej, pse duhet që të ndërhyjnë të huajt kur këta, të ashtuquajtur “udhëheqës e liderë”, që i zgjedh populli i tyre? Me e thënë me gjuhën popullore, kur grindet burri me gruan, komshiu që vjen me i nda, shpesh qan më shumë hallin e vet. Po ashtu, mësimet e nxjerra nga kriza e vitit 1997 i kanë bindur të huajt se ndoshta duhet që t’i lënë këta që të merren me punët e tyre. Ky është një mësim që edhe paria e ka mësuar shumë mirë. Prandaj, kur një i huaj flet mirë për palën e tyre, ata e thërrasin në parlament dhe i japin *Urdhërin e Skënderbeut, Medaljen për Shërbime Civile*, ose janë gati ta shpallin *Nderi i Kombit*, anipse nuk ka kurr gjë shqiptare në atë person. Kur nuk flet mirë, ata nuk e presin fare; herën tjetër ose e nxjerrin persona *non grata* dhe ai person bëhet objekti i sulmeve mediatike në *Gazeta 55* apo në *Zëri i Popullit*, d.m.th., në mjetet propagandistike të njërës palë a të palës tjetër.

Mirëpo, në thelb të të gjithë lojës politike të legjitimitit të parisë është qëndrimi i popullit. As të huajt, por as vetë paria nuk mund të vazhdojnë të luajnë të qetë cic-micin në Tiranë, nëse populli, e shqiptarët në veçanti, fillojnë e shfaqin shenja të qarta se nuk pajtohen me sundimin e tyre. Deri në këtë pikë, paria ia ka arritur që ta kontrollojë popullin, ta bindë se e vetmja rrugë është sjellja kriminale, d.m.th., sjellja e bindur ndaj parisë e ndaj rregullave të vendosura prej saj. Kështu, ia kanë arritur që ta kriminalizojnë keqas popullin shqiptar. Teknikat e stërholluara të parisë e të mbajturit

të njerëzve peng për interesat e veta materiale, dhe ndërkohë me i zhveshë nga çdo vlerë njerëzore, kanë qenë deri-diku të suksesshme. Paria e ka mbrritur qëllimin e vet, duke përdorur urrejtjen e mllëfin për të shkuarën, neverinë për jetën e tashme, dëshirat për të ruajtur dhe me marrë pronat, apo në ruajtjen legjitime të pronave të vjedhura, apo të ndërtuara në mënyrë të paligjshme.

Mbi të gjitha, sa herë vijnë zgjedhjet, pavarësisht manipulimeve, rrahjeve e kacafytjeve publike, paria nuk ndjehet shumë e sigurtë se si do të sillët populli. Prandaj, edhe fushata zgjedhore është një përpjekje e kushtueshme financiarisht, por edhe e sofistikuar në nivel të agjitacionit e të propagandës, për të fituar sigurinë se njerëzit do të sillen ashtu siç pret paria. Qytetarët duhet të shkojnë, do të shkojnë e do të votojnë ose për një palë të parisë ose për palën tjetër. Por, në fund të fundit, paria gjithmonë del e fituar, sepse politika shqiptare është dushk për gogla.

Edhe kësaj here, si çdo herë tjetër, populli shqiptar e ka mundësinë të bëjë një zgjidhje. Zgjidhja që do të bëhet ose do ta legjitimojë, ose do ta minojë sundimin e parisë. Në mungesë të forcave politike që do të mbrojnë interesat e shqiptarëve, më e pakta që shqiptarët mund të bëjnë, do të jetë që ta minojnë e ta delegitimojnë sundimin e parisë.

Cilat janë rrugët që mund të ndiqen?

Në çdo kohë, por veçanërisht sot, kur vjen puna tek legjitimimi i sundimit të parisë, populli shqiptar ka katër rrugë për të ndjekur. Njëra rrugë, ajo më e lehta, është ajo e legjitimitit të sistemit të parisë. Edhe pse ky sistem duket sikur është demokratik e i bazuar në votën e lirë, përshtypja e vëzhguesit të paanshëm është se shoqëria shqiptare jeton me një frikë të madhe për të nesërmen dhe me një pasiguri të thellë për bukën e gojës. Në shtetin shqiptar, buka e gojës fitohet vetëm e vetëm duke qenë pjesë e një klani të caktuar. Buka fitohet duke hyrë në rresht si pasues i një krahu të parisë sunduese.

Prandaj, njerëzit shkojnë e votojnë edhe pse e dinë se po ia shkatërrojnë jetën e ardhmërinë vetes e familjeve të tyre. Jo

vetëm kaq, por ata po e shkatërrojnë edhe ardhmërinë e të gjithë të tjerëve. Por, duke votuar për “thesin e miellit” që marrin prej partisë, ata e legjitimojnë sistemin dhe i japin parisë të drejtën që të sundojë edhe për katër vite të tjera. Në këtë mënyrë, askush nuk ka të drejtë që të dalë e të thotë se paria “na bëri këtë e atë”, sepse ata vetë ia kanë dhënë votën. Kur e pati mundësinë, secili e bëri zgjidhjen e vet dhe secili votoi për njërin ose për tjetrën palë të parisë. Mbas votimit e drejta e tyre për të folur kundër sistemit ndryshon. Kështu, paria sundon me votën e popullit dhe fiton legjitimitetin që dëshiron kaq shumë.

Rruga tjetër është organizimi i një force politike, që të punojë për të gjithë shqiptarët si komb. Pavarësisht tam-tamit mediatik, politika në shtetin shqiptar është një politikë e mbështetur në identitetin etnik, çka manipulohet nga paria. Mirëpo, vetë paria ka interesa e jo ndjenja etnike apo kombëtare. Nga ana tjetër, paria don që gjithsecila nga pakicat të ketë partinë e vet, por që shqiptarët të mos kenë, as përfaqësim e as ndërgjegjësim politik. Kështu, në këtë pikë pakicat në shtetin shqiptar janë të organizuara shumë mirë në strukturat e *Unionit Vllah*, *Partisë për të Drejtat e Grekëve*, *Partia e Maqedonasve*, apo edhe *Partia e Romëve*. Të gjitha këto forca politike të minoriteteve luajnë një rol disafish më të madh në politikë, se sa vlera reale e tyre. Por, për parinë jeniçere të Tiranës, vetëm shqiptarët nuk duhet të kenë një forcë që mendon e që lufton që të mbrojë interesat e tyre si komb. Siç shihen gjërat, shqiptarët nuk do të kenë përfaqësim politik si komb, as në këto zgjedhje. Kur të organizohen si shqiptarë, atëherë do të jenë gjërat më ndryshe.

Rruga e tretë është rruga e luftës së hapur me çdo mjet, e pa mëshirë kundër këtij sistemi jeniçero-martalloz. Kjo luftë duhet zhvilluar si në nivelin shoqëror, ashtu edhe në atë politik. Terreni nuk është shterpë, përkundrazi. Në shtetin shqiptar ka shumë rezistencë ndaj sistemit të parisë. Nga një anë ka shumë forca të majta, në të cilat militojnë njerëz të ndershëm dhe që besojnë në një formë të ideologjisë marksiste apo enveriste. Nga ana tjetër, ka një rezistencë të dallueshme, veçanërisht në grupimet që po lindin dhe që janë të organizuar në bazë të ideologjisë fetare. Po

ashtu, ka pasur shenja të rritjes së anarkizmit e të formave të tjera të rezistencës shoqërore e të mbështetura në kundërkulturë. Ka edhe grupe e individë që pajtohen vetëm në urrejtjen personale kundër sistemit, por që janë të paqartë në rrugën politike që duhet të ndjekin. Edhe pse duan të kontribuojnë në politikë, nuk e kanë përgatitjen e duhur. Po ashtu, ka një rezistencë që shihet qartë në forcimin e strukturave familjare e lokale, që po i kundërvihen sundimit të parisë dhe që, megjithatë, vazhdojnë që të mbeten në anë të debatit politik.

Rruga e fundit është ajo e bojkotit. Bojkoti është një armë e fuqishme, e përdorur edhe më parë, por jo sistematikisht në shtetin shqiptar. Kur njerëzit nuk ia japin votëbesimin sistemit politik, atëherë sistemi shkërmoqet e bëhet hapur diktatorial e tiranik. Me bojkotin, njerëzit e deklarojnë zgjidhjen e tyre dhe ndarjen prej sistemit të parisë e prej vlerave të saj. Njerëzit tregojnë se kanë nder e dinjitet edhe duke refuzuar të bëhen pjesë e krimit të parisë.

Frika e bojkotit është e ndjeshme në sjelljen e parisë. Po shihet qartë se parinë e ka kapur paniku se shqiptarët do të bojkotojnë sistemin e tyre. Prandaj, në kushtet e sotme, lufta e parisë është që të mos lejojë bojkotimin e zgjedhjeve, sepse kjo çon në delegjitimimin e sistemit të saj. Asaj i duhet vota e popullit. Nuk është njëlloj si të sundosh me dhunë e si të sundosh me votën e popullit. Paria e kërkon shumë legjitimimin e vet. Për të, shqiptarët duhen sunduar ashtu si do paria. Por sistemin e parisë, pavarësisht deformimeve që ka, njerëzit duhet ta pranojnë me votën e tyre e me vetëdije të plotë.

Bojkoti si rruga e vetme për të luftuar sistemin

Ka zëra që thonë se ka ardhur koha që shqiptarët ta ndajnë mendjen. Ata duhet të bëjnë një zgjedhje të vështirë por shumë të dobishme për to: të vendosin që ta bojkotojnë sistemin. Dihet që sistemi i parisë nuk do të ndryshojë nëse nuk i kundërvihen forca politike me objektiva të qarta. Zgjedhjet nuk do të zgjidhin asgjë. Zgjedhjet vetëm do të legjitimojnë parinë e diskredituar

të Tiranës. Cilado parti të fitojë zgjedhjet do t'i ruajë interesat e tjetrës. Ashtu siç e ruajti Fatos Nano një kohë Sali Berishën, ashtu edhe Sali Berisha e ruajti dhe do ta ruajë Fatos Nanon. Siç tregon edhe përvoja e Gërdecit, çmimin e kanë paguar e do ta paguajnë shqiptarët. Nga ana e vet, klanet e parisë shahen e rrihen në media, por, dihet që ata po sillen në atë mënyrë vetëm për të mbrojtur e fshehur fitimet e tyre. Kështu që njeriu i thjeshtë nuk humbet asgjë, si votoi si nuk votoi, sepse zgjedhjet janë thjesht “dushk për gogla”. Pse të votosh për një parti, kur ajo është pjesë e krimit, partnere e palës tjetër e, për ta thënë më thjesht, kur të dyja palët janë pjesë integrale e parisë së Tiranës?

Edhe kësaj here, si një herë në katër vjet, njerëzit e kanë mundësinë që t'i bojkotojnë zgjedhjet dhe frika e parisë është se do të ketë bojkot masiv të zgjedhjeve. Gur-gur bëhet mur, mur-mur bëhet kalaja. Nga shprehjet në shtyp e nga shqetësimi i analistëve të lidhur me segmentet e parisë, ndjehet frika e bojkotimit të zgjedhjeve, si dhe frika e bojkotimit të sistemit. Paria është krejtësisht e vetëdijshme që secila votë që nuk hidhet në mbështetje të njëres ose të tjetrës palë të parisë, është një shigjetë e hedhur në zemër të sistemit kriminal të saj, të këtij sistemi që i shërben asaj dhe që i duhet asaj. Duke mos votuar, njerëzit do të tregojnë se nuk pranojnë të jenë pjesë e krimit të parisë së Tiranës. Kjo është frika e madhe e parisë.

Makthi i parisë, pra, është refuzimi i shqiptarëve për të votuar, frika se mos ndodh bojkotimi masiv i zgjedhjeve, që ata i kanë përgatitur me aq kujdes dhe që u duhen aq shumë. Momenti që ata i druhen më fort, por që kurrë nuk do ta pranojnë mendërisht, është momenti i përshkruar kaq me kujdes nga Jose Saramago, kur në qendrat e votimit do të jenë vetëm komisionet e militantëve. Ky është momenti kur gangsterët e partisë do të shkojnë shtëpi më shtëpi, por të gjithë shqiptarët ose do të jenë të sëmurë, ose kanë shkuar me pushime, ose kanë thyer këmbën, ose nuk iu pëlqen kandidati i rradhës, ose mendojnë se koalicioni ka qenë i gabuar, nxjerrin bishta (si bie fjala, nuk kanë letërnjoftime, pasaporta, nuk e kanë emërin në lista, ose e kanë në katër lista, etj.), ose e thonë të vërtetën që politika ka qenë një mashtrim i madh e i paturpshëm,

dhe nuk duan të votojnë këtë pari sunduese e pikë. Makthi i vërtetë i parisë është që mërgimtarët do të shkruajnë dy gisht letër e do t'iu thonë të afërmve të tyre që po votuat, nuk iu nisim më asnjë euro apo dollar. Makthi i parisë së Tiranës e ka emrin bojkot.

Përfundimi

Në përfundim duhet thënë se legjitimimi i sundimit të parisë së Tiranës përmes zgjedhjeve kuvendore është një provë e madhe politike, që nuk duhet kaluar lehtë. Paria e kërkon legjitimitetin me çdo kusht. Ata që janë të ndërgjegjshëm se kjo është gjendja, por nuk mendojnë se ajo votë që hedhin është një plumb në zemër të së ardhmes së tyre, e të vetë fëmijëve të tyre, janë për t'u mëshiruar. Duke gjykuar nga niveli i thellë i krizës së gjithanshme, bojkotimi, nëse ndodh, do të jetë një hap i madh përpara drejt riorganizimit të sistemit politik në shtetin shqiptar.

Në mungesë të strukturave politike që të shprehin vullnetin e popullit, bojkotimi do të jetë një vendim i marrë nga shumë individë të vetmuar, por rëndësia e aktit të tyre do të jetë shumë e madhe. Po ashtu, duhet thënë se paria ka mësuar ta kthejë dhimbjen e vet në fitore, prandaj i ka instrumentet e fuqishme të propagandës. Mirëpo bojkoti masiv, si praktikë e sprovuar, është një goditje për vdekje e cilitdo sistemit ekzistues. Në rastin e shqiptarëve, bojkoti do të ishte një shenjë e qartë se shqiptarët kanë filluar të mendojnë se nuk duhet t'i lënë më peng familjet e jetën e tyre në duart e parisë.

**MITI QENDROR I TRANZICIONIT:
LËVIZJA STUDENTORE E VITEVE 1990-1991,
PËRLESHJA E RRADHËS DHE PARIA E TIRANËS**

Një nga aspektet më interesante të përleshjes elektorale të radhës, gjithnjë midis palëve të parisë, është përpjekja e tyre e përbashkët për të përdorur Lëvizjen Studentore të viteve 1990-1991, si pikë reference e burim legjitimimi. Edhe në këtë fushatë, Lëvizja Studentore po përdoret nga të gjitha palët e parisë dhe të gjithë po bëjnë thirrje për identifikim me LSSH. Kudo flitet për përmbushjen e “idealeve të Dhjetorit”, por edhe për kryerjen e “misionit historik të studentëve.” Udhëheqësit e parisë po e paraqesin veten si “dhjetorista.” Natyrisht, parulla që ata i referohen, më së shumti, është parulla e hedhur gjatë asaj kohe “ta bëjmë Shqipërinë si gjithë Europa”. Kjo thirrje rezonon me objektivin që paria i ka vënë vetes, por edhe të gjithë shqiptarëve për t’u bërë shtet anëtar i Bashkimit Europian.

Lëvizja Studentore nuk ka qenë momenti i vetëm i rëndësishëm në përplasjen midis drejtuesve të partisë-shtet dhe masave të pakënaqura me atë sistem. Përplasjet e mëparshme, si demonstrata në Shkodër, në Kavajë, ikja e mijëra qytetarëve me ambasadat, e ngjarje të tjera, kishin qenë momente të rëndësishme. Mirëpo, ngritja e studentëve nga një anë, përballja e tyre me figurën qëndrore të sistemit dhe ndryshimi i formës së regjimit, e ktheu atë shpërthim në një moment historik dhe heroik. Nëse studentët do të dinin të fitonin pluralizmin politik për të gjithë, atëherë do të ndrronte edhe forma e regjimit. Nëse studentët nuk do të dinin të fitonin, do të vendosej një formë e rreme e pluralizmit. Kjo e bën përplasjen midis studentëve dhe presidentit të atëhershëm,

Ramiz Alia, momentin kritik, qëndror dhe vendimtar në procesin e transformimit të sistemit. Legjitimiteti i pjesëmarrësve në ato ngjarje, si kundërshtarë të regjimit është shumë i fortë. Aktiviteti i tyre gjatë atyre ditëve iu jep prestigjin që të flasin si pjesëmarrës aktivë në histori, si ata që e deshën ndryshimin, por edhe që punuan për të. Fakti që ata kanë qënë aktivë në LSSH, i bën edhe më të veçantë si personalitete politike. Jo vetëm politikanët e tanishëm, por edhe masa e madhe e qytetarëve i shohin ato ditë si të jashtëzakonshme, ngjarje kritike historike, pika e kthesës së revolucionit të munguar shqiptar.

Pra, përpjekja e individëve të ndryshëm për t'u identifikuar me LSSH vjen e natyrshme, sepse efekti i atyre momenteve ka përcaktuar jetën e gjithkujt. Aq më shumë kur ata që flasin, kanë qënë pjestarë aktivë të saj. Mirëpo, këtu ka një seri paradoksesh, që ia vlen që të diskutohen sado pak e të cekën shkurtimisht. Ajo që po ndodh, nuk është identifikimi me LSSH, por përdorimi i saj për qëllime politike dhe në shërbim të mbrojtjes së interesave të parisë.

Për shembull, PS bëri një miting në Qytetin Studenti. Çka është edhe më e rëndësishme, PS e filloi fushatën elektorale atje. Përkundër opinioneve të shprehura në shtyp, sidomos të atyre që duan që PS të distancohet nga Lëvizja Studentore dhe nga kontributi i saj, kjo sjellje është një gjë shumë e mirë dhe që duhet përshëndetur. Paradoksi nuk qëndron, ashtu si paraqitet, tek fakti se Edi Rama, Pandeli Majko, apo pse Ben Blushi "*guxuan* e *shkuan*" në Qytetin Studenti, siç e paraqet PD-ja. Ish-pjesëmarrësit në atë Lëvizje janë në të gjitha partitë. Të gjithë, me sinqeritet të natyrshëm, e shohin veten si individë me kontribut në atë Lëvizje. Vetë Edi Rama, asokohe një pedagog i ri në Institutin e Arteve, është figurë e rëndësishme dhe protagonist i kundërvënies së studentëve dhe intelektualëve të rinj ndaj sistemit të atëhershëm.

Pra, pavarësisht rolit që kanë sot në politikë, Edi Rama, Pandeli Majko, apo Ben Blushi e shumë e shumë individë të tjerë, aktivë në radhët e PS-së, kanë qënë studentë e pedagogë në atë kohë

por edhe pjesëmarrës aktivë në Lëvizje. Po ashtu, edhe Ilir Meta e të tjerë në radhët e LSI-së, kanë po aq të drejtë, në mos më tepër se shumë të tjerë në partitë e opozitës, të indentifikohen me Lëvizjen Studentore. Edhe Ilir Meta, si Pandeli Majko, kanë qenë të zgjedhur nga studentët për t'i përfaqësuar në Takimin me Presidentin Ramiz Alia.

Problemi nuk është tek identifikimi i tyre me LSSH. Por, sa herë që këta duan ta përdorin kontributin e tyre, për të justifikuar e përligjur interesat e parisë së Tiranës, ata po instrumentalizohen dhe përdoren prej saj. Prandaj, prania e Gramoz Ruçit, ish-ministër i Brendshëm asokohe, kuadër me perspektivë i sistemit, që vjen të kujtojë LSSH në Qytetin Studenti, është shenja më e qartë se këta individë kanë qëllime të tjera. Ata nuk duan që të kujtojnë LSSH dhe kontributin e saj. Ata duan që ta vënë një moment të çmuar të së shkuarës së tyre, në shërbim të interesave të klaneve sunduese të parisë së Tiranës. Duke vepruar kështu, ata po e humbin vlerën e vërtetë të kontributit të tyre. Lëvizja, si Lëvizje Studentore, ka qenë qartësisht kundër parisë, ka luftuar kundër saj dhe është luftuar pa mëshirë prej saj.

Po ashtu, paradoksi nuk qëndron tek fakti se PD dhe prijatari i saj Sali Berisha, po tregohet shumë i indinjuar që Lëvizja Studentore po përdoret nga "komunistët". Ai shesh nuk i takon Sali Berishës e as PD-së që sillen sikur e kanë marrë me tapi trashëgimninë e Lëvizjes Studentore. PD ka lindur nga Lëvizja Studentore, por nuk ka qenë e nuk është LSSH. Si nismëtari i saj, si njeriu që i bëri këta njerëz bashkë për të themeluar PD-në, them me bindje të plotë, se Sali Berisha dhe PD-ja, bënë gjithçka për të vrarë e për të mbytur Lëvizjen Studentore, si dhe për të eliminuar drejtuesit e saj. Sa herë që PD bën një miting në Qytetin Studenti, ajo kthehet tek vendi i krimit të vet. Edhe në këtë fushatë, herët a vonë, PD do të turret që ta mbushë sheshin me individë të mbledhur nga rruga, që as nuk ia kanë idenë se çfarë ka qënë Lëvizja Studentore. Por PD është një parti që, me Lëvizjen Studentore, nuk e ka lidhur e nuk lidh më asgjë. Studentët që kanë qenë aktivë gjatë kohës së Lëvizjes dhe sot që janë militantë të Sali Berishës, janë njëlloj si pjesëmarrësit që janë militantë të LSI-së apo të PS-së. Në momentin që ata duan

të përdorin Lëvizjen për interesat e Sali Berishës ata janë kthyer kundër saj. Idealet e një kohë nuk mund të justifikojnë sjelljen e individëve në një kohë tjetër.

Paradoksi tjetër nuk qëndron thjesht tek përdorimi i thirrjes “ta bëjmë Shqipërinë si gjithë Europa”. Duhet theksuar se objektivi i studentëve ka qënë që ta bëjnë shtetin shqiptar si e gjithë Europa Perëndimore e jo të arrihet futja në BE. Paradoksi qëndron edhe tek konteksti ku përdoret kjo thirrje, atje, në Qytetin Studenti. Mjafton të shihen mejhanet e shumta, mjerimi i thellë në të cilin jetojnë studentët e sotëm, rrjetet e drogës, të krimit, të përdaljes, dhe të fëlliqësisë që e kanë mbërthyer për fyti Qytetin Studenti dhe Universitetin e Tiranës. Mjafton të shihen mensat, konviktet dhe, mbi të gjitha, mjafton që të shihet ndërtesa ku u zhvillua Greva e Urisë. Nga Qendër Kulture ka përfunduar në një seri mejhanesh. Prandaj, kjo parullë tingëllon më shumë si një tallje e pashije me ëndrrat e studentëve të asaj kohe. Nëse paria e përdor Qytetin Studenti si model të arritjeve të saj, në rrugën e përmbushjes së objektivit për ta bërë shtetin shqiptar si Europa, mjerë ne. Europa e sotme, ajo që shihet nga Qyteti Studenti, është një e ardhme e pashpresë.

Por, paradoksi i vërtetë qëndron tek fakti se edhe pse të gjitha palët e parisë së Tiranës luftuan pa mëdyshje që ta mbysin Lëvizjen Studentore, sot të gjithë palët kthehen po tek ajo Lëvizje. Ata i referohen asaj, flasin në emër të vlerave të saj, dhe, çka është tragjikomike, e shohin veten me krenari si pjestarë të saj. E vërteta është se disa prej tyre kanë qënë pjestarë të saj. Por, sot, ata nuk bartin në politikë vlerat e saj. Më e shumta që bëjnë, është ta trajtojnë LSSH si dordolecin në arë, në mos tjetër, për t'ia hequr palës tjetër legjitimitetin e lidhjes me LSSH. Duke iu kujtuar njerëzve një moment të së shkuarës së tyre, ata po kërkojnë që të mbulojnë pafundë-sinë e krimeve që kanë kryer më pas. Në politikë është normale që të përdo-rësh gjithçka që mundesh, por edhe përdorimi duhet bërë me masë. Dritëhija midis të vërtetës e demagogjisë, është gati e padallueshme, por dita dhe nata janë krejtësisht të ndryshme.

Me kohë, ia vlen që të qëmtohet, por edhe të problematizohet

ky përqëndrim i parisë tek Lëvizja Studentore, tek vlerat dhe tek kontributi i saj, edhe përtej identifikimit, si moment vendimtar dhe kritik i përplasjes e tranzicionit. Pse po ndodh kjo gjë edhe mbas 20 e sa viteve? Kthimi i tyre tek një Qytet Studenti që duhej t'i bëjë të ndjehen të paqetë, pse nuk kanë qenë të mirëpritur aty, është domethënëse. Në mos tjetër, një sjellje e tillë është një tregues i qartë i shterpësisë së tyre ideologjike dhe të mangësisë së vlerave gjatë tranzicionit. Të dy palët e parisë nuk kanë asgjë të tregojnë për idealet e tyre. Po ashtu, një identifikim i tillë është tregues i largpamësisë, përkushtueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së vlerave, që të nisura nga njerëz të caktuar, i dhanë frymën LSSH. Duke pasur objektiva të tilla të çmuara e në interes të të gjithë shqiptarëve, LSSH u transformua nga një turmë studentore në një strukturë të fortë. LSSH pati ide mjaft të qarta e dha një kontribut të jashtëzakonshëm në historinë e shqiptarëve. Për ndryshe, pjestarët e parisë nuk do ta përdornin imazhin e saj, praninë e tyre, dhe nuk do t'iu referoheshin vlerave të saj.

Por, gjithsesi, mendoj se është mirë që të gjitha palët e parisë duan të identifikohen me atë Lëvizje. Në mënyrë paradoksale ata e mbajnë atë në qendër të vëmendjes. Edhe pse tani kjo iu shërben atyre vetë, me kohë, Lëvizja Studentore po e merr vendin e vet të merituar në ndërgjegjen kombëtare e në politikën shqiptare. Një Lëvizje që ka synuar t'iu shërbejë të gjithëve, iu takon të gjithëve. E nganjëherë, fitorja më e madhe është që të shohësh e të dëgjosh kundërshtarin tënd që të përsërisë fjalët e mendimet tuaja, të gjejë krenari duke dashur të përvetësojë kontributet tuaja. Në mos tjetër, kjo sjellje e parisë duhet ta bëjë çdo pjesëmarrës në atë Lëvizje Studentore që të ndjehet krenar për veten, për miqtë e shoket e vet, si dhe për kontributin e papërsëritshëm që kanë dhënë në një moment kritik të historisë shqiptare.

PERËNDIA DYFYTYRËSHE, NDRYSHIMI DHE VAZHDIMI NË ZGJEDHJET E 28 QERSHORIT 2009

Sa herë që mbaronte viti i mandatit të një konsulli në Romën e lashtë, ishte një ditë e shënuar. Në Romë organizohej një procesion madhështor ku printe shtatorja e një Perëndie me dy fytyra. Ky perëndi simbolizonte, si kalimin e pushtetit nga një konsull tek tjetri, d.m.th., ndryshimin e individëve në pushtet, ashtu edhe vazhdimin e sundimit të parisë së Romës të mishëruar tek Senati. Nga ana tjetër, Janusi, ky perëndi dyfytyrësh, simbolizonte dy gjëra të ndryshme për parinë e për popullin. Për popullin, Janusi ishte simboli i ndryshimit. Për parinë, Janusi ishte simboli i vazhdimit të sundimit të saj. Njëra palë jetonte me shpresa, tjetra me interesa.

Vetë Roma ishte një shtet oligarkik. Gjatë kohës së Republikës dhe pak më ndryshe gjatë kohës së Perandorisë, Roma sundohej me dorë të hekurt prej familjeve senatoriale, parisë së vërtetë të Romës. Por edhe këta kishin nevojë për legjitimitet. Kur nuk kishte shumë popull në rrugë ose mungonte mbështetja në Forum, senatorët nxirrnin klientët e sklevërit e tyre për të mbushur rrugët e për të hedhur lule. Objektivi ishte për t'u siguruar se fitimtari kishte mbështetjen popullore. Megjithatë, kushdo që fitonte, ai do të ishte njëri prej tyre. Aklamacioni popullor ia legjitimonte sundimin parisë.

Mirëpo, edhe pse shteti shqiptar nuk është Roma, e para sunduese nuk ka asgjë të përbashkët me Senatin, para lufton fort që të marrë miratimin popullor. Ajo synon që ta marrë miratimin popullor me votë, por edhe publikisht, me aklamacion të hapur e të pakundërshtuar. Kështu, tash që në Tiranë formalisht kemi demokraci, parisë oligarkike i është dashur që t'u adoptohet këtyre

situatave, në të cilat, formalisht, populli e ka forcën dhe kontrollin mbi institucionet e shtetit. Paria nuk është asnjëherë e sigurtë për përfundimin e procesit zgjedhor. Ndaj paria oligarkike mundohet që të gjejë mënyrën se si ta minojë funksionimin e demokracisë në shtetin shqiptar e ta kthejë procesin zgjedhor thjesht në një procesion miratimi me aklamacion mitingesh.

Paria është duke ndjekur shembullin e sprovuar të parive të tjera, sidomos të *Republikave të Bananeve*. Edhe kur nuk janë kundër interesave të popujve të tyre, prapë këto pari mendojnë vetëm për vete, dhe për interesin e tyre të ngushtë. Prandaj edhe paria e ka kthyer procesin zgjedhor në një lojë procesionale. Si pasojë, brohoritjet e turmës së mbledhur në mitingjet partiake janë shenja e aprovimit të njëres palë apo të tjetrës. Në mitingjet përpara zgjedhjeve, shpresa është se ditën e votimeve, po këta njerëz do të votojnë për parinë. Në mitingjet mbas zgjedhjeve, legjitimohet rezultati dhe provohet mbështetja popullore. Aklamacioni mitingash shumëfishohet përmes televizioneve dhe, kështu, duket se sundimi i parisë është legjitim.

Por procesi zgjedhor edhe në këto zgjedhje është haptazi i manipuluar. Procesi është i dënuar që të jetë i kontestuar. Me mbi një milion e gjysëm emigrantë, faktikisht të përjashtuar nga zgjedhjet, me një milion shqiptarë të tjerë që nuk mund të votojnë si duhet, paria është e garantuar se vetëm militantët dhe klientët e saj do të votojnë. Sistemi zgjedhor është ndërtuar në mënyrë të tillë që të garantojë interesat e saj. Po ashtu, komisionet zgjedhore, të përbëra me klientë e besnikë të parisë, do t'i ngjallin këto *shpirtna të humbur* gogolianë. Ata do t'i ngjallin e do t'i bëjnë që të votojnë, duke i shndërruar emrat që gjenden në lista, në vota të hedhura në kutitë e votimit.

Përfundimi është se nuk ka rëndësi se kush do të fitojë apo kush do të humbë. Përfundimi, shumë i sigurtë. Paria, si shtresë, fiton edhe këtë herë. Të gjitha palët e dinë se kjo është lojë mashtrimi. Të gjithë e luajnë një lojë mashtrimi. Por loja që ata luajnë ka si objektiv që të polarizojë popullin në mbështetës të njëres palë apo të palës tjetër të parisë. Synimi është që të binden njerëzit që ka zgjidhje për problemet e shumta me të cilat përballen. Qëllimi

është që të binden se ka shpresë për të ardhmen. Qëllimi është që të binden, edhe përkundër realitetit, se shpresa janë njëra apo tjetra palë e parisë. Prandaj, duke qenë se zgjidhjet nuk vijnë nga programet, të dy palët e parisë përdorin sllogane e parulla pa peshë, por edhe pa kuptim.

Kështu, njëra palë e parisë çirret për “ndryshim” dhe evokon parullën zgjedhore të Presidentit Obama. Natyrisht, shteti shqiptar ka ndryshuar e do të vazhdojë që të ndryshojë, deshi apo s’deshi PD-ja. Ndryshim do të ketë edhe po të heqë dorë paria nga punët e shtetit e t’i lërë shqiptarët në punë të vet. Mirëpo, në rastin e PD-së, ndryshimi përkthehet si rrugë, ndërtim rrugësh, tunelesh, etj. Por, ka rrugë që të çojnë përpjetë. Ka rrugë që të çojnë teposhtë. Ka rrugë që të çojnë lart e poshtë pa të çuar kund. Ka rrugë ku je i dënuar të ngjitesh, si Sizifi pa mbërritur kurrë atje ku duhet. Ndryshim është edhe kalendari stinor. Vjen vera, ik dimri, ik një stinë hajde një tjetër. Ndryshimi që ka ndërmend paria është që *plus ça change et plus c’est la meme chose* d.m.th., sa më shumë ndrojnë gjërat, më shumë mbesin ashtu si janë. Rrugët ndërtohen për të vjedhur tendera, e për të futur në punë mbështetësit e parisë. Ka shtete si Gana që kanë ndërtuar rrugët më të mira në botë, por nuk kanë asnjë objekt industrial në anë të tyre dhe janë zhytur në borxhe.

Pala tjetër flet për “politikë të re.” Mirëpo, politika nuk ndryshon. Politika gjithnjë është politikë, sepse është një aktivitet i caktuar që lidhet me zgjidhjen e problemeve shoqërore. Ajo që ndryshon është objektivi për të cilin je në politikë, cilat interesa mbron në politikë dhe si i mbron ato interesa. E në se thelbi i objektivave politike nuk ndryshon, nëse njerëzit me të cilët punon nuk ndryshojnë, nëse mendësia dhe vlerat nuk ndryshojnë, atëherë, “politika e re” është një mbulojë e përdorur për të mbrojtur interesat e vjetra të palës së parisë të grupuar në PS dhe të klaneve që janë të lidhura me të. Pra, nëse një shpend këndon si gjel, duket se është gjel dhe sillet si gjel, atëherë është gjel. Ti mund ta thërrasësh thëllëzë a fazan po deshe, por ja që është gjeli.

Deri në këtë pikë duhet thënë se paria ia ka mbërritur që të krijojë përshtypjen se procesioni i saj do të jetë i pritur me shumë

kureshtje dhe se do të stoliset edhe me popullin e rreshtuar në të dy anët e rrugës, ku do të kalojnë fitimtarët e humbësit e rradhës. Shenjat e militantizmit e të dehjes propagandistike partiake janë gjithkund. Miliona euro, që s’dihet prej nga vijnë, janë harxhuar për flamujt e për këngët e PD-së. Paradokset janë të pafundme. PD mburret me fitoren e së djathtës “europiane,” në një shtet të sunduar nga mendësia katundare. Miliona euro të tjera, që s’dihet nga vijnë, janë harxhuar për flamujt “pink,” të PS-së, që formalisht ka adaptuar programet “laburiste” angleze në një shtet ku nuk ka as industri e as sisteme mbrojtjeje shoqërore. Mijëra militantë, klientë e arrivistë, me shumë flamurë në xhep, shkojnë rregullisht nga njëri miting tek tjetri, pavarësisht se cila parti i organizon. Të gjithë palët flasin një gjuhë demagogjike të hapur. Të gjithë përdorin një diskurs politik, që nuk ka fare kuptim në nivelin ideologjik. Të gjithë politikanët flasin për synime që nuk kanë asnjë lidhje me çka po ndodh realisht në atë vend.

Por, megjithatë, po shihet se, shumë njerëz jashtë rrethit të ngushtë të parisë po mendojnë me frikë për ditën e mbaszgjedhjeve. Të gjithë kanë ndër mend momentin kur *mund* të hiqen nga puna po fitoi pala kundërshtare, momentin kur do të humbin bizneset, tenderat. Shumë druhen se, ndoshta, do iu duhet që të marrin rrugët e mërgimit e të fillojnë që të jetojnë në kurbet me qeratë e shtëpive e të dyqaneve që kanë. Shumë shpesh, të ardhurat nga shteti shqiptar, ku këta e mbajnë shpresën, vijnë nga objekte të ndërtruara me krim, poshtërsi dhe vjedhje e hapur e pronës publike dhe private.

Bojkotimi i procesionit

Si mund të dilet nga kjo gjendje? Mënyra e vetme për ta tronditur këtë sundim të parisë është që në rrugët ku do të kalojë procesioni i fitimtarëve të mos ketë asnjë njeri. E po të ketë disa pak njerëz, të gjithë do ta mësojnë edhe një herë se kush janë të verbërit, skllëvërit e parisë, militantët e thekur dhe ata që urrejnë pa menduar për të ardhmen. Po pati më shumë, e dimë se edhe klientët, ata që hanë e që pinë prej tyre, kanë dalë në rrugë. Të gjithë shqiptarët i njohin

militantët partiakë dhe arrivistët. Në se në rrugë dalin hajnat, militantët, vrasësit me pagesë, vjedhësit e pasurisë kombëtare, të korruptuarit e të zvetënuarit, sado të shumtë që mund të jenë, nuk ka se si të ngatërrohen me mbështetjen e vërtetë popullore.

Në se punët vijnë deri në këtë pikë, paria e Tiranës nuk fiton. Paria e din, dhe të gjithë ne e dimë, se bojkoti i zgjedhjeve është armiku i saj për vdekje. Mungesa e mbështetjes apo e pranisë popullore do të tregonte qartë se sa pak e lidhur është ajo me interesat e popullit që sundon. Por, po doli populli për të votuar, atëherë paria e ka fituar edhe një betejë tjetër. Paria do të nxjerrë nga depoja e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve perëndinë e vet dyfytyrëshe. Me një kryetar në qeveri e me një kryetar mbrapa në opozitë, në mitingje, në rrugë, e në sherr mediatik, ajo do të vazhdojë që të ruajë interesat e veta.

Ndërsa, populli sigurisht që do të zhgënjehet sërish. Ashtu si nuk mund të jetohet vetëm me bukë, nuk mund të jetohet me shpresën e kotë se paria do të ndrrojë rrugë. Një pari që ka bërë krime të përbindshme, që nuk e ka pikën e vrasjes së ndërgjegjes për shkatërrimin që ka lënë rrugës së historisë, nuk do të fillojë që të ndrrojë rrugë, vetëm e vetëm sepse njëra palë e saj i fitoi zgjedhjet kuvendore të radhës dhe thotë se është koha për ndryshim.

OBJEKTIVI I TRANZICIONIT, LUMTURIA KOMBËTARE, DHE QEVERIA E INTEGRIMIT

Një nga shtetet më të varfra në botë, Bhutani, ka një tregues të rëndësishëm me të cilin mundohet të masë arritjet e qeverisë e popullit të vet. Ky objektiv nuk është Prodhimi i Përgjithshëm Kombëtar por Lumturia e Përgjithshme Kombëtare. Lumturia Kombëtare është një koncept që buron nga parësitë kulturore, mendësia e shoqërisë dhe vlerat e saj të përcaktuara nga mbreti i atij shteti përjetësisht të varfër. Lumturia kombëtare përcakton një rrugë zhvillimi të ndryshme nga zhvillimi ekonomik, por që ka të bëjë me aspektet e tjera të zhvillimit shoqëror si edukimi, ruajtja e traditave kulturore, harmonizimi i vlerave, ruajtjen e ambjentit e me radhë. Ky objektiv i arritjes së Lumturisë Kombëtare është vënë në qendër të projekteve zhvillimore në Bhutan. Çdo projekt që duhet të zbatohet shihet nga ky këndvështrim dhe rezultatet kanë qenë me të vërtetë të habitshme.

Po në rastin tonë? Cili *duhej* të ishte objektivi i Lumturisë Kombëtare? Si hap i parë, duhet thënë që duket sikur shqiptarët ende nuk e kanë të qartë se cili ka qenë e duhej të ishte objektivi i tranzicionit, d.m.th, i ndryshimit nga sistemi enverist parti-shtet. Ku duhej e ku duhet shkuar? Në një pikë kthese, deri edhe vetë paria sunduese enveriste pajtohej me mendimin se sistemi enverist nuk funksiononte dhe se duhej ndryshuar. Mirëpo, kur vinte puna tek ndërtimi i shoqërisë së re, masa e popullsisë fshatare kërkonte kthimin e *status quo ante*, d.m.th., tek prona e vogël familjare. Ai ishte objektivi i lumturisë për ta, nuk ishte demokracia. Prandaj, edhe PPSH mori votat dërmuese të fshatarëve në vitin 1991. Masat e proletarizuara qytetase kërkonin që të ndërtohej një shoqëri e

mbështetur në modelet televizive ku nuk punohej. Lumturia për këtë shtresë ishte me jetue si në filmat e sheqerosur të viteve 1970-1980. Edhe për masat e proletarizuara qytetase, objektivi i lumturisë nuk ishte demokracia.

Intelektualët dhe paria synonin vendosjen e kapitalizmit dhe shndrrimin e tyre në borgjezi sunduese. Edhe për ta, demokracia ishte diçka që vinte në paketë me kapitalizmin, një lojë mashtrimi me masat, të cilave mund t'iu thoje çka të vinte ndërmend, si p.sh. "Amerika na ka dhënë ne çekun e bardhë." Gjithsesi, hapi i parë në rrugën e ndërtimit të lumturisë kombëtare ishte shkatërrimi, përvetësimi, apo vjedhja e shpërdorimi i gjithçkaje që ekzistonte formalisht në pronësi të shtetit, përfshirë këtu edhe shtetin vetë.

Sidomos mbas vitit 1997, objektivi i lumturisë kombëtare gjatë tranzicionit është sprovuar efemeral dhe i plazmueshëm. Për liberalët, që mungojnë në Tiranë, objektivi duhej të ishte vendosja e një sistemi demokratik të qëndrueshëm. Për nacionalistët duhej të ishte formësimi dhe stabilizimi i një shteti kombëtar demokratik, sidomos mbas kushteve që u krijuan me Luftën Shqiptaro-Serbe në Kosovë. Mirëpo, në ikjen nga çështja kombëtare shqiptare, paria e re sunduese, tashmë e transformuar, ka këmbëngulur e po këmbëngul, me një insistencë të habitshme, se objektivi madhor "konsensual" e "mbarëshqiptar" është e do të jetë integrimi në strukturat euroatlantike. Ky koncept hibrid por, për të, shumë i dobishëm politikisht, shitet si *panacea*, d.m.th., si zgjidhja e të gjithë problemeve, dhe si objektivi përfundimtar që duhet të arrijmë. Si edhe u shpreh kryeministri Sali Berisha në fjalimin e paraqitjes së Qeverisë së Integritimit European në Kuvendin Popullor me 16 Shtator 2005,

"Integrimi në Bashkimin Evropian, i cili përbën modelin, synimin dhe destinacionin tonë final e të pazëvendësueshëm, është emëruesi më i fuqishëm i përbashkët i kësaj qeverie. Modeli i shkëlqyer i suksesit të demokracive të vendeve të Evropës Perëndimore, mbeten një frymëzim për përthithjen e vlerave më të mira që do të na çojnë në respektimin dhe përsosjen e mëtejshme të tyre por edhe në një zhvillim progresiv më të shpejtë, më cilësor dhe më tërësor në të gjithë vendin. I gjithë

programi i maxhorancës dhe Qeverisë së saj të Integritimit Evropian ka për orientim dhe synim arritjen e standardeve të prag pranimit të Shqipërisë Anëtare e Bashkimit Evropian.”

Objektivi formal i qeverive është që të punojnë për të siguruar mirëqënien, begatinë e sigurinë e popujve të tyre. Në rastin tonë, *integrimi euroatlantik* është objektivi qëndror i politikës shqiptare. Shkurt e shqip, mbasi SHBA na futën në NATO, ky objektivi që paria ia ka caktuar vetes, po përkthehet në arritjen e antarësimit të shtetit shqiptar në Bashkimin Europian me të drejta të plota. Ja si shprehet kryeministri Sali Berisha në programin e Qeverisë,

“Duke vlerësuar me përgjegjshmëri politike dhe patriotizëm rezultatin zgjedhor dhe nevojën për një qeverisje të qëndrueshme dhe efektive për të përballuar *sfidat integruese të vendit*; Duke kuptuar nevojën e bashkëpunimit bipartizan e të përgjegjshëm politik, mirëkuptimit mbarëshoqëror, dhe nevojën për integrimin social dhe eliminimin e polarizimit të shoqërisë si rezultat i politikës konfliktuale; *Duke gjykuar se kjo ishte alternativa e vetme që ruante stabilitetin politik në vend dhe vazhdimësinë e procesit integrues*, në mënyrë të veçantë, objektivat specifike afatshkurtra të tij, si lëvizja e lirë e qytetarëve shqiptarë; Me këtë përgjegjësi historike, ky koalicion i gjerë i jep jetë dhe mbështet Qeverinë e Integritimit Evropian dhe angazhohet për vazhdimin me hapa të sigurtë dhe ritme të përshpejtuara të proceseve integruese me *synimin e përgatitjes për antarësim të Shqipërisë, brënda mandatit katërvjeçar të kësaj qeverisjeje...* dhe sigurimin e lëvizjes së lirë të shqiptarëve në hapësirën Shengen brënda vitit të parë të mandatit qeverisës.”

Ky ka qënë objektivi i gjithë qeverive të shtetit shqiptar të mbas-1990's. Ky është edhe objektivi i koalicionit të parisë që synon të formojë qeverinë edhe kësaj here. Në mbështetje të fjalës së kryeministrit, Ministria e Integritimit Arenca Trashani shkruan,

“Si anëtare e kabinetit të ri qeveritar dhe si Ministre e Integritimit, dëshiroj të theksoj vullnetin politik të qeverisë

për ta trajtuar çështjen e integritimit evropian të vendit, si një prioritet kryesor të programit qeverisës. Ky nuk është në fakt një prioritet vetëm i qeverisë, por në radhë të parë i vetë shqiptarëve të cilët që në fillimet e demokracisë në vend kanë shprehur një vullnet të palëkundur për ta parë Shqipërinë pjesë të familjes së Bashkimit Evropian. Shansi historik i Shqipërisë dhe shqiptarëve është se vullneti i tyre për integrim në Europë është përputhur plotësisht dhe më vullnetin e Europës për ta pranuar Shqipërinë në familjen e madhe të saj.”

Ky është bërë edhe objektivi i *Lumturisë Kombëtare* të shqiptarëve. Por, ndryshe nga Bhutani, për shkak të gjendjes ku jemi, arritja e lumturisë kombëtare është e pambrirshme. Arsyet duhen kërkuar në dështimin e parisë, në qëndrimin e BE-së ndaj shqiptarëve, në rolin qëndror të çështjes kombëtare, dhe në krizën e thellë që e ka mbërthyer vetë BE.

Por, më parë, duhet shpjeguar roli qëndror i BE-së në arritjen e lumturisë kombëtare. Politikanët, dhe e gjithë paria, sillen sikur hyrja në BE do të na i zgjidhë të gjitha punët dhe problemet. Atëherë, do të bëhemi si gjithë të tjerët, normalë e evropianë të lumtur. Në rastin tonë, futja në BE barazohet me arritjen e mirëqenies, begatisë, dhe të sigurisë, të jetesës që kanë evropianët, dhe që e duan kaq shumë shqiptarët. Megjithatë, për shkak se ne nuk kemi as ekonomi e as shtet normal, nuk na shpjegohet arsyeja, se përse, evropianët nuk na i japin ato para e të mira materiale që thuhet se do të na i japin mbas anëtarësimit që tani, e të na lënë në punën tonë. Po ashtu, nuk shpjegohet se pse evropianët janë aq të dëshpëruar, sa të mos i lënë shqiptarët jashtë BE-së edhe për shumë kohë të tjera me teknikën e njohur të peshkatarëve, “tërhiqe perin e mos këput”.

Mirëpo detyra e qeverisë është të duket se po bën ç’është e mundur për të arritur integrimin. Jo vetëm që BE paraqitet si *Shangri-la*, apo *El Dorado*, por qeveria shpenzon fonde, kalon ligje, vendos rregulla, ndryshon targa e flamurë, shenja rruge e tekste shkolle, pikërisht për të bindur shqiptarët se arritja e këtij objektivi po ndiqet me shumë seriozitet. Ka shumë vite që, si në librin 1984, kemi edhe një ministri të posaçme që kujdeset për këtë

objektiv. Ministria e Lumturisë Kombëtare e ka emrin Ministria e Integrimit Europian.

Ia vlen të thuhet se ka zëra të qartë e skeptikë për shanset e për mundësitë e integrimit të shqiptarëve në BE. Disa pjestarë të tjerë të parisë kanë treguar realizëm në analizat e tyre për këtë problem. Ata kanë vënë në dukje se jemi aq larg integrimit, sa mund të thuhet me mjaft besim, se ky objektiv nuk është i mbrritshëm, as edhe për një kohë të gjatë. Mirëpo, pala e parisë ka ngulmuar të ecë në këtë rrugë pa krye e pa shpresë. Paria e ka kthyer integrimin në objektivin e vetëm e të pazëvendësueshëm të politikës shtetërore e kombëtare. I gjithë riorganizimi shoqëror, dhe i sistemeve të tjera, gjatë tranzicionit janë vënë në funksion të këtij objektivit “kombëtar”.

Por edhe pse kanë kaluar disa vite nga këto përpjekje të bujshme të parisë, realiteti është se shteti shqiptar është më larg se kurrë arritjes së këtij objektivit të lumturisë kombëtare. Tash, do të kemi qeverinë e integrimit europian. Nëse objektivit i saj i vërtetë është integrimi europian, atëherë duket se dështimi i saj do të jetë i garantuar. Çka është më e keqja, çdo qeveri që do të formohet nuk do të ketë as fuqinë politike, as ndërtimin institucional, as burimet e strukturat ekonomike, as kohën e nevojshme, as dëshirën e sigurtë, as mbështetjen popullore, por edhe as mirëkuptimin e shteteve që vendosin në BE, për të bërë ato ndryshime që mund të krijojnë kushtet e duhura për futjen e shtetit shqiptar në Bashkimin Europian.

Po ashtu, zgjidhja që shqiptarët kanë bërë në nivelin politik, strategjik e ushtarak është që të lidhen me SHBA e jo me BE. Mbi të gjitha, shteti shqiptar vazhdon të mbetet peng i çështjes kombëtare shqiptare, problemit më të mprehtë politik e ende të pazgjidhur në Ballkan. Ia vlen të përmenden shkurtimisht se si duket se na shohin e na trajtojnë ne, shqiptarët, ‘familja’ e jonë europiane në gjirin e së cilës po luftojmë që të shkojmë.

Për BE, duket se sistemi politik në shtetin shqiptar është i ndërtuar në mënyrë të tillë që të garantojë sundimin e dy partive të mëdha. Për më shumë, strukturat e partive i kanë futur partitë politike në kontrollin e hekurt të liderit të rradhës. Kështu, për

BE, partitë janë instrumenti i kryetarit të rradhës. Prandaj, zgjedhjet kuvendore ishin një dështim i thellë politik, dhe me pasoja të pallogaritshme, edhe për integrimin e shtetit shqiptar në BE. Vetëm paria e Tiranës mund të besojë se sistemi politik në shtetin shqiptar është demokratik dhe se qeveritë që dalin prej atyre zgjedhjeve janë legjitime. Duket se BE, që është e interesuar për stabilitet, do ta kapërdijë edhe këtë farsë elektorale, që iu servir nga paria e Tiranës. Por, duke shfrytëzuar edhe përlëshjen e radhës së segmenteve të parisë, BE do ta bëjë të qartë se ky është një dështim tjetër, shumë i rëndë, që na largon edhe më shumë nga objektivi i deklaruar i parisë, ai i integrimin në BE.

Në nivelin institucional, kam bindjen se BE e ka bërë të qartë se shteti shqiptar është një shtet i kapur nga interesat e veçanta ekonomike, e qartësisht kriminale, në të gjitha nivelet. Arrestimi i hajdutëve të xhepave dhe të vrasësve ordinerë, që mbush ekranet e faqet e gazetave në Tiranë, nuk e fsheh dot realitetin e një shteti të kontrolluar nga oligarkët e parisë. Aq më keq që realiteti është i tillë që strukturat institucionale dhe shtetërore janë të kapura e të kontrolluara prej krimit të organizuar dhe pjesë integrale e tyre. Është e vërtetë që paria i ka forcuar strukturat institucionale dhe shtetërore mbas vitit 1997. Por, paria ka shkuar vetëm deri në atë nivel sa që ato institucione të fuqizohen që të mbrojnë interesat e tyre.

Në lidhje me zhvillimin e sistemit të duhur ekonomik, shteti shqiptar nuk ka se çfarë të tregojë si dëshmi të përafritimit me strukturat ekonomike të BE. Vendi prodhon shumë pak, konsumon shumë mallra importi, mbahet me një ekonomi joformale, të kriminalizuar, që varet nga mërgimtarët dhe nga aktivitetet e jashtëligjshme dhe ku zyrtarët e individët e lidhur me to pasurohen si në përralla. Nga ana e vet, BE e sheh me shqetësim të thellë rikthimin e skafeve, sistemin ndërkombëtar të trafikut njerëzor e të drogave dhe influencën që kanë klanet e shumta kriminale mbi politikanët shqiptarë në të gjitha nivelet, si një shtet ku edhe qentë e rrugës dehen me hashash e marijuanë (ndryshe e njohur si *canabis sativa*, shqip "kërpi").

Kriza e thellë që e ka përfshirë shtetin e ekonominë shqiptare,

u fsheh me kujdes gjatë fushatës zgjedhore. Por tashti kriza ka dalë qartësisht në sipërfaqe. Arka e shtetit është bosh. Mërgimtarët nuk dërgojnë aq ndihma sa dikur. Linjat e kreditit janë tharë. Buxheti është rrudhur shumë. Varfëria për shtresa të gjera të popullit ka mbrritur në ekstrem.

Në lidhje me mbështetjen popullore, shqiptarët kanë synimin që të marrin një vizë pune për dikund në BE, të ikin në jetën e mundimshme të mërgimtarit, sepse nuk gjejnë shpresë në vendin e tyre. Për ata, hyrja në BE është mundësia e ikjes në BE dhe e gjetjes së një pune që të lejon të hash një kafshatë bukë me nder. Mirëpo si shqiptarët, ashtu edhe BE, janë krejtësisht të qartë se kanë shumë pak gjëra të përbashkëta. Urrejtja e racizmi kundër shqiptarëve janë të dukshme gjithkund në vendet e BE. BE nuk po i integron një milion e më shumë shqiptarë që jetojnë në Europë, si në Greqi, tash 20 vjet. Pse duhet të pritët që BE do të merret edhe me tre milionë të tjerë që kanë shtetin e tyre?

Po ashtu vetëdija se Europa nuk na do ne, shqiptarët, duket se është e ngulitur thellë, dhe qartësisht e prekshme edhe në shtetin shqiptar. Mbas vizitës së presidentit Bush, duket se BE e interpretoi shpërthimin e shqiptarëve dhe të ndjenjës së tyre proamerikane, si shprehje të mbështetjes së madhe popullore për lidhjen shumë të fortë, strategjike e formale që ekziston midis shtetit shqiptar dhe SHBA. Mbi të gjitha, BE i sheh shqiptarët me dyshim, si krijesa të një sistemi hibrid, që kur janë në vendin e tyre duhet të bëjnë si paria, e që sillen si paria. Për BE-në, kjo don të thotë se askush në shtetin shqiptar nuk e respekton ligjin, shtetin, vlerat e 'identitetin evropian.'

Këtu duhet thënë se BE e ka një problem historik me të gjithë shqiptarët. Shqiptarët dhe paria e duket se qëllimisht e harrojnë historinë e tyre. Në sytë e evropianëve, për pesëqind vjet, shqiptarët kanë qënë pararoja e qytetërimit islamik. Më përpara ata kanë qënë pararojë e ortodoksisë bizantine, si edhe e të gjitha herezive që nga arianizmi e me rradhë. Pra, për evropianët, edhe kur një mendim i tillë vjen nga qarqet ekstremiste, shqiptarët kanë qënë mercenarë e bashibozukë të gjithkujt, përveçse të Evropës. Përmendja e Skënderbeut si *Mbrojtës i Evropës* nuk ka kurrfarë

lidhjeje me proceset e zhvillimet shoqërore në nivel të identitetit që po ndodhin në shtetin shqiptar. Si identiteti i shqiptarëve në të shkuarën, ashtu edhe identiteti i shqiptarëve bashkëkohorë, që po ecën në rrugën që don para, si edhe e theksova më sipër, ka një lidhje tejet të dyshimtë me identitetin evropian.

Po ashtu, në nivelin politik, duket se BE nuk beson se para e Tiranës ka dëshirën e sigurtë që ta integrojë shtetin shqiptar në BE. Nga ana e saj, e vetmja rrugë që oligarkia e Tiranës ka për t'u pasuruar e për të ruajtur pozitat e mbrritura, është që me mbajtë shtetin shqiptar në një gjendje të tillë. Hyrja reale në BE është një problem i madh për parinë. Arsyeja është se para do të ketë detyrime e struktura të tjera, që do t'i mbajnë nën fre e do vendosin një sistem kontrolli mbi ta. Kjo nuk i intereson fare parisë.

Mandej, në lidhje me vetveten, para e ka mbrritur Europën. Ata i kanë të gjitha gjërat që iu duhen. Ata i kanë pasaportat diplomatike e të shërbimit, i kanë vilat e apartamentet, investimet e fëmijët, spitalet e mjekët e tyre, hotelet e vendet e argëtimit, në BE e më tej. Ata nuk kanë lënë gjë për dhimbsuri shpirti në shtetin shqiptar. Kështu si janë ata vetë, para ndjehet shumë mirë. Hallet e mëdha janë të popullit. Por hyrja, ashtu si duhet në BE, më shumë i prish, se sa i ndreq punë parisë. Para duhet të fillojë që të paguajë taksa, të luftojë korrupsionin, të vendosë shtetin e së drejtës, të respektojë normat demokratike e të stabilizojë kontrollin mbi ekonominë.

E thënë ndryshe e krejt pa doreza, BE dhe evropianët në përgjithësi, duket që kanë frikë se para e Tiranës po kërkon të imitojë stërgjyshërit e vet jeniçerë, bashibozukë e martallozë që kanë marrë në qafë disa perandori, si, bie fjala, perandorinë osmane. BE mendon se para e sheh BE ashtu si Enver Hoxha shihte Bashkimin Sovjetik e Kinën dikur, d.m.th., thjesht si një mundësi për me vjelë ndihma e dhurata e për të legjitimuar sistemin e tyre.

Por, problemi më i madh që sheh BE është problemi i çështjes kombëtare shqiptare. Kjo çështje e pazgjidhur politike do të jetë në qendër të vëmendjes së BE. Shpërbërja e ish-Jugosllavisë nuk ka përfunduar ende, stabiliteti i Maqedonisë nuk është siguruar, fati

i Bosnjës nuk është vendosur dhe të gjitha zgjidhjet varen nga rruga që do të marrë çështja kombëtare shqiptare që prek edhe Malin e Zi e Serbinë. Ky është një problem që as është zgjidhur si duhet e, po të vazhdojnë të ndiqen politikat e deritashme, duket se nuk do të mund ta marrë zgjidhjen e duhur. Pa u zgjidhur qartë, e pa iu dhënë drejtim çështjes së bashkimit shqiptar, nuk vjen në fjalë çështja e integritimit europian, as për gjithë shqiptarët e as për shtetin shqiptar.

Mirëpo, duhet ruajtur gjendja e *status quo*-së, si dhe imazhi se BE ka interes për shqiptarët që të hyjnë në BE. Prandaj edhe BE sillet sikur po mundohet t'i fusë shqiptarët në BE. Nga ana e vet, BE nuk mund të veprojë ndryshe, thjesht sepse dilema me të cilën përballlet nuk i lë rrugë tjetër. Nëse shqiptarët binden se integrimi në Evropë është një premtim i perealizueshëm, atëherë zgjidhja e vetme që shqiptarët do të kenë për të ardhmen e tyre do të jetë që të drejtohen nga vetvetja dhe të kërkojnë bashkimin kombëtar e shtetin e tyre kombëtar. Mirëpo kjo lloj sjelljeje e pritshme e shqiptarëve prish shumë ekuilibre interesash. Nga ana e vet, BE as nuk ka pasur e as nuk ka farë interesi që kjo çështje kombëtare të zgjidhet si duhet. Prandaj, gjendja do të shkojë kështu hiq e mos këput, duke u ofruar shqiptarëve “zgjidhje”, por që i mbajnë larg nga BE.

Paradoksalisht edhe BE, edhe paria e Tiranës, por edhe shtetet fqinje, pajtohen në këtë pikë. Por në marrëdhëniet e parisë me BE, edhe pse të dy palët e dinë se nuk do të ketë integrim në Europë për shtetin shqiptar, as sot e as mot, prapë luhet një paradë tragjikomike. Kështu bëhen aplikime, nënshkruhen marrëveshje, organizohen tryeza dhe takime pa fund, jepen raporte, direktiva, ndihma dhe porosi. Por, është e qartë si drita e diellit se, objektivi i tranzicionit dhe i arritjes së lumturisë kombëtare është e do të jetë gjithnjë i pambrirshëm, si ylberi, edhe me qeverinë e pritshme të integritimit.

MAKINA OLIGARKIKE E PARISË SË TIRANËS DHE DËSHTIMI I DEMOKRACISË SHQIPTARE

Me mbylljen e procesit të shqyrtimit të ankesave lidhur me zgjedhjet, paria e Tiranës ia ka arritur që, formalisht, ta legjitimojë dhe ta sigurojë sundimin e vet edhe për katër vite të tjera. Taktika e saj afatshkurtër për të shmangur vëmendjen nga kriza e thellë morale e politike, që e ka përfshirë si parinë, ashtu edhe shtetin shqiptar, është që sërish të fillojë përlëshjen brenda llojit. Shpëtimi mendohet në tjerren e bërjen e lëmshit me problemet mendore, personale, familjare, apo materiale të kryetarëve respektivë partiakë e qeveritarë. Kjo teknikë njihet si “hedhja hi syve”, apo me gjuhën e cirkut, “nxjerrja e lepurit nga kapelja”.

Mirëpo, të dy palët e parisë, si këta që do të bëjnë qeverinë e “integritimit europian”, ashtu edhe ata që do të detyrohen që të bëjnë opozitën e “integritimit europian”, e dinë shumë mirë se nuk e kanë fituar legjitimitetin e duhur me këto zgjedhje parlamentare. “Integritimi europian” nuk ka qenë dhe nuk është një objektiv politik real dhe i arritshëm edhe për shumë kohë të mira. Askush nuk beson se këto zgjedhje ishin të pastra dhe të ndershme. Një nga incidentet më interesante ndodhi në Shkodër. Kandidati për deputet i LZHK-së, dhe pinjoll i një familje shumë të respektuar Gilman Bakalli, nuk mori asnjë votë në qendrën e votimit ku kishte votuar familja e tij dhe ai vetë. Prandaj, nuk ka fare besim se zgjedhjet shërbyen si një provë për të shtyrë përpara interesat jetike të shqiptarëve. Prapë se prapë, të gjithë palët e parisë janë të interesuara dhe ndajnë synimin e përbashkët, për të mos i problematizuar si duhet e sa duhet. Një nga rastet më interesante të abuzimeve që nuk u ndoqën dhe u mbyllën me kohë ishte ai i falsifikimit të votave në komunën e Ruzhdies,

“Akuzat e ngritura ndaj komisionerëve të komunës së Ruzhdies janë shpërdorim detyre, si dhe falsifikim i rezultateve të zgjedhjeve. Komisionerët e Partisë Demokratike u denoncuan nga përfaqësuesit e Partisë Socialiste çka bëri që ndaj tyre të fillonin hetimet. Një gjë e tillë bëri që të zbardhej edhe fakti se shumë prej personave të cilët rezultonin se kishin votuar me datën 28 qershor, në të vërtetë ndodheshin jashtë shtetit. Gjithashtu probleme rezultuan edhe me numrat e pasaportave, si dhe të kartave të identitetit, të cilat nuk përputheshin me ato që ishin në realitet. Shumë prej fletëve të votimit ishin edhe me vetëm një vullë. Nga ana e prokurorisë është deklaruar se është arritur të vërtetohet se ka pasur edhe persona që kanë votuar më shumë se një herë në komunën e Ruzhdies.”

Por, efektet e dështimit të zgjedhjeve do të ndjehen edhe për një kohë të gjatë. Evidenca e dëshmitë lidhur me procesin zgjedhor, si ato që janë të dokumentuara, ashtu edhe ato që vijnë në rrugë anekdotike, tregojnë, pa pikë dyshimi, se demokracia si sistem politik në shtetin shqiptar është përfundimisht e dështuar. Çka do të dalë si përfundim nga analizat e pritshme është se, sistemi politik është një sistem oligarkik, i kontrolluar nga kartelet e parisë, dhe që funksionon në bazë të të njëjtave parime të një republike bananesh.

Raportet që do të dalin do të mundohen që të argumentojnë se figurat e pjesëmarrjes janë të pabesueshme, se manipulimet ishin flagrante e të gjithkundgjendshme dhe, mbi të gjitha, se procesi ishte thellësisht i kompromentuar në të gjitha aspektet. Mirëpo, paria e di se stabiliteti formal i një shteti të kapur nga krimi i organizuar, sikundër është edhe shteti shqiptar, është më i çmueshëm për të huajt, se demokracia e vullneti i popullit. Dhe, në këto zgjedhje, paria ia doli që përfundimisht të minojë çdo element të demokracisë së vërtetë duke kurorëzuar përpjekjet e saj disavjeçare për të vendosur një sistem oligarkik. Ndryshimet kushtetuese, dhe ato të ligjit zgjedhor kanë garantuar vendosjen e duopolisë PS-PD. Ndryshimi i ligjeve ka formalizuar vendosjen e një sistemi oligarkik të kontrolluar me dorë të hekurt nga liderët partiakë të parisë. Zgjedhjet provuan se ky sistem oligarkik, i

mbështetur në makinën e korruptuar partiake, funksionon dhe është në shërbim të parisë.

Por para nuk i bën punët vetëm. Sistemi nuk do të funksiononte nëse nuk do të kishte një strukturë të konsoliduar klientësh partiakë. Këta janë mekanizmi që lidh votuesin me prijatarët e parisë. Duke përdorur dhe deformuar sistemin ligjor, duke e dredhur simbas interesave të radhës të prijatarëve partiakë, duke e vjedhur hapur e pa pikë mëdyshjeje vullnetin e popullit, struktura ndërmjetëse merr një rol qendror. E ndërtuar me një hierarki të dallueshme, kjo strukturë po funksionon efektivisht. Prandaj edhe ingranazhi qendror i këtyre zgjedhjeve ishte komisioneri, militanti partiak. Komisioneri militant ishte ai që mbushi rutinë me votat, ai që vodhi të drejtën e shqiptarit për të vendosur për qeverinë e vet. Militanti komisioner ishte hija e parisë, dora e zgjatur e saj, masha dhe instrumenti kryesor i oligarkisë sunduese. Ky ingranazh gjendet në të gjithë vendin dhe është vënë në shërbim të parisë, pa kushte dhe verbërisht. Ka shumë njerëz që nuk duan të jenë njerëz me moral. Këta po e mbajnë peng të gjithë shoqërinë për të ruajtur interesat e parisë.

Për të vërtetuar se oligarkia sundon dhe vendos në shtetin shqiptar nuk duhet asgjë më shumë se allishverishi midis Dritan Priftit e Sali Berishës ditën e zgjedhjeve. Marrëveshja midis tyre provoi se komisionet e sistemi zgjedhor, në nivel shtetëror, janë thjesht një makinë politike. Për më tepër, kjo makinë politike është vegël e verbër e vullnetit të oligarkëve partiakë të parisë. Çka ndodhi?

Mu në mes të procesit zgjedhor, dukej se nën udhëzimin e udhëheqjeve së partive të tyre, militantët e PD e të PS po mblidhnin votat e LZHK e të LSI për vete. Puna kishte shkuar deri në atë pikë sa edhe në zonën e vet, ku duhej të ishte i sigurtë, Dritan Prifti, nuk po merrte votat që i kishte të tijat. Mbas një interviste të Priftit, nënkryetar i LSI, Sali Berisha, nuhat një mundësi reale për t'a përçarë edhe më PS-në. Berisha sheh një mundësi për të legjitimuar zgjedhjet, duke ia garantuar fitoren PD dhe duke shmangur kështu koalicionin e paravendosur me pjesën tjetër të parisë. Zgjedhjet ishin llogaritur që ta çonin vendin në një koalicion të gjerë PS-PD,

në një qeveri teknike për katër vitet e ardhshme. Ja si e përshkruan Dritan Prifti marrëveshjen që ai bëri me Sali Berishën,

“...Pashë një skenar që luhej nga komisionerët e PS-së. ... I pashë se si vepronin. Sigurisht, votat tona ndaheshin tek të dyja partitë. Votat e LSI-së hidheshin edhe tek PD, dhe tek PS. Por, rolin aktiv për ta bërë këtë gjë e kishin komisionerët e PS-së. E pashë, pastaj u detyrova të ndërmerrja një vendim taktik. Bëra një deklaratë publike për të tërhequr të paktën njërin nga palët, për ta bërë aleate. Thashë, “vota ime nuk do të jetë për Edi Ramën”. Vetëm 1 minutë pasi kam dalë nga studio, ku bëra deklaratën, më ka telefonuar zoti Berisha. Më ka telefonuar, dhe më ka thënë: “je ankuar në televizion për gjërat që po të ndodhin në Fier?”. I thashë, ‘po më vjedhin votat. PS bashkë me PD, pasi PD-ja nuk po i mbron, po preferon që të ndahen votat tona’. “Çfarë do prej meje,” më tha. I thashë, ‘të lutem shumë dua vetëm mbrojtjen e votave të mia dhe s’dua asgjë tjetër.’ Dhe, për 10 minuta jam rikthyer tek qendra e numërimit dhe më kanë ardhur dy komisionerë nga PD, dhe më kanë treguar celularin me SMS të marrë nga Sokol Olldashi, “ruani votat e LSI, njëlloj si votat e PD-së”. Për fat, pas atij momenti, unë kam bindjen që në një pjesë të mirë të qendrave të votimit, të numërimit, pra, janë ruajtur votat tona. Pasi edhe mandati im mund të ishte i diskutueshëm.”

Mekanizmi funksionoi në mënyrë perfekte dhe në të gjithë vendin. LSI i mori katër vende. PD siguroi sundimin për katër vite të tjera. PS nuk do të jetë në qeveri. Megjithatë, askush nuk do t’i prekë monopolet e saj ekonomike. Pavarësisht sherrit të pritshëm, paria e Tiranës është e sigurtë në sundimin e saj. Kjo sjellje e palëve, edhe në ditën e zgjedhjeve, është shenja më e qartë se oligarkia shqiptare funksionoi thuajse në perfeksion.

Pavarësisht tam-tamit mediatik, këto zgjedhje ishin një dështim i madh për shqiptarët. Këto zgjedhje treguan se paria e Tiranës do të sundojë, ashtu si është nisur, me çdo kusht e

me çdo çmim. Nga ana e tyre, të huajt duan stabilitet e vetëm stabilitet. Vetë shqiptarët janë duke e humbur besimin tek sistemi demokratik. Prandaj ia vlen të vihet re se situata mbaszgjedhore nuk është aspak shpresëdhënëse. Përpyekja e parisë për të bërë që të harrohen këto zgjedhje e që vëmendja të përqëndrohet në problem të tjera, mbi të gjitha në sherrin e në kacafytjen e palëve, është tejet intensive. Por, një përpyekje e tillë është e destinuar që të dështojë. Efekti i dështimit të zgjedhjeve do të jetë shumë afatgjatë. Ai do të ndjehet si në marrëdhëniet e palëve të parisë me njëri-tjetrin, ashtu edhe në marrëdhëniet e shtetit shqiptar me BE-në, e mbi të gjitha, në besimin e tronditur të shqiptarëve tek sistemi demokratik.

Ia vlen të thuhet se, edhe pse urtë e butë, edhe Fuqitë e Mëdha, që ndikojnë shumë në Tiranë, janë shprehur sistematikisht për mangësitë e vërejtura. Siç vërejti me shumë delikatesë në intervistën e tij edhe ambasadori gjerman *Herr Bernd Borchardt*, i cili natyrisht që shprehu pozicionin e qeverisë së tij,

“... kemi qenë dëshmitarë të zhvillimeve, që janë për të ardhur keq. Ka pasur shumë deklarime për presionin e ushtruar ndaj nëpunësve të sektorit publik apo studentëve, gjatë fushatës elektorale. Vëzhguesit mund të provojnë disa prej tyre. Ka patur deklarime edhe për abuzimin me burime të administratës, disa prej të cilave janë konfirmuar. Shpresoj se kjo do të riparohet në të ardhmen, pasi është në kundërshtim me Dokumentin e Kopenhagenit (të OSBE-së) mbi zgjedhjet. Gjatë procesit të numërimit, vëzhguesit vlerësuan se numërimi ishte i keq, ose shumë i keq në 1/3 e qendrave të numërimit. Kjo ishte më keq se në 2007, kur më pak se 1/4 e qendrave të numërimit u kritikuan për këtë gjë.”

Ky deklaram është shumë i rëndë, aq më shumë kur mbahet parasysh se vjen nga *Herr Borchardt*, që është një diplomat me eksperiencë politike shumë të madhe të fituar në zona tejet delikate e në krizë. Kjo deklaratë bëhet edhe më e rëndë, sidomos kur vihet në dukje se është në interesin jetik të qeverisë që ai përfaqëson, që të mbajë raporte sa më të mira me qeverinë e Tiranës. E, megjithatë,

agjenda e qeverisë gjermane për katër vitet e ardhshme të qeverisë së “integritit evropian” është, po ashtu, shumë domethënëse. Siç theksoi ambasadori gjerman: “Qëllimi kryesor i Gjermanisë është të mbështesë Shqipërinë në rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian. Mendoj se do të vazhdojmë të përqëndrohemi në furnizimin me energji, ujë dhe kanalizimin e ujërave të zeza.” Nuk mund të mos vihet re se një deklaram i tillë vjen nga vendi kryesor i BE-së dhe se këto argumente do të përdoren pa hezitim kundër shtetit shqiptar, por edhe kundër lutjeve të qeveritarëve të tij për të hyrë në BE të paktën për tetë vitet e ardhshme.

MËRGIMTARËT DHE SHKËPUTJA E MADHE

Përreth një milion e gjysëm shqiptarë, dikund rreth 45 përqind e gjithë popullsisë së shtetit shqiptar, janë detyruar që të lënë shtetin shqiptar gjatë 20 viteve të shkuara, të ikin dhe të luftojnë për me ndërtuar jetën e re në vende të huaja. Sakrificat, traumat, e vuajtjet e tyre kanë qënë të papërshkrueshme. Por, mërgimtarët gjithnjë i kanë mbajtur sytë nga familja e nga vendi i tyre dhe, prej familjes e atdheut, ata kanë marrë jetë e fuqi me mbijetuar në kushte të tmerrshme. Shpresa e tyre ishte se do të kthehet një ditë në vendin e vet. Si me çdo valë tjetër emigracioni, ndër shqiptarë apo në grupe me përkatësi tjetër etnike, lidhja e tyre me vendin amë ka qënë simbiotike dhe jetike.

Lidhja e tyre me vendin amë ka qënë jetike e përcaktuese për të dyja palët e jo vetëm për mërgimtarët. Mërgimtarët e kanë mbajtur shtetin shqiptar gjallë ekonomikisht. Ata kanë mundësuar bumin ndërtimor, duke hedhur me qindra mijëra euro në apartamente, dyqane, banesa dhe objekte. Po ashtu, përmes taksave, doganave e financimeve direkte e indirekte, ata kanë financuar luksin e parisë, rrugët dhe rrogat e shtetit, tregun e pasurive të patundshme dhe kanë mbajtur gjallë artificialisht mirëqenien e popullsisë. Pa ndihmën financiare, pa investimet, pa mallrat që kanë sjellë mërgimtarët, si dhe pa kontributin masiv profesional të mërgimtarëve, shteti shqiptar do të ishte shtet i falimentuar dhe një shtet në nivelin afrikan. Pa paratë, kontributet, investimet, dhe pa ndihmat e mërgimtarëve, mirëqenia relative e shqiptarëve nuk do të ishte e imagjinueshme. Shqiptarët janë populli i vetëm në botë me papunësi zyrtare 14 përqind, por që, realisht, është shumë më e lartë dhe supozohet që është në nivelin

e 40%, që fle mesatarisht nëntë orë në natë, që punon pesë orë në ditë dhe që rri pesë orë në kafe. Po këta shqiptarë, familjarisht të papunë, shkojnë me pushime dy-tre herë në vit dhe kanë dy-tre shtëpi, pajisje të modës së fundit dhe makina të reja. Edhe në shtetin shqiptar bie shi si gjithkund tjetër e jo thasë me para nga qielli. Duhet shpjeguar edhe ky paradoks.

Nuk ka dyshim se kontributi i mërgimtarëve është faktori kryesor për këtë gjendje mrekullie të rreme ekonomike, pa baza të qëndrueshme, por të evidentueshme në shtetin shqiptar. E megjithatë, sot ka shumë shenja se kjo lidhje, dikur shumë e fuqishme, është duke u dobësuar ndjeshëm dhe se traumat shoqërore që po përjetohe në këtë proces janë tejet të dhimbshme. Problemi është se shoqëria në shtetin shqiptar dhe mërgimtarët kanë ecur në rrugë të ndryshme e të papajtuësme. Shteti shqiptar është një vend me probleme të jashtëzakonshme shoqërore e politike. Këto probleme paria mundohet t'i mbulojë me rrugë ku nuk kalon njeri e me restaurante luksoze e hotele, ku nuk fle njeri më shumë se dy orë, dhe me ekskluzivitetin e plazheve të veta, ku çka nuk ndodh. Mjeti më i fuqishëm është propaganda mbytëse televizive, e cila krijon imazhe të rreme në mendjet e njerëzve lidhur me shkallën e zhvillimit dhe një përshtypje qartësisht të shtrembëruar të realitetit.

Nga ana e tyre, mërgimtarët kanë ecur në drejtime krejt të kundërta me parinë dhe me shoqërinë në shtetin shqiptar. Ata që duan e që dinë që të jetojnë me nder, gjatë mërgimit janë mësuar të jetojnë në sisteme ku mund të jesh i diskriminuar, por ku ka shtet dhe ku, në një mënyrë a në një tjetër, ke disa të drejta e mundësi, që të lejojnë të jetosh pa u kriminalizuar e me nder. Në shtetin shqiptar kjo nuk është më e mundur. Mërgimtarët që i kanë fituar paratë me rrugë të pista, e gjejnë vendin e tyre natyrshëm në shtetin shqiptar. Në një shoqëri materialiste, ku i vetmi standard është paraja, që nuk i ndjehet as era e gjakut e as e kimit, integrimi është shumë më i lehtë. Për ata që kanë qenë gjithnjë në fundin e nënujshëm, apo në anë të shoqërive të qytetëruara, si mërgimtarë të paligjshëm, bota e huaj që ata kanë parë ka qenë e nënujshme apo e nëndheshme. Por, figurativisht,

bota ku kanë jetuar ata është bota e peshqeve dhe e krimbave, jo e njerëzve. Marrëdhënia shoqërore e vërtetë për vedasin, italianin, grekun, anglezin apo gjermanin, është krejt e ndryshme nga ajo që përjeton mërgimtari shqiptar, që jeton si mërgimtar i paligjshëm apo si pjesë e jetës së nënujshme të shoqërisë. Nuk ka dyshim se shumë nga mërgimtarët në këto tre nivele e analizojnë gjendjen në shtetin shqiptar duke u nisur nga premisa të tilla, që i kanë nxjerrë nga përvojat personale. Prandaj edhe gjendja katastrofike e kriminale në shtetin shqiptar është e pranueshme për shumë njerëz. Pranimi i gjendjes përforcohet prej përvojave që ata kanë pasur. Këtë gjendje kanë përjetuar në botën e huaj, këtë gjendje e gjejnë në shtetin shqiptar. Kjo është e reflektuar gjerësisht edhe në masën e madhe të qytetarëve që kanë qenë si mërgimtarë sezonalë dhe që kanë pasur eksperiencë të ngjashme traumatike, deformuese dhe ndrydhëse.

Mirëpo, shoqëria që ata kanë parë e përjetuar nuk është shoqëria normale. Anormaliteti, marginaliteti, shtypja dhe shfrytëzimi, mungesa e të drejtave dhe dhunimi, që kanë përjetuar, i bën që të ofrojnë një gjykim të gabuar për gjendjen në shtetin shqiptar. Kjo gjendje është nga burimet kryesore të forcës së parisë. Paria e ka përdorur me shumë aftësi këtë mendësi sunduese, që e sheh botën e huaj si një grumbull vesesh, xhungël krimi, ndyrësi e jashtëqitjeje shoqërore; të gjitha patologji që ndeshen në shoqëritë perëndimore. Natyrisht, përvojat e tyre nuk janë pasqyrë e gjithë shoqërisë perëndimore. Por ato përvoja përcaktojnë edhe mënyrën e sjelljes së tyre në shtetin amë, lidhjen që ata kanë me shtetin dhe parinë, si dhe pritshmërinë që ata kanë në lidhje me sjelljen e moralshme e njerëzore në shoqëri.

Megjithatë, me kohë, gjërat kanë ndryshuar. Shumë nga mërgimtarët janë integruar në nivele të kënaqshme. Shumë të tjerë gëzojnë standarde jetese dhe kanë ndryshuar mendim në lidhje me shoqëritë ku jetojnë. Marrja e qytetarisë, njohja dhe përdorimi si duhet i sistemeve shoqërore, shkollimi, fëmijët, aktivizimi në bashkësi lokale, shoqërore, fetare, e politike, integrimi në botën e ndërmarrësve, e me radhë, kanë ndikuar në ndryshimin e orientimit të mërgimtarëve. Tashmë mendësia e tyre ka ndryshuar,

siguria është rritur dhe ata e shohin veten dhe të ardhmen e tyre në vendet ku jetojnë.

Shkurt, shumë nga mërgimtarët nuk i shohin me shpresë zhvillimet në shtetin shqiptar, nuk e gjejnë veten atje, dhe i kanë drejtuar sytë, mendjen e kuletën tjerakah duke u përqëndruar në vendet ku jetojnë. Nevoja e ndërtimit të jetës në një vend të huaj, humbja e të afërmeve dhe e prindërve, shpenzimet e larta të jetesës në shtetin shqiptar, ndryshimi i mendësisë së shoqërisë shqiptare, lidhja me fëmijët, integrimi i suksesshëm, por edhe stabiliteti për të ardhmen që iu ofrohet nga sistemi i mbrojtjes shoqërore, kanë qenë disa nga shkaqet kryesore që kanë ndikuar natyrshëm në këtë ftohje. Në dukje, asgjë e jashtëzakonshme nuk ka ndodhur. Ky është një fenomen i njohur dhe i pritshëm në lidhje me emigracionin.

Por, në të gjitha rastet e tjera, si tek izraelitët, grekët, italianët, e të tjerët, shteti amë ka synuar që të riintegrojë mërgimtarët e vet. Në diasporën respektive janë ngritur struktura që ndihmojnë mërgimtarët dhe në vendin amë janë krijuar mundësi për investime, punë, zhvillim e riintegrim për ata që kthehen. Mirëpo në rastin shqiptar, jo vetëm që mungojnë këto struktura, por edhe përvojat e mërgimtarëve me qeveritarët janë tejet negative. Mërgimtarët tanë kanë filluar të mos i mbajnë më sytë nga vendi amë. Tashmë, nevoja e integritit të pashmangshëm në shoqëri të tjera dhe pamundësia e kthimit mbrapa, ka krijuar dilema shumë serioze. Mërgimtarët duan që të integrohen në shtetin shqiptar por nuk shohin asnjë vlerë në procesin e riintegritit atje. Riintegrimi duhet bërë në termat e parisë dhe për shumë mërgimtarë ky kusht është i papranueshëm.

Shkaku? Pa mëdyshje, shkaku kryesor i ftohjes së tyre me vendin amë mbetet dështimi i parisë për të ndërtuar shtetin, shoqërinë dhe ekonominë e duhur, në të cilën mërgimtarët mund të gjejnë vetveten. Paria ka dështuar në ndërtimin e strukturës shoqërore, e cila do të kishte mundësi e burime të mbronte, garantonte interesat ekonomike të popullit të vet dhe, në këtë kontekst, të mërgimtarëve. Mërgimtarët kanë filluar që të mos e gjejnë më veten në shtetin shqiptar. Edhe pse shteti shqiptar ka

filluar të mbushet me mërgimtarë, që vijnë nga bota e tretë apo nga Kina, dhe që kanë marrë shtetësi shqiptare, vetë shqiptarët nuk kanë ku të kthehen. Ky është një fenomen i dhimbshëm, kriminal dhe me pasoja shumë të rënda për të ardhmen e të gjithë shqiptarëve. Shqiptarët janë i vetmi komb në botë që ka hedhur jashtë shtetit 45 përqind të popullsisë së vet dhe që i sheh si një masë “që i ka hangër furra”.

Në një nivel, shkëputja është njerëzore dhe shumë e dhimbshme. Lidhjet familjare janë dobësuar. Sherret ndërfamiljare, si dhe ngatërresat për pronat e për shkaqe të tjera janë acaruar. Nga ana e vet, shoqëria shqiptare është kthyer në një shoqëri utilitariste, që gjithçka e ven ‘në majë të lekut.’ Si tha një mërgimtar, “mërgimtarët kthehen e harxhojnë pare për me gjetë dashuri prej të afërmeve. Të afërmit e atjeshëm na japin dashuri në bazë të kontributit financiar. Ankesat, manipulimi i ndjenjave të mërgimtarit e pafytyrësia e lypjes së parave, ishin profesioni kombëtar. Mërgimtari kthehet të gjejë nder e dinjitet, por sheh të afërmit që duan t’ia numërojnë eurot në xhep. Nuk shkoj më”. Ky qëndrim do parë më në përgjithësi edhe si manifestim i fenomenit më të gjërë të problematikave të ndryshme, me të cilat përballen mërgimtarët në tokë të huaj dhe familjet e tyre në shtetin shqiptar.

Mendësia e mërgimtarëve është e ndryshme prej asaj të shqiptarëve që jetojnë në shtetin shqiptar. Po ashtu, strategjitë kulturore që ndiqen për zgjidhjen e problemeve janë të ndryshme. Vlerat morale janë në standarde të ndryshme, prioritetet që kanë janë të ndryshme dhe pozicionimi i secilës palë është i ndryshëm. E përbashkëta është që të ndrymë në peshën e halleve të veta, të afërmit dhe mërgimtarët janë dy grupe që nuk lidhen më me njëri-tjetrin. Nuk duhej të ishte kështu. Shteti shqiptar duhej të ishte Florida e Ballkanit, vendi ku mërgimtarët duhet të vijnë të kalojnë vitet e pleqërisë dhe në moshën e tretë ata mund të sillnin fuqinë blerëse, nevojën për shërbime e direkt punë e zgjidhje për shoqërinë, por edhe indirekt, mbështetje financiare e morale për shtetin efektiv. Çdo gjë në shtetin shqiptar është e kundërt me arritjen e këtij ekuilibri shoqëror. Mundësia e pasurimit të shpejtë të parisë e ka shmangur konsiderimin e zgjidhjeve të tilla

afatgjata.

Në nivel të zhvillimit të shtetit e të ekonomisë kombëtare, kontributi i mërgimtarëve në këtë tranzicion është i pamohueshëm. Pa mërgimtarët, në shtetin shqiptar nuk do të kishte asgjë. Prandaj paria i pret ata si qyqja verën, i numëron si delet në Rinas, në Durrës e në Kapshticë, sepse e di shumë mirë që pa paratë e mërgimtarëve nuk punon makina e shtetit. Paria gjithnjë është mburrur se nuk ka nevojë për fabrika atje, “se fabrikat i kemi në Perëndim” dhe se shteti shqiptar është “vend qejfi e turizmi”. Kjo është një mënyrë tjetër, shumë e përdredhur, për t’a njohur kontributin thelbësor të mërgimtarëve në mbijetesën shqiptare dhe në jetën e qejfit e në luksin përrallor të parisë.

Pa asnjë diskutim, dështimi për ta ndërtuar ekonominë e duhur, si dhe një shoqëri me vlera njerëzore e normale, është përgjegjësi e parisë. Nga një këndvështrim tjetër, ky dështim është shpërdorim i paskrupullt i mundit dhe i parave të mërgimtarëve. Edhe kështu, kontributi i mërgimtarëve ka qenë jetik për shoqërinë e për ekonominë shqiptare, e cila ka ardhur deri këtu, falë kursimeve, sakrificave, investimeve dhe interesimit të tyre. Shteti mbahet me të ardhurat e mërgimtarëve, por edhe familjet shqiptare mbahen gjallë nga të ardhurat e tyre. Për çdo njësi valute që hyn zyrtarisht, të paktën pesë të tjera hyjnë jozyrtarisht. Të gjitha këto të ardhura shkojnë në ekonominë shqiptare.

Kalkulimi që kemi bërë me disa të tjerë është se, gjatë tranzicionit, në shtetin shqiptar kanë hyrë diku rreth 120 miliardë dollarë. Arsyeja për hyrjen kaq të madhe të valutës së huaj është se shumë nga mërgimtarët shqiptarë janë bërë mjaft të fuqishëm ekonomikisht, të tjerët kursejnë jashtëzakonisht shumë dhe se përbërja e mërgimtarëve është përgjithësisht në moshën e punës, me rreth 800,000 vetë në moshë pune. Ata që bëjnë punë të pista e kanë paranë edhe më të lehtë. Duke mos e njohur mirë sistemin perëndimor, duke mos pasur mbrojtje shtetërore, edhe pse shumë janë pa dokumente e punojnë në të zezën, por shumë edhe të shtyrë nga dashuria për vendin e për familjen e vet, ata kanë derdhur shumë në shtetin shqiptar. Me mijëra shqiptarë kanë bizneset e tyre në çdo vend dhe, si askund tjetër, në SHBA. Mjafton të thuhet

se vetëm në Itali llogaritet që ka rreth 22 mijë biznese të vogla e të mesme që janë pronë e shqiptarëve. E njëjta gjendje është edhe në Greqi, në Gjermani e gjetkë, ku shqiptarët kanë treguar se janë të zotë t'ia dalin mbanë.

Kështu në lidhje me kontributin e përgjithshëm financiar të mërgimtarëve, mjafton të thuhet se, me shumë para të pastra (të fituara me mund e me punë) e pak të papastra (drogë, prostitucion, trafikë, kriminalitet, kontrabandë), gjatë këtyre 20 viteve, mërgimtarët kanë sjellë në shtetin shqiptar një kontribut marramendës që llogaritet dikund rrotull 120 miliardë dollarëve. Nëse kjo shumë duket shumë e madhe, vlen të kujtoj se vetëm vitin e kaluar shtetasit shqiptarë kanë harxhuar mbi 1,5 miliardë dollarë ... për bileta avioni. Po ashtu, të dhënat e ndryshme vlerësojnë se të paktën 68% e familjeve shqiptare mbijetojnë e jetojnë me ndihmat që u vijnë nga emigracioni. Shenja më e qartë e varësisë së ekonomisë nga emigracioni shihet tek natyra ciklike e ekonomisë në shtetin shqiptar, e cila gjallërohet nga maji deri në tetor. Mandej, ekonomia bie në gjunjë në periudhën shkurt-prill. Dy degët më kryesore të ekonomisë së atjeshme, ndërtimi dhe shërbimet, janë mbajtur gjallë kryesisht në sajë të mërgimtarëve dhe do të shemben kur ata të heqin dorë nga investimi atje.

Paradoksi shqiptar, pra, është ky: nga një anë mërgimtarët kanë dhënë gjithçka kanë pasur për atë vend dhe kanë investuar gjithçka që kanë kursyer me shpresën e kthimit një ditë në vendin e tyre. Paria e Tiranës, nga ana e saj, i ka shpërdoruar ndihmat e tyre në mënyrë të përbindshme duke pasuruar veten e vetëm veten, duke i lënë shqiptarët e tjerë në mëshirën e fatit e të aftësisë së tyre për të mbijetuar. Shumë prej mërgimtarëve nuk kanë ditur rrugë tjetër investimi e kursimi, sepse në vendet e huaja ata kanë bërë punë të rëndomta. Paratë ata i kanë fituar me gjak e me njëmijë sakrifica. Megjithatë, ata nuk i kanë njohur si duhet mekanizmat financiare të shoqërive ku jetojnë e kështu që janë të paaftë të investojnë atje. Pra, edhe pse ndoshta mërgimtarët tanë janë shumë të edukuar e me aftësi profesionale, vendi që kanë pasur në shoqërinë ku kanë jetuar, nuk i ka lejuar që të konsiderojnë edhe zgjedhje e mënyra të tjera investimesh.

Nga një anë tjetër, mërgimtarët, brezi i parë i të cilëve kurrë nuk mund të integrohet plotësisht në një vend e në një kulturë të huaj, është i lidhur emocionalisht me vendin e vet dhe, prandaj i ka mbajtur sytë e shpresën tek vendi amë. Të gjithë i kanë marrë rrugët e botës, me shpresën se do të kthehen një ditë në vendin e tyre. Dhe, po me këtë shpresë, i kanë bërë edhe investimet e tyre në shtetin shqiptar. Kanë blerë shtëpi, apartamente dhe toka. Ata kanë synuar të kthehen e të përdorin mjeshtritë që kanë pasur në vendin amë e dijen që kanë fituar në mërgim, gjithnjë me shpresë se shteti shqiptar do të bëhet një shtet me ekonomi moderne, si dhe një shtet me një sistem ku mund të jetohej normalisht. Sot, mërgimtarët janë duke u zhgënjyer gjithnjë e më shumë. Sistemi shoqëror që ata gjejnë në shtetin shqiptar nuk ka fare dallim prej sistemeve të nënujshme ku ata kanë jetuar në tokën e huaj.

Padija, pamundësia e integritit në vendet ku janë vendosur, dashuria për vendin, kujdesi për të afërmit, shpresa e kthimit, e me rradhë, i mbajnë mërgimtarët me mendjen e fiksuar tek shteti shqiptar. E vetmja mënyrë për të siguruar jetën e 'pleqërinë' e tyre, ka qenë që me i hedhë paratë e kursimet në shtetin shqiptar. Banka e mërgimtarit shqiptar, siguria e pensionit dhe e pleqërisë së tij janë dy-tre apartamente, një a dy dyqane e toka në Durrës, në Tiranë e tjerakah. Shteti shqiptar nuk i ka prekur pronat e mërgimtarëve me taksa e me mënyra të tjera, thjesht sepse zhvillimi ekonomik dhe sektori i ndërtimit janë të mbështetura tërësisht në këtë piramidë gjigande që është prurja e kontributeve, ndihmave dhe investimeve nga mërgimtarët. Por së shpejti, me shterrjen e të ardhurave, shteti do të fillojë të taksojë edhe pronat e mërgimtarëve.

Për këtë arsye, të investimit të paparë të mërgimtarëve, shteti shqiptar është i vetmi vend në botë ku toka e bukës, edhe në majë të malit, shitet më shtrenjtë se parcela qytetase në një vend tjetër. Toka kushton edhe më shtrenjtë se sa në SHBA, ku rrogat formale janë shumë herë më të larta se në shtetin shqiptar. Vilat boshe të mërgimtarëve shqiptarë, që në vendet ku jetojnë, i kanë shtëpitë në bodrume e në biruca, janë të denja për milionerët e fuqishëm të botës. Edhe ata mërgimtarë, që janë integruar shkëlqyeshëm në

shoqëritë ku jetojnë, i kanë kontribuar masivisht këtij spekulimi të frikshëm, kësaj piramide ekonomike, të mbajtur gjallë nga nevoja e mërgimtarëve për të gjetur veten e të ardhmen në vendin e tyre. Me ngadalë, por pashmangshmërisht, shumë prej tyre kanë filluar të arrijnë në përfundimin se shteti shqiptar nuk iu ofron asgjë. Përshtypja e keqe, dhe niveli i zhgënjimit që ata kanë për vendin e tyre, është i frikshëm. Së shpejti shteti do të kthehet kundër mërgimtarëve dhe do të fillojë që të kërkojë që të taksojë, e t'i mbajë peng si ata, ashtu edhe investimet e tyre.

Problemi vështirësohet edhe më shumë sepse nuk ka shpresë të qartë për përmirësim. Shteti është i korruptuar fund e krye. Sistemi mjekësor është tejet i korruptuar me mjekë e infermiere, pastrues e roje dere, që e shtrijnë dorën pa pikë turpi për një bakshish. Përndryshe, si mjekët, ashtu edhe të tjerët, të lënë të ngordhësh si qen në dhomat e frikshme të spitaleve. Paria e Tiranës nuk ka kurrëgjë të tregojë për ato para që kanë hyrë atje. Shtete të tjera kanë bërë mrekullira, e kanë ndërtuar ekonomi të fuqishme edhe me shumë më pak para se sa kanë hyrë në shtetin shqiptar. Në Shqipëri nuk ka as fabrika, as uzina, as vende pune për t'i integruar dhe shpërblyer mërgimtarët ashtu siç duhet. Si shembull përdoret Durrësi dhe lulëzimi i ndërtimit në zonën e plazhit. Por, nëse dikujt i merret mendja dhe kuturis të krahasojë Durrësin me Riminin, më mirë të kujtohet për gjirizet e ujrat e zeza, që përzihen me ujrat e pijshme dhe për llumin e Durrësit që lundron mbi ujrat e Adriatikut, ku nuk mund të zihet peshk të paktën dy kilometra larg bregut.

Megjithatë, ndryshimi më i madh po vihet re në marrëdhënien midis pjestarëve të familjeve. Shumë nga mërgimtarët janë tejet të fyer nga sjellja e pafytyrë e shoqërisë. Një shprehje e kësaj gjendje, është edhe mendësia sunduese që i sheh mërgimtarët thjesht si njerëz që paguajnë e si të përkohshëm edhe në vendin e tyre. Po ashtu, shumë mërgimtarë po kthehen, të neveritur nga niveli i zvetënimit moral të asaj shoqërie që gjejnë në shtetin shqiptar, nga arroganca e parisë, nga nevoja e njerëzve për të dëgjuar se ata që jetojnë në shtetin shqiptar janë modernë e se e gjithë bota është si do vende tek ish-Blloku i Tiranës. Megjithatë, në sytë e

shumë mërgimtarëve, ajo që po ndodh në shtetin shqiptar nuk është shprehje e lulëzimit të shoqërisë, por thjesht një degjenerim i frikshëm, zvetënim i qëllimtë dhe me pasoja afatgjata.

Në mbyllje e shkurtimisht, pa i qëmtuar si duhet, e deri në fund, pasojat e rënda, duhet thënë se pasojat e shkëputjes së mërgimtarëve nga vendi i tyre po ndjehen përditë e më tepër. Ato do të ndjehen edhe më shumë në të ardhmen. Mërgimtarët, ata që duhej të ishin ura lidhëse e shqiptarëve me bashkëkohoren, me të mirën e me të duhurën, janë duke u larguar nga vendi amë. Ata do të vazhdojnë të jenë shqiptarë, se për një brez e dy nuk mund të bëhesh diçka tjetër, sidomos në tokë të huaj, ku mbetesh i huaj gjithsesi. Por, humbja e tyre për shqiptarët si komb do të jetë më shumë se humbja e dy brezave. Ajo është humbja e një shansi historik, që sado i rëndë, është një ndër shumë të tjerë, që do t'i faturohet parisë së Tiranës.

MORALI DHE POLITIKA: RASTI SHQIPTAR

Në një shkrim të ditës trajtohet lidhjen e moralit me politikën në filozofi. Lidhja midis moralit e politikës është një temë shumë e rëndësishme dhe që duhet analizuar me shumë vëmendje. Një mënyrë tjetër për të analizuar e thjeshtuar këtë lidhje midis moralit e politikës do të ishte kjo. Morali është një mënyrë të sjelluri e kodifikuar në një sistem rregullash e normash shoqërore, që pranohet nga një grup i caktuar e nga nga individët që janë pjestarë të tij si rruga e vetme e ndërtimit të marrëdhënieve të duhura (të ndershme, të pastra, pa hile e anësi), midis pjesëtarëve të grupit si dhe midis këtij grupi e të tjerëve (kur interesat e grupit do të mbrohen e duhet të mbrohen me çdo mjet përmes shtetit). Pika e nisjes, për çdo analizë, është se cili është burimi i këtij sistemi të kodifikuar sjelljesh. A është individi, që, e racionalizon gjendjen e vet, dhe që e konsideron të moralshme atë që i shërben interesave të tij të ngushta dhe individuale? A është grupi, pavarësisht nga parimi bazë i formësimit, që mund të jetë feja, lidhja e gjakut, apo kultura? Apo morali është një vlerë universale që është e pranishme, në të gjitha shoqëritë njerëzore, sepse është diçka thelbësore, e pashkëputshme dhe e pa tëhuejzueshme nga natyra njerëzore?

Shoqëritë njerëzore nuk mund të ekzistojnë në mungesë të një sistemi moral vlerash, me të cilin pajtohen paria dhe pjesa më e madhe e shoqërisë. Skllavërimi, shitja e njeriut, shfrytëzimi dhe liria bëhen të mundshme, vetëm kur shoqëria i pranon këto sjellje si të moralshme. *Ipsa facto*, çdo sjellje e cila iu bjen ndesh normave të pranuar, është e dënueshme, sepse nuk është e moralshme. Mirëpo, duhet mbajtur ndërmend se morali është justifikimi i

interesave. Në qendër të vlerave morale të çdo shoqërie, qëndron gjithnjë ose interesi i bashkësisë, kombi ose shteti, ose interesat e individit, kur shteti është në gjendje që të ruajë interesat e veta nga shoqëria dhe individët vepron në një nivel tjetër sistemik.

Kur një shoqërie i mungon ky sistem autoritativ vlerash e modelesh sjelljeje, atëherë paria mundohet të përdorë sistemin e ligjeve dhe politikën, për të zgjidhur problemet midis pjestarëve të grupit si shtetas. Në këtë pikë, politika dhe politikanët bëhen tejet të rëndësishëm, sepse nuk ka asnjë bashkësi që identifikohet me shtetin në të njëjtin nivel. Por, kontrolli i shtetit i bën politikanët faktorin kryesor që garantojnë rregullin, sigurinë, begatinë, mbarësinë e qetësinë në shoqëri. Politikanët ose e zgjidhin konfliktin në shoqëri, duke u sjellë simbas kodit të pranuar nga shoqëria dhe punojnë, që t'i ruajnë e konsolidojnë ato vlera, ose mundohen ta ndryshojnë atë sjellje, duke përdorur shtetin për të transformuar shoqërinë simbas vizionit e moralit të tyre. Rasti i shtetit shqiptar në tranzicion është një ilustrim i shkëlqyer i lidhjes së munguar midis moralit të duhur e politikës së duhur.

Sistemi enverist u përpoq shumë fort që të ndryshonte shoqërinë shqiptare e sistemet morale të saj. Kjo çoi në krijimin e një njeriu të përcudnuar, në një shoqëri të terrorizuar e pa besimin e duhur në institucionet e shtetit. Gjithashtu kjo çoi edhe në instrumentalizimin e paskrupullt të shtetit në shërbim të interesave të parisë.

Me kohë, u krijuan tre sisteme morale, që ishin tërësisht të papajtueshme me njëri-tjetrin. Një grup i vogël, që identifikohet me interesat e shtetit e të kombit, e gjente burimin e sjelljes së vet, moralin, në një gjendje ideale, në shpresën se krijimi i shtetit-komb do të mundësonte përmirësimin e gjendjes dhe se kjo do të ishte rruga më e mirë e mundshme. Shtresat e gjera, katundarët dhe shtresa e proletarizuar qytetase, zhvilluan një sistem moral vlerash, që iu kundërvijë shtetit dhe interesave të bashkësisë. Sistemi moral, që filloi të karakterizonte këto shtresa të gjera, gradualisht dhe me tolerimin e shtetit, pranoi si të moralshme sjellje që deri pak kohë më parë edhe në nivelin shoqëror kishin qenë kriminale, si hajnia e mallit, vjedhja e pronës, trami i favoreve

e me radhë. Sistemi që u zhvillua mori karakteristika të theksuara klienteliste. Paria përdorte shtetin për t'iu bërë favore klientëve të saj në shtresat katundare dhe proletariatin urban, që, nga ana e tyre, ofronin të mirat materiale që paria dhe intelektualët nuk mund t'i gjenin në një mënyrë të ligjshme. Puna e mirë për nusen në shtet shkëmbehej me një gjel deti çdo vit, një thes me arra, apo me një antenë alumini të vjedhur në ndërmarrjen e shtetit. Kjo sjellje u bë e moralshme. Me shndërrimin e kësaj sjellje në të moralshme, shteti u bë edhe armiku kryesor i të gjithëve.

Duke qenë në kontroll të një shteti, që filloi të konsiderohej si armiqësor nga shtresat e popullit, por që për shkak të moralit sundues e shtërngonte keqazi edhe atë vetë, paria u shkëput dhe me kohë krijoi një sistem vlerash morale, që i dallonte nga shqiptarët. Duke mos e identifikuar më veten me interesin e shtetit, duke e konsideruar interesin e bashkësisë së vet si parësor, duke mos u identifikuar më me popullin, paria dhe rrethi i intelektualëve vendosi në qendër të sistemit të vet të vlerave morale, interesin e ngushtë e personal. Paradoksalisht, kjo po ndodhte nën kornizën e hegjemonisë së një ideologjie, si enverizmi, që synonte krijimin e një shoqërie komuniste përmes zhveshjes së individëve nga prona dhe nga morali tradicional shoqëror, fetar, etnik apo kulturor, që mban bashkë të gjithë shoqëritë e tjera. Po ashtu, kjo po ndodhte paralel nevojës së parisë për të ruajtur shtetin terrorist dhe strukturat që mbronin lejgitimitetin e vet në nivelin ideologjik.

Kjo situatë, në të cilën përplaseshin morali që buronte nga ideologjia sunduese dhe morali që justifikonte sjelljen e përditshme, u përkeqësua me shpejtësi marramendëse gjatë viteve 1980-të. Nga ana e vet, morali sundues i parisë u konsolidua dhe u internalizua edhe nga shumica e inteligjencias që nuk kishte më asnjë lloj besimi në ideologjinë kolektivistike komuniste. Përmes trajektoreve të përbashkëta të edukimit, përvojave, presioneve, imitimit, dhe të funksionimit në një sistem të caktuar, shtresa që duhej të bënte ndryshimin u mbrujt dhe u kompaktësua, si në mendësi, ashtu edhe në vlerat morale. Këtë synonte sistemi i mëparshëm. Mirëpo objektivi nuk ishte për të krijuar shtetarë e nacionalistë. Objektivi ishte për të krijuar njerëz të vegjël dhe

shërbëtorë të bindur të sistemit. Prandaj, ky proces mbrujtësimi zvetënoi tërësisht e rrënjësisht grupin e individëve që duhej të merreshin me politikë e që u morën me politikë, si gjatë asaj kohe, ashtu edhe më pas. Në thelb të moralit të tyre ishte zhveshja nga ndjesia e shërbimit publik, vendosja e interesave private mbi ato të bashkësisë e të shtetit, ruajtja dhe kultivimi i rrethit shoqëror, dhe dallueshmëria nga shtresat e origjinës, që përgjithësisht ishin proletariati qytetas apo katundarë. Nëse në thelb të sjelljes morale është mosshkaktimi i dëmit apo të keqes ndaj pjestarit të grupit të cilit i përket individi, në rastin e intelektualëve dhe të parisë sunduese, proletariati qytetas dhe katundarët nuk shiheshin më si pjesë e grupit, por si të tjerë, d.m.th. si të huaj. Paradoksalisht, si intelektualët ashtu edhe katundarët pajtoheshin në kundërvënien e tyre ndaj shtetit. Po ashtu, të gjithë kishin zhvilluar mendësinë klienteliste, që ua siguronte jetesën në ato kushte.

Morali i kësaj shtrese, por edhe ai i parisë dhe i shtresave katundare dhe të proletariatit qytetas, kushtëzoi sjelljen e secilës shtresë edhe mbas vitit 1990. Si shihet kjo? Deri në vitin 1990, të gjithë mund të thonin se “*sistemi mbahej përmes frikës e terrorit*” dhe se “*ne nuk kishim zgjidhje të tjera*” ose se “*besonim në atë sistem, prandaj bëmë këtë e atë gjë*”.

Por, nga viti 1990 e më pas, të gjithë kanë patur mundësinë që të bëjnë zgjidhje në bazë të sistemit moral të vlerave individuale e të grupit përkatës. Dhe, në këtë kontekst, mund të thuhet pa frikë se paria dhe shoqëria shqiptare nuk u shkëputën nga e keqja e deriatëhershme. Ishte e pritshme që proletariati qytetas dhe katundarët do të vazhdonin të silleshin me të njëjtën mendësi. Por, fillimisht pritej që paria dhe inteligjencia do të punonin për shtetin. Arsyeja ishte sepse, *formalisht*, si paria ashtu edhe inteligjencia, silleshin simbas kodit moral zyrtar. Nuk ishte e lehtë të dalloje thellësinë e zvetënimit moral të tyre. Por, paria dhe inteligjencia u zhveshën me shumë lehtësi nga zhgualli i moralit zyrtar. Duke e gjetur justifikimin në ndërtimin e ‘shoqërisë së re kapitaliste’ dhe duke pasur mbështetjen e gjerë të proletariatit qytetas e të katundarëve, paria dhe inteligjencia zyrtarizuan atë që deri dje ishte konsideruara sjellje jo e moralshme dhe kriminale.

Nga një anë, ata vazhduan ta manifestojnë atë moral imoral të rrënjosur thellë gjatë kohës së sistemit totalitar në sjelljen e tyre të përditshme, duke e çuar shoqërinë e shtetin deri në këtë pikë. Por, tashmë, kjo sjellje nuk ishte më sjellje kriminale dhe e dënueshme, por e moralshme dhe e respektueshme. Arrivizmi, pragmatizmi, hajnia, mashtrimi, poshtërsia dhe të gjithë veset e dënueshme të një kohe, u bënë virtyti publik i një kohe tjetër. Kriza e vërtetë e thellë morale dhe, në dukje, e pashërueshme, e shoqërisë shqiptare në tranzicion fillon pikërisht këtu. Paria e pati shumë të lehtë që të shiste këtë moral të nënujshëm të shoqërisë enveriste, si moralin e duhur dhe të përshtatshëm për ndërtimin e një shoqërie ndryshe.

Problemi është shumë i rënduar. Nga një anë, është refuzimi i parisë dhe i shoqërisë, tashmë haptazi të kriminalizuar, për të kuptuar e pranuar se shoqëria nuk funksionon fare, nëse konflikti është i rrënjosur thellë në mendësinë e njerëzve. Arsyeja është se pjestarë të shoqërisë e shohin njëri-tjetrin si armiq të papajtueshëm dhe konflikti është i përhershëm dhe i pashmangshëm. Në një shoqëri normale, individët mund të mos pajtohen me njëri-tjetrin, por shoqëria duhet të ketë një sistem vlerash morale, që mundëson pajtimin, ose që ofron zgjidhje të përkohëshme, siç është, bie fjala, sistemi demokratik. Përplasja e vazhdueshme, dhe ndarja në *mik-armik*, në nivelin e vlerave morale mbarëshoqërore, e bën një shoqëri të pamundshme. Edhe pse paria mund ta ruajë kohezionin e saj, përplasja është vetëm përkohësisht e shmangshme. Kjo është sindroma më e qartë e mungesës së moralit mbarëshoqëror, e shpërthimit dhe e vazhdimit të luftës brenda grupit. Kjo është edhe gjendja faktike në shtetin shqiptar. Këtu bien në sy shprehje, si “popull i majtë” e “popull i djathtë”. Këto shprehje e të tjera si këto reflektojnë këtë përpjekje sistematike të parisë për të ndarë shoqërinë në struktura mobilizuese dhe klienteliste. Këto shprehje nuk kanë asnjë bazë në mendësinë ideologjike e në vlerat e shoqërisë. Por ato kullohen nga përvojat e shkuara historike të grupeve të ndryshme. Këto përpjekje e ilustrojnë mirë mendësinë konfliktuale, të yshtur e të cytur me shumë kujdes nga paria e Tiranës. I vetmi grup që ka kohezion dhe që e di mirë e qartë se çka i

shërben si grup, është para. Paria ka një moral tjetër nga shoqëria, nga “këta pisa”, siç thirret populli në rrethet e parisë në Tiranë. Por ndarja dhe thërmimi i shoqërisë, deri në atomizimin e mundshëm, po ndodh thjesht sepse kjo i shërben parisë dhe interesave të saj. Klientelizimi është teknika përmes së cilës paria e mban bashkë e të lidhur rrjetën e mbështetësve të vet për interesa.

Ky proces duhet konsideruar edhe nga një anë tjetër. Nuk ka dyshim se i vetmi grup shoqëror që kishte dijen e mundësinë për të bërë diçka të mirë të orientimit të popullit në rrugën e duhur ishte paria. Mirëpo, ndryshe nga të gjitha partitë e vendeve të ish-kampit socialist, paria e Tiranës bëri zgjidhjen më të keqe të mundshme ideologjike e morale. Paria e konsideroi ndarjen në *mik-armik* si të natyrshme. E transformoi luftën e dikurshme të klasave, që ishte një luftë brenda llojit, sepse të gjithë ishin shqiptarë, në luftë të hapur klasore. Në përpjekjen e synimin për të ndërtuar kapitalizmin, një mendësi që pajtohej plotësisht me sjelljen e saj kriminale gjatë viteve 1980-të, paria i ndau shqiptarët në klasa, që do të ishin armike për vdekje të njëra-tjetrës. Të lidhur përmes strukturave oligarkike e kleptokratike, paria e kultivoi mendësinë që e ndan nga populli. Populli u trajtua si një grumbull “pisash”, që duheshin shfrytëzuar e përdorur pa pikë mëshire.

Vizioni i saj ishte që paria e ngushtë dhe disa të tjerë afër parisë, do të bëheshin borgjezia. Të gjithë shqiptarët e të tjerët që jetojnë në shtetin shqiptar, do të ishin proletarët e skllëvërit e tyre. Kjo ishte edhe themeli i një luftë tjetër brenda llojit. Gradualisht, në një brez a dy, taksativisht, të gjithë shqiptarët, këta “pisa”, do të bëheshin proletarë që shesin krahun e punës, ose në rastin më të mirë, *petit bourgeoisie*, mikroborgjezë, një shtresë që vegjeton në anët e shoqërisë moderne, si katundarë majë malit, dyqanxhinj të vegjël, apo si zanatçinj.

Prandaj edhe lufta e parisë së Tiranës është e drejtuar kundër çdo sistemi moral që e mban shoqërinë bashkë. Në këtë rrugë të ndërtimit të kapitalizmit engelsian, armiqtë e saj më të mëdhenj ishin sistemet morale, që burojnë nga mendësitë e bashkësive të mundshme si ideja e kombësisë, që është e lidhur pazgjidhshmërisht me shtetin dhe demokracia e vërtetë, si

metodë e zgjedhjes së udhëheqësive. Arsyeja është e kthjellët: morali që buron nga këto dy ideologji nuk ishte e nuk është asfare i pajtueshëm me kapitalizmin ekstrem klasor, monopolist e oligarkik, që ëndërronte, të cilin e dëshiron dhe për të cilin po punon edhe sot e kësaj dite që ta konsolidojë paria e Tiranës.

Këto dy sisteme morale, që janë të pajtueshme me njeri-tjetrin, nuk janë të pajtueshme me një shoqëri shfrytëzuese klasore ekstremiste si kjo që u synua dhe synohet që të ndërtohet. Natyrisht, këto dy sisteme janë të ndryshme në rrugën e zgjidhjes së konflikteve në një shoqëri. Por, zgjidhjet morale që ofrojnë secili sistem, iu bien ndesh interesave të parisë. Edhe më shumë se kaq, këto dy sisteme krijojnë shtërngesa, si mbi kapitalizmin ekstrem, ashtu edhe në sjelljen e parisë, veçanërisht në lidhjen e saj me shtetin e me shoqërinë. Arsyeja është se, të dy këto sisteme kërkojnë që paria e pasuria e saj të jenë edhe në shërbim të shoqërisë. Prandaj, paria oligarkike i lufton për vdekje. Interesat e shoqërisë nuk janë interesat e saj si shtresë. Sistemi që i shërben parisë është një sistem, ku ata që kontrollojnë monopolet duhet të kontrollojnë edhe pushtetin politik e të vendosin normat morale të një shoqërie të kontrollueshme prej tyre. Një shoqëri, që bart vlerat morale të parisë, do të jetë detyrimisht një shoqëri në shërbim të saj dhe nën kontrollin e saj.

Mirëpo këtu ka disa probleme të pazgjidhshme, anipse periodikisht të kontrollueshme prej parisë. Nga një anë, lufta për kontrollin e institucioneve të shtetit është e pashmangshme edhe midis vetë palëve të parisë së Tiranës. Në një shtet, ku nuk ka ekonomi të mirëfilltë, pasurimi fillon e mbaron me vjedhjen e arkës së shtetit. Se si vidhet arka e shtetit është temë tjetër, por ky është edhe burimi i konfliktit, që nuk mund të mbyllet nga asnjë forcë apo grup midis palëve të parisë së Tiranës. Të dy palët duan pushtetin dhe me çdo kusht. Kështu, edhe konflikti midis palëve të parisë që bien dakord për objektivin “moral” (kupto: imoral) të tyre që është “të pasurohemi vetë se këto të tjerët që s’bëjnë si ne, skllëvër kanë qenë e të tillë do të vdesin”, është bërë endemik.

Paria duhet të organizohet politikisht; ajo duhet që të bindë pasuesit e tyre që kjo sjellje është e moralshme. Cila ishte forma e

grupit që zgjodhën ata? Duke mos e parë veten si shqiptarë ose si pjestarë të shoqërisë kombëtare shqiptare, ata iu kthyen bajrakut, ortës jeniçere, kishës, xhamisë, klanit, fisit, apo akrabasë. Në mungesë të lidhjeve reale, ata iu drejtuan formës e strukturës fiktive, që thjesht vesh lidhjet personale me ngjashmërinë e lidhjeve të natyrshme të gjakut apo të vlerave. Në nivelin politik, ky moral i një mendësie të ngushtë e tejet konfliktual u shfaq, mbi të gjitha, në ringjalljen e strukturave të sistemit partisë-shtet. Në rastin e PS, ajo parti e rëndësishme politike ekziston vetëm si strukturë, ruhet si strukturë personale dhe mbahet bashkë vetëm e vetëm për shkak të mendësisë së parisë. Gjithashtu, ky konceptim i ngushtë i moralit u vu re edhe në krijimin e në funksionalizimin e strukturave, të bazuara në shtresën e të përndjekurve dhe në përqaftimin e moralit e të vlerave të kësaj shtrese, nga kundërshtarët e klaneve që kontrollojnë PS. Këta pjesëtarë të parisë, si Sali Berisha, Genc Ruli, Ilir Rusmajli, Bujar Nishani, Ridvan Bode, Tritan Shehu, apo Genc Pollo, që formalisht e shohin grupin e tubuar në PS si burimin e të gjitha fatkeqësive të veta, shumë mirë mund të kishin qenë drejtuesit e sotëm të PS-së. Edi Rama, Erion Veliaj apo Ben Blushi mund të kishin qenë fare mirë në krye të partive opozitare.

Mirëpo, vlerat e shpallura, morali partiak, kujtesa historike, normat e sjelljes e gjithçka tjetër që i ndan këto grupe të parisë, janë thjesht “shtresa gjalpi”, që e bëjnë mbrojtjen e interesave të saj të mundshme nga palët. Po për këtë arsye, paria është e organizuar në makina oligarkike, të drejtuara nga “njëshat”, që janë kthyer në mishërim të këtij sistemi kundërshtues vlerash. Rrjedhimisht edhe parlamenti e qeveria janë të mbushur me “zero”. Një nga treguesit e sistemit oligarkik është besnikëria e padiskutueshme personale e klientëve ndaj prijatarëve të klaneve respektive.

Kështu, prania e këtyre tre elementëve, gjegjësisht mungesa e vetëdijes shoqërore se shtetasit i përkasin një grupi të caktuar, mungesa e vetëdijes se shteti i përket një grupi të caktuar dhe se është në shërbim të tij, si dhe përpjekja e jashtëzakonshme e parisë për të përhapur një moral shoqëror që iu shërben interesave të saj të ngushta oligarkike, ka çuar në gjendjen

mjerane të shoqërisë shqiptare.

Problemi është se, në vend që të krijonte një sistem kulturor hegjejonik, me një ideologji që i bashkon të gjithë, që ta mbante të gjithë shoqërinë bashkë dhe kështu të muntohej që të arrinte të ndërtonte një shoqëri moderne, kombëtare dhe demokratike, paria bëri të kundërtën. Paria ka punuar dhe punon që ta ndajë veten nga shoqëria edhe në nivelin moral, duke përdorur trashëgimninë morale të sistemit të kaluar, për ta mbajtur të gjithë shoqërinë peng. Kriza morale e shoqërisë shqiptare është e thellë dhe rruga ku po i çon shqiptarët paria e Tiranës, është rruga e shkatërrimit të sigurtë të shoqërisë. Paria nuk ka se si të ndrrojë rrugë, thjesht sepse çdo rrugë tjetër që mund të ndiqet, i bie ndesh interesave të saj të ngushta.

Rrugëzgjdhja nga kriza që po përkeqësohet progresivisht fillon edhe me kuptimin e drejtë të gjendjes ekzistuese si të pashpresë, pa të ardhme e jo të moralshme. Zgjdhja nis me nevojën e ringjalljes së moralit të duhur shoqëror. Zgjdhja duhet mbështetur në një mirëkuptim të drejtë të rolit të shtetit e të përkatësisë së tij. Mbi të gjitha, rrugëzgjdhja vjen me krijimin e përhapjen e vetëdijes se shqiptarët i përkasin një grupi të caktuar dhe se politika e politikanët duhet të jenë në shërbim të atij grupi. Atëherë e vetëm atëherë, në momentin kur ta shohin veten si pjestarë të një grupi të caktuar e ta duan dhe ta konsiderojnë shtetin e tyre si mbrojtës të interesave të kombit, do të ketë shpresë, të ardhme e një jetë më të mirë për shqiptarët, por edhe për pakicat që jetojnë me ta.

MBRRITJE DHE DËSHTIME: PËRSIATJE MBI GJENDJEN DHE JUSTIFIKIMET E PARISË

Në kapërcyell të viteve 1970-të, një nga konceptet më të kontestuara dhe të debatuar ka qenë koncepti i *relative deprivation*, d.m.th. përjetimi i ndjesisë se njeriu nuk ka atë që i duhet për të qenë i përmbushur në jetë. Shkaku i revolucioneve dhe lëvizjeve shoqërore, është pikërisht kjo ndjesi e mangësisë të të mirave materiale që shkërbehen në gjendje shoqërore. Në vitin 1990 shteti shqiptar ishte në krizë, mirëpo kishte shumë njerëz që kishin një jetë normale. Kur kontrastohej me pamjen e sheqerosur të jetës që ofronte televizioni italian, edhe jeta e njeriut në gjendjen më të mirë ekonomike në Tiranë, në vitin 1990 dukej e mjerë. Po ashtu, për një masë të konsiderueshme njerëzish, të zhgënjyer nga tranzicioni, ka filluar procesi i idealizimit të jetës së tyre nën sistemin e mëparshëm.

Çdo gjykim për gjendjen e tanishme në shtetin shqiptar është relativ dhe i kushtëzuar shumë nga përvojat, këndvështrimi dhe pritjet e njerëzve e të grupeve të cilave iu përkasin. Ka shumë njerëz në shtetin shqiptar, që janë krejt të bindur se jeta e tyre ka ndrruar për mirë. Këta persona, të cilët e masin çdo gjë me gjendjen ku kanë kenë në vitin 1990 ose në vitin 1997, shohin se në zona të caktuara, ku ata jetojnë si grup, është vendosur rregull e qetësi publike. Po ashtu, mjaft rrugë janë shtruar, ka një normalizim të dukshëm të jetës për një masë të ndjeshme të popullatës, si dhe drita e ujë me rregullsi. Mbi të gjitha, për një masë të konsiderueshme njerëzish, ka një pajtim të dukshëm me gjendjen aktuale që, në dukje, ua garanton ekzistencën dhe një jetë normale.

Kjo paraqitet si arritja e parisë dhe mbyllja e tranzicionit. Individët që janë pjesë e këtij grupi, pjestarët e parisë, rrethi i klientëve me influencë, të punësuarit në shtet, pronarët e bizneseve fitimprurëse, segmenti kompakt i të punësuarve në organizata e struktura të huaja, profesionistët, (mjekët, dentistët, inxhinjerët, profesorët, avokatët) të tregojnë me bindje të thellë sukseset e tyre në jetë. Shumë prej këtyre vijnë nga koha kur e kishin apo nuk e kishin një dhomë e kuzhinë, rrinin në radhë për qumësht, gëzoheshin kur merrnin një frigorifer apo lavatriçe dhe duhej të punonin për një rrogë thuajse sa të vartësve apo të punëtorëve të tyre dhe iu duhej të dëgjonin urdhëra, që vinin nga njerëz të përbuzur prej tyre, injorantë e të parespektuar por besnikë politikë, *politrukë* të sistemit. Shpesh ata komandoheshin nga njerëz që s'u peshonte fjala dhe me moral të dyshimtë. Por, sot, këta janë të shkëputur nga këto shtresa shoqërore. Ata kanë apartamente të një cilësie të lartë, makina të modelit të fundit, pajisje shtëpiake dhe elektronike të modelit të fundit, shërbyese, shtëpi në plazh, fëmijë në shkolla të huaja, qenër race, janë zhvilluar në shije dhe konsumojnë me cilësi, si dhe udhëtojnë shpesh jashtë shtetit. Oazet e tilla ku jetojnë shtresa e ngushtë e miliarderëve të mëdhenj të parisë, por edhe shtresa e pasanikëve të rinj, të barazvlershëm me shtresën e mesme të lartë në disa vende të tjera, janë të dallueshme, si në Tiranë ashtu edhe në rrethet e tjera. Këta janë paria me nënshtresat e saj. Katër përqind e shqiptarëve kanë gjysmën e pasurive të ruajtura në banka. Ky është vetëm një tregues, sepse pasuria e tyre e vërtetë duhet shumëfishuar. Këta janë edhe pronarët e bizneseve, të tokave, pjestarë në shumë veprimtari ekonomike e me radhë.

Për këta individë, që nuk janë të paktë si numër, ky ishte edhe qëllimi i tranzicionit. Sipas tyre, “dikush do të bëhej i pasur, dikush do të varfërohej”, por “do të triumfonte më i zoti”. Tashmë, shumë prej tyre nuk ngurrrojnë që të shprehen se tranzicioni është mbyllur, apo se nuk mund të ketë kthim e ndryshim të këtij sistemi. Argumentet, që paraqiten prej tyre për të justifikuar gjendjen, janë të shumta, por shumica janë të mbështetura në mite të pastra, të kultivuara me kujdes dhe objektivin e qartë, që të shtyjnë njerëzit

të pajtohen me gjendjen dhe ta shohin atë si të pashmangshme.

Ana tjetër e tranzicionit

Mirëpo, përtej fasadës modernizuese të oazeve, si Priska, Petrela apo Golemi, ku jetojnë pasanikët, gjendja është kritike. Ekuilibri shoqëror i trumbetuar, është shumë i paqëndrueshëm, por edhe i padëshirueshëm për shumë njerëz. Këto shtresa të gjera, që nuk kanë më asnjë zgjidhje tjetër në jetën e tyre, përpos përballjes së përditshme me rrënimin ekonomik, varfërinë e me krizën morale, janë pa shpresë. Prej perspektivës së shumicës së qytetasve, ai vend të duket një vend i marrur peng prej djallëzisë e zvetënimit të parisë, injorancës së shtresave të vuajtura dhe prej krimit të organizuar.

Kur e sheh vendin me syrin e një njeriu që shpreson e lufton për një shtet demokratik të së drejtës e në shërbim të qytetarëve, një shoqëri me moral të shëndoshë e me vlera njerëzore e kombëtare, një ekonomi që krijon mirëqënie për të gjithë qytetarët, si dhe për konsolidimin e sistemeve të shërbimeve shoqërore, të gjitha të vëna në funksion të një të ardhmeje më të mirë, më të bukur, e më të sigurtë për të gjithë shqiptarët, sigurisht që nuk ndjehesh aspak mirë. Niveli i mjerimit shoqëror është i frikshëm. Me një papunësi që deklarohet nga opozita se i kalon 40%, me një ndër pesë fëmijë që jeton me ndihmë nga shteti, me 14% të popullsisë që jeton vetëm me ndihmat që merr nga jashtë, me 107,000 familje (një në gjashtë) që marrin ndihmë sociale, gjendja nuk mund të jetë e mirë.

Shkurt, me të gjithë të mirat që ka sjellë për pasanikët e e rinj, dhe me të këqiat që ka krijuar për shqiptarët e tjerë, tranzicioni është një dështim. Me të gjithë arritjet që ka pasur, sado të vogla të jenë ato e me mangësitë, sado të dallueshme që janë ato, shteti shqiptar në një gjendje kritike. Edhe pse në sipërfaqe duket sikur ka normalitet, siguri ekonomike dhe qetësi publike, si të gërmosh pak më thellë, e sheh se vendi është ende i ndalur në udhëkryq.

Problemi themelor është se nuk u bë ajo që duhej. Burimet e shumta e të jashtëzakonshme materiale e njerëzore janë

shpërdoruar, shanset historike janë humbur, kriminalizimi i shoqërisë ka shkuar deri në palcë, sistemi politik ka përfunduar në oligarki të pastër, vlerat kombëtare e njerëzore ia kanë lënë vendin një materializmi tipik për fundërrinat e shoqërive, paria sunduese është e zvetënuar dhe tërësisht e korruptuar. Mbi të gjitha, nuk ka shpresë, as te udhëkryqi i përjetshëm i tranzicionit ku është ndalur vendi, por as te paria sunduese. Në nivelin ideologjik, nuk ka një vizion të ndryshëm e bindës për të ardhmen. Nuk ka asnjë plan për të dalë nga qorrrokaku i gangsterizmit ku jemi ngujuar, por mbizotëron një gjendje rezinjate e pajtimi me gjendjen. Kjo gjendje ushqehet me një numër mitesh që kultivohen pa ndërprerje. Më poshtë do të trajtoj disa mite të tilla, që janë në thelb të justifikimeve të parisë.

Si duhet të vlerësohen arritjet e prekshme në jetën e njerëzve?

Gjatë tranzicionit ka pasur edhe arritje. Aq më shumë që mbas vitit 1997, hynë shumë para nga mërgimtarët tashmë të fuqizuar, por edhe nga kontrabanda, nga trafiqet njerëzore, nga marrja e borxheve prej shtetit, e me radhë. Por kanë kaluar dy dekada dhe nuk kemi bazë ekonomike. Shtetet e tjera vepruan ndryshe. 20 vjet mbas shembjes së regjimit hitlerian, Gjermania përjetonte mrekullinë ekonomike dhe filloi një program masiv për të sjellë në Gjermani mërgimtarë që të punonin në industrinë gjermane. E njëjta gjë ndodhi me çekët apo polakët. Por, 20 më vonë, arritjet që tregohen në shtetin shqiptar janë vetëm ndërtime e luks. Banjot janë me mermer, rubinetat janë të lara me ar, njerëzit kanë celularët e modelit të fundit, kane Benz-Mercedesë, e shumë shqiptarë shkojnë me pushime, të paktën një herë në vit, në vende të shtrenjta si në Bali, Aruba, Sharm Al-Shaykh, apo në ishujt Mauritius. Vlera e pasurisë së patundshme është rritur shumëfish dhe, mesatarisht, pasuria familjare duket e shtuar po ashtu shumëfish. Ka mjaft njerëz që nuk kanë asnjë arsye të mendojnë se tranzicioni ka qenë një dështim. Pra, arritje ka në përmirësimin e jetesës për një masë të përfillshme dhe këto janë evidente. Por, arritjet janë thaujse tragjikomike dhe një shpërdorim i pafalshëm

i mundësive të krijuara. Pa hapjen e vendeve të punës, pa industri e prodhim kombëtar, arritjet që tregohen janë më shumë se të dyshimta. Në terma të zhvillimit kombëtar, kjo është njëlloj sikur të ndërtohet një kala me rërë në mes të verës e të mos mendosh se do të bjerë shi një ditë, apo se do ta marrë batica natën.

Mirëpo, gjendja është edhe më keq se kaq. Në vend që të ishte ndërtuar një parajsë për mërgimtarët e për të huajt, ku, të paktën, njerëzit të mund të jetonin me shërbime, ndërtimet e objektet janë të ndërtuara pa kriter, pa sistem, pa një plan afatgjatë, pa infrastrukturë dhe pa vizionin e nevojshëm. Kështu, në Durrës, pallati grataçielë në bregdet, është ndërtuar në rërë, pa hipotekë, pa ujë të pijshëm, pa vend parkimi, e pa kanalizime. Më e keqja, është se kushton më shumë se sa një apartament në Miami, Tampa, apo në Boca Raton. Në Tiranë, pallati është ndërtuar në një vend ku uji i pijshëm i shkon me ujërat e zeza dhe në oborrin e një pallati të ndërtuar, me sistem modern në vitet 1960-të. Në hyrje të Shkodrës e sheh pallatin që është mënjanuar si *Kulla e Pizës*. Mungon industria e mirëfilltë. Njerëzit nuk e punojnë më tokën. Biznesi më i përhapur janë restorantet e motelet një orëshe. Shqiptarët punojnë pesë orë në ditë dhe fitimi del kryesisht nga shitblerja. E gjithë kjo ngrehinë allishverishesh e matrapazllëku, (sepse s'mund të quhet ekonomi prodhuese), është një strukturë marrëdhëniesh, që prodhon pak e aspak. Si shteti, edhe ekonomia mbahet me mërgimtarët, me paratë e krimit dhe me borxhet e palara.

Pyetja, atëherë, është se a janë shfrytëzuar si duhet mundësitë që janë krijuar, burimet materiale e njerëzore, që u vunë në dispozicion dhe kushtet specifike në të cilat e ka gjetur veten vendi? A është vepruar si duhet? Nuk duhet parë gjithçka zi. Por, duhet thënë se, figurativisht, në vend që të ndërtohej një pallat ku të jetonin mirë të gjithë, është ndërtuar vetëm një vilë ku rrin paria.

Për gjithkënd që don me e pa të vërtetën, ai vend është qartësisht fole e krimit të organizuar. Krimi i organizuar është i drejtuar prej parisë sunduese e në shërbim të saj. Sundimi i parisë mbahet në këmbë përmes një sistemi të konsoliduar oligarkik.

Populli është i çoroditur dhe i cytur nga paria, hedh valle në buzë të greminës morale, duke pritur te hyjë në BE, me argumentin e vetëm se “nuk munden me na lënë jashtë.” Edhe në rastin më të mirë, ai shtet do të jetë plevica e BE-së, vendi ku rriten prostitutat, drogaxhinjtë, pushtat, mafiozët dhe hajnat, dmth, ose Haiti ose Napoli i Evropës.

Sa për ilustrim të kësaj gjendjeje kritike, them se ndër gjërat që bien më shumë në sy janë betonizimi i jashtëligjshëm dhe i pandalshëm i vendit. Vetëm në 10 vitet e fundit janë shtuar 300,000 objekte, edhe kur popullsia ka rënë formalisht, me 300,000 vetë. Në lidhje me administratën vihet re korrupsioni i papërshkrueshëm në të gjitha nivelet. Një studim i fundit tregoi se 498 firma, ndër 500 të intervistuar, janë të detyruara që të jenë të korruptuara. Bie në sy shtresëzimi i theksuar shoqëror, me një pakicë që kanë e jetojnë mirë, dhe me një shumicë që marrin bukën me lista. Sipas disa vëzhgimeve, numri i njerëzve që marrin bukën me lista është shtuar disafish. Të bie në sy, dështimi i ndërtimit të një ekonomie të institucionalizuar të tregut, materializmi i zhveshur dhe i paskrupullt që sundon mendësinë e të gjithë shtresave shoqërore, humbja e identitetit dhe mungesa e vlerave që e mbajnë një shoqëri bashkë. Por, ndër fenomenet më të frikshme janë piramidat e injorancës arsimore, mafiat me bluza të bardha, me diploma profesoriale apo me kallashnikovë. Qindra milionë euro kalojnë në arkat e 58 universiteteve private, që prodhojnë diploma e të shkolluar në profesione që janë të garantuar të jenë pa punë, gjithë jetën. Po ashtu, nuk mund të mos vihet re shkatërrimi i sistemeve të shërbimeve publike. Të vret sytë konsolidimi i sundimit të oligarkisë së Tiranës, i manifestuar në besnikërinë e zyrtarëve e nëpunësve ndaj klaneve e individëve me pushtet. Natyrisht, shkak kryesor për këtë gjendje të frikshme e kritike është, papërgjegjësia politike e pakrahasueshme e parisë së Tiranës, që mendon veç për veten e vet.

Paradokset shqiptare janë tragjikomike dhe krejtësisht të dukshme, edhe në jetën e përditshme. Shqipëria është një vend ku as ato që e shfrytëzojnë nuk duan me jetue. Ata që kanë pronat, nuk duan me i investue paratë, që shpesh ia kanë shtrydhë me

gjakun popullit, në shtetin shqiptar. Të gjithë pjestarët e parisë nuk duan t'i rrisin dhe edukojnë, t'i shkollojnë fëmijët e tyre në shtetin shqiptar. E vërteta është që ata që e sundojnë, nuk duan as të kalojnë pushimet në shtetin shqiptar. Tani që shkruaj, për Vitin e Ri 2011, thuhet se ka 7,500 mërgimtarë që janë kthyer nga Greqia në një ditë, por edhe 3,500 makina që kanë dalë jashtë vendit, afërmendësh, për pushime. Në shtetin shqiptar ka më shumë karrike në baret e klubet e panumërta se sa ka banorë i gjithë shteti. Profesionit ma i përhapur është ai i kamerierit dhe... studentit. Në Shqipëri ka më shumë studentë universitarë se sa është rritja vjetore e popullsisë. Sivjet janë regjistruar 52,000 në universitetet e ndryshme. Thuhet se 23,000 e ca studentë janë regjistruar në universitetet shtetërore, 28,000 e ca të tjerë në universitetet private, pa llogaritur këtu rreth 2,500 të tjerë që kanë shkuar në Itali. Por, rritja vjetore e popullsisë, sipas INSTAT, është vetëm 36,000 në vitin 2008.

Luksi është i paparë. Lypsat në Tiranë të kërkojnë para borxh me iPhone e me SMS, "Ma mbush kartën, të lutem". Lajmi i ditës është se kryeministri theu rekordin personal të notit si Mao Ce Duni në lumin Jance, kur shteti nuk është i zoti të marrë para borxh. Flitet për legalizim të ndërtimeve pa leje. Në pesë vjet të qeverisjes janë ndërtuar me dhjetramijra ndërtime të tjera pa leje. Shteti ngjit shkallët e transparencës në një tabelë OJQ-je, por korrupsioni i administratës është në nivele të papara.

Por, edukimi privat e universitar është seria e 'fluskave' të biznesit, që inkurajohen qëllimisht nga qeveria dhe shteti. Më e keqja është se në shtetin shqiptar të plas krimi para syve, e të gjithë e qepin gojën. Këtu ndodhi 1996-1997-ta, u shkatërrua vendi, u vranë 2000 vetë dhe mbetën sakatë 10,000 të tjerë, e disa nga kriminelët përgjegjës për atë tragjedi kombëtare, ndër të tjerë, kryeministri Sali Berisha, zgjedhin të merren me masakrën e Tivarit. Këtu flitet për mbi 100,000 prostituta me origjinë nga shteti shqiptar dhe me 4,700 fëmijë në moshë të njomë të trafikuar në Greqi e Itali në vitin 2007-2008, ndërsa kryeministri i shtetit dhe e shoqja merren me jetimorën apo shoqatën e të paaftëve. Këtu deklarohet serbes se rritja e eksporteve në vitin

2011 është 70 përqind, kur vendi importon edhe sanë, barin e thatë, nga Maqedonia e nuk ke një impiant industrial si provë treguese se prej kah ka ardhur kjo rritje, përveç ujit të Drinit e mineraleve. Në shtetin shqiptar njerëzit nuk kanë punë e dasmat i bëjnë princërore me limuzina të marra me qera 400 euro ora. Të tërë banditët i sheh në klube, me çanta të vogla profesoriale, por që peshojnë se janë me *Zastava* brenda, gati me ia marrë jetën dikujt për një mijë euro. Këtu flitet për rritjen ekonomike më të lartë në Evropë, kur buxheti i shtetit pritët me 25 përqind. Vendi deklarohet se është më përpara vendeve të Europës në edukim, por studiues me master kërkojnë punë si pastrues hotelesh e nuk gjejnë. Paradokset shqiptare janë të pafundme.

Mërgimtarët, që e mbajnë atë vend me bukë, për buzën e trajtohen si qenie ekzotike. Për shumë studjues, është e habitshme se pse ata mërgimtarë vazhdojnë që të çojnë para e të kthehen në atë vend, që i abuzon në atë mënyrë. Flitet për zhvillimin e turizmit, e në të gjitha plazhet e vendit notohet në shtupa, jashtëqitje, boçe misri, mbeturina gjirizesh e me rradhë. Të gjithë mërgimtarët kthehen në vend gjatë verës, por të gjithë qeveritarët, bile edhe pronarët e hoteleve, ia mbathin me pushime në Kroaci, Greqi, Turqi e në Mal të Zi. Në një plazh ku shkojnë 150 mijë vetë çdo dy javë, ku është ndërtuar një qytet i tërë me vila, rrugë e restaurante, vetëm një pallat me 28 hyrje është tërësisht i legalizuar, çdo ndërtim tjetër është veç me një leje përdorimi.

Ky është i vetmi vend në botë, ku paria sunduese vendos të ndalojë sherrin për dy muajt e pushimeve verore. Qeverisja e sherri në Tiranë mbaron në qershor e fillon në shtator. Mbi të gjitha, simptomë e paradoksit shqiptar, është media dhe propaganda e saj çoroditëse. Media, që jep filma me tema ekstreme ditë e natë, merret me gjokse silikoni, me dietën e këngëtareve që reklamojnë birrë, me ura e me rrugë që nuk janë ndërtuar, me ujësjellësa që nuk funksionojnë, sepse edhe në Tiranë, të vjen uji i pijshëm me ujërat e zeza, me vende që përmythen e të shiten si objekte turizmi. Ky është vendi ku njerëzit vdesin përditë nga lëndët kimike prej banesave të ndërtuara në zonat industriale e mbi trojet e fabrikave kimike, por darkën e kalojnë në cocobongo me DJ të importuar e me

tallava politike. Paria nuk merret me këto fenomene. Tranzicioni, për parinë, ka përfunduar. Humbja e miliona jetëve është çmimi që paria thotë se duhej paguar prej shqiptarëve. Shkurt, për dikënd, që nuk bie pre e lustrës dhe e propagandës mediatike, por sheh me vëmendje problemet e rënduara, kjo është një gjendje marrëzie kolektive. Si thotë edhe Macchiavelli, *“perché un principe che può fare quello che vuole è un pazzo; un popolo che può fare ciò che vuole non è savio.”*

Ky është një delusion kolektiv, sepse mendohet që në një shoqëri normale mund të jetohej pa prodhuar, pa përpunuar, pa krijuar, përditë e pa ndërprerje të mira materiale. Edhe pse e veshur me luks, kjo që po përjetohet, është në koncept, njëlloj si jeta e të burgosurve, për të cilët realiteti fillon e mbaron tek kampi e tek jeta e burgut. Shumë prej tyre, mbasi kanë ndenjor për shumë kohë në burg, nuk duan të ikin më prej andej. Ata i heq nga burgu, por nuk e heq dot burgun prej tyre. Shoqëria shqiptare është mësuar keq me jetën e lehtë, me paranë e lehtë e pa punë dhe është e vështirë të ndërrojë. Shansi historik me ndërtuar një shoqëri normale, që na u dha në vitin 1990, është humbur. Problemet nuk janë zgjidhur, tranzicioni i menduar dhe i drejtuar nga paria na çoi në një qorrrok moral, humbje të dy brezave e shkatërrim ekonomik dhe shteti mbijeton duke shitur veprat e ndërtuara në kohën e Enver Hoxhës. Prandaj duhen krijuar kushtet për një shans tjetër historik. Duhet që të ndryshojnë strukturat politike e marrëdhëniet shoqërore dhe ekonomike, në mënyrë që të gjithë shqiptarët të përfitojnë dhe kjo duhet bërë duke përdorur me mend shtetin dhe burimet materiale e njerëzore.

Kështu si janë ndërtuar sistemet ekonomike dhe politike, është e qartë se fiton vetëm paria e Tiranës. Vendin e kanë nxjerrë në shitje. Ekonomia është një piramidë, flluskë e gjallë sapuni. Por, vetë paria ka shumë burime. Nuk ka rëndësi se si hyn paraja në shtetin shqiptar, rëndësi ka që kushdo që sjell para, ia sjell parisë dhe gjithçka kalon në mullirin e saj. Për më tepër, droga, kontrabanda, trafikimi e krimi janë burime të ardhurash, që nuk e lënë shtetin shqiptar me ra në krizë të thellë. Megjithatë, BE e ka shumë të lehtë të mbyllë edhe rubinetin e parave të pista, por sot

për sot, nuk e ka bërë atë gjë.

Por, më e keqja është duke u verifikuar në gjendjen kritike të mungesës së shpresës dhe të besimit në të ardhmen. Niveli i moralit është në nivele shumë negative. Në shtetin shqiptar, paria nuk ka pikë ndjenje atdhedashurie e shërbimi publik. Kjo shihet nga indiferenca e saj e plotë për jetën njerëzore, sepse, në shtetin shqiptar, nuk ka mbrojtje për të varfërin, të pazotin e të vuajturin. Shteti është një instrument në duart e parisë, zyrtarët janë të korruptuar deri në palcë dhe njerëzit janë pajtuar me këtë gjendje. Kjo është gjendja tipike për një republikë bananesh, ku fatet e vendit i mbajnë në duart e tyre një grup i vogël familjesh, oligarkia e konsoliduar e parisë sunduese.

Pasurimi përmes politikës

Ashtu si në të gjitha republikat e bananeve, politika aktuale e shtyn shoqërinë që të bindet se, kush merret me politikë, do të bëhet i pasur. Të rinjtë po mësojnë mbrapshtinë e të vjetërve dhe e gjithë shoqëria po hyn në një rreth vicioz. Ky është një problem shumë i mprehtë e qëndror në lejimin dhe në kultivimin e vazhdimësisë së sjelljes kriminale. Ky problem është i lidhur më shumë probleme të tjera që i përmenda më lart, por që do të ketë efekte të jashtëzakonshme në moralin, por edhe në vlerat e shoqërisë në të ardhmen. Problemi është se në një shtet ku nuk ka ekonomi, politika bëhet ekonomi. Në një shtet normal, njerëzit merren me politikë, jo që të bëhen të pasur, por të fitojnë nder e respekt në shoqëri. Paratë dhe pasuria e vërtetë fitohen me punë, me profesionalizëm e me tregëti. Askush nuk e respekton më shumë ligjin, se sa ai që ka pasuri të vënë me nder. Prandaj, një shtet i fortë është mbrojtja më e mirë e të gjithëve, e të varfërit nga shtypja e shfrytëzimi, e të pasurit nga lakmia e vet, por edhe nga krimi ku të çon paraja.

Duke mos patur ekonomi të mirëfilltë prodhuese, si dhe duke pasur përballë një sistem politik oligarkik e klanor, në të cilin strukturat shtetërore janë të pafuqishme para parisë, atëherë vjedhja e thesarit të shtetit, shpërdorimi i pozitës apo i burimeve

shtetërore, bëhen mjete e mënyra kryesore pasurimi. Në shtetin shqiptar, këto janë mënyra më e sigurtë dhe më e shpejtë e pasurimit. Kështu që, paria e Tiranës, si për të fituar pasurinë, por edhe për të ruajtur pasurinë e vet, kërkon që të mbajë, me çdo kusht, edhe kontrollin mbi sistemin politik. Prandaj, politika është gjithnjë në plan të parë.

Kështu, për shembull, Andis Harasani nuk hyn në politikë si njeri i pasur. Por, ai bëhet deputet i PS-së dhe Drejtor i Korporatës Energjitike Shqiptare dhe del nga politika me 28 milionë Euro pasuri, që më vonë thotë se i ka fituar në bursë. Po të ishte kaq i zoti, sa që me një grusht para, e me rrogën e deputetit e të drejtorit, ka bërë 28 milionë euro në katër vjet në bursë, të gjithë *hedge funds* në botë do t'i jepnin të paktën 500 milionë dollarë rrogë në vit që t'i mësonte se ku duhej të investonin paratë e tyre, që po i humbin duke i investuar me profesionistët e rrahur me vaj dhe me uthull. Po ashtu, Edi Rama ka vetëm 3,000 euro pasuri tash 10 vjet dhe nuk ka arritur të kursejë më shumë. Sali Berisha jeton në apartamentin, që ia ka blerë e bija me kursimet e punës me dieta që ka bërë jashtë vendit. Edhe akuzuesi i Ilir Metës, Dritan Prifti deklaroi dy milionë euro si pasuri të gruas, vetëm pas dy vjetëve punë si Ministër i Ekonomisë. Shteti shqiptar është i vetmi vend në botë ku deputeti deklaroi si pronësi një çerek apartamenti, një gjysëm makine, një gjysëm dynymi tokë në majë të malit të humbur, që nuk gjendet në hartë, por që ia ka lënë gjyshi, si dhe pronë në një vend ku është tërhequr deti nga mbushjet e lumit. Në të njëjtën kohë, çdo drekë e darkë pi verë të shtrenjtë, drekon në restaurante luksoze, blen diamante të shtrenjta dhe bredh gjithë botën. Më e pakta që mund të thuhet është se këtu ka diçka që nuk shkon. Megjithatë, është e dukshme që shumë nga këto para vijnë në rrugë që janë jo të ndershme e jo të pastra.

Por, pjestarët e parisë nuk kanë rrugë tjetër. Ata do të vazhdojnë në rrugën e zvetënimit e të mashtrimit. Edhe më keq se aq. Natyra e sundimit oligarkik dikton që, duke vazhduar që të ecin në këtë rrugë, ata do të përfundojnë duke i zvetënuar edhe fëmijet e tyre. Çka është edhe më e keqja, ata po e bëjnë këtë me shumë dëshirë. Me folë me gjuhën figurative popullore, gjarpëri nuk ka

pse shqetësohet që pjella e tij ka me helmatisë të tjerët. Mandej, çka lind nga gjarpëri, din vetëm me kafshue. Marrja me politikë e pinjollëve të parisë është e domodoshme, që të ruajnë fuqinë e klanit, të vjedhin nga thesari i shtetit, dhe të përjetësojnë këtë gjendje krimi, që iu shërben interesave të parisë. Dhe, me sa duket, paria është e vendosur që me ecë në këtë rrugë.

Problemet me mendimin se “kështu si ne, e kanë filluar që të gjithë.”

Një problem themelor me gjendjen është justifikimi i përdorur nga paria se kjo është rruga ku kanë kaluar edhe të tjerët. Ky është një argument që përdoret rëndom në biseda, në shtyp, në media dhe tashmë konsiderohet si e vërtetë e pakontestueshme. Nuk ka dyshim se ky argument, “kështu si ne kanë filluar të gjithë,” është pjesë e arsenalit ideologjik të parisë. Ata janë të gatshëm të përmendin menjëherë familjen Kennedy, Rockefellers e me rradhë. Sipas tyre, në fillimet e çdo cikli pasurimi, ka një krim. Ky krim, simbas parisë, është i domosdoshëm dhe i paevitueshëm. Prandaj, duhet t’i kuptojmë e t’i falim, që ata po e bëjnë këtë krim, se në fund të fundit, “kështu është jeta,” dhe se kështu është në të mirën e të gjithëve. Mirëpo, ky argument është tejet i gabuar dhe paraqitet si i vërtetë, vetëm sepse kështu i intereson parisë. Këtu ka shumë për të thënë, por gjithsesi, duhen theksuar të paktën tre gjëra.

E para, shtetet perendimore kanë patur e kanë struktura të fuqishme shoqërore e sisteme vlerash, që e kufizojnë shumë aftësinë e çdo partie ekonomike apo politike, por edhe të çdo individit, nuk ka rëndësi se sa i pasur është, për të luajtur me shtetin, sipas interesit të tij të ngushtë. Është e vërtetë që ka familje politike. Po ashtu, është e vërtetë edhe që shumë familje që kanë pasur sukses në biznes dhe e kanë të shkuarën familjare të dyshimtë. Mirëpo, me kohë, në sisteme të qëndrueshme, ideologjia del parësore dhe është, ose bëhet, kriteri në bazë të të cilit përzgjidhen e zgjidhen edhe politikanët.

E dyta, natyra e politikës është e tillë që, interesat e shtetit nuk

janë gjithnjë të pajtueshme me interesat e klasës, apo të grupit që përfaqësohet në politikë. Edhe kur ka tejkalime apo shtrembërime, sistemi demokratik funksionon në një mënyrë të tillë që ose politikanët dalin jashtë loje, ose bëhen korrigjimet e nevojshme në legjislacion dhe në mënyra të tjera. Politikanët e vërtetë shtetarë, Ted Kennedy, me gjithë mangësitë e tyre, shpesh iu kanë rënë dhe iu bijnë ndesh interesave të veta të ngushta ekonomike, por edhe shtresës së tyre, për të mirën e shtetit.

Së treti, nuk ka fillim të mirëfilltë në politikë ndër ne. Problemi ynë është se nuk ka pasur asnjëherë ndërprerje drastike me të shkuarën. Politikanët tanë, më tepër ndrrojnë e më pas janë më tepër besnikë të vetvetes. Vetvetja e tyre e vërtetë janë ata, konviktorët e katundarët me valixhe druri, që nuk e ngopnin barkun me një rrishtë buke, me shtatë lekë marmalatë molle ose fiku, dhe me çaj pa sheqer. Këta ishin ose u bënë që të gjithë anëtarë partie. Kur nuk ishin "të aktivizuar," këta ishin të lidhur me një mijë fije me sistemin e me strukturat që e kthyen Tiranën nga një fshat otoman në një metropol krimi. Politika e sotme, dhe njerëzit që janë në lojën politike, vijnë nga kjo kategori. Të gjithë i kanë rrënjët në sistemin e mëparshëm. Të gjithë kanë të shkuar politike në shërbim të sistemit e të parisë sunduese. Këtu ke në politikë aktive ish-ministra si Gramoz Ruçi apo Skënder Gjinushi. Këtu ke në politikë kandidatë për kandidatë të Komitetit Qëndror të PPSH si Sali Berisha apo anëtarë të Komitetit Qëndror si Mehmet Elezi, për të mos folur për të tjerët të rangjeve më të ulta.

E keqja nuk janë njerëzit e thjeshtë apo edhe kategoria e këtyre drejtuesve dhe ish-shërbëtorëve të ndërgjegjshëm e të spikatur të sistemit të mëparshëm apo e pjestarëve të parisë. E keqja është se fillimi i vërtetë duhej të ishte një sistem i ri i cili t'i detyronte këto individë, por edhe të tjerët që iu shkojnë mbrapa, që të silleshin si duhet. Mënyra e re duhej të ishte një mënyrë të ndryshme prej asaj me të cilën këta ishin edukuar e formësuar. Ai sistem që duhej vendosur, nuk u vendos sepse nuk iu interesonte palëve të parisë dhe nuk ishte i imagjinueshëm prej këtyre individëve që dolën në krye të formacioneve politike të parisë gjatë tranzicionit. Prandaj, tashti, në vend të një totalitarizmi kaotik kemi një kaos totalitar.

Mungesa e pranisë së shtetit funksional e të fuqishëm është një problem themelor i tranzicionit. Në çdo shtet tjetër, struktura shtetërore është aq e fuqishme sa që iu vë kufinj të pasioneve njerëzore. Edhe në Tiranë, u shemb shteti dhe u vendos një strukturë e rindërtuar shtetërore. Por, tashmë, kjo ngrehinë institucionale ka vetëm emrin e shtetit. Struktura institucionale është e mangët, dhe e paaftë për të funksionuar si duhet. Ngrehina shtetërore i shërben vetëm parisë dhe paria sillet ashtu si din e si i intereson asaj me strukturën.

Ndër justifikimet e tjera, duhen përmendur edhe dy. Njëri është mendimi se “kemi nevojë për dinasti politike.” Tjetri është mendimi se “jo çdokush mund të bëhet politikan.” Këto janë, po ashtu, monedha propagandistike të hedhura në qarkullim nga paria. Së pari, të gjithë jemi katundarë. Çdo shqiptar, edhe këta që kemi mbi kokë, janë të gjithë katundarë e bir katundarësh, malokë të Jugut, të Veriut, të Lindjes (se në Perëndim kemi detin). Së dyti, të gjithë shqiptarët vijnë nga familje të mëdha e me emër. Gjithsecili shqiptar mundet të jetë dikushi dhe, kur vjen puna tek ruajtja e dinjitetit, sillet si mbret. Shqiptarët janë popull i vështirë të sundohen. Prandaj edhe ata që i sundojnë shqiptarët nuk mundën të jenë mbretër. Por, në rastin më të mirë, mund të jenë vetëm bajraktarë, d.m.th., katundarë, thuajse të barabartë me katundarët e tjerë.

Për më tepër, në një vend të vogël e menjë popull të vogël, politika që nuk mban parasysh interesat e të gjithëve, është e përcaktuar të shfrytëzojë dhe thellojë përçarjet në shoqëri. Kur politika synon të ruajë interesat e familjes, e të “dinastive” tona katundare e konviktore, ajo është e bazuar qartësisht në kundërvënien e një familjeje kundër shtetit. Politika e shqiptarëve, një popull i vogël, duhej të ishte e bazuar në interesin e shtetit kombëtar e jo të dinastive konviktore e jeniçere. Kriteri i përzgjedhjes duhej të ishte: “kush i shërben më mirë shtet-kombit e popullit të vet?”

Por, më e rëndësishmja, popujt kanë nevojë për bijtë e tyre më të mirë. Çdo dinasti përfundon me një humbës. Popujt duhet të kenë aftësinë dhe mekanizmin të përzgjedhin më të mirët e më të aftët, brez mbas brezi. Ata individë që mund t'i shërbenin më

mirë popullit, ata duhej të ishin në krye të shtetit. Prandaj edhe demokracia, me të gjithë të metat e saj, si sistem politik, është një sistem i dëshërueshëm, sepse lejon këto prurje që politika aristokratike i përjashton që në parim.

Politika e familjeve “të mëdha” është një politikë ku vota shitet përnjëthesmiell dhe, meshitjen, humb të drejtën e vendimmarrjes, por edhe dinjitetin. Politika e vlerave dhe ajo shtetformuese, është një politikë ku një familje si Kennedy humb shumë nga ana financiare, por lufton të kontribuojë në përmirësimin e gjendjes të të gjithë popullit të vet. Politika e vërtetë është mbrojtja e interesave të shtetit-komb. Kombi, prej natyrës së vet, është një strukturë shumë egalitare. Ai që iu shërben të gjithëve, duhet të dalë në krye të shtetit dhe atëherë ecet në rrugën e mbarë. Ai që i shërben më parë vetes e familjes së vet, e përdor shoqërinë edhe shtetin për vete e për familjen e vet.

Mungesa e ideologjive

Një nga problemet kyçe që krijon një ç’orientim të paparë, është mungesa e debatit të mirëfilltë ideologjik. Paria është shumë pragmatike. Paria nuk ka kurrfarë boshti ideologjik, vlerash apo botëkuptimi të qartë e koherent, të cilit mund të thuhet se i rrin besnike në vendimet që merr. Ky është një problem formimi, sepse në të shkuarën jo të largët, të gjithë këta duhej që të bënin çka thuhej. Si komunistë të vërtetë që ishin, për ta nuk kishte rëndësi çka thuhej, sa rationale ishte ajo që thuhej, apo sa e dëmshme ishte për popullin. Ajo që kishte rëndësi ishte kush e thoshte atë gjë dhe çfarë dënimi kishte nëse nuk zbatohesh ai vendim. Prandaj, si me tufëzimin, ashtu edhe me qethjen e studentëve, me librat e ndaluar, me tallonat, me dënimin e njerëzve e me rradhë, këta individë bënin çfarë thoshte Partia. Sot, paria lufton që veprimet e saj të mos gjykohen nga shteti i së drejtës, që nuk e lënë të ndërtohet. Mbi të gjitha, ajo lufton që njerëzit të mos e gjykojnë sjelljen e saj, duke përdorur standarde të caktuara ideologjike.

Por edhe më shumë se kaq, kjo shmangie e debatit ideologjik nga ana e parisë është problem interesash dhe morali dhe bëhet

me ndërgjegje. Parisë i interesonte një gjendje amullie politike e spekulative në sistemin ekonomik. Në këtë periudhë të turbullt spekulative ata synonin që të pasuroheshin e të ndërtonin një sistem kapitalist oligarkik. Në krye të sistemit e më të pasurit, do të ishin ata vetë. Mandej, do të vinin pasuesit e tyre, sipas shkallës e rendit në hierarkinë përkatëse. Kapitalizmi ekstremist ishte sistemi që iu shërbente më së miri. Kështu që, që të gjithë, deri edhe Servet Pëllumbi, ish-pedagogu i Marksizmit në Shkollën e Partisë, filozofi mendimtar i PS-së, u deklaruan për tregun e lirë, për globalizmin, për liberalizmin e kapitalizmin. Mirëpo, kjo ideologji ekstremiste, e mbështetur në parimin “njeriu për njeriun është ujë”, nuk aplikohet askund në botë. Gjithkund ka një ndërhyrje vendimtare të shtetit në ekonomi. Por, kjo mendësi iu shërbente atyre, dhe, pikërisht për këtë gjë, kjo mendësi u promovua prej tyre, edhe pse të gjithë ishin të vetëdijsëm për të kundërtën.

Kështu, nën mbulesën ideologjike të vendosjes së kapitalizmit ekstrem, ata lejuan ngritjen e pasurimin e përkohshëm të hajnave e të gangsterëve, iu hodhën një krodhe pasurimi edhe zanatçinjve e tregtarëve të ndershëm, ndërsa vetë morën pjesën e luanit, monopolet kyçe. Tash, që është shterrë mundësia e pasurimit, ata do t’iu kthehen kundër mafias e hajnave që nuk punojnë për ta. Barrën fiskale të mbështetjes së buxhetit të shtetit, ata do t’ua hedhin zanatçinjve e tregtarëve të vegjël. Shteti punon e duhet të punojë për ta. Kjo është filozofia e tyre. Tash, që e ndjejnë se do të ketë krizë dhe probleme sociale, prijatarët e parisë vendosën që të rrisin policinë e shtetit edhe me 1,000 vetë të tjerë. Paria dhe prijatarët duan të ruajnë sistemin e tyre me çdo kusht.

Kjo më sjell tek pika e dytë, ajo e nevojës së ideologjisë. Shqiptarët, si të gjithë popujt e vegjël, kanë nevojë më shumë se kurrë që debatin për fatet e tyre ta shohin në terma ideologjike. Nuk mund të ketë politikë serioze pa një debat ideologjik e pa parti të mbështetura fort në një ideologji të caktuar e në mbrojtje të interesave të caktuara. Pavarësisht se gjithkush don me i veshë e me i mbrojtë interesat e veta me justifikime ideologjike, realiteti është se nuk punohet pa një ide të qartë të interesit kombëtar e shtetëror. Nuk mund të punohet pa një vizion të qartë se ku mund

të shkohet. Vetëm një kuptim i qartë i ideologjisë, dhe i efekteve të vendimeve që merren, mund të ta bëjë të dukshme se në çfarë rruge po ecet e se çfarë mund të pritet po u ec në një rrugë të caktuar. Nevoja e ideologjisë është iminente dhe e pashmangshme. Ndryshe politika është thjesht ngatërresë midis personave e klaneve që i mbështesin.

Prandaj, kur vjen puna tek qeverisja, me e thënë përmbledhtas, vendi është i kapur nga një sistem oligarkik, tërësisht i kontrolluar nga paria, por edhe i vënë pa kushte në shërbim të parisë. Shteti funksionon si një strukturë neopatrimoniale e bazuar në marrëdhënie klienteliste ku një grusht klanesh mafioze politike kontrollojnë politikën, median, ekonominë e vlerat thelbësore të shoqërisë. Qeverisja është e personalizuar nga Sali Berisha. Aktualisht, qeverisja bëhet me SMS, e me intervista të Blendi Fevziut, e të ndonjë tjetri. Partitë, dhe administrata shtetërore, janë vegla të verbëra të interesave të klaneve sunduese që i kanë ç'njerëzuar shërbyesit e tyre deri në palcë. Paria ia kalë të vendosë aq rregull sa iu duhet klaneve të saj për të vazhduar shfrytëzimin e vendit e skllavërimin e shqiptarëve. Shpërdorimi i burimeve njerëzore e materiale është një fenomen i gjithkundgjindshëm. Kundërshtarët e parisë eliminohen me njëmijë mënyra: ata ose marginalizohen, ose blehen, ose ikin jashtë, ose shuhen. Lufta që zhvillohet është me krijue një njeri të zhveshur nga mendësia ideologjike. Padija është instrument sundimi i preferuar i parisë. Padija po shtohet nga ditë më ditë. Edhe më keq, shteti është në krizë të gjithanshme, por askush nuk do me e pranuar thellësinë e padijes rreth asaj që po ndodh në shtetin shqiptar.

Po ashtu, mungesa e kundërshtisë së hapur ndaj sistemit, ka krijuar përshtypjen e gabuar të legjitimitetit ideologjik dhe të hegjemonisë së parisë në atë nivel. Por, paria politike është pjesë e botës kriminale e mafioze dhe e siguron heshtjen e njerëzve, duke përdorur këto mjete. Vendi jeton në një terror psikologjik dhe mediatik. Kur shihet me qetësi, e përmes lenteve ideologjike, kjo është qeverisja që kanë shqiptarët.

Shqiptarët kanë një qeveri që nuk e meritojnë

Një argument tjetër i rëndësishëm në arsenalin argumentativ të parisë është argumenti se “çdo popull ka qeverinë që meriton.” Prandaj, edhe shqiptarët duhet të qepin gojën e t’i durojnë edhe këta, se pse “nuk gjejmë më të mirë.” Por, asnjë popull nuk e meriton qeverisjen e keqe. Shqiptarët nuk e meritojnë këtë lloj qeverisje. Kjo thënie është një mënyrë për të justifikuar sundimin e parisë. Prandaj edhe përhapet me kaq zell nga instrumentet e saj mediatikë. Edhe më i humburi i shqiptarëve ka më shumë dinjitet se sa paria që e sundon vendin. Shqiptarët nuk e kanë qeverinë që meritojnë.

Problemi është diku tjetër. Problemi është se shqiptarët nuk e kanë vetëdijen se cila është rruga që duhet ndjekur. Prandaj, edhe duken sikur janë të dorëzuar para parisë. Por, mjafton të shihet se si sillen shqiptarët kur janë jashtë shtetit. Nuk ka qytetarë më shembullorë, punëtorë, e më të zotë se sa janë shqiptarët. Edhe në kushtet, kur sistemi në shtetin ku janë gjendur i ka diskriminuar, shqiptarët kanë qenë aq të zotë, sa që në dhjetë vjet, të mund ndërtojnë disa dhjetramijëra biznese të suksesshme. Nëse shteti shqiptar ia mbrrin të mbijetojë, arsyeja është pikërisht tek kontributi i këtyre miliona mërgimtarëve, që jetojnë si qytetarë të ndershëm në botë, por edhe i shqiptarëve që punojnë me nder në Shqipëri. Problemi është se ka dalë kashta mbi ujë, dhe se njerëzit janë të paqartë e të ç’orientuar ideologjikisht.

Nga ana e vet, paria kërkon që të gjithë të duken si ata vetë, të bëhen e të jenë pjesë e krimit të saj, dhe, mandej, fajin për dështimin e tyre t’ua lënë shqiptarëve. Por, duhet thënë se ka shumë shqiptarë që i mbështesin pa kushte dhe me vetëdije të plotë. Shumë nga këta nuk janë pjesë e asaj shtrese, të pasur e në gjendje, që u përmend në fillim të shkrimit. Shumë prej tyre janë nga shtresat e proletarizuara qytetase dhe katundare. Pyetja shtrohet, pse këta e mbështesin parinë? Përgjigja është pak e ndërlikuar. Por ia vlen që të ndalemi e ta shtjellojmë pak. Ajo lidhet me një sërë faktorësh kulturorë, psikologjikë dhe interesash.

Nga një anë, njerëzit që kanë kenë të dëshëruar për një copë bukë, e për një pronë, janë të lumtur. Ata që e kanë marrë pronën

me forcë prej pronarit të ligjshëm e ndjejnë veten mirë në sistemin e parisë, sepse “kështu bëjnë të gjithë”. Ata që jetojnë në Tiranë ndjehen më mirë se në vendet e tyre. Ata që hanë bukë të bardhë gruri, nuk ka rëndësi se sa i modifikuar apo me radioaktivitet është gruri, ndjehen rehat dhe mirë. Ata që flenë në dyshekët e importuar, të mbushur jo më me kashtë e pleshta, por me para, ndjehen po ashtu relativisht mirë. Këtyre s’do t’u shihet kurrë untia. Këta e krahasojnë gjithçka me atë jetë që kanë pasur para vitit 1990. Prandaj këta do të jenë militantët e përrjetshëm të partive respektive.

Nga ana tjetër, ata që kanë vrarë, vjedhur, trafikuar e grabitur, po ashtu e ndjejnë veten mirë. Shteti shqiptar është kthyer në parajsën e hajnave, të cubave, të trafikantëve dhe të gangsterëve të të gjithë partive. Ata që kanë qenë të dëshëruar për pushtet, sot janë në krye të shtetit, ku mbahen me të gjitha mjetet e mundshme, po ashtu ndjehen shumë mirë. Për këta njerëz ky vend është parajsja, jeta që ata kanë ëndërruar për vete. Këta e japin votën me sinqeritet të madh për partinë dhe udhëheqësin e tyre.

Mirëpo, një pjesë e mirë e shqiptarëve e japin votën duke zgjedhur të keqen më të vogël. Ata bëjnë kështu duke parë interesin e tyre të ngushtë, por jo duke e parë të keqen nga këndvështrimi i interesit kombëtar. Ata e shohin nga interesi i tyre i ngushtë e tejet personal, d.m.th, ata nuk shohin më larg se hunda e vet. Kush ma fut djalin në punë? Kush ma legalizon pallatin, garazhin, tokën që ia kam vjedhur, zaptuar komshisë? Kush nuk i mbledh taksat? Kështu dikush jep 20 për qind të vlerës së pallatit rushfet, kur mund të paguante 15 për qind në taksa. Dikush tjetër i jep 70 për qind të vlerës së taksës vjetore si rushfet policit tatimor, vit per vit. Dikush tjetër paguan gjashtë mijë euro për një vend pune si mësues. Duke zgjedhur të keqen më të vogël, gjithnjë nga këndvështrimi i ngushtë personal, njerëzit bëhen skllëvër të bindur të parisë.

Paria i mban peng njerëzit për krimet e tyre të vogla. Mandej, paria i shtrydh dhe i përdoron me njëmijë mënyra të ndryshme dhe ashtu siç don vetë. Kështu, duke i mbajtur peng e jashtë ligjit, paria i bën të gjithë njerëzit pjesë të sistemit të saj të jashtëligjshëm. E

vetmja mbrojtje që kanë njerëzit në këtë sistem mafioz, është që të lidhen me njërin klan të parisë. Po të ishin të gjithë të lidhur me shtetin, të mbronin shtetin dhe të paguanin detyrimet si qytetarë të rregullt, e kështu të kishin mbrojtjen e shtetit, paria e të gjithë niveleve nuk do të mund të funksiononte më. Ndririmi i sjelljes do të çonte në ndrrimin e rregullave të lojës dhe në ndryshimin e sjelljes së parisë. Në se ligji bëhet kriteri përcaktues i sjelljes dhe sistemi i drejtësisë fillon e funksionon nën trysinë shoqërore, paria do ta ketë shumë më të vështirë sundimin e saj.

Por, edhe ky problem është i lidhur me mungesën e vizionit afatgjatë dhe të mbështetur në një ideologji të qartë. Edhe ky problem është i lidhur me mungesën e strukturave ideologjike, që do të gjykonin veprimet e gjithsecilit në bazë të vlerave të caktuara, në mënyrë të paanshme dhe jo në bazë të interesave të momentit. Edhe ky problem është i lidhur me mungesën e kulture qytetare e politike që i reziston presionit e trysnisë së gjithanshme të parisë. Kur lidhesh me shtetin, dhe kur shteti është në shërbim të të gjithëve, gjithsecili qytetar është i mbrojtur, intersat e tij duhet të mbrohen. Kur shoqëria do të gjendet në kundërvënje të hapur me sjelljen kriminale, atëherë edhe rrugët e parisë të korruptojnë e zvetënojnë shoqërinë, do të ngushtohen ndjeshëm. Atëherë i korruptuari, cubi, hajni, pavarësisht lidhjeve politike e fuqisë së momentit, ka frikë edhe hijen e vet.

E ardhmja vendoset nga veprimet e përditshme

Kështu si janë duke shkuar proceset, e ardhmja duket mjaft e zymtë. E ardhmja e shtetit shqiptar është e tillë që ose shteti do të vazhdojë të jetë një republikë bananesh e nivelit të Haitit, ose do të bëhet një parajsë mafioze e krimit si Napoli në një shtet europian. Në gjithsecilën rrugë që do të ecet, vendi do të jetë në një situatë delikate. Shoqëria do të jetë e trazuar, me ekuilibre të brishta shoqërore, me jetën politike dhe ekonomike të kontrolluar nga aleanca e parisë së Tiranës me familjet e konsoliduara mafioze. Askush nuk ka interes me e prishë këtë ekuilibër. Mundet që BE të shtyjë përpara edhe procesin e kandidimit, anipse nuk do të ketë

pranim në nivelet e trumbetuara. Napoli e Palermo janë në Europë, pse të mos jenë edhe Tropoja, Tirana e Lazarati? Këto do të jenë sukseset që do t'iu serviren shqiptarëve si arritje të parisë e si fundi i tranzicionit. Mirëpo, askush nuk do të jetë i lumtur me këtë zgjidhje. Euforia e momenteve ka me kaluar dhe shqiptarët kanë me e kuptuar se asgjë thelbësore nuk ka ndryshuar. Fatet e vendit duhen kontrolluar prej tyre vetë e jo duke pritur anëtarësimin në BE. Por, gjithsesi, e ardhmja politike e vendit është duke u vendosur përditë. Paria po bën çka mundet me e kthye vendin në një çiflik feudal. Të huajt duan stabilitet. Mirëpo, edhe pse duket se ka stabilitet formal e pajtim me gjendjen, brenda shoqërisë ka kundërkorrente të fuqishme.

Nga një anë, është fuqizimi i grupeve që identifikohen me qytetërimi e besime fetare përjashtuese të njëra-tjetrës. Fuqia e tyre është rritur ndjeshëm. Shteti e paria po mundohen me i kontrollue me shumë intensitet dhe nën maskën e luftës kundër terrorizmit po mundohet të ruajë kontrollin mbi disa prej tyre. Mirëpo, duket se shteti nuk po ka aq shumë sukses. Nga ana tjetër, është edhe forcimi i grupeve e familjeve kriminale, të cilat shteti as nuk i përmend e as nuk i prek, thjesht sepse paria është e lidhur simbiotikisht me to. Më në fund, është një ndryshim në vlera, por edhe në mendësi, që është i dukshëm veçanërisht tek brezi i ri. Ndryshimi ndihet pikërisht tek ata të rinj e të reja që nuk mbajnë mend se çka kanë sistemi totalitar, e që kanë vetëm një kujtim të turbullt të luftës civile të vitit 1997.

Në një drejtim, kjo është edhe luftë brezash. Lavjerrësi do të shkojë së shpejti në anën tjetër. Ashtu si unë dhe shokët e mi u ngritëm kundër prindërve tanë, ashtu edhe ky brez që sot janë të rinj, dhe ai brez që vjen pas tij, do të kthehen kundër prindërve të vet. Një pjesë e mirë, të paktën, do të synojnë që të gjejnë nder, respekt, siguri e dinjitet duke u identifikuar me popullin. Elementë të këtij brezi, si dhe përfaqësues të spikatur të tij, duket se kanë përqaftuar vlera e sisteme ideologjike, që janë karakteristika të shteteve e të shoqërive moderne. Dëshmi e qartë për këtë është rritja e intensitetit të debateve ndërmjet marksistëve të rinj shqiptarë, të frymëzuar, në veçanti, nga Gramsci. Po ashtu, një rrymë

për t'u përshëndetur, është edhe prania e liberalëve shqiptarë, të frymëzuar nga besimi se ekonomia e tregut është zgjidhja. Por, duhet theksuar se, tashmë, po ndjehet edhe zëri gjithnjë e më i fuqishëm i nacionalistëve të rinj, të cilët besojnë se zgjidhja është një shtet-komb në shërbim të shqiptarëve. Gjithnjë e më tepër, këto zëra përfaqësues të këtyre ideologjive kanë filluar të tërheqin vëmendjen e masës së shqiptarëve të edukuar kudo që janë. Debati ka filluar të marrë përmasën e nevojshme ideologjike dhe është i pranishëm si në shtyp, ashtu edhe në mediat e ndryshme, dhe, mbi të gjitha, në internet dhe rrjetet shoqërore.

Ne e dimë se çka ka ndodhur, por nuk e dimë se çka do të sjellë e ardhmja. Me dështimin e vazhdueshëm e përditë e më të qartë të parisë, si dhe të projektit të saj, me ndërtimin e një shteti oligarkik dhe të një ekonomie monopolesh në shërbim të klaneve të parisë, konflikti shoqëror do të intensifikohet. E ardhmja e vendit do të përcaktohet nga konflikti ndërmjet këtyre ideologjive e mbështetësve të tyre të bindur, që shpesh do të vijnë nga vetë bijtë e parisë. Pra, në mungesë të një përpjekjeje titanike nga faktorët e tjerë, për me e ndryshue gjendjen, e ardhmja e vendit, dhe zgjidhja që ka mbetur, është thujse bardh-e-zi. Shteti shqiptar, ose do të mbetet një shtet kriminal, një shtet i dobët dhe neopatrimonial, tipik për botën e tretë, ose të bëhet një metropol kriminal, anipse në një shtet formalisht european. Kështu si janë ndërtue raportet shoqërore, shteti mund të shkojë shumë lehtë në rrugën e Haitit. Por, në nuk ndrrohet rrugë, shteti mund të vazhdojë që të shkojë edhe në rrugën e Napolit. Por, nuk ka shpresë se mund të shkohet në ndonjë rrugë tjetër më të mirë. Shteti nuk ndërtohet me beton, por me njerëz. Kur njerëzit që e drejtojnë shtetin janë të shtrembër, siç është paria në shtetin shqiptar, as lesa nuk mund të bëhet e jo më shteti.

**POLITIKA E PAZËVENDËSUESHMËRISË:
SISTEMI OLIGARKIK
DHE MUNGESA E ALTERNATIVAVE POLITIKE**

Në formën e vet të pastër, si dy forma të dallueshme regjimesh, oligarkia dhe demokracia, nuk mund të bashkëjetojnë. Mirëpo, problemi themelor i demokracisë, si sistem politik, është brishtësia. Partia, një pakicë e organizuar mundet që të ndërtojë koalicione, me bazë të gjerë e të qëndrueshme, që ruajnë dhe garantojnë kontrollin e saj mbi shtetin dhe mbi institucionet. Partia, gjithnjë mundohet që të minojë të drejtën e shumicës, që nuk ka pasurinë, për ta ripërshtuar atë. Shumica e arrin rishpërndarjen e pasurisë, duke përdorur votën dhe shtetin. Prandaj edhe arma më e fuqishme e pakicës është organizimi. Një pakicë e organizuar mirë, me objektiva të qarta dhe me një strategji afatgjatë, mund dhe arrin të manipulojë sistemin politik në çdo regjim demokratik. Në rastet kur shoqëria ka traditë rezistence shoqërore, organizim politik, kulturë politike, vlera ideologjike, dhe përgjegjësi qytetare, oligarkia e plutokratëve nuk mund të vazhdojë për një kohë të gjatë. Në shumë raste të tjera, sidomos në rastet kur nuk ka kulturë politike demokratike dhe një shoqëri qytetare të fortë, partitë arrijnë të manipulojnë sistemin demokratik. Partitë vendosin një oligarki të padukshme, por gjithësesi, të pranishme, dhe shumë të fuqishme. Por, duke qënë se vota është pushteti formal në demokraci, dhe të zgjedhurit do të vendosin për rishpërndarjen e pasurisë, partia lufton, me çdo mënyrë të mundshme, që të kontrollojë sistemin.

Në rastet kur partia është fillimisht politike dhe pa pasuri të qëndrueshme, vendosja e oligarkisë është problematike. Partia

duhet që më së pari të pasurohet dhe kjo arrihet përmes vjedhjes së hapur të shtetit dhe të pasurisë shtetërore, d.m.th., vendosjes së një sistemi kleptokratik. Mandej, vjen nevoja e ruajtjes së pasurisë së fituar me mjetet politike. Mirëpo, gjatë procesit të pasurimit nga thesari i shtetit, paria kleptokratike korruptohet deri në palcë, kriminalizohet e humbet legjitimitetin dhe, shpesh herë, kundërvënia nga masat e gjera të udhëhequra nga elita apo pari të reja, është shumë e fuqishme. Alternativat politike bëhen jo vetëm të dëshërueshme, por edhe të mundshme. Sistemi demokratik, sado i dobët që të jetë, mundëson daljen e organizatave, partive dhe strukturave alternative ndaj parisë sunduese.

Ndër paradokset shqiptare, është edhe ky. Paria është pasuruar në mënyrë marramendëse në nivelet e pabesueshme, duke grabitur sistematikisht e me forma të sofistikuara thesarin e shtetit. Sistemi politik, që tashmë është konsoliduar në shtetin shqiptar, ka elemente të demokracisë por, në thelb, është një sistem oligarkik i pastër. Karakteristika thelbësore e sistemit oligarkik është përqëndrimi i pushtetit në duart e një grupi familjesh, që kontrollojnë në të njëjtën kohë shtetin, ekonominë, mjetet e informimit, si dhe vlerat që bart ajo shoqëri. Hegjemonia e këtyre familjeve, të lidhura me aleanca të shumëfishta, të dukshme e të padukshme, minon çfarëdo përpjekje për stabilizimin e demokracisë, përfshirjen e kuptimshme të popullit në vendimmarrje dhe në jetën shoqërore politike. Oligarkia e parisë së Tiranës, jo vetëm që e ka mbytur demokracinë në shtetin shqiptar, por ajo po e shtyn popullin drejt një zgjedhe të re. Mirëpo, në shtetin shqiptar nuk ka alternativa të besueshme politike. Dasitë shoqërore, të prekshme në nivelin e bashkësisë, nuk përkthehen në politikë. Edhe përkundër plaçkitjes së pronës shtetërore e private, nuk ka rezistencë e kundërvënie. Si shpjegohet kjo mungesë?

Oligarkia e parisë kleptokratike të Tiranës kontrollon çdo aspekt të jetës shoqërore. Shenjat e oligarkisë e të plutokracisë, janë të pranishme dhe të dukshme gjithkund. Kështu, i gjithë shteti është i korruptuar fund e krye. Kryeministri i shtetit është i kriminalizuar. Qeveria e tij ka në përbërje individë të denjë për kartele kriminale. Familja kryeministore sillet e vepron si një

familje mafioze hapur e pa pikë hezitimi. Opozita nuk bën dallim.

Megjithatë, problemi është se rezistenca e shqiptarëve ndaj këtij procesi mbytës të oligarkizimit e plutokratizimit të parisë është e papërfillshme. Pse nuk ka kundërshti nga poshtë, apo organizim të dallueshëm shoqëror, për t'iu kundërvënë parisë? Pse mungojnë alternativat politike, që mund të pozicionohen kundër parisë dhe, duke përdorur mjetet e format demokratike, ta ndryshojnë gjendjen shoqërore e ta vënë këtë pari përpara përgjegjesisë?

Në fillim, duhet thënë se para gëzon mbështetje e legjitimitet në masa të gjëra. Militantët dhe klientët e partisë përbëjnë 10-15 % të elektoratit. Të organizuar me një strukturë që shkon deri në familje, kjo mbështetje është e dallueshme. Struktura e partive të parisë është e fuqishme. Edhe pse përplasia politike në nivelin e parisë është thjesht shfaqje, sepse, në fund të fundit, prijatarët e gjejnë gjuhën bashkë, niveli i armiqësisë në nivelin lokal shkon shumë thellë. Për më tepër, në nivelin lokal, dasitë janë historike, në sensin që fërkimet lokale midis familjeve, individëve e klaneve janë të politizuara dhe përkthehen në mbështetje të rretheve të caktuara për njërën palë apo për palën tjetër të parisë. Konsistenca e mbështetjes është në nivelin lokal. Para e përdor këtë mbështetje, që e merr lehtësisht e natyrshëm, sepse, është edhe çështje “nderi”, për të ruajtur lidhjen ekskluzive me një parti, anipse kjo fsheh interesa të lexueshme të mbështetësve.

Mirëpo, përtej mbështetjes së militantëve, të klientëve, të bandave të paguara terrorizuese, rezistenca në nivel shoqëror është e prekshme. Organizimi i grupeve, rretheve dhe strukturave që iu kundërvihen palëve të parisë është në rritje. Organizimi, si mbi baza fetare ashtu edhe të identitetit, është i ndjeshëm dhe i prekshëm. Edhe pse strukturat shtetërore iu kundërvihen me shumë intensitet të gjithë organizatave dhe individëve që paraqesin “rrezikshmëri” për shtetin, një kategori e gjerë, ku futen individë e grupe që nga intelektualët tek fanatikët, organizimi është i mundshëm dhe i verifikueshëm. Mirëpo, kjo ende nuk është përkthyer në veprim politik. Kur të përkthehet në veprim politik, atëherë kriza politike do të jetë e thellë, e pashmangshme dhe me pasoja që nuk mund të merren me mend.

Po ashtu nuk mungon potenciali shoqëror. Pakënaqësia me gjendjen është e dallueshme. Argumenti që thotë se shqiptarët janë të lumtur me gjendjen bie poshtë kur shihet numri i shqiptarëve që duan të ikin e të lënë vendin një orë e më parë. Nuk ka se si të jetë një vend i lumtur, kur ato që kanë, ata që e sundojnë dhe e shfrytëzojnë, d.m.th., qeveritarë e biznesmenë të fuqishëm bëjnë lutje të përvitshme për *Green Card*. Ka shumë që hapin restaurante dhe biznese për të marrë atë *Green Card*. Ka prej shqiptarëve, intelektualë por edhe njerëz në gjendje të mirë ekonomike, që kur vijnë në SHBA turren për të gjetur një punë në pastrimin e zyrave e në shtrimin e çative, *roofing*, në Brooklyn. Ata shqiptarë që nuk mund të ikin legalisht, ikin maleve ose me gomone. Njerëzit nuk duan të ikin nga një vend i lumtur. Megjithatë, shqiptarët janë të gatshëm, duket se kjo është edhe shumica e tyre, po u krijua mundësia, që të shkulen me rrënjë e me degë nga ai vend.

Arsyet për mungesën e rezistencës shoqërore nga ana e shqiptarëve duhen kërkuar tjerakah. Shumë nga arsyet duhen kërkuar tek sistemi që ka ndërtuar paria e Tiranës. Sistemi i sotëm politik dhe ligji elektoral e bën shumë të vështirë hyrjen në lojë të forcave politike, që nuk konformojnë me mendësinë e parisë apo që nuk janë të lidhura me të. Paria bën gjithçka mundet që të shmangë daljen e ketyre forcave dhe, si gjithnjë, ajo synon kooptimin e udhëheqësive të tyre apo në mungesë të suksesit, denigrimin e dënimit moral të tyre. Mungesa e strukturave solide, që shkojnë nga partia e deri në komisionet, ku ruhet e ku vidhet vota, nuk lejon daljen e lojës prej kontrollit të parisë. Alternativat nuk mund të ruajnë besnikërinë e njerëzve që ose blihen, ose thehen, ose largohen, ose thjesht nuk mund t'iu rezistojnë trysnive të shumta shoqërore, politike, dhe shtetërore.

Së dyti, arsyet duhen kërkuar tek përmirësimi relativ i gjendjes ekonomike të njerëzve të thjeshtë. Është vështirë me ia mbushë mendjen dikujt që dikur ka ngënë bukë misri me ujë e sheqer, apo bukë me dhallë dhe nuk e ka ngopur barkun me bukë, që gjendja është e mjerë. Njerëzit e thjeshtë nuk votojnë për programet politike, ata votojnë për të shkuarën e tyre dhe për interesin e momentit. Mungesa e alternativave të besueshme e bën zgjidhjen

e tyre shumë të lehtë dhe të justifikueshme.

Po ashtu, shumë njerëz e kanë një pronë e mbahen mbas asaj. Duke e pasur një jetesë relativisht të siguar, ata mbështesin njërën palë të parisë. Kjo është edhe sigurimi politik që ata synojnë të marrin. Biznesi në shtetin shqiptar funksionon vetëm kur je i mbrojtur nga *dikush* në strukturën politike. Po kështu, ia vlen që të përmendet edhe një anë tjetër e biznesit. Të gjithë bizneset e vogla e të mesme janë të lidhur me monopolet që kontrollohen nga paria. Shpeshherë, sukcesi i një biznesi në nivelin lokal garantohet nga lidhjet që ke në Tiranë. Dështimi garantohet nga humbja e këtyre lidhjeve.

Për këto shtresa, gjendja është e vështirë por e pranueshme, sepse, në një mënyrë ose në një tjetër, sistemi i patronazhit dhe i klientelizmit politik funksionon. Në thelb të funksionimit të sistemit klientelist është prurja e jashtëzakonshme e të ardhurave nga emigrantët. Duke qenë se ka për të gjithë, shumë nga pronarët e vegjël, mikroborgjezia, zanatçijtë, apo dyqanxhinjtë, janë të lumtur me arritjet e tyre ekonomike. Por, pjesën e luanit e merr paria. Gjendja bëhet problematike në sytë e dikujt vetëm kur konsiderohet ajo që nuk është bërë me burimet e me të ardhurat që pati shteti shqiptar gjatë tranzicionit. Ku kanë shkuar rreth 120 miliardë dollarë që kanë hyrë si para të pastra në atë vend? Nuk janë pak, por 120,000 milionë dollarë. Por, askush nuk e bën këtë pyetje. Kur e bëjnë, shqiptarët e gjykojnë parinë me metrin e tyre. Mendësia e tyre është se, po të ishin në vend të parisë, ata do të bënin të njëjtën gjë, do ta merrnin për veten e tyre.

Kjo na sjell sërish tek mendësia e popullit. Mendësia sunduese në shtresa të caktuara të popullatës është qartësisht mikroborgjeze, katundare e, në disa raste edhe lumpenproletare. Mirëpo, efekti i saj është ajo që ka rëndësi dhe ajo mendësi e frenon ndjeshëm veprimin kolektiv. Argumenti se sistemi i Enver Hoxhës e shtoi popullin shqiptar në tre milionë e ca është i saktë. Mirëpo, puna është se çfarë lloj njerëzish ishin e çfarë mendësie kishin? Mendësia e masave të gjera të asaj kohe ishte e mbështetur në disa parime që manifestohen edhe sot e kësaj dite e, bile, kanë kaluar nga një brez tek tjetri. Hajnia është nder, ligji është armiku

kryesor dhe të gjitha punët zgjidhen me të njohurit që ke e me forcë. Mendësia katundare e mikroborgjeze është sunduese në shoqërinë shqiptare.

Po ashtu, shkalla e shoqërisë qytetare është në nivele të ulëta. Si edhe është demonstruar nga Robert Putnam, nëse njerëzit nuk vetëaktivizohen në punët e bashkësive të tyre, ato bashkësi nuk do të funksionojnë si duhet. Mirëpo, në shtetin shqiptar, njerëzit nuk mendojnë aspak për të tërën, për të përgjithshmen, për bashkësinë, për shtetin, për të mirën e përbashkët. Njerëzit inkurajohen nga paria që të mendojnë vetëm për vete. Gjithkush e mat sjelljen e politikanit me metrin që mat veten. Dikur kemi pasur një shtet që ndërtoi 400 mijë bunkerë. Tash kemi një shoqëri që ka ndërtuar 400 mijë objekte pa leje. Pra, ai që ka grabitur pronën e tjetrit dhe ai që e ka ndërtuar hotelin e pallatin ku ia ka qejfi atij, nuk ka se si të merret me parinë që, po ashtu, mendon me urinë e kohës së konvikteve e të tallonave. Ai mendon se po të jetë në vend të parisë do të bëjë të njëjtën gjë. Ai e konsideron politikanin si veten, dhe shtetin si arën e kooperativës dikur e anasjelltas. Paria vepron në mënyrë shumë të stërholluar e me dinakëri, edhe pse janë të stërvitur për t'u sjellur në atë mënyrë. Kështu, edhe kur zgjedh që të mos veprojë, paria e shtyn shoqërinë në kriminalizim. Shembulli më i mirë është legalizimi i pronave. Duke e ditur se të gjithë kanë një problem me pronën, ose pse e kanë grabitur, ose pse e kanë ndërtuar pa leje, ose pse shteti nuk ua legalizon, paria nuk e bën legalizimin. Edhe pse shteti humb qindra milionë euro në vit, shumë që fare mirë mund të hynte në të ardhurat e shtetit prej taksave mbi pronën, paria nuk i legalizon pronat. Arsyeja është se frika e humbjes së pronës i mban njerëzit të lidhur me mbrojtësit e tyre politikë. Kjo sjellje përkethehet në legjitimim të sistemit kriminal të parisë.

Edhe pse ka dalë kashta mbi ujë, kjo nuk do të thotë se në shtetin shqiptar të gjithë mendojnë e sillen si lumpenproletariati, që sundon e bën ligjin në nivelin e shoqërisë, por që edhe e kontrollon edhe shoqërinë për llogarinë e parisë. Trysnia e ushtruar nga bandat dhe nga lumpeni shoqëror, shpesh janë të papërballueshme dhe prandaj, njerëzit e mbyllin edhe gojën. Ka shumë njerëz që

nuk pajtohen me gjendjen, e kuptojnë dhe e përjetojnë të keqen, sepse iu ka ardhur rradha të rrisin fëmijët e po e shohin se çfarë të ardhme do të kenë ata në sistemin oligarkik të parisë së Tiranës. Shqiptarët janë një popull që aspiron të jetojë me dinjitet, qofshin të ardhur nga malet e thepisura të Lunxhërisë apo nga fushat e Shkodrës, qofshin me shkollë të lartë apo pa shkollë fare. Këta e kuptojnë se shumëçka nuk shkon, mundohen të ndërtojnë jetën e tyre me nder, mirëpo nuk shfaqin fare shenja rezistence. Kësaj i shtohet edhe fryma mbytëse e krijuar nga paria, dhe dhuna e sofistikuar shtetërore. Po nuk u solle, të paktën formalisht, e në publik si ata, e humbet vendin e punës por edhe bukën e gojës. Gjërat janë lidhur lëmsh, si thonë korçarët, “janë kokolepsur keq fare” dhe askush nuk shfaq publikisht papajtueshmërinë me gjendjen ekzistuese.

Bashkëfajësia e shtypit dhe të mjeteve të informimit dhe të analistëve e komentatorëve, në këtë ndërmarrje kriminale është një faktor me peshë shumë të madhe dhe që nuk duhet nënvlerësuar. Opinionistët, komentatorët, dhe grafomanët e të gjithë niveleve, flasin e shkruajnë atë që kërkon paria, siç kërkon paria, dhe shtojnë përpara e shesin objektivat e saj. Shtypi dhe media janë instrumente të parisë, dhe në shërbim të hapur të objektivave të saj.

Një arsye tjetër duhet kërkuar tek mungesa e intelektualëve kurajozë e me vetmohim, të cilët të ngrihen e të organizojnë popullin. Ata intelektualë që hyjnë në politikë e që deri dje kanë qënë pjesë e parisë, e kanë kredibilitetin e humbur pa filluar. Të gjithë flasin me të njëjtat terma e me të njëjtën gjuhë, thjesht sepse mendojnë se, duke thënë atë që kërkon të dëgjojë populli, do ta marrin mbështetjen e tij. Mungesa e alternativave ideologjike ka çuar edhe në personalizmin e politikës, çka i intereson parisë, si dhe në dështimin e çdo zgjidhje e alternative tjetër.

Më shumë se çdo herë tjetër, kjo gjendje, që për popujt e tjerë do të ishte tragjike, u pa se ishte e përkeqësuar gjatë zgjedhjeve të fundit. Zgjedhjet e konfirmuan sundimin e parisë. Për arsyet e numëruara më lart, ato konfirmuan edhe mungesën e alternativave. Mirëpo, askush më shumë se vetë paria nuk është i/e vetëdijshëm

se për sa kohë sistemi do të jetë formalisht demokratik, sundimi i saj dhe sistemi oligarkik i saj janë të rrezikueshëm, e shpesh rreziku vjen pikërisht nga ato grupime e shtresa që sot duket se e mbështesin sistemin oligarkik me entuziazëm në mitingjet e radhës. Mjafton që të binden se ka një të ardhme tjetër më të mirë dhe se është me të vërtetë e mundshme, që të ndërtohet një e ardhme më e mirë dhe ndryshe.

20 VJET MBAS RËNIES SË MURIT TË BERLINIT: TRADHËTIA E MADHE

Edhe shqiptarët do ta përjetojnë rënien historike të Murit të Berlinit, si një moment historik. Por zhurmat që do të bëhen në mediat e shumta, nuk do të arrijnë që ta mbulojnë dështimin e gjithanshëm të eksperimentit që u luajt e që po luhet me shqiptarët. Tranzicioni shqiptar është përfundimisht i dështuar. Arsyeja është se shqiptarët janë futur në një rrugë pa krye. Eksperimenti që u luajt ne shtetin shqiptar ka krijuar një shoqëri të përçudnuar. Shqiptarët nuk e dinë se çdo të sjellë dita e nesërme. Kriza është gjithnjë vetëm një hap përpara. Me e thënë shkurt, kjo është kohë për reflektime serioze.

Pra, edhe pse do të jetë koha me reflektuar mbi këtë dështim historik, paria dhe veglat e saj, që formojnë opinionin shoqëror, nuk kanë me folë për këtë temën e dështimit të tranzicionit. Arsyeja është e thjeshtë. Në se nuk flitet për diçka, atëherë asgjë nuk ka ndodhur. Prandaj, ata do të flasin për gjithçka tjetër, por në veçanti, do të flasin për vendin e tyre në histori. Ata do të kallzojnë se si ia mbrritën të fisnikërohen, të bëhen pasanikë e ministra, si mbetën në krye të shtetit, kur të tjerët, që nuk u pajtuan me sundimin e tyre dhe u përzunë me një mijë mënyra e metoda, anatemohen sepse ikën dhe braktisën nga sytë këmbët, dhe “pa përgjegjësi” Atdheun, që, gjithsesi, ishte dhe mbeti pronë e parisë.

Nga ana e tyre, shqiptarët e tjerë, si ata që presin para nga mërgimtarët, ashtu edhe ata që janë të mbytur në hallet e tyre, po ashtu edhe gjysma e popullit shqiptar që jeton si krah pune, e rrënjëshkullur në mërgim, në shtete të huaja, nuk kanë kohë të merren me këtë gjë. Por ky moment nuk duhet kaluar kaq lehtë. Të

keqes që na ka kaplluar sot duhet t'i shkojmë deri në rrënjë. Rënia e Murit të Berlinit është një moment i rëndësishëm, real për disa, simbolik për të tjerët, por që të fton të vlerësosh edhe përvojat e tranzicionit, si dhe rrugën që u ndoq, ashtu edhe rrugë të tjera, që nuk u ndoqën.

Për disa, ky ishte momenti i dështimit të komunizmit si sistem shoqëror dhe projekt utopik. Për disa të tjerë, ky ishte momenti i shembjes së perandorisë sovjetike. Për disa të tjerë ishte fitorja e kapitalizmit. Për disa ishte rrëzimi i sistemit enverist dhe koha për hakmarrje. Për dikënd tjetër ishte mundësia me ikë nga shteti shqiptar. Megjithatë, një mënyrë me e vlerësue këtë moment është me e konsiderue si një mundësi historike që u humb.

Kriza e shembjes së regjimit diktatorial në shtetin shqiptar, si dhe shembja e njëkohëshme e sistemit titist në ish-Jugosllavi, e gjetën kombin shqiptar krejtësisht të papërgatitur me përballuar sfidat historike të transformimeve të gjithanshme, të kalimit nga një sistem tek një tjetër. Në veçanti, në shtetin shqiptar gjendja ishte tragjike. Në atë kapërcyell kthese historike, shqiptarët që jetonin në shtetin shqiptar kishin vetëm një synim: të gjenin një jetë më të mirë. Por, problemi themelor politik, që duhej zgjidhur e adresuar ishte çështja kombëtare shqiptare. Kjo diktohej nga situata ndërkombëtare.

Mirëpo, të kontrolluar me dorë të hekurt nga paria jeniçere për gati 50 vjet, shumica dërmuese e shqiptarëve synonte me ikë prej shtetit të tyre. Shumica nuk e kishin as vetëdijen, as përgatitjen, as dëshirën dhe, mbi të gjitha, as udhëheqjen politike, për të përballuar si duhet, me kompleksitetin e gjendjes politike të vendit, dhe me lojën ndërkombëtare. Mbi të gjitha, paria nuk e kishte vullnetin politik që të merrej me zgjidhjen e problemit ekzistencial të shqiptarëve, zgjidhjen e problemit kombëtar shqiptar. Paria nuk e pranonte rrugën e zgjidhjes së këtij problemi, që duhej të ishte ndërtimi i shtetit-komb, si rrugën që duhej të ndiqej. Në vend të synimit të gjetjes së kësaj zgjidhjeje, që duhej të ishte edhe rruga e shpëtimit të tyre afatgjatë, shqiptarët u futën në rrugën e ndërtimit të kapitalizmit oligarkik. Rruga pa krye të çon atje ku je nisë, thjesht sepse atje tek ai kryqëzim fillojnë edhe të gjitha

rrugët e tjera. Do të rifillosh atje ku, në fakt, duhej kërkuar zgjidhja qysh në fillim.

* * *

Në proceset e ndërtimit të shoqërive, fillesat janë gjithnjë shumë të rëndësishme. Nuk mund të thuhet se në fillimet e tranzicionit nuk ka pasur alternativa e se nuk doli kush me folë e me thanë se kjo do të ishte një rrugë pa krye, ashtu si edhe u vërtetua të ishte. Pa pikë modestie, dua të them se ka qenë një moment kur, në atë pikë kthese historike, ne që synonim të punonim për shtetin-komb, ta ndërtonim dhe ta vinim në shërbim të të gjithë shqiptarëve kudo që ishin, numëroheshim me gishtat e dorës. Për më tepër, në politikën shqiptare ne u trajtuam si armiq, si individë, që po pengonin lulëzimin e begatinë e shqiptarëve në rrugën “e pakthyeshme” të ndërtimit të kapitalizmit.

Secili më vete, por edhe të bashkuar, kur u krijua mundësia, ne jemi munduar të veprojmë. Ne nuk ishim pjesë e parisë, në asnjë nivel. Në fakt, në atë moment historik, ne vinim prej askundit. Por, vullneti ynë, koha e momenti historik, na e krijuan mundësinë të kthehemi në një zë të qartë e koherent në rrëmujën e fillimit të tranzicionit shqiptar. Aty ku ne shihnim shtete-kombe të fuqishme evropiane, kundërshtarët tanë, “intelektualët e shquar”, por edhe të tjerët, shihnim vetëm borgjezi e sisteme kapitaliste. Aty ku ne shihnim struktura që mbronin interesat e kombeve të tyre me thonj e me dhëmbë, kundërshtarët tanë shihnim struktura që mbronin interesat e shtresës sunduese. Aty ku ne shihnim deformime të demokracisë, kundërshtarët tanë shihnim sistemin që do t’ua garantonte sundimin oligarkik. Ne që besonim se e ardhmja mund të ishte më e mirë për të gjithë shqiptarët, u anatemuam në emër të interesave të parisë. Objektivi i përbashkët i parisë ishte me ndërtuar një sistem klasor. Në planin afatgjatë, sistemi do të ishte skllavërues, sepse ata do të ishin zotër e të gjithë të tjerët do të ishin skllavër të tyre.

Ne morëm rrugët e mërgimit dhe ata morën sundimin e shtetit. Tashti, më e pakta që mund të thuhet, është se ka ardhur koha

të pranohet se ne kishim të drejtë. Në politikë kjo nuk ka vlerë, sepse gjërat e proceset kanë ecur në kahje të tjera. Por, për ne, si qytetarë, kjo ka më shumë vlerë se gjithçka tjetër, në mos tjetër, sepse jemi njerëz në paqe me ndërgjegjen tonë.

* * *

Mendësia sunduese e parisë, në atë pikë kritike dhe e “intelektualëve të shquar”, ishte thuajse uniforme dhe monolitike. Shkaku për këtë ishin origjinat e njëjta, interesat që i ndanin si shtresë, afërsia e ngushtë dhe e pazgjdhshme në mendësi e në mbrutjen e tyre intelektuale, që i jepte karakterin konspirativ lidhjes, martesat, detyrimet shoqërore, përkatësitë klanore dhe ndjesia e armikut të përbashkët, e rrezikut të përbashkët dhe e nevojës së veprimit në grup.

Shumica dërmuese e njerëzve, me përjashtime të pakta, të përmendura më lart, bashkoheshin në një pikë. Kjo pikë bashkimi ishte ajo që në literaturë njihet si soteriologjia e të shtypurve. Në përpjekjen e tyre për t’iu kundërvënë një sistemi shoqëror e vlerash, që është shtypës e shfrytëzues, njerëzit idealizojnë një sistem vlerash që është e kundërta e atij sistemi. Kështu që, edhe pse dihej nga të gjithë se kapitalizmi ishte një sistem shfrytëzues, polarizues dhe që, pa një ndërhyrje të fortë të shtetit, do të çonte në rrugë të pakthyeshme të varfërimit e të ndarjes klasore, të gjithë e përqaftuan këtë mendësi. Zgjidhja e shqiptarëve u bë kapitalizmi që shihej nga televizioni italian.

Si atëherë, ashtu edhe sot, ajo mendësi është në thelb të hegjemonisë së parisë së Tiranës mbi shoqërinë shqiptare. Ajo mendësi i binte, dhe vazhdon me i ra ndesh realiteteve politike e sjelljes normale politike. Ajo mendësi, e mbështetur në besimin se duhej ndërtuar kapitalizmi, ka ushqyer dhe ushqen shpresa të paqena dhe ëndrra të pambrirshme, si tek paria ashtu edhe tek njerëzit e thjeshtë. Mungesa e realizmit politik e kësaj lloj sjelljeje bëhet edhe më e qartë kur shihet se nuk ka pasur fare qartësi në lidhje me gjendjen ku ishin shqiptarët, kur krahasohet me arritjet e shteteve të tjera dhe kur gjykohen mundësitë që kishim

e, sidomos kur diskutohet mbi rrugët që nuk i ndoqëm. Në mos tjetër, interpretimet e ndryshme të parisë, si dhe perceptimet e vlerësimet e të huajve në atë moment historik, tregojnë qartë se qasjet e parisë ndaj problemeve, kanë qenë shumë të ndryshme nga nevojat e shqiptarëve.

Qasja e parisë ka qenë qartësisht utilitare dhe në shërbim të interesave të saj të ngushta si shtresë. Paria e ka ditur se çka është kapitalizmi. Paria dhe intelektualët i kanë njohur mirë të gjithë patologjitë e një sistemi të njëanshëm, në të cilin tregu përcakton edhe marrëdhëniet shoqërore. Por, ja që ashtu i interesonte parisë. Nëse duhej vendosur kapitalizmi, atëherë kush, përveç tyre, duhej të ishte borgjezia? Nëse ata duhej të bëheshin borgjezia, si duhej që të fitonin pasurinë dhe të ruanin kontrollin mbi shqiptarët? Cilat struktura ndihmonin në mbrritjen e këtyre objektivave dhe në ruajtjen e sundimit të shtresës? Për të arritur këtë objektiv, paria ia shiti projektin e tranzicionit shqiptarëve edhe në nivel politik. Sllogani i ditës u bë thënia e një politikani që me cinizëm tha se duhet të veprojmë kështu sepse ... “nuk e mbajmë dot Amerikën me bukë.”

Pra, populli që kërkonte që t'i ikte gjendjes kritike e kishte gjetur zgjidhjen në idealizimin e të kundërtës së sistemit enverist. Paria kërkonte mbrojtjen e interesave të saj. Mirëpo, një nga mësimet që nuk duhen harruar është se politika është në plan të parë. Politika përcakton edhe marrëdhëniet ekonomike e shoqërore. Kështu, paria zgjodhi një objektiv politik që edhe pse ishte i paarritshëm, e mbante shoqërinë peng të saj, deri në vendosjen e në konsolidimin e një sistemi, që do të ishte në shërbim të interesave të saj si shtresë.

Kjo mungesë përputhshmërie në mes të interesave të parisë, lojës politike dhe të interesave të shqiptarëve, është shenja më dalluese e këtij tranzicioni. Ajo ka vazhduar manifestohet qartë edhe në objektivat e parisë gjatë gjithë tranzicionit. Kështu, tash shumë vite, objektivi politik i përcaktuar si “objektiv madhor” i tranzicionit është integrimi evropian. Mirëpo paria, të huajt dhe shqiptarët e shohin këtë objektiv nga këndvështrime të ndryshme. Për më tepër, të tre palët e kanë interesa të

papajtueshme me njëri-tjetrin.

Ku ishte problemi në kapërcyell të vitit 1990? Të huajt i shihnin shqiptarët si një komb që do të kërkonte bashkimin e, për shkak të konjunkturave ballkanike, si një problem të pazgjdhshëm politik. Nga ana e tyre, shqiptarët e shihnin veten si viktimë të gjithkujt. Shqiptarët që jetonin në shtetin shqiptar e urrenin shtetin e tyre amë dhe soteriologjinë e tyre, shpëtimin nga e keqja, e gjenin në ikjen nga shteti shqiptar. Një nga pasojat e rënda të sundimit të parisë së mëparshme ishte se shqiptarët në shtetin shqiptar nuk e kishin atë nivel ndjenje kombëtare, që t'i bashkonte natyrshëm me shqiptarët që jetonin në ish-Jugosllavi. Paria, që e kishte sunduar në shtetin shqiptar, trashëgimtarët e jeniçerëve dhe të martallozëve e bashibozukëve osmanë, nuk kishte pasur as edhe një pikë dashurie, por as edhe një grimë respekti, për shqiptarët si popull. Politika e saj afatgjatë kishte qënë zhveshja e shqiptarëve nga ndjenja kombëtare. Prandaj, paria e braktisi popullin shqiptar me lehtësinë e pritshme, në rastin më të parë që iu dha asaj. Paria u turr të mbronte interesat e veta, duke u përqëndruar tek ekonomia.

Mbi të gjitha, edhe interesat e të gjitha shteteve fqinje kërkonin që shqiptarët kurrë të mos e gjenin veten, dashurinë për kombin e tyre e rrugën që u duhej për të dalë nga kriza. Nuk ka pasur popull, që ka kenë aq i etur me e gjetë rrugën e duhur, si shqiptarët. Por tranzicioni ishte një zhgënjim. Edhe sot, 20 vjet mbas rënies së Murit të Berlinit, shqiptarët ende nuk e kanë gjetur rrugën e duhur. Në shtetin shqiptar ka miliarderë e lypsarë, ka luks e para, por nuk ka shpresë për të ardhmen, nuk ka besim në jetë e nuk ka qëllime fisnike, për të cilat ia vlen të jetosh e punosh ditë e natë, të jetosh e të vdesësh me stoicizëm. Me një shoqëri të mbërthyer për fyti prej kimit të organizuar, me një shtresë tregtarësh e prodhuesish krejtësisht të kontrolluar prej politikës, me një pari politike oligarkike e kriminale, me një prani të fuqishme e vendimtare të interesave joshqiptare, shqiptarët kanë arsye me kenë pesimistë për të ardhmen e tyre. Shteti shqiptar, në vend që të ishte një parajsë mbi dhe, sepse i ka të gjitha ato burime e të mira që duhen, është kthyer në një ferr për të gjithë shqiptarët, të cilët

kërkojnë të ikin një orë e më parë prej andej. Shteti shqiptar është kthyer në një gangrenë politike për të huajt dhe në një laborator eksperimentesh të dështuara të parisë alkimiste të Tiranës. Shteti shqiptar ka rënë pre e gjithfarë interesash të papajtueshme me interesin kombëtar dhe afatgjatë të shqiptarëve.

Natyrisht, ka shumë shkaqe pse gjendja është e tillë. Mirëpo, ndër të gjitha shkaqet, ai më kryesori, shkaku parësor i këtij dështimi kanë qënë intelektualët. Veçanërisht, ajo pjesë e tyre që u përfshi në politikë e në biznes, e lanë popullin shqiptar në baltë. Edhe nëse ata nuk ishin bash fajtorët për këtë gjendje ku jemi, ata ishin bashkëfajtorë të vetëdijshëm të parisë. Ata heshtën kur duhej të flisnin. Ata menduan për vete, kur duhej të shërbenin. Kur duhej të ruanin pasurinë kombëtare, ata u turrën ta vidhnin. Atëherë kur duhej të ishe më gjerë se jeta, intelektualët që hynë në politikë, menduan vetëm e vetëm për veten e për kuletën e tyre.

Intelektualët ishin fija e kashtës, për të cilën instinktivisht u kapën të gjithë shqiptarët, kudo që gjendeshin në shtetin shqiptar. Inteligjencia e tyre, d.m.th., shkrimtarët, mjekët, profesorët, doktorët, ekonomistët, apo inxhinierët ishin shpresa e tyre e vetme për me dalë nga gjendja e pashpresë. Paria e Tiranës nuk ka pasur e nuk ka dashuri për shqiptarët, sepse ndryshe nuk do t'i linte të përfundonin në atë gjendje, ku i gjeti shembja e Murit të Berlinit. Shqiptarët nuk kishin ku të mbaheshin. Populli u mbështet tek intelektualët, ashtu si mbështetet fëmija tek prindi, ose më mirë, si ata që s'kanë sy, mbështeten tek ai që ka një sy, qoftë edhe të shtrembtë. Besimi i njerëzve ishte se intelektualët do t'i shpëtonin. Ata që dinin, ata do të sillnin zgjidhjen dhe shpresën. Ata do të tregonin rrugën dhe do të mund të shpëtonin një popull, që nuk e dinte se çka ishte e mira e vet. Askush më mirë se paria nuk e dinte këtë gjë. Askush nuk u mundua, më me përkujdesje e vëmendje që të nxjerrë në krye të formacioneve politike pikërisht veglat e thyera, tashmë të transformuara në "intelektualë të shquar". Po ashtu, askush më mirë se intelektualët, që u vunë në krye të projektit të tranzicionit, nuk e dinin gjendjen e mjerë të shqiptarëve dhe nuk punuan me vetëdije për të mbrojtur interesat e shtresës, në të cilën edhe u kooptuan, anipse, shpesh edhe me

fërkime të ndjeshme.

Siç u demonstrua gjatë këtij tranzicioni e siç dëshmohet e shihet përditë, zvetënimi i pashembullt i parive të tyre intelektuale, tashmë të transformuara në udhëheqje politike e partiake, ia hoqi shpresën e fundit popullit shqiptar. Në veçanti, në shtetin shqiptar, intelektualët që hynë në politikë, u sprovuan të ishin edhe më keq se sa lumpeni i vetë shoqërisë prej kah vinin. Synimi i tyre kryesor ishte që t'i iknin objektivit e interesit kombëtar shqiptar, bashkimit të të gjithë shqiptarëve në një shtet. Lufta e tyre ishte me i kthyer shqiptarët në skllevër të proletarizuar, "të ndërtonin" kapitalizmin, ndërsa vetë të shndroheshin në borgjezi, me çdo kusht e me çdo çmim.

Kjo sjellje e intelektualëve tanë, kaq e ndryshme nga ajo e vendeve të tjera ballkanike apo e intelektualëve shqiptarë jashtë kufijve, e ka një shpjegim. Shumica dërmuese e tyre ishin e mbetën me mendësinë e konviktorëve të uritur. Ata nuk u ngritën mbi mentalitetin katundar, prej kah edhe vinin. Intelektualët që hynë në politikë, me pak përjashtime, në trojet shqiptare jashtë shtetit shqiptar, ishin e mbetën vegla të sistemeve e të klaneve sunduese, që i kishin formuar për interesat e tyre. Kur ato sisteme u shembën, edhe kur nuk mbetën shërbyes të klaneve sunduese, ata u kthyen në imitues të praktikave, të cilave iu kishin shërbyer. Kështu, tashmë të transformuar në pari e re sunduese, ata e kthyen thyerjen shpirtërore e sundimin e popullit në objektivin e tyre kryesor politik.

Kur iu dha mundësia, në veçanti këtyre të parisë së tashme të Tiranës, ata treguan se etja e tyre për pushtet dhe mosbesimi e urrejtja e tyre për popullin shqiptar e për gjithçka që e përcaktonte atë popull si komb, ishte e pakufishme. Në mos shumica dërmuese, pa dyshim shumica e tyre u turrën që të pasuroheshin dhe të shfrytëzonin çka mundnin nga shteti shqiptar e nga shoqëria shqiptare, me një etje dhe uri të pakufishme. Ata jetuan e jetojnë jetë përrallore, të paktën në krahasim me të tjerët, por gjithnjë duke e urrye e përbuzë popullin, pa asnjë farë mëdyshje. E përbashkëta e sjelljes të të gjithë atyre që dolën në krye të lojës është se, edhe kur ata nuk e urrenin deri në fund të shpirtit popullin prej të cilit

vinin, ata kishin një ndjenje neverie, por edhe frikë prej popullit. Aq e dukshme është kjo sjellje, sa edhe sot, asnjëri prej tyre nuk guxon me e përmendë diçka që e ka bërë në të mirë të shqiptarëve, sepse lista e krimeve nuk ka fund. Ka shumë argumente që provojnë se ata individë janë sjellë thjesht si vegla të dikujt, vetëm e vetëm pse kanë qenë të motivuar nga interesa të ngushta të shtresës së tyre.

Ky është edhe shkaku pse, 20 vjet mbas Rënies së Murit të Berlinit, shqiptarët janë në një qorrsockak historik. Në shtetin shqiptar kanë ndryshuar shumë gjëra, por kur konsiderohet e ardhmja, shqiptarët janë aty ku kanë qenë, sepse nuk kanë shpresën për të ardhmen. Ende sot, shqiptarët nuk e kanë vizionin se si me e ndërtue jetën si duhet, siç vepron çdo komb tjetër i qytetëruar. Mjerisht, lukunia e intelektualëve të interesuar vetëm për veten e tyre, ia mbrritti me dalë fitimtare dhe po ecën pa ndalesë në rrugën që ka zgjedhur. Pa hezitim, kjo ka qenë dhe mbetet tradhëtia më e madhe me të cilën është përballur kombi shqiptar gjatë këtij tranzicioni, që as nuk ka e as nuk do të ketë fund edhe për do kohë të vështira. Prandaj çdo shqiptar ka të drejtë të ndihet i tradhëtuar prej intelektualëve që u kthyen në politikanë. Kur populli i tyre priste që ata individë të bënin gjithçka mundnin për të mirën e popullit, ata u treguan se ishin njerëz të vegjël, që e braktisën popullin e vet.

Zgjidhjet e tyre do të ishin të ndryshme po qe se këto individë do të mendonin se për çka jeton një intelektual e për çka jeton një politikan. Pasuria e vetme që lë dikush është kujtimi në zemrën e njerëzve. Më i miri ndër ne nuk merr më shumë se dy metra dheu. Ka pasë raste kur njerëz të adhuruar si zotë sa ishin gjallë, prej frikës e urrejtjes së njerëzve, sot nuk i kanë as eshtnat në varr. Njeriu duhet të jetojë e të vdesë me shpresën se e ka fituar respektin e njerëzve të vet, me shpresën se dikur, dikush ka me ardhë me i pastruar varrin, me i lënë një tufë lule të vërteta e me e kujtue për një gjë të mirë. Gjithkush e ka një ferr brenda vetes, por lufta e intelektualëve të vërtetë është që me u ngritë mbi vogëlsitë e gabimet e jetës së tyre e me mendue se nuk ka gjë më të bukur e më të mirë se me jetue e me vdekë për popullin e vet. E po e them edhe unë, me një shprehje latine, se pse kështu është edhe

moda në Tiranë, *dulce et decorum est pro patria mori*, e ëmbël dhe e lavdërueshme është vdekja për atdhe.

Çdo komb arrin që në momentet e duhura me e gjetë fuqinë e me nxjerrë bij të tillë, që të mendojnë për të, dhe të sakrifikohen për të dhe mbas të cilëve të mblidhen të gjithë, sepse ata ia tregojnë rrugën popullit të tyre. Prandaj, ata jetojnë përjetë në kujtesën e atij populli. 20 vjet mbas Rënies së Murit të Berlinit, dështimi i gjithanshëm i tranzicionit shqiptar ka treguar fytyrën e vërtetë të parisë së Tiranës. Gjithashtu, dështimi i tranzicionit ka tregue se, edhe pse e kanë bërë gjoksin gropë, “intelektualët e shquar” të tipit Sali Berisha dhe Fatos Nano, por, mbas tyre edhe e gjithë paria e Tiranës, nuk kanë nxjerrë individë të tillë që t’u shkojë historia mbrapa, as deri në Vjenë.

MANIPULIMI I DASIVE POLITIKE: OBJEKTIV PARËSOR I PARISË SË TIRANËS

Një nga aspektet kryesore të jetës politike ku manifestohet kriza vdekjeprurëse e moralit në shoqëri është organizimi i konfliktit politik, ndarja *mik-armik* dhe manipulimi i paskrupullt i dasive politike nga ana e parisë së Tiranës. Në të gjitha shoqëritë e tjera që dolën nga sistemi i mëparshëm në perandorinë sovjetike, dasitë sunduese politike janë kthyer në rregullsitë e në shtratin tradicional. Gjithkund, njerëzit mbështesin parti e struktura, që janë të bazuara në katër dasitë tradicionale: besimin fetar, në identitetin kombëtar, në interesat materiale, apo në territorin e trevën. Shteti e kombi janë kthyer në qendër të vëmendjes dhe mbrojtja e interesit kombëtar është parësore për paritë e këtyre kombeve e shteteve ish-socialiste.

Dasitë janë natyrale e normale kur kategoritë janë gjinia, raca, gjatësia, peshja etj. Dasitë bëhen të rëndësishme kur përcaktojnë strukturën e bashkësisë si feja, etnia, gjuha, kultura e të tjera. Dasitë megjithatë bëhen politike kur njerëzit mobilizohen në bazë të një dallimi të tillë dhe luftojnë që të marrin kontrollin e shtetit.

Në këtë drejtim, në shtetin shqiptar ka ndodhur një paradoks i jashtëzakonshëm dhe i papërsëritshëm. Dasitë politike sunduese në kohën e tanishme në shtetin shqiptar janë identike me ato të periudhës së mëparshme. Edhe pse shoqëria ka evoluar në drejtime krejt të tjera dhe raportet shoqërore janë të ndryshuara radikalisht, dasitë politike janë të ngrira. Dasia kryesore, ajo që ua lehtëson shumë punën partive politike me marrë mbështetjen e njerëzve është ndarja në komunistë-antikomunistë. Sjelljet e individëve, lidhjet e tyre politike, besnikëria klasore e sociale, të

gjitha gjykohen përmes këtij këndvështrimi. Kjo gjendje polarizimi e kundërvënije ka arritur një nivel historie e ekstremizmi të tillë, që gjithkund tjetër do të ishte e frikshme. Mirëpo, kjo nuk është një dasi e natyrshme.

Dasia kultivohet dhe kontrollohet me kujdes nga paria e Tiranës përmes një numri mekanizmash që duhen vënë në pah. Polarizimi dhe kundërvënia është shumë e mprehtë dhe intensive në nivel të parisë. Por ndërsa paria e gjen gjuhën, polarizimi ekstrem i shoqërisë shqiptare është i qëllimtë. Si pasojë e këtij polarizimi të qëllimtë të parisë, vendi duket i përfshirë nga një luftë intensive klasash, që herë-herë duket shpërthyes dhe, që thuhet, e çon vendin në prag të një 1997-te të re apo të grushtit të shtetit. Mirëpo, kjo luftë është imagjinare. Paria e mban vendin në tension të përhershëm, vetëm se pse kështu i intereson asaj. Edhe pse shkohet deri në përplasje e vrasje në rrugë ndërmjet militantëve e mbështetësve, në mes të palëve të veta, paria nuk e ka përplasjen për së vërteti.

Një veçanti e kësaj lufte klasash imagjinare është se ajo nuk zhvillohet më nga shteti i manipuluar nga paria kundër popullit të vet. Tashmë, lufta zhvillohet nga të dy palët e parisë, për interesat e veta të ngushta kundër popullit dhe kundër vetë shtetit. Kjo përpjekje e pandalshme e parisë së Tiranës është një luftë e klaneve dhe të strukturave kriminale në nivel të shoqërisë, për kapjen dhe kontrollin e shtetit. Duke i përdorur masat e gjera të popullit, mbështetësit, funksionarët, militantët, por edhe familjet e këtyre kategorive, si armë mitingashe në përplasjen e tyre për pushtet, segmentet e parisë kanë krijuar një gjendje dramatike, që e ka paralizuar shtetin e që e ka mpirë edhe shoqërinë shqiptare. Mendësitë e perceptimet e këtyre dy grupimeve, që mbështesin njëri-njëri apo palën tjetër të parisë, janë të papajtueshme e diametralisht të kundërta.

Si hap i parë duhet thënë se dasitë në një shoqëri janë esenciale, kur bëhen dasi politike, d.m.th. kur ato përdoren me mobilizuar njerëzit në mbështetje të marrjes së pushtetit. Ka qenë e natyrshme që në vitin 1944, PKSH të mobilizonte njerëzit e thjeshtë kundër parisë sunduese, duke i shtyrë fshatarët e varfër

kundër të pasurve, punëtorët kundër prodhuesve e me rradhë. Ideologjia e saj e justifikonte një qëndrim të tillë. Ka qenë krim për me e përjetësue këtë luftë klasash për 45 vitet e ardhshme edhe për ideologjinë që thuhej se PPSH po e zbatonte në shtetin shqiptar. Po ashtu, në vitin 1990, ka qenë e drejtë me i mobilizue njerëzit kundër atyre që thonin se “bar hamë e parimet nuk i shkelim,” dhe që e lanë popullin në atë mjerim, që të gjithë e kujtojmë mirë. Ama, është krim që 20 vjet më vonë, të vazhdosh të mobilizosh njerëzit në emër të luftës kundër komunizmit, apo të ruajtjes së nderit të Partisë së Punës e të Enver Hoxhës. Komunizmi nuk ekziston, enveristët kryesorë janë bërë miliarderë dhe kapitalistë, dhe disa janë edhe në krye të shtetit.

Arsyeja pse ndodh kjo është se paria ka interesa të qarta. Çdo interpretim tjetër ia prish skemën e sundimit edhe në nivel të vlerave e të identitetit. Si në vitin 1944, ashtu edhe në vitin 1990, ashtu sikurse po ndodh edhe në vitin 2009, paria sunduese e Tiranës synon të njëjtin objektiv, anipse kësaj rradhe e paraqet të kamufluar në mënyra të ndryshme e me përbërje të ndryshme konceptuale e argumentative.

Cili është objektiv i parisë? Synimi i saj, në këtë pikë, është që me i shtye njerëzit që, me çdo kusht, ta gjykojnë veten, të shkuarën e tyre e të gjithëve ne, sistemet që kanë kaluar e përvojat që kemi pasur, si individë e si popull, por edhe parinë vetë të bazuar në një gjykim bardh-e-zi të marrëdhënieve shumë të ndërlikuara njerëzore e shoqërore, që zhvillohen në një periudhë të caktuar. Ky është interesi i saj i pandryshuar. Njerëzit ndryshojnë, por nuk ndryshojnë objektivat dhe paria e Tiranës, e cila, *plus ca change et plus e la meme chose*.

Jeta është e shkurtër, por politika që ndiqet në shumë raste është shumë me e shtrirë në kohë se jeta e një njeriu apo e një brezi. Mbështetja për parti të caktuara kalon edhe në breza. Por, në rastin shqiptar kjo nuk është normale sepse ka ndrruar gjendja. Prandaj, politika që ndiqet në shtetin shqiptar mbron interesat e parisë. Edhe pse fizikisht kemi pasur ndrrime në përbërjen e parisë, mendësia e parisë vazhdon me mbetë po ajo që ka kenë gjatë këtyre 100 viteve që kemi pasur shtet. Dhe,

në shtetin shqiptar, politika është arti i jetës. Trashëgimia e fortë bizantine, osmane, serbe, e ndoshta duhet me shtue edhe disa të tjera, e ka garantuar sundimin e hipokrizisë, mungesën e ndjenjës së kombësisë e të atdhedashurisë, për mos me përmendë këtu terma të tilla që karakterizojnë marrëdhëniet shoqërore në një shoqëri normale, si “ndershmëri”, “virtyt publik”, “dinjitet” e me rradhë.

Thelbi i lojës së parisë është me ruajtë e me kultivue dasitë shoqërore. Ky problem i dasive shoqërore e politike, të cilit kaq shumë i mëshon paria, si dhe ai i manipulimit të tyre të pandërprerë, janë paradoksi tjetër unik shqiptar që qëndron në thelb të dështimit të tranzicionit. Tragjedia e politikës shqiptare ilustron, më mirë se me gjithçka tjetër, pikërisht me këtë paradoks.

Paradoksi konsiston në atë që, ndërsa në sipërfaqe shoqëria shqiptare duket sikur ka mbetur e ngrirë në një mendësi që e ndan atë në dy grupe në enveristë e në antienveristë, realiteti është krejt tjetër. Shoqëria është transformuar rrënjësisht gjatë këtij tranzicioni. Grupe e shtresa të reja shoqërore, ose të formësuara ose në formim e sipër, janë të destinuar të luajnë një rol progresivisht e me të rëndësishëm në politikën shqiptare. Disa faktorë të tillë shoqërorë duhen mbajtur mirë parasysh në çdo analizim të tranzicionit dhe të rrugëve për zgjidhjen e problemeve të shumta, me të cilat përballemi e do të përballemi. Këto shtresa e grupime shoqërore, tashmë kanë e do të kenë rëndësi vendimtare në këtë proces, veçanërisht në të ardhmen e afërt.

Megjithatë, i shtyrë e i cytur nga paria, dhe nga zallamahia mediatike e propagandës partiake dhe e mercenarëve mediatikë të parisë së Tiranës, populli shqiptar po ecën në dy krahë të kundërta të rrugës. Po të vazhdohet të ecet kështu, përplasja është e paevitueshme. Me të vërtetë, është vetëm çështje kohe, para se plaga e malcuar të shpërthejë. Dhe e keqja është se, duke dashur ta shmangë urrejtjen e popullit prej vetes, paria e Tiranës qëllimisht e drejton atë urrejtje të mbështetësve të vet drejt pjesës tjetër të popullit. Asgjë nuk e ilustron këtë qëndrim më mirë se thënia e Sali Berishës në vitin 1995 gazetarit amerikan Peter Lukas (botuar

në librin e këtij të fundit) “mbas meje u baftë qameti.” Në qendër të interesave të parisë janë ata vetë si individë, mandej familjet e tyre, mandej klani që i mbështet. Të gjithë shqiptarët e tjerë janë mish për top në përplasjen e tyre.

Në thelb të këtij problemi kyç, të përplasjes së pandërprerë të popullit shqiptar për hir të parisë e në shërbim të interesave të saj, qëndrojnë sistemet e ndryshme të shpallura të vlerave të parisë. Njëra palë paraqitet si trashëgimtare e strukturës sunduese, me vlera socialiste e demokratike, kur në krye të saj janë disa nga njerëzit më të pasur të shtetit. Pala tjetër paraqitet si parti konservatore dhe e vlerave liberale, kur në fakt është një strukturë klienteliste e populiste. Këto etiketime sistemesh, si sisteme vlerash apo antivlerash, janë formuluar nga prijatarët e palëve të parisë që kështu kanë arritur të mbledhin grupin më të madh të mbështetësve.

E vërteta e pastër është se të dy palët i përdorin këto sisteme vlerash absurde për të fshehur e për të mbuluar mbrojtjen e interesave të tyre jetike në ekonomi, në përpjekjen për kontrollimin e shtetit, të sistemit të vlerave sunduese dhe të të gjithë shoqërisë. Kështu, Partia Socialiste drejtohet nga një kupolë mafiozësh, që kontrollojnë sektorë të caktuar e të rëndësishëm të ekonomisë, ndërsa krahu tjetër, PD, drejtohet nga familja e kriminalizuar e kryeministrit Sali Berisha. Militantët që mbështesin partitë e simpatizantët e tyre janë thjesht partizanë, tifoza, interesaxhinj, të paguar, shpesh edhe fundërrinat e shoqërisë. Mirëpo, këta që bërtasin më shumë, dëgjohen edhe më shumë dhe e kanë kapur vendin peng.

Në diskursin politik, por edhe më shumë në thellësinë e bindjeve të mbështetësve të tyre, dallimet në pikëpamje midis palëve të parisë së Tiranës janë të prekshme e krejtësisht të papajtueshme. Të dy forcat kryesore dhe satelitët e tyre nuk kanë interpretime të kundërta për rrugën që duhet të merret nga shqiptarët si popull, për zgjidhjen e problemeve bashkëkohore. Dallimi është se të dy palët kanë marrë pozicione të ndryshme lidhur me vlerësimin e së shkuarës së shqiptarëve nën sundimin e Enver Hoxhës dhe të parisë së Tiranës gjatë tranzicionit. Përplasia është për simbole, si

mauzoleumi i Enver Hoxhës, për figurat politike, për monumentet, interpretimin e historisë, lapidaret dhe lidhjet familjare të politikanëve të ndryshëm.

Mbështetësit e palëve respektive shohin anën më të keqe të së shkuarës së tyre tek të tjerët dhe prandaj janë të motivuar që të përplasen deri në fund. Por, matanë përplasjes së mbështetësve të tyre, paria ka mirëkuptimin e nevojshëm dhe segmentet e saj i ruajnë rrugët e komunikimit me njëri-tjetrin. Matanë gjuhës së helmatisur dhe thikës së shtrirë në publik, gjithnjë qëndron dora e shtrirë dhe oferta për të zgjidhur problemin. E shkuara është e manipulueshme deri në ekstrem, por sapo kalon kriza, ajo duket sikur harrohet. Sali Berisha thotë se është më socialist se PS dhe Edi Rama flet për kontributin e tij në lëvizjen demokratike.

Kjo është një pari që, përveç të gjithë elementëve të numëruar më parë, tashmë e bashkon interesi dhe krimi i përbashkët. Këta ia hanë mishin njëri-tjetrit, por kockën ia lënë. Pra, në sipërfaqe, e gjithë politika e sotme e parisë sillet e persillet rreth intepretimit të së shkuarës, rreth injorimit të së tashmes dhe heshtjes, apo mashtrimit të hapur, rreth së ardhmes. E vetmja mënyrë, që paria ka gjetur që t'i mbajë njerëzit të lidhur për strukturat e saj politike, është t'i bindë që ata kanë qenë të persekutuar në një periudhë ose në një tjetër.

Nga ana e saj, Partia Socialiste, Gramoz Ruçi e të gjithë rrotull tij, luftojnë me bindë "popullin e majtë", se ata kanë jetuar mirë në kohën e Enver Hoxhës. Përpjekja e tyre bëhet për t'i bindur se, militantët, mbështetësit por edhe fëmijët e tyre duhet t'ia dinë për nder PPSH-së. Gjithashtu, lufta e PS-së bëhet të bindë militantët se Sali Berisha është armiku i tyre për vdekje dhe se ata nuk mund të jetojnë mirë sot, pikërisht për shkak të Berishës. Nga ana e vet, PD e Sali Berisha, se, në fund të fundit, PD është Sali Berisha, lufton të bindë mbështetësit e vet, "popullin e djathtë", se ata kanë qenë "të persekutuar" nga sistemi i atëhershëm. Thelbi i argumenteve të këtij grupimi është se Saliu është Skënderbeu modern, që i ruan prej "balozave të zinj" të PS. Ata që ia mbrijnë ta përjetësojnë e t'i zgjasin jetën këtij polarizimi fals janë segmentet në shërbim të parisë. Përmes mjeteve të saj të informimit (shumica dërmuese

e gazetave punojnë për dikënd e shtyjnë një agjendë të caktuar), përmes strukturave politike (që janë vegla të përbera nga individë që e kanë një çmim të caktuar), zyrtarëve të pandershëm (që kanë hallin e vendit të punës), përmes intelektualëve (që janë shndrruar në tellallë të parisë), përmes manipulimit të figurave me një shkuar të dallueshme (e shumë po shiten për një çmim të caktuar), përmes përzënies e mbylljes së gojës së atyre që duan me thënë të vërtetën (që klasifikohen e përshkruhen me njëmijë mënyra jo të këndshme), paria ka arritur të krijojë një atmosferë surreale e, në të njëjtën kohë, tragjikomike.

Ndarja në *mik-armik* e shqiptarëve nuk i reflekton dasitë reale ne nivel të komunitetit (bashkësisë) e të shoqërisë civile. Dasitë kryesore janë të varfër-të pasur, Jug-Veri, dhe shqiptarë-joshqiptarë. Megjithatë, për shkak të kontrollit të hekurt të parisë mbi debatin e informacionin politik, kjo gjendje që i ndan shqiptarët në bazë të parimit mik-armik, përkufizon diskursin politik, vlerat, statusin, prestigjin, vendin që zë gjithkush në shoqërinë shqiptare. Kjo idiosinkraci, midis identitetit të vërtetë e atij partiak, ka krijuar një gjendje anormaliteti të theksuar.

Shoqëria shqiptare është e kapur në një moment çmendurie, sepse kjo dasi nuk ka kurrfarë lidhjeje me realitetin, apo me gjendjen tonë si shoqëri. Gjendja jonormale nuk lind nga shqiptarët, nuk pasqyron realitetin e vlerat e tyre, por është pjellë e mendësisë së parisë. Norma që ka dalë triumfuese në Tiranë dhe që e përcakton sjelljen e njerëzve në jetën publike, është se ne duhet të pranojmë se jemi ashtu si thotë paria. Gabimi i madh i shumë e shumë njerëzve është se ata e kanë pranuar pa diskutim se edhe si individë, ata kanë identitetin që paria u thotë se i përshkruan më qartë.

Duke bërë zgjidhje pragmatike, për një numër arsyesh të ndryshme, njerëzit zgjedhin midis dy argumenteve bardh-e-zi, sikur nuk kishin e sikur nuk ka zgjidhje e mendime të tjera. Argumenti sundues që ka përcaktuar sjelljen e shqiptarëve është, në dukje, i qartë. Edhe po të mos jesh antienverist, do të sillesh ashtu si thotë Sali Berisha e pisqolla e tij mediatike, Fahri Balliu, që mund të perifrashet kështu, "o 'popull i djathtë', nuk durohen dot

këta trashëgimtarët jeniçerë të Bllokut. Nuk durohen këta që erdhën me poture nga malet e thepisura të Toskërisë e na shkatërruan oxhakun apo kullën e zakonit. Nuk durohen komunistët, çunat e Enverit e të Stalinit që bënë të 99-tat, dhe që janë bërë vegla të imperializmit serb e grek". Çdo veprim e sjellje e drejtuesve të këtij krahu të parisë e ka veshjen simbolike të kundërvënies regjimit "komunist". Të gjithë simbolet e sistemit të tyre duhen shkatërruar me rrënjë. Ky bëhet kali i betejës i PD-së.

Nga ana tjetër krahu, tjetër i parisë e vesh argumentin e vet me kundërvënien ndaj Sali Berishës, që është kthyer në gogol për militantët e PS. Edhe po të mos jesh enverist i thekur, po nuk e durove dot Sali Berishën, do të shkosh mbas Gramoz Ruçit. E argumenti është pak a shumë i ngjashëm, "o 'popull i majtë', nuk durohet ky maloku i Vicidolit. Nuk durohen reaksionarët e ballistët. Nuk durohen malokët dhe çeçenët e veriut, që i vunë kazmën asaj që ishte ndërtuar nga ne, nga partia e nga Komandanti dhe që janë bërë vegla të imperializmit serb e grek". Natyrisht që që të gjithë këta pjestarë të parisë, edhe prijatarët, janë vegla në duar të interesave të shtresës, anipse instrumente të lara me ar. Megjithatë, duhet thënë se qëllimi i mjetit përcakton edhe vlerësimin. Lopatën laje sa të duash me ar, lopata po lopatë mbetet.

Po pse ngjasin këto gjëra e pse përdoren këto argumente absurde në politikë? Problemi është se nga ana e njerëzve të thjeshtë nuk ka gjykim të ftohtë. Nga njëra anë, shumë nga njerëzit aq dinë e aq bëjnë, sepse deri aty janë të aftë me mendue. Ka shumë padije dhe, për këtë shkak, këto bindje kanë zënë rrënjë në mendjen e njerëzve. Po ashtu, kur vjen puna me zgjedhë midis jetesës e së vërtetës, njerëzit mendojnë për bukën e përditshme. Ata ose heshtin ose pajtohen sa për sy e faqe me atë që thuhet nga ajo palë që iu jep një kafshatë buke. Por ka shumë që e ndjejnë përkufizimin e dhënë nga segmenti respektiv i parisë si real. Ata ose kanë jetuar më mirë gjatë kohës së sistemit enverist ose kanë vuajtur shumë. Mendësia e tyre është e ngrirë në kohë dhe frika e kthimit të gjendjes, apo ndjesia e urrejtjes për tjetrin, *armikun*, kultivohet me kujdes.

Nga ana tjetër, ajo çka e bën të pamundur gjykimin e ftohtë të

njerëzve, është edhe fakti se analistët, opinionistët dhe vlerësuesit e ndryshëm ende nuk e kanë objektivitetin e duhur. Disa analistë turren që të bëhen apologetë të një grupi të caktuar. Disa analistë të tjerë nuk arrijnë që të shkëputen nga përvojat personale e familjare dhe t'i analizojnë me ftohtësi proceset e kaluara. Disa të tjerë sillen në mënyrë arriviste për përfitime personale. Pasoja është se një shumicë e madhe e popullsisë i ka pranuar shpjegimet e parisë dhe identifikohet me to. Paria ka synuar që ato identitete të bëheshin përcaktuese. Dhe, në fakt, identitetet e stisura prej parisë janë bërë përcaktuese për identitetin e shumë njerëzve.

Vendet ndërrohen, kur vjen çështja e trajtimit të këtyre grupeve, gjatë tranzicionit. PS mundohet t'i bindë mbështetësit e vet se ata janë të persekutuar nga Sali Berisha, por nuk e japin një cent nga perandoritë ekonomike që kanë ndërtuar. Nga ana e tij, Sali Berisha mundohet të paraqitet si mbrojtësi i ish-të-përndjekurve. Berisha e paraqet veten si njeriu që i mbron dhe i shpëton të përndjekurit nga komunistët, pronarët nga zaptuesit e pronës, monarkistët nga armiqtë e tyre republikanë e me radhë. Mirëpo fjalët e tij nuk kanë vlerë, sepse në realitet ai vazhdon duke e çuar vendin e shtetin pikërisht atje ku u intereson këtyre armiqtë të tij. E kështu vazhdon loja e parisë së Tiranës, "shaju ditën, puthu natën." Por, të dy palët ruajnë me kujdes interesat e shpinën e njëri-tjetrit. Nga ana e tyre, shqiptarët vazhdojnë që të mos e jetojnë jetën normale që meritojnë.

Pra, përplasja midis dy palëve të parisë është reale, por jo vdekjeprurëse. Ata i kalkulojnë mirë veprimet e tyre, ndërsa gjendja duket e nderë dhe përjetohet dramatikisht vetëm nga njerëzit e thjeshtë. Lojtarët kryesorë të parisë merren me njëri-tjetrin në mënyrë racionale, ia dinë pikat e dobëta njëri-tjetrit. Ata, përdorin teknika të njohura për të ndërtuar e për të mbajtur dasi artificiale politike, që në Tirane kanë qenë tejet të suksesshme dhe, faktikisht, i kanë izoluar të gjithë ata që mund të flasin kundër parisë. Teknika është e thjeshtë. Kundërshtari paraqitet sikur i përket palës tjetër. Mandej fillojnë sulmet në media. Sapo të fillojë tam-tami në media, mbështetësit respektivë që lexojnë vetëm një gazetë, dhe shohin faqen e parë dhe titujt

në emisionin e Bashkim Hoxhës, krijojnë një bindje të caktuar për persona, politika e interesa. Kjo është pikërisht ajo që do kryetari i partisë respektive, që ata të besojnë se është realiteti.

Paria nuk e bën luftën me kundërshtarët e vet për t'i zhdukur. Ajo kërkon vetëm t'i paralizojë e t'i bëjë inefektivë, me gjuhën e tyre "t'ia heqë gjarpërit dhëmbin". Sa kohë që njerëzit nuk janë në lojën politike, sa kohë që nuk janë të rrezikshëm, sa kohë që ata nuk flasin, sa kohë që ata shiten e blihen, sa kohë që tremben për vdekje nga shantazhi e nga kërcënimi, atëhere janë punët mire. Vetëm ashtu paria mundet të vazhdojë të vjedhë si i do qejfi e pa frikën e ndëshkimit.

Përppjekja e tyre themelore është që të mbajnë bashkë tufën e mbështetësve të tyre dhe të mos e lënë të shohë dritën e ditës, të mos merret me të të vërtetën e as të mos e kuptojë se cili është interesi i tyre real e jetik si qytetarë e si shqiptarë. Dhe, çka është më e keqja, përditë e më shumë, ata e shohin veten si çobanë të "kopeve" të mbështetësve e popullin shqiptar, si bagëtitë e tyre. Duke dashur t'i mbajnë "kopetë" e tyre bashkë, ata mundohen që t'i vulosin të gjithë njerëzit si kundërshtarë apo mbështetës të dikujt, t'i përçajnë e t'i izolojnë, t'i trembin me "gogolin", apo duke imituar ujkun. Kush nuk është me njërën palë *ipso facto*, është armik dhe është me palën tjetër. Figurativisht, instrumenti që përdoret për të mbajtur tufën bashkë nuk është më zagari i stanit, por gazetarët, televizioni, radioja, si dhe mercenarët e tjerë të shtypit të përditshëm që shiten si analistë. Dhe natyrisht, në nivelin shoqëror, shpifja e thashethemet janë instrumenti i preferuar i parisë.

Kohët e vështira që po kalojmë duhet me na shtypinë reflektim, pa pasione e me kujdes, mbi të shkuarën tonë të vështirë, si dhe mbi rolin që kanë luajtur brezat e mëparshëm në historinë tonë. Si duhet ta trajtojmë brezin e atyre që hynë në politikë gjatë Luftës së Dytë Botërore e që vazhduan të jenë aktivë edhe mbas përmbysjes së sistemit partishtet? Si duhet ta trajtojmë kontributin e tyre? A luajtën ata një rol pozitiv apo negativ? Si duhet t'i gjykojmë ata e sjelljen e tyre, si gjatë Luftës ashtu edhe më pas? Pse duhet të shohim botën bardh e zi, ashtu siç do dikush sot në politikën

shqiptare? Pse duhet me i nda shqiptarët në krahët në të cilët ata u ndanë gjatë Luftës së Dytë Botërore?

Jeta e askujt, e lëre më jeta e tre brezave, nuk është e nuk mundet të jetë e as me u përshkrue bardh e zi. Historia mund të shkruhet prej atyre që zgjedhin se si me i përshkrue ndodhitë e ngjarjet, por e vërteta e madhe historike mbi një periudhë të vështirë, duhet me u thënë me ndersmeri. Shqiptarët nuk kanë qartësi për të shkuarën e nuk janë të shkëputur nga rrjedha e zhvillimeve historike që i kalojnë caqet e shoqërisë sonë. Atëherë e vetëm atëherë, kur të kemi një kuptim të qartë të historisë sonë e të rrugës që kemi shkelur për të ardhur deri tek këto përvoja, do të gjejmë shpëtimin nga e keqja që na kaplluar dhe nga politikanët, që na mbajnë të lidhur për vuajtjet tona. Këta e kanë synimin e tyre parësor që me na mbajtë peng dhe të lidhur për gjykimin e së shkuarës, sepse e dinë mirë që ngrirja e mendësisë dhe e interpretimit historik nuk na lë as me shikue mundësitë që kemi përpara. Kjo është zgjidhja, që të gjithë duhet të kërkojmë e që disa po e kërkojnë me ngulm. Kjo është zgjidhja që kaq shumë dëshirohet, e që duhet me luftue me e gjetë.

Kur të kuptojmë vetveten, kur të kujtojmë realisht të vërtetën dhe një pjesë e madhe e së vërtetës tonë është çka ndodhi gjatë Luftës së Dytë Botërore, do të kuptojmë edhe se cilët jemi e se cilën rrugë na duhet të marrim, që të mbrijmë atje ku duhet, për të qenë njerëz normalë, ashtu si ëndrrojme të gjithë.

Historia ka ndodhë, ndërsa historianët përshkruajnë çfarë ata mendojnë se ka ndodhur. Dhe politikanët shohin vetëm atë që iu shërben atyre. Por historia që ka kaluar, ka ndodhë një herë. Ajo as nuk zhbëhet, as nuk mund të përsëritet më. Çudia është se në vend që të japin gjykime të drejta e të paanshme, gjykimet që janë dhënë e që po jepen për historinë gjatë këtyre mbi-20 vjetëve të shkuara janë në shumicën dërmuese bardh-e-zi. Çka është edhe më keq, disa shkrues, të ashtuquajtur analistë, komentatorë e të vetëquajtur historianë, herë të shtyrë prej padijes e më shumë prej interesave të parisë, e kanë shtrembëruar historinë si kanë dashur ata. Ata që janë në shërbim të parisë, e cila synon që ta përdorjë të shkuarën për qëllimet e veta politike, eliminojnë çdo

pikë kontributi që mund të ketë kundërshtari i tyre.

Përpyekja e ime këtu është të nënvizoj, se edhe nata më e zezë nuk është aq e zezë sa paraqitet, thjesht se e ka një yll dikund që shndrit. Dasitë e një kohe, nuk duhet të përcaktojnë realitetin e një tjetre. Edhe dita ma e bukur, në fakt është natë, por edhe ajo e ka një yll që ne e njohim si diell. Edhe këta njerëz që gjykohen se kanë bërë aq shumë të këqija, dikur e dikund e kanë bërë një të mirë. Duhet me të jemi të drejtë dhe t'u dhanë hakun. Ne duhet t'i japim Qezarit, atë që është e Qezarit, dhe të drejtës atë që është e të drejtës.

Fajtoje e jashtëzakonshme për gjendjen e për dasinë e krijuar e të kultivuar është media. Mendimi i im është, se argumentet e njëtrajtshme mbi këtë subjekt që dalin përditë në shtypin shqiptar janë të gabuara, tendencioze, dhe shumë të dëmshme politikisht. Më e pakta që mund të bëjmë është të hedhim një hije dyshimi mbi argumentet e ngrira, por tashmë sunduese në gjykimin e njerëzve e të parisë së atjeshme lidhur me identitetet e dasitë sunduese në shoqërinë e dikurshme e të sotme shqiptare. Më e pakta është që të bëhemi të vetëdijshëm, si me shkaqet e gjendjes e me burimin e problemeve, me të cilat përballemi, ashtu edhe nevojën për të gjetur rrugën e duhur e për të mos gabuar edhe një herë tjetër.

Mirëpo, kërkimi i së vërtetës historike dhe vetëdijësimi i njerëzve është një problem i madh. Me kërkue të vërtetën, do të thotë me i hedhë hijen e dyshimit dhe me i vënë një pikëpyetje të madhe përpyekjes titanike e sistematike të parisë të Tiranës, për të ruajtur dhe kultivuar me kujdes këto dasi politike të rreme. Mirëpo, segmenti kryesor që e kundërshton çdo ndryshim janë individët, që gjenden në krye të partive politike, eksponentët e vërtetë të parisë. Dhe objektivi parësor i tyre mbetet krijimi e kultivimi i dasive. Në shtetin shqiptar ose je "demokrat" ose "socialist". Ky polarizim është i gënjeshtërt e fals, sepse nuk reflekton, në asnjë mënyrë e në asnjë nivel, marrëdhëniet e sotme ekzistuese në shtetin shqiptar. Realiteti mund të shihet me syze, por nata është e terrtë dhe dita është ditë sepse ka dritën e diellit. Duhet t'i heqim syzet e parisë e ta shohim veten ashtu si jemi dhe atëherë do të fillojmë të kuptojmë ku jemi.

ELIMINIMI I KUNDËRSHTARËVE POLITIKË: DISA METODA KONTROLLIMI TË SISTEMIT NGA PARIA

Shoqëria e sotme në shtetin shqiptar është në një krize të thellë e të gjithanshme morale që, në dukje të parë, duket pa gjasa shërimi. Shteti është i kapur, paria është e korruptuar, administrata është e kriminalizuar, shoqëria civile është e paralizuar dhe ekonomia është e bazuar në shërbime e në shitblerje. Çka është më e rëndësishme, shoqëria është moralisht e ç'orientuar, pa vlera të përbashkëta, e përçarë dhe e thërmuar. Shoqëria shqiptare nuk sheh zgjidhje. Zgjidhja duhet të vinte nga intelektualët me integritet dhe kundërshtarë të parisë, që duhet të punonin për popullin e tyre kundër projektit të parisë sunduese. Mirëpo, në Tiranë nuk gjenden më intelektualë me integritet, që t'i kundërvihen parisë.

Efikasiteti i parisë në zbatimin e projektit të saj shihet qartë në shterpësinë e vlerave morale. Të gjitha zgjidhjet që mund të ofrohen duhet të kenë një themel moral dhe duhet të jenë të pranueshme nga grupe të caktuara. Paria nuk lejon as formulimin e modeleve që ofrojnë zgjidhje dhe as formësimin e grupeve, që mund të ofrojnë zgjidhje lidhur me rrugët që duhet të ndiqen e me zgjidhjet e përshtatshme për të dalë nga kriza. Kjo mungesë e moralit të duhur, e etikës publike, e intelektualëve dhe e grupeve që mendojnë për të gjithë shqiptarët, ka krijuar përshtypjen mbytëse se ai vend është i pashpresë dhe i dënuar që të mbesë në këtë qorrsokak. Niveli i diskursit politik është mjeran, materializmi është sundues e rampant, zvetënimi moral i parisë është i prekshëm dhe ka dalë krejt sheshit, mungesa e alternativave dhe mosbesimi në alternativat ekzistuese kanë krijuar një boshllëk të jashtëzakonshëm vlerash.

Për të zbërthyer gjendjen, duhet kuptuar mirë mekanizmi përmes të cilit paria ka arritur që të vendosë një sistem shterpë në vlera dhe që gjen kaq pak kundërshtime politikisht të mirëorganizuara nga shoqëria. Në të gjithë sistemet e tjera, paria ose i koopton intelektualët dhe prijatarët e grupeve që ia rrezikojnë pushtetin, ose i lufton me të gjithë mënyrat dhe metodat e ndryshme. Në rastin shqiptar, ndiqen po këto dy rrugë. Por paria përdor një numër metodash të sprovuara, që janë të lidhura, para së gjithash me mendësinë katundare të popullsisë dhe me të shkuarën specifike të shoqërisë shqiptare.

Në një vend ku shteti ka qenë njëherë e për kaq shumë kohë krejtësisht i plotfuqishëm, lidhja me shtetin ka qenë jetike për grupe e individë, në luftën e mbijetesës. Ai ka qenë sistemi; njerëzit nuk kanë njohur botë të tjera dhe në atë sistem janë përpjekur të gjejnë zgjidhjet e problemeve të tyre jetike. Kanë bërë kompromise, janë ndërjerë keq, kanë qenë të instrumentalizuar prej shtetit, por kanë mbijetuar. E shkuara e tyre, që dikur është dukur krejt normale, tash është kthyer në armën që i mban peng. Nuk ka rëndësi se të kujt, të krimit të PS-së ose peng të krimit të PD-së. E kështu, njerëz që mund të ishin shqiptarë të mirë, qytetarë të mirë, zyrtarë të aftë, njerëz me botë, njerëz që kanë dashtë një jetë më të mirë, më të ndershme, me shpresë e me dinjitet, janë shuar në heshtje e janë tretur e po treten në harrim. Këta të mjerë janë varrosur së gjalli në të shkuarën e tyre. E varrmihësi ka qenë paria e Tiranës. Ajo i mban peng me të gjithë mënyrat e mundshme, me të shkuarën, me bukën e gojës, me kërcënime të nderit, me shpresa boshe e, natyrisht, me shpifjen, etiketimin dhe mërgimin.

Thelbi i shpjegimit të teknikës dhe i suksesit të parisë qëndron në manipulimin e mendësisë katundare. Në bashkësinë katundare krimi nuk është krim sepse shkelet ligji; krimi bëhet krim kur shkelen normat shoqërore katundare. Prandaj, edhe të gjithë individët që i kanë shërbyer shtetit dhe ligjit në sistemin e mëparshëm janë automatikisht të kriminalizuar. Në bashkësinë katundare shteti është armiku. Mirëpo, shteti i mëparshëm nuk kishte se si të kontrollonte shoqërinë, përveçse përmes njerëzve që ishin pjesë e asaj bashkësie. Prandaj edhe figura më e urreyer

publike dhe më e anatemuar nga ana e bashkësive katundare është informatori me pseudonim. Informatori është pjesë e bashkësisë dhe prania e shtetit në bashkësi.

Nga ana e vet, paria e sistemit të vjetër nuk kishte pse të bëhej informatore, sepse ata ishin truri i sistemit. Edhe kur kishte trysni për t'u bërë informatorë, familjet ndërhyjnë dhe ajo çështje mbyllet pa zhurmë e pa bujë. E shumta që mund të bënte, një njeri i lidhur fort me sistemin ishte të dilte dëshmitar në gjyq. Kjo ndodhte për raste flagrante. Sistemi nuk i nxirrte informatorët e vet dëshmitarë, sepse kishte investuar shumë në ta dhe i duheshin për shumë kohë.

Paradoksi i kësaj gjendje është se njerëzit më të larë e më të pastër moralisht para bashkësive katundare kanë dalë ish-drejtimesit e sistemit dhe pjestarët e familjeve të parisë. Kjo shpjegon edhe faktin që sot figurat kryesore në lojën politike janë të gjitha të lidhura me parinë. Shtresat që duhej të sillnin shpëtimin e popullit, ata që duhej t'i kundërviheshin parisë ishin të stigmatizuar dhe të përdorur. Në një mënyrë ose në një tjetër, të gjithë kishin dosje. Dallimi midis Zyrës së Kuadrit e Sigurimit të Shtetit nuk ishte fort i theksuar. Kështu paria, tashmë e zgjeruar me "intelektualët e shquar", përdor teknikën e kulaçit dhe të kërbacit. Në se individi pranon që t'iu shërbejë interesave të parisë dhe prijtarëve, atëherë nuk i hapet dosja dhe nuk tregohet se çfarë të shkuare ka pasur ai individ, veçanërisht në bashkësinë katundare, reale apo të imagjinuar ku e ka gjetur veten.

E kundërta ndodh në se individi del kundër parisë. Atëherë paria hap dosjet që janë e ruhen me fanatizëm, si arma më e fuqishme bërthamore. Individit kundërshtar të parisë i numërohen të gjitha. Objektivi është diskreditimi publik dhe stigmatizimi në mendësinë e katundarëve militantë të partisë respektive dhe në opinionin publik. Teknikat shkojnë nga shantazhi tek nxjerrja e dosjes në faqen e parë të gazetës. Individu që ka kryer krimin e pafalshëm të shërbimit të shtetit kundër bashkësisë, pavarësisht se cili ka qënë regjimi, e ka "humbur fytyrën" dhe statusin në shoqëri. Në atë moment atij i rrezikohen të gjitha, puna, lidhjet shoqërore, stabiliteti familjar, ekonomia dhe mundësitë e jetesës

për fëmijët. Obsesioni i shqiptarëve me informatorin është unikal dhe shtrihet deri në periudhën e formimit të shtetit. ‘Spiuni’, ‘fuksi’, ‘800 lekshi,’ janë figura të urryera. Mirëpo, askush nuk e quan për turp spiunimin që bëhet në kohën e sotme. Ndoshta sot më shumë se kurrë, shoqëria është e mbuluar nga një rrjet i pasur informatorësh e spiunësh, njëlloj vullnetarë, si ata të regjimit të mëparshëm.

Në se intelektualit thytet, atëherë, paria zgjedh edhe rrugën tjetër të rikooptimit. Katarsisi i vërtetë për shumë prej këtyre individëve që mund të bënin ndryshimin është rikthimi në masën e militantëve përmes duarve të prijatarit të partisë. Kur diskreditohesh në bashkësinë e militantëve, vetëm prijatari mundet të të kthejë në lojë. Atëherë nuk ke më dinjitet, por je thjesht një vegël në duart e tij. Titujt, rrogat, gradat, ofiqet dhe lavdërimet janë të përkohëshme dhe mjeti përmes të cilit bëhet ky pakt mbijetese “me djallin”. Ky nuk është pakt faustian, sepse asnjëri prej tyre nuk po bëjnë gjë për të mirën e shqiptarëve.

Në lidhje me njëri-tjetrin, duke e respektuar paktin e moshapjes së lojës në drejtime të tjera, paria përdor sulmet *ad hominem*. Çdo gjë që nuk është e pranueshme për mendësinë e bashkësisë katundare bëhet objekt stigme publike i pjestarëve të parisë. Fotografitë kompromentuese, dokumentet e divorcit, problemet mendore, veshja, ushqimet, dashnoret, sekretaret, dashnorët e familjes, fusha e specializimit, investimi i familjes, rrahja e gruas me kapak tenxhereje me presion, martesat në familje e gjithçka tjetër. Elementi më i rëndësishëm i sulmit ndaj njëri-tjetrit janë veset. Ky është edhe sulmi më i lehtë, sepse në Tiranë nuk gjen kënd që është në politikë pa një listë të gjatë vesesh. Po nuk pate vese, po nuk u solle si njeri me vese, nuk gjen dot vend në shoqërinë e parisë së Tiranës. Pisqollat mediatike të të gjithë llojeve e tipeve, siç është bie fjala, Fahri Balliu, janë të stërvitur në këtë profesion dhe kanë bërë shumë armiq të betuar, por që duket se po presin me durim kohën dhe rradhën e tyre.

Aty ku nuk gjendet ndonjë pikë e dobët dhe ku nuk punon shantazhi, paria përdor shpifjen. Mekanizmi i shpifjes që përdor paria e Tiranës është shumë i sofistikuar. Teknika e saj e preferuar

është denigrimi dhe izolimi i kundërshtarëve nga bashkësia që duhej t'i mbështeste. Për shkak se njerëzit nuk mund të dinë se çfarë ka ndodhur në të vërtetë, ata bien lehtësisht pre e insinuatave dhe shpifjeve që dalin nga fabrikat e segmenteve respektive të parisë, sepse në fund të fundit, "e tha edhe gazeta" në emisionin e mëngjezit. Në një shoqëri ku ka gati 70 vjet që nuk është marrë vesh se ku ka filluar e vërteta dhe ku fshihet lepuri i mashtrimit, ku besimi tek lajmi fillon e mbaron tek personi që e përcjell e jo tek vlerësimi i fakteve, ku thashethemet trajtohen si e vetmja rrugë me marrë vesh të vërtetën, shpifja është instrumenti i zgjedhur dhe i preferuar. Shpifja ka qenë ngritur në art në sistemin e mëparshëm. Dhe paria e Tiranës e ka përdorur dhe po e përdoron shpifjen me efikasitet të jashtëzakonshëm, për të denigruar, izoluar dhe eliminuar të gjithë kundërshtarët e saj. Mbi të gjitha, paria e Tiranës e ka përdorur shpifjen për të ruajtur ndarjen artificiale politike në mbështetës e kundërshtarë të segmenteve sunduese të saj. Shpifja është mjeti i preferuar për të manipuluar dasitë politike dhe për të marrë legjitimitetin nga mbështetësit e parisë.

Një nga instrumentet e tjera më të përdorura është dëbimi dhe mërgimi i detyruar i kundërshtarëve. Nuk ka rëndësi në cilin grup janë kundërshtarët e parisë. Në momentin që ata ikin nga shteti shqiptar, ata nuk janë më pjesë e lojës politike dhe kalojnë në harrim. Mendësia e parisë edhe këtu është kaptundare, dhe funksionon sipas parimit, "a ke lugë ti?" Po pate lugë, "je në tavë," d.m.th. po ha nga ai sahan ku duhet të hajë paria dhe prandaj do të sulmohesh. Në këtë luftë rreth sofrës, ka shumë njerëz që janë dorëzuar. Trezultati tragjik i luftës për të fshirë me çapë "tavën e dheut" është që sot ka më shumë shqiptarë të edukuar që mund të jepnin shumëçka për shtetin e tyre, por që janë jashtë vendit e që nuk duan as të marrin e të japin me parinë që është në krye të shtetit.

Paria sunduese e Tiranës e ka ngritur një shkallë më lart se ka qenë në sistemin e mëparshëm artin e etiketimit të kundërshtarëve dhe shkatërrimin e figurave politike. Në momentin që dikush thotë të vërtetën, ajo e vërtetë kalon në filtrin e interesave të parisë, të segmentit të interesuar të saj dhe të gardianëve të interesave të saj

në shtyp e në media. Po qe e pranueshme, për njërën palë, lejohet të kalojë. Por, në momentin që dikush nuk pajtohet me krimin që po ndodh në shtetin shqiptar, ai duhet të paraqitet si persekutues i kopesë që i shkon mbrapa kryetarit të rradhës, me lajtmotivin, “ky është ujk i veshur si dele” sepse punon për palën tjetër ‘kundërshtarë’. Kundërshtari i përcaktuar si i tillë, demonizohet si shërbyes i të gjithë shërbimeve të spiunazhit të botës, si përçarës, si anti-shqiptar, si njeri që urren, cmirëzi, lakmiqar për poste dhe, mbi të gjitha, si persekutor. Në mos qoftë persekutues, atëherë duhet të paraqitet si nipi, djali i hallës, vajza e tezes, si dhëndri i kriminelit ose si nusja e persekutorit.

Tragjedia është se në një vend ku PPSH sundoi për 40 e ca vjet e ku dy bijat e saj politike, PD e PS, kanë sunduar bashkë për më shumë se 20 vjet, ka persekutorë sa të duash. Bile si kanë ardhur punët, mundet të lirisht, se nuk po merret vesh se kush është persekutori i kujt. Të gjithë janë të lidhur me persekutorë, realë apo imagjinarë. Në një pikë a në një tjetër, të gjithë pjesëtarët e parisë kanë persekutuar gjithkënd. Gjithkush ndjehet sinqerisht i persekutuar dhe askush nuk thotë se ka persekutuar kënd dhe, pikërisht kjo, është ajo situatë që i intereson parisë. Por kriteri është se kur nuk i intereson parisë, je persekutues dhe, kur i intereson asaj, je i persekutuar.

Tash 20 vjet në trazicion kemi një shtet që është krejtësisht i pafuqishëm, por që po përdoret për të blerë heshtjen, mosveprimin dhe pajtimin e njerëzve me gjendjen. Në këtë shtet, parimet kryesore janë *“haja qenit e pija qenit, e hajt t’i bijmë karadyzenit”*. Por, parim edhe më kryesor është fjala e urtë katundare, *“në ato maja rripa-rripa, herë ma hipe, herë ta hipa.”* Në një vend ku gjithkush mendon që të vjedhë sa më shumë që është e mundur nga shteti, segmentet e parisë presin me durim rradhën e sundimit. Pavarësisht prurjeve të paimagjinueshme materiale e financiare të mërgimtarëve, në këtë kohë të vështirë për shqiptarët, lufta për kontrollin e burimeve materiale e të shtetit ka qenë e frikshme edhe për shkak të kësaj mendësie të parisë që e pret palën tjetër të jetë e pamëshirshme kur të vijë në pushtet. Shteti ka pasur për të gjithë, si balena që duhet tre vjet me u kalbë në fundin e oqeanit, e

të gjithë janë turrur me vjedhë sa më shumë nga ajo që ka mbetur. Shumë nga ata që i kuptonin proceset dhe gjendjen u zvetënuan dhe u shitën deri në pikën e fundit. Por edhe ata që u shitën presin rradhën e tyre.

Megjithatë, paria ia ka arritur të shkatërrojë opozitën e vërtetë që në embrion. Prandaj, sot, edhe pse e kuptojnë mirë se në çfarë qorrsokakaku moral i ka futur paria e Tiranës, shumë shqiptarë janë të pazotët me folë, e shohin veten të përdorur, nuk dinë rrugë të tjera, e kanë humbur ndjesinë e nderit e të dinjitetit, ose janë ndry në veten e tyre e po shkatërrohen. Shkaku është se sistemi i vendosur nga paria i detyron që, për të jetuar, të merresh vesh edhe me dreqin tre herë në ditë. Shkurt, lufta e objektivi i parisë, ka qenë që askush të mos mundet të ikë prej lëmshit të kimit e të gëlbazës morale, ku e ka synimin t'i fusë e t'i mbajë paria e Tiranës. Deri tash, ajo duket se ia ka arritur qëllimit. Njerëzit bëjnë krime si pa të keq. Arsyeja për këtë sjellje është se paria ka injektuar tek të gjithë mendësinë e burgut e të kampit të përqëndrimit. Në burg, shumëkush mundohet që të mbijetojë vetëm vetë edhe pse, ndoshta për këtë, kërkohet të shesësh dhe shpirtin tënd e ardhmërinë e fëmijëve.

Si pasojë e mungesës së alternativave morale e politike, persekutimi nga ana e parisë ka marrë forma të ndryshme dhe me pasoja të rënda për shoqërinë, që shpesh kanë shkuar deri në neuroza e histori kolektive. Në këtë përpjekje për të mbijetuar në kënetën morale të Tiranës, gjithkush e shet veten për çka nuk ka qenë e çka nuk do të jetë. Gjithkush mundohet të shitet formalisht si mbështetës i dikujt edhe pse e di mirë se ai njeri nuk ia do fare të mirën. Por paria ka ndërtuar një sistem, ku, për të mbijetuar, individi duhet të jetë i lidhur se s'bën dhe pa kushte me dikënd. Shoqëria nuk ka standarde të pastra morale, nuk ka sjellje civile publike e përgjegjësi shtetërore dhe, me i ra shkurt, kjo që po ngjet është njëlloj si festa përrallore e shtrigave dhe e vampirave që nuk ngopen me rropullitë e të gjallëve e të vdekurve. Kush e ndërpret apo e dënon këtë sjellje të parisë së Tiranës, është automatikisht i klasifikuar si armik. Ai duhet dënuar e eliminuar, jo vetëm nga paria, por mbi të gjitha, nga mbështetësit e saj. Ana tjetër është se,

për sa kohë që nuk ka kundërshtarë të hapur, orgjia konsiderohet realiteti i jetës për të gjithë shqiptarët.

Mungesa e botëkuptimeve dhe e interpretimeve të ndryshme nga paria ka çuar në konsolidimin e mendësisë së, kështu siç është gjendja në shtetin shqiptar, është dhe sillet e gjithë bota. Të paktën këtë ua thotë shqiptarëve përditë e mijëra herë në ditë arsenali mediatik i segmenteve të parisë. Shkurt e përmbledhtas, objektivi i përbashkët i PS-së dhe i PD-së është që t'i mbajnë njerëzit peng, t'i zvetënojnë, dhe t'i zhveshin nga çdo gjë njerëzore. Asgjë që i cënon në rrugën e tyre të pasurimit e të sundimit nuk duhet mbijetojë.

Si mund të dilet nga ky rreth vicioz, ku mendësia e shoqërisë vazhdon të mbahet peng prej mbisundimit të mendësisë katundare, prej manipulimit mediatik, vakuimit të autoriteteve morale dhe intelektuale dhe nën kontrollin e parisë? Një mënyrë për të dalë nga ky qerthull është me kuptuar si duhet faktin se përvojat historike e traumatike të shekullit të 20-të kanë lënë gjurmë të thella e të pashlyeshme në mendjen e në kujtesën historike të shqiptarëve. Rrënjët e së keqes shkojnë thellë në histori dhe nuk është vendi këtu për t'i trajtuar ato. Mirëpo, për shoqërinë tonë, në një farë mënyrë, rrënjët e së keqes janë të prekshme edhe në vitin 1939. Ky ishte një moment kritik, kur paria e atëhershme, me rrënjë e me degë, e shiti shtetin e kombin shqiptar. Paria, që kishim në atë pikë historike, u tregua të ishte paraardhëse e denjë e parisë së sotme. Edhe kundërshtarët e tyre, që fituan, kur u erdhi rradha të sundonin u treguan të ishin jo më pak antishqiptarë. Për më tepër, të gjithë shqiptarët që sot jetojnë në shtetin shqiptar, janë produkt i çfytuar i sistemit që u vendos nga fitimtarët e radhës. Tragjedia është që shumë shpejt edhe këta u bënë skllëvër të sistemit dhe shumë prej tyre e humbën edhe jetën prej sistemit që kishin ndërtuar po vetë.

Ndërsa duhet analizuar me kujdes roli i sistemit në formësimin e njerëzve, duhet thënë se gjatë periudhës 1944-1990 shteti shqiptar ka përjetuar një eksperiment të pashoq në fushën e transformimit të shoqërisë. Sistemi që u vendos terrorizoi shumicën dërmuese të popullsisë. Në mos tjetër, dy-tre breza u rritën pa pasur asnjë ide të qartë për shoqërinë normale. Ata, që

përbënin 90% të popullsisë në vitin 1990 nuk kanë njohur sisteme të tjera përveç sistemit enverist. Prandaj edhe pasojat e asaj kohë po i jetojmë sot.

Eksperimenti enverist synonte të ndërtonte një shoqëri që nuk kishte ekzistuar kund në historinë njerëzore. Eksperimenti dështoi dhe me dështimin e sistemit terrorist (as socialist e as komunist), shoqëria shqiptare u shfaq e përçudnuar, thellësisht e përçarë dhe pa një bazë të fortë identifikimi të përbashkët. Edhe sot, mbi njëzet vjet më vonë mbas shembjes së atij sistemi, tre brezat që ishin aktivë gjatë asaj periudhe vazhdojnë të jenë objekt i analizës së vazhdueshme nga të gjitha anët. Shumë njerëz numërohen fajtorë sepse nuk kanë ditur më mirë. Normalisht që nuk kanë ditur më mirë, sepse nuk kanë pasur se si të dijnë më mirë. Kur sistemi të ka deformuar që në ngjizje nuk pritet që të silllesh në mënyra të tjera.

Masa e madhe e njerëzve, që kanë jetuar në sistemin e kaluar, edhe shumë nga intelektualët dhe inteligjencia në përgjithësi, nuk janë fajtorë për shumë nga sjelljet e tyre. Nga distanca kohore e sotme, ato sjellje nuk duken si gabime të thjeshta, apo veprime kriminale, por si sjellje të diktuara nga një marrëzi kolektive, që e kishte mbërthyer shoqërinë. Nuk mundën të konsiderohen fajtorë njerëzit që nuk kanë njohur mënyra të tjera jetese në sistemin e kaluar. Tranzicioni, megjithatë, krijoi kushte për ndryshimin e mendësisë. Të gjithë, ose kanë pasur përvoja jashtë vendit, ose ui janë hapur sytë, ose kanë kuptuar si tragjedinë e përjetuar nga shqiptarët gjatë sistemit të kaluar, ashtu edhe shkallën e kriminalizmit të sistemit të ndërtuar nga paria gjatë tranzicionit. Tashmë askujt nuk i falet sjellja e gabuar dhe kriminale.

Nuk e teproj me thënë se, duke i përgjithësuar gjërat, dikush shkruan me shumë urrejtje e dikush tjetër shkruan me shumë nostalgji për ato tre breza që jetuan gjatë asaj periudhe intensive 60-vjeçare. Natyrisht, që nuk ka vend për atë shumicën e heshtur, që as nuk flet e as nuk ndihet. Por kush nuk flet, numërohet për i vdekur e nuk numërohet ndër të gjallët.

Duke i lënë pasionet mënjanë, ka ardhur koha me i vu gjërat ne vendin e duhur. Kjo mbërrihet vetëm kur gjithkush është e duhet të

jetë i drejtë. Njeriu është i drejtë kur e thotë të vërtetën e kur nuk pranon që opinionet e bindjet e tjetërkujt t'i shesë si të vërteta. Kjo lloj sjelljeje e bën të vërtetën skllavin e politikës së momentit dhe të interesave të dikujt. Kjo lloj sjelljeje e merr një popull të tërë në qafë, thjesht sepse e shet rrenën oportuniste për realitet. E vërteta s'i bën qejfin askujt dhe nuk ka se si t'ia bëjë qejfin kujt. Ne, si popull, do të vihemi në rrugë të mbarë vetëm kur ta pranojmë të vërtetën e hidhur e pa hezitim. Ne do të kuptojmë se kush jemi e pse jemi sot këshut vetëm kur të vendosim të mos ndjekim e të pranojmë atë pikëpamje, që është e pranueshme dhe e leverdisëshme vetëm në një moment të caktuar e vetëm për dikënd të caktuar.

Një hap i parë është që të pranojmë se historia e të gjithëve dhe e gjithsecilit prej nesh, si njerëz, por edhe si shqiptarë, është shumë komplekse. Historia e prindërve tanë është edhe më shumë komplekse. Shkaku duhet kërkuar tek momentet e kohët në të cilat jetuan. Kohët ishin shumë të veçanta dhe të papërsëritshme. Ata që e kuptojnë kompleksitetin e asaj kohe janë shumë më përpara atyre që mendojnë se historia është bardh-e-zi. Problemi ynë është se, njerëzit që janë gati me u shprehë për këtë periudhë komplekse me sinqeritetin e duhur e me objektivitet, janë fare pak. Më mirë me thënë, me u përballë me të vërtetën, kërkohet kurajo. Ky është virtyti më i çmueshëm publik, por që shumë prej analistëve tanë iu mungon. Po ashtu brezi i ri, që po rritet e formësohen në politikë, po hedh shtat i modeluar nga forma që e laton paria.

Nga ana e vet, paria e Tiranës ka luftuar dhe lufton që sjelljet publike dhe besnikëritë e njerëzve dhe të inteligjencias në veçanti, të ndërtohen me një dualizëm, që e polarizon dhe e ndan çdo brez në mbështetës të një grupi të caktuar dhe që e sheh historinë e shqiptarëve si përplasje brezash e grupesh, të rreshtuar në dy anët e hendekut ideologjik. Kështu kemi partizanë e kolaboracionistë, komunistë e reaksionarë, të privilegjuar e të persekutuar e me rradhë, në të gjithë brezat e brez pas brezi. Synimi i parisë ka qenë që këto dualizime të kristalizohen sa më shumë që të jetë e mundur në kohë e në të ardhmen.

Objektivi i parisë ka qenë dhe është krejt i qartë. Polarizim me çdo kusht përmes manipulimit të dasive politike. Nëse

identifikohesh me pjesën e parë të binomit, je “socialist”. Nëse identifikohesh me pjesën e dytë të binomit, je “demokrat”. Ky identifikim bazë, me strukturën partiake respektive të parisë, përcillet edhe tek brezat e mëvonshëm. Kështu, paria është duke ndërtuar një strukturë të qëndrueshme, e cila ia jep mbështetjen politike që i duhet si dhe legjitimitetin e nevojshëm për sistemin që ajo ka ndërtuar dhe që i shërben aq mirë asaj.

Kjo ndarje është një politikë e vetëdijshme dhe konseguente e parisë. Paria ka zgjedhur që të përqendrohen në këto dasi. Shpjegimin sepse ndodh kështu po e jap këtu përmbledhtas, por mendoj se mjafton me kaq për të sqaruar gjendjen. Problemi themelor i çdo politikani është që të gjejë hapësirën më të madhe të mundshme për të vepruar sa më lirshmërisht e pa u ndëshkuar nga mbështetësit e vet. Duke lënë mënjanë shantazhin e shitblerjen, rruga e vetme për t’ia krijuar vetes këtë hapësirë veprimi, është të veprosh, në dukje, sipas bindjeve të grupit që e mbështet, emëruesit të përbashkët që e mban grupin bashkë. Atëherë, manipulimi politik është perfekt. Në mungesë të intelektualëve të përkushtuar dhe të mendimeve ndryshe, njerëzit besojnë se po udhëhiqen nga lideri i tyre. Në fakt, prijatari nuk bën gjë tjetër, veçse shtyn përpara agjendën e interesat e veta, duke ruajtur konformitetin me sistemin e vlerave të mbështetësve të tij. Nga ana e tyre, mbështetësit, as nuk e dinë se po manipulohen, as nuk e mendojnë atë gjë, as nuk mund ta mendojnë atë gjë. Gjykimi i tyre mbështetet në ato dhjetë-pesëmbëdhjetë postulate, që përbëjnë bazën e identitetit të tyre politik dhe që merren si të mirëqëna prej tyre. Dhe, qeverisja e shtetit shqiptar ka vazhduar e do të vazhdojë edhe në bazë të disa parimeve të tjera të njohura të mendësisë katundare që duhet të analizohen me më kujdes një kohë tjetër.

Në përfundim, duhet thënë se amalgama e klaneve të parisë e di se si vepron e pse sillet ashtu si sillet. Ajo po lufton të ruajë interesat e veta, me të gjitha mënyrat e me mjetet e mundshme. Figurativisht, duhet thënë se paria e Tiranës është sjellur e do të sillet sikurse sillet ushujza. E vetmja goditje që i dhemb, është ajo që e shkëput nga preja e vet. Përndryshe, paria e Tiranës është e

stërvitur në sistemin e mëparshëm dhe i duron të gjitha. Aq më keq, që në këtë proces, edhe preja vetë, shqiptarët, besojnë se ushujzat janë të mira për shëndetin. Duhet thënë edhe se paria e di mirë se, ky projekt i saj mundet të vazhdojë, për sa kohë që e ruan dukjen e fuqisë, kontrollin mbi ekonominë dhe shtetin dhe për sa kohë që nuk lejon konsolidimin e alternativave.

Por, alternativat janë të pashmangshme dhe formimi i tyre është vetëm çështje kohe. Me kohë, dhe në kushte të caktuara, do të dalin forca politike dhe intelektualë, që do t'i kundërvihen parisë dhe projektit të saj. Edhe këta njerëz që sot po bëjnë kompromise me gjithçka, prej nderit deri tek fëmijët e tyre e po përçudnohen prej dëshirës, prej hallit apo prej zorit, nuk do të harrojnë dhe s'kanë se si të harrojnë. Njerëzit mund të mos flasin, por të gjithë e dinë mirë se nga po u vjen e keqja. Herët ose vonë do të shuhet edhe këta, do të treten në harrim e si brezat e mëparshëm dhe do të varrosen në të shkuarën e tyre. E keqja nuk ka emër e përkatësi. Po ka shumë të ngjarë që disa prej tyre do të gjejnë forca për të luftuar të keqen e për të synuar të ndërtojnë një jetë më të mirë. Njerëzit nuk e kanë kohën me dëgjojnë këto gjëra, mirëpo duhet thënë e vërteta, qoftë edhe kur ia thua pusit pa fund.

SHTETI MAFIOZ DHE NEVOJA PËR NDRYSHIM

Skandali i rradhës në Tiranë të lë një përshtypje të hidhur. Nuk ka rëndësi se cili është skandali. Ai mund të jetë Jala, Gërdeci, Fazlliçi, Centrali Bërthamore, falja e 364 kilometra katrore det Greqisë, apo importimi i plehrave nga Italia. Mbasi tejkalohen individët e veçantë, ky skandal i radhës është prova më e mirë për të evidentuar të paktën katër aspekte të procesit politik. Së pari, në vazhdohet kështu, fundi i të keqes nuk ka fund e nuk duket se do të ketë fund. Së dyti, zvetënimi i parisë është i pashërueshëm. Së treti, paria është një rrjetë merimange, në të cilën janë të kapur të gjithë. Së katërti, ky tranzicion ka dështuar. Kjo do të thotë ka ardhur koha për një fillim të ri.

Është mirë që gjërat me i thënë me emrin që kanë, me gjuhë të thjeshtë e të drejtpërdrejtë, që edhe njerëzit e thjeshtë të jenë në gjendje të kuptojnë të keqen që jetojmë, si dhe rrugën në të cilën po na drejton paria. Kurrë nuk është vonë me ndrrue rrugë, por çdo ditë që vonohet kalimi në rrugën e duhur, çmimi që duhet paguar, bëhet më i madh. Me kohë, ndrrimi i rrugës bëhet më i vështirë dhe gjendja, literalisht, bëhet vdekjeprurëse. Shtetet dhe kombet, si njerëzit, shpërbëhen edhe prej abuzimeve me vetveten e me popullin e tyre.

Ka ardhur e ka kaluar koha me reague me të gjithë mënyrat e mjetet e drejta dhe civile kundër të keqes që sundon në shtetin shqiptar. Mbi të gjitha, duhet reaguuar kundër parisë, që është instrumenti kryesor i të keqes. Figurativisht, ka ardhur koha me shtrydhë çibanin, me pre kancerin e së keqes, sado e dhimbshme dhe e pamundshme që të duket kjo rrugë, por nuk ka tjetër. Shqiptarëve u duhet një shtet i ri kombëtar, me struktura

demokratike, me një strukturë politike të re, me njerëz të rinj, me vizion të ri e fillim të pastër. Shqiptarëve u duhet të punojnë për një të ardhme të pastër, të ndershme e të lumtur për të gjithë, ashtu si e meritojnë njerëzit normalë.

Problemi: modeli i Haitit në Europë

Spiralja e së keqes, ku paria e Tiranës e ka futur popullin e shtetin shqiptar, është një spirale që nuk do të ndalet as edhe kur atij vendi t'i dalë uji i zi. Jo thjesht për shkak se shqiptarët nuk po dinë se çfarë po hanë e se çfarë po pinë. Të untuarit për sende, nuk duan të dinë se çfarë po hanë e pinë. Ata veç duan të ngopin barkun me bukë dhe, mandej, synojnë që të hanë me lugë ari.

Kjo është një çështje e rëndësishme mendësie, që ka të bëjë edhe me indiferencën lidhur me problemet e shumta e të panumërta me të cilat përballet shoqëria. Nuk është e rëndësishme thjesht pse shqiptarët përmythen e mashtrohen ditë e natë dhe nuk reagojnë kundër parisë. Nuk është e rëndësishme pse edukimi është një piramidë e gjallë dhe të gjithë regjistohen në piramidat universitare. Është e rëndësishme, jo thjesht pse administrata është e dallueshme për një korrupsion të frikshëm dhe askush nuk kundërshton. Është e rëndësishme jo vetëm pse ekonomia është në shërbim të monopoleve dhe nuk ka bazë prodhuese. As pse shëndetësia, kujdesi e shumëçka në strukturat e shërbimeve është për faqe të zezë. Jo pse shteti qeveriset nga paria, sepse gjithkund do të ketë një pari, por pse paria sillen sikur s'kanë një pikë vlere njerëzore e janë thjesht një zhgan oligarkik. Jo pse propaganda marramendëse ka krijuar një gjendje kome ideologjike, mpirje mendore e marrie kolektive e as pse shtypi e media, me ndërgegje të plotë, është vënë në shërbim të këtyre interesave. Jo pse uji i zi i gjirizeve vjen në rubinetat e ujit të pijshëm të shumë qytetarëve. E jo pse mbas ujit të zi, do të vijë centrali bërthamor. Jo, pse mbas marrisë së centraleve bërthamore, po vijnë plehurat italiane me tumoret e kanceret e Napolit. Jo pse mbas këtyre shenjave të vdekjes klinike të një shoqërie vjen edhe shkretimi haitian, me kolerën, me vdekjen, pasigurinë, krimin e rënien e shoqërisë në nivele të

barbarizmit, procese, që për shkak të teknologjive moderne, janë të llahtarshme e, shpesh, me pasoja afatgjata qindrvjeçare. As kthimi i njerëzve të thjeshtë në skllëvër, kukudhë e lugetër moralë nuk është fundi i së keqes, që vjen prej sistemit që ka ndërtuar paria. Fundi i së keqes nuk ka fund, dhe gjithmonë ka edhe më keq. As kur njerëzit të hanë njeri-tjetrin nuk do të jetë fundi, sepse prapë toka do t'i mbetet dikujt.

Është mirë me e thënë shkurt se, po u vazhdua në këtë rrugë, në përgjithësi, modeli i së keqes që na pret në të ardhmen e afërt është, pak a shumë, Haiti. Në vazhdohet kështu, e ardhmja e shqiptarëve nuk është më një 1997 e re. E vërteta është që gjendja, që po shitet si normalitet në shtetin shqiptar edhe sot e kësaj dite, lirshëm mund të konsiderohet si 1997 në një vend tjetër të qytetëruar. Si duken punët, me këtë pari e me këtë rrugë, e ardhmja e sigurtë e shqiptarëve është Haiti, *Toka e Shkretë*, një rreth i Ferrit. Shteti shqiptar do të jetë i izoluar dhe një çiban në brinjë të Evropës. Nji Palermo mafioze e kriminale i del boll Evropës e nuk i prish punë, pse është vetëm një qytet në Itali, po një shtet mafioz e gangsterial, fund e majë, është problem i jashtëzakonshëm edhe për BE-në. Prandaj, shteti shqiptar nuk ka perspektiva që të anëtarësohet në BE. Por, ndoshta BE e ka llogaritur që mundet me e tolerue, në anë të vet, e përtej detit, nji shtet *bagno dorata*. Në fund të fundit, shteti shqiptar, modeli i republikës së bananeve, është edhe tani në një izolim të hekurt politik. Megjithatë, një ishull lundruer me plehurat kombëtare, të hedhura në lumenjtë e në bregdetin shqiptar, e ka mbriritë bregdetin e Kroacisë dhe po pengon lundrimin e anijeve evropiane.

Shkaku i të keqes është paria e Tiranës. Nuk ka pikë dyshimi se paria sunduese, e të gjitha ngjyrave, partive, klaneve, feve, etnisë, e krahinave është e sprovuar si strukturë mafioze. Njëlloj si mafia, edhe paria sunduese nuk ka vlera, por vetëm interesa. Nuk ka dyshim se nga ana e vet paria e Tiranës po punon me ngulm e intensitet që të ndërtojë Tokën e Shkretuar, rrethin e nëntë të Ferrit në tokë e ky do të jetë shteti shqiptar, Haiti i Europës, prona e tyre. Arsyeja është se edhe gjarpëri e do nji vend që ta ketë të tijin. Ky shtet edhe sot është ashtu siç i intereson parisë.

Shteti shqiptar është një shtet pa nder, pa sovranitet, pa dinjitet, shteti i gangsterëve, i banditëve, i trafikantëve, i kontrabanditëve, i pushtave, i kodoshëve dhe i kriminelëve politikë.

Nëse e tashmja është tregues i së ardhmes, shteti shqiptar, Haiti i nesërm i Europës do të jetë një zonë ku njerëzit kanë me jetue me celular në një dorë dhe me një pistoletë në tjetrën. Të imunizuar prej të keqes e duke punuar me mashtrues njeri-tjetrin, kanë me kaluar mbi kufoma si në një rrugëtim normal. Sjellja do të jetë e ndërtuar mbi parimin “bjeri i forti, të ligut” d.m.th., pa rregulla, pa nder, pa vlera e kurrfarë merite, me e quajtë sjellje të një qenie normale njerëzore. Prandaj edhe skandali i radhës është një hap tjetër drejt kësaj të ardhmeje, që i pret shqiptarët në rrugën që po shkojnë, dhe e ardhmja e tyre është për t’u pasur frikë.

**PO SHKOJMË KU ISHIM -
PËRSIATJE MBI GJENDJEN,
20 VJET MBAS RËNIES SË MURIT TË BERLINIT**

Njëri ndër kontributet më thelbësore e më me influencë të Immanuel Kant, filozofit gjerman të shekullit të 18-të, ka qenë argumenti se njerëzit mund të jenë të këqinj nga natyra, d.m.th. të interesuar për veten dhe interesin e tyre të ngushtë. Por, institucionet shtetërore i bëjnë ata që të sillen ndryshe. *Status naturalis*, thotë Kant, është gjendja e luftës. Por, Kant ka këmbëngulur se e vetmja formë institucionale, që çon në vendosjen e paqes së përhershme, është republika tregtare. Institucionet e ndryshojnë këtë gjendje.

Ajo që duhet shtuar këtu është se institucionet, si dhe politikanët që i drejtojnë ato institucione, mund ta marrin një popull në qafë, duke e kthyer shoqërinë në gjendjen fillestare të natyrës, d.m.th., në gjendjen e luftës shoqërore, kur njeriu për njeriun është ujk. Mirëpo, ajo që Kant nuk e thotë, është se ka edhe forma regjimi e sundimi të parive të ndryshme, që i shtyjnë popujt e tyre që të bëhen edhe më bishë se shtazët. Ka shtete që i shtyjnë njerëzit që të fillojnë e të hanë edhe njëri-tjetrin. Mirëpo, edhe në këto raste, njerëzit mund të rebelohen. Shpesh, njerëzit arrijnë ta gjejnë rrugën e duhur të kundërvënies ndaj këtij projekti. Ata përdorin sisteme të ndryshme vlerash shoqërore, por edhe forma të caktuara organizimi, që shkojnë nga familja e zgjeruar tek një formë bashkësie, për t'i rezistuar shtetit, të kontrolluar e të instrumentalizuar nga paria sunduese.

Nga ana tjetër, kur shoqëria është e fuqishme, ka vlera të përbashkëta dhe ka sisteme të tilla të konsoliduara, d.m.th.

shoqëri civile të fortë, atëherë shteti duhet të gjejë mënyrën që t'i përshtatet shoqërisë. Kompromiset midis parisë dhe strukturave shoqërore bëhen të paevitueshme. Në këto raste, herët a vonë, shoqëria vjen në ekuilibrin e nevojshëm të bashkëjetesës me parinë. Por nuk ka fitimtarë të përhershëm. Ideologjia sunduese nuk lejon teprime të dëmshme.

Megjithatë, shteti mbetet faktori kryesor përmes të cilit paria arrin të formësojë shoqërinë që sundon, të imponojë vlerat dhe të përçojë ideologjinë e saj. Duke qënë se për periudha të gjata kohe, konjunkturat politike, të brendshme e të jashtme, i lejojnë paritë që të ruajnë një kontroll efektiv, dhe afatgjatë mbi institucionet shtetërore, atëherë influenca e tyre është e jashtëzakonshme.

Por, forma më e pakëndshme e ndikimit institucional mbi sjelljen e njerëzve ndodh kur tre faktorë të rëndësishëm konvergojnë së bashku. Së pari, institucionet janë *pro forma*, por vetëm formalisht, ashtu si duhet të jenë, në ligj e në letër. Paria është e konsoliduar deri në atë pikë sa që arrin që të marrë vendime, e të gjejë zgjidhje të problemeve, ashtu si intereson asaj, pa e prekur strukturën ligjore dhe duke ruajtur aparenat. Paria e luan lojën politike ashtu si don vetë.

Së dyti, ndikimi i institucioneve është tejet negativ kur paria sunduese i kontrollon institucionet pa skrupujt e nevojshëm të shërbyesit publik, kur i mungon edhe etika minimale e shërbimit publik. Si pasojë, paria i instrumentalizon institucionet shtetërore, hapur dhe për qëllimet e veta arriviste, të ngushta e të përfitimit. Së treti, kjo ndodh kur shoqëria pajtohet me këtë gjendje dhe hyn në hullinë e sjelljes që dëshëron paria sunduese, duke pranuar hegjemoninë e sistemit të vlerave të parisë dhe ideologjinë e saj. Kjo ndodh pse shoqëria nuk di si të gjejë rrugën e duhur me dalë nga ky qerthull.

Gjithashtu kjo mund të ndodhë sepse interesat e përditshme të jetesës, shpesh edhe veset njerëzore, e bëjnë bashkëpunimin e saj me parinë të dëshërueshëm e thuajse të pashmangshëm. Mungesa e ideologjive, bartësve të tyre dhe e standardeve të sjelljes, që e formësojnë një bashkësi, çojnë në fragmentarizimin, atomizimin dhe manipulimin e shoqërisë. Në këto raste, shoqëria

gradualisht e shndrro veten në shëmbëlltërinë e parisë sunduese, por ajo nuk është më shoqëri normale. E vetmja strukturë shoqërore që e ruan shëmbëlltërinë e normalitetit është paria. Shoqëria është në gjendjen që përshkruan Platoni në shpellë. Realiteti në të cilin jetojnë njerëzit, morali shoqëror, vlerat dhe qëllimet e tyre në jetë, janë të përcaktuara nga projekti i parisë. Nëse projekti ka qënë absurd, atëherë realiteti ku jetojnë njerëzit është, po ashtu, absurd.

Në ato kushte, kur këto tre faktorë konvergojnë, ajo shoqëri është e paracaktuar që pashmangshmërisht të transformohet në një shoqëri të kriminalizuar, thellësisht të përçarë dhe lehtësisht të manipulueshme. Në ato raste, gjithçka e gjithsecili e ka një çmim; individ i jeton pa vlera, pa moral, pa nder, por edhe pa shpresë për të ardhmen. Në këtë shoqëri, njeriu për njeriun bëhet ujë dhe mbijetesa është objektivi i vetëm e i pambrirshëm për të gjithë. Askush nuk ka siguri për çka ka e për çka zotëron, as për nderin e vet. Askush nuk e di se çka sjell e nesërmja. Askush nuk mund të jetojë ndryshe, veçse dita më ditë, më mirë me thënë, me e shty nga dita më ditë. Askush nuk mundet t'i gëzohet të qënurit njeri, sepse nuk mundet (edhe po të duan), të jenë dhe të bëhen njerëz. Sistemi ku jeton, të detyron të sillesh si bishë edhe në nivelin e familjes, bërthamës së një shoqërie të shëndoshë. Në se bindja sunduese është se, vetëm bishat e predatorët mundet me mbijetue, atëherë njeriu synon që të bëhet bishë dhe ujë. Kjo është në natyrën njerëzore. Kjo është edhe zgjidhja që iu përshtatet interesave të ngushta e vetjake të parisë si shtresë.

Gjendja e natyrës nuk është vetëm lufta e hapur midis njerëzve, një gjendje e tipizuar nga vrasja e njeriut për përfitim material, për cmirë, apo për kënaqësi perverte. Gjendja e natyrës është e pranishme edhe atëherë kur gjithkush jeton me frikën se ajo vrasje mundet me ndodhë në çdo kohën e në çdo moment. Vrasja nuk vjen vetëm me plumb; edhe heqja e bukës së gojës është vrasje. Edhe marrja e nderit dhe e dinjitetit, është vrasje. Gjendja e natyrës është e pranishme, kur je i pazoti të përballesh me atë trysni, që vjen nga paria e nuk sheh asnjë zgjidhje tjetër, veçse të tjetërsohesh nga natyra njerëzore. Gjendja e natyrës është e

pranishme, kur nuk i dihet as prej kah të vjen e keqja, as prej kah e pret moralisht goditjen e radhës. Paaftësia me veprue kur duhet kundër të keqes që të kërcënon, edhe kur e di se cila është e keqja dhe nga po të vjen, është thelbi i tragjedisë njerëzore.

Ndërkohë paria, si të gjitha paritë, e di mirë se çka duhet thithur nga shpirti i njerëzve. Paria e di se si iu duhet hequr siguria e jetës dhe e pronës njerëzve të thjeshtë. Paria e di mirë se si duhet kalbëzuar moralisht një shoqëri e caktuar. Mirëpo, ndonëse e di se kur vdes njeriu nga kanceri, me të vdes edhe kanceri vetë, paria, që e mban shoqërinë nën kontroll, përmes këtij terrori të strukturuar, shpreson e jeton të vdesë një ditë më vonë se të gjithë të tjerët. Për të arritur objektivin e vet, ajo e shtyn shoqërinë të kthehet në gjendjen e natyrës. Gjendja e natyrës në modernitet krijohet në kampin e përqendrimit dhe në burg.

Pikërisht, kjo gjendje e frikshme e natyrës, është mënyra e organizimit shoqëror në shtetin shqiptar. Këto tre faktorë kanë konverguar dhe janë dukshëm duke e përcaktuar të ardhmen e shqiptarëve. Institucionet e vendosura formalisht janë republikane dhe demokratike. Në letër gjithçka është e shkëlqyeshme. Mirëpo, asnjë strukturë institucionale nuk funksionon si duhet, thjesht sepse parisë së Tiranës i intereson që institucionet e të gjitha niveleve të mos funksionojnë ndryshe, veçse si vegla të saj dhe në shërbim të interesave të saj. Institucionet, në të gjitha nivelet, janë të kapura dhe të kontrolluara nga klanet e parisë. Populli është i përçarë, por paria është kompakte.

Për shembull, mbasi u shanë e u rrahën para zgjedhjeve, gjatë zgjedhjeve e më pas, tash përfaqësuesit e parisë e gjetën e do ta gjejnë shpejt gjuhën e përbashkët me njëri-tjetrin. Cilat zgjedhje? Po nuk ka fare rëndësi. Kjo ndodh sa herë ka zgjedhje. Gjërat do të vijnë në ekuilibër, edhe pse ky është një ekuilibër krimi. Problemi është se ky ekuilibër krimi u shërben të gjitha palëve të parisë, prandaj edhe sistemi, do të vazhdojë që të mbrohet e të ruhet nga të gjitha palët.

Po ashtu, në shtetin shqiptar nuk ka të ardhme e nuk ka shpresë. Shpresa që iu ofrohet shqiptarëve, integrimi europian, është një rrenë e pastër dhe, në të afërmen e afërt e të mesme,

krejtësisht e pamundshme. Nga ana e vet, paria është e krimbur në paratë e vjedhura nga arka e shtetit, nga rushfetet, nga grabitja e pronave, si dhe nga allishverishet më të ndyra. Gjithashtu, ajo është e krimbur moralisht, në çdo drejtim, në çdo aspekt që mund të konsiderohet.

Paria e Tiranës e ka treguar fytyrën e vet të vërtetë dhe, për disa njerëz, ajo është e zezë si nata e Ferrit. Ata që e kuptojnë dhe që e njohin parinë, duan të ikin një orë e më parë nga shteti shqiptar. Bile edhe shumë pjestarë të parisë vetë, duan të ikin një orë e më parë, për të përdorur një shprehje komitësh, “nga sytë, këmbët”. Të gjithë e dinë se dikur, mirë a keq, kjo gjendje do të ketë një fund, e ai fund nuk do të jetë i këndshëm për ta. Mirëpo, shumë janë të mbajtur peng nga pronat, nga lidhjet që kanë, dhe nga interesat. Kështu, ata e gjejnë veten të detyruar që të vazhdojnë “lojën” edhe do kohë.

Zvetërimi i parisë, i promovuar përmes politikave të ndryshme, ka penetruar thellë në shtresa të tjera të shoqërisë. Kriminalizimi i shoqërisë shqiptare është bërë më i dukshëm sot, se sa ka qenë ndonjëherë me parë. Në sipërfaqe, askujt nuk i bën përshtypje ajo çka ndodh, anipse atje ndodh përditë një hata e madhe mbas tjetrës. Gjithçka që mundet me e ëndërrue edhe njeriu më i zi e më i ndyrë ka ndodhur, apo pritet të ndodhë në shtetin shqiptar.

Por, në sipërfaqe, shteti shqiptar duket si parajsja e qejfit, një vend ku të gjithë hanë e pinë. Tirana ka më shumë Mercedes se Berlini. Tirana ka më shumë bare, drogë e prostituta se gjithkund tjetër. Në zona të caktuara të Tiranës, shtëpitë e jetesa kushtojnë më shumë se sa në Paris, në Romë e në Tokio. Më e keqja është se shumë njerëz janë të bindur se nuk ka rrugë tjetër, se nuk mundet të ketë rrugë tjetër, përveç kësaj që po ndiqet. Po ashtu, Tirana ka shumë të tjerë e ndjejnë thellë dhimbjen e plagëve që, as janë mbyllur dhe as do të mbyllen. Por këta janë të pazotët të veprojnë dhe konformohen. Megjithatë, rezistenca e disa shtresave të caktuara të shoqërisë ndaj parisë dhe projektit të saj po bëhet përherë e më e ndjeshme dhe është në rritje.

Peshuar me këtë balancë, shteti shqiptar gjendet sot, 20 vjet mbas rënies së Murit të Berlinit, në një qorrsohak, në të cilin

nuk gjendet asnjë shtet tjetër që doli nga sistemi i mëparshëm. Me institucione të kapura, me një pari kriminale e me një shoqëri që është duke u kriminalizuar deri në palcë, me njerëz pa shumë besim e shpresë në të ardhmen. Natyrisht, kush nuk ka shpresë, nuk ka se si të ketë dhe të ardhme. Por, pikërisht kjo është gjendja e jonë.

Trysnia që ushtrohet mbi shoqërinë është thuajse e papërballueshme. Në se nuk ndrrohet rrugë, shqiptarët, dhe vetë paria e Tiranës, munden me e pa të shkruar në mur të ardhmen e tyre. Më e pakta që mundet me u thënë është se, ajo e ardhme është e shkuara, që po përsëritet në një formë tjetër, shumë të pakëndshme, edhe vetëm në imagjinate e jo më me e jetuar. Dhimbja shtohet edhe më shumë, sidomos kur i sheh popujt e tjerë që ecin me kurajo në rrugë të tjera të progresit, të mirëqënies e të zhvillimit. Ndërsa ne po endemi në rrugë pa rrugë, në rrugë që i kemi kaluar edhe disa herë më parë. Për shqiptarët, edhe njëherë tjetër si më shumë se njëzet vjet më parë, kanë ardhë kohë të vështira. Po shkojmë ku ishim më parë, format ndrojnë, sistemi i kontrollit ndrron, por sistemi i parisë funksionon gjithnjë dhe është në shërbim të saj.

DON KISHOTIZMI I RREMË SI ZGJIDHJE POLITIKE E PARISË SË TIRANËS

Njëri ndër paradokset e spikatura të tranzicionit është se, kur vjen puna tek objektivat politike, në sipërfaqe, paria e Tiranës është sjellur e po sillet si Don Kishoti, hidalgoja imagjinare dhe i rënë nga vakti, i Servantesit. Por qasja është thelbësisht e gabuar. Don Kishoti lexon libra kalorsiakë dhe ia mbush mendjen vetes se ka lindur për vepra fisnike. Ai vepron në një mënyrë të caktuar, i shtyrë nga motive fisnike, duke imituar heronj dhe ngjarje që nuk kanë ndodhur veçse në libra. Në fund, edhe Don Kishoti e kupton nivelin e marrëzisë së tij dhe ndrron rrugë. Në rastin e parisë së Tiranës, ajo sillet si Don Kishoti, por duke bërë një kalkulum krejt të ftohtë e të mbështetur në interesat racionale të saj si shtresë.

Si duhet kuptuar ky krahasim? Në emër të një dashurie imagjinare për Dylqinjën e Tobozës, në ndjekje të kodit kalorsiak, në udhëtimet e tij, Don Kishoti bëri një numër veprimesh, që i binin krejtësisht kundër realitetit e racionalitetit. Don Kishoti shihte atë që nuk ishte, mendonte atë që nuk duhej menduar, e përdorte si standard sjelljeje pikërisht atë që nuk i shërbente, as atij, por, që nuk i shërbente as edhe njerëzve që ai kërkonte t'i ndihmonte. Mbrapa Don Kishotit, idealist e nostalgjik për kohën e lavdisë së shtresës së tij të imagjinuar, (sepse në fakt, ai nuk ishte tamam hidalgo, por katundar disi më në gjendje se të tjerët), shkonte Sanço Pança, katundari praktik, të cilit Don Kishoti i kishte premtuar se do ta bënte sundimtar të një ishulli. Edhe pse Sanço Pança e shihte se Don Kishoti kishte lajthitur, shpresa se do të bëhej guvernator ishulli, por edhe i pasur, e bënte t'i toleronte marrëzitë e hidalgo imagjinare.

Nga ana e tij, Don Kishoti mundohej të mbahej si fisnik i vërtetë, duke u sjellë si i tillë në gjendje absurde. Ky është edhe thelbi tragjik i bëmave të tij: një idealist, që për hir të vlerave e të normave të moralit të vet, bën krejt të kundërtën e asaj që duhet të bëjë një njeri racional. Kur duhet të ikë, sepse nuk ka shanse për të fituar, ai lufton. Kur duhet të shmangë një grup jomiqësor, ai iu del i vetëm përpara. Kur nuk ka armiq, ai i imagjionon dhe i shpik. Realiteti i tij është i rremë, sepse ekziston vetëm në mendjen e tij. Por edhe të tjerët e pranojnë realitetin e tij. Deri edhe Sanço Paçça, arrin dhe e mashtron atë, kur i sjell 30 katundare, të veshura me rrecka dhe zhul dhe i thotë se janë Dylqinja dhe damat e saj të nderit, që duken ashtu, sepse i kanë magjepsur.

Nga ana e vet edhe paria e Tiranës silllet si Don Kishoti. Atje ku nuk ka kështjella, paria imagjionon centrale bërthamore. Plehrat e Italisë shiten si mbrojtje e ambjentit dhe zhvillim. Atje ku nuk ka ishuj prosperiteti, ku Sançot dhe katundarët praktikë do të bëhen të gjithë guvernatorë, ose me pakta, do të jetojnë pa punuar, si katundarët grekë të Kretës që kanë 15 vjet që veç pinë *Ballantine's* me paratë e BE-së, paria flet për një *El Dorado* që do të mbrihet përmes integritetit europian. Atje ku ka armiqësi dhe shtete që punojnë kundër shqiptarëve, paria sheh miqtë më të mirë të shqiptarëve. Atje ku është zgjidhja, paria sheh problemin. Aty ku Dylqinja e Tobozës, d.m.th, Shqipëria e Tranzicionit, është thjesht një katundare joeuropiane, paria krijon mitin e magjepsjes, duke i varur flamurët e NATO-s dhe të BE gjithkund dhe, së bashku me Sançot e pafund, në shtyp e në media, deklarën se shqiptarët janë tashmë europianë, bile, janë europianët më të lashtë.

Mirëpo, mbas kaq dështimesh, dikush hamendëson se paria sunduese duhej të kishte zënë mend. Nuk ka dyshim që, në të gjithë këto raste, duke u sjellë si don Kishoti, paria është duke ndjekur një objektiv politik, të vetëcaktuar, por që është tërësisht i paarritshëm prej saj. Mirëpo, ka një dallim thelbësor midis Don Kishotit dhe individit tipik pjestar të parisë së Tiranës. Dallimi është se paria e Tiranës po e ndjek objektivin e vetëcaktuar, por të pambriritshëm politik, me ngulm e deri në absurditet. Arsyeja është se, vetëm kjo ndjekje absurde e një objekti të pambriritshëm politik i shërben

asaj dhe Sançove të shumtë. Çka është edhe më keq, ajo i krijon vetë, sistematikisht dhe me qëllim, situatat absurde në të cilat i duhet mandej të veprojë si Don Kishoti. Paria duhet t'i mbesë besnike rolit deri në fund dhe duhet që, të paktën formalisht, të jetojë në realitetin absurd ku i ka mbyllur shqiptarët.

Zgjidhja e saj, edhe në ndjekjen e objektivave, edhe në përzgjedhjen e metodave për t'i arritur ato objektiva është e vetëdijshme. Mbas kaq shumë dështimesh, është e pamundur që mos të vihet re se nuk po nxirren mësimet e duhura as nga paria, as nga Sançot e shumtë. Por, duke vazhduar me atë sjellje patologjike dhe paradoksale, paria po i rrin besnike formulës së saj politike dhe konceptit të saj strategjik. Sa kohë që duket se po ecet përpara, sa kohë që ekonomia mbahet, me para të pastra apo me para krimi e gjaku, sa kohë që edhe të zotët e kështjellave ku ndalet Don Kishoti e trajtojnë atë dhe turmën e mbushur me Sanço Pança si *Grandee de Espana*, e bile i tregojnë rrugën e integritimit europian, d.m.th., arkipelagun e mbushur me ishuj, ku secili Sanço shqiptar do të bëhet guvernator i një ishulli-katund, rrena është realiteti.

Po u kuptua se nuk ka rrugë tjetër, secili Sanço shkon të merret me punën e vet, sepse të gjithë e kanë lënë tokën e gjyshit djerrë. Ata që dinë më shumë, një nga një apo në grup, "i fusin një të vjedhur" hajdutçe, sa ta zërë gjumi pak Don Kishotin. Mandej, e braktisin pa mëshirë, në mos i fusin një plumb nga një *Vespa* dhe i vjedhin *Rosinantin*, d.m.th., partinë politike dhe e fillojnë lojën nga fillimi.

Donkishotizmi i parisë është një zgjidhje dinake politike për të mbajtur turmën e mbushur me Sanço Pança bashkë. Paria e arrin këtë duke iu folur për *El Dorado*, për pasuri, e për ishuj imagjinare, që ata do t'i kenë pronë të tyre. Paria i mban Sançot bashkë, duke shpërdoruar paratë dhe kontributet e mërgimtarëve. Ky është edhe thelbi kriminal i sjelljes së saj. Paria është e vetëdijshme për atë që bën; ajo nuk kujdeset për të vënë në vend padrejtësitë, por vetëm për të mbrojtur interesat e saj. Don Kishotizmi i parisë së Tiranës është i rremë. Don Kishoti duhet të na dhimbset, të ndiejmë keqardhje për të e t'i ofrojmë

mbështetje. Parinë e Tiranës duhet me e urrye, me e pasë frikë dhe me u distancue sa më shumë prej saj.

Por edhe Sançot tanë janë ndryshe në dukje dhe gjasme modernë, si edhe paraqitet Don Kishoti i parisë, që ata ndjekin. Sançot tanë të shumtë, d.m.th., kalemxhinjtë, banditët, trafikantët, hajnat, afaristët, si dhe cubat e lamashët e panumërt që i shërbejnë parisë së Tiranës e dinë që kjo është një “lojë”. Por edhe katundarët tanë praktikë ose individët me mendësinë e katundarit praktik, e dinë mirë që kjo që po ndodh është një “lojë” që do ia “fusim edhe BE-së”. Ata i shkojnë mbrapa parisë, sepse e dinë se ajo lloj sjelljeje është e vetmja mënyrë me mbushë xhepat e tyre e me mbijetue në dekadencën e absurdit të Bllokut të Tiranës. Nga larg, të vetmit që me sa duket nuk e dinë planin e parisë së Tiranës janë zyrtarët e BE-së. Të paktën për sy e faqe, këta i marrin gjërat seriozisht, me naivitetin e dikujt që nuk e njeh mendësinë katundare.

Mirëpo, ndërsa presin që të mbrijnë tek BE, ishulli i tyre imagjinar, që edhe ata e dinë se nuk e mbrijnë dot, sepse nuk ka ishull për to, por vetëm katunde të originës, gjatë rrugës ata nuk lënë gjë pa bërë, pa vjedhur, pa shpifur e pa grabitur. Mbrapa vetes ata po lënë një shkretëtirë të llahtarshme morale vlerash. E si për parinë, ashtu edhe për shërbyesit e saj, mendësia sunduese është mendësia e këtyre dallaverexhinjve, që mendojnë vetëm e vetëm për kuletën e vet. Ky është Don Kishoti i mafias, dhe turma me Sanço Panço të krimit. Ka shumë dramë, komedi, dhe tragjedi në Don Kishotin e vërtetë. Por në rastin shqiptar, Don Kishoti është mishërimi i krimit, ashtu si edhe Sanço Pança është hajni, kusari, apo cubi katundar, që edhe nusen e vjedh “hajdutçe” dhe që ecën me parimin, “kalova lumin, të marr edhe kalin”.

Duke i lënë metaforat mënjanë edhe pse sjellja e saj po justifikohet me argumente absurde, paria e Tiranës po ndjek me insistencë objektivat e saj realë, të mbështetura në interesat e saj të ngushta, që i ndan me Sançot e shumtë. Duke vepruar kështu, paria po e përforcon pushtetin e saj politik dhe ekonomik. Duke vepruar kështu, ajo e kontrollon mendësinë e shoqërisë, e vlerat e saj që krijohen nga shqytarët e saj të shumtë në të gjitha fushat e jetës. Me mjete të fuqishme ekonomike, politike e propagandistike

në duart e saj, paria e Tiranës po e krijon realitetin absurd, ku ajo do të veprojë lirisht. Aty ku nuk ka mullinj me erë, paria i ndërton vetë një herë mullinjtë e erës. Mandej, njëra palë e parisë i mbron dhe tjetra e sulmon palën tjetër. Të huajt e kanë kuptuar se ky është një teatër absurd, aq më keq, që paria ia ka dalë që t'i bindë shumë nga njerëzit e thjeshtë se absurdi i jetës që ajo ka ndërtuar dhe që iu servir atyre përditë, është real.

Më tragjikja është se ky është udhëtimi i saj i dytë. Në udhëtimin e saj të parë, ajo ishte e frymëzuar nga "komunizmi". Në emër të një dashurie imagjinare për sistemin e komunizmit dhe Karl Marksit dhe Engelsin, paria synoi ndërtimin e një shteti komunist. Mirëpo Marksi dhe Engelsi, nga ana e tyre i kishin quajtur shqiptarët si njerëz të egjër, si joeuropianë, të paqytetëruar dhe si katundarë të mirë me pre dru. Ata i kanë quajtur shqiptarët edhe si të paaftë me krijue shtet. Por, edhe pse nuk ndërtuan një shtet komunist, paria e atëhershme dhe e tashme sunduese, si dhe Enver Hoxha, ndërtuan një shtet shumë të fortë, por thelbësisht terrorist. Në fillim, Enver Hoxha iu premtoi shqiptarëve se do të hanin me lugë floriri. Mandej e mbylli duke thënë "bar hamë e parimet nuk i shkëlmin". Mirëpo, gjatë gjithë kohës, ai e mbajti pushtetin me dorë të hekurt dhe i bëri njerëzit të hanin edhe bar, por parimet i shkeli me të dy këmbët. Që të mos ta teprojmë, të themi se hanin byrek me hithra, apo bukë misri me dhallë. Por, shumica dërmuese, jetonin me tallona, hanin bukë misri me ujë e sheqer dhe hapnin kanale e prashisnin gjithë ditën.

Si pasojë, në fund të udhëtimit, kur na zuri viti 1990, e gjetëm veten me një shoqëri të përçudnuar, të amoralizuar e të imoralizuar. Disa herët, e disa më vonë, e kuptuan se e gjitha kishte qenë një mashtrim i paskrupullt. Në emër të komunizmit e të marksizëm-leninizmit, në atë vend u krijua një situatë absurde, imagjinare, dhe e pajetueshme. Edhe ata që dënoheshin me vdekje linin si deklaratë të fundit: "Të rrojë Socializmi Shkencor" apo "Të rrojë Komandanti", me shpresë se fëmijët nuk do të përfundonin në kampe internimi e të persekutuar deri në katër breza, me rrënjë e me degë.

Mirëpo, nga kjo situatë absurde, të vetmit që dolën shëndoshë e

mirë ishin pjestarët e parisë dhe rrethi i “intelektualëve të shquar.” Dhe jo vetëm aq. Tashmë, ata ishin të transformuar në europianë “soji” e në kapitalistë të sinqertë, me dije të thella për institucionet dhe shtetin e me maniera. Në shëtitjen e përnatëshme në *Broduejn* e Tiranës, dhe pas një zupe me ponç, shkonin në apartamentet në pallatet e ndërtuara me punë vullnetare dhe ëndërronin *une vie à la parisienne*. Natyrisht, të hënave, të gjithë shqiptarët hanin groshë. Edhe këta, si shumë të tjerë, jetonin me tallona. Por, grosha (fasulja) ishte pjatë e preferuar në shumë familje të parisë. Përtej groshës, lustrës së shkollimit jashtë shtetit, e titujve, emrat e mbiemrat, si dhe veshjet e prindërve që nuk i hiqnin poturet dhe rrobet e zeza, tradhëtonin origjinat e tyre orientale, katundare, por edhe të dyshimta në shumë aspekte të tjera si, bie fjala, etnia, profesionet familjare dhe niveli kulturor.

Këtu fillon udhëtimi i dytë i parisë. Edhe ky udhëtim nisi me objektivin e ndërtimit të një shoqërie të re, sërish absurde, por gjithnjë në shërbim të tyre. Mbasi ishin ndryshuar gjatë 50 viteve në kontroll të shtetit, ata donin të ndërtonin shoqërinë që iu shërbente më mirë interesave të tyre të ndryshuara. Një herë kishin dashur pushtetin. Mbas pushtetit donin edhe pasurinë. Këtu nisi edhe udhëtimi tjetër i saj me Sanço të tjerë, më të shkolluar e rrënjësisht të transformuar në udhëtimin e saj të dytë, që e ndjekin për hir të interesit. Tash, jemi në mes të rrugëtimit të tranzicionit, një shtegtim, që për të nuk duhet të përfundojë ndonjëherë. Në emër të një dashurie imagjinare të shqiptarëve për kapitalizmin, për Europën, për europianizmin e shqiptarëve e me radhë, paria ka ndërtuar një shtet tejet të kriminalizuar, por që i shërben asaj.

Në thelb, ky shtet është po aq terrorist, sa edhe shteti i mëparshëm. Ndoshta ky është një shtet edhe më shumë se terrorist, sepse këta, kësaj here, të vrasin pa të prekur. Këta i lënë njerëzit të vdesin vetë. Këta i lënë njerëzit të vyshken në mes të rrugës e të mjerimit. Këta i lënë njerëzit të lirë, aq të lire, sa që mund të vetëvaren në litar, të vdesin pa punë, të shesin trupin e fëmijët, ose të pinë bar miu. Në të njëjtën kohë, televizionet, radiot, e gazetat merren me ditë të tëra me aventurat intime të një këngëtareje, që vetëm të këndojë nuk di, por që ka shkuar shëtitje në Hollivud dhe

që është e bërë e famshme për një lidhje që ka me parinë, përmes mpleksjes me individë të caktuar. Megjithatë, shembulli më i mirë për të ilustruar këtë është vëmendja që i kushtohet një artisteje, të famshme, në shtetin shqiptar, që thotë se tash, që ka mbetur shtatzënë, ka ardhur koha të gjejë burrë dhe të martohet.

Mullinjtë e erës, që ka ndërtuar paria e Tiranës, janë të panumërueshëm. Historia shumë e pasur e kryeministrit të tanishëm dhe mulliri i erës i radhës, (“qeveria e integritit”), ia kalon imagjinatës së Servantesit, që kur erdhi në trojet tona u ndal, nga halli, deri në Ulqin, ku e shitën si skllav dhe ku punoi për shqiptarët për nja dhjetë vjet. Sigurisht që kjo është një lidhje e fuqishme që kemi me shqiptarët me Europën, sepse, në fund të fundit, ai doli gjallë nga shërbimi si skllav që bëri për shqiptarët, doli me mend në kokë dhe ndoshta më i zgjuar, sepse romanin e *Don Quixote*, ai e shkroi mbasi jetoi me ne.

Mirëpo, paria e re, e transformuar dhe e zgjeruar, nuk ndalet duke vendosur objektiva të pambrirshme e jashtë çdo imagjinate. Këta iu premtuan shqiptarëve një herë “çekun e bardhë”, mandej “integrimin euroatlantik” e tash flasin për “integrimin evropian”. Kështu, si po vjen puna, realisht do ta përfundojnë me “integrimin post-osman”. Prapë, lidhja me Servantes është shumë e fuqishme dhe e dobishme. Argumenti do të ishte se ishim ne, shqiptarët, që e mbajtëm skllav për dhjetë vjet këtë armik të betuar të perandorisë.

Për sa kohë që kishte para, nga emigracioni dhe nga punët e fëlliqta, krimi e trafiku, Sançot e shumë, si dhe e shoqëria e pranonin sjelljen e parisë, pa shumë diskutime. Problemi është se, edhe në këtë rrugëtim të radhës, paria e Tiranës ka hyrë e ka mbetur, e zënë në çark, në shtegun e pakrye të “bar hamë e parimet nuk i shkelim”. Duke u mbështetur në anën më të ndyrë e më të kriminalizuar të shoqërisë, paria sunduese ka krijuar një situatë absurde. Në këtë gjendje, diskursi politik, objektivat e shpallura, gjendja reale, si dhe sjellja e saj dhe e Sançove të saj janë krejtësisht të papajtueshme njëra me tjetrën. Tani që kriza po përkeqësohet me shpejtësi marramendëse, si Sançot e shumë, ashtu edhe të tjerët, do të fillojnë të merren me Don Kishotin, që

ka bllokuar pusin, dhe që nuk lë, as Sançot, as njerëzit, por as kuajt, që të pinë më ujë.

Në këto momente të vështira për parinë, lufta kryesore bëhet për t'i bindur Sançot se vazhdon rrugëtimi drejt *El Dorado*. Përshtypja është krijuar se jemi duke hyrë në BE, në mos nga dera, nga dritarja, d.m.th., kontrabandë. Përshtypja e krijuar është se hyrja në BE është iminente. Prandaj, çdo vit thuhet, me sigurinë e nevojshme, se anëtarësimi është duke ardhur në vitin që vjen. Kjo ndodh kur paria është e vetëdijshme, shumë e vetëdijshme, që objektivi i integritimit është njëllë me, siç thuhej dikur, "shkuarjen në komunizëm". Shpresa se shteti shqiptar do të integrohet në Bashkimin Europian është një përrallë e pastër politike, demagogji e paskrupullt dhe një objektiv politik, pa asnjë shpresë realizimi edhe, për shumë, shumë kohë të mira. Gjithsesi, 47% e shqiptarëve besojnë se kemi hyrë në BE.

Por edhe pse proceset duhet me ecë në rrjedhën e vet, gjithçka e ka një fund. Pyetja më e frikshme është se çka do të gjejmë në fund të këtij rrugëtimi të dytë? Çfarë ndjesie përçudnimi kemi me përjetue, çfarë mangësie vlerash morale e njerëzore do të gjejmë? Çfarë mendësie do të ketë ajo shoqëri që do shpohet nga gërmadhat e rradhës? Një gjë është e sigurtë dhe e trishtueshme. Ashtu, si edhe në fund të rrugëtimit të parë, edhe pse Don Kishotët tanë të parisë së Tiranës do të treten në histori, mullinj të tyre të erës do të vazhdojnë të rrotullojnë mendjet e njerëzve.

SUKSESI I DYSHIMTË I PARISË SË TIRANËS: KRIJIMI I NJERIUT TË RI TË TRANZICIONIT

Një shkencëtar rus, Pavlovi, është bërë shumë i njohur, për arsye se ka provuar që qeniet mund të zhvillojnë reflekse, të kushtëzuara apo të pakushtëzuara. Megjithatë, një shkencëtar tjetër bashkëkohor rus, shumë më pak i njohur, përveçse në rrethet akademike, Beljajevi, ka arritur të provojë se është plotësisht e mundëshme që, brenda disa brezave, të ndërrohet predispozicioni gjenetik i një lloji të veçantë kafshësh. Me një fjalë, Beljajevi ia arriti të ndryshojë natyrën e specieve në nivelin gjenetik.

Lloji që ai zgjodhi ishte shumë e veçantë: dhelpra siberiane. E njohur si një nga shtazët më të egra e më të pazbutëshme, dhelpra siberiane dukej si lloji më i papërshtatshëm për këtë eksperiment. Megjithatë, duke i veçuar dhe duke i ndërzyer dhelprat, që dukeshin më të buta, njëra me tjetrën, në 18 brezni, Beljajevi ia arriti të krijonte një lloj të ri krejtësisht të zbutur dhelpre siberiane. Ky lloj i ri nuk paraqiste kurrfarë rreziku për njeriun. Të njëjtën gjë bëri edhe me dhelprat që dukeshin më të egra. Duke ndjekur të njëjtin proces, ai krijoi një lloj dhelpre, e cila ishte shumë më e egër se dhelpra siberiane në natyrë. Përfundimi ishte se, ajo që kishte rëndësi nuk ishte kultivimi i refleksit të një individi të veçantë, argumenti i njohur pavlovian, por zhvillimi i predispozicionit gjenetik të llojit. Kështu është provuar se, në historinë e tyre, njerëzit kanë arritur të ndryshojnë predispozicionin gjenetik të bimëve e të kafshëve, nga lakra, tek ujku, tek macja. Ajo që Beljajevi bëri, nuk ishte gjë tjetër, por, një përsëritje sistematike dhe e sprovuar shkencërisht e diçkaje, që njeriu e ka bërë i shtyrë nga interesi i vet, përgjatë shumë kohësh.

Në nivelin e shoqërive njerëzore, kjo teori përkthehet në këtë mënyrë: po të mbahen të izoluar për një kohë të mjaftueshme e të detyrohen që të përzgjidhen në bazë të disa kritereve rigorozisht të caktuara, njerëzit si individë, por edhe bashkësia e tyre, d.m.th., fisi, tribuja e kombi si grupe, mundet që të ndrrojnë, edhe gjenetikisht. Grupet zhvillojnë karakteristika të përbashkëta, thelbësisht të dallueshme nga karakteristikat që kishin në pikën fillestare. Kultura, përparësitë, dhe mënyra e sjelljes së grupit ndrron. Vlerat dhe sistemi i besimit të tij ndërrojnë po ashtu. Mbi të gjitha, genet e tyre bartin informacionin e nevojshëm dhe e transmetojnë atë nga brezi në brez, duke e transformuar edhe grupin në tërësi. Kurdoherë që përballen me kushte të caktuara, grupet e tilla sillen në atë mënyrë që ua dikton predispozicioni gjenetik.

Tashti, kjo teori duhet marrë me rezerva të mëdha sepse përveç natyrës, asnjë forcë nuk e ka konsistencën, jetëgjatësinë, e intensitetin për të ndryshuar llojin e njeriut. 18 breza janë 36 vjet për dhelprat, por 18 breza është pak a shumë periudha që shqiptarët, si etni, kanë jetuar në Perandorinë Osmane. Por, mund të thuhet se, kur ky predispozicion përforcohet nga politika të caktuara institucionale, atëherë rezultatet duhen konsideruar me seriozitet. Për shembull, njëri ndër argumentet lidhur me dallueshmërinë e jahudinjeve si grup etnik, është se mbas çdo periudhe pushtimi, skllavërimi, apo eliminimi, jahudinjtë që mundën të shpëtonin, ishin profesionistët, ata që kishin përgatitje dhe dije që iu duheshin sundimtarëve të ndryshëm, që nga egjiptianët, tek babilonasit, tek seleukidët, tek romakët, e deri tek Lufta e Dytë Botërore. Në çdo valë, jahudinjtë që shpëtuan ishin më të zotët, më të aftët, e ata më në gjendje. Kjo teori e selektivitetit, simbas Podhoretz e të tjerëve shpjegon edhe shkallën e lartë të arritjeve të jahudinjeve në kohën moderne.

Në rastin tonë, ka pasur përpjekje që të aplikohet po kjo teori. Por, drejtimi ka qënë në kah të kundërt. Teza është hedhur se përmes devshirmesë, si dhe rekrutimit të djemve më të aftë e më të zotë për në ushtri e shkuarjes në luftëra, raca shqiptare u dobësua sistematikisht. Një tezë tjetër është se kishte një politikë osmane në këtë drejtim. Pjesa më e aftë e bashkësisë islame shqiptare

mërguan në pjesët e tjera të perandorisë, ku kishin mundësi që të ecnin përpara, si politikisht, ashtu edhe ekonomikisht. Bashkësitë ortodokse dhe katolike zhvilluan një mënyrë të sjelluri, e cila ishte e vulosur në mënyrë të pashlyeshme prej këtyre përvojave. Por, kjo teori nuk qëndron për shumë arsye. Nga një anë, numri i shqiptarëve të rekrutuar në devshirme ka qënë gjithnjë i vogël, në një popullsi që gjithnjë e ka kaluar milionin. Bashkësitë kanë qënë të përcaktuara nga përkatësia fetare dhe jo etnike. Ka pasur, gjithnjë, një masë të konsiderueshme individësh nga grupe etnike të tjera që janë asimiluar në bashkësi të caktuara fetare. Por, nga ana tjetër, përpara pushtimit osman, shqiptarët, si popull, kanë kaluar në përvoja që njihen si grykëshishe, d.m.th., kur numri i shqiptarëve ka qënë i vogël dhe për shkaqe të caktuara, janë zhvilluar ose kultivuar disa elemente të mendësisë apo fizike, që përvoja osmane vetëm sa i theksoi, por nuk i zëvendësoi apo i eliminoi. Por, kjo tezë meriton kërkon një argumentim më të thelluar e më të detajuar shkencor.

Në kohët moderne, në veçanti, rolin e Beljajevit si përzgjedhës e luajnë strukturat autoritative, e në veçanti, shteti. Natyrisht, asnjë shtet nuk mund të jetë aq i qëndrueshëm në kohë, apo aq i fuqishëm sa të ndjekë një plan të tillë, deri në zbatimin e tij final. Kur vjen puna tek njerëzit, nuk ka asgjë që është e përfunduar, apo e dhënë, një herë përgjithmonë. Shtetet ndryshojnë, natyra njerëzore është shumë e komplikuar dhe e adaptueshme, dhe kultura e grupit shpesh zhvillohet në kundërshtim me interesat e shtetit.

Shkurt, njerëzit nuk mund të kontrollohen e të përzgjidhen në atë mënyrë që të shkojnë në një rrugë apo në një tjetër dhe të mbesin të ngrirë me një predispozicion gjenetik, në mënyrë definitive. Njerëzit mendojnë dhe bëjnë zgjidhje duke përdorur arsyen dhe ndjenjat e tyre. Në mos tjetër, njeriu është nga qëniet e pakta që mund të fshehë ndjesitë e veta dhe të thotë bindshëm të kundërtën e asaj që mendon. Kultura e trashëguar është një faktor i rëndësishëm në sjelljen e individëve, por, me karakter të dyanshëm, sepse është edhe një pengesë e fortë për sjellje që normat kulturore i konsiderojnë të papranueshme.

Personalitetet e ndryshme të njerëzve, ashtu si edhe defektet e tyre, fizike e psikologjike, janë një pengesë e rëndësishme. Shkartisja nuk ndodh gjithnjë mes të përzgjedhurve me të njëjtin predispozicion gjenetik. Një nga shembujt më të përdorur për të ilustruar këtë shndërrim është degjenerimi i dinastisë osmane mbas Sulltanit të dhjetë.

Megjithatë, është një fakt i njohur se paritë e vendeve të caktuara janë përpjekur që të zhvillojnë dhe të përzgjedhin një grup njerëzish që do të kishte karakteristika të caktuara e të dallueshme nga të gjithë të tjerët. Një ndër rastet më të spikatura ka qënë përpjekja sistematike, por jetëshkurtër e nazistëve gjermanë për të krijuar racën superiore ariane, e cila, sipas mendësisë së tyre, do të kishte karakteristikat e përshtatshme për të sunduar botën. Eksperimenti tjetër, që synonte krijimin e një grupi të caktuar, ka qënë ai i drejtuar nga Pol Poti në Kamboxhia. Por, eksperimente të tjera afatgjata janë ruajtja e strukturës së parisë angleze në shekuj. Praktika të njohura për kultivimin e disatributeve të caktuara janë praktikat raciste apo martesat brenda sekteve, tribuve, kastave, apo jashtë familjeve të zgjeruara.

Në këtë kategori futet edhe përpjekja e pashoqe e Enver Hoxhës dhe e parisë së Tiranës, gjatë kohës së sistemit diktatorial. Përpjekja e sistemit ishte për të krijuar një lloj të ri njeriu, i cili duhej të ishte i përshtatshëm për të punuar e për të funksionuar në strukturat e shtetit e të shoqërisë, ashtu siç mendonin, e siç kërkonin sunduesit e kohës. Ky lloj i ri njeriu duhej të ishte njeriu i ri socialist, *homo albanicus*, krejtësisht i formësuar në bazë të nevojave të sistemit, që kishin ndërtuar Enver Hoxha dhe paria e Tiranës. Sistemi ishte i kopjuar nga rusët, por edhe i mbështetur në praktikat e kishës dhe të inkuizicionit spanjoll, veçanërisht në besimin se duheshin katër breza për të ndërruar mendësinë e për t'u konsideruar si i përgatitur për t'u integruar në shoqëri me të drejta të plota.

Në fund të hierarkisë shoqërore ishin "elementët e deklasuar", armiqtë që duheshin "riedukuar", trashëgimtarët e grupeve, të përcaktuara si shtresë sunduese, përpara vitit 1944. Në këtë grup hynin edhe "armiqtë e popullit", kulakët dhe të tjerët, që

konsideroheshin si të pasur, si dhe pjestarët e parisë sunduese, që kishin rënë viktimë e luftës midis klaneve të parisë. Në një rreth më lart ishin hajnat, cubat, pushtët, kodoshët e njerëzit e të gjithë veseve që vinin, në masë të madhe, nga familje që nuk e kishin damkën e “armikut të klasës”, një damkë e përjetëshme. Këta edhe mund të rehabilitoheshin, qysh fëmijë e deri në një moshë të caktuar, bile edhe të përdoreshin si shembull për suksesin e sistemit. Përtej kësaj bote të nëndheshme, fillonte struktura e shoqërisë normale, njerëzit që konsideroheshin se ishin në rregull me ligjin, që mund të kishin një punë, që mund të ngjiteshin në shkallët e karrierës, që përbënin masën. Këta ishin katundarët, proletariati urban dhe inteligjencia.

Brenda këtyre strukturave klasore gjendej masa e parisë së tretë, që e lidhte parinë me këtë grup, mësuesit, oficerët, inxhinierët, agronomët, anëtarët e thjeshtë të partisë, apo edhe sekretarët e rinisë dhe kryetarët e lagjeve apo të organizatës së grave. Sipër këtyre, qëndronte një grup selektiv i shoqërisë, Sigurimi i shtetit, strukturat udhëheqëse të partisë në nivele lokale, shefat e kuadrit, drejtorët e me radhë. Paria e vërtetë, rrethi i parë fillonte me sekretarët e komiteteve të partisë, me anëtarët e qeverisë, me anëtarët dhe kandidatët e Komitetit Qendror, me gardën e ngushtë pretoriane dhe familjet, klanet e ngushta të figurave kryesore të regjimit. Për shumë kohë, dyshja e padiskutueshme në krye të shtetit, e rrethuar nga njerëz besnikë, që shpesh nuk kishin pozita formale në sistem, ishin Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu. Shumica e rrethit të parë ishte e përqëndruar në Tiranë. Fitorja graduale e klanit të Enver Hoxhës e shkoqiti dhe thërmoi klanin e Shehut, si dhe shtresën e parisë së lidhur me të. Mirëpo, në gërmadhat e tij, mbetën klanet e konsoliduara të Hysni Kapos apo të ortodoksëve të Korçës e të Elbasanit. Këto klane, deri atëherë dytësore dhe të lidhura me njerën ose tjetrën palë të parisë, u fuqizuan dhe u bënë shtylla të forta të parisë, tashmë të përqëndruar dhe të lokalizuar në Tiranë. Rrjeti i lidhjeve u konsolidua me martesë, miqësi, edukim dhe përvoja të shumta e të përbashkëta. Paria filloi të trashëgohej. Mënyra më e mirë ishte edukimi jashtë vendit, monopolizimi i ekspertizës dhe vendosja në pika nevralgjike e trashëgimtarëve.

Kështu, me të gjithë mënyrat e mundshme, paria arriti të merrte monopolin edhe në këtë fushë.

Objektivi i sistemit kishte qënë formimi i njeriut të ri. Në të gjitha nivelet, njeriu i ri duhej të ishte një njeri me partishmëri, me përkushtim ndaj shtetit, ideologjisë enveriste dhe i gatshëm të jepte gjithçka për socializmin. Nën koren e dhunës dhe të konformimit, dukej se sistemi kishte qënë shumë i suksesshëm dhe se kishte një legjitimitet të thellë. Mbështetja që gëzonte në shtresa të gjera të popullsisë ishte e dukshme, e prekshme dhe vinte natyrshëm. Entuziazmi në mbështetje të sistemit kishte arritur nivele historike. Mirëpo, kur sistemi u shemb, në gërmadhat e atij sistemi u pa se njeriu i ri socialist, veçanërisht individi që iu përkiste rrathëve të poshtëm të shoqërisë, ishte një qenie shumë e dyzuar, hipokrite, cinike ... dhe krejtësisht e çoroditur. Të gjithë përvojat e përjetuara gjatë sistemit të kaluar ishin fshirë si me magji, dhe në kujtesën e të gjithëve mbetën vetëm anët negative, që tashmë vetë paria po i propagandonte si të tilla.

Megjithatë, paradoksi ishte se në se kishte ndonjë grup që kishte ndryshuar thelbësisht e rrënjësisht gjatë sistemit të Enver Hoxhës, ishte vetë paria e Tiranës. Sistemi enverist arriti t'i ndryshonte të gjithë shqiptarët, por, mbi të gjitha, arriti që të krijonte një lloj të veçantë jeniçerësh në parinë e Tiranës. Duke qënë në kontroll absolut të shtetit e të institucioneve, duke i njohur shtërngesat e shtetit, paria e Tiranës zhvilloi sensibilite të dallueshme nga pjesa tjetër e popullsisë. Në dy breza, mendësia e saj kishte ecur në kahe krejt të kundërta me mendësinë e popullit. Mbi të gjitha, e rritur me një urrejtje të frikshme për gjithçka kombëtare apo që kishte të bënte me popullin e vet, paria jeniçere e Tiranës e tregoi fytyrën e vet të vërtetë, menjëherë sa po iu dha mundësia. Dhe, fytyra e mendësia e parisë ishin të frikshme. Në thelb të mendësisë së parisë ishte një cinizëm i pashoq, një hipokrizi shembullore, një përbuzje e thellë dhe urrejtje për popullin e vet, mendësi klanore, një materializëm i skajshëm, mungesë e theksuar vlerash e morali, pragmatizëm, arrivizëm, si dhe një shpirtvogëlsi ekstreme.

Paria e pati shansin historik për të përmirësuar gjendjen, si para vitit 1990, ashtu edhe më pas. Këta individë mund të delnin

nga lëkura e tyre dhe të viheshin në shërbim të popullit. Por, këta vendosën që të bëjnë të kundërtën. Dhe, në proces e sipër, paria tregoi se kush ishte ajo, si njerëz, dhe si shtresë. Ishte fatkeqësi e madhe për shqiptarët që pjestarët e eksponentët e asaj parie, ndër të tjerë, Ramiz Alia, Fatos Nano, Gramoz Ruçi, Skënder Gjinushi, por edhe Sali Berisha, Gramoz Pashko e me rradhë mbetën apo dolën në krye të shtetit shqiptar. Këta ishin të gjithë njerëz të informuar për çka po ndodhte dhe ku duhej shkuar. Për shumë vite, ata e dinin mirë se cila ishte gjendja. Gjendja ishte me të vërtetë e mjerë, por, për vite të tëra, këta nuk bënë gjë. Si mund të besohej se, po të liheshin në krye të punëve dhe të drejtonin tranzicionin, këta do të bënin ndryshimin për mirë? Mirëpo, këta kishin punuar që të mos kishte të tjerë dhe, në fakt, nuk kishte të tjerë.

Edhe gjatë tranzicionit, synimi i tyre ka qenë dhe mbetet ndrrimi i kahut të tranzicionit, në drejtimin që u shërben atyre, si shtresë dhe si individë. Përtej grindjeve të ditës e sjelljeve prej rrugaçësh të orës së fundit, përtej kacafytjeve televizive, ata e dinë mirë se çka kanë dashur dhe se çfarë duan. Ajo që i bashkon pazgjidhshmërisht me njëri-tjetrin nuk është vetëm formimi, e shkuara, lidhjet personale, apo të natyrave të tjera. Ajo që i bashkon pazgjidhshmërisht me njëri-tjetrin, është edhe interesi i tyre i përbashkët, për të transformuar shoqërinë në atë mënyrë që ajo t'iu shërbejë interesave të tyre.

Është krejtësisht e qartë se, qysh në fillim, këta, besnikë të sistemit të kaluar, kanë pasur një plan të qëndrueshëm e koherent për transformimin e shoqërisë shqiptare dhe krijimin e njeriut të ri të tranzicionit, *novus homo albanicus*. Përmes vendosjes së kapitalizmit, ata synojnë që shoqëria shqiptare të bëhet një shoqëri klasore. Pasoja është se shqiptarët do të transformohen në proletarë, d.m.th., në skllëvërit e tyre modernë. Si të tillë shqiptarët duhet që të jenë në shërbim të tyre, të jenë pjesë e sistemit të tyre, të ndajnë vlerat e tyre, të mos arrijnë që të mendojnë ndryshe prej tyre. Ata duan një shoqëri në fytyrën e tyre e në shërbim të tyre, pa vetëdije tjetër, pa vlera të ndryshme e pa pikë ndërgjegje e përgjegjësie shoqërore. Prandaj, paria nuk u ngrit në nivelin e momentit historik të transformimit në elitë kombëtare.

Paria ka mjete të shumta në dispozicion për të mburjtur njeriun e ri. Megjithatë, mekanizmat kryesore për të arritur këtë objektiv janë, mbajtja e një shteti të dobët, hallakatja mendore e shqiptarëve, sundimi me dorë të hekurt i shoqërisë përmes strukturave politike partiake, sistemi informal i sundimit, korruptimi sistematik i shoqërisë, krijimi i një *lagermentalitat* fals dhe vendosja e objektivave politike të pambrirshme që e mbajnë shoqërinë të varur. Si pasojë, shoqëria shqiptare është transformuar e po transformohet në një grup të frikshëm njerëzish që nuk kanë asgjë të përbashkët me shoqëritë e ligjshme. Shoqëria shqiptare ka gjithçka të përbashkët me botën e krimit, të zvetënimit e të vesit dhe shumë pak të përbashkët me shoqëritë normale. Paria sunduese është plotësisht e vetëdijshme se të ardhurat kryesore në shoqëri vijnë nga aktivitetet e paligjshme, drogat, prostitucioni, kontrabanda, vjedhja e shtetit dhe burime të tjera. Mirëpo, gjatë kohës së sistemit të mëparshëm, hajnia ishte një zgjidhje e problemeve të jetesës. Por tash hajnia është krenari kombëtare. Hajni ma i madh nderohet si nderi i kombit. Poshtërsia e sjellja e pandershme kanë qenë moralisht e shoqërisht të dënueshme. Tash, me qenë “kopil i madh” është virtyt publik.

Paradoksi i transformimit të njeriut qëndron në faktin sepse paria po mundohet t’ia arrijë qëllimit të vet, duke e mbajtur shtetin qëllimisht të dobët. Por, shteti është instrumenti kryesor për ndryshimin e njerëzve dhe për krijimin e mendësive të reja. Atëherë, si mendon paria e Tiranës që, me një shtet të dobët, ta transformojë shoqërinë shqiptare? Mekanizmi që ajo ka gjetur është i shumëfishtë dhe ia vlen të analizohet me vëmendje.

Së pari, krimbi e gërryen mollën nga brenda. Prandaj me shqiptarët e me të tjerët, që jetojnë me ta në shtetin shqiptar, paria e Tiranës vepron me kujdes. Ajo e mban të gjithë shoqërinë të varur për një kafshatë bukë, d.m.th., me një vend pune. Standardi i jetesës që ka vendosur shoqëria është i pamundur të ruhet për njeriun që jeton me një rrogë zyrtari apo buxhetori. Rroga vjetore duhet të mbulojë 10 %, taksën që mban shteti, 3,000 dollarë në vit kredinë e apartamentit, 2,500 dollarë në vit shpenzimet e makinës (kredi, sigurime, naftë dhe mirëmbajtje), 1,000 dollarë dritë, gaz

e ujë, 700 dollarë telefonat, të shtëpisë dhe celularë, 500 dollarë internetin, dhe 250 dollarë kabllorin. Një gruaje mesatare i kushtojnë lyerja e thonjve dhe rregullimi i flokëve rreth 600 dollarë në vit. Kjo pa llogaritur shpenzimet e tjera personale, si kafetë e pijet e përditshme, ushqimet, veshjet, dhe cigaret. Kjo nuk llogarit edhe shkollën private, mësimet e gjuhëve të huaja dhe të lëndëve të ndryshme, dy herë pushime në vit (më të lirat në Maqedoni, por edhe në Turqi, Itali, Spanjë, e deri në Antibe apo në Bali), si dhe shpenzimet e paparashikuara, si mjekime, operacione, sebetpet e pafund familjare, drekat e darkat në restaurante ku, edhe pjata me spageti *alla bolognese*, të kushton më shumë se në Romë, d.m.th., 10 euro.

Nëse ndokush mendon se paria nuk është e vetëdijëshme që zyrtarët e të gjithë niveleve vjedhin e korruptohen për të mbajtur këtë standard jetese, atëherë ai nuk e ka vizituar asnjëherë shtetin shqiptar. Paria, dhe gjithë të tjerët, shkojnë në të njëjtat restaurante, frekuentojnë të njëjta kafe, pushojnë në të njëjtat vende. Paria shkon në Dhërmi, të gjithë të tjerët shkojnë në Dhërmi. Paria e ndërton vilën në Petrelë, të gjithë duan të shkojnë në Petrelë. Paria takohet në Sheraton, të gjithë duhet të shkojnë e të shihen në Sheraton. Një këngëtare lidhet me dikë të parisë, dhe të gjithë turren për vete. Ky është një rreth i mbyllur. Të gjithë e dinë se sa e ka rrogën gjithkush, me se jeton, në cilën shkollë i çon fëmijët, kush është vjehrra, ku i ka bërë operacionet vajza dhe gruaja, si dhe se ku i kalon pushimet familja e tij, e çfarë vere kiliane apo neozelandeze pi. Të gjithë e dinë se nuk mbahet ky standard jetese me rrogën e mësuesit, të mjekut, të policit, të oficerit apo të zyrtarit.

Së dyti, paria bën të njëjtën gjë me shtresat e tjera. Kështu, paria e shtyn dhe e lejon prodhuesin e vogël që të korruptohet e të zvetënohet sa më shumë që të jetë e mundur. Ajo e inkurajon prodhuesin dhe tregtarin e vogël, që të ecë në rrugën e së keqes e të vesit përmes favoreve, rushfetit, varësisë prej politikës apo kalimit të mallrave në dogana. Nga ana e njerëzve të thjeshtë, vuajtja për të shkuarën, ashtu edhe untia njerëzore për mall, pronë e pushtet mbi të tjerët, nuk njeh kufij. Rruga më e shkurtër për të gjithë është

që të anashkalohej ligji. Mirëpo, duke u përqëndruar në interesin e vet të momentit, njerëzit harrojnë se arma e preferuar e parisë është krijimi dhe konsolidimi i një morali shoqëror dhe i normave të sjelljes, që legjitimojnë të gjithë veset e zvetënimet e mundshme. Në këtë mënyrë, paria ia ka arritur që të imunizojë shoqërinë nga vlerat e vërteta njerëzore e normale. Në veçanti, brezi që ka lindur gjatë e mbas viteve 1980-të, është jashtëzakonisht i ekspozuar dhe, në masë të madhe, shumë i imunizuar ndaj këtyre fenomeneve dhe veprimeve, që, përndryshe, në çdo kohë tjetër, do të ishin konsideruar tërësisht imorale dhe amorale.

Po ashtu, duhet theksuar se njerëzit kanë vuajtur shumë në të shkuarën. Ata kanë vuajtur për gjëra materiale, kanë vuajtur që ishin me pakicë në shoqërinë e kohës, por edhe kanë vuajtur duke e jetuar jetën e të huajve përmes ekranit e duke e dëshiruar jetën e shtresave shoqërore që janë pasanikë në Perëndim. Paria e përdor këtë vuajtje të njerëzve të thjeshtë, nivelin absolutisht mjeran të së shkuarës për ta theksuar “suksesin” që ata kanë arritur. Po ashtu, paria e përdor untinë njerëzore dhe materializmin, si rripa të hekurt që e mbajnë shoqërinë të lidhur mbas saj.

Paria është e vetëdijshme që trysnia shoqërore i bën njerëzit të konformohen. Duke mos pasur vlera e standarde të mirëfillta, njerëzit ndjekin në masë televizionin dhe mjetet e propagandës. Dhe ajo që shitet si standard mode e veshje në Tiranë është, pak me thënë, veshje ekzotike apo ekstreme diku tjetër. Në mungesë të dijeve e të vlerave të mirëfillta nga ana e popullit, paria e di se njerëzit do të kërkojnë që të ndjekin standardet e modës më të fundit në Paris. Në se në Paris vishen me pantallona të bardha në maj, në Tiranë moda shkon në qershor, dhe vitin tjetër vjen në Nju Jork. E njëjta gjë ndodh edhe mjetet elektronike, telefonat, makinat, e pajisjet më të fundit. Njerëz që janë bosh, mundohen që të gjejnë kuptimin e jetës së tyre në blerjen e pasjen e shpikjeve të fundit. Statistika e fundit që del është se 4700 fëmijë të vegjël shqiptarë trafikohen në Greqi. Në të njëjtën ditë, kryeministri i shtetit del me *IPad* në dorë në konferencë për shtyp e flet se si në fund të viteve 1970, ai ka pasë punuar me kompjuter Apple. (!)

Tashmë në shtetin shqiptar, edhe në nivelin shoqëror nuk

është e pranueshme që të ketë standarde jetese, që s'janë të njëjta me pasanikët në vende të tjera. Paria ka punuar me shumë efektivitet që të krijojë në mendjen e njerëzve një mendësi të tillë, ku të gjithë duhet të sillen sikur kanë dhjetë shërbëtorë në shtëpi. Duke shpërblyer sistematikisht e me shuma përrallore disa lloje sjelljesh e duke dënuar disa të tjera, përmes shoqërisë, politikës, mediave, e bile edhe përmes sistemit të thashethemeve, strukturat autoritative të parisë së Tiranës kanë krijuar e rikrijujnë një model sjelljeje efektiv që është i pranuar si i moralshëm nga shtresa të gjera të shoqërisë. Ky model sjelljeje i ka transformuar, si zyrtarët e shtetit, ashtu edhe të gjithë qytetarët në një luzmë njerëzish që shkon kah don paria sepse edhe të ardhurat e mundshme për të përballuar këtë mënyrë jetese vijnë ose përmes lidhjeve me parinë, ose përmes botës së krimit, që lulëzon sepse e lejon paria. Qytetari model i këtij sistemi është hajni-militant-afarist dhe femra e zhveshur, që kalon ditën e natën në lokalet e ndryshme. Ky lloj njeriu, që *'ka lind për qejf'*, siç thotë kënga e njohur, i duhet parisë. Këtë model sjelljeje e shpërblen paria e Tiranës dhe individët e shtresat e tjera e emulojnë masivisht. Mirëpo kjo sjellje, shumë e pranuar në Tiranë, kërkon që të financohet në një mënyrë. Edhe në Tiranë bie shi, nuk bien paratë nga qielli.

Një nga metodat më efikase është përzgjedhja e njerëzve, që duhet të vazhdojnë të jetojnë në shtetin shqiptar. Ata që dinë e kanë mend, por nuk konformohen, duhet të ikin. Në shtetin shqiptar duhet të rrinë e të mbesin vetëm ata që bëjnë çfarë thotë paria. Mirëpo, nuk mund të futen të tjerët në burg ose të nisen në kamp të përqëndrimit.

Prandaj, paria përdor metodën e seleksionimit përmes mërgimit. Paria nuk ka fare nevojë që të përdorë forcën, që të izolojë shoqërisht ata që nuk pajtohen me të. Paria nuk vepron ashtu siç bënte në sistemin e mëparshëm. Të gjithë ata që nuk duan të jetojnë në atë vend, të gjithë ata që nuk duan të ndjekin rregullat e lojës të vendosura prej parisë, janë të inkurajuar që të ikin jashtë shtetit, të degdisen ku të munden. Shteti shqiptar iu takon "militantëve" dhe "qëndrestarëve" të parisë, atyre që nuk "ikën", por që duan "ta bëjnë Shqipërinë". Por, rezultati shihet qartë.

Shteti shqiptar dhe njeriu i ri, që jeton aty, është krijesa e parisë. Paria e Tiranës e konsideron shtetin shqiptar si pronën e saj dhe kërkon një lloj njeriu të caktuar që të ekzistojë në atë pronë.

Shumë shqiptarë mbrijnë në përfundimin e duhur vetë, pa ndonjë shtysë prej saj dhe ikin në mërgim. Në fakt, shumica dërmuese e atyre që kanë ikur në mërgim janë pikërisht nga shtresa e njerëzve që duan të jetojnë me nder, që e kuptojnë se çfarë po ndodh në shtetin shqiptar. Nuk është rastësi që rreth 67% e ligjëruesve universitarë me grada shkencore kanë emigruar. Sot, pa frikë mund të thuhet se gjen më shumë mjekë, inxhinjerë, ekonomistë, mësues, e profesionistë shqiptarë në Toronto e në Nju Jork, me diploma universitare e pasuniversitare të fituara në shkolla elitë që nga Harvard, Princeton, Columbia, Oxford dhe Cambridge se sa gjen në Tiranë, Shkodër, Vlorë, Korçë, Durrës, Fier apo Elbasan.

Sistemi i dëbimit të trurit të kombit, të atyre që nuk pajtohen me parinë, është shumë i sofistikuar, sepse paria nuk i thotë askujt që të ikë. Ikja nga shteti shqiptar është vendimi i tyre personal. Paria vetëm sa e respekton atë vendim të tyre për të ikur nga vendi i vet. Bile, në shtetin shqiptar emrat e fituesve të *Green Card* dhe të lotarive për leje qëndrimi botohen në gazeta; dorëheqja nga ana e mërgimtarëve e qytetarisë shqiptare është një nga pjesët më të rëndësishme të botimit në *Gazetën Zyrtare*. Problemi është se mbi një milion e gjysëm shqiptare kanë ikur e nuk kanë ndërmend që të kthehen më, jo pse nuk duan, sepse aty i kanë hedhur kursimet, por se u vjen frikë e neveri kur shohin se çfarë shoqërie është krijuar atje. Ata nuk kanë asnjëfarë lidhjeje me atë shoqëri. E kështu, njerëz pa atdhe, ata që kanë mend, preferojnë të kthehen në vendet ku janë të huaj, por njerëz me vlera e me dinjitet. Për shembull, në vitin 1991, vetëm 3.2% e masës së emigrantëve ishin njerëz me universitet të mbaruar apo me grada shkencore. Në vitin 2006, para se të shpërthente piramida e arsimit universitar, përqindja e emigrantëve me universitet të mbaruar, apo që kishin pasur një vend pune si nëpunës, ishte rritur në 13%. Sipas Ministrisë së Punës, në vitet 1990-të, 40% e njerëzve me arsim universitar janë larguar nga shteti shqiptar.

Pra, pak a shumë, në këto 20 vjet, para e Tiranës ia ka arritur që të transformojë rrënjësisht shoqërinë shqiptare. Ata që nuk kanë mundur të jetojnë më në shtetin shqiptar, kanë ikur. Ata që kanë pasur lidhje, kanë ikur. Ata që kanë gjetur mundësinë, kanë ikur. Ata që kanë mbetur, nuk kanë zgjidhje të tjera, por konformohen. Shumë nga ata që kanë mbetur, tashmë e pranojnë sistemin e parisë dhe e konsiderojnë si mënyrën e vetme të jetesës. Edhe botën kur e shohin, këta e shohin përmes lenteve të sjelljes në shtetin shqiptar.

Këtu duhen theksuar edhe dy aspekte të tjera. Hendeku midis shqiptarëve që mbesin në shtetin shqiptar dhe atyre që punojnë në profesionet e tyre në botën e huaj është i pakapërcyeshëm. Askush më mirë se mërgimtarët që kthehen mbas një kohe të gjatë, nuk e kupton se sa larg janë ata mërgimtarë të ikur me kohë prej njeriut të ri të krijuar nga para e Tiranës gjatë këtij tranzicioni, vetëm 20 vjeçar. Njeriu model i tranzicionit është bosh, materialist, hipokrit, pa vlera morale të vërteta, arrivist, me një edukim gjysmak, pa pikë ndjenje shërbimi publik. E dyta, natyrisht, jo të gjithë shqiptarët kanë rënë në këtë kurth të parisë. Rezistenca e grupeve të caktuara është intense dhe në rritje.

Por në dukje, thuajse të gjithë konformohen me sjelljen e pritur nga para. Brezi i ri nuk njeh moral tjetër dhe herët a vonë, i duhet që të vendosë. Pra, Beljajevi duhet të rrotullohet në varr sepse, në dukje dhe gjykuar nga mitingjet e nga tamtamet e mediave, para e Tiranës po ia mbririn objektivit të vet vetëm në dy breza. Ajo ia ka arritur të transformojë shoqërinë dhe ta bindë popullin shqiptar se kjo është rruga ku duhet të shkohet e tjetër zgjidhje nuk ka.

Edhe Enver Hoxha duhet të rrotullohet në varr (atje ku e kanë fshehur), sepse krijesat e shërbyesit e tij bënë tamam atë që ai nuk kishte mundur as ta imagjinonte. Këta ia arritën përmes spastrimit të bënin atë që e kishte inkurajuar përmes shtimit të popullsisë. Këta ia arritën që të krijonin një njeri të ri, pavarësisht se sa i përbindshëm do të ishte ky *novus homo albanicus* edhe për Enver Hoxhën vetë. Mirëpo, para nuk është e sigurtë se ajo çka ka krijuar i shërben asaj pa kushte. Ajo nuk është e sigurtë se mundet me e kontrollue gjendjen deri në fund. Ajo nuk e din me

siguri se çka bluan në mendje ky njeriu i ri i tranzicionit. Njerëzit janë të adaptueshëm. Ata kanë arsye e mendojnë. Prandaj, paria është e shqetësuar dhe ka shumë arsye të jetë e shqetësuar. Nuk dihet se çka ka me i sjellë dita nesër, se ndoshta, këtij *novus homo albanicus* i janë ndrruar vetëm reflekset e kushtëzuara e jo predispozicioni gjenetik.

RRETHIMI DHE INTEGRIMI – MBI KONCEPTIN STRATEGJIK TË PARISË SË TIRANËS

Në thelb të marrëdhënies së shtetit me qytetarët e vet, (kjo vlen për të gjitha shtetet), qëndron një marrëveshje e pashkruar, rëndësia e së cilës bëhet e dukshme vetëm në momentet kur shteti gjendet në krizë të thellë. Kjo marrëveshje mbështetet në besimin reciprok, se shteti do t'iu ofrojë të gjithë qytetarëve të vet sigurinë e jetës, të mirëqënies ekonomike dhe rregullin e duhur shoqëror. Të tre këto forma të sigurisë janë të ndërlidhura dhe të pashkëputshme nga njëra-tjetra. Këto tre forma të sigurisë janë të ndërlidhura në konceptin bazë strategjik të shtetit. Ky është objektivi që mbetet në themel të politikave të shtetit.

Shtetet që ua ofrojnë këtë siguri qytetarëve të tyre janë shtete të qëndrueshme, me qytetarë besnikë, me mirëqënie relative me një rend shoqëror që pranohet nga të gjithë si legjitim. Këto shtete kanë koncepte strategjike, që janë të dallueshme nga njëri-tjetri, por që mendohet se janë në shërbim të interesave të popujve të tyre. Shtete të tilla janë Sllovenia, Franca, Gjermania, Izraeli apo Taivani.

Mirëpo, ka shumë raste kur shteti kapet e vihet në shërbim të një grupi të caktuar. Në këto raste, shteti instrumentalizohet e shfrytëzohet prej këtij grupi. Ky grup, që merr kontrollin e shtetit, zakonisht fillon si një grup me interesa shumë të ngushta, të dallueshme nga interesat e shtetit e të qytetarëve të tjerë. Duke përdorur mjetet e shtypit e propagandën, fuqinë ekonomike, lidhjet me politikën, me zyrtarët, ushtarakët, policinë, etj., ky grup ia arrin që të zaptojë shtetin.

Çka është edhe më problematike, ky grup ia arrin që t'iu

imponojë shtetit e qytetarëve konceptin bazë strategjik se si do të arrihet siguria e shtetit dhe e qytetarëve vetë dhe, kështu, bëhet paria sunduese e tyre, në shumë raste edhe elita e vërtetë e një populli. Në parantezë, duhet thënë se ka një dallim të madh midis parisë sunduese dhe elitës. Të paktën në parim, elita (të zgjedhurit) e udhëheq popullin e shtetin, duke vepruar me mendësinë e shërbimit publik. Nga ana e saj, paria (ata që kanë fuqinë) e sundon popullin e shtetin duke vënë, mbi të gjitha, interesat e veta të ngushta.

Ky është thelbi i problemit tonë. Ky është edhe fillimi i ikjes nga realiteti dhe i ndërtimit të një realiteti absurd, që jetohet nga qytetarët. Realiteti që ndërtohet, në fakt, është jeta e tyre. Mirëpo, gjithçka është në shërbim të pastër të parisë. Kjo ndodh sepse, ndërsa duket se shteti po i mbron qytetarët e vet, në fakt shteti e qytetarët po i shërbejnë parisë. I vetmi grup që përfiton nga kjo gjendje absurdi është paria.

Duke mos pasqyruar interesat e vërteta, reale dhe jetike, të qytetarëve dhe të shtetit vetë, koncepti strategjik i shtetit, i sendërtuar nga paria sunduese, bëhet baza për aventura politike. Aventurat politike nuk janë thjesht aventura. Ato natyrisht i shërbejnë këtij grupi dhe përmbushjessë interesave të tij. Aventurat politike janë shkatërrimtare për shtetin e qytetarët, mirëpo nuk janë për parinë që lulëzon e përfiton. Realiteti që krijohet, e që është i mbështetur mbi këtë koncept fals sigurie është një realitet absurd. Është realitet sepse njerëzit e jetojnë përditë atë jetë. Por, është absurd, sepse është i ndërtuar mbi premisa që nuk janë reale e të vërteta. Premisat e realitetit, ku jetohet përditë, janë të imagjinuara, të rreme dhe në shërbim të këtij grupi.

E megjithatë, për njerëzit, kjo është jeta që jetojnë ata. Zgjidhjet që bëhen nga njerëzit edhe kur ky sistem shembet, janë të mbështetura në këtë absurditet të jetës se tyre. Prandaj edhe zgjidhjet që bëhen nga njerëzit në realitete absurde të tilla janë të paparashikueshme, të paimagjinueshme dhe, në rastin me të mirë, anormale për njerëzit që nuk janë pjesë e asaj shoqërie. Për shqiptarët ka dy raste të shënuara historike, kur paria sunduese ia ka arritur të kapë shtetin plotësisht, të kontrollojë plotësisht

mjetet e informimit dhe të propagandës, të vendosë kontrollin e vet mbi strukturat ekonomike, politike e të sigurisë dhe të imponojë konceptin strategjik bazë të shtetit shqiptar.

Është interesante dhe me vlerë që të gjykohet se prej nga ka ardhur paria sunduese, por këtë analizë e kam bërë në një shkrim tjetër. Por, ia vlen që shkurtimisht të përmenden e të vlerësohen dy konceptet bazë strategjike që kanë rezultuar shkatërrimtare për shqiptarët, por që, natyrisht, kanë qenë e janë krejtësisht në interes të parisë sunduese.

Në parantezë, duhet thënë se çdo shtet normal synon që para të gjithave të sigurojë mbijetesën e vet. Shpesh edhe përkundër interesave imediate të parisë, kjo mbijetese është në thelb të konceptit strategjik të shtetit. Mbijetesa sigurohet duke pasur bazën territoriale, ekonomike, ushtarake e demografike dhe mandej aleancat që të lejojnë që të ndjehesh i sigurtë nga rreziqet që mund të paraqiten në sistemin ndërkombëtar.

E në rastin shqiptar? Po të ishte një shtet e popull normal, interesi i shtetit shqiptar duhej të ishte fuqizimi i bashkëpunimit ndërshtetë, përhapja e këtij koncepti strategjik të shtetit që e lidh kombin me shtetin dhe i bën qytetarët besnikë të shtetit. Mandej, në kontekstin e lojës politike ballkanike, shteti i shqiptarëve do të ishte në gjendje që të jepte e të merrte si i barabartë me shtetet fqinje. Në këtë mënyrë, të gjitha problemet e shumta më të cilat përballemi, do të mund të zgjidheshin pak a shumë drejt e disa edhe në interes të shqiptarëve.

Mirëpo, gjatë këtij gjysëm shekulli, dy konceptet bazë strategjike të adaptuara nga paria e Tiranës i kanë rënë ndesh katërcipërisht interesit strategjik të shtetit e të vetë qytetarëve. Duke menduar për ruajtjen e sundimit të vet, paria e Tiranës, si gjatë kohës së Enver Hoxhës, ashtu edhe tashti, synon vetëm e vetëm t'i ikë realitetit të politikës së vërtetë.

Ajo ka ndjekur e po ndjek interesat e veta, që janë të qarta, por që janë në kundërshtim të plotë me interesat e popullit të vet. Paria ka qenë e don që të mbesë në kontroll të shtetit shqiptar me çdo kusht. Ajo synon të kontrollojë ekonominë e shoqërinë dhe ta transformojë shtetin në një instrument të vetin, për pasurimin

e fuqizimin e vet. Interesi strategjik i parisë është ky interes i ngushtë i saj. Ky interes ndahet nga të gjitha palët e parisë që, përveç rrahjeve e sherreve të ditës, gjithnjë e kanë gjetur e do ta gjejnë gjuhën me njeri-tjetrin.

Ja vlen që shkurtimisht të analizohen të dy konceptet strategjike të parisë së Tiranës, që e kanë formësuar politikën e shtetit shqiptar dhe që na kanë sjellë në këtë gjendje të mjerë ku jemi sot. Kjo duhet bërë, sepse një krahasim me të shkuarën do të tregojë se si më parë, ashtu edhe tani, realiteti që jetohet sot në Tiranë është një realitet absurd, pa lidhje me të vërtetën e me jetiken, me interesin e shtetit e të qytetarëve. Pasojat e këtij absurditeti janë të frikshme dhe gjurmat që do të lërë në mendësinë kolektive të shqiptarëve duhen peshuar mirë.

Në thelb të konceptit bazë strategjik të shtetit gjate kohës së Enver Hoxhës ishte ideja e rrethimit. Si fillim, duhet thënë se Enver Hoxha nuk e ka dashur kurrë kombin shqiptar. Kur i lexon veprat e tij, e sheh se atij i janë dashtë 10 vjet për të përmendur një herë Kosovën. Edhe kur e përmend, në takimin me malësorët e Tropojës, Hoxha flet për shfrytëzuesit feudalë. Prandaj, duke kërkuar t'i ikë kombit e idesë së shtetit-kombit, paria e Tiranës dhe vetë Enver Hoxha flisnin për rrethimin imperialisto-revizionist.

Koncepti bazë strategjik u bë “të jetojmë si në rrethim”. Argumenti ishte se do të na pushtonin SHBA dhe BRSS. Frika imagjinare nga një pushtim i tillë u intensifikua bash kur atij e parisë së Tiranës iu dhanë siguritë nga NATO se shteti shqiptar nuk do të prekej, thjesht sepse ishte në interesin e fuqive të mëdha për të mos krijuar probleme të këtij lloji në Ballkan. E megjithatë, paradoksalisht, shteti shqiptar u bë mishërimi i modelit makiavelian të sundimit nga princi dhe paria, si dhe të vënies në plan të parë të mbrojtjes së territorit të shtetit.

Mirëpo, paradoksi është se edhe pse nuk kishte kërcënim direkt, parisë i duhej me çdo kusht ideja e rrethimit. Po të thuhej se nuk do të na pushtonte njeri, si do ta mbanin ata pushtetin? Si do të mund t'i mbanin ata shqiptarët ne një shtet terrorist, që kontrollohej me dhunë policore? Mbi të gjitha, pse duhej të mbeteshin ata në pushtet? E kështu, duke ndjekur interesat e veta,

paria e Tiranës e ndërtoi realitetin absurd ku shqiptarët jetuan për disa dhjetra vjeçarë. Energjitë e burimet materiale, të pakta e shumë të çmueshme, u derdhën në ndërtimin e bunkerëve, në harxhimin e kohës së punës për zborë e stërvitje, për ndërtime e struktura, për tunele e armatime. Këto masa e shpenzime ishin krejtësisht joproduktive dhe në kundërshtim me interesin kombëtar të shqiptarëve në atë periudhë historike. Gazetarët e shkrimtarët, mësuesit e këngëtarët, inxhinjerët, mjekët e partiakët, që të gjithë pa përjashtim, u morën me rrethimin imperialist-revizionist.

Ana tragjikomike e kësaj loje që u luajt me shqiptarët është se paria e Tiranës nuk e besoi vetë rrenën e vet. Por, duke e luajtur lojën si duhet e deri në fund, ajo filloi t'i tregonte botës përmes propagandës së Radio Tiranës realitetin e imagjinuar shqiptar. Argumenti i saj ishte se realiteti absurd që përjetonte shteti shqiptar e qytetarët ishte realiteti që duhej të përjetonte edhe bota e huaj. Ky ishte realiteti i imagjinuar, paria e dinte këtë, të huajt e dinin këtë. Për ata që jetonin në shtetin shqiptar, ky ishte realiteti i vërtetë.

Por, ndërsa shqiptarët në shtetin shqiptar e jetonin këtë realitet dhe, në këtë realitet ishte mbyllur jeta e tyre e vetme, paria e Tiranës bënte çka ishte e mundur për të kontrolluar lëvizjet nacionaliste shqiptare jashtë vendit. Rrena ishte vetëm për popullin shqiptar e jo për parinë. Paria e Tiranës e dinte se kush ishte armiku i saj i vërtetë dhe lufta e saj ishte për të mbytur nacionalizmin shqiptar e për të mbajtur kontrollin e shtetit në duart e jeniçerëve e të aleatëve të tyre. Rrethimi imperialist-revizionist ishte një koncept që i shërbente asaj për të kontrolluar popullin e vet, "për t'iu hedhur trutë e gomarit" shqiptarëve, për t'i shmangur nga interesi i tyre jetik. Interesi jetik i shqiptarëve duhej të ishte fuqizimi i shtetit të tyre kombëtar.

Mbas vitit 1990, koncepti strategjik i shtetit shqiptar është i ndërtuar mbi idenë e integritit, euroatlantik apo european. Paria e Tiranës e të gjitha llojeve dhe e të gjitha ngjyrave, ka qenë kundër vendosjes së idesë së shtetit-kombit në qendër të konceptit strategjik të shtetit shqiptar. Arsyeja është e thjeshtë. Krijimi i shtetit-komb do të çonte në minimin e kontrollit të saj

mbi shtetin shqiptar, për shkak se strukturat që do të krijoheshin do të ishin të mbështetura në një ideologji e në një sistem tjetër vlerash prej atij të parisë sunduese. Dhe, duke ndjekur të njëjtat metoda, si në kohën e Enver Hoxhës, paria e Tiranës, që prapë ishte e njëjta në thelb e në mendësi, edhe pse e zgjeruar me një tufë të re arrivistësh, luftoi me të gjitha mjetet e mënyrat kundër kësaj ideje, duke synuar në të njëjtën kohë që ta përdorë atë për interesat e saja të ngushta.

Interesat e saj për të promovuar idenë e integritit europian janë krejtësisht të qarta. Edhe pse duket se objektivi i integritit po iu shërben qytetarëve që, në fakt, mezi presin të marrin një vizë e të shkojnë e të punojnë në të zezë, e thjesht duan të ikin nga sytë-këmbët nga vendi i tyre, paria po mendon për veten.

Objektivi i saj është që t'i mbajë njerëzit nën kontroll. Nuk ka gjasa që shqiptarët të hyjnë në Europë. Po ta dinë këtë gjë si të sigurtë, atëherë shqiptarët do të rebelohen, sepse në shtetin shqiptar nuk është gjendja aq e mirë sa duket në Bllokun e Tiranës. Por, si pushtimi gjatë rrethimit, që nuk ndodhi kurrë, edhe europianizimi gjatë integritit nuk do të ndodhë kurrë, të paktën jo në atë formë që e duan dhe e presin shqiptarët, dhe që e propagandon paria.

Mirëpo për të mbajtur popullin nën kontroll, integrimi duhet paraqitur si një proces që kërkon energji e forca të mëdha e, mbi të gjitha, durim nga shqiptarët. Në fakt, paria e Tiranës ka një sëmundje interesante, të trashëguar nga koha kur dikur e diku, kanë qënë "dikushi" në katund, marrëzinë e madhështisë. Untia e tyre për status e për pushtet është përkthyer në objektivat e saj strategjike: pasurim i shpejtë dhe sa më i madh, ndërtimi i një jete luksi dhe moderne, kontroll pa kushte i shtetit, madje edhe kur ai shtet mund të perfundojë sa një tavolinë tek Sheratoni, ikje nga përgjegjësia historike e morale dhe minim i çdo vlere shoqërore. Pjestarët e parisë nuk ngopen po nuk e panë veten si nga më të fuqishmit në Europë.

Sa kohë që ka shpresë për anëtarësim, njerëzit do të përballojnë shumë vështirësi e probleme, që përndryshe nuk do t'i pranonin. Duke e paraqitur përpjekjen e saj politike si përpjekje për integritim,

paria ka gjetur mbulesën më të mirë të mundshme. Prandaj, për të arritur objektivat e veta, paria lufton ta paraqesë integrimin si imminent e të pashmangshëm.

Kështu, Evropa është bërë miti qëndror, miti i *El Dorados* së politikës shqiptare. Mirëpo, të gjitha konceptet dhe botëkuptimi që rrjedhin prej këtij miti janë irrealë. Për shembull, thuhet se kur të hyjmë në Evropë do t'i zgjidhim të gjitha gjërat, se në Evropë do të hyjmë, në mos tjetër kontrabandë, se Evropa nuk mund të na lërë ne jashtë saj, se gjithçka duhet ta bëjmë me objektivin e integritimit në mendje e me rradhë. Kështu kemi parti që i janë përkushtuar objektivit të integritimit, ministri e qeveri të integritimit, OJQ e OJF, tekste shkollore e klasa të veçanta, që i edukojnë shqiptarët për vlerat e integritimit. Kemi edhe shkrimtarë që i nxjerrin shqiptarët si themelues të Europës e si ruajtës të vlerave të qytetërimit evropian, poetë që shkruajnë për Europën, këngëtarë që këndojnë më mirë për Europën se sa për katundin e tyre. Flamurët evropianë gjenden në të gjitha zyrat. Edhe në mejhanet luksoze ta sjellin kafën në filxhane me flamurin evropian.

Histeria integruese është e të njëjtit nivel e intensitet si histeria e dikurshme e rrethimit. Në vend të zborit, shqiptarët shkojnë në klub e pinë kafe, duke pritur hyrjen në Evropë. Paria, megjithatë, e di se kjo është një rrenë e pastër. Evropa ua ka berë të qartë se shqiptarët nuk mund të hyjnë në Evropë edhe për disa dhjetra vjetë. Mirëpo, rrena e integritimit duhet shitur dhe duhet që t'ua mbushim mendjen shqiptarëve se jemi në rrugë të mbarë. Kështu që bëjmë kërkesa për anëtarësim në BE, pa na ftuar kush, flasim për përmbushje kushtesh e detyrimesh, që nuk na i ka vënë kush dhe i themi vetes evropianë, kur të gjithë e dimë se në Evropë na shohin si diçka krejt tjetër. E ndërkohë, paria vazhdon me punue kundër interesit kombëtar të shqiptarëve. Zgjidhja që ka gjetur paria e Tiranës nuk është më me i kthyer lëvizjet nacionaliste në marksiste-leniniste, por me i kthyer udhëheqësit politikë të shqiptarëve në trojet e tjera në hajna e cuba e jeniçerë, si ata vetë.

Si përfundim, duhet thënë se, për shkak të këtyre koncepteve kriminale strategjike të parisë, shqiptarët i kanë humbur disa

shanse historike, që nuk do t'iu kthehen kurrë më. Njerëzit, që e kanë harxhuar jetën duke luftuar rrethimin apo duke dëshëruar integrimin, janë të mbyllur në atë realitet absurd e imagjinar, që u ka krijuar paria e Tiranës. Gjykimet e tyre për botën e për veten janë infantile dhe të shtrembëruara, të dëmshme për ata vetë e për të gjithë të tjerët. Askush me mirë se Evropa nuk e di këtë gjë dhe ajo e ka bërë këtë shumë shumë të qartë.

Mirëpo, është në interesin jetik të parisë se Tiranës që të zgjasë këtë gjendje absurde, sa më shumë që të jetë e mundur. Vetëm kështu mundet që të fuqizohet e të mbesë në kontroll të shtetit e të qytetarëve, që i konsideron në shërbim të saj. Prandaj, si pushtimi që nuk ndodhi asnjëherë, gjasat janë se edhe integrimi nuk do të ndodhë asnjëherë. Ajo që mund të thuhet është se, në fund, kur të vijë momenti i zhgënjimit të frikshëm, që është i pashmangshëm, as paria e Tiranës nuk do t'i ketë arritur objektivat e saj, por as shqiptarët nuk t'i kenë arritur objektivat e tyre.

PROBLEMI I KRIMINALIZIMIT TË PARISË: SHKAKU KRYESOR I DËSHTIMIT TË SHTETIT SHQIPTAR

Në disa shkrime është në dukje se problemi themelor me të cilin përballet shteti shqiptar është problemi i kriminalizimit të parisë së Tiranës. Shkaku për këtë kriminalizim është lidhja në kërthizë që kjo pari ka me krimin e organizuar. Por, edhe pse segmentet politike të parisë grinden publikisht e në media, paria e Tiranës është shumë më kohezive. Elementet që i mbajnë të dy krahët e parisë të lidhur bashkë janë influenca e jashtëzakonshme e krimin të organizuar, interesat e saj të ngushta ekonomike e politike, si dhe mbi të gjitha, mendësia kriminale e vetë parisë. Shembujt që mund të përdoren janë të shumtë, por shembulli i radhës është shitblerja dhe kalimi dorë më dorë i ish-Taivanit, sot një lokal kumari tek Shallvaret. Ky lokal ka kaluar në pronësi nga njëra palë e parisë tek tjetra e anasjelltas, thjesht me qëllime përfitimi personal. Në proces janë përzjerë të gjithë llojet e politikanëve dhe të interesave, nga të dy palët e parisë dhe marrëveshja është bërë nga dy vetë që janë të njohur si armiq të mëdhenj të njëri-tjetrit. Taktikat e përdorur nuk kanë asnjë dallim nga teknikat mafioze, që nga evazoni fiskal, tek larja e parave, tek shkëmbimi i interesave materiale për influencë politike e anasjelltas.

Ndërsa shembulli i sjellur është shumë domethënës, kjo dukuri ia vlen të analizohet edhe për disa aspekte të tjera. Ky rast është veçanërisht i veshëm, për të kuptuar rolin që luan ky kriminalizim i gjithanshëm i parisë në dështimin e shtetit shqiptar në tranzicion. Ky rast shërben edhe për të ilustruar edhe kapjen e shtetit nga bota e krimin, përmes vetë strukturave politike, ekonomike e shoqërore të parisë. si gjithnjë, skandali i rradhës është një rast tjetër për të

reflektuar mbi gjendjen.

Shteti dhe krimi i organizuar

Në çdo shoqëri të stabilizuar e të moralshme, shteti normal është kundërshtari më i rreptë i kriminelit dhe armiku i pakompromis i krimit të organizuar. Në një shtet normal, ligjet dhe strukturat janë formuluar e ndërtuar në mënyrë të tillë që jeta, nderi, pasuria, mirëqenia e qytetarëve, si dhe rregulli shoqëror, të mos çenohen nga askush. Nga ana e vet, shoqëria normale, jo vetëm i respekton këto norma e rregulla si të moralshme, por nuk e pranon dhe nuk e legjitimon sjelljen kriminale. Prandaj, gjithkund kriminelët e bandat dënohen e humbin të drejtat bazë qytetare e shkojnë në burg. Shpesh, kriminelët humbin edhe jetën.

Megjithatë në shtetin shqiptar, siç del edhe nga shembulli i Taivanit, vërehet se sjellja kriminale nuk është e kufizuar, e paorganizuar, apo e dënueshme. Në fakt, e kundërta është e vërtetë. Ajo që del nga analiza e këtij rasti, por edhe nga shumë raste të tjera, është se kapja e hapur e shtetit shqiptar nga bota e krimit, legjitimimi i sjelljes kriminale, pranimi nga ana e shoqërisë e kësaj sjelljeje kriminale si normale, si dhe kriminalizimi fund e krye dhe i padiskutueshëm i parisë dhe i institucioneve të shtetit, janë karakteristika thelbësore për realitetin shqiptar. Duke qenë se shteti nuk iu jep zgjidhje problemeve të tyre, individë dhe shtresa të tëra të shoqërisë i janë drejtuar dhe i drejtohen botës kriminale, tolerojnë sjellje kriminale dhe bëhen bashkëfajtorë në krimin e parisë. Duke i zgjidhur problemet e tyre imediate si individë, ata e shkatërrojnë fabrikën e shtetit dhe të institucioneve, si dhe dëmtojnë rëndë mundësitë e tyre për të ndërtuar një jetë normale në të ardhmen.

Si shembuj të njohur të kapjes së shtetit shqiptar nga krimi i organizuar mjafton të përmenden 400,000 ndërtimet pa leje, dhjetra mijëra vajza që shiten rrugëve të botës, plakat që arrestohen për rritje droge, fushat e mbjella me kanabis, katundet që ruhen nga bandat e armatosura, motelet e hotelet e prostitucionit, 60,000 të droguarit e Tiranës, 20,000 shqiptarët që

janë në burgjet e botës, grabitja e hapur dhe sistematike e pronës shtetërore, shkalla marramendëse e informalitetit në ekonomi që shkon deri në 70%, rushfetet që merren nga gjykatësit e zyrtarët, shitblerja e posteve zyrtare, deputetët që arrestohen “gabimisht” me thika e kobure, apo politikanë që vdesin rrugëve, pasi dalin nga motelet me sekretaret, politikanët që gdhihen në fund të mandatit me disa milionë euro pasuri “të fituar në bursë”. Në fund, por jo më e fundit, mjafton të shihet numri në rritje i kriminelëve, të akuzuarve, vrasësve me pagesë, i hajnave dhe i gangsterëve, tashmë të deklaruar edhe si eksponentë të politikës nga të dyja krahët e parisë së Tiranës.

E natyrisht, shembujt e korrupsionit e të kriminalizimit, të vjedhjes e të shfrytëzimit të paskrupullt të shtetit e të shoqërisë nga ana e parisë janë të panumërt. Këtu mund të përmenden privatizimet, gomonet, piramidat, viti 1997, bandat e shumta, Gërdeci, Kinostudio, Taivani, Porto Romano, Fazlliçi, pallatet e Tiranës, Golemi, Jala, Gjiri i Lalzit e me rradhë. Të gjithë këto shembuj shërbejnë për të ilustruar qartë argumentin se shteti shqiptar nuk është një shtet normal. Shteti shqiptar është një shtet i kapur dhe i dështuar, në të cilin sundon krimi dhe paria e Tiranës është vegël e krimit të organizuar.

Një shembull shumë domethënës, por edhe për të të ardhur keq i këtij kriminalizimi të gjithanshëm, ishte edhe falja me aq ceremoni e pompë e ndërtimit të paligjshëm të vilës së Ismail Kadare nga ana e qeverisë. Do të ishte njëmijë herë më mirë që qeveria shqiptare ta kishte blerë një vilë mbretërore apo private dhe t’ia bënte dhuratë, apo të ndërtonte një vile të re posaçërisht për të e kudo tjetër që mund të ndërtohej, se sa ta shtynte shkrimtarin e njohur që të bëhej bashkëfajtor në këtë krim të përvetësimit të pasurisë private. Ismail Kadare herët a vonë, me zë apo në mënyrë të heshtur, do të duhet që ta falenderojë parinë për faljen e vilës së tij të ndërtuar në tokën e paligjshme. Atëherë, edhe ai do të çertifikohet si bashkëfajtor në krimin e parisë dhe legjitimues i hapur i krimit të saj.

Një problem tjetër është se nuk ka fare dallim midis palëve të parisë në shkallën e lidhjes së tyre me krimin e organizuar.

Dallimi thelbësor është ky. Nëse deri më tani PD e kontrollon botën kriminale me dorë të hekurt, PS është e kapur nga bota kriminale. Sali Berisha i kontrollon strukturat e krimit vetë apo përmes familjes së tij. Udhëheqja e PS janë të kontrolluar nga krimi ose përfaqësues të familjeve kriminale, janë në politikë për të mbrojtur interesat e krimit. Por, ky dallim zhbëhet e bëhet krejt i parëndësishëm kur të gjitha palët e parisë konsiderohen ashtu siç janë. Këta janë pjestarë të segmenteve të parisë së Tiranës, klane e individë të pasuruar përmes politikës. Këta sillen e veprojnë si instrumente të vetëdijshme të krimit të organizuar, qoftë si ushtarë, qoftë si shefa të strukturave të tilla. Për të kuptuar më mirë këtë lidhje simbiotike të krimit me politikën, duhet analizuar ajo që ndodhi gjatë sistemit të kaluar, sepse atje janë edhe disa nga shkaqet kryesore të kriminalizimit të sotëm të parisë së Tiranës.

Origjinat e kriminalizimit të shtetit dhe të parisë së Tiranës

Në thelb, origjinat e kriminalizimit të shtetit e të parisë në shtetin shqiptar janë katër. Ka edhe shkaqe të tjera. Megjithatë, këto katër shkaqe janë më kryesoret, prandaj edhe ia vlen që të qëmtohen me kujdes, edhe pse shkurtimisht këtu.

Së pari, shoqëria shqiptare doli nga sistemi i mëparshëm thellësisht e korrupsuar dhe e kriminalizuar në të gjitha nivelet. Kriminalizimi, korrupsioni e zvetënimi ishte më pak i dukshëm tek paria e tek intelektualët. Mirëpo, kriminalizimi vinte duke u shtuar regresivisht, d.m.th., sa më shumë që zbriteshin shkallët shoqërore e deri tek njerëzit e thjeshtë. Sa kohë që kishte shtërngesa të forta institucionale, paria dhe intelektualët e asaj kohe vepruan në mënyrë makiavelike dhe si *skile*. Ata shkonin deri në kufinj të lejueshmes, por në shoqëri duhej të ruhej fort, dhe ç'është e vërteta, ruhej paraqitja e një figure të moralshme dhe me dinjitet e vlera. Kjo kontrastonte me sjelljen përherë e më të varfër moralisht të shtresave të tjera. Proletarizimi, që në raste të caktuara shkonte në tre breza, pati efekte shumë domethënëse në vlerat e shoqërisë. Po ashtu, nevojat në rritje të jetesës i shtynë njerëzit që të braktisnin strukturat morale dhe shtërngesat që e dallonin shoqërinë deri në

atë pikë. Raportet shoqërore u përmbysën. Hajnia, veset, mungesa e respektimit të normave shoqërore dhe në përgjithësi, ajo që njihej si sjellje e gabuar u bë norma. Zhvillimi i rrjeteve të kriminologjisë njohe një hop cilësor. Prostitutat kalonin nga një rreth në një tjetër me çmime të caktuara dhe me rrethe shfrytëzimi të mbyllura. Për dy javët e pushimit vjetor fitohej rroga e gjashtë muajve. Po ashtu rrethet e kumarit, të basteve, të shitblerjes së valutës e me rradhë njohe një zhvillim të jashtëzakonshëm. E gjithë kjo po ndodhte me tolerimin e shtetit që nuk kishte rrugë të tjera për të ruajtur qetësinë publike përveçse për të toleruar këto sjellje kriminale dhe për të vendosur mekanizma kontrolli që nuk e kanalizonin këtë sjellje në veprimtari politike kundër sistemit. Nuk ka dyshim që gjërat dihehin edhe nga “organet kompetente” por gjithnjë mbyllej një sy.

Me parinë ishte disi më ndryshe. Edhe paria ishte e korruptuar dhe sistemet njiheshin, por funksiononin në nivele të tjera dhe me monedhë tjetër. Gjithsesi, paria dhe “intelektualët e shquar” ishin shumë të shtërnguar në sjeljen e tyre. Megjithatë, sapo u zhdukën shtërngesat, paria e tregoi fytyrën e vet të vërtetë. Fytyra e saj e vërtetë ishte shumë e pakëndshme, pse u pa se paria ishte tërësisht e kalbëzuar moralisht.

Shumë shpejt u pa se paria dhe “intelektualët e shquar” nuk e duronin më shtërngesën e shtetit. Pavarësisht se nga cila rrugë erdhën në kundërshtinë ndaj shtetit paria, “intelektualët e shquar” dhe kriminelët ordinerë, fakti është se të gjithë nuk e donin një shtet të fortë. Natyrisht, që në atë kohë të vështirë, kishte një shtresë të madhe kriminelësh ordinerë dhe recidivistë të pakorigjueshëm, për të cilët kjo lloj sjelljeje ishte normale dhe për të cilët shkatërrimi i shtetit ishte edhe çlirimi i vërtetë i tyre. Pra, pavarësisht nga rruga nga e cila erdhën tek krimi i hapur dhe kriminalizimi i ndërgjegjshëm, si paria, ashtu edhe keqbërësit ordinerë, për shkak se ndanin të njëjtën mendësi, përfunduan në të njëjtin predikament të kundërvënies ndaj shtetit.

Një element shumë i rëndësishëm që e shpjegon këtë shkrim të natyrshme të parisë me llumin e shoqërisë ishte edhe struktura e ndryshuar e marrëdhënieve shoqërore gjatë sistemit të kaluar

edhe në nivelet e shtresave që ishin besnike të sistemit dhe që kishin qënë burimi i legjitimitetit të tij deri në fund të viteve 1970-të. Për shkak të varfërisë së thellë, proletarizimit ekstrem, mungesës së materialeve e produkteve, nevojave në rritje e me rradhë, shoqëria nga poshtë-lart e nga lart-poshtë, zhvilloi mekanizma të komplikuar, por shumë efektive për zgjidhjen e problemeve të tyre jetike. Mekanizma të tilla ishin trami me mallin e shtetit, strukturat e shkëmbimit të mallrave të vjedhura, kryerja e punës vetjake në orarin e punës, përdorimi i mjeteve e i pozicionit për interesa vetiake, deri edhe përfitimi i favoreve seksuale e me rradhë. Gradualisht, hajnia, mashtrimi, zvetënimi e korrupsioni u bënë mënyrë e nderuar apo e pranuar jetese jo vetëm nga shoqëria, por edhe nga “intelektualët e shquar” dhe nga paria e Tiranës. Zhvëshja e shtresave të gjera shoqërore nga sistemi i vlerave morale normale ishte e frikshme.

Rrënjët e “kapitalizmit” ekstrem shqiptar të derisotëm, duhen kërkuar pikërisht në marrëdhëniet shoqërore, që u zhvilluan gjatë kësaj periudhe. Shoqëria iu përgjigj dështimit të shtetit të atëhershëm, duke zhvilluar një sistem të tillë, mjaft efektiv të ekonomisë informale, ku gjithçka e kishte një çmim dhe ku gjithkush e dinte se çka i kishte borxh tjetrit. Shoqëria u transformua në një rrjetë merimange, ku të gjithë vareshin nga njëri-tjetri, ishin bashkëfajtorë në krim dhe i ruheshin shtetit që, në fakt, ishte dorëzuar pa kushte para kësaj mendësie.

Së dyti, duke qënë e vetëdijshme se shteti i konsoliduar është armiku kryesor i pasurimit të saj, në fillimet e tranzicionit, paria e Tiranës dhe intelektualët që iu bashkëngjiten asaj (dhe hajnat e cubat e transformuar në militantë, natyrisht) e bënë si detyrë parësore shkatërrimin sistematik të shtetit. Shteti ishte pengesa dhe duke mos qënë më ai shteti terrorist, prapë frika se mund të rindërtohej nga dikush e dikur, e bënte parinë të ishte e vëmendshme karshi çdo përpjekjeje për fuqizimin e tij. Duke qënë e zvetënuar deri në palcë, paria e Tiranës nuk mundej të pranonte që shteti të arrinte ta shtërngonte parinë, të vinte kufizime në pasurimin e saj, ta taksonte, ta dënonte, ta kontrollonte e ta mbante nën fre. Paria, nuk mundej e nuk mundet të pranojë, që duhet të kishte shtet e

struktura që të lejonin ndërtimin e një shoqëri normale.

Kështu, duke mbrojtur interesat e saj, paria e Tiranës ka hyrë në aleancë me llumin e shoqërisë. Ajo ka luftuar e lufton me shumë konsekuencë kundër forcimit të shtetit. Paria e sheh shtetin si një të keqe të domosdoshme. Asaj i duhet një shtet i dobët por në shërbim të saj. Asaj i duhet një shtet që kap hajnat e xhëpave, por që nuk prek peshqit e mëdhenj. Ajo do të vazhdojë që të luftojë kundër shtetit efektiv edhe në të ardhmen, me të gjitha fuqitë e saj.

Së treti, besimi tek tregu i pakontrolluar dhe i painstitucionalizuar, kapitalizmi pa kufinj e, mbi të gjitha, liberalizmi u bënë baza ideologjike e preferuar e parisë. Kjo ndodhi, jo vetëm pse ishte ajo platformë e ndërtimit të shtetit që po këshillohej nga të huajt. Mbi të gjitha, kjo ndodhi sepse ajo platformë e ristrukturimit të shoqërisë në bazë të interesave të ngushta ekonomike, i përshtatej dhe i përshtatet plotësisht interesave të saj jetike. Në thelb të liberalizmit qëndron një shtet i dobët. Ndërsa sipërmarrësit, që vinin nga shtesa e proletarëve të djeshëm, u turrën të blinin e të shisnin mallra nga e gjithë bota me para në dorë, paria e përdori liberalizmin si një instrument të fuqishëm ideologjik, për të justifikuar shpërbërjen, rrënimin e vjedhjen sistematike të shtetit, si dhe vënien e ruajtjen e pasurisë së saj nga shteti e nga shoqëria.

Së katërti, një popull që kishte vuajtur aq shumë nga një shtet i mbrapshtë gjatë kohës së sistemit të mëparshëm, nuk kishte se si të dyshonte në sjelljen e mbrapshtë, por dinake e të qëllimtë të parisë për shkatërrimin e shtetit. Shkatërrimi i shtetit dukej si objektiv normal e parësor për të gjithë. Në fillimet e tranzicionit, shkatërrimi sistematik dhe i tërësishëm i shtetit ishte dukuria më vrastare dhe më e dhimbshme që mund të përjetohej. Ndërsa paria e Tiranës dhe ata 1500-2000 vetë që e dinin mirë se çka ishte shteti i së ardhmes ishin pjesë integrale e saj, u turr që të pasurohej vetë. Këta vepruan kështu, duke përdorur dijet e fituara në kurriz të shqiptarëve e të paguara me paratë e tyre gjatë viteve të gjata studimit brenda e jashtë vendit. Objektivi i tyre, “ndërtimi i kapitalizmit” dhe ndarja në klasa ishte rruga për t’i skllavëruar shqiptarët. Nga ana e tyre, shqiptarët e thjeshtë prenë pemët, mollët e hardhitë, shkulën edhe vidat e fundit nga tornot e nga

makinat e paguara me gjak dhe i shiten për hekur e skrap, nën duartrokitjet e fërkimin e duarve të parisë sunduese.

Shumë shqiptarë u turrën në emigrim. Ndërsa shumë prej tyre e gjetën veten dhe, me shumë vuajtje, u integruan si njerëz normale në një shoqëri normale, shumë të tjerë, pa atë përgatitje qytetare e nivel vlerash, e gjetën veten të përballur me shtete shumë efektive dhe shoqëri të mirëorganizuara që, për më tepër, i kishin vënë shqiptarët në shënjestër. E vetmja mënyrë për të mbijetuar, për mjaft nga këta individë që kishin një të shkuar jo të pastër, ishte kriminalizimi e pasurimi përmes krimit. Me prostitutat në qoshe të rrugës, me qesen e drogës në një dorë e koburen në dorën tjetër, këta u turrën të pasuroheshin me çdo kusht. Njëlloj si paria e Tiranës, edhe këta, vrasës, hajna e banditë ordinerë, nuk kishin kurrfarë skrupujsh moralë e njerëzorë. Shumë prej tyre bënë vetëm atë gjë që dinin; pikërisht atë gjë që deri dje e kishin bërë në forma të tjera. Dhe ata që nuk përfunduan në varreza e në burgje, u kthyen në shtetin shqiptar, ku u bënë mbështetësit kryesore të politikës së parisë e të partive të saj dhe instrumentet e udhëheqësive. Disa nga lokalet e famshme të frekuentuara rregullisht nga paria kanë qënë pronë e këtyre tipave me të shkuar shumë të dyshimtë. Është shumë domethënëse që mendësia e botës së nëndheshme të Perëndimit dhe normaliteti i sjelljes në shtetin shqiptar kishin një përputhje interesante.

Tërheqja e politikës nga krimi dhe ajo e krimit nga politika në shtetin shqiptar ka kenë gati magnetike. Asgjë nuk e nxori në pah qartësisht kriminalizimin e parisë, as veshja si oficerë e kuadro e hajnave e vrasësve me patentë, as gradat e postet që iu dhanë banditëve të rrugës e vrasësve ordinerë, as tolerimi e bashkëpunimi midis strukturave të partive, udhëheqësive të tyre e gangsterëve të lagjeve, se sa kriza e thellë e vitit 1997. Atëkohë u pa qartë se, pa mbështetjen e krimit, paria nuk kishte fuqi të kontrollonte shoqërinë. Aleancat e deriatëhershme midis lumpenit shoqëror dhe parisë u çimentuan dhe kanë vazhduar që të përkufizojnë sjelljen e parisë edhe deri tani. Banditët u bënë bodigardë, shefa informalë kuadri, drejtuan komisione zgjedhore, përcaktuan se kush zgjidhet e disa u bënë edhe figura të shquara

politike, bile po botojnë edhe kujtime të shkruara nga shkrimtarë të blerë. Kjo gjendje tashmë është e konsoliduar. Kjo lidhje e politikës me krimin vazhdon të mbysë shpresën për një shtet të shëndoshë edhe sot e kësaj dite.

A mundet paria e Tiranës të ndërrojë rrugë?

Shqiptarëve iu duhet një shtet disi i fortë, për aq sa i kemi kushtet e mundësitë. Mbi të gjitha, shqiptarëve iu duhet një shtet normal, i ndershëm, i varfër, por në shërbim të qytetarëve. Shqiptarëve iu duhet një shtet që ruan rendin, që nderon të ndershmit e dënon krimin. Mirëpo, me këtë pari që është në fuqi sot në Tiranë, kjo nuk ka gjasa që të ndodhë. Paria e Tiranës është e lidhur në kërthizë me krimin e organizuar, me të paligjshmen, me të pandershmen, me vjedhjen e me shkeljen e ligjit.

Prandaj, kjo që po ndodh, nuk është thjesht punë batakçinsh ordinerë. Kjo është shumë më tepër se punë batakçinsh ordinerë, sepse si rrënjët ashtu edhe pasojat e kësaj lidhjeje të parisë me krimin, shkojnë thellë dhe duket se janë të pazgjidhshme. Lidhja e parisë me botën e krimit është një nga aspektet më të frikshme të tranzicionit. Nuk ka aspak gjasa që kjo lidhje do të këputet pa një ndryshim drastik të sistemit. E keqja është se mbrapa çdo figure qendrore të një klani të parisë, qëndrojnë vrasësit e hajnat e gatshëm për t'i zënë vendin "shefit" e për t'i ngrënë kryet, po erdhi puna deri aty. Këta nuk dinë rrugë tjetër, nuk njohin sjellje të tjera dhe nuk do të pranojnë shtërngesat që vijnë me një shtet të konsoliduar e të qëndrueshëm.

Për këtë arsye, edhe vetë paria duhet trajtuar ashtu si është. Paria e Tiranës është një shtresë kriminale, në shërbim të krimit, që mbijeton në sajë të krimit dhe që është kthyer në kancer i shoqërisë shqiptare. Faza e tanishme është edhe më tragjike, sepse nuk kemi më një aleancë të thjeshtë të parisë me krimin. Tashmë kemi simbiozën e parisë me krimin: paria prodhon krimin dhe krimi riprodhon e fuqizon parinë e Tiranës. Por kjo shkon deri në një pikë. Kriminalizimi i shoqërisë ka nisur të rrezikojë sundimin e parisë dhe përfshirja e kriminelëve shqiptarë në rrjetet

ndërkombëtare ka qënë shumë e suksesshme. Reputacioni i botës kriminale shqiptare është në lartësinë e rrjeteve më të sofistikuara kriminale si *organizacja* apo Mafia. Padyshim, paria ka meritën e vet në këtë sukses të integritit të shqiptarëve në botë.

PËRSËRITJA E HISTORISË: MBI SKANDERBEGUN E TRANZICIONIT

Elvira Dones është një shkrimtare e shquar shqiptare, një krijuese mërgimtare, që na bën nder të gjithëve. Letra e saj në gazetën *La Repubblica* lidhur me incidentin shumë të rëndë diplomatik në konferencën e përbashkët për shtyp të kryeministrave Berisha dhe Berlusconi, ishte një akt kurajoz qytetar. Berlusconi i kërkoi Sali Berishës që të ndalte gomonet por të sillte sa më shumë vajza të reja për prostituta në Itali sepse ... Berlusconi ishte beqar. Elvira Dones mbrojti me dinjitet vendin e saj dhe foli në mbrojtje të atyre vajzave që enden rrugëve të botës, si dëshmi e gjallë e krimit të parisë së Tiranës dhe e kriminalizimit të shtetit shqiptar të tranzicionit.

Prandaj, sulmi i mbrëmshëm i kryeministrit Berisha në emisionin *Opinion* - një titull që i përshtatet, sepse atje rrallë thuhet të vërteta - ishte një pikë e ulët në sjelljen e tij. Berisha tha se ajo "kishte braktisur fëmijën e vet dhe këtë e di i gjithë qyteti". Kjo ishte një sjellje tipike e tij, një sulm i llogaritur mirë, por shumë domethënës në aspekte të tjera. Askush nuk duhet t'ia kujtojë dhe askush nuk ia ka kujtuar z. Berisha problemet në fisin e tij, femrat që kanë braktisur fëmijët, femrat që dashurohen e martohen me kushërinjtë, apo probleme të tjera. Mendoj se shqiptarët janë sjellë mirë, që nuk ia përmendin as prej nga vjen e as familjen që ka. Ajo është puna e tij dhe ne duhet të merremi me Sali Berishën si zyrtar publik. Ne duhet të merremi me sjelljet e tij në publik e në detyrën e lartë që ia ka caktuar vetes si kryeministër i shqiptarëve.

Mirëpo, ky sulm i ndyrë dhe tejet katundaresk i tij ndaj Elvira Dones, një shkrimtare shqiptare që ka bërë emër në Zvicër, duhet

të shërbejë si një refleksion mbi disa fenomene të dallueshme të tranzicionit. Së pari, ajo që të vret është mungesa e dinjitetit të shtetarit e të shtetit që ai përfaqëson. Së dyti, është kompleksi i skllavit i kryeministrit të një shteti, që iu përul Berluskonit dhe tash sulmon me arrogancë vajzën e gruan shqiptare, që mbron dinjitetin e vendit të vet. Së treti, kjo sjellje tregon se sa poshtë ka rënë shteti e kombi shqiptar, sepse duket ashiqare që shqiptarët janë të pazotët që të mbrojnë veten e tyre.

Po ashtu, ky incident tregon se sa i dështuar është ky tranzicion, se sa e dështuar është paria sunduese dhe se çfarë shkretine morale është krijuar prej saj. Ngulmimi i parisë për ta shitur këtë tranzicion, si një kthesë historike e për ta shitur dështimin si arritje, shihet qartë në përpjekjen e saj për ta paraqitur tranzicionin si përsëritje të historisë dhe vetveten si heronj të këtij tranzicioni, anipse janë të pazotët që të mbrojnë nderin e shtetit në një konferencë shtypi.

Duke u larguar nga incidenti me zonjën Dones, mendoj se duke reflektuar mbi “përsëritjen e historisë”, do të bëhen edhe më të qarta, si dështimi i parisë ashtu edhe ai i tranzicionit. Edhe pse thënia, se historia përsëritet dy herë, një herë si tragjedi e herën e dytë si komedi është më e vjetër se rasti për të cilin u përdor në mesin e shekullit të 19-të (krahasimi midis Napoleonit I dhe Napoleonit III), në fakt, historia nuk përsëritet dy herë.

Ashtu si thotë edhe filozofi i vjetër grek Herakliti, “nuk mund të ecet dy herë në të njëjtin ujë”. Më e shumta që mund të bëhet është që të gjenden disa elementë krahasimorë dhe të ndërtohet një paralele midis dy kohëve, midis dy gjendjeve, midis dy veprimeve apo midis dy njerëzve. Perandoritë ngrihen e bien, kombet e shtetet formohen e zhduken, familjet fisnikërohen e degjenerohen, partitë lindin e vdesin, por ndyrësia shpirtërore e mercenarëve nuk ka fund në të gjithë kohët. Duke e thjeshtuar historinë, duke e zhveshur atë nga veçantitë dhe duke u përqëndruar në aspektet e përbashkëta, në shumë raste theksohet ngjashmëria midis kohëve, ngjarjeve e personave.

Mirëpo, me vetëdije apo pa vetëdijen e duhur, përsëritjen e historisë e stisim ne vetë, duke luajtur me padijen tonë, me

perceptimet apo me interesat që kemi. Dhe kjo nuk është e kufizuar vetëm në interpretimin e së tashmes. Tragjedia është se po ne e kemi në dorë që të ndërtojmë të shkuarën si duam vetë dhe ta interpretojmë çdo aspekt të saj, ashtu si na intereson në një moment të dhënë. Kujtesa historike është e manipulueshme dhe, askush më mirë se paria, nuk është e vetëdijshme për këtë gjë.

E në rastin e shtetit shqiptar, gjatë këtij tranzicioni të dështuar, ka patur shumë raste kur paria sunduese dhe eksponentët e spikatur të saj duan të krijojnë përshtypjen se po përsëritet historia, se ky tranzicion i dështuar është një përsëritje e historisë heroike e të lavdishme të shqiptarëve. Ndër shembujt më të spikatur janë dy. Duke evokuar Ismail Qemalin, Fatos Nano thotë për veten e tij se “i shkon mbrapa historia.” Ndërsa Sali Berisha, vetëkrahahet me Skanderbegun.

Por, paralelet ndërtohen e krijohen qëllimisht për të krijuar imazhe të caktuara e përshtypje të gabuara në mendjet e njerëzve. Nga një anë, kjo është një shenjë e qartë e mendësisë së pushtetarëve, d.m.th., kjo shërben si një tregues i neverisë së thellë e mungesës së plotë të respektit për popullin shqiptar dhe dashakeqësinë e tyre. Nga ana tjetër, paralelet janë të mbështetura në padijen e thellë e në infantilitetin politik të njerëzve. Natyrisht, në më të shumtën e rasteve, këto paralele nuk janë asgjë më shumë se keqinterpretime e shtrembërime të realiteteve, mirëpo, kur trumbetohen pa ndërprerje, fitojnë një farë vlere në mendjen e njerëzve.

Një shembull i qartë i këtij lloji krahasimi thelbësisht të gabuar është edhe paralelja e ndërtuar midis Skënderbeut dhe kryeministrit Berisha, që po promovohet e kultivohet me kujdes në shtypin e median shqiptare. Që nga shtypi i tij privat, tek pisqollat e tij mediatike të tipit Aleksandër Frangaj e Fahri Balliu, deri tek mbështetësit e tij, si tek “qëndrestarët” ashtu edhe tek “mercenarët” e PD-së, ky mitizim e krahasim është përdorur pa kurrfarë hezitimi e pa skrupuj. Natyrisht që kjo nuk do të ndodhte pa aprovimin e z. Berisha, sepse, përndryshe, ai do të dilte të thonte se nuk është Skënderbeu dhe mbyllet ajo punë.

Por kjo sjellje e tolerimi që i bëhet kësaj sjelljeje flet edhe

për gjendjen e vetë z. Berisha, për lidhjen e tij me elektoratin e me mbështetësit e vet, si dhe për shkallën e manipulimit politik në strukturat që ai sundon. Për ta përsëritur edhe një herë, ana tragjike e këtij krahasimi është se me këtë sjellje, si ai ashtu edhe mbështetësit e shërbëtorët e tij tregojnë se nuk kanë kurrfarë respekti as për shqiptarët e as për historinë e tyre. Heshtjen e njerëzve ata e marrin për aprovim dhe e shesin në shtyp si të tillë. Në fakt kanë të drejtë, sepse përderisa njerëzit nuk flasin, ata nuk numërohen, ose numërohen si aprovues të kësaj marrëzie të radhës.

Ana komike e këtij krahasimi është se të gjithë ata që e promovojnë e dinë pa asnjë mëdyshje se këtu nuk ka asgjë të vërtetë. Edhe pisqolla mediatike e tipit Fahri Balliu, e di se ndër të vetmet gjëra që Sali Berisha e Skanderbeg Kastrioti kanë të përbashkëta janë se të dy janë nga Ballkani Perëndimor, se i kanë pasur nënat femra (të ndryshme kuptohet), se kanë pirë ujë e kanë ngrënë groshë, bukë e djathë dhe se kanë qenë të dy në Itali. Dhe... krahasimi mbaron aty. Berisha dhe Skanderbegu nuk kanë asgjë të përbashkët, bile ato janë antipode të udhëheqësit e të njeriut. Në nivelin politik, megjithatë, asgjë nuk e ilustron më mirë këtë dallim thelbësor midis tyre se sa lidhja që njeri e tjetri kishin me gadishullin italik e me sunduesit e tij si dhe trajtimi që ata morën nga ata sundues në kohën e vet respektive.

Kështu, Skanderbegu ka qenë i përfshirë në fatet politike të Italisë dhe ka luajtur një rol vendimtar. Skanderbegu mori ndihma të çmueshme e mbështetje politike nga Aragonët e Napolit, vasal formal i të cilëve u deklarua, edhe pse e ruajti pavarësinë e vet në të gjitha drejtimet. Në këmbim të kësaj mbështetje politike, por edhe materiale që mori nga Alfonsi V, ai e mbështeti të birin, mbretin Ferdinand, që ishte ilegjitim, dhe e ndihmoi që të hipte në fronin e Napolit. Në një seri betejash, me 1500 ushtarë e oficerë shqiptarë, Skanderbegu shkatërroi fuqinë e Orsinit, princit të Tarantos dhe mendësinë e kondotierëve, si dhe garantoi pushtetin e Ferdinandit, i cili e quajti prindin e vet. Në këmbim të kësaj mbështetje, mbreti i Napolit iu dha trashëgimtarëve të Skanderbegut titullin trashëgimtar të Dukës, një seri kështjellash,

dhe lejoi vendosjen e disa dhjetramijëra shqiptarëve që ikën nga sundimi turk në territorin e mbretërisë si shtetas të lirë e të barabartë, me ligjet e me doket e tyre në Mbretërinë e tij. Fshatra të tëra, që më parë ishin të braktisura, u mbushën me shqiptarë, të cilët vazhduan të punojnë, të ruajnë dinjitetin, nderin e lirinë e tyre në tokë të huaj.

Pra, Skanderbegu shkoi si zot e gjeneral me ushta e ushtarë dhe u kthye fitimtar, si asnjë tjetër. Shqiptarët nuk shkuan si skllëvër, por si njerëz të lirë dhe vazhduan të jenë njerëz të lirë ndryshe nga vedasit që ishin nën disa zgjedha. Nga ana e tyre, vedasit e atjeshëm i kishin aq shumë frikë shqiptarë sa nuk jepnin e nuk merrnin fare me ta. Krenaria e nderi i shqiptarëve u bënë proverbiale. E kontributi i tyre, i njerëzve të lirë e të vetëdijshëm se kush ishin, spikati në nivelin më të lartë, në atë të shtetformimit e të drejtimit të shtetit, edhe të Italisë së sotme. Pra, Skanderbegu shkoi me ushta e me ushtarë, bëri ligjin, vendosi dinastinë që donte të mbështeste në fron dhe ua garantoi shqiptarëve nderimin e të huajve.

Në anën tjetër të krahasimit, edhe z. Berisha shkoi në Itali disa kohë më parë dhe u tha se kishte shkuar në të njëjtën kohë që kishte shkuar edhe Skanderbegu. Shkoi edhe gjatë javës së kaluar. Mirëpo, nderimi që Mbreti Ferdinand i Napolit i bëri Skanderbegut kontraston shumë me nderimin që Berluskoni i bëri Sali Berisha në këtë vizitën e fundit.

Sali Berisha u mburr me 22 mijë sipërmarrjet e bizneset e formuara dhe në pronësinë e shqiptarëve mërgimtarë në Itali, për të cilat as ai e as shteti shqiptar nuk kanë meritën më të vogël. Ato biznese iu detyrohen aftësive të shqiptarëve e jo qeverisë së shtetit të tyre që i përzuri e i bëri të iknin në Itali. Në të vërtetë, pyetja shtrohet, pse nuk mund t'i ndërtojnë këto 22 mijë shqiptarë bizneset e tyre në shtetin e në atdheun e tyre? Këto 22 mijë sipërmarrës e biznesmenë nuk shkuan si fitimtarë e si ushtarë në Itali. Ata shkuan në Itali si mërgimtarë që nuk i mbajti vendi i tyre e që, edhe më keq, nuk mund të kthehen në vendin e tyre.

Ndër të tjera, zotimi i kryeministrit të tanishëm shqiptar se nuk do të dërgoheshin më vajza shqiptare në Itali që të shiteshin

rrugëve, se do të ndaloheshin gomonet e skafet, shkaktoi një reagim interesant. Berluskoni i tha që të ndalonte gomonet, por le të sillte sa më shumë vajza të bukura shqiptare që të mbushnin trotuaret e Italisë, sepse ai ishte... beqar. Praktikisht, Berluskoni i kërkoi kryeministrit shqiptar që të bëhej ndërmjetësi midis këtyre vajzave e trotuarit, ku ato do të shiten. Fjala më e saktë është kodosh apo pusht. Berluskoni i kërkoi shtetit shqiptar që të eksportonte prostituta, por të bukura ama dhe në këtë mënyrë të forconte marrëdhëniet shqiptaro-italiane, sepse Berluskoni, që është ndarë nga gruaja, të cilën e pati njohur në një regjistrimin e skene filmike me lakuriqësi të theksuar, tashmë ishte beqar dhe kishte nevojë për femra për mbrëmjet e tij *bunga-bunga*.

Reagimi mjeran, servil dhe i padinjitet i palës shqiptare i atypëratyshëm dhe i mëpastajshëm, si në rastin e sulmit kundër Elvira Dones, tregon se deri ku ka mbërritur zvetënimi politik i parisë sunduese. Duhet sqaruar edhe një herë se krahasimi midis Skanderbegut dhe kryeministrit të tanishëm shqiptar mbaron këtu. Të dy kanë qenë në Itali. Por njëri thirret të shkojë me ushta, tjetri me pushta. Njëri thirret të vendosë kush është mbreti e tjetri thirret të mbledhë plehrat e Palermos. Njëri krenohet se është shqiptar e epirotas e tjetri gëlltit ofendime nga më të rëndat.

Aq më keq, tamam kur duhet të heshtë e të shohë veten në pasqyrë, e kushedi se ç'ka do të shohë atje, kryeministri i shtetit shqiptar sulmon ato shqiptare të suksesshme si Elvira Dones, që mbrojnë nderin e dinjitetin e simotrave të tyre. Elvira Dones ka bërë atë që pak njerëz në politikën shqiptare kanë arritur ta bëjnë e, për këtë, duhet nderuar e respektuar. Ajo mbrojti nderin e dinjitetin e vajzave të humbura rrugëve të botës dhe iu kundërvue sjelljes së kryeministrit italian. Kryeministri shqiptar sillet si shërbyes i të huajit dhe iu kundërvue vajzës e gruas shqiptare. Ata që kanë thënë, se fundi nuk ka fund, se gjithnjë ka edhe më keq, kanë të drejtë.

Mirëpo, përtej incidentit të rastit, duhet të reflektojmë edhe më gjerë. Mbi të gjitha, duhet të reflektojmë se sa poshtë ka rënë gjendja në shtetin shqiptar. Në mos tjetër, një incident i tillë të tregon se sa dëshpëruese është gjendja në shtetin shqiptar

dhe sa e nevojshme është dalja e alternativave që iu kthejnë njerëzve nderin e dinjitetin si dhe shtetin që duhet të vihet në shërbim të tyre.

INTELEKTUALËT DHE PSEUDO-INTELEKTUALËT E TRANZICIONIT

Reflektimi lidhur me vendin dhe me rolin e intelektualëve në jetën publike është i nevojshëm dhe i dobishëm. Për mua, ky reflektim ka qenë një preokupim që e kam patur gjatë gjithë këtyre viteve në mërgim. Çështja e rolit të intelektualëve në tranzicion, edhe pse e abuzuar deri në ekstrem në debatet e shumta, është e nevojshme të qartësohet dhe është vërtet e dobishme të trajtohet si duhet.

Për ta mbështetur mendimin tim, duke mos mundur të prek çdo element të nevojshëm për një argument të gjerë, edhe pse shumë gjëra i kam përmendur në shkrimet e mia të tjera, këtu do të cek disa aspekte të vendit e të rolit të intelektualëve në lidhje me politikën e ditës. Në veçanti, do të ndalem tek transparenca e zgjedhjeve, duke e përdorur këtë problem të madh të rradhës, si një rast për me ilustruar argumentin e ngritur me lart. Në fund, do të parashtoj edhe disa gjykime e zgjidhje personale të miat lidhur me këtë problem.

Intelektuali dhe vendi i tij në shoqëri

Si një person që merret me idetë, d.m.th., me krijimin, shpërndarjen e interpretimin e ideve, të mendësive, të botëkuptimeve e të vlerave, me autoritet e me kompetencë, shpesh të vërtetuara me tituj e grada shkencore, intelektual i ka një vend të veçantë në çdo shoqëri. Qoftë si klerik, krijues artistik, studjues apo si profesor, detyra e tij është të mbajë gjithnjë parasysh të mirën e përbashkët të grupit të cilit i përket dhe të ofrojë zgjidhje

profesionale, në të mirë të grupit të vet.

Si ekspert i dijes për një fushë të caktuar, intelektualit duhet të bëjë analizën më të paanshme, më të drejtë, të pandikuar nga interesi i momentit, as i tiji si individ e as i atyre që kanë pushtet. Në këtë drejtim, intelektualit duhet të flasë me autoritetin e dijes, si zëri i së vërtetës. Standardi i gjykimit të tij duhet të jetë thelbësisht teknokratik, i paanshëm dhe i pavarur nga opinioni sundues i kohës. Baza e gjykimit të tij është dija që ai ka në një fushë të caktuar. Prandaj, intelektualë si Myslym Pashaj, meritojnë respekt, sepse e përdorin dijen për të bërë një shërbim të çmuar publik.

Ka intelektualë që kanë besuar në atë që kanë bërë dhe nuk kanë bërë kompromis me të tjerët për vlerat e me mendimet e tyre si Sokrati, Pali i Tarsus, Giordano Bruno apo San Juan De La Cruz. Intelektuali mund të jetë gabim dhe ka shumë intelektualë që kanë bërë zgjidhjet e gabuara: Giovani Gentile, Martin Heidegger e Carl Shmitt, janë disa shembuj që e ilustrojnë mirë këtë gjë. Zgjidhja e tyre ka qenë e gabuar, sepse ato u instrumentalizuan prej politikës, e kësaj e humbën kredibilitetin e të folurit në mënyrë të paanshme dhe si intelektualë. Ata u bënë vegla të vullnetit të një grupi të caktuar. Edhe në shtetin shqiptar, intelektualët që u rreshtuan pas Sali Berishës e udhëheqësit të PS-së, Fatos Nano, e mandej u përdoruan pa kushte prej tyre, si Neritan Ceka e shumë nga KOP-sat, e kanë humbë besueshmërinë me kohë. Humbja e pavarësisë së menduarit është humbje e besueshmërisë; ajo të bën ushtar të parisë e thjesht një instrument të vullnetit të saj.

Ka edhe shumë pseudo-intelektualë, njerëz që flasin, por nuk e dinë se çfarë thonë, ose që janë thjesht pena të shitura në shërbim të një grupi të caktuar për interesa ekonomike, favore, apo për lidhje personale. Këta pseudo-intelektualë, njerëz të harrueshëm, dhe të përdorueshëm për politikën e ditës, janë shoqërisht më të rrezikshmit. Duke u sjellë si partizanë politikë, këta e kanë gati një masë të madhe mbështetësish militantë, që pranojnë çdo gjë që iu thuhet nga partia pa rezerva. Ndër këto pseudointelektualë hyjnë pisqollat mediatike të tipit Fahri Balliu.

Por, intelektualit i vërtetë duhet të jetë në gjendje me e thënë të

vërtetën ashtu si e mendon dhe ashtu si e ndjen ai, pa patur frikë nga paragjykimet, mënjanimet, ndëshkimet, etj. Pra, intelektualit duhet ta shohë veten të çliruar nga të gjitha shtërngesat, që e detyrojnë të deformojë mendimin e tij. Këto shtërngesa janë të pashmangshme për dikënd tjetër që është përfshirë në jetën shoqërore e politike aktive, si politikan apo si patericë mediatike e politikanit. Intelektuali i vërtetë është besnik i vlerave në të cilat beson. Metri me të cilin e gjykon veten është besnikëria karshi atyre vlerave e ndërgjegja e tij.

Intelektuali dhe Politikani

Një hap i mirë përpara do të ishte kontrastimi, sado i përciptë, i intelektualëve me politikanët. Ideali është mbreti-filozof i Platonit. Mirëpo ideali është ideal, sepse nuk mund të mbrihet. Në realitet, intelektualit dhe politikani lëvizin në dy botë të ndryshme. Ata janë në dy profesione të ndryshme. Intelektuali mendon për problemet, duke peshuar zgjidhjet e mundshme në nivel moral e profesional, politikani duhet me i zgjidhë problemet ashtu si të mundet. Njëri vepron në nivelin e të dobishmes e të dëshirueshmes, tjetri në nivelin e të mundshmes e të nevojshmes. Si pasojë e veprimtarisë në këto dy botë të ndryshme, por jo gjithnjë të papajtueshme, dallimi midis një intelektualit e një politikani është thelbësor e, për disa, si nata me ditën.

Politikani duhet të gjejë një rrugë me u pelqye nga mbështetësit të vet, me zgjidhë probleme praktike, me mbajtë parasysh shtërngesat e ndryshme e të shumta në vendimmarrje. Natyra e veprimit politik është e tillë, që politikani duhet me mbështetë një zgjidhje të kënaqshme e asnjëherë optimale, sepse ai vepron në një ambient krejt tjetër prej intelektualit që ka si shtërngesë vetëm vlerat e veta e të vërtetën. Këto interpretime dhe rrugë-zgjidhje të ndryshme të problemeve politike, krijojnë bazën për një konflikt të pazgjidhshëm e të përhershëm midis politikanit e intelektualit.

Prandaj, një intelektual i vërtetë kurrë nuk mundet të jetë i kënaqur me politikën e ditës, me dukuritë e me zgjidhjet që evidentohen në procesin politik. Arsyeja është se, gjithmonë,

zgjidhjet që bëhen nga politikanët do të jenë jo të përsosura. Gjithmonë ka zgjidhje edhe më të mira e shpesh intelektual i njeh dhe i di këto zgjidhje. Kompromisi, pazarllëku, interesat e ngushta, ekzigjencat e mendësisë, të kulturës politike e institucionale, gjendja ndërkombëtare e shumë elemente të tjera, që janë pjesë e këtij kalkulimi në vendimmarrje, janë gjithmonë pengesa për arritjen e së mirës më të madhe të mundshme, të asaj të mire që intelektual mendon se duhet të mbrihet, sepse është në të mirë të të gjithëve.

Duke thënë atë që askush tjetër nuk mundet me e thënë, duke mbrojtur atë që parimisht duhet bërë, duke sugjeruar më të mirën gjë të mundëshme, intelektual kryen një shërbim publik të pazëvendësueshëm. Për të qenë në nivelin e duhur, intelektual duhet t'i shprehë, t'i mbrojë, e të mos heqë dorë prej bindjeve të veta, edhe me jetën e vet. Bindjet mund të jenë të gabuara, por ajo që e dallon intelektualin prej të tjerëve është të qenurit i qetë me ndërgjegjen e vet. Koha ka me i zgjedhë e me i ndarë ata që mendojnë drejt nga ata që mendojnë gabim.

Politikani, nga ana tjetër, mendon përmbi të gjitha, për mbijetesën e vet në politikë. Çdo zgjidhje që bën, politikani e bën në funksion të këtij objekti. E kundërta ndodh me intelektualët. Mbijetesa e një intelektual është mbijetesa e ideve të tij. Intelektuali duhet të jetojë në një emigrim të vetëimponuar edhe brenda një shoqërie të caktuar, mos të jetë i lidhur me interesa materiale, që e kthejnë dhe e mbajnë peng të politikës e të kujtdo që ka interesa të tjera larg së vërtetës. Ai duhet të ketë kurajon me folë pa frikë. Intelektualët e kanë si obligim me u kthye në pjesëmarrës në debatin publik. Ata duhet me ia dhënë shoqërisë mendimin e tyre, në veçanti, kur flitet për fusha në të cilat ato kanë dije e janë të specializuar. Intelektuali që don vetëm me marrë e mos me dhënë në fushën e vet është njëllë sikur nuk ka ekzistuar ndonjëherë.

Një shembull zgjidhjeje politike: kërkesa për transparencën e zgjedhjeve

Debati për transparencën e zgjedhjeve të Qershorit 2009 ka

konsumuar kohë e jashtëzakonisht shumë energji në Tiranë. Natyrisht, intelektualët e Tiranës janë rreshtuar ose në njërën anë, ose në anën tjetër të barrikadës. Si edhe shihet, nga debati për “Çorapen e Tajlerandit”, por edhe nga shkrimet e shumta të individëve që gjithkund tjetër nuk do të klasifikoheshin si intelektualë të formuar, një palë mbrojnë Edi Ramën e një palë mbrojnë Sali Berishën. Të dy palët i paraqesin argumentet e tyre, të rreshtuara me kujdes e të mbështetura në të drejtën, ose kushtetuese ose morale, por sipas këndvështrimit që u intereson atyre.

Në thelb të përplasjes për transparencën e zgjedhjeve është kontrolli i pushtetit. Unë nuk shoh ndonjë gabim me mendimin tim se Sali Berisha kërkon të rrijë në pushtet deri në fund të këtij mandati e se Edi Rama kërkon të marrë pushtetin sa më shpejt që të jetë e mundur. Po nuk kërkoi me e marrë pushtetin, atëherë Edi Rama nuk ka pse rri në politikë. E për një politikan, gjithçka i shërben arritjes së këtij objekti të marrjes së pushtetit dhe këtu, kërkesa për transparencën e zgjedhjeve, sipas mendimit tim, është pastërtisht politike. Unë nuk kam thënë kund se po u hapën kutitë, Edi Rama do të bëhet kryeministër menjëherë.

Por nuk ka dyshim se në këtë rast, edhe hapja e kutive, qoftë drejtpërdrejt (vjedhja del ashiqare) qoftë indirekt (shumica qeverisëse e humbet legjitimitetin), do të çojë në kontestimin e gjendjes dhe në zgjedhje të parakohshme. Po doli se i ka vjedhur votat Sali Berisha, si do të rrijë në pushtet ai person? Po doli se ka pasur manipulime, aty janë komisionerët dhe është kollaj me ua hedhë fajin atyre. Por, të gjithë e dimë se, në rastin me të mirë, edhe sikur të shkojnë edhe një herë tek *Krokodili*, Sali Berisha do të hapë tre-katër zona, por jo të gjitha kutitë. Më duket se çdo gjykim tjetër që e sheh këtë përplasje si të motivuar nga dëshira me nxjerrë në dritë të vërtetën, për hir të se vërtetës, apo me mbrojtë kushtetutën e ligjin është i papjekur dhe naiv. Në politikë, për një politikan, ajo i shërben është e vërteta dhe gjithmonë ka një anë që paraqitet si e vërtetë me mbrojtë kauzën tënde.

A ka të drejte Edi Rama me kërkuar hapjen e kutive e qartësimin e së vërtetës? Padyshim që ai ka shumë të drejtë. I hapi kutitë edhe

Iraku e jo më shteti shqiptar. Kutitë duhet të hapen. Mirëpo, në Irak i pranojnë rezultatet ashtu si janë. Në shtetin shqiptar, ku zgjedhjet ishin krejtësisht të papastra e të pandershme, ku komisionerët u sollën ashtu si u urdhëruan që të sillen, ku ndodhën “çudira” elektorale e të gjithë janë të vetëdijshëm për këtë problem, të gjithë palët e dinë se hapja e kutive çon në prishjen e ekuilibreve ekzistuese.

Kjo zgjidhje është e papranueshme për disa politikanë si Sali Berisha e Ilir Meta. Por, në këtë pikë, kjo zgjidhje është jetike për të tjerët, si Edi Rama. E prandaj, përplasja do të vazhdojë deri sa të vijë puna që edhe Sali Berisha të mos ketë nga të shkojë, si bie fjala, tek zgjedhjet lokale, zgjedhja e Presidentit e deri në zgjedhjet kuvendore të vitit 2013. Ose vetë, ose me ndërhyrjen e të huajve, kompromisi do të duket sikur është i pashmangshëm. Mandej do të shkojmë në përplasjen e rradhës.

Ndërkohë, intelektualët militantë e pseudo-intelektualët janë rreshtuar në mbrojtje të platformës së njerës palë. Ata përsërisin argumentet e qëmtuara me kujdes nga politikanët dhe këshilltarët e tyre dhe, kështu, kthehen në tellallët e partisë.

Këta pseudo-intelektualë që luajnë lojën *miq-armiq*, janë në Tiranë, i kanë hapësirat mediatike nën kontrollin e tyre dhe bërtasin e dëgjojnë më fort se të gjithë të tjerët. Kush nuk iu bashkëngjitet, etiketohet dhe është “armiku”. Por, sjellja e tyre është tipike e pseudo-intelektualëve. Këta e përdorin dijen që kanë për të shtrembëruar të vërtetën dhe për ta vënë në shërbim të politikës së ditës. Intelektualët e vërtetë, nuk pranojnë që të luajnë me të vërtetën në të cilën besojnë.

Një interpretim ndryshe i kërkesës për transparencën e zgjedhjeve

Mendimi im, është se që të dy këta udhëhëqes të parisë janë të motivuar vetëm e vetëm nga interesi personal dhe i strukturave oligarkike klanore që i mbështesin. Mendimi im është se sistemi që ka ndërtuar paria e Tiranës është me të meta të mëdha dhe lejon e mundëson kështu përplasjen midis palëve të parisë dhe

prijatarëve të tyre. Mendimi im është se shërrit i rradhës bëhet vetëm për interesat e tyre personale dhe se transparenca e votave po përdoret për të arritur qëllime të pastra politike personale.

Paria e Tiranës, që mendon vetëm e vetëm për vete, nën petkun e shërrit të rradhës, e përdor mendësinë katundare (fshatare, rurale) për me mobilizue njerëzit për qëllimet e veta politike. Sali Berisha nxjerr me qindra mijëra vetë, burra që ndryshe të vrasin për nder dhe iu ven përpara këngëtares Çiljeta Xhilaga, anëtare e Këshillit Drejtues të PD-së, të këndojë këngët e saj të preferuara. Sali Berisha e bën këtë gjë që të tregojë forcën e vet dhe besnikërinë që ai pret të gjejë dhe që ai e gjen tek mbështetësit e tij militantë.

Po ashtu edhe Edi Rama, kryetari i PS, mbledh mbështetësit e tij me metoda që shfrytëzojnë mendësinë katundare në miting mbas mitingut, e tashti ka filluar me folë si Enver Hoxha dikur. Parimi që e ndajnë të dy këta prijatarë të mitingjeve, të mbushura me katundarë, është se “kështu e lyp ky popull”. Në mendjen e tyre, këto forma organizimi janë praktika që japin rezultat të menjëhershëm. Vetëm kështu edhe kundërshtari e kupton se sa i fortë jam unë. Prandaj, pyetja në shtyp është se sa mijëra vetë kishin nxjerrë njëri e tjetri në mitingun e rradhës. Loja është tek mobilizimi. Të dy palët nuk shkojnë deri tek mobilizimi, pika më delikate, thjesht sepse aty ndalen të dyja palët që i ruhen fort përplasjes së vërtetë. Edhe në mes të grevës së urisë, loja me përfaqësuesit e tyre respektivë u luajt në perfekcion. Këta të deleguar u takuan përditë dhe mesazhet siguroese u dhanë gjithë kohës në media, dhe u dërguan privatisht. Të dy palët e parisë e dinë se po mori flakë shteti, sepse kështu si është, shteti shqiptar është si një mullar bari i tharë, do të digjen edhe këta vetë.

Prandaj, synimi është që të përplasemi, aq sa të mbajmë shërrin ndezur dhe tufën e militantëve bashkë, të zgjidhim hallet tona, por të mos e lemë shërrin të na nxjerrë edhe ne jashtë loje. Të dy palët veprojnë kështu të shtyrë nga interesat e tyre të ngushta e personale e pa farë respekti për popullin shqiptar e për interesat e tij jetike. Ata e kanë çuar popullin në këtë gjendje, e mbajnë dhe e kanë lënë në këtë gjendje jermi ideologjik e moral, me qëllim e pa pikë mëshire. Ata do të luftojnë që ta mbajnë e ta

kultivojnë këtë gjendje sa më shumë që të jetë e mundur, thjesht sepse padija është nëna e sherrit. Padija është burimi i konfliktit politik midis njerëzve që nuk kanë mjete të sofistikuara me e interpretue botën e që gjithçka e shohin në nivele personale, duke u bërë kështu lehtësisht të mobilizueshëm prej kryetarit të rradhës të partisë “së tyre”.

Kështu duhet kuptuar edhe kjo përplasja e rradhës për transparencën. Le ta them në parantezë, se konflikti midis tyre ishte i shmangshëm, për aq kohë sa dukej se shpenzimet e sherrit do t’i paguante një palë e tretë. Produkti i kësaj marrëveshjeje midis një njeriu që shkruan për çdo gjë që ndodh në botë si kompetent, Kastriot Islamit, e një burokrati shumë besnik i shefit të vet si Ilir Rusmajli, u formulua një sistem zgjedhor që, në dukje, e garantonte sundimin e parisë e duokracinë PS-PD. Vendosja e një sistemi të tillë zgjedhor e mbylli lojën politike në interes të dy partive të mëdha.

Mirëpo, këta politikanë si Sali Berisha dhe Edi Rama mendojnë si arrivistë të mirëfilltë. Edi Rama synoi të hiqte qafe LSI-në. Sali Berisha i shkoj mbas avazit, sepse kishin rënë dakord për qeveri teknike. Por, sapo drejtuesit e LSI-së u treguan të hapur ër një marrëveshje me Sali Berishën, d.m.th., sapo u krijuan mundësi të reja, pazaret e deriatëhershme për qeveri teknike, për ngushtimin e hapësirës së LSI-së, dhe eliminimin e partive të vogla u prishën. PD ra doakord me LSI që të qeverisin. Tash që PS u dënua të mbetet në opozitë edhe për katër vjet të tjera, plasi sherri i pritshëm dhe i paevitueshëm por që, gjithsesi, po menaxhohet me kujdes nga të dy palët.

Në një intervistë të dhënë shumë kohë para zgjedhjeve pata parashikuar qartë se palët e parisë nuk do t’i respektonin marrëveshjet e bëra, se ata do të manipulonin dhe do të bënin rrëmujë mbas zgjedhjeve, sepse ashtu u leverdis e pse nuk dinë e nuk duan me vepruar ndryshe. Koha provoi se kisha shumë të drejtë. Ajo intervistë gjendet në *Youtube* dhe lexuesi mund ta shohë kur të dojë.

Pra, në momentin që iu prek interesi i tyre i ngushtë, asnjëra palë nuk pyeti për marrëveshjen që kishin bërë dhe të dy palët e

shkelën me të dy këmbët. Tash duhet të sillen kështu siç po sillen, sepse, po u sollën ndryshe, do ta humbin mbështetjen që kanë. Por, gjithmonë, ata janë të kujdesshëm që mos me i pre të gjithë urat me njëri-tjetrin. Përplasja duhet të ndodhë vetëm në media e të shërbejë për të mbajtur bashkë tufën e militantëve të tyre partiakë. Kur duhet ata duhet të takohen të shtërngojnë duart sikur nuk ka ndodhur asgjë dhe “të bëjnë politikë”.

Tash, në këtë konflikt të rradhës, të dy palët iu referohen rregullave të shkruara e vlerave morale, por loja politike në shtetin shqiptar nuk luhet me rregulla të shkruara e në bazë të parimeve morale. Nuk mendoj se motivimi i tyre është përmirësimi i gjendjes së popullit shqiptar e as vendosja e drejtësisë, sado e drejtë që është kërkesa e rradhës e PS-së. Sado fisnike që janë këto motive me të cilat paraqiten sot të dy palët, njëri flet për mbrojtjen e kushtetutës e tjetri për transparencën; sjellja e tyre koherente e konsistente në të shkuarën provon krejt të kundërtën. Çdo veprim i tyre bëhet thjesht i shtyrë nga nevoja për të pozicionuar veten dhe forcën politike që përfaqësojnë, në funksion të fitimit të zgjedhjeve të rradhës e të përmirësimit të pozicionit të tyre në parti e në sistemin politik.

Prandaj nuk ka rëndësi drejtësia e kërkesës së Edi Ramës. Në një vend ku gjithçka bëhet me hile e me poshtërsi, në një vend ku partia që ti drejton e mbështetësit tuaj janë epitomë e hilesë dhe e poshtërsisë, një kërkesë e tillë për drejtësi, transparencë e respekt të votës nuk është pjesë e rregullave të marrëdhënies midis palëve të parisë. Paria i numëron ata individë që i respektojnë këto parime si anormalë.

Cili është plani? Secili ka planin e vet. Sali Berisha don me ndenjë në pushtet, me krijue një bazë mbështetësish që i lë të vjedhë edhe katër vjet dhe i përdor më vonë siç don ai vetë, kur të dalë në opozitë. Edi Rama kërkon të forcojë bazën e vet politike brenda në PS. Ai kërkon me qenë fituesi moral i zgjedhjeve të kaluara dhe fituesi i zgjedhjeve të ardhshme në krye të një partie, që edhe pse në opozitë, është e konsoliduar nën udhëheqjen e tij.

Por, nuk është ky problemi. Sjellja e tyre katundare e me katundarët respektivë, është krejtësisht racionale dhe e

kuptueshme në politikë. Problemi ashtu si e kam paraqitur në shkrimet e mia të shumta, është se paria e Tiranës, pjesë e se cilës janë edhe Edi Rama, Sali Berisha, Gramoz Ruçi, Ilir Meta, Fatos Nano, Sabri Godo, Skender Gjinushi, e të gjithë të tjerët, nuk i respektojnë rregullat edhe kur i vendosin vetë e me marrëveshje. Kur nuk iu shërben diçka, kur nuk iu leverdis një zgjidhje, e kur nuk marrin atë që duan, atëherë ata i drejtohen rrugës, d.m.th., “përmbysin kazanin e ortës,” sepse vetëm rruga u ka mbetur. Kjo është logjika e sjelljes së tyre.

Argumenti im është se këtu qëndron tragjikomedia e politikës në shtetin shqiptar: mobilizimi i katundarëve, përmes manipulimit të mendësisë katundare, në emër të interesave të tyre të ngushta, që janë po ashtu karakteristike, interesa të ngushta vetjake katundare, në shërbim të oligarkisë së parisë e në dëm të shtetit e të interesit të përgjithshëm. E asgjë nuk e ilustron këtë sjellje më shumë se lufta e tanishme për transparencën e votës, një stuhi që vetëm po e forcon kontrollin e parisë mbi popullin e mbi shtetin. Kjo po ndodh në një kohë të vështirë krize të gjithanshme, që po e përfshin shtetin shqiptar si cunami. Lufta e çdo intelektualit duhet të jetë e pakompromis dhe e drejtuar kundër parisë e kundër këtij sistemi kriminal në shërbim të saj. Të gjithë pjestarët e parisë së Tiranës janë njëlloj e të gjithë janë kundër shqiptarëve.

Prandaj edhe detyra e intelektualit të vërtetë është me mbajtë parasysh interesat afatgjata, mirëqënien dhe sigurinë e popullit të vet. Politikanët e ditës vijnë e shkojnë, por populli mbetet. Politikanët jetojnë për brohoritjet e turmës e për pasurinë e lavdinë e ditës. Pseudo-intelektualët duan të ndërtojnë karriera e të mbushin xhepat. Por intelektualit i vërtetë duhet të shpresojë që mendimi i tij të jetojë në mendjen e dikujt. Prandaj, sa herë ndeshemi me dukuri të tilla, duhet të kujtojmë se rrugën ku ecin, intelektualët e zgjedhin vetë. Një intelektual që ka bindje të forta, edhe kur është krejt i vetëm, por ka kurajon të mbrojë bindjet e veta, kundërshtarëve të vet iu duket sikur është grup e shumicë.

DISA MENDIME MBI SHKRIMIN E SHABAN MURATIT: “DIPLOMACIA PUBLIKE DHE GLOBALIZIMI RAJONAL”

Shaban Murati është njëri ndër figurat e spikatura të diplomacisë shqiptare. Autor i shumë librave, komentator i njohur, ndjekës i vëmendshëm në shtyp i proceseve politike ballkanike e më gjerë, por edhe për një kohë të gjatë si Drejtor i Drejtorisë së Prognozës e Analizës në Ministrinë e Jashtme, Ambasador, e tash edhe si President i Akademisë Diplomatike në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Dr. Murati është një personalitet publik me rëndësi të veçantë, mendimi i shprehur i të cilit duhet analizuar me shumë seriozitet.

Edhe kur nuk e shpreh mendimin e tij personal, thjesht sepse ai vazhdon të jetë nomenklaturë e Ministrisë së Jashtme, nuk ka dyshim se ai i gjen mënyrat për të shprehur mendimet e tij, në mos tjetër, duke i pranuar e duke i paraqitur pikëpamjet zyrtare si të vetat. Prandaj, çdo gjë që thotë e që shkruan Shaban Murati duhet marrë me seriozitet e duhet analizuar, jo vetëm si shprehje e mendimit të tij personal, por edhe si shprehje e qëndrimit dhe e pikëpamjeve, në bazë të të cilave po e ndërton politikën e vet të jashtme shteti shqiptar, ai shtet që është, e në këtë gjendje mjerane në të cilën gjendet sot, në të gjitha instancat.

Për këto arsye, analiza e djeshme e Muratit “Diplomacia Publike dhe Globalizimi Rajonal,” botuar në *Gazeta Shqiptare* të datës 24 Maj 2010 ishte një shkrim shumë i rëndësishëm dhe që ia vlente të analizohej me qetësi. Siç shihet edhe nga titulli, tema e analizës së tij është për diplomacinë publike. Por, diplomacia publike nuk është qëllim në vetvete, nuk ka se si me qenë. Diplomacia publike është thjesht një instrument i përdorur nga shteti për të arritur

objektiva të caktuara politike. Me një fjalë, pyetja është se çfare objektivash politike synohet apo propozohet që të ndiqen?

Mirëpo, mbas konspektimit të vëmendshëm të analizës, lexuesi i kujdesshëm duhet të mbetet shumë i shqetësuar e të ndjehet shumë i paqartë. Kjo përpëlitse vjen për shkak të disa arsyeve të ndërlydhurae konceptimeve problematike, por që burojnë logjikisht nga premisat e nga botëkuptimi i shprehur në këtë shkrim të dendur të tij.

Duhet thënë që në fillim së analiza është profesionale dhe mundohet të ndërtojë një argument konsistent. Si e tillë, ajo qëndron në një nivel shumë më të lartë se rrrërtërrtërrret e shtypit të përditshëm të Tiranës. Mirëpo, kjo është një analizë që nuk i vë pikat mbi 'i' për arsyet e meposhtme:

Së pari, mendimi im është se analiza përmban një numër mangësish të thella konceptuale. Së dyti, analiza reflekton një kuptim të cekët të proceseve në politikën ndërkombëtare. Kjo, ndoshta, mund të jetë një zgjidhje e qëllimtë nga ana e Muratit. Megjithatë, një përvetësim i tillë i klisheve sunduese ideologjike, që bien në kundërshtim me interesin kombëtar në një shkrim ku edhe shiten për konsum publik nga një figurë e një niveli të tillë, nuk është i pranueshëm. Nuk është aspak e dobishme që një populli, edhe ashtu të dezinformuar deri në ekstrem, t'i shiten argumente që nuk kanë fare vlerë, thjesht sepse kështu bëhet edhe më shumë dëm pa pasur nevojë. Së treti, e si pasojë e asaj çka u tha më lart, nëse shteti shqiptar e formulon interesin e vet shtetëror në bazë të kësaj mendësie, që pasqyrohet në analizën e Muratit, atëhere duhet thënë se politikat e atij shteti kanë qënë, janë e do të jenë të dështuara.

Cili është problemi? Problemi me këtë analizë, e me luzmën e analizave pa fillim e fund që botohen përditë, është se shumica e shkruesve nuk e dinë mirë se çka po ndodh në të vërtetë në politikën ndërkombëtare. Po ashtu, duke mos i pasur konceptet e qarta e të duhura për të analizuar proceset e dukuritë përcaktuese në politikën ndërkombëtare, ose duke e bindur veten se po veprohet në një realitet të caktuar, ata gabojnë rëndshëm. Më së pari, edhe kuptimi i interesit të gjerë shtetëror dhe, në veçanti, interesat

jetike shtetërore, nuk perceptohen e nuk mund të mbrohen ashtu siç duhet. Prandaj, ia vlen të cekën disa nga problemet kyçe të kësaj analize. Është veçanërisht e dobishme për të vënë në pah disa mospërputhje midis mendësisë së parisë së Tiranës e të realitetit të politikës ballkanike e asaj ndërkombëtare.

Problemi kryesor që ka kjo analizë është premisa lidhur me kahun e drejtimin, në të cilin po ecën sistemi ndërkombëtar, si dhe me mënyrën se si këto procese do të influencojnë të ardhmen e shtetit shqiptar. Premisa e diplomacisë tradicionale është se politika bëhet për të mbrojtur interesat e shtetit tënd. Prandaj, politika ndërkombëtare ka qenë gjithnjë një perpjekje e pandryshuar e shteteve për të mbrojtur interesat e tyre jetike me të gjitha mënyrat e metodat e mundshme. Shtetet nuk kanë fare besim në institucionet ndërkombëtare apo në mirëdashjen e shtetit tjetër. Parimi kryesor i politikës tradicionale është se gjithkush duhet që të kujdeset për shtetin e vet, e duke mbajtur në mend se, para së gjithash, ka një balancë fuqie që rregullon sistemin ndërkombëtar. Brenda strukturave të kësaj balance fuqie, Fuqitë e Mëdha bëjnë çka duan e shtetet e vogla bëjnë çka mundën.

Mirëpo, Murati mendon se është krijuar një realitet i ri, në të cilin, kjo sjellje tradicionale nuk vyen më. Ai thotë se, “Ballkani është pjesë e procesit botëror të globalizimit, por me veçorinë se në këtë rajon, globalizmi është më i vonuar se në pjesët e tjera të kontinentit evropian.” Premisa, pra, është se globalizimi është sundues, se është i pashmangshëm, se Evropa është e avancuar në këto proceset e globalizimit dhe së është ceshtje kohe para se edhe Ballkani të përfshihet në këto rrjedha të pashmangshme globalizuese që, sipas Muratit, e kanë kthyer përmbys lojën ndërkombëtare, e cila tash po luhet, simbas tij, me rregulla të reja.

Por Ballkani është i vonuar dhe nuk është i përfshirë në këto procese globalizuese. Për Muratin, “Kjo vonesë paraqet një rrethanë, që ka ndikimet e veta në kompleksin e marrëdhënieve dypalëshe dhe shumëpalëshe në rajon, duke i bërë shpeshherë këto marrëdhënie edhe më të vështira, edhe më të ndërlikuara.” Zgjidhja që sheh Murati është në globalizimin e pashmangshëm të

Ballkanit. Globalizimi, mbi të gjitha, do të jetë panacea, zgjidhja e të gjithë problemeve me të cilat përballet rajoni.

Ky botëkuptim është normativ e moralisht i dëshërueshëm. Megjithatë, është një botëkuptim i paverifikuar në realitet. Problemi është se këtu globalizimi merret si i mirëqenë. Edhe pse kjo premisë nuk mbështetet me evidencë, e nuk zbërthehet me teza e argumente në vijim të analizës së tij. Për më tepër, Murati nuk konsideron një numër faktorësh e procesesh të evidentuara gjerësisht në politikën ballkanike, të cilat mund të ndikojnë që të krijojnë një të ardhme tjetër. Ajo e ardhme mund të jetë e duket se do të jetë krejt e ndryshme nga ajo që Murati e paraqet si të pashmangshme. Ajo që do të ndodhë, tradicionalistët do të thonin se është e tashmja por edhe e ardhmja. Në fakt, çdo argument që Murati paraqet në mbështetje të tezës së tij, është lehtësisht i kontestueshëm në realitetin ballkanik e më gjerë. Në rastin më të mirë, mund të thuhet se teza e tij mbi globalizimin, çelësi i argumentit të tij, është i mbështetur në shpresë, është me shumë dëshirë se sa realitet, më shumë bindje ideologjike se sa përvojë e përjetuar e realitetit. Në veçanti, në realitetin ballkanik, është një argument shumë i cekët dhe pa mbështetje.

Pse e them këtë? Globalizimi është një koncept shumë i kontestuar që, në thelbin e tij, nënkupton shkrirjen e barrierave shtetërore dhe lëvizje të lirë e pa pengesa të kapitalit, mallrave e të njerëzve në nivel global. Prandaj togfjalshi “globalizim rajonal”, siç e përdor Murati, është një përdorim jo normal i konceptit. Mund të ketë integritime rajonale, por jo “globalizime rajonale”. Duke i lënë mënjanë këto lapsuse, ndër të tjera, mund të thuhet pa shumë mëdyshje se globalizmi, anipse shumë i dëshërueshëm për shumë grupe, shtresa e shtete, edhe në rastin me të mirë, ka qenë i pjesshëm, i cekët dhe i kufizuar në marrëdhëniet ekonomike. Edhe kur është evidentuar dikund, globalizimi ka mbetur në tentativë, i ngushtuar në marrëdhëniet ekonomike, pa u shtrirë e pa mundur që të shtrihet thellësisht në fusha të tjera si marrëdhëniet politike, shoqërore, kulturore. Marrëdhëniet midis shteteve nuk kanë shkuar përtej proceseve të ngadalta të integritimeve rajonale të cilat, shpesh, kanë shkuar edhe në kahje të kundërt.

Edhe kur shtetet e veçanta kanë pasur nivele të larta të ndërvarësisë ekonomike, kjo nuk i ka penguar që të kenë fërkime e përplasje për çështje politike. Kështu po ndodh, bie fjala, edhe këto ditë në marrëdhëniet midis Francës e Gjermanisë, apo midis Gjermanisë e Mbretërisë së Bashkuar, p.sh., në takimin Merkel-Cameron. Kjo don të thotë se kriza është mu në zemër të Bashkimit European. Po ashtu, duhet thënë se mbas krizës së tregjeve financiare, globalizimi është duke humbur terren me shpejtësi. Shteti sovran ka fituar e po fiton me shpejtësi atë pak terren që humbi në fusha të caktuara. Kjo shihet, për shembull, nga vendosja e sistemeve të forta rregullatore mbi shkëmbimet e marrëdhëniet financiare dhe tek forcimi i strukturave e i institucioneve shtetërore, si dhe tek ndërhyrja vendimtare e shteteve në tregje e në ekonomi.

Me i ra shkurt, njëri problem delikat me këtë pikëpamje është se, për shumë shekuj, bota ka qenë e përbërë prej shteteve, të cilat kanë një atribut unik, sovranitetin, d.m.th. të drejtën e njohur për të marrë vendime, pa pyetur kënd, për politikat e brendshme e të jashtme. Pse duhet që të mendojmë se sistemi ndërkombëtar, i përbërë prej shteteve, do të zëvendësohet nga një sistem globalizues, dhe i cili nuk do të ketë një strukturë të tillë vendimmarrëse e gjithëpërfshirëse siç është shteti?

Problemet e Ballkanit nuk vijnë e as nuk përkeqësohen nga vonesa e globalizimit apo e përfshirjes së gadishullit në proceset globalizuese, çka do që ato janë për Muratin. Problemet e Ballkanit janë probleme kombëtare, janë probleme të formimit të shteteve kombëtare, një proces që nuk ka përfunduar, prej të cilit paritë sunduese të disa shteteve, nuk kanë hequr fare dorë e as nuk duket se kanë ndërmend të heqin dorë.

Paradoksi është se edhe pse shteti shqiptar po e pret globalizimin e zgjidhjen e problemeve të veta prej globalizimit, shtetet e tjera të Ballkanit nuk duket se po presin që problemet e tyre të zgjidhen prej globalizimit. Hyrja në Europë është një mënyrë për të zgjidhur problemet e tyre ekonomike dhe të natyrave të tjera, por integrimin ata e konsiderojnë gjithnjë në funksion të interesit të tyre kombëtar. Për shqiptarët, edhe integrimi në BE

po e humbet joshjen, thjesht sepse vetë Bashkimi Europian është në krizë të thellë. Duke mbajtur parasysh interesimin në rënie të BE-së, thjesht sepse BE po shkon nga një krizë e thellë në disa të tjera të përnjëhershme, duke mbajtur parasysh përkushtimin në rritje të parive sunduese në disa shtete të Ballkanit, duke vënë re intensitetin e ndjenjave nacionaliste që shpërthejnë herë mbas herë, duke e ditur se udhëheqës demagogë do të mundohen që të mobilizojnë njerëzit në bazë të ideologjive shoviniste e revanshiste, si dhe duke parë përplasjen e fuqive të mëdha dhe aleancat që po forcohen e që pasqyrojnë lojën e madhe, duke e pritur daljen e alternativave të mundshme politike brenda vetë shteteve ballkanike, nuk duket se globalizimi do të ndodhë gjatë jetës sime e gjatë jetës së Muratit.

Bismarku thotë që nuk mund të parashikohet politika mbas tre vjetëve, por nuk ka pikë dyshimi se globalizimi nuk do të ndodhë gjatë këtij shekulli. Ndoshta në Ballkan do të vendoset paqja. Por paqja do të vendoset, jo pse Ballkani mund të përfshihet në proceset globalizuese. Paqja do të vendoset, sepse në Ballkan do të krijohet një balancë fuqie, e cila nuk lejon shtetet e tjera në rajon që të kontrollojnë shtete pa sovranitet të mirëfilltë si shteti shqiptar. Ndoshta Murati mund të kishte konsideruar edhe këtë pikëpamjen tjetër. Rezultatet dhe përshkrimi i së ardhmes ku ai mund të mbrrinte, do të ishin krejt të tjera. Si pasojë, edhe drejtimi i politikës shqiptare duhej të ishte krejt tjetër.

Një ndër argumentet e Muratit është i bazuar në besimin se po të punojnë për të mirën kolektive të tyre, shtetet e Ballkanit do t'i bënin një shërbim reciprok e të natyrshëm njëri-tjetrit. E nuk ka pse që të ketë probleme lidhur me këtë premisë, thjesht sepse të gjitha vendet ballkanike ndajnë të njëjtat objektiva dhe kanë shprehur të njëjtat aspirata. Këto objektiva politike të përbashkëta përfshijnë hyrjen në BE, forcimin e lidhjeve ekonomike e në nivel të parisë, dhe shkëmbimet kulturore. Në nivelin e diskursit politik diplomatik është e këndshme që të flitet për bashkëpunim ndërballkanik. Mirëpo, realiteti është krejt tjetër dhe realiteti është shumë i vrazhdë. Përveç shtetit shqiptar, është krejtësisht dhe lehtësisht e evidentueshme

se të gjithë shtetet e tjera ballkanike vazhdojnë të përdorin diplomacinë tradicionale në mbrojtje të interesave të tyre kombëtare e shtetërore. Shtetet e tjera ballkanike nuk pyesin për globalizimin por për balancën e fuqisë.

Pra, shkurt, kjo tezë e Muratit i bie ndesh realitetit të tanishëm të Ballkanit. Pavarësisht se të gjithë shtetet ballkanike, për hir të kulaçit të ndihmave kanë pranuar *pro forma* që të ndjekin të njëjtat objektiva të servirura nga bashkësia ndërkombëtare, shtetet ballkanike nuk kanë hequr fare dorë nga ndjekja e objektivave tradicionale shtetërore e kombëtare. Shpresa për Muratin është se Ballkani nuk do të jetë më fuçi baruti, por, realiteti është se tashmë Ballkani është kthyer në *cluster bombs*. Në Ballkan ka ndodhur e kundërta e asaj çka shpresonin shtetet e BE-së dhe SHBA. Nuk ka luftëra frontale, por ka përplasje për pozicionim që ndodhin sot e gjithë ditën e gjithkund në Ballkan. E në rastin e shqiptarëve, maqedonët vrasin shqiptarë në Kumanovë, Koshtunica hyn në Kosovë, grekët duan varret e ushtarëve të tyre në jugun e shtetit shqiptar e me rradhë. Këto nuk janë objektiva që priten nga shtete që dësherojnë globalizimin.

Mund të thuhet se, edhe pse po mbahet gjallë me shiringat e vizave e me perspektivën e kandidimit në BE, projekti fillestar european për të ndërtuar një mini-maxi-Jugospace, të zbutur e të paqësuar me shtetet që dolën nga ish-Jugosllavia e të shtuar me shtetin shqiptar, ka dështuar. Shtetet ballkanike e kanë intensifikuar përpjekjen e tyre për të arritur objektivat nacionaliste. Paritë e tyre nuk heqin dore prej agjendës së pastër nacionaliste. Kështu, Greqia mund të jetë e falimentuar, por ajo nuk heq dorë nga kërkesa për ndrrimin e emrit të Maqedonisë. Greqia nuk heq dorë as nga përpjekja për të arritur objektivat e saj në lidhje me vetë shtetin shqiptar. Serbia po ashtu mund të jetë në prag të falimentit, por nuk heq dorë nga plani i *Serbisë Homogjene*. Maqedonia, shteti ku Murati ka qënë ambasador, është në prag të një krize tjetër. Maqedonia është një shtet i mbajtur bashkë me zor nga Fuqitë e Mëdha dhe që, përherë e më me intensitet po sheh nga Bullgaria. Logjika e transformimit të shteteve ballkanike në kështjella rëre, me shpresën se ashtu do të shmangej përplasia

etnike e nacionaliste, ka pasur sukses vetëm në shtetin shqiptar.

Për më tepër, analiza e Muratit neglizhon një nga aspektet më të rëndësishme të përvojës së marrëdhënieve ndërkombëtare. Shtetet e vogla ua detyrojnë ekzistencën e tyre përplasjeve midis fuqive të mëdha. Për Muratin, "Ballkani është një rajon i përbërë nga shtete, të cilat, në një klasifikim botëror mund të cilësohen "të vegjël". Ballkani nuk ka në kufijtë e tij ndonjë nga shtetet, që sot klasifikohen si fuqi botërore." Mirëpo, ky është një konceptim i gabuar.

Fuqitë e Mëdha janë aty ku kanë interesa e Ballkani nuk bën përjashtim. Nuk ka pse të kemi fqinjë fizikë Fuqitë e Mëdha, anipse përmes EU i kemi disa Fuqi të Mëdha shumë më afër se duhet. Të tjerat, që janë më larg, janë të pranishme përmes shumë marrëveshjeve dypalëshe, të cilat mendoj se Shaban Murati i njeh mirë.

Mbas vitit 1990, Kroacia, Maqedonia, Kosova, Bosnja e Mali i Zi janë shembujt më të qartë të shteteve që ua detyrojnë ekzistencën e tyre Fuqive të Mëdha, ashtu siç ua detyronte edhe vetë shteti shqiptar në një kohe tjetër. Me përjashtim të shtetit shqiptar, që ka bërë bashkë një numër objektivash të papajtueshme me njëri-tjetrin dhe që i konsideron si interesa jetike edhe kur janë të pambrritshme, si bie fjala, integrimin në BE, shtetet e tjera ballkanike po ndjekin politika paralele.

Shtetet e tjera ballkanike po ndërtojnë aleanca të qarta me shtete që nuk janë pjesë e zgjidhjes së problemeve në Ballkan, qofshin shtete si Serbia që janë jashtë NATO e jashtë BE-së, apo qofshin shtete si Greqia, që janë brenda të dyjave. Realiteti ballkanik është një realitet i përplasjes midis Fuqive të Mëdha, ku shtete, si p.sh., Serbia, duan të luajnë politikën tradicionale, me aleanca tradicionale e duke ndenjur majë gardhit, as këndeje e as andej. Shtete të tilla si Serbia po presin që të shohin se kush nga Fuqitë e Mëdha u jep me shumë. Si rusët, si kinezët kanë investuar rëndshëm në parinë serbe dhe janë të mirëpritur në Beograd. Serbët flasin për integrimin european por sytë i kanë nga Kosova, nga Republika Srpska në Bosnjë e nga Mali i Zi. Këto objektiva, jetike për ata, janë në thelb të politikës së tyre të jashtme.

E nuk janë vetëm serbët. Karakteristika themelore e përbashkët e lojës politike në Ballkan është përdorimi i shteteve për të arritur objektivat e përcaktuara nga agjenda respektive nacionaliste. Përdorimi i shteteve për të arritur objektiva të tilla natyrisht që e bën të pashmangshme ndërtimin e balancës rajonale të fuqisë në Ballkan. Po ashtu e bën të pashmangshme edhe përzierjen e Fuqive të Mëdha në këtë lojë. Parimi është se nuk ka më një tufë delesh kur njëra dele është ujk. Për shkak të mosndrrimit të aspiratave të tilla nacionaliste, Ballkani është më keq se një fuçi baruti. Ballkani është kthyer në një seri *cluster bombs* që shpërthejnë e që mund të shpërthejnë në çdo kohë. Kjo është krejt e kundërta e asaj që aspiron e argumenton Murati.

Edhe pse ai i përmend disa nga këto gjëra, Murati i kategorizon këto kahje si përjashtime nga norma e nga sjellja e duhur. Por, edhe pse moralisht mund të ketë të drejtë, ky është realiteti ballkanik. Shtetet e tjera po punojnë intensivisht për mbrritjen e objektivave të tyre. Ai që merret me politikë duhet të bazojë gjykimet e veta në realitetin ku gjendet. As grekët, as serbët, as bullgarët nuk bëjnë përjashtim nga ky rregull i ndjekjes së interesit nacionalist. Shembujt e kohëve të fundit, që mund të sillen për të ilustruar sjelljen e tyre nacionaliste, janë të panumërt. Vetëm shteti shqiptar, që është lavdëruar shpesh për këtë sjellje koherente e konsistente të tij, ka hequr dorë nga ndjekja e asaj që duhej të ishte interesi jetik shtetëror: forcimi i marrëdhënieve ndërshtetërore dhe forcimi i legjitimitetit të shtetit shqiptar. Mirëpo, shteti shqiptar e ka sovranitetin shumë të kufizuar. Kjo u pa nga ndërhyrja energjike e të huajve në restaurantin *Krokodili*, në lidhje me krizën e rradhës midis palëve të parisë.

Po ashtu, Murati merret me një nga problemet kyçe të politikës së sotme ballkanike, atë të përpjekjes së shtetit grek për t'u bërë shteti hegjemon i Ballkanit. Në vitin 1990, Greqia ishte e pozicionuar për të qenë fuqi rajonale dhe shteti grek investoi shumë në këtë drejtim. Me falimentimin e tanishëm të shtetit grek, projekti për ta bërë Greqinë fuqi rajonale ballkanike ka dështuar. Greqia nuk do të jetë në gjendje që të marrë veten edhe për shumë vite të tjera. Humbja që ka pësuar do të përkthehet edhe në humbje politike

e influence në rajon. Natyrisht, që duke e ruajtur pozicionin në BE, dhe duke menaxhuar me kujdes investimet që ka bërë në vendet e caktuara, Greqia do të luajë një rol më të madh se sa i ka mundësitë, por Greqia nuk mund të jetë më fuqi hegjemone, as edhe në Tiranë. Edhe mbështetja që Greqia ka marrë më përpara nga shtete të caktuara të BE-së për të qenë shtet hegjemon në Ballkan, tash do të vihet në pikëpyetje të madhe. Në këtë kontekst, mendimi i Muratit për të arritur barazvlefshmërinë e shteteve ballkanike është pak naiv. Shtetet kanë vlerë aq sa kanë fuqi e aq sa kanë të tjerët interesa tek ato.

Mendoj se Murati shtyhet shumë duke i mëshuar argumentit se BE është modeli që duhet të ndiqet. Murati thotë: "Ne e kemi tashmë një model tepër pozitiv dhe udhërrëfyes: Bashkimin Europian, të cilit i përkasim të gjithë." Për fat të keq, BE është e do të jetë në krizë të thellë edhe për shumë e shumë kohë të tjera. Shteti shqiptar e shtete të tjera në rajon nuk i përkasin BE-së. Në fakt, shtetet ballkanike duan t'i mbesin në derë BE-së e BE nuk do që t'i pranojë, por nuk ka zgjidhje pse nuk menaxhohen ndryshe problemet politike që lindin nga rajoni. E në rastin shqiptar, ma do mendja se Murati e di mirë se ka marrëveshje, traktate, e të tjera dokumente të nënshkruara që e bëjnë hyrjen e shtetit shqiptar e përkatësinë e tij europiane mjaft problematike. Përveç SHBA, një shtet aleat jetik politik e ushtarak i pazëvendësueshëm e Italisë, një vend më të cilin ka lidhje historike ekonomike e kulturore, shteti shqiptar duhet të jetë shteti i shqiptarëve. Shteti shqiptar duhet që të veprojë si fqinjët e vet e të konsiderojë si partnerë të dorës së parë edhe Gjermaninë e Turqinë, për sa kohë që kjo e fundit është në linjë me interesat shqiptare në Ballkan.

Por, në përfundim, do të thoja se kjo analizë shmang problemin kyç të Ballkanit, zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare. Mendimi se globalizimi do t'i zgjidhë të gjithë problemet është një devijim nga realiteti. Me ose pa dashjen e shtetit shqiptar, problemi shqiptar duhet të zgjidhet. Shumëçka që po ndodh në Ballkan, edhe vetë inisiativat e shteteve ballkanike, edhe inisiativat e ardhura në BE, janë të ndërtuara me këtë problem në mendje. Duke ofruar një interpretim të së ardhmes të mbështetur

në premisën se globalizimi është i paevitueshëm e se zgjidhja e problemeve ballkanike vjen vetëm përmes intensifikimit të këtyre proceseve, e si pasojë duke e injoruar problemin shqiptar, Murati nuk po e bën shërbimin e duhur si diplomat me përvojë që është. Po ashtu, ndjekja e një politike të tillë futuriste vetëm sa e vonon stabilizimin e qetësimin realist të Ballkanit.

**KATUNDARIZIMI:
PROBLEMI I MENDËSISË KATUNDARE
SI SËMUNDJA E POLITIKËS BASHKËKOHORE SHQIPTARE**

Në këtë shkrim do të përqëndrohem në analizimin e mendësisë katundare dhe në rolin që luan kjo mendësi në shoqërinë shqiptare. Në fushën e studimeve shoqërore, ka një traditë të dallueshme që i vendos kulturën dhe mendësitë popullore, *mentalité populaires*, në qendër të analizës së proceseve historike shoqërore. Në rastin shqiptar nuk ka analiza të thelluara të mendësive popullore, sidomos të evolucionit të mendësisë popullore gjatë tranzicionit. Mendësia popullore është analizuar gjerë e në thellësi gjatë kohës së sistemit enverist si, për shembull, kur sjelljet tipike katundare paraqiteshin si të gabuara apo të prapambetura. Por, përplasja midis mendësisë popullore dhe mendësisë që kërkonte të promovonte e të nguliste në shoqëri sistemi enverist, është subjekt që kërkon shumë vëmendje dhe një analizë më të thellë, se sa janë mundësitë këtu.

Në këtë shkrim, qëllimi është që të vihet në dukje natyra specifike e mendësisë sunduese popullore ndër shqiptarët gjatë tranzicionit. Paria flet për ideologji universaliste, si socializëm apo liberalizëm. Unë mendoj se mendësia sunduese është mendësia katundare. Argumenti im është se mendësia katundare është problemi kryesor me të cilin përballemi. Problemi dhe pengesa kryesore në rrugën e transformimit dhe të modernizimit të vërtetë të shoqërisë është procesi i katundarizimit të gjithanshëm të shoqërisë. Mendësia katundare është në themel të sjelljes së popullit dhe të parisë sunduese. Mendësia katundare është tipari kryesor i kulturës tonë kombëtare dhe politike gjatë tranzicionit.

Megjithatë edhe pse ata janë formalisht katundarë apo sillen si katundarë, vetë paria dhe prijatarët e saj vijnë nga shtigje dhe përvoja të tjera. Në rastin e parisë sunduese, që vjen në masë të madhe nga njerëz të shkolluar dhe me përvojë pune shtetërore për një kohë të gjatë, mendësia katundare është vetëm një instrument kontrolli, për të ruajtur pushtetin e tyre mbi shqiptarët. Prandaj edhe duhet bërë dallimi midis katundarëve, që e shohin botën në një mënyrë të caktuar dhe parisë, që e ka përdorur dhe e përdor këtë mendësi pa besuar në të. Megjithatë, një pjesë e saj ka arritur deri në atë pikë sa e ka internalizuar këtë mendësi dhe janë kthyer në origjinë. Por, nuk ka dyshim se përdorimi dhe kultivimi i mendësisë katundare ka qenë një zgjidhje e qëllimtë e parisë, me synime të qarta të ruajtjes së pushtetit dhe të interesave të shtresës së parisë. Pavarësisht urbanizimit formal, d.m.th. të lëvizjes së masave të gjera nga katundet në qytete, në tri valët historike të viteve 1930-1942, 1950-1970 dhe 1990-2000, mendësia e masës dërmuese të shqiptarëve ka qenë dhe ka mbetur një tipike mendësi katundare.

Argumenti këtu mund të përmblihet në pak fjali. Në vitin 1990, paria dhe intelektualët e kanë pasur shansin historik që të ndaheshin me këtë mendësi dhe të drejtonin shqiptarët në rrugën e duhur. Ata qëllimisht zgjodhën rrugën më të keqe, vendosën të ndjekin mendësinë katundare. Në vend që të udhëhiqnin popullin, ata ndoqën vetëm interesat e tyre të ngushta. Zgjidhja e tyre i ka sjellur shqiptarët në këtë gjendje kritike. Rruga që zgjodhën i bënë përgjegjës të padiskutueshëm të këtij krimi historik, sepse ata e zgjodhën këtë rrugë me vetëdije të plotë dhe pa brejtjen më të vogël të ndërjegjes.

Ibn Khalduni, katundaria dhe teoria e qarkullimit të parive

Në *Prolegomenonin* e tij të famshëm, *Al Mukaddima*, mendimtari i shquar arab i shekullit të 14-të, Ibn Khaldun paraqet një teori ciklike të konfliktit shoqëror të bazuar në përplasjen midis qytetërimit e barbarizmit. Në thelb, teoria e tij thotë se barbarët (në rastin e tij, beduinët që vijnë nga shkretina) pushtojnë zonat

e qytetarizuara, që tashmë janë të sofistikuara, por që janë të zhytura në degjenerim.

Barbarët e rinj, që edhe këta vijnë nga shkretina, i pushtojnë qytetet, të frymëzuar nga një fe e re, apo nga interpretimi i ri i fesë, që ata kërkojnë që të ripërtërihet. Barbarët e radhës (në kontekstin e Ibn Khaldun, beduinët, katundarët e shkretinës) fitojnë, sepse ata kanë kurajo, guxim dhe vlera. Mbi të gjitha, ata fitojnë sepse, për të jetuar në shkretinë, ata kanë zhvilluar organizim e strukturë të mbështetur në lidhje të fuqishme tribale e të gjakut. Kur e përdorin fenë si ideologji mobilizuese, ata ia arrijnë që të krijojnë kohezionin e nevojshëm e masën kritike, për të marrë kontrollin e shtetit. Barbarët bëhen pakica e re e organizuar dhe kompakte që hyn si thika në gjalpë në një shoqëri në dekadencë morale dhe politike. Barbarët i rivitalizojnë këto qendra. Ata e rindërtojnë shtetin dhe e bëjnë efektiv. Mirëpo, për tre-katër breza edhe ata vetë degjenerohen e bëhen të pazotët për të mbajtur pushtetin. Duke u mbështetur tek e njëjta fe, barbarët e rinj organizohen në katundet e tributë e tyre dhe marrin kontrollin e shtetit. Kjo teori njihet si teoria e qarkullimit të parive.

Një aplikim sipërfaqësor i teorisë së Ibn Khaldun në rastin shqiptar do të paraqitej kështu. Çdo tre-katër breza, një masë katundarësh, të etur për prona e për pasuri, turma malësorësh heroikë, të lidhur në strukturë tribale apo me një ideologji të caktuar, të drejtuar nga një grup individësh që kërkojnë pushtet, merr me forcë kontrollin e shtetit. Kur fitojnë, këta zhvendosin parinë e vjetër dhe e vënë shtetin në shërbim të këtij grupi. Katundarët e thjeshtë nxjerrin kunjat e vjetër në nivelin e katundit me bashkëkatundarët e tyre respektivë e, natyrisht, grabisin, vrasin e vjedhin çka iu del përpara, në emër të barazisë e të ligjit të më të fortit. Por, dalëngadalë, paria e asaj mase njerëzish sofistkohet dhe fillon që ta përdorjë shtetin për qëllimet e veta. Për më tepër, ajo vepron kështu duke ndjekur logjikën e forcimit të shtetit. Në rastin tonë, një shembull i mirë është Ahmet Zogu, aristokrati katundar nga Burgajeti i Matit. Një rast tjetër është Enver Hoxha, nipi i kryekatundarit të Gjirokastrës (siç përcaktohet në një dokument të vitit 1916), apo Mehmet Shehu, i biri i sheikut

të Çorrushit. Gjatë tranzicionit, kryekatundarët më të njohur janë Sali Berisha nga Viçidoli, Gramoz Ruçi nga Salaria, Fatos Nano nga Lunxhëria dhe Ilir Meta nga Skrapari.

Brezi i parë i shtresës sunduese e mban pushtetin me forcë. Ata i kthejnë katundarët në vendin e tyre, i mbajnë me rrogë, iu japin pasurinë e humbësve, apo bëjnë një reformë agrare. Kur kanë mundësi, ndërtojnë shtetin efektiv. Brezi i dytë i parisë bëhet politik dhe sundon me dinakëri e me zgjuarësi. Ky brez e mban pushtetin duke përdorur monopolin e dijes e rrjetin e lidhjeve, që e bëjnë të pazëvendësueshëm e legjitim, në sajë të fitimit të pushtetit nga ana e brezit të parë. Brezi i tretë bëhet artistik. Këta i harrojnë origjinat e veta katundare e sinqerisht besojnë se janë kryeqytetas të vërtetë. Në vijim, brezi i katërt, vjen i degjeneruar e i zvetënuar. Ky brez është kozmopolit në vlera, i prirur për qejfe dhe i pazoti të sundojë. Në këtë pikë, simbas teorisë së Ibn Khaldun, pritet vërshimi i një masë tjetër malokësh e katundarësh, që i zhvendos edhe këta pjestarë të parisë.

Kështu, cikli i qarkullimit të parive fillon prej fillimit. Ai duhet të rinisë me tribu të reja e me një ideologji të re. Gjithnjë, në dukje, por vetëm në dukje ama, shteti është në shërbim të interesit të katundarëve të rradhës. Në fakt, fitimtarja e vërtetë është gjithmonë paria sunduese e grupit të katundarëve, të mobilizuar në bazë të interesave të veshura me ideologjinë e kohës. Problemi shqiptar është se katundarizimi ka shkuar në drejtim të kundërt. Tashmë edhe paria sillet simbas mendësisë katundare, duke mos lejuar as formësimin e daljen e alternativave, por edhe duke e zvetënuar shoqërinë deri në atë pikë sa gjendja duket tërësisht e pashpresë.

Ibn Khalduni dhe rasti shqiptar

Në rastin shqiptar, përvojat tona tregojnë se kjo teori e qarkullimit të parive nuk është e aplikueshme apo e vërtetueshme për disa arsye. Nga një anë, gjatë një shekulli që e kemi pasur shtetin tonë të pavarur, ne i kemi ndrruar paritë sunduese shumë shpesh. Nga ana tjetër, paritë janë zëvendësuar përmes

një lufte formale ideologjike të pamëshirshme. Projektet që janë ndjekur kanë qënë modernizuese, por kanë rrjedhur nga tradita krejtësisht të kundërta ideologjike dhe kanë qënë të mbështetura në konceptime krejtësisht të ndryshme të realitetit. Në dy raste (1944 dhe 1990) paritë nuk janë marrë thjesht me kontrollin e shtetit, por me ndryshimin rrënjësor të shoqërisë. Në vitin 1912 e deri më 1939 në krye të shtetit ishin bejlerët e vërtetë, mehmurët me shkollë, dhe figurat e bashkësive fetare. Në vitin 1944 në krye erdhën katundarët dhe pinjollët e shtresave të mesme me gjysëm shkolle në Perëndim. Në vitin 1990 në krye mbeti paria sunduese, tashmë shumë e sofistikuar në përvoja dhe e zgjeruar me intelektualët dhe profesoratin universitar. Asnjëri grup nuk ka ndenjur në kontroll të shtetit më shumë se dy breza. Tradita jonë, në kohë kaq të shkurtër, njeh zëvendësimin, zgjerimin, transformimin, por edhe eliminimin e parive nga fitimtarët e radhës. Grupi i ri fitimtar, jo vetëm që e ka spostuar parinë sunduese të deriatëhershme nga rolet kryesore, por edhe shpesh i ka mënjeluar apo zhdukur fizikisht. Kështu ndodhi në vitin 1944 me ata elementë të parisë sunduese të deriatëhershme, që nuk u larguan. Metoda e preferuar e eliminimit të parisë gjatë tranzicionit ka qënë kooptimi ose mërgimi i detyruar.

Struktura e veçantë e organizimit tonë shoqëror ka çuar në formësimin e disa paradokseve unike shqiptare. Përfundimi kryesor që duhet vënë në pah është se, në vend që në vend të ndërtimit të shtetit, qoftë edhe në shërbim të vet, paria sunduese e rradhës është treguar po aq, në mos më shumë e katundarizuar se vetë katundarët që e sollën dhe që e mbajnë në pushtet. Ky është paradoksi i vërtetë i politikës shqiptare. Ndërtimi i shtetit dhe i strukturave nuk bëhet për të ndërtuar një shtet, që do të ishte në shërbim të të gjithëve. Ndërtimi i shtetit dhe i strukturave bëhet për të ruajtur kontrollin e klanit të caktuar katundar, ose të aleancës së disa klaneve katundare, mbi ngastrën e pushtetit. Politika që luhej në krye të shtetit ishte një ripërsëritje e sjelljes së katundarëve në katund. Kjo ndodh për shkak se shoqëria shqiptare e mbi të gjitha, paria sunduese, ka mbetur pre e mendësisë katundare që nuk i lejon shqiptarët që të bëjnë shtetin që duhet. Mungesa e shtetarëve

të mirëfilltë, mungesa e një etike dhe morali publik, të rrënjosur në një ideologji që iu shërben të gjithëve, sundimi i një mendësie arriviste dhe materialiste katundareske, janë karakteristika të parive shqiptare. Prandaj edhe teoria ciklike e Ibn Khaldun nuk është e aplikueshme në rastin shqiptar.

Katundi si forma më e përhapur e organizimit të shoqërisë shqiptare

Katundi ka qënë forma më e përhapur e organizimit të shoqërisë shqiptare dhe ka mbetur si i tillë edhe sot. Ka një dallim thelbësor midis fshatit dhe katundit. Ky dallim nuk zhvillohet sa duhet në literaturë, por ia vlen që ta diskutojmë këtu. Thënë përmbledhtas, fshati është një numër familjesh, që merren me blegtori apo me bujqësi dhe që janë në varësi ekonomike dhe politike prej parisë sunduese të kohës. Niveli i solidaritetit dhe i vetëdijes si shtresë është i pranishëm, por jo përcaktues deri në atë pikë sa fshati të transformohet në një entitet të mbyllur në vetvete. Katundi është një bashkësi e organizuar dhe kompakte, me struktura të forta shoqërore, me vlera, me hierarki dhe me një mendësi të dallueshme edhe nga katundi tjetër. Në mesjetë katundet tona kanë qënë edhe shtegtare, por me kohë, nën trysninë e shtetit, ka pasur një stabilizim të vendbanimeve dhe të familjeve në katundet e caktuara. Ruajtja e lëvizjeve në bazë të katundit mbështetej në ciklet bujqësore dhe blegtorale por kjo nuk e çenonte thelbin e vetë katundit. Edhe sundimi i familjeve të bejlerëve ishte shumë sipërfaqësor, sepse katundi kishte gjithnjë pronën e vogël apo të madhe të familjes dhe jeta e ritmi i jetës në bashkësinë katundare ishte autonom prej shtetit osman dhe vetë parisë.

Por, katundi shqiptar nuk ka qënë i izoluar. Në parantezë, nëse ka ndonjë gjë që mund të thuhet lidhur me shqiptarët si komb është se, historikisht, në grup ose veç e veç, kudo që ata kanë jetuar, në katund apo në kryeqytetet e perandorive, shumë prej tyre e kanë provuar veten si njerëz të lirë, të aftë, të zgjuar, e krijues. Mbi të gjitha, shqiptarët janë të sprovuar si njerëz që kanë ditur të krijojnë shtete e të mësojnë edhe të tjerët se si të bëjnë

shtete e perandori. Ky është një kontribut historik që sado poshtë që të bien shqiptarët si komb edhe po të shkojnë më keq se sa janë tash, askush nuk mundet që t'ua heqë.

Mirëpo, ikja e këtyre figurave të shquara politike e kulturore nga katundi respektiv, nuk e ka ndrruar ritmin e jetës në katund. Nga ana tjetër, autonomia e katundit ka qenë e theksuar, por katundi shqiptar nuk ka qenë asnjëherë i shkëputur nga shteti. Lidhja e kandarëve shqiptarë me shtetin ka qenë jetike. Punësimi i katundarëve nga shteti, si bashibozukë, jeniçerë, apo dervexhinj ishte një formë mërgimi nga katundi. Jeta e vërtetë zhvillohej në katund. Katundi ishte, në një farë mënyre, qendra e universit të tyre, madje edhe e atyre shqiptarëve që punonin për shtetin osman dhe të gjithë synonin që të ktheheshin atje, të gjallë a të vdekur. Kështu, Sinan Pasha kërkoi të varrosej në Kaninë, Mehmet Pashë Qyprilliu ngriti xhaminë e Roshnikut, Koxha Sinan Pasha ngriti xhaminë e Prizrenit, Mustafa Koçibej kërkoi të varrosej në Mborje e me radhë.

Prandaj, duhet theksuar se nga të gjithë figurat që iu bëjnë nder shqiptarëve në historinë e tyre, shumica e kanë rrënjën në një nga katundet e panumërta të trojeve shqiptare. Ashtu ishin kohët, katundi shqiptar, i madh apo i vogël, ishte djepi që lindi figura madhore të historisë e të mendimit politik, shoqëror, dhe kulturor të shteteve, ku ishin të përfshirë edhe shqiptarët por edhe i shtetit shqiptar. Kështu, Mustafa Koçibej, Volteri i Lindjes, ishte nga Mborja, Frang Bardhi ishte nga Nënshati, Pjetër Bogdani nga Hasi i Thatë, Shemsedin Samiu ishte nga Frashëri, Arkitekt Sinani ishte nga Bicaj i Kukësit, Gjergj Fishta nga Fishta, Binak Alia nga Krasniqja, Sefë Kosharja nga Kosharja, Petro Nini Luarasi nga Luarasi, pa numëruar këtu figurat politike, si Skënderbeu nga Kastrioti, Iljaz Mirahori nga Panariti, Ajaz pasha nga Himara, Qyprijtë nga Roshniku i Beratit, Ismail Pashë Velabishti nga Velabishti, Bushatllinjë nga Kosmaçi, Zef Ndok Illia nga Jubani, Anastas Kullurioti nga Salamina, Mustafa Pashë Bajraktari, që ishte po nga Mborja e Korçës, Mehmet Ali Pasha ishte nga një katund afër Mesarës, Ahmet Zogu nga Burgajeti, Bajram Curri nga Malësia e Gjakovës, Fan Noli nga Ibrik Tepe, Isa Boletini nga

Boletini, Lleshi i Zi prej Oroshit e me rradhë. Mund të thuhet pa frikë se nuk ka një katund të banuar me shqiptarë, që nuk e ka një figurë të njohur që ka lënë gjurmë në histori. Historia e shqiptarëve është historia e katundarëve fisnikë, me largpamësi, mençuri, me aftësi të rralla drejtuese, me dinjitet, e me zotësi shtetformuese. Ky lloj shqiptari i është imponuar botës. E jo vetëm në politikë. Mirëpo, problemi është se këta që bënë shtete për të tjerët, ishin vetëm katundarë ndër shqiptarë. Historia e shqiptarëve është historia e katundit të tyre.

Mund të thuhet pa frikë se katundari shqiptar ka kenë figurë me interes e historisë shqiptare edhe në fushën kulturore, qoftë kur ka kenë jeniçer, si Hasan Zyko Kamberi nga Leskoviku apo Nezimi i Frakullës, klerik si Mulla Hysen Dobraçi nga Dobraçi, enciklopedist si Shemsedin Samiu nga Frashëri, apo poet politik si Dritëro Agolli prej Menkulasit. Në historinë e shtetit shqiptar, natyrisht që ka edhe shumë katundarë, që kanë bërë dëm sa s’thuhet. Këtu mund të përmenden, bie fjala, Haxhi Qamili nga Sharra, Lalë Krosi prej Klosit, Mehmet Shehu nga Çorrushit, Hysni Kapo nga Tragjasi, Gramoz Pashko nga Vodica, Pjetër Arbnori prej Shirokës e shumë e shumë katundarë e stërnipa katundarësh të tjerë, që kanë lënë emër shumë të diskutueshëm në jetën politike shqiptare.

Duhet thënë se të gjithë shqiptarët i njohin dhe i dinë origjinat katundare, pavarësisht se kur janë shkëputur prej katundit. Kur nuk e pranojnë hapur, origjinën e tyre katundare e tregojnë mbiemrat e llagapet, sidomos ato që u ndrruan gjatë kohës së Enver Hoxhës e që askush nuk don t’i përmendë më. Kur nuk e tregojnë mbiemrat, origjinën e tregojnë njerëzit që japin intervistat për familjet e “shquara” dhe “fisnike”. Në këto intervista, shihet se si këta individë nuk mundën të shkojnë as tre-katër breza më larg, pa ndeshë stërgjyshër që kanë qenë katundarë. Shembulli më i mirë i ilustrimit të origjinave tona katundare ishte mbledhja e familjeve “fisnike e aristokrate”, që u bë në Tiranë disa vite më parë. Shumica dërmuese e pjesëmarrësve ishin trashëgimtarët e reshperëve, esnafëve e të bakallëve të dikurshëm.

Më e keqja është se edhe qytetet tona, deri në fillim të Luftës

së Dytë Botërore, ishin katunde të zgjeruara. Familjet jetonin si në katund. Dyert më të njohura qytetare rrisnin edhe fiq, rrush, hudhra, spinak e kastraveca në bahçen e shtëpisë. Mirëpo, për shkak të nevojave ideologjike të sistemeve që kaluam, dallimi midis katundit dhe qytetit është i theksuar më shumë se sa duhet në literaturë. Ky dallim është i bartur deri në ekstrem edhe në mendësinë e njerëzve, që shohin një mur të pakalueshëm midis qytetarëve dhe katundarëve. Ky mur ndoshta ekziston në Francë apo në Itali, por ndër ne ka qenë një rrugë dykalimshe. Për këtë arsye, d.m.th., që edhe kur iknin nga katundi, nuk shkëputej katundi prej tyre, mendësia katundare ka qenë mbisunduese ndër shqiptarët. Origjinat e njohura të shumicës shqiptare janë në katunde. Prandaj edhe nuk duhet të habitemi aspak që në krye të politikës shqiptare, ishin e janë kryesisht njerëz, familjet e të cilëve kanë jetuar në lagjet e katundet paksa jashtë qyteteve, disa të tjerë që blenë pasuritë e zotnive të tyre të deridjeshëm, apo disa të tjerë që u pasuruan në mënyra të dyshimta dhe me spekulime të hapura. Në krye të politikës shqiptare kanë dalë gjithnjë katundarët e stërnipat e katundarëve, në veçanti ata që e morën pronën me pushkë në dorë, qoftë si jeniçerë, si bashibozukë, si xhandarë, si partizanë, apo si antikomunistë. Historia shqiptare është e mbushur me katundarë, që duan të jenë të famshëm e të mëdhenj në katundin e në klanin e vet.

Edhe sot realiteti shqiptar, jo vetëm në shtetin shqiptar, është se partitë kryesore e shteti drejtohen nga katundarë, sado të fisëm në katundin e tyre, por katundarë gjithsesi. Asnjëri prej atyre që na drejton nuk i kalon dy breza në zona qytetase: Gramoz Ruçi e Valentina Leskaj vijnë nga Salaria e Tepelenës, Sali Berisha vjen nga Viçidoli i Tropojës, Ilir Meta vjen nga Skrapari, Fatos Nano nga Lunxhëria, apo Skënder Gjinushi nga Kurveleshi, pa llogaritur të tjerët, që nuk duan të tregojnë se çfarë janë. Ka shumë që ende nuk e dinë se a janë shqiptarë, çobanë, palikaris, konjarë apo jeniçerë të adaptuar. Megjithatë, të gjithë e dinë se janë katundarë, por refuzojnë që ta pranojnë këtë. Duhet pranuar se kur vjen puna me e bërë biografinë e vet, dhe për këtë i kemi biografitë që kanë lënë në Arkivin e PPSH-së, kur kanë qenë anëtarë partie, tre breza e

poshtë, të gjithë liderët tanë dalin ose katundarë safi ose të ardhur nga shtresa të varfëra qytetare, që bartin mendësinë katundare. Por problemi është tjetërkund. Problemi është se përtej lustrës së qytetërimit provincial, sjellja e të gjithëve është e sunduar prej mendësisë katundare.

Si shembull ilustrimi do të përmendja përplasjen lidhur me legjitimitetin e grupeve të ndryshme në Tiranë. Deri në vitin 1920, Tirana, në rastin më të mirë, ka qenë një katund i zgjeruar. Në vitin 1945 e mbas, Tirana u popullua me të ardhurit nga Toskëria. Në vitin 1990 u popullua me të ardhurit nga Gegnia. Përkundër vulgarizimit në shtypin e përditshëm, por edhe përkundër thashethemnajës së Tiranës, problemi nuk shtrohet se erdhën katundarët e na zunë tokat apo se na morën shtetin. Në një farë mënyre, është qesharake që të dëgjosh katundarët e malokët që erdhën nga Toskëria në Tiranë e ranë në qytete të tjera në vitin 1945, që të ankohen me sinqeritet të pastër për katundarët e malokët që nga Gegnia ranë në Tiranë e në rrethe të tjera mbas vitit 1991. Shteti shqiptar është i të gjithë katundarëve e malokëve shqiptarë dhe askush nuk ka më shumë të drejta se të tjerët. Askush nuk ka të drejtë që ta ndjejë veten superior ndaj të tjerëve. Para shtetit e para ligjit duhet të jenë të gjithë të barabartë, si katundarët e rinj ashtu edhe të vjetrit.

Natyrisht që jetesa në qytete për disa breza i ka ndryshuar dhe i ka qytetëruar deri në një farë mase shumë prej këtyre katundarëve. Në radhë të parë, duhet theksuar ndryshimi i pësuar prej vetë parisë, si dhe prej intelektualëve dhe profesoratit universitar. Mirëpo, problemi është se edhe pse këta i kanë ikur katundit, nuk ka ikë katundi prej tyre. Gjatë kohës së sistemit të mëparshëm, mendësia katundare ka qenë e mbuluar me një zhguall të ngurtë të ideologjisë enveriste, një moral dhe sjellje që formalisht këta e praktikonin me fanatizmin e nevojshëm në sferën publike. Por, përtej lustrës së jashtme, problemi kryesor me parinë është se e ka pranuar dhe e pranon logjikën e mendësisë katundare si legjitime.

Ka pasur edhe një rrugë tjetër perverse, përmes shkollimit e stërvitjes profesionale, që e ka përforcuar këtë mendësi katundare.

Sistemi i mëparshëm ka punuar me intensitet, që t'i thyejësi individë dhe t'i vejë në përdorim të shtresës sunduese. Individualizmi dhe arrivizmi i tyre është në ekstrem. Kjo sjellje individualiste, e acaruar edhe nga jeta e gjatë dhe e vështirë në konvikte e zборе, me një riskë buke të zezë, me shtatë lekë marmalatë fiku apo molle, e me çaj pa sheqer, si dhe përvojat çnderuese e çnjerëzuese në mjerimin e sistemit të kaluar, që synonin me i kthye në vegla të pashpirt të sistemit, kanë përcaktuar e përcaktojnë sjelljen e tyre edhe në politikën e sotme.

Prandaj edhe problemi themelor i politikës së sotme shqiptare është sundimi i pakundërshtuar i mendësisë katundare. Kjo mendësi është evidente qysh nga fshatrat më të humbur të majave të thepësura të Toskërisë e të Gegnisë, deri në zemër të institucioneve shtetërore. Shteti shqiptar është i drejtuar prej katundarëve, që nuk kanë një pikë ndjenje kombëtare e njerëzore. Këta janë individë që e urrejnë popullin e vet. Mirëpo, nëse populli e pranon mendësinë katundare si legjitime dhe të natyrshme, në rastin e parisë, ajo e ka bërë zgjedhjen e tillë, që të përdorë mendësinë katundare për të ruajtur sundimin e vet. Si duhet kuptuar ky paradoks?

Paradoksi i sundimit të mendësisë katundare në politikën shqiptare

Duke e qëmtuar me vëmendje origjinën e këtij paradoksi, duhet theksuar se, historikisht, katundi ka qënë e mbetet strukturë shumë e fuqishme e sunduese në shoqëritë e në politikën shqiptare. Qytetet e vërteta si qendra politike, kulturore e rrezatimi vlerash e mendësie shtetare kanë qënë të pakta, e këtu mund të përmenden Shkodra, Peja, Gjakova, Prizreni, Shkupi, Berati, dhe Janina. Po ashtu, perandoritë, me të cilat shqiptarët kanë qënë të lidhur, i kanë pasur qendrat vendimmarrëse larg prej trojeve shqiptare. Si pasojë, qytetet shqiptare ku ka qënë përqëndruar fuqia politike e shqiptarëve kanë qënë më shumë qendra tranziti dhe udhëkryqe politike ku familjet sunduese nuk kanë zgjatur më shumë se tre-katër breza.

Shumica e këtyre familjeve me pushtet kanë qënë të lidhura më shumë me qendrën e perandorisë se sa me katundet rreth e rrotull, edhe pse këta i sundonin në emër të asaj perandorie. Bile, edhe kur ato familje, të lidhura si me qendrën e perandorisë, ashtu edhe me shoqërinë e katundarëve e malokëve të krahinës, pra edhe kur kanë pasur rrënjë e mbështetje në shoqërinë e kohës, kane ndenjtur në katunde. E në fakt, në Toskëri, katunde si Frashëri apo Libohova kanë pasur më shumë pushtet, kultivim mendësie shtetare e influencë se sa qytetet vetë. Si ilustrim, bie fjala, mund të përmendet Gjirokastra, një qytet që ka qënë i mbushur me duaxhijt e derës së Asllanpashallinjve, aq sa për 50 vjet u sundua me dorë të hekurt prej një gjeorgjiani të adaptuar në atë familje, si Javer Hurshit. Për më tepër, qytetet e tilla kanë qënë shpesh qendra të sunduara e të populluara nga të huajt. Shpesh qytetet e asaj kohe nuk kanë qënë gjë tjetër pos katunde të shtrira e më të populluara se katundet e tjera si Tirana apo Kavaja, ku një pjesë e mirë e të ardhurave të familjes vinte nga bahçja e shtëpisë.

Po ashtu, prej krijimit të shtetit të pavarur e deri tani, paritë e vjetra, veçanërisht ato familje që ishin shumë të lidhura me perandorinë osmane, sepse edhe origjinën e kishin nga kapikuletë, ishin pa rrënjë të thella në popull. Kështu, duke qënë një pakicë e papërfillshme numerikisht, paritë me influencë shtetare, edhe kur ishin nga familje qytetare apo me pasuri të madhe, qofshin nga shtresat tregtare e reshperë muslimane, bektashiane, katolike apo ortodokse, ishin e u bënë edhe më të katundarizuar se ndjekësit e tyre. Pavarësisht pasurive, e pavarësisht formimit sipërfaqësor kulturor, edhe kur e luajtën rolin kryesor në politikën shqiptare, pinjollët e këtyre familjeve e luajtën si katundarë të sofistikuar. Për më keq, me ndejë në majë të pirlgut të politikës shumë të turbullt të shekujve të fundit, ata nuk lanë gjë pa bërë. Sot, shumë prej pinjollëve të tyre duhet që të mos harrojnë se shumë prej tyre, edhe kur rrjedhin direkt nga shërbëtorët e shumëkujt, u shkartisën me katundarët fitimtarë të rradhës. Kështu, në një rrugë apo në një tjetër, atapërfunduan duke u kthye indirekt në origjinat e tyre katundare.

Duhet mbajtur në mend se cikli i zëvendësimit të parive ka

kenë i tillë, që gjatë ekzistencës së shtetit shqiptar, asnjë pari sunduese nuk ka zgjatur më shumë se dy breza. Për ta përsëritur argumentin, edhe kur kanë sunduar më shumë se dy breza, paritë sunduese kanë rënë pre e katundit dhe kanë sunduar si në katund, me një fjalë, lufta politike e parisë së radhës është zhvilluar për të kontrolluar katundarët e vet besnikë, e jo për t'i transformuar në shtetas e në qytetarë të lidhur pazgjidhshmërisht e parësisht me shtetin. Përjashtim bën, deridiku, periudha e fillimit të sistemit të partisë-shtet, por, me dështimin e vet të hershëm ekonomik e politik, edhe ai sistem përfundoi në një luftë të mundimshme nga klanet sunduese për të kontrolluar katundarët. Nga ana e tyre, paria sunduese dhe strukturat shtetërore, u sollën si katundarë të vërtetë.

Me të gjithë përjashtimet, me shumë shmangie të përkohshme nga norma, mendësia katundare ka kenë sunduese edhe në krye të partisë-shtet. Udhëheqja kryesore përbëhej, në masë të konsiderueshme, nga katundarë safi. Mjafton të shihet përbërja e Komitetit Qëndror apo e qeverisë. Edhe kur nuk ishin katundarë, influencat mbas këtyre individëve, klanet që i mbështesnin ishin thelbësisht katundare në mendësi. Kjo mendësi u përforcua edhe më shumë, qoftë përmes martesave e familjeve, përmes rrethit shoqëror, strukturave politike-shoqërore apo edhe të vetë traditës sunduese politike. Instrumenti përmes të cilit është arritur mobilizimi e sundimi i masave katundare ka qenë manipulimi i paskrupullt i mendësisë katundare, si dhe ushqimi i kësaj mendësie përmes të gjitha mjeteve e mënyrave të mundshme, derisa është bërë mendësia sunduese ndër shqiptarët. Prandaj, sëmundja e katundarizimit mbetet sëmundja kryesore e politikës së sotme shqiptare. Shkaku kryesor i lëngatës ku jemi, është paria e Tiranës dhe instrumenti i saj i preferuar është mendësia katundare e shoqërisë shqiptare. Paria lufton që të kontrollojë shoqërinë, duke e mbajtur peng të mendësisë katundare. Si pasojë e kësaj përpjekjeje intensive nga ana e parisë për të kontrolluar shtetin e shoqërinë, vetë shoqëria shqiptare ka rënë viktimë e mendësisë së vet. Edhe më keq se aq, paria e ka përvetësuar këtë mendësi dhe, përditë e më shumë, po manifeston sjellje të pastra dhe të qarta të

rrënjosura në mendësinë katundare. Aq thellë kanë shkuar efektet e kësaj politike afatgjatë të parisë sa, sot po ecet simbas parimit katundar se e keqja nuk ka fund. Dhe, në fakt, nuk po merret vesh se ku është fundi i së keqes.

Përkufizimi i katundarit dhe i mendësisë katundare

Është e rëndësishme që të theksohet dallimi midis katundarit dhe shtetasit. Paritë dhe shtresat e qytetarizuara lidhen me shtetin. Shteti bëhet shtylla kryesore e identitetit të tyre. Besnikëria e tyre i shkon së pari shtetit dhe institucioneve. Shteti ndihmon në krijimin dhe në konsolidimin e një kulture politike, në të cilën shtetasi qytetar, jo qytetasi, d.m.th. jo ai që thjesht jeton në qytet, merr pjesë aktive në jetën politike, të bashkësisë dhe kulturore të shoqërisë.

Katundari është ai person shoqëror, i cili merret me prodhimin e vogël bujqësor e blegtoral, me ndihmën e pjesëtarëve të familjes, me siguruar mbijetesën e vet e me përmbushur detyrimet që ka karshi parisë që kontrollon pushtetin politik e ekonomik. Pra, katundari është njeriu i lidhur pazgjidhshmërisht me tokën e pronën dhe me bashkësinë pjesë integrale e së cilës edhe është. Kjo lidhje përcakton edhe ndarjen e punës, format e pronësisë, rolet e funksionet e pjestarëve të familjes, nivelin e lartë të solidaritetit, strukturën e katundit, marrëdhëniet midis katundarëve, por edhe midis katundarëve e pasunarëve, si dhe të katundarëve, shtetit e parisë sunduese. Lidhja e katundarit me shtetin është komplekse. Ajo që Richard Pipes thotë për muzhikun rus, është e aplikueshme në të gjitha kontekstet e katundarëve, “dinakëria dhe përdorimi i forcës garantojnë mbijetesën: katundari përdor dinakërinë, kur është i pafuqishëm dhe dinakërinë me forcën kur është i fuqishëm”.

Mendësia katundare buron, së pari, nga kushtet specifike në të cilat katundarët janë të detyruar që të jetojnë e funksionojnë. Morali buron nga interesat. Interesat e katundarëve janë të përjetshme dhe të njëjlojta, sepse janë të lidhura me ciklin e prodhimit dhe me nevojën e pashmangshme për të garantuar

mbijetesën në një bashkësi të mbyllur dhe që funksionon e izoluar nga strukturat e jashtme prej saj. Izolimi relativ i shtyn katundarët që të mbështeten në traditën, në zakonin, në sjelljen e sprovuar, që është e moralshme në bashkësinë ku ata jetojnë dhe, mbi të gjitha, në lidhjet familjare e në njohjet personale. Autoriteti më i lartë është *pater familias*.

Shteti, ligji, paria, kultura politike, sistemet e ndryshme të shpërndarjes së pasurisë e të organizimit politik, bile edhe vetë qyteti, nëse nuk është një katund i madh (shtëpi me bahçe ku prodhohet gjithçka që ka nevojë familja) janë elemente të papranueshme për katundarin, sepse janë të papajtueshme me vlerat e me mendësinë e tij. Nderimi dhe dinjiteti kërkohen në bashkësi e jo nga shteti. Po ashtu, nuk ka rëndësi se nga vijnë të ardhurat, apo paratë, ajo që ka rëndësi është se sa ruhet fytyra në katund. Shteti është shfrytëzuesi i përjetshëm. Të gjithë katundarët, me mendësinë praktike, e shohin shtetin si armikun kryesor të interesave të tyre. Niveli i solidaritetit midis katundarëve është shumë i ndjeshëm. Kjo ndodh, jo aq për shkak të vetëdijes klasore, por se të gjithë e perceptojnë sjelljen morale dhe amorale në mënyrë thujse identike. Mendësia katundare është kaq shumë influente në kulturën tonë, që është e mbushur me shprehje të tipit “larg vatrës sime,” “qeveria e kap lepurin me qerre”, “gjithkush për veten e vet,” apo “furra e ha nga një.”

Armiku dhe miku përcaktohen në bazë të kësaj mendësie. Forca është kriteri kryesor, dhe forcat janë numrat e klanit. Statusi, nderi dhe dinjiteti fitohen e humben në katund. Thashethemet janë gazeta. Babai është filozofi. Gjykata është pleqnia, e drejta dhe kanuni. Pronësia është e shenjtë. Kultura është ajo e trashëguara, jo e shkruara apo e kultivuar. Dija fitohet rreth oxhakut. Mendësia e grupit mbërrihet përmes diskutimeve pa fund netëve të gjata të dimrit e të ditëve të shiut. Bota e katundarit është bashkësia e tij, sepse aty është mbijetesë. Taksat janë shfrytëzim, sepse katundari mendon se atë që e ka prodhuar vetë duhet ta konsumojë po vetë. Sistemi ekonomik i përkthyer në prodhim dhe kërkesë, është cikli i prodhimit vjetor dhe nevojat e bërthamës familjare.

Mirëpo në një pikë katundarët janë forca më pozitive e një

shoqërie. Kuptimi i kombit, si *farë*, është thelbësisht i ndryshëm midis katundarëve, qytetarëve dhe parisë. Duke qenë se katundarët kërkojnë dinjitet, nder e respekt, duke qenë se ata nuk mund të jetojnë jashtë një bashkësie të caktuar, duke qenë se besojnë kaq fort në lidhjen e gjakut, qoftë edhe fiktive, katundarët janë forca e vërtetë e ndryshimit dhe e ripërtëritjes së një shoqërie. Prandaj katundarët janë nacionalistët e vërtetë, sepse për ata, gjaku dhe lidhja e gjakut janë më të rëndësishmet që munden me qenë, dhe kombi transformohet në bashkësinë, në të cilën ata përfshihen natyrshëm. Nëse ka një grup intelektualësh që punon me ndershmëri për këtë arritjen e këtij objekti politik, atëherë katundarët do të jenë forca e papërbalueshme që do ta transformojë shoqërinë në rrugë pozitive. Kjo anë e mendësisë katundare ku nderi, dinjiteti, dhe respekti merren vetëm përmes bashkësisë mban shoqëri të tëra bashkë dhe parinë e tyre nën kontroll të ideologjisë sunduese. Nuk ka nevojë që të shkohet më larg se sa tek gjermanët apo edhe bullgarët.

Por që të kthehem në pikën e diskutimit të elementëve negative të mendësisë, d.m.th., në anën materiale të saj, bota e vërtetë e katundarit është katundi. Prandaj, armiku i tij nuk është shteti që është larg apo paria. Prej katundit, këto janë të paluftueshme. Armiku është katundari tjetër që nuk pajtohet me të për interesa materiale. Me qenë katundar është një mënyre jetese, është edhe një mendësi e dikujt që nuk ikën dot prej botës së vet të vogël. Katundarët janë shumë racionalë, edhe pse njerëzve iu duket se nuk janë. Ata gjithmonë mendojnë, më së pari, për pronën e për veten e tyre. E kur të vihet kjo parësi në qendër të analizës, shihet se shteti e paria, që i kërkojnë e që i marrin produktet e punës së tyre, janë armiq për vdekje. Mirëpo, për shkak se katundari është i lidhur me tokën e me bagëtinë, praktikisht ai është i ngjuar në pronën e vet, ai është peng i pronës së vet. Atij i duhet me dhënë e me marrë me shtetin e me parinë nga pozita të nënshtruara.

Prandaj, edhe kur shteti sillet në mënyrën më të ndyrë të mundshme, katundari nuk merret me shtetin, por ai merret me katundarin tjetër. Kështu, kur ndodhi tufëzimi, katundarët nuk u turrën me mbrojtë njëri-tjetrit, por, literalisht, me dëmtue njëri-

tjetrin. Kur ndodhi grabitja e madhe e tokave dhe e pronave, katundarët tanë nuk u turrën me mbrojtë shtetin e pronën e të gjithëve, por secili prej tyre e lypi atë ngastrën e vet pesë dynymshe dhe, në midis të asaj ngastre, ai ndërtoi kështjellën e familjes. Kjo ngrehinë ishte një shtëpi me shtatë flamure, me model zviceran apo gjerman, me rrugën deri tek dera si dhe me banjone e shtruar me mermer. Mirëpo, mendësia katundare shihet qartë kur vërehet se rruga publike përgjatë këtyre pallateve në midis të tokës së bukës është e mbushur me male plehrash e me gjithfarë rreziqesh për jetën për vetë katundarët. Por katundarët nuk shohin më larg se sa prona e vet. Për ta nuk ekziston hapësira publike.

Lidhja me pronën vetjake, nyja e kërthizës së mendësisë katundare, është edhe pikakycën e të cilën duhet të përqëndrohem, për të kuptuar më mirë natyrën e këtij problemi. Katundari, që mendon veç për pronën e vet, e pranon si të natyrshme sjelljen e parisë së Tiranës, që veç vjedh e grabit. Të gjithë mendojnë se kjo sjellje është në rregull. Pavarësisht se argumentet që paraqiten nga paria janë të mbështetura në justifikime e koncepte ideologjike si, bie fjala, “tregu i lirë”, “krijimi i borgjezisë”, “vendosja e kapitalizmit” etj., në thelb të gjithë palët bien dakord se parimi “bjeri i forti të ligut”, një parim aq katundar sa s’bëhet më, është sjellje normale. Forcimi e shtimi i pronës është në zemër të mendësisë katundare. Pasanikët nuk munden me qenë gabim. Ndryshe si do të viheshin paratë që kanë? Edhe kur duhet me dënue dikënd, ai dënohet kur nuk respekton normat e vendosura në katund, d.m.th., kur kapet “me presh në duar”. Po u kape, mbarove, e humbe dinjitetin për shtatë breza. Dhe dinjiteti është gjithçka, bile për katundarin është shumë më i rëndësishëm se sa vetë prona. Prona e dinjiteti janë dy gjëra për të cilat katundari nuk të fal. Para së gjithash, dinjiteti është i lidhur me poshtërimin në të shkuarën, thjesht sepse askush nuk e di se çka e pret në të ardhmen, anipse gjithkush mendon për të ardhmen.

Prandaj, partitë tona politike dhe e gjithë paria e Tiranës, munden t’i mobilizojnë lehtësisht katundarët, duke i mbajtur peng për të shkuarën e tyre. Lehtësia e mobilizimit katundar ndodh sepse të gjithë palëve, politikanët tanë, ua kujtojnë kohën

kur kanë qenë ose sundues apo shtresë e mirë e në gjendje, ose të përndjekur nga sunduesit e rradhës. Ky është kali ideologjik që duan të kalërojnë që të dy segmentet e parisë, çka vihet qartë në dukje sa herë që kanë përplasje e zgjedhje. Së bashku me lejimin e vjedhjes e të korrupsionit, gërricja e plagës së poshtërimit dhe ngacmimi në dinjitetin e njerëzve është çelësi i suksesit të parisë. Prandaj edhe mekanizmi kryesor për të përhapur opinionet që i interesojnë parisë janë thashethemet. Njerëzit besojnë atë që iu thuhet.

Mendësia katundare, është parakapitaliste dhe në strukturën e shoqërisë shqiptare ishte mbisunduese dhe e gjithkundgjindshme edhe në sistemin enverist, edhe më parë, në të gjitha sistemet e tjera. Në të gjithë kohët, paria kishte në mendësinë e saj, si objektiv parësor, ndërtimin e strukturave institucionale që janë armiqësore ndaj katundit. Mjafton të kujtohet pashaportizimi gjatë sistemit enverist, apo getoizimi urban gjatë tranzicionit. Edhe kur paria ishte e angazhuar në ndërtimin e shtetit, të socializmit apo edhe ndërtimin e kapitalizmit, ajo kurrë nuk arriti të bënte atë që duhej, sepse edhe vetë ishte e rritur me mendësinë katundare, *zgjodhi* të funksiononte në bazë të vlerave të mendësisë katundare, dhe prandaj mbeti peng i strukturave katundare.

Megjithatë, shumë vetë brenda strukturave të parisë vinin nga katunde që kishin qenë të lidhur në kërthizë me shtetin osman. Këto katunde kishin një strukturë ushtarake e kuptim të politikës në nivelin e shtetit, siç ishin, bie fjala, katundet e jeniçerëve, të transformuar në bektashinj, në Toskëri. Prapë se prapë mendësia katundare ishte sunduese, si në sjelljen personale, ashtu edhe në organizimin familjar, të klanit dhe të fshatit edhe në Toskëri edhe në Gegni.

Frika e dyfishtë e humbjes së pronës e të dinjitetit i mban katundarët të lidhur me parinë. Për sa kohë që paria i lë të vjedhin e të grabisin, sa kohë i lejon me ndërtue pa leje, mos me pague taksat, mos me krye detyrimet qytetare e shtetërore; sa kohë që i lë me i zgjidhë të gjithë hallet e problemet e tyre në mënyrë private e në nivelin e katundit, punët janë mirë. Katundarët nuk ia lënë fajin parisë. Faji i piramidave ishte faji i atyre që vunë paret “dhe

e hëngrën” se “vetë e patën fajin”. Ata që përfituan prej interesave, “ishin të zotët, bravo iu qoftë”, apo “hallall ta baftë Zoti, mor lal”. Sa për qeveritarët, “fajin e patën vetë” ata njerëzit që vuajnë nën sundimin e tyre. Katundarët gjithmonë e gjejnë një mënyrë me u armiqësue me njëri-tjetrin, por kurrë nuk armiqësohen me ata që sundojnë e që nuk lënë gjë pa bërë në kurriz të tyre. Njeriu e di se po sillet si katundar bash atëherë kur e di se paria po ta punon të zezën, e prapë nuk b’zan, por e mbështet. Gjithkush e di se po sillet si katundar kur dikush nga paria flet për integrimin evropian, për rritjen më të lartë ekonomike në botë, për popullin e lumtur, i fut njerëzit në grevë urie, shan “çeqenët” e “malokët”, kalon ligjin për homoseksualët, flet si Enver Hoxha, e bën të bardhën të zezë, dhe individit, si qytetar apo nënshtetas, nuk i bën fare përshtypje. Edhe kur e di se po mashtrohesh haptazi, e prapë se prapë shkon në miting apo futesh në grevë urie për të mbështetur interesin e pjestarit të parisë, individi shërben si shprehja më e mirë e mendësisë katundare.

Ilustrimi ma i qartë i sundimit të mendësisë katundare është dukja e gatishmërisë për dhënien e jetës për parinë. Edhe kur dihet e kur shihet qartë se kjo pari mendon veç për veten e vet, se ajo e përbuz popullin e katundarët e vet, prapë se prapë, me qindra-mijëra njerëz dalin me flamuj të kuq apo blu, në mitingun e rradhës. Përshtypja është se të gjithë janë militantë. Por, kur i analizon fotografitë e mitingjeve, të dalin rreth pesë milionë pjesëmarrës. Kjo do të thotë se, tamam simbas mendësisë katundare, shumë njerëz shkojnë në të gjitha mitingjet që bëhen, me flamurë, e me karta anëtarësimi në xhepa, duke zgjedhur të keqen më të vogël e duke mos e prishur me kënd. Gjithkush po mendon për veten e vet.

Dy shembuj që ilustrojnë paradoksin e lidhjes së parisë me popullin

Këtu ia vlen që të jepen dy shembuj nga sjellja e shoqërisë shqiptare, për të ilustruar sundimin e mendësisë katundare. Së pari, ka një arsye pse lezhjanët dalin në protestë disa herë kundër

nje sjelljeje, të papranueshme për ata, të një banori të qytetit të tyre që u vetëdeklarua homoseksual. Punët kanë shkuar keq, deri në atë pikë sa qytetarët e kërcënojnë me jetë familjen e këtij individi. Bindja, se dalja e një banori të Lezhës me orientime të ndryshme seksuale, është fyerje për të gjithë Lezhën, është pak problematike. Zgjedhja personale e atij njeriu nuk ka pse t'i fyejë lezhjanët. Gjithkush i bën zgjedhjet e veta.

Paradoksi fillon kur, në të njëjtën kohë, po këta lezhjanë mbështesin fuqimisht kryetarin e një partie si Sali Berisha, që kërkon në parlament legalizimin e martesave të individëve të tillë. Ajo që është edhe më e çuditshme, asnjë nga këta protestues lezhjanë nuk e mori mundimin që të bënte një protestë në Lezhë, apo në Tiranë, për të mbrojtur nderin e shtetit e të kombit shqiptar nga ligji për lirinë e homoseksualëve që premtoi Sali Berisha.

Një shembull tjetër është dalja e qindra mijëra njerëzve në bulevard në mbështetje të politikës së kryetarit të një partie, qoftë ky Edi Rama apo Sali Berisha. Dalja e këtyre njerëzve në miting, në emër të një numri kërkesash, që në thelb janë tërësisht irracionale nga këndvështrimi i qytetarit e i katundarit normal, por që janë krejtësisht të kuptueshme kur mbahet parasysh interesi i ngushtë i kryekatundarit të rradhës, është paradoksale.

Pse është paradoksale? Para zgjedhjeve, këta dy udhëheqës të parisë së Tiranës dhe të deleguarit e tyre, Kastriot Islami e Ilir Rusmajli, ranë dakord që të ndërtonin një sistem zgjedhor, që do të eliminonte partitë e vogla politike. Këta kishin rënë dakord të bënin një qeveri teknike me mirëkuptim dhe, kështu, duke e konsoliduar një herë e mirë sistemin oligarkik, ata do të përqëndronin pushtetin në duart e tyre. Mirëpo, disa i kishin bërë llogaritë gabim. Sapo iu dha mundësia, Sali Berisha i iku pazarit dhe u soll sipas vlerave e mendësisë që e karakterizojnë atë vetë por edhe të gjithë parinë. Ai e prishi marrëveshjen, e la Edi Ramën në baltë, dhe në opozitë.

Tash, vala e protestave do të vazhdojë me intensitet nga të dy palët. Sharjet e ofendimet, që kanë botuar e që botojnë në mediat nën kontrollin e tyre respektiv, nuk kanë njohur e nuk do të njohin kufinj. Në këtë përplasjen e rradhës, interesat e tyre janë jetike.

Njëri do të rrijë në pushtet e tjetri do të marrë pushtetin. Të dy nuk rrinë dot në një karrike. Atëherë, ai që nuk e zë karriken, duhet t'ia bëjë jetën tjetrit sa më të vështirë që të jetë e mundur. Sjellje tipike e mendësisë katundare. Prandaj edhe politikanët i drejtohen rrugës. Aftësia e tyre, për të mbledhur në bulevard me qindra mijëra njerëz, i mahnit vëzhguesit e huaj. Këta nuk dinë se si ta shpjegojnë këtë paradoks shqiptar të mobilizimit të pandërprerë dhe masiv. A dalin në punë këta qindra mijra njerëz? Por, natyrisht, kjo lloj sjelljeje bëhet lehtësisht e kuptueshme, kur mbahet parasysh mendësia katundare e tyre. Katundarët po luftojnë për interesat e parisë por gjithnjë kanë në mend interesat e tyre.

Megjithatë, kur e krahason me problematikën shqiptare, nuk ka se si të mos të bëjë përshtypje një sjellje e tillë. Të bën përshtypje mungesa e përplotë e kurajos qytetare për të protestuar për mungesën e kushteve elementare të jetesës shoqërore. Të bën përshtypje, kur ndeshesh me rastet e abuzimit flagrant të katundarizmit me shtetin dhe me institucionet në të gjithë nivelet. Të bën përshtypje, mungesa e kurajos qytetare për të kundërshtuar korrupsionin, banditizmin, mashtrimin, zvetënimin e parisë e me rradhë. Prapë, çelësi i shpjegimit është mendësia katundare. Shteti dhe kombi janë në një gjendje të mjerueshme. Mirëpo, në të njëjtën kohë, askush nuk e çan kokën se në shtetin shqiptar vidhet me të dy duart, se bëhen ndërtime pa leje, se uji i pijshëm vjen me tepricat e gjirizit e të tjera dukuri, që të bëjnë shumë përshtypje. Të gjithë mendojnë vetëm për veten e tyre. Katundarizmi është një mendësi sunduese dhe shumë e përhapur në shtetin shqiptar.

Pse paria e Tiranës është fajtoare për gjendjen?

Për shkak të trysnisë së politikës, të acaruar deri në ekstrem, për shkak të luftës midis klaneve dhe palëve të parisë, si dhe të nevojave të organizimit brenda klaneve, vetë paria enveriste u dorëzua dhe gradualisht adaptoi mendësinë klanore katundare. Kjo u vërejt menjëherë gjatë e mbas vendosjes së sistemit parti-

shtet në vitin 1944 dhe shpërtheu me përplasjen e klaneve Hoxha dhe Shehu në vitet 1970. Pra, përplasja klanore u acarua në pika kritike, por mendësia katundare ishte e pranishme dhe sistematikisht e evidentueshme në sjelljen e parisë sunduese gjatë gjithë kohës së sundimit të sistemit enverist. Gjatë gjithë kësaj kohe, aleancat, që mund të kishin nisur nga mendësi e përvoja komunitare, përfunduan duke u bërë klanore. Të gjithë lidhjet e palëve të parisë u çimentuan dhe u kultivuan në bazë të kësaj mendësie. Edhe goditjet u dhanë në bazë të kësaj mendësie, duke e sulmuar klanin respektiv me rrënjë e me degë.

Edhe klanet e ndryshme, që dolën si humbës nga përplasjet, e ruajtën dhe e kultivuan edhe më shumë mendësinë e klanit. Klanet që fituan i shtërnguan rradhët edhe më shumë rradhët. Shteti shqiptar ishte i modeluar sipas modelit sovjetik, por mendësia e shtetarëve ishte tipike e katundarëve jeniçerë osmanë, një dallim që nuk duhet të nënvlerësohet. Mirëpo, si paria, ashtu edhe inteligjencia ishin të detyruar që të silleshin simbas një sistemi vlerash morale “zyrtare”, që ishte krejtësisht i papajtueshëm me mendësinë katundare. Të gjithë ishin të shkolluar dhe kishin aq mend sa të bënin zgjidhjen që duhej. Por zgjidhja që ata bënë ishte që të punonin për veten e tyre dhe kundër popullit të vet në një dyzim të çuditshëm të mendësisë.

Kur erdhi koha e ndryshimit të sistemit, gjendja nuk ishte e lehtë por ata duhej të udhëhiqnin, sepse vetë e morën përsipër atë detyrë. Fundi i atij sistemi hibrid enveristo-katundar, na gjeti pa një shoqëri me mendësi të kultivuar qytetare dhe me vlera demokratike, por me katundarë që jetonin me bukë misri me ujë e sheqer, si dhe me masat e gjera të shtresave urbane të proletarizuara, apo me katundarë të transplantuar në qytete. Të gjithë mendonin si katundarë, ose silleshin hapur si katundarë. Megjithatë, në kapërcyell të ndrrimit të sistemeve, paria dhe “intelektualët e shquar” e kishin një kapital të madh politik, që mund ta përdornin për të futur proceset në rrugën e duhur. Zgjidhja që ata duhej të bënin duhej të ishte që të përdornin ndjenjat kombëtare, dëshirën për të jetuar me nder e me dinjitet të katundarit shqiptar, për të ndërtuar një shtet-komb modern.

Në shtetin shqiptar nuk pati revolucion të mirëfilltë. Paria kërkontendryshimin, por intelektualët i shprehën të paralizuar dhe në shërbim të parisë. Forca më progresive e shoqërisë ishin studentët. Mirëpo, kur vjen puna tek revolucionet, nuk ka rëndësi se kush është faktori qendror në ngjarjen kryesore. Faktori më me rëndësi është se sa janë të aftë intelektualët që të mobilizojnë shtresat e ndryshme dhe, në veçanti, katundarët. Faktori kryesor në çdo revolucion është katundaria dhe fshatarësia. Aleanca arriviste midis parisë, shtresave urbane të proletarizuara, por me mendësi të theksuar katundare, intelektualëve dhe katundarëve tanë në vitin 1991 ishte aleanca më e rrezikshme dhe vdekjeprurëse që mund të bëhej për demokracinë. Emëruesi i përbashkët nuk ishte ndërtimi dhe ruajtja e shtetit. Emëruesi i përbashkët ishte interesi personal dhe i ngushtë, tipik për mendësinë katundare. Shumica kishin një dyshim të thellë ndaj shtetit. Shumica kishin një ide të shtrembër për kapitalizmin e për të ardhmen. Shumica e shihnin sistemin demokratik si një një sistem që duhej manipuluar. Ishte shumë e vështirë, për të mos thënë e pamundur, që këta të dilnin nga mendësia katundare, që e shihte gjithçka të lidhur me klanin, me familjen, dhe interesat e ngushta të tyre. Por po të ruhej shteti, edhe katundarët do të përmbaheshin dhe nuk do të kishin shkuar gjërat në atë pikë në të cilën edhe shkuan.

Tranzicioni filloi me shembjen e shtetit. Kolapsi ekonomik i qëllimtë dhe i inkurajuar prej vetë parisë, i acaroi këto marrëdhënie dhe nxori në plan të parë rëndësinë e klanit dhe të lidhjeve politike për parinë. Në të njëjtën kohë, tranzicioni krijoi mundësi të jashtëzakonshme për katundarët. Duke mos e pranuar sistemin e vendosur si legjitim, katundarët tanë përdorën të gjithë hapësirat e mundshme për të ndjekur objektivat e tyre të mbijetesës. Shembja e shtetit dhe heqja dorë nga ana e parisë e të qeverisurit të vendit, çuan në grabitje në masë të pronës dhe të pasurisë private dhe të përbashkët.

Ky nuk ishte atomizim, thërmim i shoqërisë. Katundarët nuk grabitën tokat e njeri-tjetrit në katundin e vet. Atje tokat u ndanë sipas normave katundare dhe gjithkush mori tokën e vet. Ajo që ndodhi ishte një zhvendosje masive, në bazë katundi dhe klani në

zonat e në hapësirat e mundshme. Në këtë mënyrë, katundi nuk ishte më një strukturë e izoluar që kontrollohej nga shteti. Nën zhguallin e një urbanizimi fiktiv, katundi u bë njësisia bazë e shtetit. Shteti u bë një katund gjigand. Katundi më i madh në botë, me disa shtresa e mbishtresa katundarësh është Tirana.

Parësia e politikës mbi ekonominë përcaktoi edhe natyrën e konfliktit midis palëve të parisë. Zgjidhja që ata bënë për të ndërtuar një sistem, ku katundarizimi është gjithkund endemik, anipse i përmbajtur deri në një nivel ose në një tjetër, e detyroi parinë sunduese që të hiqte dorë nga projekti i vet i transformimit të shoqërisë në një shoqëri kapitaliste me proletarë e borgjezi të pastër. Politika doli sërish në plan të parë.

Për të ruajtur interesat e veta dhe vendin e vet, si forcë përcaktuese e rrjedhave dhe e proceseve, paria iu përshtat mendësisë së shtresave të gjera shoqërore që, deri atëherë, ishin të mbajtura në shtërngesë nga shteti. Këto shtresa, që deri në atë pikë silleshin në forma të jashtëligjshme, por të toleruara nga sistemi dhe nga vetë paria, shpërthyen me fuqi në skenën politike. Në vend që të gjenin vullnetin politik e t'i kontrollonin këto shtresa, të gjithë palët e parisë, zgjodhën rrugën më të lehtë. Paria sunduese, si shtresë, filloi të adaptonte mendësinë kriminale dhe, pa mëdyshje, u kriminalizua. Në vend që të silleshin si burra shteti, prijatarët e parisë filluan të silleshin si rrugaçë. Lufta midis klaneve u ashpërsua deri në atë pikë sa fuqia e klaneve matej me fuqinë e mitingjeve dhe të rrugës. Kapja e shtetit u bë objektivi kryesor politik. Synimi ishte që shteti duhej të vihej në shërbim të një klani të caktuar. Niveli i materializimit, mungesa e vlerave njerëzore e ideologjike, zhveshja nga ndjenja e shërbimit publik, turrja mbas interesit të ngushtë, kriminalizimi i shoqërisë e të gjitha patologjitë e tjera janë në nivele ekstreme.

Tashmë, katundarët kanë dalë në krye të shtetit dhe shteti është kthyer në një katund gjigand. Si rezultat i sundimit të kësaj mendësie, shoqëria shqiptare është thellësisht e kriminalizuar, pa besim në parinë apo në institucionet shtetërore, dhe pa shpresë përmirësimi nga brenda shtetit. Tash kemi një sistem oligarkik, të maskuar me një veshje demokratike, ku si populli ashtu edhe

paria sundohen nga mendësia katundare, ku mendohet për mbijetesën e ditës, për përfitimin individual, për interesat e klanit të ngushtë, dhe ku shteti është kapur e kapet nga klane të caktuara që e shfrytëzojnë për nevojat e tyre të ditës.

Mendësia katundare është sunduese në të gjithë shtresat. Për parinë, problemi themelor i kësaj mendësie është se katundarët nuk kërkojnë vendosjen e kapitalizmit. Katundarët janë forca kryesore kundër vendosjes së sistemit kapitalist. Katundarët nuk kërkojnë vendosjen e demokracisë; ata kërkojnë mbrojtjen e interesave të tyre përmes kultivimit të strukturave familjare, por edhe të marrëdhënieve shoqërore-ekonomike tipike për katundet, si pazaret, shitblerja, tregtimi i favoreve, kultivimi i traditës. E vetmja mënyrë që i bën katundarët ta pranojnë shtetin dhe demokracinë është përmes figurave influente, që duhet të jenë të pranuar nga bashkësia si pjesë e saj, d.m.th. kleriku, mjeku popullor, plaku i urtë, mësuesi e me rradhë. Tashmë të gjithë këta janë të sofistikuar, me shkollë të lartë dhe me një pozitë me peshë në sistem. Këta mbedhin votat dhe kontrollojnë makinën oligarkike në sistemin lokal. Shumë prej tyre nuk janë më thjesht hallka të sistemit, ata janë në kontroll të sistemit.

Përvojat e frikshme të shqiptarëve në mërgim, zakonisht të shtypur për vite në fundet e shoqërive moderne, si në Gjermani e Itali, e të një shoqërie ende të pashkëputur nga mendësia e vet katundare, si në Greqi, e lehtësuan shumë këtë proces të dyanshëm të forcimit të mendësisë katundare në nivel të shoqërisë dhe të parisë. Përvojat e hidhura të shqiptarëve në mërgim kanë lënë një gjurmë të pashlyeshme dhe kanë qënë një katalist shumë i fuqishëm për kthimin e mendësisë katundare dhe të klanit si strukturë bazë e shoqërisë. Trajtimi shumë negativ që patën në vendet e huaja e forcoi edhe më shumë mosbesimin e tyre ndaj shtetit dhe ndaj strukturave politike, si dhe ndaj demokracisë. Mbështetja në strukturat e familjes dhe të klanit u bënë nevojë jetike. Mbijetesa u garantua edhe përmes krimit dhe familja ishte bërthama e veprimtarisë. Prandaj, edhe kriminalizimi i parisë u mundësua nga mërgimtarët, si dhe nga përvojat e tyre të hidhura.

Lufta e analistëve dhe e komentatorëve, që shkruajnë pa lidhje

e pa një kuptim të qartë të gjendjes, ka qenë, të shpallte popullin shqiptar fajtor, ose me ia lanë fajin sistemit të kaluar, Turqisë, imperializmit, kapitalizmit, grekëve, serbëve, etj. E megjithatë, faktore kryesore mbetet paria. Paria është ajo shtresë që duhet të kishte e që duhet të ketë vizionin e duhur për ndërtimin e marrëdhënies shoqërore. Paria është ajo shtresë që ofron zgjidhjen e problemeve, sepse paria e ka dijen e përgatitjen e nevojshme të zgjidhë problemet. Një pari bëhet elitë sepse identifikohet, para së gjithash, me shtetin dhe, me punën e me përkushtimin e vet, e vë një popull në rrugë të mbarë. Arsyeja pse paria është në gjendje që të bëjë atë që nuk ka ndodhur në asnjë vend tjetër të botës, përveç Afganistanit, Somalisë, Haitit e Kongos, është manipulimi i mendësisë katundare dhe mbajtja e popullit në një gjendje jermi ideologjik. E njëjta gjë nuk mund të ndodhë kurrë në Gjermani apo në Suedi.

Pra, për shkak të sundimit të përplotë të parisë që shfrytëzon mendësinë katundare, e të vlerave që burojnë prej saj, jemi në krizë. Njëri ndër elementët më të spikatur të krizës politike shqiptare ka qenë mungesa e nje ideologjie të mirëfilltë, të paraqitur sistematikisht e në mënyrë kohezive. Një ideologji e tillë do të lejonte një masë militantësh të një partie politike që të gjykonin proceset dhe ngjarjet e shkuara politike ashtu si duhet. Një ideologji e tillë do të lejonte njerëzit që të gjykonin sjelljen e politikanëve e të ofronin gjykime koherente e konsistente, në vlerat e asaj ideologjie për gjendjen në të tashmen. Mbi të gjitha, një ideologji e tillë do të ofronte një vizion të qartë se ku do të mbrihet në të ardhmen.

Prandaj, në shtetin shqiptar, nuk gjen mbështetje të gjerë një ideologji e mirëfilltë socialiste, liberale apo nacionaliste, që do të ofronte një projekt për përmirësimin e gjendjes, edhe pse kjo është zgjidhja e vetme e daljes nga kjo gjendje e thellë krize ku janë shqiptarët. Në vend të një ideologjie të tillë, si bie fjala, socializmi, liberalizmi, apo nacionalizmi, paria e të gjitha ngjyrave dhe e të gjitha partive, ofron një përzierje paradoksale (e që politikisht nuk ka fare kuptim) parullash e slloganesh. Shpeshherë, këto sllogane janë krejtësisht kontradiktore. Ato përjashtojnë

njëra-tjetrën. Mbi të gjitha, që të gjitha janë të pambrritshme e të parealizueshme në nivele praktike. Si pasojë e kësaj mungese sistemesh të qarta vlerash e ideologjie kohezive, sjellja e parisë duket krejt e çoroditur dhe pa kurrfarë racionaliteti. Mirëpo, paria nuk merret aq shumë me të huajt aq sa merret me katundarët militantë të partisë respektive.

Prandaj, politika në shtetin shqiptar është një politikë e paradokseve, sepse struktura e mobilizimit të masave të gjera të popullit nga paria e Tiranës është ekskluzivisht e mbështetur në strukturën e katundit. Kauzat që ndiqen janë nga më të paimagjinueshmet, ose thjesht probleme që ngrihen, sepse zgjidhja e tyre është në shërbim total të liderëve partiakë. Parullat që hidhen janë krejt pa kuptim e pa kurrfarë baze në realitet. Nga ana tjetër, rrrërrërrërrët e shtypit të Tiranës janë hamullitje të pakuptimta. Pastruesit e plehrave në Perëndim shiten si komentatorë të ditur. Komentatorët e njohur të Tiranës, që s'ia kanë idenë sistemeve të tjera, duan të flasin anglisht e të duken kompetentë, kur shkrimet e tyre janë krejt pa bosht e qesharake. Përpijekja për të shpjeguar këtë mori fenomenesh që e bëjnë politikën e Tiranës unike në natyrën e mendësisë së saj katundareske, nuk do të ishte e plotë pa lidhjen e qartë të parisë së Tiranës me popullin. Nyja që i bashkon është mendësia katundare.

Përfundim

Në përfundim duhet theksuar se ajo që e bën këtë gjendje të mundshme është kultivimi i pandërprerë i mendësisë katundare nga ana e parisë së Tiranës dhe përdorimi i paskrupullt i kësaj mendësie për qëllime politike. Procesin e kultivimit të mendësisë katundare e ka lehtësuar konvergimi i tre faktorëve të shtjelluar në këtë shkrim. Së pari, përbërja katundare e parisë së Tiranës. Së dyti, është niveli i lartë i katundarizimit të shoqërisë shqiptare. Së treti, kthimi në mendësinë e origjinave katundare i shtresave të banuesve në qytete, që tashmë në masë të madhe janë nga shtresat urbane të proletarizuara gjatë sistemit të mëparshëm. Si pasojë, në një farë mënyre, e gjithë shoqëria shqiptare ka rënë

pre e mendësisë katundare. Dallimi është se paria vepron në këtë drejtim në mënyrë të vetëdijshme. Arsyeja është se kjo mendësi i shërben asaj për arritjen e objektivave të shumëfishta dhe afatgjata, që paria i ka caktuar vetes. Për një masë të madhe të fshatarëve e të katundarëve bashkëkohorë, kjo lloj sjelljeje është normale. Për ata, kjo sjellje është e vetmja që i lejon të funksionojnë dhe që e bën realitetin të lexueshëm e të kuptueshëm. Nga ana e tyre, edhe qytetarët e disa brezave janë dorëzuar dhe duket se tashmë mendojnë vetëm e vetëm se si të mbijetojnë në këtë botë dhe kanë adaptuar sjelljen dhe mendësinë katundare. Në këtë mënyrë, katundarizimi i politikës është bërë i përplotë. Gjithkujt që e sheh nga jashtë sjelljen e çmeritur të politikës e të parisë, gjendja në shtetin shqiptar i duket pa pikë kuptimi.

Prandaj, pa e kuptuar qartë, e pa e konfrontuar mirë, e si duhet këtë sëmundje të politikës bashkëkohore shqiptare, nuk mund të ketë as diagnostifikim, por as edhe zgjidhje ashtu si duhet të problemeve. Natyrisht, kjo është edhe arsyeja pse teoria e Ibn Khaldunit nuk është e aplikueshme dhe as e verifikueshme në rastin shqiptar.

SHTETI I GANGSTERËVE, DËSHTIMI I TRANZICIONIT, DHE NEVOJA E NJË FILLIMI TË RI

Përplasja, që ndodhi më 21 Janar 2011, është thjesht një hap tjetër në rrugën logjike të politikës së bandave politike e të rrugës së dhunës, që ndiqet sistematikisht nga paria. Përtej diskutimeve të analistëve “zhurmues” lidhur me qëllimet imediate të dy palëve të parisë, përtej reagimit të forcave qeveritare e mbështetësve privatë të kryeministrit, përtej sjelljes skandaloze të zyrtarëve shtetërorë të të gjithë niveleve, përplasja ishte një fenomen shumë shqetësues, por edhe një tregues i qartë i sëmundjes së shoqërisë shqiptare. Kur nuk shihet si një fenomen i veçuar, por konsiderohet si simptomë e një sëmundje, nga e cila lëngon e gjithë shoqëria, përfundimet që mund të nxirren nga ngjarjet e këtyre ditëve janë lehtësisht të përmbledhura në disa fjali.

Së pari, tranzicioni shqiptar ka dështuar për t’u dhënë sigurinë që meritojnë të gjithëve. Gjendja do të vijë duke u përkeqësuar në mënyrë progresive. Prandaj, jemi të futur në një rrugë pa krye. Së dyti, shkaktare e pakontestueshme për dështimin është paria, e cila mban parasysh vetëm interesat e veta dhe e shtyn popullin që të përplasët në rrugë. Së treti, ka ardhur koha për një fillim të ri. Çdo ditë që kalon ai bëhet më i domosdoshëm. Së katërti, ky fillim i ri duhet të realizohet nga një forcë e re, me një sistem të qartë vlerash, që është në dobi të të gjithë shqiptarëve. Kjo përpjekje për një fillim të ri duhet bërë e menduar mirë, me metoda të sprovuara e me forma demokratike.

Pra, ka ardhur e ka kaluar koha që shqiptarët të mbyllin këtë kapitull me pasoja tragjike e që nuk do të shuhën lehtë në historinë e shqiptarëve. Arsyeja është e qartë. Po vazhduam në këtë rrugë,

e ardhmja do të duket e do të jetë edhe shumë më e keqe e me pasoja shumë më të rënda se sa ka qenë e shkuara. Këta që na sundojnë nuk kanë se çfarë të na ofrojnë më përveç kriminalizimit të mëtejshëm, të vjedhjes së pasurisë kombëtare, të trafikimit, të degjenerimit moral, të zvetënimit të brezit të ri, të moralit të drogës, të kontrabandës, e të çnjerëzimit, të humbjes së dinjitetit e të nderit. Këta duhet të ikin.

Një grusht familjesh të parisë, jeniçerët e Enver Hoxhës, bllokmenët e shërbyesit e tyre, po na mbajnë peng të gjithëve. Ka ardhur koha, që të gjithë, si individë e si popull, të bëjmë zgjidhjen që duhet. As nuk duhet të biem më në lojën e tyre, as të mos përdoremi më prej tyre. Mënjanimi nga politika i këtyre pak përfaqësuesve të interesave të krimit, mënjanimi nga politika i një grushti gjarpërinjsh politikë, është domosdoshmëri historike. Sa më shpejt që të ndodhë ky mënjanim, aq më mirë do të jetë për shqiptarët. Tashmë, nuk është më çështje nevojë historike, por është vetëm çështje metodash. Pika kryesore në rend të ditës nuk është se cila palë e parisë ka të drejtë, por se si duhen hequr qafe jeniçerët e bashibozukët kriminalë të duopolisë oligarkike të Tiranës, si duhet vepruar për t'i hequr qafe me sa më pak dëm për shoqërinë shqiptare e për të ardhmen e saj.

Dilema e parisë së Tiranës

Si fillim, duhet të kuptojmë mirë dilemën e tanishme të parisë sunduese. Paria ka hyrë në rrugën pa krye me kohë dhe është e vetëdijshme se kjo është një rrugë pa krye. Mirëpo nuk e di se nga mund t'i vijë goditja. Tragjeditë e vitit 1997 janë një dëshmi e qartë në mendjen e gjithkujt, se çfarë ndodh kur njerëzit rebelohen. Në këtë rrugë ku jemi, përplasja që po vjen nuk është më lehtësisht e shmangshme nga paria. Për më tepër, ajo do të ketë pasoja të rënda, ndoshta jo si të vitit 1997, por gjithsesi do të jenë pasoja të rënda.

Pse e them këtë? Në përplasjen e paevitueshme që do të ndodhë, zgjedhjet e zgjidhjet e palëve të parisë janë të pakta. Të gjitha zgjedhjet iu bien ndesh të paktën interesave të njëres

palë ose janë të papranueshme për palën tjetër. Secila palë e sheh veten si humbëse, nëse arrihet një kompromis që i jep diçka palës tjetër. Niveli i sjelljes së tyre dëshmon se sado që të mundohen që të merren vesh, asnjëherë nuk do t'i besojnë njeri-tjetrit deri në fund.

Në se Edi Rama nuk bashkëpunon me të e nuk arrin një kompromis që i jep kohë, Sali Berisha s'ka rrugë tjetër, përveç që ta mbajë pushtetin me dhunë. E në se vendos që të mbajë pushtetin me dhunë (tashmë ai s'ka më rrugë tjetër) përplasja me palën tjetër të parisë është e pashmangshme, dhe mandej është çështje javësh para se ai të ikë nga pushteti. Megjithëse, Berisha do t'i drejtohet rrugës e antimitingjeve, ai nuk ka më një parti solide që ta mbështesë në opozitë, por thjesht klane e banda, që tashmë nuk ia kanë aq shumë nevojën. Ai që i bleu të gjithë, ka për të parë se si do ta shesin të gjithë. Kështu që atij i duhet pushteti me çdo kusht për t'i mbajtur këta bashkë. Sali Berisha do të luftojë që të bëjë kompromis, cilido që të jetë çmimi.

Nga ana tjetër, Edi Rama, edhe për shkak të konjunkturave brenda PS-së, është i detyruar që të vazhdojë me konsekuencë në rrugën që ka nisur sepse, përndryshe, rrezikon shumë në të ardhmen e tij politike si person. Nëse ai tërhiqet e pranon një kompromis çfarëdo që e lë Sali Berishën në pushtet, atëherë ai do t'i japë vetes ndoshta disa vjet jetë politike, por do të tregojë edhe se është në lojën politike për interesat e veta të ngushta e të klaneve mbrapa tij. E ardhmja e tij do të jetë tërësisht e kompromentuar në sytë e militantëve e të mbështetësve të PS-së e të klaneve të regjura të saj, që shohin një mundësi për të marrë pushtetin e që, gjithashtu, shkojnë mbas interesave të veta të ngushta. Edhe atij i duhet t'i shkojë deri në fund kësaj rrugë të ndeshjes sepse çfarëdo kompromisi përbën rrezik jetik për të.

Pra, zgjidhja logjike për të dy palët është kompromisi, por kompromisi është i mundshëm vetëm nëse të palët pajtohen dhe çmimin e poshtërsisë së tyre do ta paguajnë shqiptarët. Për ta paguar këtë çmim, shqiptarët duhet të pajtohen që të viktimizohen edhe një herë tjetër. Sunduesve të parisë iu intereson që ata të jenë në qendër të vëmendjes. Ata synojnë që t'i ndajnë njerëzit në

pasues të njërit e të tjetrit. Megjithatë, kur vjen puna të dallaveret e tyre, ata e gjejnë gjuhën. Ata grinden për të thithur gjakun e shtetit e të shqiptarëve, por grindja e tyre është vetëm e vetëm për thelën e pushtetit të secilit.

Mafia politike njih vetëm rregullin e forcës. Ajo nuk do të ndalet para përdorimit të saj as në ditët që vijnë. Prandaj, përplasjet midis forcave politike dhe bandave kriminale që iu shkojnë mbrapa, në Tiranë e më gjerë, do të vazhdojnë të bëhen edhe më intensive në ditët që vijnë. Asnjëra palë nuk mund të ndalet thjesht sepse nëse tregojnë qoftë edhe një shenjë dobësie, edhe ata që sot iu shkojnë mbrapa për bukën e gojës janë të gatshëm që t'i lënë në baltë.

Kështu, nga ana e vet, qeveria i mban mbështetësit e vet bashkë duke vrarë demonstrues e duke u betuar se nuk do të ndalet në rrugën e krimit. Opozita e ka nxjerrë masën e njerëzve të pakënaqur në rrugë për të arritur qëllimet arriviste të mbrritjes në pushtet. Asnjëra palë nuk punon për shqiptarët. Ata do t'u hedhin një kockë mbështetësve të tyre, por vetëm një kockë. Në mendësinë e tyre, as qentë nuk duhen ushqyer mirë, sepse iu duhen sa më të uritur për përplasjen e nesërme e jo më mbështetësit e militantët që nuk e dinë pse po përdorohen në këtë mënyrë.

Cilado rrugë që do të ndiqet në javët e ardhshme, do t'u tregojë të gjithë atyre që duan të shohin e të kuptojnë se çfarë po ndodh njëherë nga dy mundësitë. Nga një anë, do të shihet se këta janë duke punuar "në një tavë" të gjithë bashkë. Nga ana tjetër, do të shihet qartë nga të gjithë shqiptarët se asnjëri nuk punon për ta. Kahdo që të shkojnë në përplasjen e tyre, paria e Tiranës dhe segmentet e saj kësaj here do ta tregojë fytyrën e vet të vërtetë në përplasjen apo në kompromisin që do të bëhet. E njerëzit me mend e që duan të jetojnë me nder e dinjitet, duhet të bëjnë zgjidhjen e drejtë, d.m.th. që të mos bëhen pjesë e krimit, pjesë e lojës së parisë, dhe të përdoren si mish për top për klanet mafioze të parisë së Tiranës.

Objektivat dhe niveli i realizimit të planeve të parisë

Plani i shtresës sunduese të dalë nga PPSH, e të organizuar në partitë e ndryshme ka qenë dhe mbetet krijimi i një shteti oligarkik. Ky shtet do të kishte struktura, do të ishte i maskuar si demokraci, por do të ishte i sunduar prej tyre. Shteti do të ishte në shërbim të tyre dhe aq i fuqishëm, sa që të mund të përdoret kundër të gjithë shqiptarëve të tjerë që, sipas mendësisë së tyre, duhet të kthehen në proletarët e skllëvërit e përvetshëm të tyre.

Sundimtarët e klaneve të parisë nuk janë ndalur para asgjëje në realizimin e këtij plani të përbindshëm. Ata e kanë ndjekur me konsekuencë, pa pyetur për dhimbjen që u kanë shkaktuar njerëzve, pa dhënë llogari për vrasjet e krimet makabre, e pa u kujdesur për çmimin që është paguar. Ata kanë bërë atë që iu ka interesuar atyre. Prandaj sjellja e tyre gjatë këtyre 20 viteve është e pamohueshme, kriminale, jonjerëzore, e përbindshme.

Gjaku e djera e miliona shqiptarëve në emigrim e në shtetin shqiptar ka shkuar për të mbushur xhepat e sunduesve të rradhës. Vendi nuk ka ekonomi të institucionalizuar apo me aftësi konkurruese, të huajt nxjerrin miliarda dollarë fitime që shkojnë jashtë vendit, administrata shtetërore është fund e krye e korruptuar, udhëheqësitë politike janë eksponentë të klaneve mafioze e në shërbim të interesave joshqiptare, partitë politike janë lukuni lamashësh e hajdash, sistemet e edukimit, të shëndetësisë, të mbrojtjes shoqërore e me rradhë janë për faqe të zezë. Jeta e nderi i njerëzve janë më të pasigurta sot se kurrë. Materializmi i skajshëm i njerëzve nuk njih skrupuj. Shoqëria po kalon trauma të jashtëzakonshme morale, psikike e në vlera.

Tranzicioni ka dështuar që të ofrojë jetën që shpresonin të kishin shqiptarët. Planet dhe sjellja e parisë e kanë lënë shtetin shqiptar në një qorrsokak pa shumë zgjidhje. Kështu, si janë gjërat, nuk mund të vazhdohet. Shteti nuk ka as një minimum sovraniteti. Objektivi i përbashkët i ndërtimit të vendit, si një shtet evropian e me standarde evropiane, ka dështuar. Në vend që të ndërtohej një shtet i lulëzuar, me ekonomi të përparuar, me siguri për të ardhmen e të gjithë shqiptarëve, në vend që të përdoroheshin me mençuri

burimet e paçmueshme njerëzore e materiale, gjithçka është shpërdoruar. Shteti është në një krizë të thellë të gjithanshme, politike, ekonomike e shoqërore. Shoqëria është tejet e polarizuar, me një shtresë sundimtarësh e zhganet e pasuesve të tyre, që bëjnë një jetë përrallore prej sulltanësh e jeniçerësh, por edhe me masat e mëdha të njerëzve që fiken përditë nën një peshë injorance të kalkuluar, që shtohet përditë. Lufta e sundimtarëve të parisë ka synuar t'ia heqë dëshirën me qenë njerëz me nder shqiptarëve. Paria ka synuar me i kthye në qenie që jetojnë për një kafshatë bukë. Nesër do t'ua heqin edhe atë kafshatë bukë. Kur të mos kenë më me vjedhë vetë, as nga krimi as nga shteti, sundimtarët do t'ua heqin kafshatën nga goja fëmijëve e të gjithë shqiptarëve.

Përtej disa rrugëve të shtruara e ndërtesave të lyera me bojë, si dhe të vilave e pallateve të parisë, shoqëria shqiptare ka një fytyrë të frikshme. Në vend të njerëzve që punojnë, sheh kumarxhinj që e kalojnë kohën në bingo e në loto. Në vend të punës me nder, sheh njerëz që shesin drogë e që trafikojnë gjithçka, vetëm për hir të fitimit material. Në vend të njerëzve me familje, nder e dinjitet, sheh pushta e fundërrina, kodoshë e trafikantë të gjithçkaje. Në vend të shërbyesve publikë, sheh hajna që rregullojnë veten në "shtatë breza" me një allishverish e dallavere me paratë e popullit. Në vend të njerëzve që kërkojnë respekt prej popullit të vet, sheh mafiozë që vrasin dëshmitarët e krimeve të tyre.

Jeta në shtetin shqiptar nuk vlen kurrëgjë. Shteti është në shërbim të klaneve mafioze e punon kundër popullit të vet. Çdo ditë që kalon e shton zullumin e sundimtarëve e çdo ditë që kalon e bën edhe më urgjente nevojën e ndrrimit të rrugës ku jemi. Paria nuk duhet lejuar që të vazhdojë në rrugën e krimit të vet. Ka ardhur koha me ndrrue rrugë. Ata që shesin sot veten, nesër nuk do ta kenë për gjë me shitë edhe fëmijët e tyre. Ata që nuk duan nder për famijen e vet, nuk kanë si të duan nder për të tjerët.

Dilema e qytetarëve

Dilema e qytetarëve është e qartë. A do të bëhemi një katund kriminelësh e banditësh në brinjë të Evropës, që s'ka pse të na

pranojë as si vend kandidat, apo do të ndërrojmë rrugë e të bëhemi një shtet normal? A do të bëhemi përfundimisht Haiti mafioz i Europës, shteti i drogës, kontrabandës dhe i prostitucionit, apo do të ndërrojmë rrugë duke e kthyer faqen e historisë për një fillim të ri e për një të ardhme të re, me siguri, begati e mirëqenie për të gjithë shqiptarët? A do të mbesin shqiptarët skllever të një grushti klanesh që kontrollojnë shoqërinë, ekonominë, vlerat, shtypin, dhe që e kanë kthyer shoqërinë, në një strukturë kriminale, të zvetënuar, pa vlera e pa moral, pa siguri e pa të ardhme, apo do të jenë qytetarë të nderuar, njerëz me dinjitet, me siguri e me vlera që jetojnë në tokën e në vendin e tyre, me një shtet që i mbron dhe iu shërben e me një shoqëri që i nderon si duhet?

Shkurt e përmbledhtas duhet thënë se sistemi politik i vendosur në shtetin shqiptar nuk është një sistem demokratik, por një sistem oligarkik e në shërbim të pakushte të parisë. Paria e Tiranës është e zvetënuar, e korruptuar dhe e degjeneruar deri në palcë. Ajo mund të jetë krenare për këtë gjë, e duhet shprehur mirëkuptim për këtë iluzion, sepse edhe sorra mendon se është e bukur.

Shteti nuk ka sovranitet. Shoqëria është e kriminalizuar. Shteti shqiptar është një qendër e trafikimit njerëzor, qendër e kontrabandës, e hajnisë e mashtrimit dhe e një sjellje të përbindshme amorale e imorale në të gjitha nivelet. Ministrat pasurohen me shtatë minuta, për shtatë breza, e vjedhin para në vlerën e ndërtimit të shtatë shkollave. Vendi është pa zot, shteti dhe administrata janë tejet të korruptuara. Sistemet e shkollimit, të shëndetësisë, të mbrojtjes shoqërore e me rradhë janë një mashtrim i paskrupullt. Këtë gjendje ne të cilën është vendi nuk mund ta dëshirosh as për armiqtë dhe jo më për shqiptarët.

Ndarja e polarizimi i shqiptarëve është bërë e bëhet përditë edhe më e dukshme. Ata që duan një copë bukë, gjithsesi që të falet ajo, e kanë shitur shpirtin të sunduesi i rradhës. Ata që duan të jetojnë me nder ikin përditë nga shteti shqiptar. Pajtimi me gjendjen është norma e sjelljes shoqërore. Kjo është vdekjeprurëse për shoqërinë e për interesat e saj të vërteta e të shëndosha.

Por, kjo gjendje nuk është gjendje normale. Nuk ka vend në

botë ku kjo gjendje të trajtohet si normale. Ky shtet është shteti i gangstereve dhe i bandave të parisë, që sillen sikur ky popull iu ka ra për hise. Edhe pse unë e disa të tjerë e kemi thënë tash 20 vjet dhe e kemi ditur mirë se do të përfundojmë në gjendje fatkeqe, askujt nuk ia kishte marrë mendja se do të rrëshqisnim kaq poshtë e kaq pa dinjitet. Bukë hanë të gjithë qeniet e gjalla, bukë han edhe qeni, por njeriu është njeri sepse, mbi të gjitha, njeriu jeton me nder e dinjitet. E në shtetin shqiptar, njerëzit janë ba si copa druri dhe trajtohen si kafshë, jo vetëm nga sistemi politik e nga paria, por edhe nga shoqëria. Shoqëria shqiptare është kaq e kriminalizuar, sa nuk të lë me qenë njeri i ndershëm e me jetue me nder e dinjitet. Shkaktarja kryesore dhe e padiskutueshme e kësaj gjendjeje, është paria e Tiranës. Kjo është shoqëria që ajo ka kërkuar e kërkon me sundue. Por, kur njerëzit ta kuptojnë se paria synon që ata të jenë shpirtna të vdekur, pak prej tyre do të jenë të gatshëm për me vdekë për të.

Cila është rruga ndryshe?

Rruga në të cilën duhet të ecim duhet të jetë ajo e normalizimit të shoqërisë. Ajo është rruga e ndërtimit të një shoqërie me vlera humane, me marrëdhënie normale, një shoqëri demokratike me ekonomi tregu, por të institucionalizuar, ku mbrohet pasuria, jeta, dinjiteti e nderi i qytetarëve. Ne na duhet një shtet e administratë e pastër e në shërbim të të gjithëve, na duhen kapitenë të industrisë e të ekonomisë, që e ngrejnë standardin e jetesës për të gjithë, që ndjehen pjesë e të gjithëve dhe që punojnë për të mirën e përbashkët. Ne na duhet një shoqëri e mundësive të barabarta e shanseve të pastra, ku fëmija i masës të ketë mundësitë të bëhet një kontribues i vyeshëm për shoqërinë. Ne na duhet një shoqëri, shtet dhe struktura të tilla që t'u japin nder e siguri, prosperitet e begati, shpresë e të ardhme të gjithë qytetarëve.

Paria, dhe ai dhjetë përqindësh i popullsisë, që e kanë vënë pasurinë gjatë këtyre 20 viteve, me mënyra që vetëm ata i dinë se si, do t'i kundërvihen egërsisht e me të gjithë mënyrat e metodat çdo përpjekjeje për ndërtimin e një shoqërie të tillë. Edhe pse

një shoqëri me ekuilibre të tilla është edhe në të mirë të tyre, ata nuk do ta pranojnë. Synimi i tyre është që të polarizojnë masat e popullit e në mjegullën që krijohet, të mund të vjedhin sa më shumë nga thesari i shtetit e nga pasuria kombëtare. Aty ku duhet të jetë Zvicër, është Haiti. Aty ku duhet të ketë turizëm e shërbime, ka varreza plehrash e makinash. Aty ku duhet të ketë punë, ka bingo e kumar. Aty ku duhet të ketë edukim, qytetari e normalitet, ka drogë, trafikë e poshtërsi të të gjitha llojeve.

Ka edhe një rrugë tjetër; dhe ajo është rruga ndryshe. Kjo është rruga e pastrimit të administratës prej korrupsionit, në të cilën, si qytetari ashtu edhe zyrtari, janë të mbrojtur e në shërbim të interesave të të gjithëve. Kjo është rruga e ndërtimit të strukturave politike, që iu shërbejnë interesave të popullit e angazhohen në luftën politike me përparësinë e shërbimit më mirë të interesave të popullit. Kjo është rruga e ndërtimit të një ekonomie tregu të institucionalizuar, në të cilën prodhuesit, tregtarët e resherët mbrohen nga shteti i tyre. Ata do ta ruajnë standardin e jetesës, duke i shërbyer shoqërisë e jo vetëm duke marrë prej saj e duke i derdhur paratë e tyre në xhepat e politikanëve. Kjo është rruga e ndërtimit të një të ardhmeje në të cilën ka shpresë, siguri jete, e mbrojtje të barabartë para ligjit për të gjithë. Kjo është rruga e atyre që duan të jetojnë me punë, me nder, e me dinjitet. Askush nuk mund të hyjë midis njeriut e dinjitetit të tij, askush nuk duhet të guxojë që të shkelë me këmbë tjetrin, të spekulojë me të ardhmen e tjetrit, të vjedhë, të grabisë, të korruptojë, të vrasë e të trafikojë pa pritur dënimin me vdekje nga shoqëria.

Kush do ta bëjë ndryshimin?

Ndryshimin mund ta bëjnë vetëm shqiptarët. Ndryshimin do ta bëjnë qindra e mijëra djem e vajza, të rinj e të reja, që kanë jetuar jashtë, që janë shkolluar e që nuk duan të jetojnë në një kamp përqëndrimi modern. Ndryshimin do ta bëjnë qindra e mijëra shqiptarë që, edhe në këto kohë të vështira, janë munduar me të gjitha metodat për të ruajtur nderin e dinjitetin e për të mos u përzier në ndyrësitë e parisë. Ndryshimin do ta bëjnë të gjithë ata

prindër që nuk duan që vajza e nipi, mbesa e djali të trafikohet, të vritet, të përdhunohet rrugëve të botës, por që të jetojnë me nder në familjet e tyre.

Ndryshimin do ta bëjnë të gjithë ata që nuk e duan më retorikën e poshtërsisë, që i ndan shqiptarët në komunistë-antikomunistë, po që kërkojnë një shoqëri të re e moderne, që buron prej të gjithëve e në shërbim të të gjithëve. Ndryshimin do ta bëjnë edhe të gjithë ata afaristë, reshperë, e tregëtarë, që janë të lodhur nga zhvatja e pafytyrësia e politikës që i mban peng dhe që vendosin se është më mirë që të lidhin kontratë me popullin se sa me banditët e klaneve të parisë. Ndryshimin do ta bëjnë të gjithë ata që janë të ngopur me poshtërsinë e parisë dhe e kuptojnë se kjo është rruga pa krye. Ndryshimin do ta bëjnë qytetarët e katundarët, të cilët duan që të jetojnë me nder e me punën e tyre, në një shoqëri që respekton të mirën e që dënon krimin. Kjo është ajo masa gjigande e heshtur, e pazëshme e shoqërisë shqiptare, e cila jeton e mënjanuar nga përplasjet midis palëve të parisë, nuk sheh zgjidhje e nuk bëhet pjesë e zgjidhjes. Por ajo masë është aty. Ajo nuk ka shkuar askund e nuk ka ku të shkojë. Bile, ajo që po ndodh është se qindra e mijëra mërgimtarë që po kthehen përditë, shohin se ai vend është duke iu marrë frymën e duke iu vjedhur shpresën.

Çfarë duhet të bëhet?

Hapi më i madh dhe më i rëndësishëm është distancimi i njerëzve nga loja e parisë. Njerëzit nuk duhet të bien më pre e propagandës partiake e të shfrenuar mediatike që i mban peng të një mendësie kriminale. Kjo pari sundon sepse ia ka arritur që të polarizojë shoqërinë deri në atë pikë, sa që kundërshtarët e njëjës palë, mbështesin palën tjetër, të keqen më të vogël, simbas mendimit të tyre. Mirëpo, dallimi midis palëve është mospërfillës.

Hapi më i rëndësishëm është që njerëzit të shohin të dy palët e parisë, si të keqen e vërtetë të pandashme, si dy fytyrat e zeza të parisë. Njerëzit duhet të bojkotojnë aktivitetet politike të parisë, mitingjet, mbledhjet e me rradhë. Njerëzit duhet të fillojnë e të flasin me njëri-tjetrin, atyre që iu besojnë, në familje, në rreth

shoqëror e kudo që është e mundur. Njerëzit duhet të sillen ndryshe. Ata duhet që me ndërgjegje të refuzojnë të bëhen pjesë e së keqes. Nevoja për ndryshim është e prekshme. Por ajo do të bëhet një imperativ politik, vetëm kur njerëzit të fillojnë e të reagojnë. Ndryshe, duhet ta dinë se rruga e pranimit të gjendjes është rruga e skllavërimit. Kjo rrugë të bën veç skllav të interesave të parisë, por kurrë njeri të lirë. Njeri i lirë bëhesh vetë, bëhesh kur nuk e pranon të keqen, kur ndahesh prej, kur vendos ta luftosh të keqen, më së pari në veten tënde. Ashtu si dikush të ka dhënë ty jetë, ashtu edhe ti duhet ti japësh jetë dikujt, po nuk mund t'i japësh jetë dikujt e mandej t'ia falësh të ardhmen e asaj qenie dikujt tjetër. Ka ardhë e ka kalue koha që njerëzit me u bërë të vetëdijshëm se nuk duhet me e shitë të ardhmen e fëmijëve, të ardhmen e secilit e të familjeve të tyre kaq lirë sa po e shesin me sjelljen e tyre sot, kur e lënë fatin e tyre të vendoset nga një pari sunduese kriminale.

Përmbledhja e argumentit

Zgjidhja që kanë shqiptarët është e qartë si drita e diellit. Ajo është zgjidhje bardh-e-zi. Ata ose duhet të pranojnë që, në shkëmbim të bukës së gojës, të shesin nderin e dinjitetin e të bëhen skllavërit modernë të parisë e të mendësisë së saj kriminale, ose të punojnë për të mirën e tyre si shtetas e qytetarë normalë. Si skllavërit do të hanë një copë bukë që ua hedhin si lëmoshë, si njerëz të lirë, do të hanë një copë bukë me nder e me dinjitetin e duhur. Shqiptarët e meritojnë një të ardhme, në të cilën gjithkush e gjen vetveten, jeton me nder, i mbrojtur prej shtetit të vet, në vendin e vet, pa ia pasë lakmi kujt. E njerëzit meritojnë atë për të cilën edhe kanë punuar. Pengesat në rrugën drejt kësaj të ardhmeje janë të shumta, por ato nuk janë të pakapërcyeshme. Kurrë më shumë se sot, zgjidhja nuk ka qenë në dorën e shqiptarëve dhe kurrë ma shumë se sot shqiptarët nuk kanë qenë kaq të çoroditur e pa vetëdije për zgjidhjen që duhet ndjekur.

Shqiptarët nuk përfitojnë gjë nga këto përplasje. Shqiptarët

duhet të tregojnë me veprimet e tyre se ata e dinë që të dy forcat politike më të rëndësishme janë thjesht dy grupe mafioze, struktura kriminale, që e kanë rrjepur dhe e kanë shkatërruar vendin, që e kanë shitur tek interesa joshqiptare dhe që luajnë haptazi e pa pikë mëshire me jetën e të ardhmen e shqiptarëve e të fëmijëve të tyre. Ka ardhur e ka kaluar koha që me ia thënë parisë të vërtetën në sy: ju jeni shkaktarë për këtë krim të përbindshëm të dështimit të tranzicionit, të humbjes së dy brezave, të shkatërrimit të ekonomisë kombëtare, të kriminalizimit të shoqërisë, të humbjes së vlerave dhe të kthimit të shtetit shqiptar në follenë e krimit të organizuar, të vjedhjes së pronës kombëtare e private, e rrënimit të nderit e të dinjitetit të familjes sime. Parisë e shërbyesve të saj iu duhet thënë: unë dua një të ardhme tjetër e ju nuk jeni pjesë e saj.

RRETHI VICIOZ I TRANZICIONIT DHE BOJKOTIMI I SISTEMIT SI DOMOSDOSHMËRI SJELLEJE POLITIKE

Në këtë pikë të tranzicionit shqiptar, ka një paradoks, që duhet peshuar me kujdes. Paria mendon se ka fituar dhe po punon që të konsolidojë sistemin e saj. Por për kombin shqiptar, dhe për objektivat që duhet të kenë shqiptarët që duan të jetojnë me nder, me punë, me dinjitet e të mbrojtur në shtetin e tyre nuk ka dyshim se tranzicioni ka dështuar dhe se tashmë jemi futur në një rrugë pa krye. Koha ka ardhur me i pa gjërat me syrin që duhet e me vërtetësi. Me e thënë përmbledhtas, ajo që paria sunduese e Tiranës po iu servir të gjithë shqiptarëve nuk është një shtet modern, një shoqëri moderne, një ekonomi moderne, në shërbim të popullit të vet e të interesave afatgjata të tij.

Shteti që është ndërtuar gjatë tranzicionit është si një kala feudale osmane. Në atë shtet, prej zembrës së tij, Bllokut të Tiranës, në emër të ekonomisë së tregut, të stabilitetit rajonal, të Evropës së Bashkuar e të interesave të tyre, me të gjithë mënyrat e mundshme, jeniçerët e deridjeshëm të Enver Hoxhës e stërnipat e kapikuluve, po i mbajnë peng të gjithë shqiptarët.

Shteti s'ka sovranitet. Shoqëria është e kriminalizuar kulm e themel. Ekonomia është një piramidë e gjallë. Shteti shqiptar është një përzierje e Haitit e Kolumbisë në Evropë. Vendi importon gjithçka, edhe ujë e qepë ... dhe eksporton drogë, kontrabandë, armë, vrasës, kodoshë, shpërlarje parash e prostituta. Shoqëria është e zhveshur nga të gjitha vlerat njerëzore dhe kombëtare dhe është e sunduar nga mendësia materialiste më e keqe e katundarizmit. Sistemi është thelbësisht oligarkik dhe është kthyer në një kancer për të gjithë shqiptarët. Kur një shtresë politike kaq e fuqishme

është e sunduar nga jeniçerizmi e katundarizmi të shkrirë në një krijon probleme të mëdha për shoqërinë. Duhet thënë se ajo që ka ndodhur në shtetin shqiptar është fryti i triumfit të jeniçerëve, këtë rradhë, të maskuar si mbështetës të kapitalizmit e të ekonomisë së tregut. Kazani i ortave jeniçere është përcaktuesi i fatit të të gjithë shtetit shqiptar. Ky ishte fundi i tranzicionit, ndoshta jo siç e mendonin ata, por ashtu si punuan ata që të vinte.

Dhe, për ata që dinë, ky lloj fundi e mbyllje e tranzicionit nuk mund të pranohet si një shoqëri normale. Ma shumë se diçka është mbrapsht me këtë sistem, që i shtërngon të gjithë shqiptarët të punojnë për ta e që të vihen në shërbim të interesave të tyre. Të organizuar në partitë e drejtuara nga klanet e Bllokut, e me tentakula të shtrira në të gjitha sistemet, ekonomike, politike, shoqërore, të kulturës e të vlerave, ortat e jeniçerëve të parisë kanë ndërtuar një sistem të frikshëm kontrollimi, legjitimimi e shfrytëzimi të popullit e të shtetit shqiptar. Por kjo nuk do të thotë se kanë të drejtë.

Atë që jeniçerët tanë s'mundën t'u bëjnë osmanëve, po ua bëjnë shqiptarëve. Turqia, që shpëtoi prej tyre, kur i degdisi ata pak që mbetën në malet tona, është bërë një shtet shumë i fuqishëm e modern. Shteti shqiptar, i sunduar prej aleancës paradoksale të jeniçerëve, të rajave të tyre të deridjeshëm e të bashibozukëve, është një krijesë tragjikomike në sistemin ndërkombëtar. Ai është një shtet pa nder e dinjitet, ku të gjithë vjedhin e sillen sikur ky popull u ka rënë për hise. Ky nuk është shteti që duhet, ky nuk është që meritojnë shqiptarët.

Koha është për të ndryshuar sistemin e për t'u shkëputur nga kjo formë e sofistikuar kontrolli e shfrytëzimi nga ana e parisë. Arsyeja për këtë nevojë urgjente është se çdo ditë që kalon, keq e më keq do të bëhet gjendja. Çdo ditë që kalon, edhe përkundër kalbësisë së dukshme morale, sundimi i parisë dhe i shërbëtorëve të tyre duket më i pathyeshëm. Le të mos mendojë njeri se ky sistem ka të ardhme. Sistemi është i dënuar të shembet. Por problemi është se nuk duhet që t'i zërë edhe shqiptarët brenda.

Një nga rrugët, më e vështira por edhe më e lehta për të kundërshtuar këtë sistem kriminal, është që skllëverit e

imagjinuar të mos pranojnë të jenë skllavër të hapur të parisë. Shqiptarët duhet të kujtojnë logjikën e skllavërve. Lidhja e skllavit me sunduesin funksionon sepse që të dy janë të lidhur me një palë pranga. Nëse skllavi vendos që të mos ecë, skllavopronari duhet ta tërheqë zvarrë. Nëse skllavi është i lumtur që është skllav, atëherë skllavopronari e sundon përmes mendjes e përmes frikës së tij. Në shtetin shqiptar, prangat janë jeta e lehtë, zvetënimi e horrlëku, por edhe dashnia për vendin, për të afërmit, e mbi të gjitha, krijimi i bindjes së rreme se skllavi nuk mundet të ekzistojë pa skllavopronarin e vet. Parimi i funksionimit të parisë së Tiranës është i njëjtë me atë të kodoshit të rrugës e të femrës së trafikuar. E ajo lidhje funksionon sepse viktimja mendon se pa mbrojtjen e mbështetjen e tutorit, ajo nuk mundet me mbijetue. Shpresa që e mban në rrugë është se ai që e përdor pa mëshirë, një ditë do të martohet me të.

Kjo është edhe lidhja midis jeniçerëve të ortave të parisë e të popullit shqiptar. Si të gjithë njerëzit e rrugës, edhe paria mundohet që të ruajë me çdo kusht legjitimitetin e vet, duke u shitur sikur ky sistem është një sistem që e don populli shqiptar. Argumenti tjetër i saj është se e gjithë bota kështu është. Se shqiptarët janë këta që ajo thotë se janë. E se sistemi që është ndërtuar është më i miri në botë. Propaganda e shfrenuar vetëm se përforcon këtë përshtypje të rreme, por tejet negative për shqiptarët. E si gjithnjë, jeniçerët, që ishin shërbëtorët më të këqinj të Portës, mandej u transformuan në komunistët më të ashpër të botës e tash janë kthyer kapitalistët më katundarë të botës, japin aprovimin për këtë udhë pa krye.

Është e vështirë, për të mos thënë e pamundur, që të ndryshohet ky sistem kriminal vetëm e vetëm nga brenda shtetit. Aleanca e katundarëve sundues, jeniçerë, bashibozukë e raja, duket e pathyeshme. Kujtdo që iu del kundër, ata i kthehen kundër me një forcë të papërballueshme duke përdorur të gjithë instrumentet në arsenalin e tyre të pasur. Frika që e ka kapur shoqërinë shqiptare është e jashtëzakonshme. Njerëzit kanë frikë edhe të flasin në kafene. Tash kanë filluar të flasin me gishta e me shenja, më keq se në kohën e sistemit të mëparshëm. Askush nuk ka fuqinë me iu kundërvu kriminit të parisë, sepse ndëshkimi është më keq se në

kohën e sistemit të mëparshëm. Pavarësisht bindjeve personale, publikisht duhet me zgjedhë anën e njëres palë të parisë. E sa të marrësh njëren anë, politikisht je i vdekur, sepse je kthyer thjesht në ushtar të saj.

Njerëzit nuk duan ta marrin vesh se ngatërresa e jeniçerëve me bashibozukët nuk është prej së vërteti. Ata rrihen ditën e puthen natën. Ata grinden për një kockë, por nuk i lënë të tjerët të hanë kockën e tyre. E lëre më kur kockat janë miliardat e shtetit e të shqiptarëve. Kjo nuk është më kockë, por një një pre e tillë që ata nuk mundën me e lënë me t'u ikë nga dora.

Në një vend ku të vrasin për pesë lekë, ku njerëzit duhet të mendojnë se humbin jetën, bukën e nderin, si për hiçmosgjë, pasurinë e ruan frika, e shton kontrolli mbi shtetin dhe e garanton politika. Rrethi është i mbyllur. Jeniçerët besojnë se kanë fituar përfundimisht. Kjo ishte parajsja e tyre, e shqiptarët duhet të jenë skllëvërit e përjetshëm.

Në dukje, sistemi është i ndërtuar në një mënyrë të tillë, që të duket se është i pashmangshëm. Edhe më keq, sistemi është i ndërtuar që të duket sikur shqiptarët duan pikërisht këtë sistem, sepse si skllëvërit më të këqinj, ata vetë duket sikur janë gati të shesin veten, nderin, e familjet e tyre për hir të interesave të parisë. Çdo përleshje në rrugë, e cila mbështetet nga qindra mijëra shqiptarë, i tregon si parisë edhe botës se ata janë mbështetësit e saj, se ata, shqiptarët, e duan këtë sundim e shfrytëzim. Problemi, pra, është se ky sistem duket sikur është legjitim, i mbështetur e jo vetëm i pranuar, por edhe i dëshëruar prej shqiptarëve.

Duke e parë nga një këndvështrim tjetër, duhet thënë se hapi më i madh përpara në shembjen e ndrrimin e këtij sistemi kriminal është delegitimimi i tij. Ky është objektivi më i parë që duhet të arrihet, nëse duhet që të ndrohet rrugë. Ndryshimi i sistemit në vitin 1990, duhej të ishte në të mirë të të gjithëve e jo vetëm të kësaj shtrese. Por, sistemi që këta kanë ndërtuar është i tillë që iu shërben kryesisht atyre. Të gjithë klanet e parisë kanë rrogëtarët klientë të tyre, që mbahen me favore e korrupsion dhe që nuk ndalen para asgjëje për të mbrojtur interesat e parisë brenda shtetit. E kështu, edhe pse në shtetin shqiptar duket se nuk po vdes

kush për bukë (bile ka shumë shqiptarë që hanë me lugë floriri, anipse nuk dinë se çka po hanë), sistemi është i degjeneruar fund e majë, i kriminalizuar e pa asnjë shpresë për të ardhmen.

Ka ardhur koha për ndryshim. Skllevërit e imagjinuar të parisë, sepse shqiptarët janë shumë të vështirë me u sundue, duhet të tregojnë se nuk janë skllevër. Koha ka ardhur që shqiptarët të tregojnë se ata mendojnë ndryshe e drejt dhe se nuk pajtohen me gjendjen e krijuar. Kontrolli i parisë mbi shtetin e shoqërinë duket sikur është i pathyeshëm por, në fakt, e kundërta është e vërtetë. Pra, ka një rrugë për të thyer këtë kontroll të parisë. Zinxhiri më i fortë nuk është më i fortë se hallka e tij më e dobët. E hallka më e dobët e sundimit të parisë është lidhja jetike që shteti ka me një million e gjysmë mërgimtarë shqiptarë. Pa mbështetjen e tyre të gjithanshme, shteti shqiptar kthehet, thuhet brenda natës, në një kamp përqëndrimi. Ai shtet është më keq se Haiti, nuk është as një republikë bananesh.

Mërgimtarët janë ata që e mbajnë atë vend gjallë. Por, me një përdredhje tragjike të fatit, duke mbajtur e mbështetur familjet e tyre e duke investuar atje, ata e kanë fuqizuar edhe parinë deri në këtë pikë. Mërgimtarët janë ata që duhet të tregojnë se, edhe pse të ikur, të hedhur tej si të padëshirueshëm prej parisë, si njerëz që në atë vend të kriminalizuar nuk e gjetën rrugën të jetojnë me nder e me punën e vet, nuk duan të jenë më pjesë e krimit të parisë së Tiranës. Koha ka ardhur me iu mbyllë rubinetin e ndihmës ekonomike e me i detyruar njerëzit të zgjohen para këtij realiteti të gënjeshtërt, që ushqehet e mbahet me gjakun e mundin e tyre.

Më pak se dhjetë përqind e popullsisë ka nën kontroll formal të gjithë shtetin dhe ekonominë. Për këta, jeta në shtetin shqiptar është parajsë. Evropën e kanë në kuletën e vet. i kanë të gjitha ato që iu duhen në Tiranë, Golem e në Dhërmi. Ata i kanë aeroportin, spitalet, hotelet, restaurantet, supermarketet. Ata kanë në Tiranë gjithçka që e duan për veten e tyre.

Mirëpo, shteti është një shtet i falimentuar në të gjitha drejtimet. Prandaj, si këta sundojnë e rrogarët e sejmënët e tyre, ashtu edhe pjesa tjetër e popullit, jetojnë sepse ai vend i ka fabrikat e vendet e punës jashtë shtetit. Mbi një million e gjysmë

shqiptarë derdhin gjakun e djersën në vendet e huaja e të gjithë të ardhurat e kursimet e tyre mandej shkojnë në shtetin shqiptar. Përmes kanaleve të ndryshme, ligjore, formale, joformale e kriminale, miliarda euro e dollarë në vit shkojnë në shtetin shqiptar. Fatkeqësia është se këto shuma marramendëse shkojnë në xhepat e parisë dhe janë kthyer në instrumentin kryesor për të përjetësuar sistemin sundues në shërbim të saj.

Mërgimtarët, pra, janë thembra e Akilit e shoqërisë së ndërtuar nga jeniçerët e parisë së Tiranës. Njerëzit nuk duhet të pranojnë këtë gjendje si të pashmangshme, por mërgimtarët mund t'i detyrojnë ata që ta pranojnë zgjidhjen e imponuar prej tyre. E po vendosën mërgimtarët që të mos e pranojnë këtë gjendje si legjitime dhe të rebelohen, atëherë herët ose vonë, paria nuk ka zgjidhje tjetër, veçse të dorëzohet.

Për të arritur këtë objektiv madhor, mërgimtarët duhet të ngrihen kundër vetes së vet e kundër interesave të veta më të ngushta e që duken si të arsyeshme. Por, për të arritur ndryshimin që duan, nëse duan të jetojnë si njerëz në vendin e tyre, ata nuk duhet të tërhiqen. Ndryshe, valë të tjera shqiptarësh do të emigrojnë e ai vend do të bëhet një parajsë e kriminelëve, çdo ditë e më keq, një vend ku asnjë mërgimtar nuk do të gjejë as vendin për të vdekur.

Fuqia e mërgimtarëve shihet tek cikli i ekonomisë shqiptare. Në periudhën shkurt-prill të çdo viti, ekonomia dhe ai vend janë në gjendje komatoze. Asnjë mërgimtar nuk çon të holla dhe vendi është i paralizuar. Në Tiranë ka pak më shumë gjallëri, sepse atje ka miliarda e ka shumë zyrtarë që kanë para e që vjedhin shtetin. Por gjithkund tjetër në shtetin shqiptar njerëzit flejnë gjumin e dimrit. Bizneset janë të vdekura. Dyqanet janë bosh. Restaurantet janë bosh. Askush nuk ka punë. Të gjithë presin mërgimtarët që të kthehen. Ata i presin mërgimtarët që të ndërtojnë shtëpi. I presin që të blejnë apartamente me çmime marramendëse. I presin që të shkojnë në restaurant, ku harxhohet më shumë se në Francë. I presin që të bëjnë pushimet ne Sarandë e në plazhe të tjera, ku paguajnë qimet e kokës për t'u larë në një ujë gjirizesh. I presin për të paguar faturat e shkollave e universiteteve private, që janë

thjesht piramida edukimi. I presin që të bëjnë dasmat, që kushtojnë sa qimet e kokës sepse, prej pajës, tek apartamenti, tek shoferi, të gjitha i paguan mërgimtari. I presin të paguajnë doktorët, zyrtarët e korruptuar e gjykatësit e degjeneruar, i presin që të paguajnë për gjithçka.

Nuk është se mërgimtarëve nuk iu dhemb shpirti me keqpërdorimin që i bëhet gjakut e djersës së tyre. Gjithkujt i dhimbet gjaku i vet. Ata e ndjejnë deri në palcë arrogancën e atyre që nuk punojnë, rrijnë në kafe gjithë ditën e lume dhe lypin para prej tyre. E ndjejnë përbuzjen se janë të përkohshëm e nuk kanë më rrënjën në vendin e tyre. E ndjejnë se as ata e as fëmijët e tyre nuk gjejnë vend në këtë pus ndyrësie e zvetënimi. Ata shkojnë me pushime në shtetin shqiptar gjatë verës, ndërsa paria ikën në Turqi e Greqi. Ata paguajnë për universitetet private e paria i çon fëmijët e vet studiojnë jashtë. Ata shkojnë në plazhe me gjirize, e paria shkon në Maldive. E megjithatë, dashuria për nënën e babën, i shtyn mërgimtarët tanë, që kur kthehen në vendet ku punojnë, të betohen se nuk duan me u kthyer kurrë më në shtetin shqiptar. Por, prapë, kthehen dhe me dhimbje i harxhojnë kursimet e vitit atje. Dashuria e tyre për të afërmit, për vendin ku kanë lindur, për miqtë, për të shkuarën e tyre, është pengu që i mban lidhur. Por, realisht, e vetmja shtresë që përfiton prej parave të tyre është paria.

Prandaj, kush don që të kthehet në atdhe me jetue si qenie normale, me qenë i nderuar e i respektuar, duhet t'u thotë jeniçerëve të parisë se nuk pranon të bëhet pjesë e krimit të tyre. Duhet t'i thotë vetes se nuk do të jetë pjesë e krimit, se nuk do me jetë thjesht një mjeran që paguan çka i shërben parisë. Nëse një masë e konsiderueshme e mërgimtarëve nuk investon në shtetin shqiptar, nuk paguan për marrëzitë e çmenduritë kulturore, nuk shkon me pushime, veç sa me pa nënë e babë, nuk jep më shumë se për ilaçe e bukë, ai vend falimenton. Atëherë, parisë i del uji i zi.

Pavarësisht se gjithkush mendon se nuk është ai vetë njeriu që duhet me e bë një veprim të tillë, koha ka ardhur që gjithkush për vete, qoftë edhe në heshtje, me e marrë vendimin që, për një

kohë, nuk duhet me kontribue financiarisht. Ashtu si edhe me piramidat financiare, nëse mërgimtarët nuk paguajnë, piramida shembet. Koha ka ardhur, për secilin, me e pa veten në pasqyrë e me pyetë: “A dua unë me qenë pjesë e këtij krimi?” Një pyetje tjetër është, a e dua unë të mirën e ngushtë të mbijetesës absurde, që veç e zgjat agoninë e mashtrimin, apo dua një shoqëri ku jetohet me nder e dinjitet?

Zgjidhja që duhet bërë është e rëndë. Gjithkush duhet të kalojë mbi dobësitë e veta, sepse kurrkush nuk është midis një njeriu e ndërgjegjes së tij. Por liria e ka një çmim e gjithkush duhet me e pague çmimin e lirisë së vet. Skllav mund të lindësh, por njeri bëhesh. E koha ka ardhur me u sjellë si njerëz me nder e dinjitet. Shenja më e dallueshme e njeriut të vërtetë është aftësia me e pa të keqen në sy e me i thënë se nuk do të bëhet pjesë e saj.

KAOSI TOTALITAR

Është thujtë e pashmangshme që, sa herë që jepen gjykime për një periudhë të caktuar në historinë e një populli, të gjenden e të përdoren paralele me periudhat e mëparshme në historinë e atij shteti apo populli. Prandaj, në fillim të viteve 1990-të u bë modë intelektuale që gjithkush të kërkonte e të gjente paralele midis ndrrimit të sistemit në vitin 1990-1991 me periudha të tjera në historinë e shqiptarëve. Por, ajo që ra më shumë në sy ishte se shumica e analistëve i referoheshin periudhës midis dy luftërave botërore. Kjo periudhë kritike, si dhe figurat qëndrore të jetës kulturore e ideologjike të shoqërisë shqiptare aktive në atë kohë, u kthyen në etalonet kryesore për të matur sjelljen e politikanëve e të figurave publike në tranzicion.

Ndër autorët e shumtë që përmenden në litanitë e botuara, citoheshin, më së shumti, antishqiptarë e antikombëtarë të markave të ndryshme, si Branko Merxhani apo Giuseppe Valentini, mercenarë jeniçerë si Faik Konica, e mbi të gjitha, Fan Noli. Një figurë komplekse e dorës së parë në historinë e shqiptarëve, Noli ka mbetur si pikë referimi edhe në gjykimet mbi kohën e tanishme. Në veçanti, shumë individë shihnin tek argumenti i Nolit mbi pesë anarkitë analizën reale të shoqërisë shqiptare. Sipas tyre, në tranzicion po përjetohej një përsëritje e pesë anarkive noliane në një periudhë tjetër historike të popullit shqiptar. Mendimi im është se analogjia ishte e gabuar dhe se interpretimi i tyre e ilustronte qartë cektësinë e mendimit intelektual në atë periudhë.

Po cilat janë këto anarki? Në një fjalim të tijin në vitet 1920, duke përshkruar kaosin në të cilin gjendej shoqëria e atëhershme shqiptare, Noli flet mbi pesë anarkitë që sundonin në shtetin

shqiptar. Së pari, sipas tij, ishte anarkia fetare. Shoqëria shqiptare ndahej në katër fe që nuk kanë zënë rrënjë në zemrën e një populli pagan. Së dyti, Noli flet për një anarki sociale, që ai e konceptonte si gjendjen e një shoqërie, ku nuk kishte qartësi mbi shtresat shoqërore e mbi interesat e tyre në shoqëri. Së treti, thoshte Noli, kemi një anarki morale, ku sundon padija e poshtërsia. Së katërti, Noli flet për një anarki patriotike, sepse tradhëtarët shiteshin si patriotë e shërbëtorët e të huajve mburrëshin si shtetformues. Në fund, Noli flet për anarkinë e boshllëkun e idealeve e të vlerave, si pengesën kryesore për ndërtimin e një shteti modern.

Nga ana tjetër, të gjithë ata që deri dje flisnin për këtë paralelizëm me të shkuarën e kohës së Nolit, sot kanë heshtur. Edhe më keq, të pesë anarkitë për të cilat flet Noli, nuk janë më thjesht një përshkrim i gjendjes në të cilën ishin shqiptarët në atë kapërcyell të historisë së tyre. Edhe një vështrim i përciptë i gjendjes ku jemi, të bën të ndjehesh tejet i shqetësuar për fatin e këtij populli dhe për rrugën ku janë shqiptarët. Arsyeja është se dallimi midis kohës së Nolit e tranzicionit, midis viteve 1920 e viteve 1990 e më pas, është rrënjësor. Ky nuk është kaosi i gjendjes që na lanë të tjerët. Ky është një kaos që e kemi krijuar e ushqyer vetë. Shteti shqiptar është në gjendjen e një kaosi të qëllimtë totalitar. Të gjitha anarkitë e përmendura nga Noli janë të pranishme, shumë më të mprehta se atëherë e, çka është më e keqja, të kthyer në sistem dhe të kultivuara nga vetë sistemi politik i parisë.

Karakteristikat më thelbësore të dallueshmërisë midis gjendjeve rridhnin nga ndryshimi në strukturat shtetërore prej kah vinim. Në vitin 1920 kushtet kishin qënë të tjera. Ne po vinim nga një strukturë perandorake, e bazuar në miletin fetar. Parimi bazë i legjitimitetit të perandorisë ishte zhvendosur nga besnikëria ndaj një dinastie të veçantë dhe një ndarje e rreptë e bashkësive të përcaktuara në bazë të fesë, në shpërthimin e nacionalizmave të ndryshme, shumica me identitetin përcaktues fetar, e në rastin e shqiptarëve, etninë, besimin se baza e kombit ishte lidhja e gjakut. Krijimi i shtetit shtronte edhe nevojën e krijimit të kombit etnik nga këto grupe të ndryshme.

Mirëpo, në vitin 1990, po vinim nga një shtet totalitar që, në

45 vjet i kishte shkatërruar të gjitha këto struktura dhe e kishte rikrijuar strukturën e shoqërisë në bazë të një parimi tjetër. Në dy-tre breza, struktura e shoqërisë shqiptare ishte bërë formalisht moderne. Struktura e të gjithë grupimeve që dolën në vitin 1990 ishte e përcaktuar nga lidhja e tyre me shtetin. Nevoja e sistemit për të krijuar një patriotizëm fiktiv, pse i mbështetur në besnikërinë ndaj individit në krye të parisë, e të partisë vetë, i kishte shembur muret që ndanin shoqërinë, kishte fshirë në masë të ndjeshme kujtesën e besnikërinë fetare, kishte zhveshur masat e gjera të njerëzve nga vlerat e mirëfillta morale e qytetare, i kishte lënë të zvetënuar e të paskrupuj, të gatshëm për t'ua shitur blerësit më të parë. Por, gjithsesi, ishte krijuar një vetëdije se dasitë e vjetra, që iu kishin shërbyer me efektivitet osmanëve për të sunduar shqiptarët, nuk ishin më reale. Kaosi që kishte ekzistuar nën perandorinë osmane, kishte qenë i tillë vetëm formalisht, sepse kontrolllet mbi grupimet e ndryshme ishin mjaft të rrepta e efektive dhe izolimi i tyre nga njëri-tjetri kishte qenë çelësi i suksesit.

Uniformiteti që ekzistonte në kapërcyell të vitit 1990-të ishte po aq efektiv sa dhe i frikshëm. Pavarësisht zhveshjes nga vlerat e mungesës së besimit në një fe të caktuar, të gjithë shqiptarët ishin pak a shumë njëlloj. Shembja e sistemit totalitar la një gërmadhë të frikshme, ngaqë mungonin të gjithë strukturat e mirëfillta, që përtej familjes, klanit e dhunës, të mund të krijonin legjitimitetin për sistemin që donte të vendoste paria.

Për parinë, duhej të rivendosej një sistem që të ishte i kontrollueshëm, por dhe të shtërngonte veprimtarinë e njerëzve në atë nivel që të mos rrezikohej sundimi i saj. Kaosi pra duhej dhe ai duhej të ishte i rregulluar e i kontrolluar mirë. E gjatë kësaj periudhe tranzicioni, diku me qëllime të lexueshme qartë e diku, me një sofistifikim inteligjent, paria ka shtyrë përpara një formë të re organizimi shoqëror, të mbështetur pikërisht në inkurajimin e këtyre anarkive, që do ta grimcojnë shoqërinë shqiptare, që do ta paralizojnë e do ta bëjnë të paaftë për të rezistuar trysnisë së parisë. Prandaj, paralelizmi midis anarkive noline dhe anarkive të tranzicionit është jo vetëm një mundësi krahasimi, por edhe një domosdoshmëri analitike.

Kështu, në drejtimin fetar, shqiptarët kanë nisur të ecin në rrugë të kundërta, duke përqafuar fe, besime e ideologji, që veç i ndajnë e do t'i ndajnë edhe më shumë në të ardhmen. Feja po përdoret si instrumenti kryesor nga palët e interesuara, për të minuar e për të shembur idenë e kombit shqiptar. Feja po kthehet në instrumentin kryesor të identifikimit me grupe, kombe e interesa, të cilat nuk kanë kurrëgjë të bëjnë me shqiptarët si grup etnik. Shqiptarët mund të kenë qenë dikur paganë, heretikë në mesjetë, fetarë gjatë kohës së perandorisë osmane, apo në sistemin e mëparshëm, ateistë, zotsharës e zotmohues, por sot nuk janë më.

Në mungesë të vlerave të vërteta e kombëtare, feja po bëhet boshti qëndror i identifikimit të njerëzve. Feja po vendoset në qendër të vëmendjes së tyre dhe të identitetit të tyre. E përplasja midis mbështetësve e besimtarëve të feve të ndryshme nuk është më e paevitueshme. Më e keqja është se ajo paraqitet nga paria, si e evitueshme dhe nën kontroll. Por, edhe pse fundin e rrugës nuk e shohim të qartë, fundi dihet se do të jetë një përplasje, ku në emër të besnikërisë fetare, njerëzit do të kthehen edhe kundër familjes së vet.

Së dyti, në drejtim të anarkisë sociale, përzierja shoqërore që ka ndodhur në shtetin shqiptar, në veçanti mbas viteve 1944 e në vazhdim, nuk ka lënë rrugë e mundësi për të ndërtuar një strukturë shoqërore të qëndrueshme e që do t'i mbrojë interesat e saj në politikë me koherencën që të jep tradita e lidhjet e shumëfishta. Mirëpo, nëse Noli shihte në shtetin shqiptar një popull ku të gjithë katundarët ishin bejlerë e agallarë, si thonë kolonjarët “dyzet bejlerë në një ferrë,” tashti, të gjithë duan me çdo kusht të jenë bejlerë. Në këtë rrugë të polarizimit të qëllimtë të shoqërisë, paria sunduese ka punuar e punon sistematikisht që të polarizojë shoqërinë shqiptarë duke e ndarë e fragmentarizuar sa më shumë që të jetë e mundur në dasi, që janë të manipulueshme prej saj, duke krijuar kategoritë shoqërore që iu ngjajnë kastave, me dallimin që të gjithë të tjerët janë “të paprekshëm” e ata janë në majë.

Më e keqja është se në vend që të ndërtohet një shoqëri e mundësive, paria e Tiranës po punon që të ndërtohet një shoqëri e

skllevërve të saj. Mundësitë ekonomike e të pasurimit në fillimet e tranzicionit, gjaku e djersa e humbur e miliona mërgimtarëve, krijuan përshtypjet e rreme se mundësitë ishin për të gjithë. Por ashtu si pritej, ngushtimi i mundësive të pasurimit po çon në ngushtimin e rrethit të parisë sunduese. Me ngushtimin e mundësive edhe shteti, në vend që të shërbejë si ndërmjetës midis shtresave, është kthyer në instrument të pastër sundimi oligarkik të parisë së Tiranës. Shtresëzimi që po ndodh mbulohet më një cipë të hollë pasurimi të shtresave mikroborgjeze e katundare. Por, në thelb, parisë së Tiranës i intereson që të krijojë bindjen se të gjithë shqiptarët janë ashtu si iu thonë mjetet e saj të propagandës se janë.

Së treti, anarkia e vlerave është një fenomen tejet shqetësues. Në shtetin shqiptar, mbas vitit 1990 u vendos diktatura e profesorëve të sistemit të mëparshëm. Shpejt u pa se këta konviktorë të të gjithë niveleve, (edhe djemtë e Bllokut kishin jetuar si konviktorë në mos në vend, jashtë shtetit), ishin të gjithë të zhveshur tërësisht nga çdo vlerë njerëzore e morale. Në se, në kohën e Nolit, injoranti shitej se i dinte të gjitha, sot, këta ish-profesorët konviktorë, që janë në krye të politikës, e përdorin të gjithë dijen që kanë pasur e që e kanë fituar me mundin e shqiptarëve, për të manipuluar, zvetënuar e shfrytëzuar shoqërinë në interes të tyre. Poshtërsia e tyre e krimi që e kanë kryer e që po e kryejnë me vetëdije të plotë, nuk njeh kufinj. Të përgatitur për të qenë vegla të një sistemi të pashpirt, këta nuk dinë të bëjnë tjetër, veçse të ndërtojnë një sistem të pashpirt. Sistemi që kanë ndërtuar e që po ndërtojnë është i mbështetur në injorancën, poshtërsinë, e në promovimin e veseve më të ulëta e të ndyra njerëzore. Por, për sa kohë që ata munden ta vjelin, nuk është problem për ta.

E nuk është për tu habitur që piramida më e madhe është ajo e edukimit. Në emër të fitimit personal, këta individë janë kthyer në tregtarë të injorancës e të shitblerjes së mendjes. Mjafton të shihet një individ si Ylli Pango, ministri i deritashëm, një njeri i akuzuar si i zhveshur nga të gjitha vlerat morale. Ky është "intelektuali i shquar" tipik për këtë shtresë, njeriu që nuk ndalet para asgjëje.

Po ashtu, këta njerëz të zhveshur nga të gjithë vlerat njerëzore, kanë sjellë moralin e të shkuarës së tyre në politikë. Ata shiten e blihen me çmimin e caktuar, ndrronjë koalicione e parti, çka të thonë sot nuk ta thonë nesër, pa asnjë përskuqjeje turpi. Sjellja e tyre është bërë norma e sjelljes në mbarë shoqërinë. Ekstremet puqen dhe sjellja e atyre, që duhej të ishin modele vlerash, nuk ndryshon askund nga sjellja e lumpenit të shoqërisë në vende të tjera. Kjo që na shitet për politikë dikund tjetër është thjesht sjellja e burgaxhijve të dënuar si hajna xhepush, që u veshën policë pas vitit 1990. Por edhe kjo zhveshje nga vlerat morale, dinjiteti e njerëzia e ka rrënjën e shpjegimin e vet, tek synimi i parisë së Tiranës për të krijuar një shoqëri të lidhur vetëm mbas interesave material e të terrorizuar për bukën e gojës.

Së katërti, në shtetin shqiptar të gjithë politikanët janë qartësisht në shërbim të interesave joshqiptare. Duke e anatemuar idenë kombëtare, ata po u bëjnë shërbimin më të keq vetë shqiptarëve. Edhe më shumë se aq, shitja e vendit dhe e interesave afatgjata shteteve të interesuara, qysh nga të drejtat, qytetaria, territori, interesat bankare, koncesionet e me rradhë, janë një provë e padyshimtë se kjo anarki vlerash është e qëllimtë.

Patriotizmi është një virtyt i paçmueshëm. Por kur horrat duan të justifikohen me patriotizmin, atëherë patriotizmi është streha e fundit e horrit. E kjo pari politike, nuk ka kurrfarë ndjenje patriotike. Ajo punon veç për veten e vet e për interesat e saj. Anarkia e vlerave i shërben këtyre interesave të ngushta të saj dhe ajo punon që ta forcojë e përjetësojë këtë anarki. Nëse njerëzit e dinë se cila është e mira e tyre, nëse vendosin të punojnë për kombin e për veten e tyre, atëherë, çka u duhen këto sundues? Duke e ditur se ata nuk kanë vend në një sistem të drejtë shoqëror, paria punon me të gjithë mënyrat e metodat për të eliminuar e asgjësuar çdo ide kombëtare e çdo përpjekje që e sheh shtetin si një instrument të fuqishëm në shërbim të interesave të shoqërisë kombëtare. Një shtet i fuqizuar e në shërbim të shoqërisë kombëtare është një armik për vdekje i parisë, është armiku publik numër një i saj.

Në fund, anarkia e pestë është ajo e vlerave. Paria e Tiranës, konviktorët e katundarët e deridjeshëm, njerëzit që kanë pritur me

orë me hangër një rrishtë bukë, çaj pa sheqer e me pak marmalatë molle konvikteve, janë të përgatitur nga sistemi i mëparshëm, mos me pasë dashuri për kënd. Edhe njerëzit e thjeshtë, ata që punonin duke ngrënë një rrishtë bukë misri me ujë e sheqer, kanë një uri materiale, që ua ngushton shikimin deri në ekstrem.

Këta janë produkti i uniformitetit të vlerave të sistemit të kaluar. Si intelektualët e të gjitha niveleve, si të tjerët, duhej të zhvisheshin nga çdo vlerë njerëzore, për t'i shërbyer sa më mirë që të ishte e mundur sistemit kriminal të atëhershëm. Sjellja e tyre i ka rrënjët në të shkuarën e tyre, dhe anarkia e vlerave e manifestuar në dallkaukllekun e luftën për të kapur një karrike me çdo kusht e me çdo çmim.

Kthimi i kësaj sjelljeje jo të moralshme në normën shoqërore, është në rrënjë të kësaj anarkie. E, nga ana e vet, paria e Tiranës vepron kështu, jo pse nuk e din se ka rrugë e mënyra të tjera. Ajo e di se ka rrugë të tjera. Por kjo anarki është e qëllimtë, sepse është në shërbim të interesave të saj.

Ku po shkojmë?

Ku po shkojmë? Edhe me një shikim të shpejtë si ky, duhet thënë se në shtetin shqiptar ka një përpjekje intensive për të atomizuar shoqërinë. Përpjekja për ta transformuar edhe më fort në drejtim të zhveshjes morale është më se e dallueshme. Objektivi është për të krijuar një shoqëri ku të sundohet më lehtë përmes përçarjes dhe të krijimit të një sistemi shoqëror, ku çdo gjë e çdo vlerë e ka një çmim material.

Në përfundim, duhet thënë e vërteta e pastër. Është e dhimbshme por, të pesë anarkitë bashkëkohore, edhe pse jo në të njëjtën kahje si ato të Nolit, por, gjithsesi, në të pesë konsiderimet, janë pesë shtyllat e agjendës politike të parisë. Kësaj here, nuk po punohet që të shuhen apo të zbuten këto anarki. Nga ana e parisë po punohet e luftohet që të përjetësohen këto anarki. Kjo agjendë ndiqet në mënyrë sistematike, të qëllimtë, pa asnjë mëdyshje e me vetëdije të plotë nga ana e parisë sunduese. Arsyeja është e qartë dhe e thjeshtë. E vetmja mënyrë për të sunduar e

shfrytëzuar popullin, është që ai të mbahet *in perpetuum* në këtë gjendje anarkie totale, fragmentarizimi dhe atomizimi të thellë shoqëror. Kjo është gjendja që asaj i shkon më për shtat: gjendja e kaosit totalitar.

Çdo përpjekje për të dalë nga kjo anarki e nga ky kaos totalitar paraqitet sikur është një aventurizëm politik, papjekuri, moskuptim i realitetit apo i konjunkturave ndërkombëtare, apo edhe në papajtueshmëri të plotë me të ashtuquajturat vlerat e sotme europiane të popullit shqiptar. Paria e Tiranës po lufton hapur e me të gjithë mënyrat për të mbrojtur interesat e saj. Kush pajtohet me argumentet e saj dhe e pranon këtë kaos totalitar si gjendje normale, herët ose vonë, do të detyrohet që të lërë peng si veten e vet, ashtu edhe të ardhmen e fëmijëve e të familjes.

PASHMANGSHMËRIA E GJENDJES DHE ZGJEDHJA E VULLNETSHME

Njëri ndër objektivat kryesorë e të pandryshuar të parisë së Tiranës është që gjendja e krizës së thellë morale, shoqërore e të vlerave, në të cilën është mbërthyer shteti e kombi shqiptar, të pranohet si e pashmangshme nga populli shqiptar. Nga ana e saj, por edhe e instrumenteve intelektuale dhe mediatike të kontrolluara prej parisë, kjo gjendje paraqitet si e pashmangshme dhe e paevitueshme, si pasojë e drejtpërdrejtë e rrethanave historike.

Argumenti i tyre, i pandryshuar në thelb por i përsëritur në një mijë e një forma të ndryshme, është se ky ishte “fati” historik i shqiptarëve. Kjo ishte e vetmja rrugë, se nuk kishte mënyrë tjetër që gjërat të mund të shkonin ndryshe dhe se kjo ishte rruga më e mirë e mundshme. Meqë, gjithnjë sipas tyre, nuk kishte rrugë tjetër përveçse që të shkonim në drejtim të ndërtimit të kapitalizmit ekstrem siç paraqitej prej tyre, atëherë të gjitha pasojat që rrjedhin nga kjo përpjekje “për të ndërtuar” kapitalizmin, janë procese të natyrshme e të pashmangshme e duhet të trajtohen si të tilla. Për më tepër, theksohet se populli e bëri zgjidhjen vetë, prandaj duhet të mbyllë gojën e të punojë ... për parinë.

Çudia është se një masë dërmuese e shoqërisë shqiptare e ka pranuar këtë argumentim të parisë, të përsëritur me njëmijë mënyra e pa kurrfarë ndërprerjeje, si plotësisht të vlefshëm e të pakontestueshëm. Konsensusi shoqëror është i gjerë. Katër grupimet me peshë në atë shoqëri, që dolën nga sistemi i mëparshëm, katundarët, shtresat e proletarizuara qytetase, inteligjencia dhe paria kanë arritur në këtë bindje e në

përfundimin e përbashkët, se kjo rrugëzgjdhje e gjendje ishte e pashmangshme. Kjo bindje është përforcuar me një nivel rezinjate shoqërore, që duket sikur është mbisunduese. Kjo të shtyn që të mendosh për rrugën ku janë duke ecur shqiptarët. Meqë kjo nuk është rruga e duhur, duhet menduar edhe për mundësitë e daljes nga kjo gjendje.

Paria e ka pasur një ide shumë të qartë se si do të ishte e ardhmja. Ndërsa katundarët dhe shtresat e proletarizuara qytetase, nuk ia kanë pasur idenë se çfarë sistemi do të ndërtohej pas vitit 1991, inteligjencia e kishte një ide, ndonëse të turbullt, se si do të ishte e ardhmja. Mirëpo, ky vizion i inteligjencias për të ardhmen që duhej ndërtuar ishte i ushqyer nga sistemi i mëparshëm dhe i kishte rrënjët në interpretimin e kapitalizmit gjatë kohës së sistemit enverist. Premisa bazë e mendësisë së inteligjencias ishte se sistemi që do të ndërtohej do të ishte e kundërta e socializmit, ashtu si u paraqit gjatë sistemit enverist. Pra, ky sistem do të ishte një sistem kapitalist i tipit të Perëndimit të Largët, i monopoleve e karteleve të përshkruara nga Lenini në *Imperializmi si faza më e lartë e kapitalizmit*, ose në rastin më të mirë, një kapitalizëm si ai që përshkruhej nga Engelsi në Mançesterin e vitit 1844.

Të lidhur ngushtë me një mijë fije me parinë sunduese, pjesa më e spikatur e inteligjencias, intelektualët e kryeqytetit, ishin instrument me rëndësi dhe pjesë e parisë sunduese. Edhe në atë sistem, por veçanërisht fill mbas ndryshimit të rregullave të sistemit, këta synonin që ose të bëheshin pjesë e saj, ose t'i zinin vendin parisë në kontrollin e shtetit. Prandaj, e vetmja shtresë që ishte krejtësisht e qartë, e vetëdijshme për rrugën që po ndiqej, për pasojat që do të kishte shoqëria dhe për fatkeqësitë që do të sillte ecja në atë rrugë, ishte paria sunduese e Tiranës dhe aspirantët për t'u bërë pjesë e saj, "intelektualët e shquar" të kryeqytetit.

Grupimet më kryesore të kësaj shtrese sunduese ishin tre: paria e Bllokut (që ishte edukuar jashtë), profesorati universitar (ajo pjesë që kishte qenë jashtë e që i duhej të dinte se si funksionon sistemi) dhe zyrtarët e shtetit (që duhej të jepnin e të merrnin me botën e jashtme). Këta e kishin një ide të qartë se si funksiononte sistemi që do të vendosej, me të mirat ashtu edhe me të këqijat

që do të sillte. Të bijtë e Enver Hoxhës, që kishin studjuar jashtë me vite, mjekët si Sali Berisha që kishin jetuar me vite në botën e huaj, diplomatët apo partiakët si Sofokli Lazri, juristët si Luan Omari apo ekonomistët si Gramoz Pashko e Fatos Nano, fizikanët si Rexhep Mejdani apo matematikanët si Skënder Gjinushi, apo drejtorët e Ndërmarrjes Fruta-Perime, të kthyer në shkrimtarë, si Sabri Godo, e dinin se si funksiononte bota e huaj. Ata që mendonin se kapitalizmi ishte ajo çka jepte *RAI*, nuk e njihnin gjendjen e nuk dinin si funksiononte bota e huaj. Ata që e besonin *RAI-n* nuk ishin nga ky grup.

Mirëpo, paradoksi është se realiteti, që të gjithë këto kishin parë në vendet ku kishin qenë në Perëndim, (shumica në Francë, Austri, Suedi, Gjermani, Itali, apo në Zvicër), nuk ishte realiteti i kapitalizmit ekstrem. Në të gjithë këto vende, që gjatë gjithë kohës së Luftës së Ftohtë ishin e mbetën shtet-kombe të qëndrueshme, kishte sisteme shoqërore të konsoliduara, shtete të konsoliduara, ekonomi të institucionalizuara e me rradhë. Sistemet e sotme në të gjitha këto vende janë një evoluim i asaj që këto pjestarë të parisë e shumë të tjerë të brezit të mëvonshëm që identifikohen lehtë sepse më vonë dolën si lojtarë me peshë në lojën politike (Genc Pollot e tranzicionit), e kanë parë, e kanë njohur, dhe e kanë ditur që është gjendja reale e shoqërive perëndimore.

Askund, në asnjë vend ku kanë qenë këta individë të parisë, ku secili prej tyre ka kaluar vite jete jashtë vendit, nuk kanë parë një kapitalizëm ekstrem. Prandaj, pyetja që shtrohet këtu është e thjeshtë. Si është e mundur që kur dolën në krye të forcave politike dhe të strukturave shtetërore, apo edhe mbetën në prapaskenë duke mësuar nipat e mbesat, dhëndurët e bashkëfshatarët që të bëjnë politikë, të gjithë këta individë u sollën në mënyrë kriminale? Pse këta individë u turrën të ndërtonin një sistem shoqëror i cili nuk ekziston kurrkund përveçse në mendjen e disa ekstremistëve ideologjikë dhe në mendjen e parisë sunduese në shtetin shqiptar? Pse duhej që të bëhej e të luhej ky eksperiment me shqiptarët?

Përgjigja është e qartë. Çdo gjë që këta e bënë gjatë këtij tranzicioni e bënë mbrapsht, sepse kështu mendonin se do të përfitonin për veten e tyre. Privatizimi me rrënjë i çdo strukture

ekonomike e mbrojtjeje shoqërore, shkatërrimi i fabrikave e ndërmarrjeve të ndërtuara me aq sakrificë nga i gjithë populli shqiptar e që ishin pronë e të gjithë popullit shqiptar, rrënimi i shtetit, rrënimi i identitetit, legjitimitimi i krimit dhe i poshtërsisë, ngritja në moral e sjelljes së zvetënuar, piramidat, dhe korrupsioni i gjithanshëm, ishin karakteristika themelore të këtij projekti të parisë. Krimet e kryera nga paria e Tiranës, por me shtytjen e inkurajimin e saj janë të përbindshme e lista nuk ka fund. Kujt nuk i kujtohet “çeku i bardhë” i Gramoz Pashkos, thirrjet “kemi bukë vetëm për tre ditë,” të Ylli Bufit, “paratë e popullit janë të pastra” të Sali Berishës, bisedat e Fehmi Abdiut me Fatos Nanon në Rogner, bisedat e Edi Ramës me Mihal Delijorgjin, krimet e Fatmir Mediut, skandalet e pafund të të tjerëve, që për shtatë minuta u bënë milionerë e më radhë? Kujt nuk i kujtohet 1997-ta? Gërdeci? Kujt nuk i kujtohen përmbytjet e Shkodrës, një qytet që mbas përmbytjeve bën edhe karnival(!). Lista e skandaleve nuk ka fund.

Pikënisja e fillimit të gjykimit është se askund në Europën Qëndrore e Lindore nuk u krijua një gjendje kaq monstruoze, në ndjekje të qëllimeve të caktuara, të zbatuara me konsekuencë e pa mëshirë, sa kjo që u krijua në shtetin shqiptar. E për këtë nuk ka se si t’iu vihet faji katundarëve apo shtresave të proletarizuara qytetase. Nuk mund t’iu vihet faji as hajnave, as rrugaçëve, as lumpenit të shoqërisë, që, me thënë të drejtën, nga fundi i viteve 1980-të, u shtuan si shumë. Lufta e sistemit enverist ishte që t’i mbante këto shtresa nën kontroll. Mjeti përmes të cilit sistemi synonte t’i kontrollonte ishte nga një anë dhuna e, nga ana tjetër, padija më e thellë. Synimi ishte që këto shtresa të mendonin ashtu si donte paria. Kur erdhi puna që të vepronin, shumë nga këta njerëz u shtynë dhe u motivuan nga urrejtja që kishin. Pavarësisht se veprimet e tyre individuale duken si të motivuara nga interesa të ngushta apo nga interesa personale, në një masë të konsiderueshme, edhe kur kanë prerë hardhitë, kanë mbyllur minierat, kanë vjedhur kapakët e pusëve, tullat e ndërmarrjeve e kanë shkullur dërrasat e bankave të shkollave, këta individë, të të gjithë shtresave, kanë bërë çka iu ka thënë paria e Tiranës hapur,

ose përmes rrugaçëve politikë që u bënë instrumentet e parisë, pas Dhjetorit 1990.

Njerëzit i kanë parë dhe i kanë konsideruar këta pjestarë të parisë së Tiranës, pavarësisht nga partia në krye të cilës dolën, asgjë më pak se sa si shpëtimtarë. Kam bindjen se po të ishin treguar më me mend e të sinqertë njerëzit si Gramoz Pashko, Sali Berisha, Sabri Godo e të tjerët, njerëzit e thjeshtë do t'i kishin ndjekur deri në një cak pa hezitimin më të vogël. E ashtu do të ishin ruajtur minierat, vreshtat, fabrikat, uzinat, spitalet, dyqanet e me rradhë, sepse të gjitha këto ishin pasuria e popullit shqiptar e jo e dikujt tjetër.

Mirëpo, siç edhe shihet nga sjellja e tyre konseguente e mbas 1990-tës, këta pjestarë të parisë së Tiranës kishin objektiva të tjera. Ata e kanë ditur mirë se çfarë po bëjnë e se në çfarë rrugë po e fusin kombin e shtetin shqiptar. Ata i kanë marrë vendimet e tyre me një vetëdije të plotë. Ata duan që edhe sot, mbasi po shihet qartë se ky sistem që është krijuar prej tyre ka dështuar plotësisht, ta shesin krimin e tyre si arritje. Anjëri nga këto pjestarë të parisë nuk ka kërkuar falje, nuk ka pranuar gabime, nuk iu ka kërkuar ndjesë shqiptarëve. Mbrojtja më e fortë që këta kanë për sjelljen e tyre është argumenti i pashmangshmërisë së sistemit. Mirëpo ky sistem nuk ishte i pashmangshëm. Ai u vendos me qëllim e është pasojë e politikave konseguente të ndjekura nga paria, e rreshtuar në formacionet politike të dala nga PPSH, e të kontrolluara nga vetë paria e prijatarët kryesorë të saj.

Projekti i tyre afatgjatë ishte i qëllimtë dhe me objektiva të qarta. Synimi i tyre ishte ndërtimi i një kapitalizmi ekstrem, të mbështetur në mendësinë katundare të shumicës dërmuese të popullit shqiptar. Katundarët do të merrnin nga një copë tokë, shtresat e proletarizuara do të kishin një copë pronë të vogël apo dyqan, por monopolet e vërteta të kontrollit të ekonomisë dhe të shtetit do të ishin në duart e tyre. Me kohë, këta do të bëheshin sundimtarët e vërtetë, oligarkët e një sistemi që do të kishte një polarizim të frikshëm ekonomik, shoqëror e politik. Kur të ktheheshin armiqtë e tyre të Luftës së Dytë Botërore, bejlerët, agallarët dhe tregtarët e pasur, nuk do të gjenin asnjë pronë. Ata

do të mbesnin pakica e përjetshme, pa forcë ekonomike, dhe kështu do të eliminoheshin si faktor politik. Kështu ata vetë, para sunduese enveriste, do të mbesnin para dhe do të integroheshin në borgjezinë ndërkombëtare.

Hedhja jashtë vendit e një milion e gjysëm shqiptarëve në emigracion ishte një arritje, por edhe një pengesë e madhe për parinë në përmbushjen e planit të saj. Ishte një arritje e shënuar, sepse këta shqiptarë që dolën jashtë i hodhën të gjithë kursimet e jetës në shtetin shqiptar. Kështu, edhe pse pa të ardhme, ata i kontribuan planit të parisë, duke mbajtur gjallë ekonominë e vendit, që ende mbahet me remitancat e tyre. Por, po kjo masë e jashtëzakonshme e jetëve të sakrifikuara të shqiptarëve, edhe pse faktori kryesor që e mban ekonominë gjallë, është pengesë për planet e parisë. Duke çuar ndihmë të madhe financiare, por edhe duke i mbajtur familjet e tyre gjallë, me bukë e me të mira të tjera materiale, mërgimtarët nuk lejuan skllavërimin e thellë të familjeve të tyre.

Kjo ia prish planet parisë. Shqiptarët më parë vdesin duke pirë kafe e raki me alkool metilik me paratë që sjellin mërgimtarët, se sa të punojnë për parinë për 150 mijë lekë në muaj. Ai që vepron në këtë mënyrë kultivon me shumë kujdes e sistematikisht lidhjet familjare e farefisnore e nuk kontrollohet më lehtë prej parisë. Kjo gjendje mosvarësie e ka thelluar dasinë ndërmjet popullit e parisë dhe ia ka vështirësuar asaj punën. Edhe pse nuk vërehen qartë, strukturat e lidhjeve kulturore në nivel të shoqërisë kanë filluar që të evoluojnë në drejtime të tjera prej interesave të parisë. Para i ka dashur njerëzit që të jenë të zhveshur nga vlerat, por jo që të jenë *krejtësisht* të zhveshur.

Mirëpo për sa kohë që askush nuk e konteston kontrollin e tyre oligarkik mbi shtetin, ekonominë, vlerat, e mbi çdo aspekt tjetër të jetës, para llogarit se mundet që ta tolerojë e ta tejkalojë edhe këtë gjendje. Para e di shumë mirë që, herët a vonë, mërgimtarët do të shkëputen përfundimisht e do t'i lënë të gjitha kursimet në shtetin shqiptar, në mos tjetër, për të ndjekur fëmijët e tyre. Ata që mbesin në shtetin shqiptar janë më të pazotët, ata që nuk kanë mundur që të ikin e prandaj është më

e lehtë për t'i sunduar. Në mendësinë e parisë, skllavërimi i një shoqërie si shoqëria shqiptare, që tashmë është e zhveshur nga vlerat morale e qytetare, është vetëm çështje kohe.

Pse duhen thënë këto gjëra? Këto duhen thënë sepse vënë në dukje nivelin e vetëdijes së parisë dhe përgjegjësinë e saj dhe të inteligjencias që u integrua në të mbas vitit 1990. Në se katundarët e shtresat e proletarizuara qytetase e panë vendosjen e një sistemi kapitalist ekstremist si të pashmangshëm, para e Tiranës dhe “intelektualët e shquar”, por edhe deri diku inteligjencia e shtresave profesioniste (inxhinierët, mjekët, etj.) e panë këtë ngrehinë kriminale si një sistem që iu shërbente më së miri interesave të tyre. Kështu që, shumica punuan me vetëdije e me ndërgjegje të plotë për vendosjen e një sistemi të tillë kriminal. Pak kush prej tyre u distancua nga kjo ndërmarrje kriminale. Ata që u distancuan nga kjo lojë u mënjanuan nga jeta politike. Por, shumica dërmuese ka përfituar prej këtij sistemi dhe, më e keqja, është se përfitimi ka kenë shumë i madh, i shpejtë dhe i lehtë. Këta profesionistë sot ndjekin interesin e vet të ngushtë dhe e shohin botën përmes kuletës së vet. Prandaj, tashmë, ky sistem iu duket legjitim dhe më i drejti i mundshëm.

Por, nga ana tjetër, edhe pse ka shenja rezistence të fortë shoqërore, paraliza morale e shoqërisë është e thellë dhe e jashtëzakonshme. Por, edhe një herë, duhet theksuar se heshtja sipërfaqësore nuk është aprovim. Duhet kuptuar edhe shkaqet e kësaj heshtjeje kolektive që nuk është gjithnjë e vetëdijshme, por që vjen si rezultat i presioneve të shumta politike, ekonomike dhe shoqërore, kryesisht nga para dhe nga mjetet e saj të propagandës e të presionit të rrugës. Nuk është se njerëzit normalë, ata që janë përjashta strukturës së parisë, nuk e dinë se çka po ndodh. Mirëpo, as edhe një njeri nuk po guxon me e hedhë gurin e fajit mbi parinë. Edhe kur e hedhin, janë aq të përlyer sa që sjellja e tyre lehtësisht interpretohet si hakmarrje personale. Kështu që, argumentet e tyre, edhe kur janë të drejta, zhvlerësohen.

Arsyeja duhet kërkuar tek fakti se thujase të gjithë pjestarët e shtresës së inteligjencias së kryeqytetit, ‘intelektualët e shquar,’ një pjesë e profesoratit universitar dhe ushtruesit e profesioneve,

janë bërë pjesë e këtij krimi, sepse thua jse që të gjithë ose kanë përfituar shuma e pasuri përrallore për një kohë të shkurtër, ose jetojnë në një nivel të lakmueshëm prej këtij krimi. Kjo është jeta e tyre e përditshme, ata e kanë pranuar këtë sjellje si normale, e shumë prej tyre sot nuk shohin më rrugë të tjera.

Mbitëgjitha, ata shohin të ardhmen e tyre financiare, ekonomike, e materiale të lidhur pazgjidhshmërisht me vazhdimësinë e këtij krimi. Nuk ka rëndësi nga vijnë paratë e kush i sjell. Profesori që jep mësim në tre universitete, ndërkohë që edhe as vetë nuk din se çfarë po jep mësim, inxhinjeri që ka firmën e ndërtimit që ndërton një pallat që nuk i reziston një kallëpi me dinamit, burokrati që ka blerë koncesionin për hidrocentralin e vogël të një katundi të humbur, nëpunësi që ka falsifikuar letrat në kadastër, shitësja që ka privatizuar dyqanin, mjeku që të lë të vdesësh sepse ka hapur klinikën private e kërkon që të shkosh në të, infermierja që nuk të bën gjilpërën pa lekë, katundari që i ka vjedhur tokën tjetrit, por që për të mbrojtur tokën e vet të vret pa mëshirë, analisti që paguhet mijëra euro në muaj për të thënë budallallëqe edhe pse e di mirë se sa pa lidhje po flet, kontrabandisti që shet drogën e Lazaratit e të gjysmës së zonave malore të vendit, trafikantët e femrave dhe miqtë e tyre që marrin rushfetet, vrasësit me pagesë që shohin se ka rënë çmimi nga konkurrenca, shitësit e makinave të vjedhura, importuesit e grurit të shplarë me lloj-lloj gjërash, të hekurit me radioaktivitet, të pulave që duhet të groposeshin, të ushqimeve e të mishit të prishur e shumë e shumë të tjerë si këta, të gjithë janë pjesë e këtij krimi shoqëror. Të gjithë e dinë çka po ndodh, të gjithë e dinë se çka po bën tjetri, dhe asnjëri nuk po flet. Prandaj, e gjithë shoqëria është e kriminalizuar fund e krye dhe gjithkush është pjesë e këtij krimi. E nuk duhej të ishte kështu. Kjo nuk ishte e paevitueshme. Por, ja që këta jemi dhe, në krahasim me shtetet normale, jemi me u pasë frikë.

Mirëpo, petku i pashmangshmërisë nuk e mbulon dot përgjegjësinë e thellë morale të parisë e të veglave të saj. Ajo që ka ndodhur në shtetin shqiptar është e përbindshme, sepse ky është një krim që është bërë me vetëdije të plotë, me ndërgjegje të plotë. Ky është një krim, që nuk mund të falet e që nuk mund të kalohet

kaq lehtë e pa zhurmë, siç mendon dhe siç shpreson paria që të ndodhë. Gjithçka që ka ndodhur, është bërë me vetëdije të plotë. Edhe më keq, gjithçka që po ndodh edhe tash që u janë hapur sytë të gjithëve, po ndodh me vetëdije të plotë e pa pikë vrasjeje të ndërgjegjes. Edhe nëse atëherë nuk kanë ditur gjë, askush nuk mund ta thotë më një gjë të tillë. Sot po veprohet me ndërgjegje. Sot po ecet me ndërgjegje në rrugën e krimit.

Një krim, që bëhet me ndërgjegje të plotë, duhet dënuar pa hezitimin më të vogël. Në mos tjetër, duhet dënuar para historisë. Dhe ky krim, që është kryer gjatë këtyre 20 viteve, nuk duhet lënë të kalojë si kurrëgjë. Nuk duhet të ndodhte kështu, nuk kishte pse të ndodhte kështu. Por, përgjegjësia për këtë krim të përbindshëm është e parisë sunduese, të organizuar në të gjitha partitë politike e në strukturat që ajo ka ngritur, për të përjetësuar këtë sistem që po lë pasoja, të cilat po përkeqësohen me shpejtësi marramendëse.

ZGJEDHJET LOKALE DHE SJELLJA E FAKTORËVE QENDRORE NË POLITIKËN SHQIPTARE

Në Tiranë u bënë zgjedhjet, por edhe plasi sherri i pritshëm mbaszgjedhor. Sherri pritet që të tërheqë, gradualisht e vijimisht, së pari militantët, mandej strukturat partiake e shtetërore e në vazhdim popullin e mobilizuar në mitingje. Në fund, sherri do të mbyllet me ndërhyrjen e të huajve. Zgjedhjet lokale u mbyllën me dështim. Shteti është në karantinë politike ndërkombëtare. Njerëzit janë të frikësuar për kthimin e vitit 1997. Por, segmentet e parisë kërcënojnë njëri-tjetrin me përdorimin e dhunës shtetërore e mafioze.

Fajtoje e padiskutueshme për gjendjen është paria e Tiranës. Edhe pse të gjithë faktorët e rëndësishëm konvergjuan dhe ndikuan që këto zgjedhje të zhvillohen në nivel të pranueshëm, paria nuk synonte mbajtjen e tyre si duhet. Edhe tash, siç shihet nga rasti i Bashkisë së Tiranës, paria nuk e pranon përfundimin e tyre sipas ligjeve të fuqi. Herë njëra palë e herë pala tjetër, paria e Tiranës po e mban shtetin peng. Ajo bën ligje të reja simbas interesave të momentit, nxjerr përfundime të reja simbas interesit që ka në atë pikë dhe, për shkak të mungesës së ligjshmërisë e të respektit për ligjin, vendi është hedhur në një krizë të thellë. Ajo që është më e keqja, paria e bën këtë me vetëdije të plotë. Në mos tjetër, edhe kjo krizë e stisur prej saj tregon pa pikë dyshimi se paria e Tiranës është problemi kryesor i shqiptarëve.

Zgjedhjet e vitit 2011 si pikë kthese në tranzicion

Zgjedhjet lokale të 8 Majit 2011 ishin një moment i rëndësishëm

në proceset politike të tranzicionit në shtetin shqiptar. Duke qënë se po zhvilloheshin mbas një situatë të tensionuar e shpërthyesë, që kulmoi me ngjarjet e 21 Janarit 2011, vetë mbajtja e tyre ishte një sukses. Por, duke e parë rolin qendror dhe përcaktues të të huajve, shenja më e qartë e dështimit të tranzicionit është pikërisht mbajtja e tyre. Pa ndërhyrjen e vendosur, yshtjen, shantazhin e ofertat e të huajve, nuk do të kishte zgjedhje lokale.

Problemi thelbësor është gjithnjë i njëjti dhe i pandryshuar: këto zgjedhje duhej të ishin një provë tjetër force për segmentet e parisë. Të gjithë prijatarët ishin përgatitur për këtë provë force. E shkuara tregon se gjuha e forcës dhe e rrugës është e vetmja gjuhë që ajo e merr vesh mirë dhe që i bindet. Po ashtu, duke qënë se paria nuk ka besim tek demokracia, nuk pyet për popullin e vet, nuk ia ndjen fare se çka mendon bota dhe, mbi të gjitha, nuk ka besim tek pala tjetër, sherri është i paevitueshëm. Këto zgjedhje i provuan këto.

Në këtë drejtim, duhet thënë se nuk kishte dyshim se a do të kishte sherr e rrëmujë, por se cili do të ishte shkaku, *casus belli*, "sebepe i sherrit", për rrëmujën e rradhës. Dhe ajo që ndodhi e po ndodh po tregon se shkaku i së keqes është paria e Tiranës, e rreshtuar në koalicionet e rradhës. Një analizë e sjelljes së faktorëve qendrorë gjatë këtyre zgjedhjeve, por edhe paradokset që u vunë re, tregojnë se shkaktarë kryesorë të gjendjes janë segmentet e parisë sunduese. Ata janë strumbullari i së keqes, dhe faktori themelor për këtë tragjikomedi politike, që luhet në kurriz të të gjithë shqiptarëve.

Faktori ndërkombëtar

Së pari, meqë shteti shqiptar është një shtet vetëm formalisht i pavarur, faktori ndërkombëtar, në të gjitha nivelet, si institucionet shtetërore qendrore të tyre ashtu edhe përfaqësuesit në Tiranë, kanë luajtur një rol të jashtëzakonshëm. Duke i bërë të mundura këto zgjedhje, duke ndërmjetësuar midis palëve, duke u kthyer në garantin e procesit demokratik në shtetin shqiptar, të huajt u dëshmuuan si faktori më me peshë në lojën politike. Tashmë, të

huajt e kanë përgjegjësinë për drejtimin e shtetit shqiptar. Paria mendon vetëm për pronat e veta. Mirëpo, aq sa ishte pozitiv roli i tyre për procesin zgjedhor, po aq domethënës ishte edhe roli qendror që luajtën ndërkombëtarët për dështimin e demokracisë në shtetin shqiptar. Ka pak gjasa që, pa praninë e të huajve, paria e Tiranës të silltet si një shtresë e përgjegjshme politike, që mendon e silltet me dinjitetin e atyre që duhet të përfaqësojnë një popull.

Ka pak gjasa që edhe me praninë e ndjeshme dhe me rolin vendimtar e në rritje të të huajve shqiptarët të arrijnë që të ndërtojnë një sistem të besueshëm demokratik. Paria e Tiranës nuk u beson të huajve dhe të huajt nuk i besojnë parisë. Por paria di se si të bëhet e domosdoshme dhe se si të ruajë veten e interesat e saj edhe nga të huajt. Të huajt kanë marrë përgjegjësinë për drejtimin e shtetit dhe, nga ana e vet, paria silltet sikur gjithçka vendoset në kryeqytetet e botës. Por paria kërkon vetëm që përgjegjësinë t'ua lërë të huajve dhe të ruajë atë që ka fituar, si "borgjezi e madhe", duke mbajtur të paprekur monopolet e kontrollin mbi strukturat. Sa herë që të huajt do të ndeshen me parinë, paria do t'i drejtohet mitingut, militantëve, rrugës e propagandës dhe do të kushtëzojë çdo projekt të huaj për ndryshim pozitiv demokratik derisa, në emër të stabilitetit rajonal e të vendit ta fitojë edhe betejën e rradhës me të huajt.

Votuesit

Së dyti, pati shumë dukuri të dënueshme e patologji të pritshme e të manifestuara dukshëm në nivelin lokal. Ndër të tjera, mund të përmenden korrupsioni, shitblerja e votës, fuqia e strukturave klanore apo të interesave, demagogjia elektorale, fushatat e ndërtuara mbi "pika të dobëta" e të parëndësishme të karakterit të individëve e me rradhë. Por, pavarësisht patologjive të shumta, ajo që ra në sy, ishte se procesi i votimit u konsiderua shumë seriozisht nga qytetarët shqiptarë.

Sjellja e qytetarëve shqiptarë, e ilustruar, në një anë, nga bojkoti masiv i sistemit, tregon një shkallë të lartë humbjeje legjitimiteti të sistemit. Shumë qytetarë nuk votuan. Por, nga ana tjetër, edhe

mënyra se si u dhanë e u morën votat, nga ata që votuan, është domethënëse. Pavarësisht nga moskuptimi i rëndësisë së votës dhe i shitjes së saj me qëllime pragmatike e dritëshkurtëra, sjellja e masës së votuesve është një tregues i qartë se njerëzit janë të vetëdijshëm për rëndësinë e procesit qoftë edhe për zgjedhjen e problemeve e të mbrojtjes së interesave të tyre imediate.

Shkurt, pavarësisht mangësive të shumta e të evidentueshme, është e qartë se qytetarët shqiptarë duan të sillen si njerëz normalë dhe të bëjnë zgjidhjet që duan, për njerëzit që ata duan të zgjedhin dhe me rregullin e duhur demokratik. Kjo është një dukuri shumë pozitive dhe një shenjë e qartë se demokracia ka zënë rrënjë në shoqërinë shqiptare. Më e pakta që njerëzit duan të bëjnë është që të përdorin votën e tyre. Se si e përdorin votën e tyre është çështje tjetër, por tashmë është e qartë se ata e dinë rëndësinë e votës së tyre. Dallimi midis qëndrimeve është se si e masin ata vlerën e votës: në të mirën e tyre individuale, apo të të gjithë qytetarëve të tjerë.

Paria dytësore

Së treti, paria dytësore ishte e interesuar për këto zgjedhje lokale. Vetë perspektivat e saj ekonomike janë të përcaktuara nga pushteti lokal dhe prandaj, interesat e saj lidhen me pushtetin lokal, e zgjidhen përmes pushtetit lokal. Paria dytësore, aktiviteti dhe influenca e së cilës është e përqendruar në qytete e në komuna të caktuara, u soll si një seri grupimesh të dallueshme autonome. Në dukje, këto grupime janë të lidhura me segmentet e parisë së Tiranës. Nga ana tjetër, këto grupime janë kryesisht të interesuara për të ruajtur interesat e tyre, që shpesh janë edhe të përbashkëta me të parisë, po jo më të përputhshme.

Duhet theksuar se të gjitha patologjitë e sistemit ishin të dukshme edhe në këtë nivel. Por vetë kandidatët lokalë e dinin se, me klientët e tyre duhej që të bënin premtime të arsyeshme, apo përafërsisht a mundësisht të realizueshme e në shërbim të një pjese të bashkësisë. Shitblerja e votës, presioni ekonomik e politik, demagogjia, tribalizmi, klientelizmi, strukturat klanore,

shfrytëzimi i mendësisë katundare, rushfeti, ndarja paraprake e tortës së përfitimeve materiale e me rradhë, ishin qartësisht të pranishme në allishverishet e në premtimet e kandidatëve lokalë.

Në mos tjetër, paradokset u bënë të qarta në rastet kur këshillin bashkiak apo komunal e merr një parti, por kryetar bashkie zgjidhet kandidati i një partie tjetër. Kjo flet shumë çka për këto allishverishe. Kjo lloj sjelljeje, “xhambazllëku elektoral”, ku dhënia paraprakisht, apo shitja e votës, merr formën e premtimeve të caktuara për shërbime në të ardhmen, është e njohur dhe e pranuar si praktikë legjitime në shtetin shqiptar.

Struktura zgjedhore

Së katërti, struktura zgjedhore ishte mjaft efiçente. Si gjithnjë, pati shumë probleme të të gjitha llojeve, por që u kontrolluan relativisht mirë nga strukturat... deri në një pikë. Me një fjalë, komisionerët, zyrtarët, komisionet e të tjera aspekte të procesit, funksionuan me mjaft efikasitet. Duket se, në masë dërmuese, kandidatët në nivelin lokal i pranuan zgjedhjet dhe rezultatit e tyre si legjitim. Pra, me gjithë mangësitë e problemet e vërejtura më lart, procesi funksionoi. Ka shumë punë për të bërë, por në shumë komuna e qytete procesi ishte shembullor e dinjitoz.

Paria e Tiranës

Së pesti, faktor tjetër qendror është paria e Tiranës. Të dy segmentet kryesore të saj shkuan në këto zgjedhje me përdhunë e me dyshim. Në zgjedhje, ata përdorën shtetin e strukturat që kontrollojnë, për të influencuar procesin sa më shumë që të ishte e mundur. Demagogjia e tyre ishte krejtësisht e shfrenuar dhe pa kurrfarë baze realiste përmbushjeje në të ardhmen.

Por, asnjë nga faktorët qendrorë nuk po i ndiqnin në atë nivel që pritej. Populli nuk donte sherr, se është i tejngopur me sherret e kërcënimet për grushte shteti nga të dy palët. Paritë dytësore kishin interesat e tyre dhe grupimet e saj, ose vepronin, ose do të vepronin në mënyrë autonome prej parisë

së Tiranës. Të huajt, të zotët e vërtetë të atij vendi, ishin të gatshëm të përdornin si kulaçin ashtu edhe kërbacin, për t'i mbajtur segmentet e parisë nën kontroll. Në këto kushte, paria u detyrua që të ndiqte rrugën e zgjedhjeve.

Rezultati është se të dy palët e parisë së Tiranës dolën të dobët nga zgjedhjet. Fitoret e tyre ishin si fitoret e Pirros. Shpesh, kandidatët fitimtarë në nivel lokal as nuk e përmendën emrin e partisë apo të udhëheqësit respektiv në Tiranë. Për disa ditë, u duk se shteti shqiptar po jepte shembullin që nuk e kishte dhënë asnjëherë deri më tani,, të paktën duke pasur një votim paqësor, me rregulla, megjithëse nën frikën e kamerave e me një sistemi kontrolli që e bënte vjedhjen e hapur të votave në kutinë e votimit, të pamundur.

Por, ajo që ndodhi me zgjedhjet për kryetarin e Bashkisë së Tiranës krijoi paqartësi e mundësi të mjaftueshme për sherr. Duke e parë se kishte mundësi fitimi apo manipulimi, sepse fitorja ishte vetëm me 10 vota, Sali Berisha u turr për të thyer Edi Ramën dhe për të kushtëzuar njohjen e tij si kryetar i Bashkisë së Tiranës me garanci të tjera, si për zgjedhjen e presidentit, ashtu edhe për moskërkesën për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohëshme. Masha u bë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Gjithçka po bëhet me ligj, e përmes KQZ, por ligji bëhet për të arritur gjithçka që do Sali Berisha. Kjo është sjellja më vdekjeprurëse për demokracinë. Demokracia funksionon vetëm kur respektohen rregullat dhe precedentët. Ndryshimi i rregullave bazë në mes të lojës politike e vret demokracinë. Mirëpo, në Tiranë, ligji bëhet si t'i teket një segmenti të parisë e më të fortit.

Nuk është se kjo sjellje nuk ka prapavijë politike lidhur me të ardhmen e "lojës" së Sali Berishës. Duke ndërruar rregullat e lojës mbas ndeshjes, Sali Berisha po e shtyn Edi Ramën që të dalë në rrugë e të përplasat me shtetin, që tashmë e kontrollon Sali Berisha. Këtë ai e bën me qëllim dhe me një llogaritje afatgjatë. Kështu ai i del përpara planeve të Ramës për të kërkuar zgjedhje të parakohshme. Me mbështetje apo pa mbështetje militantësh, sherri ka filluar e me kohë do të intensifikohet e zbutet simbas zgjidhjes që do të mund t'i japin të huajt. Por, në Tiranë, jo gjithnjë shkon

loja si llogaritet ne fillim. Tash që ka dalë dreqi nga shishja edhe pse pasi të arrijë diçka, Sali Berisha do të jetë gati për kompromis (ai thjesht i jep Edi Ramës diçka që është e tij dhe i takon me ligj), Edi Rama nuk ka rrugë tjetër veçse që të luftojë për zgjedhje të parakohëshme. Po vazhdoi sherrin me Sali Berishën në rrugë, Edi Rama humbet vetë dhe PS humbet para ndërkombëtarëve.

Po nuk e vazhdoi sherrin dhe po nuk pati marrëveshje, del nga loja politike vetëm Edi Rama dhe klanet e tjera dalin në krye të PS. Kështu, Edi Rama e humbet rolin kryesor brenda PS-së. Sido që të ndodhë, Sali Berisha llogarit që të ketë përballë një PS të dobësuar e të lodhur dhe, kur të marrë maksimumin që mundet, do ta mbyllë sherrin e kështu nis cirku për të gjetur fajtorët që të marrin përgjegjësinë.

Përfundim

Ajo që duhet vënë në dukje, është se, shqiptarët bënë zgjedhje të pranueshme lokale. Paria i vuri flakën vendit. Zgjidhjen e krizës së thellë politike do ta gjejnë të huajt, sepse në një shtet pa sovranitet, atyre iu takon ta gjejnë. Në këtë shkrim, u mundova të vë në dukje se vetëm faktori ndërkombëtar kërkoi e kërkon qetësi e stabilitet. Populli kërkoi e kërkon stabilitet. Paria dytësore po ashtu kërkoi e kërkon stabilitet.

Po pse ndodh shërrin që minon demokracinë? Zgjedhjet treguan se kishte vetëm një faktor që kërkonte sherr para e pas zgjedhjeve. Ai faktor ishte paria. Pra, ka rëndësi edhe se si nisi shërrin e kush e nisi e, jo vetëm se si do të mbyllet. Shërrin, pra, nisi e po ndodh sepse paria iu ka dalë haptazi kundër interesave e sjelljes së popullit. Ajo nuk pyet as për të mirën e popullit, ajo nuk pyet për interesat e parisë dytësore, as për të huajt, as për shtetin e kombin. Tash, është e qartë se shkakun kryesor dhe i vetëm i shërrit dhe i gangrenës politike është paria. Paria e mban popullin e vendin dhe të ardhmen peng. Sido që të shkojnë edhe këto tensionet mbas zgjedhjeve, është e qartë se edhe këto zgjedhje provuan se paria nuk punon për shqiptarët, por vetëm për interesat e saj të ngushta.

MANIPULIMI I REALITETIT: PARADOKSET E ZGJEDHJEVE LOKALE TË 8 MAJIT 2011

Këto zgjedhje lokale do të mbahen mend si njëra nga zgjedhjet më të mira që populli shqiptar ka zhvilluar gjatë tranzicionit. Siç edhe e kam vënë në dukje në analizën e mësipërme, këto zgjedhje do të mbahen mend si për sjelljen më pozitive e, pse jo, edhe shpresëdhënëse, të elektoratit shqiptar, ashtu edhe për sjelljen aspak të moralshme të parisë së Tiranës. Sjellja e parisë, e motivuar vetëm e vetëm nga interesat personale e klanore të prijatarëve, kontraston shumë me sjelljen e të gjithë shqiptarëve. Këto zgjedhje treguan që, edhe pse shoqëria shqiptare është në krizë të thellë, prapë se prapë, brenda saj ka shumë elemente pozitive e që të japin shpresë. Mësimi më i rëndësishëm që doli prej tyre, është që shqiptarët duan që demokracia, sado e papërsosur që të jetë në kushtet shqiptare, të mund të funksionojë sa më mirë që të jetë e mundur.

Gjithashtu, këto zgjedhje lokale, do të kujtohen e do të analizohen edhe për një numër paradoksesh të lidhura me shkallën e manipulimit të realitetit nga paria e të gjithë niveleve. Këto paradokse nuk janë të veçanta për shqiptarët. Ato ndeshen në shumë kontekste të tjera dhe, në një farë mënyre, janë pjesë e normalitetit të politikës në shumë vende afrikane dhe në republika bananesh. Shumë popuj jetojnë në sisteme ku shkalla e manipulimit të realitetit nga paritë e tyre, është tejet e sofistikuar. Mirëpo ka pak raste ku manipulimi i realitetit është kaq i hapur, i pasofistikuar dhe i pafytyrë.

Megjithatë, në kontekstin shqiptar, këto paradokset e manipulimit të realitetit janë të shumë të rëndësishëm për të evidentuar rolin

që luan paria e Tiranës. Po ashtu, këto paradokse shërbejnë për të evidentuar disa dukuri e zhvillime të reja të marrëdhënieve midis parisë së Tiranës dhe parive dytësore. Intensiteti, me të cilin u manifestuan këto kontradikta të papajtueshme, midis gjendjes reale dhe përshkrimit të saj nga paria, ishte i jashtëzakonshëm. Në këtë drejtim, shteti shqiptar është një version i ri i 1984-ës. Përprjekja e prijatarëve dhe e mjeteve të informimit në shërbim të tyre, për të detyruar shqiptarët që të jetojnë në një realitet virtual, ishte e jashtëzakonshme, koherente dhe ngulmuese.

Parimet themelore, mbi të cilat duket se është e ndërtuar kjo sjellje, janë të rreshtuara më poshtë. Së pari, partitë përcaktojnë një mesazh të qartë dhe të përbashkët në të gjithë zonat, që bazohet në dasitë tradicionale. Së dyti, kandidatët paraqesin argumentin që vjen nga Tirana, ashtu si iu pëlqen votuesve militantë dhe mbështetësve të tyre në një zonë të caktuar, duke iu përmbajtur në vija të trasha mesazhit që vjen nga Tirana. Së treti, çdo gjë duhet të jetë në funksion të fitimit të votës. Së katërti, faktori që vendos zgjedhjet të mbetet struktura klanore dhe klienteliste, që mbështet një kandidat. Prandaj, zgjedhjet do të zhvillohen duke mbajtur parasysh interesat e klaneve lokale dhe në shërbim të klaneve lokale.

Në një farë mënyre, në parimet që zbatohen, strategjia e parisë nuk ka ndonjë dallim nga strategjitë e partive perëndimore, apo nga fushata që bëhet nga kompanitë e mëdha për të tregtuar prodhimet e tyre. Mirëpo, partitë në Europë ose diku tjetër, përpiqen që të bindin opinionin publik. Prania e makinerisë oligarkike është e dukshme edhe në nivel të qyteteve të mëdha si Chicago, Paris apo Munchen. Mirëpo, manipulimi i realitetit, në rastin shqiptar, shkon deri në mashtrim të hapur. Sapuni shitet për djathë. Për të ndodhur një dukuri e tillë, duhet që njerëzit të pajtohen me premisën e gjykimit të parisë, pra, duhet që ata të jenë të paafte të gjykojnë si duhet. Mirëpo, ky nuk është një shpjegim i bindshëm. Këta që i bëjnë pazaret janë të gjithë me shkollë të lartë. Nga ana tjetër, shpjegimi është se ka një mirëkuptim paraprak midis mashtruesit e të mashtruarit. Pra, çelësi i shpjegimit duhet kërkuar tek rregullat e sjelljes dhe tek normat shoqërore, pra, tek

mendësia e përbashkët e të dy palëve.

Si duhet kuptuar kjo gjë? Si hap i parë duhet thënë se ka një dallim shumë thelbësor midis shkallës deri ku mund të shkohet me manipulimin e realitetit, në fushën e politikës dhe në fushën e *marketing*. Shembulli më i mirë është krahasimi midis sapunit dhe djathit. Një prodhues sapuni duhet të nxjerrë në pah cilësitë e sapunit. Ai nuk mund të thotë se sapuni mund të hahet si djathë. Nga ana tjetër, një shitës djathi mund të shesë djathin për sapun, sepse mund të thotë që, edhe pse djathi të lë me erë, larja me djathë zhduk shenjat e melanomës, e mban lëkurën e pastër. Apo, po të jetë i zgjuar, i gjen edhe shumë cilësi të tjera të djathit, që janë të mira për shëndetin e njeriut. Pra, e vërteta mund të përdridhet deri në një pikë të caktuar, por logjika duhet të çojë në një përfundim të caktuar, që është i besueshëm dhe i pranueshëm sepse është logjik. Ndryshe, kur nuk ekziston kjo lidhje, përpjekja për të të shitur sapunin për djathë, quhet mashtrim i hapur.

Mirëpo, që mashtrimi të pranohet si fakt dhe si i pakontesueshëm, duhet që prijatarët të dinë se çfarë mendon populli e në çfarë niveli mund të mashtrohet dhe mandej ta bindin popullin që të pranojë mashtrimin. Njerëzit kanë tendencën që të besojnë atë që duket e pranueshme në mendjen e tyre. Kur paritë ofrojnë informacion që, sistematikisht, është qëllimisht i pasaktë, i paplotë, i gabuar ose rrenë e pastër, qytetarët mund të krijojnë përshtypje të gabuara lidhur me alternativat. Me kohë, një numër i tillë rrenash apo perceptimesh të gabuara bëhet një sistem koherent dhe perceptimi i qytetarit është, sistematikisht e në mënyrë koherente e konsistente, i deformuar. Njeriu i thjeshtë jeton në realitet absurd.

Në rastin shqiptar, manipulimi i realitetit, si dhe këto paradokse, që janë ndërtuar mbi rrena të pastra, janë të rëndësishme. Ato shërbejnë si tregues domethënës të krizës së thellë të shtetit, të shoqërisë shqiptare, të dështimit të tranzicionit. Mbi të gjitha, ato janë tregues i papërgjegjshmërisë politike të parisë sunduese të Tiranës dhe i këmbënguljes me të cilën paria po mbron interesat e saj. Shqiptarët jetojnë në një realitet absurd dhe këto paradokse prekin si absurdin e rrenës politike ashtu edhe të gjendjes.

Ndër paradokset më të spikatura, dhe që mendoj se do të duhet të debatohen më me kujdes në të ardhmen, thjesht sepse janë tregues të qartë të gjendjes ku është demokracia dhe shoqëria shqiptare, janë edhe këto gjashtë paradokset e rreshtuara më poshtë. Natyrisht ka edhe shumë paradokse të tjera. Por, kur shihet pylli, pse duhen numëruar edhe pemët? Një aspekt tjetër i rëndësisë së tyre është edhe lehtësia me të cilën mund të mbështetet argumenti që zhvillohet këtu. Këto paradokse janë qartësisht të evidentueshme edhe me një analizë krejtësisht të përciptë të procesit politik, nga cilido analist apo komentator, por edhe nga njerëzit e thjeshtë.

Gjendje kritike dhe premtime idilike

Së pari, edhe pse vendi është në një krizë të thellë ekonomike, politike e shoqërore, premtimet e bëra nga paria e Tiranës, dhe nga paria dytësore, ishin në nivele tragjikomike. Premtimet e bëra për fushatat lokale ishin të pabesueshme, të parealizueshme dhe demagogji e pastër. Kështu, për shembull, në programin elektoral të kandidatit të PD-së për Bashkinë e Tiranës, Lulëzim Basha, ndër të tjera thuhet,

“Misioni im është hapja e 30 mijë vendeve të punës në dy vitet e ardhshme. Për të krijuar më shumë punësim, dhe punësim me pagë më të mirë, ne duhet të nxisim ekonominë, duke ndihmuar hapjen e bizneseve të reja dhe zgjerimin e atyre ekzistuese. Si Kryebashkiaku juaj, unë do të heq rreth 60 taksa dhe tarifa vendore dhe do të ul 2 deri në 5 herë taksat dhe tarifat që mbesin.”

Po, si do t'i hapë Lulëzim Basha 30,000 vende pune? Sa vende pune hapi kur drejtonte një ministri apo një tjetër, dhe kur kishte në dispozicion fonde të paimagjinueshme si ministër transporti? Aq më shumë, si do t'i hapë 30,000 vende pune, kur premtonte heqjen e 60 taksave dhe tarifave, si dhe uljen deri më 80% të taksave që mbesin, e në të njëjtën kohë premtonte edhe rritjen e rrogave? Këto premtime demagogjike, e pa asnjë bazë në realitetin

objektiv, flasin vetë. Por, edhe më demagogjik është programi me premtime i kandidatit për kryetar bashkie në Fier, një qytet me rreth 120,000 banorë, të Partisë Republikane,

“Ne, së bashku me ekipin tim, do të punojmë që Fierin, nga qyteti i të papunëve ta kthejmë në qytetin e shpresës, duke hapur 12 500 vende të reja pune. Projekti është gati dhe po presim datën 9 maj për të filluar implementimin e tij. Ne do punojmë për qytetarin dhe pikërisht nga këta të fundit kanë ardhur shqetësimet për taksat e larta që godasin biznesin. Me marrjen e detyrës së kryebashkiakut, do të rishikoj në mënyrë urgjente taksat e vendosura nga bashkia, duke hequr ato taksa që janë parazitike dhe duke ulur një pjesë tjetër, në mënyrë që t’i japim frymë biznesit të vogël dhe të mesëm dhe të hapim vende të reja pune.”

Nga një anë, gjendja ekonomike e vendit nuk duket aspak shpresëdhënëse. Edhe me një vështrim të përciptë, të dhënat që botohen në shtypin e përditshëm tregojnë një gjendje krize të thellë e që po acarohet në mënyrë intensive. Kandidatët tregojnë përralla demagogjike dhe janë duke tregtuar ëndrra të perealizueshme. Në fitojnë ose humbin, mirë do të ishte që t’ua kalojnë fitimtarëve planet e tyre për vendet e punës.

Edhe një vështrim i përciptë i gjendjes ekonomike tregon se situata është duke u rënduar. Kështu, sipas INSTAT, niveli i punësimit ka rënë me 5.9%, në krahasim me vitin e kaluar. Kjo do të thotë se, duke lënë mënjanë ata që nuk kishin punë as vitin e kaluar, një në 16 shqiptarë nuk e ka punën që e kishte vjet. Gjatë vitit 2010, borxhi i shtetit u rrit me 500 milionë dollarë të tjerë. Nga ana tjetër, inflacioni është rritur me 4.7% zyrtarisht, e realisht, në formën e rritjes së çmimeve, inflacioni ka shkuar edhe më lart. Edhe më me rëndësi, sipas Bankës së Shqipërisë, në krahasim me vitin e kaluar, të ardhurat nga mërgimtarët, përmes dërgesave në rrugë të verifikuara, janë pakësuar me rreth 15%. Po kështu, në prill 2011 defiçiti tregtar u rrit me 19.5% në krahasim me vitin e mëparshëm. Eksportet ranë me 16.3%, në krahasim me marsin e viti 2010.

Kjo është një gjendje krize, që po thellohet përditë. Kriza nuk ka kaluar pa lënë gjurmë edhe në marrëdhëniet e shtetit shqiptar me tregjet e me bankat ndërkombëtare. Shteti shqiptar formalisht humbi një shkallë tjetër në klasifikimin lidhur me besueshmërinë e marrjes borxh. Prandaj, shteti u detyrua që të marrë një hua shtetërore me interes shumë të lartë. Edhe në këtë kohë, shteti është krejtësisht i dëshpëruar për të ardhura. Qeveria po përgatitet që të shesë, apo “të privatizojë” edhe 1280 objektet e fundit në pronë të shtetit. Mirëpo, kandidatët flasin për figura e për projekte marramendëse.

Si duhet interpretuar kjo gjendje paradoksale? Në një vend që mbahet me të ardhurat nga mërgimtarët, ku prodhohet pak, ku mungon baza e mirëfilltë industriale dhe ku vetëm të ardhurat nga krimi janë në rritje, kjo është një gjendje krize tejet e vështirë, që do të vijë duke u thelluar. Rruga e vetme e daljes nga kriza është ndërtimi i një ekonomie që prodhon dhe që, kur është ekonomi e shëndoshë, eksporton më shumë se importon. Por, sistemi ekonomik në shtetin shqiptar nuk mbështetet në prodhimin kombëtar. Prandaj edhe mundësitë e ripërtëritjes ekonomike e të daljes nga kriza, me politikat e brendshme, janë tejet të pakta. Ky thellim i krizës së përgjithshme, që është e paevitueshme, është edhe fillimi i fundit të sistemit të ndërtuar prej parisë. Sistemi ekonomik është i ndërtuar në shtyllat e mëposhtme. Më e keqja është se të gjitha shtyllat mbi të cilat është ndërtuar ekonomia janë duke marrë goditje të përnjëherëshme dhe nga të gjitha anët.

Së pari, sistemi mbështetet në marrjen e borxheve me kredi të ulëta nga ana e shtetit. Këto borxhe, shpesh me afate pagimi deri në 25 vjet, janë të lakmueshme prej politikanëve që, nga ana e tyre, ua kalojnë barrën e pagesës brezave e qeverive të tjera, që do të vijnë mbas tyre. Mirëpo, si me të gjithë borxhet, interesi paguhet gjatë shumë viteve të para. Borxhi i vërtetë paguhet pasi paguhet interesi. Në përfundim, në rastin e borxheve afatgjatë, të gjithë shqiptarët duhet të paguajnë të paktën 150% ose edhe dyfishin e shumës që është marrë borxh. Paketimi dhe shitja propagandistike e borxheve, njëlloj si në fillimet e viteve 1990-të, bëhet duke i quajtur “donacione”, “grante”, “ndihma të huaja”

e me rradhë. Mirëpo, këto janë thjesht shtrembërime të realitetit. Këto borxhe duhen paguar dikur e do të paguhen deri në fund. Më e keqja është se shumica e parave të marra borxh shkon për të paguar po ata struktura financiare që i ofrojnë këto borxhe. Më kohë, interesi bëhet i papërbalueshëm dhe shteti gjendet, lehtësisht, në prag të falimentimit. Në rastin tonë, vetëm gjatë vitit 2011 do të paguhen 600 milionë dollarë interes, për të qenë në rregull me borxhdhënësit.

Së dyti, shteti është mbajtur me shitjen e pasurisë kombëtare. Deri më tani, paria e Tiranës e ka parë çmontimin e shtetit dhe të sektorëve strategjikë të ekonomisë si burim kryesor të ardhurash. Privatizimi i sektorëve strategjikë është ndër rrugët më të shpejta të mbledhjes të të ardhurave nga paria. Privatizimi i sektorëve strategjikë ekonomikë ka qenë sistematik dhe ishpejtë. Mbi të gjitha, energjia, infrastruktura financiare, minierat, telekomunikacioni, apo sipërmarrjet për ndërtimin e infrastrukturës janë justifikuar me petkun ideologjik dhe me argumente si “tregu i lirë”, “konkurrenca” e të tjera. Mirëpo, vetëm bankat e huaja nxorren një fitim rreth 350 milionë dollarë gjatë vitit të kaluar. Në shtyp përmendet kalimthi se vetëm kompania që ka koncesionin e kromit ka nxjerrë deri tani një fitim rreth 500 milionë dollarë. Kur të bëhet një analizë e pasurisë kombëtare, që sjell fitim të pastër për të huajt, shuma me të cilën përballemi, është me të vërtetë marramendëse. Shteti shqiptar është një pus pasurimi pa fund. Por, këto para nuk shkojnë në xhepat e shqiptarëve.

E njëjta gjë mund të thuhet për koncesionet e tenderat e panumërt, që janë kthyer në burim të pastër fitimi për monopolet e huaja. Asgjë më mirë nuk e sqaron këtë gjendje se sa ndërtimi i rrugëve. Mjafton të shihen shpenzimet për “Rrugën e Kombit,” “Rrugën e Arbërit,” “Rrugën e Elbasanit,” për stadiumin kombëtar e me rradhë. Norma e fitimit që nuk duhej të kalonte 20% të shpenzimeve në fakt është marramendëse. Cilësia, megjithatë është shumë e ulët dhe jo në parametrat që janë premtuar. Shto këtu faktin që paratë që merren borxh do të paguhen me interes, shpesh mbi 8-9%. Por, kjo është mënyra e përfitimit e parisë që, përmes një sistemi korrupsioni të

sofistikuar, zhvat pjesën e luanit të investimit.

Së treti, ekonomia shqiptare mbështetet në ndërtimin e skemave piramidale dhe të fluskave të shumta ekonomike në fusha të ndryshme nga ndërtimi tek arsimit. Fluskat janë bërë të sofistikuara dhe, në një farë mënyre, e kanë paralizuar shoqërinë. Për shembull, statistikat flasin për dhjetra mijëra studentë universitarë. Edhe sivjet, paradoksi është se numri i studentëve që u regjistruan në universitete ishte pak më i lartë se rritja vjetore e popullsisë. Mirëpo, shteti shqiptar është një shtet që nuk hap dot vende pune. Edukimi është ekonomia për profesorët dhe pronarët e këtyre universiteteve, por jo për shoqërinë. Universitetet janë punishte diplomash, që vyejnë vetëm për të vjelur të ardhurat nga populli. Çdo vit, në piramidën e edukimit kalojnë rreth 400 milionë euro, por nga universitetet deklarohen vetëm 40 milionë euro. Kjo do të thotë se me një pagesë mesatare prej 3,000 Euro në vit, në të 58 universitetet private nuk duhet të ketë më shumë se 13,500 nxënës në të katër vitet. Por, vetëm sivjet janë regjistruar 28,000 studentë. Pra, shpjegimi duhet kërkuar diku tjetër. Duke vepruar kështu, qeveria pranon humbjen e taksave, mbron palët e parisë që kanë hapur punishtet arsimore, e shtyn duke ruajtur paqen shoqërore edhe katër vjet, mërgimtarët e ardhshëm përgatiten për t'u hedhur në tregun e huaj, mijëra profesorë dhe doktorë po fitojnë nga tranzicioni dhe mbyllin gojën, si dhe njerëzit qetësohen, sepse iu kanë dhënë "edukim e shkollim" universitar fëmijëve. Ky formim, më e shumta, mund t'u hyjë në punë kur të shkojnë në Greqi apo në Itali. Më mirë do të ishte t'i edukonin që të bëheshin mekanikë, kuzhinjerë, apo mirëmbajtës ndërtesash. Me 12,000 euro investim në bankë, përfitimi me 6 përqind do të ishte 60 euro në muaj. Kështu, me që në universitete nuk mësohet gjë, të paktën, do të mund të mbulonin shpenzimet që konsumohen prej fëmijëve të tyre gjatë viteve të gjata të papunësisë për gjithë jetën.

Së katërti, larja e parave të pista dhe futja masive e parave të drogës, të prostitucionit e të kontrabandës. Flitet për shumë familje të fuqishme mafioze shqiptare, për përfshirje masovike të shqiptarëve në rrjetet e kultivimit, të trafikimit e të shitjes së drogës në të gjithë vendet. Por, të gjitha këto para, që fitohen në

këto rrugë kriminale, janë një pjesë e rëndësishme e ekonomisë. Vilat, makinat dhe pronat më të dukshme i kanë pikërisht ata që merren me këtë veprimtari jo të ligjshme. Por, shpenzimet i bëjnë në shtetin shqiptar dhe aty i hedhin paratë e tyre.

Së pesti, e mbi të gjitha, në futjen e shumave të mëdha të të ardhurave nga mërgimtarët. Nga shteti shqiptar kanë emigruar 45.4% e popullsisë, një shifër me të vërtetë tronditëse. Në rrugë që mund të ndiqen zyrtarisht, përmes bankave e sistemit të dërgesave, sivjet pritet që të transferohen nga mërgimtarët dikund rreth 700 milionë eurove. Mirëpo, shumica e mërgimtarëve i sjellin paratë vetë, dhe nuk duan të paguajnë tarifa që shpesh i afrohen 8-10% të shumës së transferuar. Prandaj, është më mirë që kalkulimi të bëhet në një mënyrë tjetër duke llogaritur që të paktën katër-pesëfishi i kësaj shumë vjen dorazi. Aq më shumë që shumë mërgimtarë i kanë të gjithë kursimet e jetës të investuara në ndërtime, toka, prona etj. në shtetin shqiptar dhe jo të gjithë i kanë dërguar paratë me banka, me *MoneyGram* apo me kompani të tjera. Dikush i ka blerë ato 300,000 banesa që janë krejt bosh. Prandaj, me rreth 1,000,000 shqiptarë në gjendje pune në botën e huaj, ekonomia është e varur tërësisht nga të ardhurat e mërgimtarëve. Mirëpo, në shtyp përmendet se vetëm gjatë këtij viti janë kthyer rreth 150,000 mërgimtarë nga Greqia. Edhe pse shumë prej tyre mund të jenë punëtorë sezonalë, numri i të kthyerve përgjithmonë është i jashtëzakonshëm. Shumë më shumë të tjerë do të kthehen vitin e ardhshëm, duke krijuar një gjendje eksplozive. Paria po i del përpara punës duke forcuar aparatën e dhunës, policinë dhe duke e shtuar me 1,000 policë të tjerë, një rritje me 8% të forcës së tanishme. Mirëpo, gjendja do të vijë duke u përkeqësuar.

Së gjashti, prodhimi kombëtar ka pësuar një rënie të ndjeshme. Kjo ndjehet në fushën e ndërtimeve, ku mungesa e likuiditetit dhe e shitjeve e ka paralizuar të gjithë sektorin. Në Tiranë flitet për 30,000 apartamente të pashitura dhe në Durrës llogariten diku rreth 10,000-15,000 apartamenteve të pashitura. Në sektorin e shërbimeve flitet për miliona turistë, por shumica rrinë një ditë e pjesa tjetër janë shqiptarë nga trojet e tjera, apo mërgimtarë me pasaporta, që numërohen nga tre herë nëse shkojnë në Ohër, në

Korfuz apo në Ulqin e kthehen prapë në darkë.

Së shtati, ndihmat dhe investimi i huaj po ashtu ka rënë e po vazhdon të bjerë me shpejtësi. Kjo shihet jo vetëm në zërat e FDI (investimi direkt ngajastë) por edhe në mundësitë e marrjes borxh nga shteti. Nuk është pa domethënie që edhe norma e interesit të marrjes së parave borxh po rritet në kufinj shqetësues.

Mundësia e hyrjes së parave nga të gjitha këto rrugë po vjen duke u tkurrur me shpejtësi. E prandaj, tashti e mbrapa paria ka dy rrugë kryesore për të mbajtur më këmbë ngrehinën institucionale dhe për të përballuar detyrimet. Nga një anë ajo duhet të fillojë e të hajë veten. Këtë paria nuk do ta bëjë sa kohë që ekziston mundësia e vjeljes të të ardhurave nga shoqëria. E dyta është që paria do të synojë që ta hedhë barrën e vështirësive mbi shqiptarët. Ajo do ta bëjë këtë duke vendosur taksa të reja mbi mjetet, mbi pronat (që atëherë duhet të ligjërohen) e mbi bizneset e vogla e të mesme. Mirëpo, kjo politikë do të fusë të gjithë ekonominë në një rreth të mbyllur, ku gjërat do të vazhdojnë që të përkeqësohen sistematikisht e gradualisht dhe në të gjithë shtetin në të njëjtën kohë. Shkurt, situata ekonomike e shoqërore në shtetin shqiptar është e rënduar, për të mos thënë katastrofike e tragjike. Në shtetin shqiptar nuk ka ekonomi të mirëfilltë dhe kriza do të jetë e rënduar.

Premtimet elektorale, megjithatë, ishin për projekte marramendëse e krejtësisht të pabesueshme. Le të lëmë mënjanë sloganet e nivelit të rrugës *"Shqipëria është e Bukura e Dheut"* e të tjera shprehje të demagogjisë elektorale të tipit Munchauzen. Këto forma të demagogjisë së shfrenuar janë pranuar si normale. Por, miliardat që u prematuan për rrugë, për projekte turistike, ura, tunele, fshatra turistike, etj., në të gjitha bashkitë e komunat që tashmë shihen si me të ardhme të sigurtë në fushën e turizmit, përfshirë këtu edhe disa qendra ish-fermash e kooperativash, të shpallura si zona me të ardhme për turizmin ndërkombëtar si Bilishtin, Ballshin e Dumrenë, nuk dihet nga do të vijnë.

Niveli i kapjes së shtetit nga paria është tronditës. Shteti është i falimentuar, por qeveria bën amnisti fiskale, thjesht për qëllime elektorale. Paradoksi është se shteti shqiptar lyp para gjithkrah

e nuk i jepet borxh, por prapë, në fushatë, zyrtarët premtojnë tunele, rrugë që nuk të çojnë në fabrika apo uzina por në fshatra të humbur ose tek shtëpia e deputetit apo e kryetarit të komunës.

Këto nuk janë investime që hapin punë. Edhe kur hapin punë këto janë projekte në shërbim të sipërmarrësve të lidhur me pushtetin. Këto projekte u shërbejnë që t'ua bëjnë jetën më të lehtë atyre që kanë mënyra të tjera jetese, pra, i shërbejnë kryesisht parisë dhe shërbyesve më të afërt të saj.

Flamuri i unitetit dhe thellimi i prekshëm i dasive politike e shoqërore

Së dyti, në sipërfaqe, duket sikur që të dy koalicionet politike zhvilluan një fushatë mbarëkombëtare, në sipërfaqe të kontrolluar nga partitë me shtrirje kombëtare. Në këtë drejtim, kishte një përpjekje të dukshme, për të ruajtur apo për të fituar mbështetje sa më të gjerë popullore. Megjithatë, nuk mund të mos vihet re se ndarjet fshat-qytet e Jug-Veri ishin shumë të qarta dhe të theksuara fort. Në fakt, ndarjet ishin shumë më tepër të theksuara se sa në zgjedhjet e tjera të mëparshme.

Nuk është ekzagjerim me thënë se Aleanca për Qytetarin fiton vetëm komunat e fshatrave apo të lokaliteteve të vetëquajtura qytete mbas vitit 1990-të. Kjo mbështetje fshatare për AQ u vërejt në nivel kombëtar. Në sipërfaqe, duket sikur ka një paradoks, sepse, u vërejt se AQ fitoi shumë vota në qytete si, bie fjala, në Tiranë. Megjithatë, u vërejt se edhe ato vota që AQ i fitoi në qytete, ky formacion i fitoi me katundarët e me fshatarët e rënë nga malet. Nga Vermoshi në Leskovik, nga Tropoja në Bilisht, harta e fitores së AQ-së ndjek vijën e vargmaleve që, me thënë të drejtën, janë njëlloj si në Jug ashtu edhe në Veri.

Pavarësisht mburrjeve të disave, shteti shqiptar është vendi i maleve të thepisura dhe, prandaj edhe i malokëve, d.m.th., i atyre katundarëve që ose jetojnë në malet, ose vijnë nga malet. Shqipëria është e mbushur me male, me aq shumë male, sa me përjashtim të Shkodrës, e të zonës bregdetare, shumica e qyteteve janë në male e këtu nuk bëjnë përjashtim edhe qytete bregdetare, si Vlora edhe

Saranda që janë në rrëzë të kodrave e maleve. Aq shumë kemi qenë të lidhur me malet, veçanërisht në Jug të vendit, sa edhe qytetet si Gjirokastra e Berati i kemi ndërtuar në male, bile sa më të thepisura, aq më të dashura për ne. Nga ana tjetër, shumica dërmuese e qyteteve (me përjashtim të qytetit më të madh fushor të vendit, Shkodrës, aq fushor sa përmytet pesë herë në vit), u fituan nga Aleanca për të Ardhmen.

Kjo dasi e thelluar midis fshatit dhe qytetit, nuk e zbeh fare dasinë e thelluar edhe më shumë këto vitet e fundit, dasinë Jug-Veri, Toskëri e Gegëri. Në masë dërmuese qendrat kryesore të Jugut votuan për AA e ato të Veriut votuan për AQ. Po të lëmë mënjanë Bilishtin e Hasin, Shllakun, Temalin e Lekbibajn, shihet qartë se mbështetjet politike për koalicionet janë edhe në baza rajonale. Jugu voton në masë për PS-në. Por, Veriu voton në masë për PD-në. Edhe më qartë, harta elektorale tregon që, si normë, PS merr qytetet e PD merr fshatrat, por edhe qytetet, kur janë të katundarizuara.

Ky thellim i dasive politike është një problem i mprehtë politik e shoqëror, që nuk duhet anashkaluar lehtë. Tashmë, shqiptarët kanë nisur që të ecin në rrugë të kundërta dhe është më e lehtë që të shtyhen për t'u përplasur me njëri-tjetrin. Këtu nuk mund të mos vihet re se strukturat feudale politiko-partiake, të manifestuara në formën e pashallëqeve partiake, janë të konsoliduara, po ashtu, edhe në baza rajonale. Pavarësisht se kush është në krye të klanit respektiv, Ridvan Bode apo Stefan Çipa, Qazim Sejдини apo Jozefina Topalli, influenza e qendrës në zona e në rajone të caktuara është e kufizuar, për shkak të funksionimit efektiv të makinës elektorale lokale, që tashmë duket se është e konsoliduar në duart e klaneve, me bazë të fortë lokale. Shembulli më i mirë është zgjedhja e kryetares së bashkisë në Burrel. Ajo ishte një figurë e nderuar në qytet dhe u zgjodh me mbështetje të gjerë lokale, edhe përkundër sugjerimeve e presioneve të Tiranës.

Partitë, mjetet e propagandës e mediat janë në Tiranë, por makinat politike lokale janë shumë më të konsoliduara dhe veprojnë me një autonomi të theksuar nga paria. Feudalizimi i partive politike ishte një dukuri që u vu re qartë në vitin 2007.

Tashmë, ky është një fakt shoqëror, që do të ketë influenca mbi marrëdhëniet politike, mbi ristrukturimin e parisë, ashtu edhe mbi rolin që do të luajnë interesat ekonomike e identitetet e grupeve të caktuara në të ardhmen.

Fushata është thellësisht “ideologjike”, por zgjidhjet që ofrohen janë pragmatike

Fushatat ishin thellësisht “ideologjike”. Kundërvëniet ishin si gjithnjë të mbështetura në dasinë e hapur apo të nënkuptuar, *komunistë-antikomunistë*. Kjo dasi, shpesh e maskuar keqazi me termat e pakuptimtë “të djathtë” e “të majtë” është në qendër të politikës shqiptare sepse ndihmon në mobilizimin e masës së militantëve të dy palëve. Ka militantë që ende besojnë tek prijatarët e parisë, por ka edhe shumë të tjerë që kërkojnë të maskojnë qëllimet e tyre pragmatike e arriviste, me pretextin e vazhdimin të një luftë imagjinare me “armikun imagjinar”, ose që janë në marrëdhënie të pastra klienteliste me elementë të parisë në të gjitha nivelet. Hipokrizia e kësaj sjelljeje është e dukshme kur përkujtohet që, në shumë raste, ai armik që luftojnë sot është e shkuara e tyre personale, d.m.th., vetvetja.

Këto terma që përkufizojnë grupet mbështetëse të parisë mund të ishin edhe “rozë” e “blu”, “karafila” e “vjollca”, por ngjyra nuk ka rëndësi. Identifikimet janë thjesht të mbështetura në ndarjen mik-armik dhe përcaktimi bëhet në bazë të lidhjes që ka votuesi me parinë. Në nivelin ideologjik, këto koncepte nuk kanë pikë kuptimi. Me kohë, para dhe gjatë fushatës, AQ dhe AA ngritën një numër çështjesh pseudo-ideologjike. Të dy koalicionet i përdorën këto probleme fiktive thjesht për të futur pishat e për të ndarë popullin, duke luajtur me simbolet dhe duke e mbajtur sherrin në nivelin simbolik. Duke i cytur e duke i shtyrë njerëzit që të identifikohen me të shkuarën e një grupi shoqëror ose të një tjetri, AQ dhe AA synuan që të bëheshin monopolizuesit e një tradite të caktuar politike dhe të mblidhnin votat e mbështetësve tradicionalë e të militantëve.

Kështu, përmendja e lidhjeve familjare të disa udhëheqësve

e deputetëve të PS-së me figura qëndrore të sistemit të shkuar, pjestarë të parisë. Këtu vlen të përmendet edhe përcaktimi si “neoblokmenë” i udhëheqësve të rinj të PS-së. Duke e lidhur çdo gjë me Bllokun, Sali Berisha dhe PD e lënë veten jashtë lidhjes me parinë e vjetër, krijojnë e përforcojnë një lidhje të fuqishme simbolike në politikë, ngushtojnë grupin që ka vënë në shënjestër dhe mobilizon me lehtësi mbështetësit e vet. Në këtë përzgjedhje hyjë edhe ngritja e çështjes së Piramidës (Mauzoleumit të Enver Hoxhës) e të ndërtimit të parlamentit, theksimi i krimeve të sistemit të dikurshëm, por edhe vënia në qendër e përvojave të hidhura të të perndjekurve, botimi i rregullt i kujtimeve nga burgu e me rradhë, ishin taktika mobilizuese të ndjekura me konsequencë nga PD. Po ashtu, edhe kundërvënia nga PS nuk ishte e zhveshur nga simbolizmi ideologjik, anipse shumë më i fshehur dhe i paraqitur si kundërvënie ndaj sundimit të PD dhe të LSI, që u paraqitën si të zhveshura nga çfarëdo lloj përgjegjshmërie shtetërore e shoqërore.

Megjithatë, ra në sy se fushata ishte mirëfilli ideologjike vetëm në Tiranë dhe në mjetet e fuqishme të informimit të përqëndruara në kryeqytet. Fushata e koalicioneve dhe e politikanëve përfaqësues të tyre, formalisht ishte thellësisht ideologjike, por aty ndalej. Zgjidhjet e bëra e të propozuara nga kandidatët lokalë e nga qytetarët ishin tejet pragmatike dhe haptazi demagogjike. Si shpjegohet kjo? Platformat e partive ishin mbarëvendore, por zgjedhjet ishin krejtësisht lokale, pragmatike e të kontrolluara nga klanet e caktuara, shpesh të pavarura nga qendrat e partive në bazë të pazareve parazgjedhore. Në nivel lokal, ndarjet fiktive ideologjike në “komunistët kundër antikomunistëve” janë të tejkaluara dhe pragmatizmi i qytetarëve është krejtësisht i dallueshëm. Në shtetin shqiptar nuk bëhet më politikë me identitet, as me identitetin e rrënjosur nga sistemi tjetër, as me identitet kombëtar, por thjesht në bazë të interesave të kalkuluara me shumë kujdes.

Si shihet kjo gjë? Në të gjitha nivelet lokale shumica dërmuese e njerëzve u përqëndruan tek vetë kandidatët, tek strukturat e tyre. Pazari lokal elektoral ishte i bazuar krejtësisht në interesa immediate dhe në zgjidhjen e problemeve në atë nivel. Tregtia

me votat ishte shumë intensive dhe trami elektorale me votat përfshinte ndërtimet e legalizimet (ose premtimet për ndërtim, shfrytëzim, legalizim), përfitimet prej pushtetit qendror, vendet e punës dhe allishverishet e zakonshme, të luajtura sipas një politike klanore të rrënjosur thellë gjatë këtyre viteve e, tashmë, mbizotëruese në shtetin shqiptar.

Zgjedhje demokratike dhe politikanë të kriminalizuar

Një paradoks tjetër ishte edhe mundësia që u krijua për forca politike e për individë të veçantë, që të merrnin pjesë në zgjedhje dhe të provonin, si fuqinë e tyre politike, ashtu edhe mbështetjen që kanë në popull. Në lidhje me korrupsionin masiv e të gjithkundgjindshëm, këto vitet e fundit nuk kanë qenë të ndryshme nga vitet e shkuara. E megjithatë, ngjarje si Gërdeci, shitja e kufijve shtetërorë dhe e detit ku ka naftë e pasuri kombëtare, korrupsioni i hapur e i ligjëruar qeveritar, ngjarjet e 21 janarit e me rradhë duhej të linin një shenjë tek votuesit. Kudo tjetër, në çdo shtet tjetër, përpara se të zgjidhnin apo të mbështesnin individë të tillë të korruptuar e të kriminalizuar deri në palcë, votuesit normalë duhej të ishin menduar dy herë.

Ajo që ra në sy ishte mbështetja e madhe e marrë nga individë tërësisht të kriminalizuar apo të akuzuar për krime të përbindshme. Ndërsa Partia Demokratike mori vota më shumë, nga ana e vet, LSI fitoi 40 mijë vota më tepër se në vitin 2009. E kjo ndodh kur prijatarët e kandidatët e koalicionit qeveritar, Sali Berisha, Ilir Meta, Lulzim Basha e me radhë, janë të akuzuar haptazi për korrupsion. Nuk bën përjashtim as krahu tjetër. Një komunë si Libofsha, kthehet e voton për kandidatin e PS, edhe pse kontrolluesi i makinës elektorale atje, Dritan Prifti, është i akuzuar për marrje rushfeti të rreth 70,000 eurove kur ishte ministër i LSI-së, një skandal që Prifti e ka regjistruar me telefonin e vet.

Por paradoksi është se edhe pse votuesit nuk e dinë të mirën e tyre si njerëz e qytetarë të një shteti e të një bashkësie politike, demokracia mund të funksionojë edhe në këtë mënyrë të përcudnuar. Me sa shihet, votuesit shqiptarë votojnë pastërtisht

për interesin e tyre të ngushtë, thjesht sepse nuk shohin se kanë interesa të tjera të përbashkëta apo politikanë që t'i mbrojnë këto interesa të përbashkëta. Po t'u hapen sytë dhe të kuptojnë se e mira e përbashkët është edhe në të mirën e tyre personale, atëherë ata mund të votojnë ndryshe. Ajo që bie në sy është se votuesit nuk shiten më aq lehtë. Vetëdija e tyre shihet edhe në votimin për Tiranën, apo në raste të tjera si në Durrës kur votat për Këshillin Bashkiak u dhanë për një parti të caktuar dhe votat për kandidatin për Kryetar Bashkie u dhanë për dikënd tjetër.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm, që shpjegon shumëçka, është edhe politizimi në ekstrem i strukturave zgjedhore në të gjitha nivelet. Krahas politizimit, dallohet qartë edhe një nivel shumë i lartë i korrupsionit politik. Ashtu si komisionerët, edhe anëtarët e KQZ u paraqitën si të varur pa kushte nga politika. Me çka po shihet, edhe vendimi i Kolegjit Zgjedhor do të jetë i varur nga pazaret që do të bëhen në ditët e ardhshme. Kjo sjellje e elektoratit është një shenjë e qartë se kemi makina elektorale lokale, që kontrollohen prej parisë, por ky kontroll është tejte i brishtë dhe aleancat janë të përkohshme, të personalizuara, dhe të përcaktuara nga interesat e klaneve. Kur aleancat mbështeten në përfitimin material, atëherë gjithçka është punë çmimi. Mirëpo edhe mundësia e përplasjes midis segmenteve të parisë është shumë më e madhe.

Pra, nga një anë duhet thënë se politika është bërë biznes. Zgjidhjet që po bëjnë shqiptarët nuk janë të mbështetura në ndonjë besim në shtetin, në demokracinë, apo në vlerat e mirëfillta demokratike. Nga ana tjetër, aftësia e parisë së Tiranës për të siguruar mbijetesën e sistemit që ka krijuar varet nga mundësitë e saj për të ndarë të mirat materiale publike e për të garantuar interesat e parisë dytësore e të votuesve të kontrolluar prej saj më mirë se pala tjetër. E kjo nuk është një mundësi e pakufizuar e parisë apo një zgjidhje që pala tjetër nuk do ta kontestojë. Sa më të pakta bëhen kockat që duhet të ndahen, aq më e ashpër do të bëhet përplasia midis palëve të parisë së Tiranës.

Zgjedhje demokratike, por vendimet merren nga të huajt

Shqiptarët bënë zgjedhje demokratike, aq sa mundën e në kushtet që u krijuan nga paria. Por njerëzit që bënë zgjedhjet, u përdorën dhe u nëpërkëmbën nga paria. Zgjedhjet u mbajtën dhe e ruajtën dekorin e rregullit e të normalitetit vetëm e vetëm sepse të huajt vunë veton e tyre në çdo hap të procesit. Ishte jodinjitoze të shihje ambasadorët e huaj, deri edhe ambasadorin e Danimarkës, të premtonin, të kërcënonin, të ndanin lëvdata e të bënin premtime nga më qesharaket, si bie fjala, “hyrja e juaj në BE varet nga këto zgjedhje.”

Mbas një fushate intensive polarizuese, me të dyja segmentet e parisë të mprehura për të ndezur sherrin me njëri-tjetrin, dukej se këto zgjedhje nuk do të duhej që të mbaheshin fare. Ndërhyrja e paprecedent e pranisë ndërkombëtare, që praktikisht i detyroi palët e parisë që të merrnin pjesë në zgjedhje, tregoi para së gjithash dy gjëra. Së pari, këta pjestarë të parisë ende mendojnë si bajraktarët e prijësit katundarë, që duan pushtetin në zonën e tyre, por që nuk mendojnë për shtetin si pronë e shqiptarëve. Së dyti, ndërhyrja vendimtare e të huajve tregoi se kush është në kontroll të atij shteti.

Të huajt, përmes përfaqësuesve të tyre, demonstuan një front të përbashkët. Ata treguan se janë të zotët të shtyjnë parinë e Tiranës që të sillen në një mënyrë ose në një tjetër dhe ashtu siç duan ata. Kjo është një shenjë e qartë se përgjegjësia e të huajve tashmë është edhe më e madhe. Nëse të huajt ia arritën që t'i mbajnë bashkë të gjithë këta individë të përlyer e të diskredituar politikisht, atëherë pyetja shtrohet: pse nuk ndikojnë që të ndryshohet sistemi zgjedhor e kështu të mundësohet dalja e një klasë të re, që do të bëjë një politikë të re në të mirë të të gjithë shqiptarëve? Nga sjellja e tyre në të ardhmen e afërt mbas zgjedhjeve do të kuptohet edhe sa të interesuar janë, në veçanti, politikanët e BE-së dhe përfaqësuesit e tyre për shqiptarët.

Pragmatizmi katundar dhe çështja kombëtare shqiptare

Nuk duhet harruar se shteti shqiptar dhe paria e Tiranës nuk veprojnë në ndonjë vakum ndërkombëtar, veçanërisht në një rajon si Ballkani. Zgjedhjet lokale u zhvilluan në një kohë kur po vazhdon që të vendoset fati i Kosovës dhe, që është i lidhur pazgjidhshmërisht me të dhe i të gjithë shqiptarëve. Mirëpo, kjo çështje kombëtare ishte tërësisht e papërmendur, e padiskutuar, edhe pse gjendja në lidhje me Kosovën ka evoluar në drejtime jo të mira dhe është përkeqësuar. Kjo mungesë nuk është thjesht zgjidhje e bërë nisur nga pragmatizmi katundar, por edhe një plan afatgjatë i parisë së Tiranës.

Pragmatizmi katundar i parisë së Tiranës dhe i parisë dytësore, siç dëshmohet nga zallahahia e mbaszgjedhjeve, e minoi plotësisht mundësinë e ndërgjegjesimit të opinionit publik shqiptar në lidhje me çështjen kombëtare. Dhe kjo sjellje e qëllimtë çoi direkt ujë në mullirin e parisë. Duke u sjellë siç sillet, paria ia arriti të minojë edhe një herë çështjen kombëtare, bash në momentin kritik kur po nënshkruhen marrëveshje, që e bëjnë sovranitetin e shteteve ku jetojnë shqiptarët, edhe më të dyshimtë. Sjellja e parisë në lidhje me krizën e shtjellën që i ka përfshirë shqiptarët në Greqi, që së shpejti do të përfshijë edhe shqiptarët që jetojnë në Itali, është qartësisht e papërgjegjshme. Prandaj, nuk ka rëndësi se kujt i shërbejnë pjestarët individualë të parisë, por ka shumë rëndësi ajo që ata bëjnë. Dhe, veprimet që ata kryejnë me ndërgjegje të plotë janë tërësisht në kundërshtim flagrant me interesat e qytetarëve të vet.

Megjithatë, duhet theksuar fitorja e një numrit të konsiderueshëm votash nga parti të vogla. Për shembull PDIU, një formacion me bazë të ngushtë krahinore, e paraqiti veten si parti kombëtare e me interesa kombëtare. Kjo tregon se politika e identitetit kombëtar nuk është e vdekur.

Po ashtu, mbështetja publike që po merr *Aleanca Kuq e Zi*, veçanërisht në Shkodër e në Tiranë, është një shenjë e qartë se shqiptarët nuk janë të zhveshur nga ndjenja kombëtare, por mungon struktura politike që mund të mobilizojë këtë masë

votuesish në bazë të politikës së identitetit kombëtar.

Pse sillen shqiptarët në këtë mënyrë? Zgjidhja që shqiptarët po bëjnë është zgjidhje pragmatike sepse nuk shohin struktura e individë që të mbrojnë interesat e tyre. Kurdoherë që del një forcë politike, e cila synon të mbrojë idetë, vlerat, e interesat kombëtare dhe që nuk është e kompromentuar nga e shkuara e politikanëve në krye të saj, shqiptarët nuk hezitojnë që ta mbështesin. Dyfytësia e shqiptarëve, që në këtë pikë, mbështesin parinë antikombëtare, por edhe interesat kombëtare, është një tregues edhe i pasigurisë që kanë, e prandaj nuk rrezikojnë, ashtu edhe i pakënaqësisë që ndjejnë me gjendjen ku janë e nuk pajtohen me politikën e parisë.

Përfundim

Nga një anë, këto paradokse tregojnë se paria po vazhdon me konsekuencë rrugën e saj. Të huajt janë të detyruar që të marrin haptazi kontrollin e shtetit e të procesejeve, shenjë e qartë e rëndimit të situatës. Nga ana tjetër, këto paradokse tregojnë se ka një ndryshim në mendësinë e shqiptarëve. Duket se ka një masë qytetarësh, e cila nuk po pajtohet hapur me parinë dhe që është e gatshme që të mbështesë rrugëzgjidhje të tjera.

Gjendja për parinë është edhe më kritike se sa duket në sipërfaqe. Kjo masë, që duket se është pakica, në fakt është shumica shqiptare, që për shkak të presioneve mediatike e të gjithfarlojshme, nuk shprehet dhe po zgjedh që të konformohet me standardet e vendosura nga paria për sjelljen në politikë. Por, kjo nuk duhet të interpretohet sikur njerëzit nuk dinë se çfarë po ndodh. Kur të thuhet kjo spirale e heshtjes, gjendja do të shihet qartë e për atë që është. E, në mos tjetër, kjo është një tregues i qartë se paria e Tiranës nuk ka asgjë të sigurtë në sundimin e saj.

PARIA E TIRANËS DHE KATËR PROBLEMET POLITIKE TË PAZGJIDHSHME TË TRANZICIONIT

Në shtetin shqiptar, prania përcaktuese e parisë, si dhe roli i saj parësor në proceset politike, si edhe del nga shkrimet e përmbledhura këtu, janë fakte shoqërore të pamohueshme. Mirëpo, siç edhe është vënë në dukje në këtë përmbledhje, roli i saj parësor e përcaktues në vendimarrjen politike është gjithnjë i pasigurtë. Roli qëndror i parisë është i kërcënuar nga prania dhe roli që luajnë katër faktorë të rëndësishëm. Këto faktorë, në dukje jo aq të ndërlidhur, janë gjithnjë të pranishëm e të pamënjanueshëm në sistemin politik shqiptar. Në disa drejtime, këta faktorë e mundësojnë sundimin e parisë dhe, në se janë të pranishëm, në masën e duhur, janë të pranueshëm për parinë.

Por, në disa drejtime të tjera, forcimi i rolit të tyre e ka ndërlikuar gjendjen edhe për vetë parinë. Mund të thuhet se pamundësia e eliminimit të këtyre faktorëve e kërcënon, në mënyrë të përhershme, por edhe të pazgjidhshme, sundimin e parisë dhe oligarkinë e saj. Megjithatë, në gjendjen e tanishme, *mendësia katundare e kriminalizuar e shoqërisë, sistemi formal demokratik, ideologjia shtetformuese kombëtare*, si dhe *roli qëndror i shtetit* janë pengesa të fuqishme dhe të pazgjidhshme në zbatimin e planeve të parisë së Tiranës.

Rrethi vicioz i mendësisë katundare dhe të kriminalizuar të shoqërisë

Së pari, si edhe e kam shpjeguar këtu, *mendësia katundare*

dhe e kriminalizuar e shoqërisë, deri në një farë mase, është e dëshërueshme për parinë. Ngushtësia e mendësisë dhe përqëndrimi tek prona e vogël, si dhe frika e pandërprerë e njeriut me sjellje jo të ndershme, e lehtëson shumë sundimin e saj. Shoqëria fragmetarizohet e kontrollohet nga paria, që kështu zëvendëson shtetin e të drejtës. Duke u vënë në qendër të shoqërisë, paria formëson vlerat, mendësinë dhe e drejton procesin andej nga i intereson asaj. Pra, nga një anë, parisë i intereson që njerëzit të mos mendojnë më larg se sa pragu i shtëpisë së tyre, (koncepti mbisundues është, “larg vatrës sime”) apo më larg se sa kufiri i krimit që mund të kenë kryer. Kjo, d.m.th. që njerëzit të mos kenë mendësinë e një qytetari të interesuar për jetën publike e shoqërore në një shtet e shoqëri të caktuar. Në këtë mënyrë, mendësia e tyre e cunguar dhe ngushtësia e fushëpamjes së tyre, bën që ata të kenë një ide të shtrembëruar për realitetin ku jetojnë. Këta individë jetojnë me frikë nga paria dhe shteti i instrumentalizuar. Ata dhunohen nga paria që të mendojnë vetëm e vetëm për veten e vet. Duke mos parë zgjidhje tjetër, mandej e pranojnë gjendjen si të pandryshueshme. Prandaj, njerëzit që mendojnë kështu, sundohen më lehtë.

Nga ana tjetër, paritë gjithkund tolerojnë apo lejojnë, si një formë valvole çliruese shoqërore, praninë e sjelljeve kriminale që, formalisht, nuk janë të pranueshme nga morali shoqëror, por që nuk e rrezikojnë sundimin e parisë. Prostitucioni, droga, vrasjet, sherret, qe mandej kthehen në “gjak” midis fisesh, bandat që iu vënë gjoba dyqaneve, të fortët e lagjes e me radhë, janë elementë të nevojshëm të sundimit të saj. Paria i njez rrjetet e krimit, por, si paria, si institucionet e caktuara, i lënë të veprojnë, deri në një kufi të caktuar.

Por, kur shteti dobësohet ndjeshëm dhe strukturat e nëndheshme kriminale fuqizohen dhe arrijnë të veprojnë në mënyrë autonome prej parisë, atëherë sistemi i sundimit të parisë është i rrezikuar seriozisht. Veçanërisht, në ato raste, kur strukturat e krimit fuqizohen aq sa që synojnë dhe arrijnë që të përcaktojnë sjelljen dhe moralin në shoqëri, atëherë ato bëhen një problem i pazgjidhshëm për parinë. Arsyeja është se atje ku sjellja

kriminale është përcaktuese, nuk mund të vendoset një shtet i cili zbaton ligjet e vetë parisë e jo më një shtet i mirëfilltë ligjor.

Por, edhe vendosja e një shteti të instrumentalizuar, përmes të cilit paria ka monopolin e besueshëm mbi mjetet e dhunës e ligjin, është e pamundur në një shoqëri ku mbizotërojnë strukturat mafioze klanore e katundare. Në këto raste, monopolin e dhunës dhe të forcës e kanë strukturat e organizuara të nëndheshme kriminale. Këto janë të organizuara në nivele të ndryshme, që nga niveli familjar deri në nivel lokal. Ka struktura të organizuara në bazë të fshatit, si të Lazaratit, por edhe struktura të parisë që veprojnë në nivel shtetëror, si ato të kontrabandistëve, të klaneve politike si të Trustit të Gështenjave të Tropojës, apo të trafikantëve në nivel të qytetit si Vlora, që paralizojnë shtetin.

Pavarësisht nga parimi në bazë të të cilit formësohen, këto struktura do të luftojnë që të kenë përfaqësuesit e tyre në politikë. Kështu ka ndodhur, në të gjithë rastet, kur kartelet e trustet me mendësi kriminale e katundare nuhasin një shtet të dobët. Në rastin shqiptar, strukturat kriminale i kanë përfaqësuesit e tyre në politikën e Tiranës. Lidhja e tyre me parinë është jetike dhe e pazgjidhshme. Tashmë, strukturat kriminale janë bërë njësh me parinë politike dhe ndërvarësia midis tyre është e dukshme dhe e njohur në shoqëri.

Në këto raste, jo vetëm që strukturat kriminale dhe klanore e paralizojnë dhe e thyejnë shtetin, por ato e mbajnë parinë politike peng të tyre dhe e bëjnë atë pjesë të tyre, njëlloj si ato vetë bëhen pjesë simbiotike e saj. Autonomia në veprimtari dhe në strukturë, si dhe lidhja e gjakut garanton që strukturat e nëndheshme janë pakica me të vërtetë e organizuar dhe e lidhur për jetë a vdekje. Korrupsioni, mitmarrja, kërcënimi, vrasja, futja në politikë e pjestarëve, marrja e tenderave, shmangja e policisë e me radhë bëhen objektivat që i shtyjnë strukturat kriminale që të influencojnë në jetën politike.

Kur lidhja kriminale çimentohe edhe me lidhjen e gjakut, siç ndodh shpesh në shtetin shqiptar, atëherë struktura mafioze duket se është e papërballueshme. Familja e zgjeruar është bërthama me të vërtetë e organizuar dhe e lidhur për jetë a vdekje. Kjo nuk është

më një strukturë kriminale e organizuar thjesht për përfitim. Prandaj, edhe viktimat e parë është morali i duhur shoqëror. Shpesh, një dukuri e vërtetuar në raste e në vende të tjera, me afirmimin e strukturës mafioze e dukjen e pafuqisë së shtetit, thuhet brenda ditës, besnikëria e njerëzve kalon nga shteti inefektiv tek struktura mafioze. Problemi me besnikërinë e njerëzve është se, nuk ka rëndësi se çfarë mendojnë njerëzit në mendjen e tyre, rëndësi ka se si sillen. Por, prania e gjithkundgjindshme e strukturave mafioze përcakton edhe mënyrën se si mendojnë, si sillen dhe si veprojnë shqiptarët. Prandaj, ndonëse në mënyrë të natyrshme në shtetin shqiptar shumica dërmuese e shtetasve janë të etshëm për një jetë normale e të moralshme në sipërfaqe, duket sikur gjithkush mendon, sillet, e paragjykon si paria dhe tentakulat e saj të krimit të organizuar.

Një pari me mendësi shtetare dhe një sistem mafioz i konsoliduar, nuk mund të bashkëjetojnë me njëri-tjetrin. Njëra mendësi përjashton tjetrën. Por, në prani të strukturave kriminale, të mbrojtura e të kultivuara nga paria, problemi malcohet deri në atë pikë sa, me sundue, parisë i duhet që ose të kooptojë strukturat mafioze-klanore, ose që vetë të sillen si strukturat mafioze-klanore. Në të dy drejtimet që mund të ndiqen, e ka vetëm dy drejtime, mendësia kriminale del si përcaktuese e sjelljes së saj. Shteti, që do të jetë gjithnjë i dobët dhe inefektiv, do të përdoret sipas diktatit të mendësisë kriminale të klaneve mafioze të parisë.

Paria e Tiranës nuk i ikën dot këtij rrethi vicioz. Çka është edhe më keq, ajo është e lidhur ngushtë me strukturat kriminale dhe, është në shërbim të tyre por edhe në drejtim të tyre. Prandaj, strukturat kriminale mafioze janë të gjithkundgjindshme në shtetin shqiptar. Strukturat kriminale dhe mendësia që buron e i mban gjallë ato struktura, janë djepi ku po rigjenerohet edhe vetë paria sunduese. Sjellja kriminale është mënyra se si fitohet e mbrohet pasuria e saj dhe prej përfitimit buron edhe justifikimi i sjelljes kriminale, që është në thelb të mendësisë së saj. Morali i botës së krimit është morali sundues, i natyrshëm për parinë dhe tashmë i imponuar edhe mbi shoqërinë shqiptare. Ky moral kriminal është në thelb të mendësisë së parisë, por edhe të brezit të

ri të saj që po hyn në politikë. Në këtë pikë, paria sunduese nuk ka asnjë mjet, mënyrë, metodë, apo vullnet politik për t'u shkëputur nga mendësia kriminale dhe klanore.

Sistemi demokratik: problemi i zgjidhjeve të përkohëshme

Problemi i dytë i pazgjidhshëm i parisë është sistemi demokratik, që në shtetin shqiptar, nuk është tërësisht e formalisht nën kontrollin e vetë parisë. Paria e Tiranës, si të gjithë paritë, ka një lidhje tejet të komplikuar me demokracinë e me sistemin demokratik. Ka shumë përpjekje teorike, që janë munduar të pajtojnë qënien e parisë si shtresë që luan një rol shumë më të madhe se sa vota që hedh në një sistem demokratik. Po ashtu, ka disa interpretime që e shohin rolin e saj si një faktor vendimtar në një sistem demokratik funksional. Por, të gjitha këto përpjekje janë synojnë të legjitimojnë një formë të oligarkisë plutokratike në demokraci.

Në një sistem demokratik bashkëkohor, ku formalisht ndiqet parimi “një qytetar, një votë”, politika është shumë më komplekse. Paritë janë shumë të fragmentarizuara, mundësia e daljes së parive të tjera alternative është gjithnjë e pranishme, ideologjitë luajnë një rol gjithnjë të ndjeshëm dhe manipulimet e procesit politik janë të evidentueshme. Për më tepër, problemet e shumta mund të zgjidhen vetëm në mënyrë të përkohëshme. Shoqëria nuk kontrollohet më kaq lehtë nga paria, si në forma të ndryshme të autoritarizmit. Për shkak se nuk ka siguri se mund të kontrollohet mendja e të gjithë njerëzve, demokracia kthehet në një problem thuajse të pazgjidhshëm për parinë sunduese.

Pse e them këtë? Në një anë tjetër, paria do të kërkojë e do të luftojë që të imponojë strukturën e sistemeve politike, ekonomike, kulturore e shoqërore, që i shërbejnë më mirë asaj. Kështu, paria do të punojë për interesat e veta dhe shpesh, paria arrin që të minojë sistemin demokratik me një efektivitet maksimal. Mirëpo, paria kurrë nuk mund të ketë kontroll ligjor e të përplotë mbi proceset formale demokratike. Si pasojë, pavarësisht se paria mund ta kontrollojë sistemin dhe njerëzit, ajo duhet të përballlet

me rrezikun e përhershëm të humbjes së legjitimitetit.

Gjatë këtyre dhjetravjeçarëve të fundit, demokracia, si formë regjimi, ka evoluar shumë. Edhe pse një formë shumë e brishtë qeverisjeje dhe lehtësisht e manipulueshme, në vendet ku ajo merret seriozisht si demokraci kombëtare, në Izrael, Slloveni apo në Gjermani, demokracia, si formë e përzgjedhjes së udhëheqjes shtetërore e kombëtare, është një pengesë serioze në planet e gjithkujt. Rregullat e normat e sjelljes politike në një sistem demokratik janë pak a shumë të pranuarra gjerësisht. Nga një anë, edhe kur ka interpretime të ndryshme, presioni i jashtëm është gjithnjë i pranishëm. Nga ana tjetër, parisë *periodikisht*, *rregullisht*, e *masivisht*, i duhet miratimi dhe vota e popullit.

Por, që të dy këto aspekte, formalisht e ligjërish, janë jashtë kontrollit të plotë të parisë. Çdo përpjekje për të manipuluar këto aspekte mund të jetë e suksesshme. Por, në thelb, çdo përpjekje e tillë është përherë e jashtëligjshme dhe vetë suksesi i manipulimit të radhës nga ana e parisë është i përkohshëm. Prandaj edhe paritë që mëtojnë ta minojnë demokracinë në vendin e tyre veprojnë me shumë kujdes, si *skile*, prapa skenës. Në rastin shqiptar, paria e minon sistemin demokratik në nivelin politik, pa asnjë mëdyshje, hapur dhe me metoda kriminale. Mirëpo, me kohë, kjo do të çojë në diskreditimin e plotë të demokracisë dhe në vendosjen e sundimit të hapur oligarkik.

Atëherë, kundërvënia ndaj parisë do të jetë shumë më e qartësuar dhe strukturat që do të dalin do të jenë të mbështetura në ideologji, që i shohin njerëzit si të barabartë. Këto ideologji ndihmojnë që të mobilizojnë njerëzit, edhe në emër të vlerave demokratike, për të marrë kontrollin mbi shtetin nga paria sunduese. Lufta e parisë është e përqendruar kundër këtyre ideologjive dhe në kultivimin e një mendësie që e mban shoqërinë peng, çka arrihet qoftë përmes kultivimit të sjelljeve e të vlerave në funksion të interesave të ndërlidhura, qoftë edhe përmes strukturave kulturore tradicionale.

Prandaj, në analizimin e një shoqërie demokratike, siç janë përcaktuar që të jenë shqiptarët, e siç do të vazhdojnë që të jenë, duan-s'duan prijatarët e parisë, çdo përpjekje për të kuptuar

proceset politike dhe rolin e parisë në këto procese, nuk duhet që të zbërthejë e të përqëndrohet vetëm në raportet politikokoekonomike të parisë me popullin. Një vëmendje e madhe i duhet kushtuar edhe nivelit të kontrollit të saj ideologjik mbi shoqërinë, që me delegjitimimin e sistemit demokratik bëhet përherë e më i brishtë dhe më i vështirë për t'u ruajtur.

Ideologjia shtetformuese dhe kombëtariste

Së treti, lidhja e parisë me mendësinë që vë shtetin përpara interesave të shtresës është komplekse. Paria nuk mundet që të pranojë një mendësi e cila i shtyn njerëzit që të identifikohen me shtetin dhe me bashkësinë ligjore-politike, të cilën shteti ose e krijon, ose e mbron, ose e promovon. Ideologjia sunduese e kohës në Ballkan është nacionalizmi, d.m.th. një parim organizimi politik, që thotë se secili komb duhet të jetojë në shtetin e vet. Kjo është një mendësi që edhe po nuk u erdhi natyrshëm shqiptarëve, do të vijë si rezultat logjik i kundërvënies ndaj projekteve nacionaliste të shtet-kombeve fqinjë dhe i dështimit të parive të tyre. Shqiptarët mund të mos jenë nacionalistë, por do të bëhen të tillë ose do të asimilohen në kombet e tjera.

Paria ka punuar me konsekuencë që shqiptarët të mos bëhen nacionalistë. Problemi i saj është se paria kërkon që të ruajë kontrollin e saj të hekurt edhe mbi shtetin edhe mbi shoqërinë, siç e kishte gjatë sistemit të kaluar. Mirëpo, nuk ka shtet pa një komb të caktuar. Vetë paria është përballur me këtë problem disa herë në të shkuarën. Shqiptarët morën një shtet që nuk kishte komb të formuar dhe që, për më tepër, kishte një shumicë shqiptare që jetonte jashtë kufinjve të shtetit. Mirëpo, një nga postulatet e sprovuara të shtetformimit është se çdo shtet duhet të ketë a të krijojë kombin e vet. Kjo është karakteristika e shteteve, edhe moderne. Aty ku gjenden etni dhe kombe të formuara, paritë adaptohen. Romakët bëhen bizantinë. Aty ku nuk gjenden, kombet formohen prej shteteve. Ideja e Bizantit bëhet identiteti shtetëror grek. Kombet synojnë të kenë shtetet e tyre dhe shtetet punojnë që të krijojnë kombet e tyre. Paritë nuk kanë shumë zgjidhje. Edhe

paria enveriste u detyrua që të përdorte një formë të përcudnuar të patriotizmit shtetëror të veshur me ngjyra proletare e me tone kombëtariste. Ndarja e shqiptarëve, me një mur informativ, e mundësoi përpjekjen e parisë që, gjithsesi, u sprovua të ishte jo e suksesshme.

Problemi është se kombësia, do të marrë, pashmangshmërisht, thelbin e vet etnik-qtetar apo një karakter qtetar, që vendoset si mbishtresë mbi identitetin etnik. Shqiptarët nuk bëjnë përjashtim nga ky rregull. Prandaj, sado që të përpiqet paria që t'i shmanget idesë shtet-formuese kombëtare e të krijojë një identitet të ri, shqiptarët si popull nuk kanë shumë zgjidhje. Po të ishte paria e suksesshme, ajo mund t'i bënte të gjithë shqiptarët në shtetin shqiptar një komb të veçantë. Por, me që dështimet kanë qenë të njëpasnjëshme, ajo do të përfundojë duke i bërë shqiptarët që të kërkojnë zgjidhje të tjera.

Për shkak të rrethanave ku gjenden, shqiptarët duhet që të punojnë që të kenë shtet-kombin e tyre, ose duhet që t'i bashkëngjiten një kombi tjetër e të asimilohen. Rruga e asimilimit është thujse e mbyllur. Dështimi i projekteve asimiluese në vendet e tjera fqinje, ku edhe përkundër përpjekjeve të shqiptarëve për t'u bërë grekë e italianë, barrierat shoqërore e shtetërore janë të pakapërcyeshme, ia ka ngushtuar shumë zgjidhjet parisë. Edhe pse duket se paria ia ka arritur ta shmangë nacionalizmin shqiptar dhe ta bëjë të padëmshëm, shteti shqiptar është një shtet i ri dhe kombformimi është një proces që kërkon një kohë të gjatë. Popujt e kanë të gjithë kohën në dispozicion, por paritë e kanë kohën e sundimit të numëruar.

Roli qëndror i shtetit në shoqëri

Së katërti, politika, në një shtet me sistem të stabilizuar demokratik, ka edhe një dimension tjetër, që është parësor, edhe për forma të tjera të regjimit si oligarkia, teokracia apo edhe monarkia. Ky dimension është ruajtja dhe kultivimi i ekuilibreve stabilizuese në marrëdhëniet shoqërore. Ky objektiv arrihet kryesisht përmes vendosjes së një administrate shtetërore

me autonomi të theksuar nga shoqëria. Shteti, dhe lidhja e të gjithë shtresave me shtetin, bëhet emëruesi i përbashkët i një shoqërie. Shteti është i interesuar për ruajtjen e kultivimin e ekuilibreve shoqërore, sepse shteti e sheh shoqërinë përmes prizmit të interesave të veta. Natyrisht shteti janë njerëzit, janë qytetarët, por mbi të gjitha, ata që punojnë për shtetin, d.m.th., shtetarët. Pavarësisht nëse këta vijnë nga paria, apo janë të rritur në strukturat e shtetit, shtetarët vendosin interesin e shtetit mbi të shtresës nga vijnë, ata identifikohen me shtetin dhe punojnë për shtetin.

Institucionet funksionale autonome shtetërore, me të cilat një pjesë e parisë sunduese është e lidhur në mënyrë simbiotike, me kohë bëhen relativisht të shkëputur nga shoqëria. Arsyja për këtë autonomi të politikës e të shtetit që e promovon këtë lloj sjelljeje, është e dyfishtë.

Nga një anë është sistemi ndërkombëtar dhe natyra e përkatësisë në sistemin ndërkombëtar, ku vetëm shtetet njihen si njësi të sistemit. Roli i shtetit është qëndror, i pazëvendësueshëm, i dobishëm dhe i veshëm për çdo shoqëri të caktuar, si dhe për organizimin e funksionimin e duhur të saj. Shteti është njësi themelore e sistemit ndërkombëtar. Edhe kur nuk ka sovranitet të brendshëm si Somalia, shteti është në shoqërinë e shteteve, një grup i ngushtë në numër, me autoritet formalisht të pakufizuar, dhe në gjendje që të vendosë pengesa si në marrëdhëniet që vendos shoqëria e vet me shoqëritë e tjera, ashtu edhe të ndalojë ndërhyrjet e shteteve dhe të faktorëve të tjerë me peshë nga jashtë. Sistemi ndërkombëtar është i organizuar në mënyrë të tillë që të mbrojtë të drejtat e shteteve dhe sovranitetin e tyre. Edhe kur paritë vendosin që të heqin dorë nga drejtimi i shtetit, sistemi ndërkombëtar nuk i lejon që të shkojnë në rrugë të caktuara. Kjo mund të përkthehet edhe kështu: edhe nëse paria e shoqëria janë të kriminalizuara, shteti dhe shoqëria mund të izoloohen, mënjanohen dhe ndëshkohen, por shteti vetë nuk mund të shpërbëhet formalisht sepse nuk e pranueshme për shtetet e tjera në sistem. Po ashtu, me një pari të re, edhe ky shtet mund të ndërrojë drejtim dhe të marrë vendin që i takon në sistem.

Nga ana tjetër, zgjedhja e formës së regjimit është punë e brendshme e shtetit dhe e shoqërisë. Shteti shqiptar ka një formë regjimi demokratike. Formalisht e ligjërish, politika në një sistem demokratik është procesi i marrjes së vendimeve prej një bashkësie politiko-ligjore. Kjo bashkësi ligjore-politike duhet që, të paktën formalisht, në mënyrë të fshehtë dhe periodikisht, të pajtohet me programet që ofrohen e me vendimet që merren nga të zgjedhurit politikë e nga shtetarët e emëruar. Por përzgjedhja e drejtuesve të shtetit nuk presupozon ndrrimin *en toto* të administratës dhe imponimin e kontrollit të parisë mbi shtetin përmes mobilizimit të shoqërisë.

Si struktura më efektive e organizimit shoqëror, shteti ka interesin e vet, që nuk është as interesi i parisë, as ai i klaneve mafioze, as interesi i strukturave të nëndheshme. Shteti duhet të kujdeset për popullin dhe shtetasit edhe në nivelin e mirëqënies shoqërore. Po ashtu, për shkak se ka një numër strukturash politike që formalisht nuk pajtohen me të e me sjelljen e saj, si bie fjala, paria apo elita e shtresave që janë në fund të piramidës shoqërore, apo edhe segmente ideologjikisht të motivuara brenda vetë asaj, paria duhet që të bëjë të pamundurën për të ruajtur sundimin e saj. Paria mund të jetë e suksesshme gjithë kohën, por mjafton vetëm një dështim për ta kthyer gjendjen nga e brishtë apo e paqëndrueshme, në gjendje kritike.

Shteti janë njerëzit, por shtetarët kanë mendësi, vlera, dhe përparësi që janë të dallueshme nga ato të pjestarëve të tjerë të parisë e shpesh, që iu kundërvihen atyre. Ideologjia dhe mendësia e këtyre shtetarëve përcaktohet nga ky interes shtetëror. Identifikimi me shtetin, vendosja e shtetit në qendër të vendimmarrjes, bëhet një element i rëndësishëm, që informon edhe sjelljen e këtyre pjestarëve të parisë. Mbi të gjitha, struktura institucionale kushtëzon e formëson sjelljen e individëve, që tashmë funksionojnë si pjesë e strukturës dhe duke ndjekur normat e sjelljes shoqërore të kultivuara nga struktura.

Një element tjetër me peshë është ideologjia. Në thelb të marrëdhënies së pjestarëve të parisë me njëri-tjetrin qëndrojnë interesat e ngushta. Mirëpo, këto interesa vishen me një sistem

vlerash, që është shumë i qëndrueshëm dhe që e ngushton shumë hapësirën e veprimit të parisë. Për hir të nevojës së ruajtjes së legjitimitetit si dhe të bashkësisë, paria nuk mund të shkelë normat e vendosura të sjelljes. Çdo sistem politik është, ose i kontrolluar nga paria ose ka një pari që është në shërbim të një ideologjie të caktuar. Për shkak të shtërngesave ideologjike apo politike, në mjaft raste, paria sunduese nuk mundet që ta minojë hapur sistemin.

Por edhe një përafrim i tillë lë shumë elemente pa shpjeguar, sidomos në lidhjen e shtetit me popullin. Ka sklevër individualë, por nuk mund të ketë kombe sklevërish të vullnetshëm. Por, edhe sklevërit rebelohen kur nuk e kanë bukën e gojës. Shteti duhet të sigurojë të paktën minimumin e jetës dhe, në vende normale, shteti e bën këtë duke shkuar edhe kundër interesave të parisë. Çështja kryesore, pra, është se *thelbi i veprimit politik është shpërndarja e të mirave, në çdo formë që ato manifestohen, materiale apo shpirtërore, përmes përdorimit të autoritetit shtetëror*. Të mirat vijnë në formën e sigurive të ndryshme: të sigurisë së jetës së njeriut, të sigurisë së një jetë më të mirë, të sigurisë së nderit e të respektit të dinjitetit njerëzor. Këto arrihen përmes vendosjes së rendit të përshtatshëm shoqëror, që për një bashkësi të caktuar mundëson mbrojtjen e të mirave të tilla. Ajo që ka edhe më shumë rëndësi është edhe se kush i përfiton këto të mira dhe si përfitohen ato. *Qui prodit?* Për të perifrazuar titullin e një libri, politika bëhet për të përcaktuar se kush përfiton, kur e përfiton, çka përfiton dhe si e përfiton atë të mirë. Shembuj shumë të mirë për shqiptarët do të ishin Izraeli dhe Sllovenia, dy shtete ku punohet për popullin.

Herët a vonë, e mira e bashkësisë bëhet edhe objektivi i shtetit normal e modern. Paria duhet të futet në atë hulli, ku sukcesi i saj nuk e minon funksionimin e shtetit dhe përpjekjen e shtetit për të të siguruar besnikërinë e kombit, etnik apo qytetar, nuk ka rëndësi, po gjithnjë ndaj shtetit të vet. Pra, paria është e domosdoshme, sepse pa njerëz të aftë në pozita drejtuese e të veshur me autoritetin e nevojshëm, dhe me mbrojtje nga shoqëria që drejtojnë nuk mund të funksionojë një shoqëri komplekse moderne. Paria e mirëfilltë që i duhet, dhe që i shërben shtet-

kombit modern, është zyrtari intelektual, ekspert në fushën e tij dhe i kontrolluar deri në atë pikë sa nuk mund të dalë nga kornizat e kontrollit, që ushtrohet sistematikisht si nga segmentet e tjera të parisë, edhe nga shoqëria civile, e po ashtu, edhe nga populli vetë, në kornizat e një ideologjie të caktuar.

Ky rol qëndror i shtetit në të gjithë aspektet e jetës shoqërore i bie ndesh projektit të vetë parisë si shtresë. Prandaj, përpjekja për të kuptuar se çfarë ndodh në politikën e një shteti të caktuar, duhet të përqëndrohet edhe në analizimin e arsenalit ideologjik të përdorur nga paria sunduese për të fituar periodikisht, legjitimitetin e mbështetjen e popullit që sundohet prej saj. Ky dimension ideologjik ka në thelb të vet ideologjinë hegjemone apo sunduese, e cila e legjitimon strukturën e shpërndarjes të të mirave shoqërore, si dhe vetë rolin drejtues të parisë, edhe kur sjellja e saj është në kundërshtim me interesin shtetëror. Në një mënyrë a në një tjetër, po përmes këtij dimensionit ideologjik edhe shoqëria vetë arrin që të krijojë mekanizmin e mbrojtjes nga paria sunduese. Ky mekanizëm mbrojtës merr forma të ndryshme, por, gjithsesi, është i rrënjosur në ideologjinë sunduese apo hegjemone të kohës. Pra, bashkë me qartësimin e strukturës së pushtetit në një shoqëri, bëhet jashtëzakonisht shumë i rëndësishëm edhe kuptimi i kontekstit shoqëror dhe i ideologjisë sunduese të kohës ku zhvillohet veprimi politik. Argumentet që individët e veçantë përdorin për të analizuar e peshuar gjendjen e tyre, vlerat përcaktuese të kohës, sjellja e njerëzve në atë kontekst shoqëror, përparësitë që ata vendosin për veten e tyre, marrëdhëniet që ata ndërtojnë me njëri-tjetrin, janë të gjitha të përcaktuara ose të influencuara nga mendësia sunduese e kohës. Pra, kush përfiton çka, kur e përfiton e si e përfiton është e përcaktuar dhe e legjitimuar, më së pari, në nivel të mendësisë së shoqërisë, të asaj çka është e drejtë, e pranueshme, normale, dhe legjitime, në bazë të parametrave të ideologjisë sunduese, të vlerave e të moralit që buron prej saj.

Kriza shqiptare dhe rruga e daljes nga tranzicioni

Në përfundim, edhe po e pati paria sunduese kontrollin mbi çdo element të sistemit, gjithnjë ekzistojnë këto katër elemente që e vënë në dyshim sundimin e parisë. Por, paria kurrë nuk ka patur e kurrë nuk mund të ketë gjë të sigurtë në shtetin shqiptar. Për më tepër, problemi i pazgjidhshëm i parisë është se politika, në një sistem që formalisht e ligjërisht është demokratik, nuk është e nuk mund të jetë thjesht shprehje e sundimit përmes forcës e kontrollit të parisë dhe as një veprim funksional i lidhur thjesht me përcaktimin e asaj që përfitohet prej parisë.

Por, atëherë, në një nivel praktik, cili është mësimi që duhet të nxirret? Çfarë rruge duhet të ndiqet për të dalë nga kriza e pritshme, që duket se është e pashmangshme? Në lidhje me rrugën që duhet të ndiqet, nga kjo pikë e në vazhdim, në thelb, mendimi im është se zgjidhjet janë dy.

Njëri drejtim është që do të vazhdojmë që të ecim në këtë rrugë eksperimentale. Kështu, do të shkojmë në fundin e saj logjik e të frikshëm, atë të një shoqërie të kriminalizuar e jonormale, sepse edhe tashti jemi edhe shumë më keq se *Gomorra* e Saviano. Kjo rrugë e lehtë për t'u ndjekur e sheh shtetin shqiptar gradualisht të kthyer në Haitin e Evropës e, në rastin më të mirë, në një *quartiere napoletano*, apo në atë që në lingua mafiosa njihet si *borgata*.

Drejtimi tjetër është që të ndërrohet rrugë sa më shpejt që të jetë e mundur. Prandaj, me kujdes e përkushtim shoqëror, duhet që të krijohet mundësia e përmirësimit të gjendjes. Kjo do të jetë rruga më e mundimshme. Por, në të njëjtën kohë, kjo është edhe rruga e vetme që duhet ndjekur për të siguruar të ardhmen që duhet.

Ky ndryshim i domosdoshëm shoqëror nuk mund të bëhet nga paria sunduese apo nga këpurdhat partiake, nga shoqatat joqeveritare e nga strukturat e dyshimta të interesave të tjera të organizuara, që gëlojnë në Tiranë e që janë pjesë e strukturave të parisë. Këto struktura diversive, janë thjesht zgjatje të krahëve të parisë sunduese dhe janë në shërbim të saj. Kjo rrugë kërkon angazhimin e një grupimi të ri njerëzish, të papërllyer e me

përkushtim ndaj kësaj zgjidhjeje. Kjo rrugë kërkon një strukturë të qartë, ideologji e rrugëzgjdhje të mbështetura në rastet më të suksesshme të ndërtimit të shoqërive të ndryshme bashkëkohore të mbështetura në projekte modernizuese.

Mendimi im është se rruga ideale ku duhet të ecim është rruga e normalizimit të shoqërisë si një bashkësi me identitet të qartë kombëtar, të vendosjes së ekuilibreve të duhura shoqërore, dhe të ndërtimit të strukturave shtetërore që i kontribuojnë ruajtjes e kultivimit të vlerave morale. Kjo arrihet përmes zbatimit të një projekti shoqëror, që i zgjidh problemet e shumta që janë vënë në dukje në këtë përmbledhje. Zgjidhja vjen duke i eliminuar tepritë e deritanishme, por edhe duke krijuar mundësi të reja që do të jenë në të mirën e përgjithshme. Ky projekt duhet vënë në jetë në mënyrë metodike, duke mbajtur parasysh kushtet specifike shqiptare, dallueshmëritë kulturore të popullit tonë, mundësitë tona ekonomike, burimet njerëzore dhe interesat jetike kombëtare. Gjithashtu, për shkak të rëndësisë së dorës së parë që do të kenë në këto procese, duhet që të mbahet parasysh edhe roli dhe vendi i interesave të huaja që janë të pranishme si aleatë strategjikë, por edhe si shtet-kombe që kanë minoritetet e tyre në shtetin shqiptar.

Do të ketë kundërshtime nga të gjitha anët, shpesh nuk do të mbrihet synimi i dëshirueshëm, por duhet që të bëhet më e mira që mund të bëhet. Rruga është e gjatë dhe kundërshtitë e pritshme nga shoqëria do të jenë të fuqishme. Këto do të jenë të lidhura me parinë, me strukturën shoqërore që është krijuar, me mendësinë sunduese dhe, mbi të gjitha, me shkallën e jashtëzakonshme të kriminalizimit aktual të shoqërisë shqiptare.

Që kjo rrugë të jetë e suksesshme, ka nevojë për një rindërtim të menduar mirë të strukturave e të institucioneve shtetërore, për një afirmim të vlerave e të identitetit, për një përparësi të interesit shtetëror e kombëtar dhe të vënies së interesave të bashkësisë mbi interesat personale të parisë. Kjo rrugë është rruga e ndërtimit të shtetit kombëtar, e stabilizimit të sistemit demokratik dhe e strukturave partiake. Kjo është rruga e vendosjes së një ekonomie tregu të institucionalizuar, e një administrate që zbaton ligjin

dhe e kultivimit të një shoqërie civile shekullare që kontribuon aktivisht në jetën publike. Kjo është rruga e zhvillimit dhe e të lulëzimit të vlerave morale, që duhen për të kultivuar një shoqëri të shëndoshë, të begatë dhe bashkëkohore.

Më në fund, por më e rëndësishmja, baza e suksesit për një tranzicion është *njësimi kombëtar*, formësimi i ndërgjegjes kombëtare, d.m.th. një identitet i përbashkët i shtetasve. Në rastin shqiptar, për shkak të natyrës specifike të problemit, tranzicioni shqiptar nuk mund të shihet i shkëputur nga çështja kombëtare shqiptare. Zgjidhja e çështjes kombëtare shqiptare është parakushti për suksesin e çdo reforme dhe zbatimin e çdo projekti, që do t'i vendosë proceset në hullitë e duhura.

BOTIMET PRINCI

FILOZOFI | KRITIKË | POLITOLOGJI

- ARSHI PIPA..... *Kritika, Ese 1940-1944*
ARSHI PIPA..... *Për Migjenin, Tri Esse*
ARSHI PIPA..... *Montale dhe Dante (Një monografi kritike)*
ARSHI PIPA.. *Stalinizmi Shqiptar: Aspekte Ideopolitike (ribotim)*
ARSHI PIPA..... *Politika e Gjuhës në Shqipërinë Socialiste*
ARSHI PIPA.. *Skicë mbi konceptimin e jetës plotësuar me Mbi Gjenium*
ANTON NIKË BERISHA..... *Vepra letrare e Martin Camajt*
ARSIM SPAHIU..... *Gjuha e epirotëve të vjetër*
BARDHYL UKCAMAJ..... *Shqiptarët në Qytetërimin Perëndimor*
ERICH FROMM..... *Arti i të dashuruarit*
LEON BATTISTA ALBERTI..... *Mbi Skulpturën*
LEON BATTISTA ALBERTI..... *Mbi Pikturën*
LOUIS SLOBODKIN..... *Skulptura: Parimet dhe Praktika*
ZEF PACI..... *Fotografia si ritual: Marubi*
BORIS GROYS..... *Në mungesë të horizontit (në proces)*

MEMUARISTIKË | ROMAN | DRAMË

- ALLAN GRAUBARD..... *Roma Amor, Gruaja Bombë / Sade*
LISANDRI KOLA..... *Saga e një dite*
NASHO JORGAQI..... *Migjeni në kujtimet e bashkëkohësve*
URAN KALAKULLA..... *Për bashkëvuajtësit e mi nën komunizëm*
VIRION GRAÇI..... *Litari dhe Lamtumira*
ALEKSANDR SOLZHENITSYN..... *Arkipelagu Gulag (në proces)*

POEZI

- MUHAMET ADEMI..... *Liria e fijos se barit*
PRIMO SHLLAKU..... *Lule nate*
ROMEO ÇOLLAKU..... *Heshtjen duke gërmuar*
ZEF ZORBA..... *Buzë të ngrira në gaz*
FREDERIK RRESHPJA..... *Duke kërkuar Itakën (në proces)*